UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE

Vështrim krahasues mbi veçantitë leksiko-semantike në disa vepra në prozë të I. Kadaresë në variantet shqip dhe gjermanisht

Punim për gradën shkencore “Doktor”

Doktorante
MA. Gladiola Sadiku

Udhëheqës shkencor
Prof. Dr. Tomorr Plangarica

Maj 2014

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE

Vështrim krahasues mbi veçantitë leksiko-semantike në disa vepra në prozë të I. Kadaresë në variantet shqip dhe gjermanisht

Punim për gradën "Doktor i Shkencave"
në Gjuhësi/Didaktikë

KOMISIONI

1. **Porf. Dr. Raul Lilo (Kryetar)**
2. **Porf. Dr. Brikena Kadzadej (Oponente)**
3. **Prof. Dr. Nonda Varfi (Oponent)**
4. **Prof. Dr. Emine Teichmann (Anëtare)**
5. **Prof. Dr. Mustafa Karapinjalli (Anëtar)**

FALENDERIME

Me mirënjohje të thellë dua të falënderoj përzemërsisht prof. dr. Tomorr Plangaricën për ndihmën e tij të vyer, këshillat, sugjerimet, durimin dhe motivimin e përhershëm që më ka dhënë në forma të ndryshme, duke më orientuar dhe drejtuar hap pas hapi gjatë gjithë përgatitjes së këtij punimi. Vërejtjet dhe sugjerimet e tij kanë luajtur, pa dyshim, një rol të patjetërsueshëm në hartimin e kësaj teze.

Prof. dr. Emine Teichmann-in e falënderoj përzemërsisht për leximin e kujdesshëm dhe sugjerimet me vlerë.

Falenderoj kolegët e mi të Seksionit të Gjermanishtes në universitetin "A. Xhuvani", Elbasan dhe, po ashtu, ata të Departamentit të Gjermanishtes në Universitetin e Tiranës për mbështetjen dhe nxitjen që më kanë dhënë përgjatë gjithë kohës së përgatitjes së këtij punimi; në mënyrë të veçantë dua të falënderoj prof. dr. Brikena Kadzadej, për mendimet me vlerë që më ka dhënë për aspekte të ndryshme të objektit tim të studimit.

Së fundmi, dua të falënderoj familjen time, veçanërisht vajzat e mia dhe burrin tim, që më mirëkuptuan dhe jetuan vijimisht me shqetësimet e mia intelektuale, duke qenë në këtë mënyrë nxitja pa kushte e synimeve të mia.

PASQYRA E LËNDËS

Hyrje.....i
0.1 Përligjja e punimit.....i
0.2 Objekt i studimit dhe hipotezat e tij..... iii
0.3 Metodologjia dhe struktura e punimit.....iv
Kreu 1 Aspekte leksiko-semantike në diskursin letrar 1
1.1 Përcaktimi i kategorisë së kuptimit.....1
1.1.1 Teoritë mbi kuptimin / domethënien.....1
1.1.1.1 Strukturalizmi dhe gramatika gjenerative.....1
1.1.1.2 Konceptet që e përcaktojnë kuptimin si rezultat të aktit të komunikimit.....3
1.1.1.3 Kuptimi si rezultat i proceseve njohëse, mendore.....5
1.1.2 Konotacionet.....6
1.2 Presupozimet.....7
1.3 Përkufizimi i kuptimit si dije semantike.....9
1.3.1 Përcaktimi i specifikës së dijes semantike në raport me llojet e tjera të dijeve 10
1.3.2 Frame –model.....12
1.4 Gjuha, proceset konjitive, emocionet.....12
1.4.1 Emocionet si sisteme njohëse dhe vlerësimi.....13
1.5 Koncepti, dija enciklopedike, emocionet.....16
Kreu 2 Trajtimet teorike mbi kuptimin e teksit 18
2.1 Trajtimet teorike mbi kuptimin dhe përmbajtjen e tekstit 18
2.1.1 Semantika e tekstit.....20
2.2 Veçantia e tekstit letrar dhe sfondi sociokulturor 22
2.2.1.1 Përcaktimi i kategorisë së sfondit sociokulturor si pjesë përbërëse e kuptimit 23
2.2.1.2 Sfondi sociokulturor dhe ambiguiteti (dykuptimësia).....24
2.2.2 Teksti, sfondi sociokulturor dhe konteksti.....25
2.2.2.1 Roli i kontekstit sociokulturor në prodhimin dhe rrokjen e kuptimit të tekstit letrar 26
2.2.2.2 Konteksti sociokulturor në tekstet historike.....27
2.2.3 Lokalizimi i informacionit sociokulturor në kategoritë gjuhësore 28
2.2.3.1 Aktivizimi i njohurive metagjuhësore.....28
2.2.3.2 Leksiku i gjuhës së përditshme.....28
2.2.3.3 Arkaizmat dhe historizmat.....30
Kreu 3 Dukuri leksiko-semantike dhe pragmatike në veprat "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Darka e gabuar", "Prilli i thyer".....32
3.1 Analizë e dukurisë së sfondit sociokulturor duke u mbështetur në disa vepra në prozë të I. Kadaresë.....32
3.1.1 Qëllimi i analizës 32
3.1.2 Metodat e analizës.....33
3.1.3 Fondi leksikor – bartës i informacionit sociokulturor në prozën e Kadaresë.....33
3.1.3.1 Fjalë të vjetruara 33
3.1.3.1.1 Arkaizmat.....34
3.1.3.2 Fjalët e reja 39
3.1.3.3 Fjalët e huaja (Huazimet) 44
3.2 Dritëhijet semantike: Përdorimi i teorisë së lakunave në analizën e romanit „Prilli i thyer".....47

3.2.1 Qëllimi 47
3.2.2 Dy fjalë mbi etnopsikolinguistikën 49
3.2.2.1 Aspekte kulturore të psikolinguistikës 49
3.2.3 Sqarim i koncepteve. Aparati konceptual 50
3.2.4 Atelieja e kulturave dhe ligjërimeve të ndryshme në romanin “Prilli i thyer” 50
3.2.5 Ligjërimi si kulturë 54
3.2.6 “Prilli i thyer nga qasje te ndryshme të teorisë së traduktologjisë 57
3.2.6.1 “Prilli i thyer” nën dritën e teorisë “skopos” 57
3.2.7 Përkthimi 62
3.2.7.1 Procesi i përkthimit 63
3.2.7.2 Përkthimi si komunikim ndërkulturor 64
3.2.8 Elemente kulturore në romanin “Prilli i thyer” dhe invariancat dhe ekuivalencat gjegjëse në gjermanisht 65
3.2.9 Romani “Prilli i thyer” një lakunë e tërë 68
3.2.9.1 Lakunat si sinjale të veçorive specifike kulturore në përqasjen e romanit të Kadaresë me versionin në gjermanisht 72
3.2.9.2 Klasifikimi i lakunave në “Prilin e thyer” 74
3.2.9.2.1 Lakuna leksikore në “Prillin e thyer” 75
3.2.9.2.2 Lakunat gramatikore në “Prillin e thyer” 79
3.2.9.2.3 Lakuna stilistike në “Prillin e thyer” 81
3.2.9.2.4 Lakunat kulturore në „Prillin e thyer“ 84
3.2.10 Eliminimi i lakunave në tekstin e përkthyer në gjermanisht të romanit „Prilli i thyer“ 86
3.2.11 Leksiku kanunor në romanin”Prilli i thyer”dhe në gjegjësen në gjermanisht 89
3.3 Në kufijtë e gjuhës. Funksioni ikastik i ligjërimit në romanin „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ 96
3.3.1 Funksioni ikastik i gjuhës në tekstin letrar 96
3.3.2 Funksion ikastik i gjuhës që nga lashtësia 98
3.3.3 Pasthirrmat dhe onomatopetë 102
3.3.4 Efekte ikastike-evokative në “Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ 103
3.3.4.1 Peizazhe natyrore 104
3.3.4.2 Peizazhe tingullore 118
3.3.4.2.1 Tabloja 1 118
3.3.4.2.2 Tabloja II 124
3.3.4.2.3 Plaka Nicë - një klithmë dëshpërimi 131
3.3.4.3 Portrete 136
3.3.4.4 Peizazhe psikologjike 140
Kreu 4 Metaforat në romanet „Darka e gabuar“ dhe „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ 145
4.1 Metaforat në tekstet letrare 145
4.1.1 Vlerat njohëse dhe estetike të metaforave 145
4.2 Të kuptuarit e metaforave si fenomen i pikëtakimeve të të dy analizave: semantikore dhe pragmatike 149
4.2.1 Identifikimi i shprehjeve me kuptim metaforik, hapi i parë i analizës 150
4.2.2 Parafrazimi i kuptimit metaforik si ndërthurje e analizave semantike dhe pragmatike 152

4.2.3 Komponente kuptimore emergente si pjesë e përmbajtjes së thënieve 154
4.3 Modeli i botës së tekstit dhe komponente konceptuale emergente në procesin e të kuptuarit të metaforave në „Darka e gabuar“ 155
4.3.1 Teoria konjitive e të kuptuarit të metaforave në tekst..... 156
4.3.1.1 Kuptimi i metaforave dhe modeli i realitetit tekstor..... 157
4.4 Metaforat në “Darka e gabuar” të Kadaresë dhe gjegjëset e tyre në gjermanisht..... 159
4.4.1 Evidentimi i marrëdhënieve të ekuivalencës së vlerave formale-estetike të metaforave në variantet shqip dhe gjermanisht të romanit “Darka e gabuar” 160
4.4.1.1 Ekuivalencë e plotë..... 160
4.4.1.2 Ekuivalencë e pjesshme..... 161
4.4.1.2.1 Metafora, me shkallë figurshmërie më të lartë në gjuhën pritëse 162
4.4.1.2.2 Metafora, shkalla e figurshmërisë së të cilave është më e ulët në gjuhën pritëse..... 164
4.4.1.2.3 Zhvendosja e figurshmërisë 173
4.4.1.3 Metaforizimi 178
4.4.1.4 Çmetaforizimi..... 181
4.5 Somatizmat në veprën e Kadresë dhe ekuivalentet në gjermanisht..... 184
4.5.1 Frazeologjizmat me pjesë të trupit në romanet “Darka e gabuar” dhe Gjenerali i ushtrisë së vdekur” 186
4.5.1.1 Somatizmat në „Darka e gabuar“ dhe „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ 186
4.5.1.1.1 Metodologjia e analizës..... 188
4.5.2 Somatizmat me pjesë të trupit të njeriut *gojën*..... 189
4.5.3 Somatizma me syrin..... 193
4.5.4 Somatizma me gjymtyrë përbërëse *dorën*..... 203
4.5.5 Somatizma me gishtin..... 205
4.5.6 Somatizma me këmbë..... 206
4.6 Frazeologjizmat me shpirtin dhe mendjen..... 210
4.6.1 Frazeologjizma me gjymtyrën emërore *shpirt*..... 211
4.6.2 Frazeologjizma me gjymtyrë emërore *mend/mendje*..... 215
Përfundime të përgjithshme..... 223
Bibliografia..... 227

Hyrje

0.1 Përligjja e punimit

Proza e Kadaresë është ndër ato vepra që me ngarkesën intelektuale, abstraguese dhe emocionale, dhe me forcën ngjitëse të jashtëzakonshme, është shkëputur nga rrafshi i parë i rruzullit tokësor në gjuhën e të cilit është shkruar, për të qarkulluar në orbitën qiellore të letërsisë gjithësore.[1] Edhe Plantey, kryetar i Akademisë së Shkencave Politike dhe Morale të Francës, në ceremoninë e pranimit të shkrimtarit në këtë institucion në fjalimin e mbajtur me këtë rast, i vlerëson vlerat e veprave të Kadaresë të çmuara, me një domethënie të fuqishme dhe të thekshme në të gjithë botën.[2]
Kjo gjithëkohësi që nënkupton qenie jashtë kohës dhe jashtë hapësirës, funksionim të saj në hapësira dhe kohëra të pakufishme ka qenë shtysa e parë që na nguci të studiojmë veprat e Kadaresë, t'i bëjmë ato objekt hulumtimi në një punim si ky i yni, i cili, para së gjithash, është punim përqasës.
Nga ana tjetër Kadareja, si rrëfimtar, rrëfen dhe shkruan në radhë të parë për shqiptarët. Ai e lidh krijimtarinë e tij me truallin e vet amtar shoqëror, psikologjik, emocional dhe letrar. Krijimtaria e tij është fryt i vetëdijes shqiptare, i kulturës shumëshekullore dhe i etnosit të lashtë shqiptar. Ai përvijon në krijimtarinë e tij modelin e një shoqërie të formësuar nga përvoja, kultura e përbashkët e komunitetit shqipfolës, model i cili në funksionin shenjues dhe pasqyrues u nënshtrohet nga ana tjetër zhvillimeve dhe ndryshimeve të përvojave. Kjo do të thotë që në veprën e tij gjëllijnë Shqipëria dhe shqiptarët, që janë objekt frymëzimi, dashurie, vuajtjeje dhe përvuajtjeje, krenarie, himnizimi, adhurimi. Por, nga ana tjetër, edhe kjo lëndë është pjesë e një trualli gjithënjerëzor, që ndikon mbi objektin, kulturën shqiptare. Edhe modele të përvojave joshqiptare përthyhen dhe pasqyrohen në prizmin e përvojës në truallin amtar, ato dashur pa dashur bëhen bartëse të gjurmëve të përvojës amtare. Kjo *ndërsjelltësi* gjuhë - kulturë amëtare - kulturë gjithënjerëzore - krijimtari artistike përligj dhe njëkohësisht drejton edhe pikëvështrimet, qasjen tonë ndaj temës. Sepse, teksti, më së shumti teksti letrar, është pikëtakimi mes gjuhësisë së sotme dhe letërsisë, është një produkt gjuhësor, një formë e veçantë diskursive në procesin e komunikimit e në ndriçimin e vlerave, vetive dhe karakteristikave më të shumta të tij ndihmojnë dhe ndikojnë prurjet dhe konceptet e reja të gjuhësisë, si, thënia, diskursi/përftesa ligjërimore, situata komunikative, situata e të thënit.[3]
Kjo mënyrë konceptimi e tekstit implikon edhe një metodologji të re në analizën e teksteve letrare, e cila nuk mjaftohet vetëm në inventarizimin e mjeteve shprehëse, teknikave të përftimit të figuracionit, por edhe „kushtëzimeve kontekstuale kulturore e intelektuale në përzgjedhjen dhe përpunimin e mjeteve gjuhësore, duke synuar drejt një translinguistike."[4] Një qasje si kjo kushtëzon padyshim objektin e punimit i cili, para së gjithash, rreh të zbulojë lidhjet dhe kushtëzimet leksiko-semantike të tekstit kadarean nga dukuria e sfondit sociokulturor, i cili ngjiz veçanësi për secilën gjuhë (në rastin që hetojmë shqip-gjermanisht) në kategoritë gjuhësore të lokalizuara, por edhe në përftesa të krijuara nga stili kadarean.

[1] Shih, Kuçuku, Bashkim, *Kadare në gjuhët e botës*, Onufri, 2000, f. 10.
[2] Shih, po aty, f. 12.
[3] Shih, Plangarica, Tomorr, *Mbi lidhjet e gjuhësisë me letërsinë në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe letërsisë*, f. 6.
[4] Shih, po aty, f. 7

Lidhja gjuhë-kulturë-letërsi, korrespondenca kategori gjuhësore tipa-ontologjikë, qasja sipas së cilës përkthimi është një transferim interkulturor, që sharton elemente të një kulture në një kulturë tjetër bëhet edhe më evidente nëse përqasim veçanësi të veprave të tilla, siç është „Prilli i thyer“ i Kadaresë që si tharm të ngjizjes së tyre kanë një dukuri unikale për kombin shqiptar, gjakmarrjen. Kjo përqasje parakupton edhe vetëkupton edhe hetimin e dukurisë së lakunave, që do të na ndihmojnë në analizën semantike të varianteve shqip dhe gjermanisht. Dritëhijet semantike të veprës mund të zbardhen nën qasjen e teorisë së lakunave.

Vlerat e një teksti letrar nuk mund të përcaktohen vetëm nga kuptimet, domethëniet, ngërthimet, referimet në kontekste të emetuara nga shenjat gjuhësore, shenjuese dhe pasqyruese të realiteteve jashtëgjuhësore, por edhe nga përftesa dhe instrumente të tilla jashtë elementeve të kuptimit, që lidhen me një funksion tjetër të gjuhës. Brenda sistemit të gjuhës së ndërtuar me fjalë dhe fjali të kuptimshme ekzistojnë materiale dhe mundësi, që të organizuara, ndikojnë në forcën shprehëse të thënieve, pa u përfshirë në funksionimin e zakonshëm të njësive gjuhësore leksikore. Kështu ato rrezikojnë të dalin jashtë sistemit. Dukuri dhe mjete të tilla, siç janë ato që lidhen me tingujt, grupet e tingujve që shenjojnë e shprehin drejtpërdrejt zhurma e dukuri të tjera të realitetit, pa ndërmjetësimin e kuptimit, p.sh., onomatopetë, fjalët onomatopeike, pasthirrmat, aliteracioni, forca ikastike e të cilave lidhet me aftësinë e veçantë evokuese, paraqitëse, vizatuese të mjeteve gjuhësore, u largohen funksioneve leksikore-gjuhësore dhe bien në një terren kufitar, që është vështirë të përcaktohet. Përshkrimi dhe analiza e mjeteve të tilla, e mbështetur në funksionin ikastik të shenjave gjuhësore, ndihmon në zbulimin e mesazhit të tekstit. Vepra “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, vepër që i dhuroi shkrimtarit njohje në qerthullin e letërsisë botërore, që sjell risi për shkak të temës së trajtuar – estetizimit të një tabuje letrare, siç është ajo e zhvarrimit, si edhe ndërtimit të një hapësire letrare të paparë, në të cilën ku jeta dhe përtejjeta kalojnë natyrshëm, si edhe për shkak të llojit të shestimit pasojë-pasojë[5] – është intriguese për të ndërmarrë një analizë të përftesave dhe instrumenteve përtej kufijve të gjuhës që mbështeten te variacioni tingullor, te organizimet tingullore, te lidhja e tingujve me kuptimet.

Në ndërtimin e realitetit tekstor, metaforat kanë padyshim një rëndësi të madhe; ato organizojnë një botë jo konvencionale, pikërisht nga mosrespektimi i rregullave konvencionale të gjuhës. Metaforat janë mjet organizues me funksion drejtues dhe karakter modelues në skicimin e botës tekstore, të cilat padyshim nuk mund të gjykohen me aparatin e logjikës së koncepteve të vërtetësisë apo jovërtetësisë.[6] Në aktin e ligjërimit poetik, ku gjuha nuk është pasqyrim i realitetit statik, por një përafri drejt botës që ndryshon, metaforat ndërtojnë një realitet tekstor, duke evidentuar në këtë mënyrë një ndërsjelltësi në marrëdhëniet midis ligjërimit poetik dhe ligjërimit real, pikërisht, sepse janë një krijim poetik që e ngërthejnë (rrekin të kapin) realitetin me karakterin e tij ndryshues. Të trajtuara në këndvështrimin konjitivist jo si figura letrare, por si mënyrë e njohjes, pikëmbërritje e proceseve të të menduarit në kërkim për njohjen, ato paraqesin interes për studim, sepse jo vetëm dëshmojnë vlera artistike të veprës, por edhe sepse si mjet dhe mënyrë shenjimi i realiteteve të panjohura

[5] Shih, Kuçuku, Bashkim, *Kadare në gjuhët e botës*, Onufri, 2000, f. 16.

[6] P. Ricoeur propozon përkundrejt një “verite unnivoque” të kategorive “e vërtetë – e gabuar” të logjikës, një konceptim shpërfillës ndaj këtyre kategorive të ligjërimit metaforik: metafora është një lindje, një realitet dinamik në zgjerim të vazhdueshëm. Shih, Ricoeur, Paul *Die lebendige Metapher*, München, Fink, 1986, f. 19.

përmes të njohurave ngjizin veçanësi në secilën gjuhë. Përqasja e metaforave në gjuhë të ndryshme ndriçon edhe diferencat në modelet gjuhësore.

Vepra dhe krijimtaria e Kadaresë ka qenë objekt i shumë studjuesve vendas, por edhe të huaj. Por, trajtesat, studimet më të shumta kanë rrahur të evidentojnë vlerat artistike të veprave të Kadaresë, të përshkruajnë personazhe, t´i përqasin ato me figura të tjera të letërsisë botërore. Ndër studimet e pakta, të cilat janë fokusuar në vlerat gjuhësore, stilistikore të Kadaresë mund të përmendim punimin e zonjës E. Sadiku.[7] Megjithatë edhe ky punim, për shkak të diferencës në kohë me qasjet e reja teorike mbi tekstin letrar, nuk përdor metodologjitë dhe kahjet e reja në analizën e teksit letrar. Ai është një pararendës i studimeve të sotme, pasi në të gjenden, edhe pse në mënyrë intuitive, disa gjurmë të teorizimeve dhe metodologjive të sotme mbi tekstin.

0.2 Objekt i studimit dhe hipotezat e tij

Objekt studimi i këtij punimi është evidentimi dhe përqasja e veçorive leksiko-semantikore të prozës së Kadaresë në korpuse, si "Prilli i thyer", Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Darka e gabuar" e më gjerë dhe gjegjëseve të tyre në gjermanisht. Objekti i punimit parakupton shqyrtimin e konceptimit të tekstit letrar në qasjen e teorive të reja gjuhësore, e kuptimit të tij, shqyrtimin e lidhjeve që vendos ai me kontekstin sociokulturor, me përftesa dhe instrumente jashtë kufijve të gjuhës të mbështetura në organizimet tingullore, në simbolizmin tingullor,[8] por edhe përqasjen e tyre me gjegjëset në gjuhën gjermane, për të dëshmuar lidhjet, ndërsjelltësitë gjuhë-kulturë, gjuhë-njohje-shenjim.

Gjatë hulumtimit dhe përshkrimit të objekti të studimit, jemi orientuar nga hipotezat e mundshme që përvijoheshin natyrshëm në përballjen me atë objekt studimi, të cilat na imponuan trajtimin pa mëdyshje të çështjeve të tilla, si:

- Lidhjet kuptim, procese konjitive, dije semantike, enciklopedike, model-konfigurim dijesh, lidhjet emocione-njohje-gjuhë.
- Kushtëzimet tekst letrar, kuptim/domethënie teksti nga sfondi sociokulturor.
- Lokalizimi dhe kategorizimi i njësive bartëse të sfondit sociokulturor në veprat e Kadaresë.
- Lidhjet lakuna gjuhësore, lakuna kulturore me raportet kulturë-gjuhë në "Prillin e thyer".
- Kategorizim i përftesave dhe instrumenteve që lidhen me kombinimet e qëllimshme tingull-kuptim në zbërthimin e mesazhit të veprës "Gjenerali i ushtrisë së vdekur".
- Evidentim dhe kategorizim të grupit të metaforave që paraqesin probleme në përkthim.
- Evidentim i koncepteve universale dhe të veçanta në somatizmat

Trajtimi, hetimi i çështjeve të sipërpërmendura synon të japë një ndihmesë të vlefshme teorike, praktike/pragmatike dhe didaktike në analizën e veçorive leksiko-semantike të veprave letrare. Vlera teorike e punimit ka të bëjë, para së gjithash, me

[7] Sadiku, Emine, Kadareja – ky stilist i madh, Tiranë, 2000.

[8] Smbolizmi tingullor lidhet me shoqërimet tingull-kuptimi, që vendosen qëllimisht për të arritur efekte të ndryshme. Shih, Lloshi, Xhevat, Stilistika dhe pragmatika, Tiranë, 1999, f. 59.

informacionin e gjerë që ofron në lidhje me tekstin letrar dhe interpretimin e tij. Studime të tilla bëjnë akoma më të qartë analizën e teksteve letrare. Referimi në teoritë e reja lidhur me tekstin letrar, konceptet dhe parametrat për shqyrtimin dhe analizën e tij janë gjithashtu një prurje në kuadrin teorik të analizës së tekstit letrar.

Punimi ka dhe interes pedagogjik-didaktik. Gjithnjë e më tepër shtohen sot kritikat në adresë të studentëve, që paraqesin dobësi të theksuara në analizën e tekstit letrar. Ata nuk janë në gjendje ta analizojnë dhe ta interpretojnë atë. Punimi në vijim tregon, ndër të tjera, se një analizë e një vepre letrare nuk parakupton vetëm evidentimin e vlerave gjuhësore dhe artistike të saj, por edhe shqyrtimin e këtyre vlerave në një kontekst të caktuar gjuhësor, kulturor, etnografik.

Metoda kontrastive e punimit vë në dukje dallimet dhe ngjashmëritë midis dy gjuhëve (në rastin tonë pa afri gjenetike). Analiza të tilla mund të integrohen në çdo formë e nivel të mësimdhënies së gjermanishtes.
Përvetësimi i një metodologjie dhe aparatit konceptual metodologjik për analizën leksiko-semantike të veprave letrare, si edhe krahasimi i veçanësive në gjuhët që përqasim, hetimi konkret i tyre në korpuse letrare, ndihmon në përmirësimin e kompetencës praktike në gjuhën e huaj, forcon vetëdijen gjuhësore dhe qëndrimin kritik ndaj literaturës. Trajtime të tilla janë interesante dhe ndihmësjellëse edhe në fushën e teorisë së përkthimit.

0.3 Metodologjia dhe struktura e punimit

Punimi ynë është, para së gjithash, një trajtim kontrastiv sinkronik. Sipas konceptit tonë kontrastues janë evidentuar jo vetëm ndryshimet, por dhe ngjashmëritë.

Punimi përmban gjithsej 4 kapituj. Kapitulli i parë synon të paraqesë këndvështrimet teorike aktuale të çështjes, si shpjegim konceptesh, një ekspoze (paraqitje) të shkurtër teorike të konceptit kuptim, etj. Në fokus vendoset koncepti kuptim, kuptim teksti, kontekst sociokulturor, gjuhësi konjitive, modelim i dijes enciklopedike dhe gjuhësore. Nga pikëpamja metodologjike është bërë një trajtim analitik i koncepteve, që do të na shërbejnë si aparat metodologjik për analizën e teksteve.

Pas përvijimit të aparatit konceptual kalojmë në analizën konkrete të kategorive gjuhësore dhe jogjuhësore dhe vlerave leksiko-semantike të veprave të Kadaresë. Si procedurë kryesore e punës shkencore u përdor ajo sintetiko-analitike. Metoda kontrastive përdoret në tri korpuse, romane të Kadaresë, “Prilli i thyer”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” dhe “Darka e gabuar”, me qëllimin e evidentimit të ngjashmërive dhe dallimeve midis origjinalit dhe përkthimit dhe vërtetimit të tezave të parashtruara në pjesën teorike.

Gjithë punimi është ndarë dhe strukturuar në katër kapituj, të cilët përmbajnë nënndarjet përkatëse. Në fund të punimit gjenden përfundimet e përgjithshme të tij.

Në kapitullin e parë do të paraqesim kuadrin e përgjithshëm teorik në të cilin do të shpaloset punimi ynë. Në të do të trajtojmë çështjen e analizës kuptimore të gjuhës duke skicuar dhe analizuar modele të ndryshme të përvijimit të kuptimit.
Duke skicuar modele të përvijimit të kuptimit që nga ai strukturalist deri në atë të gjuhësisë konjtive, do të synojmë të tregojmë se kuptimi nuk paraqitet vetëm nga

tërësia e komponenteve kuptimore. Ai duhet parë i kushtëzuar nga funksioni i tij, nga kushtet dhe situata e thënies dhe të thënës[9], qëllimi i përdorimit. Madje edhe më tepër: si konfigurim i dijes gjuhësore, e cila ka lidhje të ngushtë me atë jogjuhësore, me dijen enciklopedike të formësuar në një kontekst të caktuar shoqëror e kulturor. Kjo qasje do të bëjë të domosdoshëm edhe sqarimin e lidhjeve midis kategorisë së kuptimit dhe komponenteve të tjera kuptimore, si konotacionet, presupozimet, implikaturat, sepse gjatë proceseve produktive apo receptive të përdorimit të gjuhës përzgjidhen koncepte nga skemat, të cilat ngërthejnë dhe elemente jogjuhësore të dijes enciklopedike. Në përvijimin e analizës kuptimore të fjalëve do të tregojmë se një rol të rëndësishëm në këtë proces luajnë edhe faktorët emocionalë, që i bashkangjiten apo mbështjellin rrafshin e përmbajtjes së transmetimit të informacioneve. Në përfundim të kapitullit të parë do të tregojmë se ekziston një lidhje e ngushtë midis strukturave gjuhësore, konceptuale dhe emocionale; dhe se thëniet apo formulimet e gjuhës mund të konsiderohen si gjurmë të proceseve konjitive, emocionale, që realizohen në gjuhë përmes proceseve deduktive e induktive.

Në kapitullin e dytë do të paraqesim shkurtimisht konceptin e tekstit dhe metodologjitë e reja të analizës së tij. Duke u nisur nga përkufizimi i Lechenerit, sipas së cilit teksti është "një tërësi e strukturuar, që paraqet lidhje dialektike midis strukturave gjuhësore, gjuhëshoqëruese, jogjuhësore, të imazhit kompleks të realitetit, të situatës, fakteve, marrësit e dhënësit të një veprimtarie gjuhësore", do të tregojmë se shqyrtimi i vlerave të tekstit parakupton domosdoshmërinë e shqyrtimit dhe leximit të tij në varësi të qasjeve teorike që lidhen me procesin e receptimit dhe të interpretimit. Brenda kësaj mënyre konceptimi të tekstit do të vendosim problematikën e shqyrtimit të tekstit letrar, i cili si një formë e veçantë diskursive, një hapësirë gjuhësore koherente, të cilën duhet ta rindërtosh lidhet pazgjidhshmërisht me shqyrtimet e analizës së gjuhës në përdorim e në procesin e komunikimit, me kushtëzimin e saj nga konteksti dhe sfondi sociokulturor.[10] Në shqyrtimin e lidhjeve, kushtëzimeve kuptim dhe domethënie - sfond sociokulturor do të evidentojmë domosdoshmërinë e aktivizimit të sfondit sociokulturor. Një hap i rëndësishëm në analizën metodologjike të kuptimit të leksemave dhe evidentimit të kushtëzimit të domethënieve të tyre nga sfondi sociokulturor është edhe kategorizimi në shtresa i leksikut dhe pështkrimi i mekanizmave bartëse të sfondit sociokulturor.

Në kapitullin e tretë do të ilustrojmë me interpretime të fjalëve apo të grupeve të fjalëve, fjalive e teksteve nga disa vepra në prozë të autorit I. Kadare domosdoshmërinë e aktivizimit të sfondit sociokulturor për arritjen e një interpretimi të tekstit sa më afër qëllimit të autorit. Do të tregojmë se arkaizmat, huazimet, duke evokuar një sfond tjetër kohor dhe kulturor, përdoren në ligjërimin e Kadaresë për të paraqitur me vërtetësi epoka historike të së shkuarës, për t`u dhënë ngjarjeve ngjyrimin e nevojshëm kohor, për të shënuar mentalitete njerëzore, për të portretizuar

[9] Çiftin terminologjik thënie/e thëna e kemi përdorur sipas terminologjisë së propozuar nga Remzi Përnaska dhe Tomorr Plangarica. Ata propozojnë për dy skajet e ligjërimit në frëngjisht énonciation / énoncé termat thënie / e thëna. Shih, Përnaska, Remzi/ Plangarica, Tomorr, Mbi disa skaje filozofike-logjike-gjuhësore në fushën e sintaksës së shqipes, teorisë së të thënit/pragmatikës dhe gjuhësisë tekstore, në, Konferenca Shkencore Ndëkombëtare "Terminologjia në shkencat e ligjërimit", Elbasan, 13 mars, 2012, f. 8.

[10] Shih edhe, Adam, J. M. Postface, në: Littérature e linguistike: Dialogue ou coexistence? Le français aujourd'hui, Armand Colin/AFEF, decémbre 2011, f. 103-114 cituar sipas Plangarica, Tomorr, Plangarica, Tomorr, *Mbi lidhjet e gjuhësisë me letërsinë në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe letërsisë,* f. 7.

personazhe dhe informuar mbi botën e tyre të brendshme. Ndërsa neologjizmat mundësojnë ngjyrime kuptimore, shenjojnë nocione të reja dhe flasin për stilin e autorit.
Syth tjetër i rëndësishëm në këtë kapitull do të jetë edhe analiza e veprës "Prilli i thyer" sipas teorisë së lakunave. Shtjellimet mbi kuptimin si dije semantike të kushtëzuar nga faktorë shoqërorë, mbi ndikimin e sfondit sociokulturor në prodhimin e receptimin e teksteve do të krijojnë truallin e nevojshëm për të trajtuar edhe probleme teorike dhe praktike që lindin si pasojë e tyre gjatë përkthimit të teksteve. Nga ana tjetër shtjellimet mbi veçantitë e tekstit letrar, estetikën receptive, madhësitë e estetikës, praninë e vendeve bosh në tekstin letrar ku objekti ose gjendja referojnë në sfonde e hapësira që nuk jepen në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekst,[11] e bëjnë trajtimin e problemeve që lindin gjatë transferimit të strukturave tekstore nga një gjuhë në tjetrën të pashmangshëm. Kështu, hulumtimi ynë në këtë syth ka një pamje teorike-praktike, ku do të përzihen dhe përvojat vetjake në fushën e përkthimit.
Qëllimi kryesor i këtij kapitulli do të jetë përdorimi i teorisë së lakunave në kuadrin e veprimtarisë përkthyese të teksteve letrare. Vëmendje të veçantë do t´i kushtojmë analizës së përkthimit të romanit të I. Kadaresë "Prilli i thyer" në gjermanisht nga J. Röhm "Der zerrissene April". Modeli i lakunave do të përdoret si aparat teorik për të shpjeguar dukuritë dhe problemet e ndryshme gjuhësore-kulturore që dalin gjatë përkthimit. Karakteri taksonomik sistemor i modelit lakunor e bën atë të përshtatshëm në analizën e përkthimit dhe të teksteve të përkthyera ku nevojiten shpjegime dhe sqarime për elemente të caktuara semantike. Lidhur me këtë Stolze thotë se një model i tillë është efikas në "kapërcimin e vështirësive në të kuptuarit e teksteve në gjuhë të ndryshme që përmbajnë detyrimisht dallime në konceptimin e realitetit, dallime të aspektit kulturor, etj."[12]
Analiza e korpusit tonë, romanit "Prilli i thyer", variantit origjinal dhe përkthimit gjermanisht "Der zerrissene April", do të paraprihet nga paraqitja e disa koncepteve që lidhen me lakunat dhe aktivizohen gjatë shpalosjes së teorisë mbi to.

Sythin tjetër të këtij kapitulli e kemi quajtur *„Në kufi të gjuhës"* për shkak se procedetë dhe instrumentet e përdoruara panalizën e romanit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" nuk kanë të bëjnë me kuptimin (denotativ, konotativ, gramatikor), por me një funksion tjetër të gjuhës, i cili realizohet jashtë kuptimit. Është si të thuash margjinal. Gjuha jonë e ndërtuar me fjalë dhe fjali të kuptimshme përbën një sistem. Brenda këtij sistemi ekzistojnë materiale dhe mundësi, që të organizuara, ndikojnë në forcën shprehëse të thënieve pa u përfshirë në funksionimin e zakonshëm të njësive gjuhësore leksikore. Kështu ato rrezikojnë të dalin jashtë sistemit. Dukuri dhe mjete të tilla u largohen funksioneve leksikore-gjuhësore dhe bien në një terren kufitar, që është vështirë të përcaktohet. Ne do të merremi me përshkrimin dhe analizën e mjeteve të tilla si dhe me funksionet e tyre.
Objekt i vëzhgimeve tona do të jenë komponente formale, që me anë të organizimit specifik, paraqesin ngjashmëri shkallësh e llojesh të ndryshme me realiet e shënuara, synojnë efekte estetike të veçanta. Është fjala për tingujt e të folurit, më gjerë për planin e shprehjes, efekti i të cilëve është i padyshimtë. Këtë efekt të shenjave gjuhësore që lidhet me kombinimet e qëllimshme të tingujve me kuptimet dhe

[11] Shih, Iser, Wolfgang, *Der Akt des Lesens - Theorie ästhetischer Wirkung*, München, Wilhelm Fink Verlag, 1976, f. 53. Në këtë vepër Iseri nënvizon se "Qëllimi i teksteve letrare mund të përfytyrohet, vetëm se nuk jepet në mënyrë eksplicite dhe si pasojë është i pranishëm vetëm në aftësinë imagjinare të recipientit.
[12] Stolze, Radegundis, *Hermeneutisches Übersetzen*, Tübingen, Gunter Narr Verlag, 1992, f. 77; 85.

domethëniet e mjeteve gjuhësore gjuhëtari Xhevat Lloshi e emërton "simbolizëm tingullor". Ai pohon se "i gjithë spektri i vetive të tingujve të gjuhës edhe ndërthurjet e tyre, denduria e shpërndarja fshehin mundësi për vlera shprehëse."[13]
Mendimi mbi ndikimin estetik të planit të shprehjes vendos në fokus marrësin e mesazhit të tekstit letrar. Roli i marrësit të mesazhit të një teksti letrar është i një rëndësie të veçantë. Teoritë më të fundit mbi analizën e tekstit letrar, si ato hermeneutike, estetika receptive etj. i kanë dhënë prej kohësh recipientit vendin dhe statusin që i takon. Vëzhgimet tona do të përqëndrohen në çështje, si:

- A kanë shenjat gjuhësore krahas kuptimit (dhe funksioneve që lidhen me kuptimin) edhe një funksion ikastik/evokativ që mbështet, plotëson dhe përforcon kuptimin?
- A mund të marrë shenja gjuhësore brenda tekstit funksion ikastik?
- Ç'ndikim kanë strukturat me funksion evokativ në domethënien e në shprehësinë tekstore.

Një vend të veçantë në studimin tonë do të zërë paraqitja e mjeteve dhe funksioneve ikastike, që kemi hasur dhe vërejtur në romanin e I. Kadaresë "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", teksti shqip dhe përkthimi gjermanisht.
Për të realizuar synimin tonë analizues, do të dallojmë disa komponente letrare të tekstit të I. Kadaresë. Këto komponente janë shtresa të materialit letrar ose plane, ku shpaloset mendimi letrar, stili, atmosfera e tablove të ndryshme, ku do të analizojmë funksionin ikastik të gjuhës. Në bazë të përdorimit e funksionit të mjeteve gjuhësore me funksion ikastik kemi dalluar këto rrafshe:

- *Peizazhet natyrore*
- *Peizazhet psikologjike*
- *Peizazhet tingullore*
- *Portretet*

Në kapitullin e katërt, të quajtur "Metaforat në romanet `Darka e gabuar` dhe `Gjenerali i ushtrisë së vdekur`", do të skicojmë, krahas vlerave estetike të metaforave, edhe vlerat e tyre si mjet njohjeje, si pasqyrë të proceseve mendore, si mënyra të shprehjes së përvojës, pra, do të priremi, në këtë mënyrë, drejt natyrës metaforike të procesit diskursiv. Si „shprehje e drejtëpërdrejtë e përjetimit (fiktiv apo real) në të gjitha facetat"[14], apo „shprehje e ndjenjave,"[15] me vlerë diskursive për të gjithë tekstin, ato kanë vlerë referenciale, vlerë të cilën P. Ricœur e quan "mode plus fondamentale de reference."[16] Kjo qasje ndaj metaforave dëshmon se kuptimi dhe analiza e domethënies së tyre është një çështje që lidhet edhe me ndërtimin dhe zbulimin e koherencës tekstore.

[13] Shih, Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, Toena, 1999, f. 54.
[14] Wilhelms, Gottfried, *Die Metapher – „Kern um Wesen aller Poesie" oder „Schminke, Parfüm"? Zur Problematisierung der bildlichen Rede in der modernen Literatur*, në, Deutsche Viertelsjahrbericht 62, f. 549-569.
[15] Shih, Schwarz-Friesel, Monika, *Sprache der Emotion*. Tübingen, Francke, 2007a.
[16] Ricoeur, Paul, *Die lebendige Metapher*, München, Fink, 1986, f. 13.

Si rezultat i kombinimit të fushave të ndryshme të perceptimit ato kanë një strukturë të dyfishtë: një strukturë të domethënies artistike[17] (që i korrespondon vlerave estetike të tekstit) dhe një strukturë semantike.
Përveç vlerës njohëse dhe pasqyrimit të përvojës, metaforat në tekstet letrare përmbajnë edhe ngjyrime vlerësuese dhe emocionale.

Analiza e metaforave në romanin "Darka e gabuar" do të paraprihet edhe nga një shtjellim teorik për analizën e metaforave si analizë ku takohen dy pikëvështrime: ai semantik dhe ai pragmatik. Edhe vendi i komponenteve emergente në zbërthimin e kuptimit të metaforave do të jetë një çështje që do të trajtohet në këtë kapitull. Duke përcaktuar si "veçori emergente ato komponente kuptimore që lindin gjatë procesit të dekodimit të metaforave, të cilat nuk janë komponente përbërëse të kuptimit të leksemave të veçanta që qëmtojmë, dhe as komponente të koncepteve të tyre, apo kombinimeve të koncepteve, do të ndalemi në skicimin e një modeli për zbërthimin e kuptimit të metaforave në tekstet letrare, që do të mundësojë edhe kornizën e përgjithshme për analizën konkrete të metaforave në romanin "Darka e gabuar". Analiza midis varianteve në origjinal dhe në përkthim do të evidentojë në grupimet e metaforave vlerat formale dhe estetike të metaforave në veprën "Darka e gabuar" në origjinal dhe në përkthim.

Në këtë kapitull do të analizojmë edhe somatizma, shprehje frazeologjike me pjesë të trupit, që kemi inventarizuar nga veprat "Darka e gabuar" dhe "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" në variantet shqip dhe gjermanisht. Arsyeja e përzgjedhjes së somatizmave lidhet me faktin e thjeshtë se në frazeologjizmat me pjesë trupi gjejmë të shprehur më së miri mentalitetin, mendësinë dhe kulturën e një etnie, "simbolikën e gjuhës së trupit, si edhe traditita dhe paragjykime",[18] ata janë "metafora antropologjike", që emërtojnë cilësi që lidhen me pamjen e njerëzve, karakteristika të tyre, ndjenja dhe emocione të tyre, d.m.th., me sjellje dhe mentalitete të njerëzve të caktuar dhe komuniteteve apo shoqërive të caktuara njerëzore.[19]
Analiza e përqasja e somatizmave në shqip dhe gjermanisht ka për qëllim evidentimin e koncepteve universale dhe specifike në secilën gjuhë që kanë shërbyer si mekanizëm motivimi në ngjizjen e kuptimit të somatizmit. Në raste mospërputhjeje të koncepteve metaforike në secilën gjuhë do të konsultojmë edhe fjalorët përkatës në këtë fushë të studimit, për të shpjeguar apo arsyetuar mospërdorimin e njësisë frazeologjike në përkthim.

Punimi mbyllet me përfundimet, ku kemi përmbledhur pikëpamjet dhe qëndrimet teorike në lidhje me analizën dhe metodologjinë e shqyrtimit të kuptimit të tekstit, si edhe rezultatet e arritura nga analiza e veprave të Kadaresë të përdorura si korpuse në punimin tonë.

[17] Ricoeur e emërton domethënien artistike të metaforës si moment ikonik, i cili kushtëzon pranueshmërinë e diferencës kuptimore që mbetet e tillë. Ricoeur, Paul, *La metafore vive*, 1975.
[18] Shih, Földes, Csaba, Über die somatischen Phraseologismen der deutschen, russischen und ungarischen Sprache. Versuch einer konfrontativen Analyse, në, *Germanistisches Jahrbuch DDr-UVR. Hrsg. vom Deutschlektorat beim Kultur- und Informationszentrum der DDR in Budapest. Bd. 4*. Budapest. 1985, f. 18-40, këtu, f. 21.
[19] Shih, Ullmann, Stephen, *Semantics. An Introduction on the Science of Meaning*. Oxford, Basil Blackwell, f. 214.

Kreu 1 Aspekte leksiko-semantike në diskursin letrar

1.1 Përcaktimi i kategorisë së kuptimit

Analiza kuptimore e gjuhës është vërtet një fushë e gjerë dhe problematike, por në të njëjtën kohë edhe një mekanizëm mjaft i rëndësishëm për të kuptuar funksionimin e gjuhës, për të hyrë në thellësi të saj, për të zbuluar vlerat cilësore të pafund që fsheh veçanërisht semantika leksikore.
Në rryma të ndryshme gjuhësore, kuptimi është përcaktuar nisur nga koncepte dhe këndvështrime të ndryshme, p.sh., strukturalistët e studiojnë kuptimin e fjalës me metoda të huazuara nga fonologjia, duke e parë kuptimin të ndashëm në përbërës kuptimorë, gjenerativistët nisen në studimin e kuptimit jo nga fjala, por nga fraza, gjuhëtarët e fundshekullit XX (ata të pragmatikës gjuhësore) e përcaktojnë kuptimin e fjalës në komunikim, duke e parë atë si rezultat të veprimtarisë njerëzore.

1.1.1 Teoritë mbi kuptimin / domethënien

Trajtimet dhe teoritë e shumta mbi kuptimin (gjerm. *Bedeutung/ Sinn*; ang. *meaning / sense;* fr. *signifikation / sens*) do t`i diskutojmë duke parë pikërisht konceptin nga nisen pikëvështrimet e tyre për përcaktimin e kuptimit. Për punimin tonë na intereson të trajtojmë ato koncepte që e përcaktojnë kuptimin në aktin ligjërimor dhe si rezultat të proceseve mendore, njohëse.

1.1.1.1 Strukturalizmi dhe gramatika gjenerative

E para rrymë gjuhësore, e cila bëri dallimin midis gjuhës si sistem dhe gjuhës si akt ligjërimor, ka qenë strukturalizmi. Edhe pse kjo rrymë studion kuptimin e fjalës në sistem, mbi bazën e raporteve të vendosura midis njësive semantike, vlen të studiohet pikëvështrimi dhe kontributi i saj për vetë modelet e gjetura në përcaktimin e kuptimit, modele që më vonë u përdorën për të shpjeguar ruajtjen e kuptimit në kujtesë. Ky element do të na ndihmojë ndër të tjera edhe të shpjegojmë edhe kategorinë e sfondit sociokulturor.

Strukturalizmi klasik e përshkruan gjuhën si sistem të shenjave, nisur nga dikotomia gjuhë-ligjërim, të folur apo bashkëmarrëdhëniet gjuhë-ligjërim-të folur (langue-language-parole). Në këtë trajtim gjuha kishte rëndësi të dorës së parë: strukturalistët u interesuan dhe studiuan çështje që lidheshin me sistemin e gjuhës, ndërsa ligjërimi, e folura ishte një dukuri dytësore. Sh. Rrokaj shkruan se "gjuhësia strukturale e këtij brezi (strukturalizmit klasik) i kushtoi rëndësi veçanërisht formës, duke e lënë mënjanë studimin e kuptimit, por, siç dihet, format janë të tilla pikërisht se shprehin kuptimet dhe anasjelltas."[20] Sipas këtij koncepti "gjuha nuk bën gjë tjetër veçse u ngjit etiketa sendeve dhe kalimi nga një gjuhë në një tjetër është thjesht ndërrim etiketash."[21] Me këtë konceptim gjuha shihet si nomenklaturë, si sistem i izoluar që analizon kuptimin e shenjave gjuhësore jashtë lidhjeve me folësin konkret, kushtet, situatën e komunikimit. Në lidhje me këtë Lyons-i shkruan se „Strukturalizmi klasik studionte vetëm sistemin e gjuhës dhe mohonte dallimet midis gjuhës si sistem

[20] Rrokaj, Shezai, *Strukturalizmi klasik në gjuhësi*, Tiranë, Shblu, 2002, fq. 180.
[21] Memushaj, Rami., *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, Dituria, 2002, fq.180.

(Saussure langue, Chomsky Kompetenz) dhe ligjërimit (Saussure parole, Chomsky Performanz).[22] Si pasojë e këtij trajtimi, sistemi i gjuhës u pranua në mënyrë ideale si objekt i vetëm studimi. Kjo pikëpamje gjen shprehjen e vet edhe në hipotezën e një folësi ideal, në një komunitet gjuhësor homogjen. Reichmann-i shprehet se në këtë mënyrë mohohet ndryshimi i kuptimit, funksioni komunikativ dhe karakteri social i komunikimit. Duke i parë proceset e ndryshimit të gjuhës si çekuilibrim të sistemit, mbulohet edhe karakteri historik i komunikimit.[23]
Strukturalistët kërkonin përshkrimin e gjuhës me ndihmën e metodave analitike, metodë që u huazua nga fonologjia. Busse e karakterizon në këtë mënyrë konceptimin ideal të përshkrimit të gjuhës me ndihmën e analizës komponenciale:[24]
"Njësia më e vogël semantike nuk është më fjala (shenja gjuhësore), por sema, komponenti semantik. Semantika barazohet kështu me studimin e 'komponenteve semantike' të shenjës, ose me 'analizën komponenciale'. Kuptimi shihet 'si strukturë e përbërë nga elemente konceptore të përmbajtjes, si edhe nga lidhjet e vendosura midis tyre.'"[25]
Në procedurat e analizës semike u fut edhe gjurmimi i elementeve të kuptimit. "Parimi kryesor është që një përshkrim semasiologjik, nëpërmjet pohimit apo mohimit (e ka ose nuk e ka tiparin e përcaktuar), shpreson të dalë në strukturimin shkencor semantik të fjalës."[26] Strukturalizmi vlerësohet pikërisht për gjetjen e këtyre modeleve, me anën e të cilave rikonstruktohet kuptimi, apo struktura kuptimore e shenjës, e cila shikohet si e ndashme në komponente kuptimore.[27] Këtë këndvështrim do ta përdorim edhe për të sqaruar ruajtjen e kuptimit me anën e komponenteve semantikë në kujtesë, dhe për të shpjeguar lidhjet e vendosura midis dijes enciklopedike dhe asaj semantike, si edhe në përqasjen e analizës kuptimore të ligjërimit të Kadaresë në shqip dhe në variantet në gjermanisht.

Për gramatikën gjenerative – si kritikë e strukturalizmit klasik, e zhvilluar veçanërisht nga Çomski (Chomsky) – nuk ka rëndësi cili është kuptimi i njësisë gjuhësore, por a është e rregullt kjo njësi nga ana semantike ose nga ana formale. Gramatika gjenerative, si njësi themelore gjuhësore njeh frazën dhe pranon dy tipe frazash: frazën gramatikore dhe frazën semantike. Sipas Çomskit "... përbërësi sintaksor i gramatikës duhet të specifikojë, për çdo fjali, një strukturë të thellë[28] që përcakton

[22] Lyons, John, *Bedeutungstheorien*. In: Sematik: ein internationales Handbuch der zeitgenösisschen Forschung. Semantics. Hrsg. v. A. v. Stechow; Dieter Wunderlich. Berlin/New York, 1991, fq 1-24, këtu fq. 15.
[23] Shih, Reichmann, Oskar, *Historische Lexikographie*. In: Sprachgeschichte. Ein Handbuch zur Geschichte der deutschen Sprache und ihrer Erforschung, botuar nga, Werner Besch/ Oskar Reichmann/ Stefan Sonderegger, 1. Halbband, Berlin, New York 1984, fq. 460-492, këtu fq. 448 e në vijim.
[24] Analiza komponenciale (semasiologjike) ose analiza në përbërës kuptimorë synon zbërthimin e kuptimit të fjalës në tipare dalluese semantike, të cilat janë njësitë më të vogla të planit të përmbajtjes. Këto tipare semantike, njësi minimale të kuptimit, quhen ndryshe edhe sema. Shih, Memushaj, Rami, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, Dituria 2002, fq 163.
[25] Busse, Dietrich, *Textinterpretation: sprachtheoretische Grundlagen einer explikativen Semantik*. Opladen, 1992, fq.30.
[26] Thomai, Jani, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989, fq. 37.
[27] Shih, Motsch, Wolfgang, *Zur Kritik des sprachwissenschaftlichen Strukturalismus*. Berlin, 1974 (=Sprache und Gesellschaft 3).
[28] Një çift konceptesh i gjuhësisë gjenerative është ai i strukturës sipërfaqësore dhe asaj të thellë të gjuhës. Me strukturë sipërfaqësore Çomski kupton „organizimin në kategori dhe fraza, që lidhet drejtpërdrejtë me sinjalin fizik, pra jo vetë sinjalin fizik. Kurse me strukturë të thellë kupton një sistem kategorish dhe frazash, por me një karakter më abstrakt. Sipas kësaj gramatike, struktura sipërfaqësore

interpretimin semantik të saj dhe një strukturë sipërfaqësore që përcakton interpretimin fonetik të saj. E para prej këtyre interpretohet nga përbërësi semantik; e dyta nga përbërësi fonologjik."[29] Pra, përmbajtja semantike e fjalisë përcaktohet nga struktura e thellë që qëndron në bazë të thënies aktuale.
Një konceptim i tillë i organizimit të gjuhës e dallon gjuhësinë gjenerative nga ajo strukturaliste, e cila i përmbahej mendimit se struktura e thellë dhe ajo sipërfaqësore janë të njëjta.
Gramatika gjenerative interesohej për mënyrën e rikonfigurimit të kuptimit të fjalës, për dijen, por jo për mënyrën e rikonfigurimit të proceseve që ndodhin në tru për ruajtjen e saj.
Reichmann-i shkruan se "vlera e teorive strukturaliste dhe gjenerativiste qëndron, edhe pse nuk i kushtojnë rëndësi funksionit komunikativ të fjalëve, se ato u përpoqën të përcaktojnë strukturat gjuhësore, të *përshkruajnë* ruajtjen e tyre në kujtesë me anën e modeleve të zbuluara."[30] Por strukturalistët nuk vlerësojnë proceset mendore, njohëse dhe lidhjen e tyre me ato gjuhësore. Për këtë arsye nuk mund të flitet edhe për dukurinë e ambiguitetit të gjuhës.

Këto parashtrime i quajtëm me vlerë për punimin tonë pasi analizën komponenciale, të propozuar nga strukturalistët, do ta përdorim hera-herës në interpretimin e vlerave kuptimore të njësive gjuhësore. Por, interpretimet përmes analizës komponenciale ose semike do të përdoren nga ne në kuadër të njësisë tekst dhe kuptimit/domethënies dhe jo si qëllim në vetvete.

1.1.1.2 Konceptet që e përcaktojnë kuptimin si rezultat të aktit të komunikimit

Në gjuhësinë strukturaliste dhe të gramatikës gjenerative kuptimi i fjalës përcaktohet ose nga lidhja e vendosur midis shenjës dhe të shenjuarit, ose prej marrëdhënieve strukturë sipërfaqësore-strukturë e thellë. Por kuptimi i fjalës mund të rroket vetëm në komunikim, "i cili nuk arrihet thjesht nga vargëzimi i mjeteve sipas disa rregullave, por me ndërthurjen e tyre në përputhje me pasqyrimin e realitetit, me vijueshmërinë logjike, me synimet e folësit në rrethanat e komunikimit dhe me veprimin e përbashkët të të gjitha anëve sipas mënyrave të përvijuara historikisht në përvojën e kulturës gjuhësore të popullit shqiptar."[31] Ky konceptim shpreh domosdoshmërinë e studimit të kuptimit të fjalës në komunikim, ligjërim[32], i cili kuptohet dhe shihet si formë e veprimtarisë njerëzore. Pikërisht kjo arritje na intereson për punimin tonë.
Si burim i këtij koncepti shihen mes të tjerave psikologjia sovjetike mbi gjuhën, filozofia e Wittgenstein-it mbi gjuhën dhe sociologjia e gjuhës e Weber-it. Heinemann/Viehweger shkruajnë: "Mendimi bazë i pragmatikës linguistike i dalë nga teoria e akteve gjuhësore të filozofisë analitike gjuhësore anglosaksone është se çdo thënie gjuhësore (gojore apo me shkrim) mund të përshkruhet si një akt sipas rregullave. Pra, gjuha dhe të folurit trajtohen në këtë mënyrë në lidhje me të gjithë

---

i korrespondon vetëm tingullit, anës fizike të gjuhës, kurse struktura e thellë mendimit. Cit. sipas Rami Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, Tiranë, Shblu 2003, fq. 207.
[29] Cit. sipas Rami Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, Tiranë, Shblu 2003, fq. 207.
[30] Shih, Reichmann, Oskar, *Historische Lexikographie*, në, Sprachgeschichte. Ein Handbuch zur Geschichte der deutschen Sprache und ihrer Erforschung, botuar nga Werner Besch/ Oskar Reichmann/ Stefan Sonderegger, 1. Halbband, Berlin, New York 1984, fq. 460-492, këtu fq 449.
[31] Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë: Toena 1999, fq. 7.
[32] Është pragmatika e cila studion përmbajtjen e thënies (fjali + kushtet e përdorimit të saj) në një kontekst të caktuar.

veprimtarinë njerëzore, dhe për aq kohë sa bëhet fjalë për një veprimtari sociale, edhe me ndërveprimin (interaksionin).”[33]

Raportet midis sistemit të gjuhës dhe proceseve gjuhësore, ndryshe nga strukturalizmi, zënë vend të rëndësishëm. Vlera e fjalës në komunikim është në qendër të trajtimeve të këtij drejtimi gjuhësor. Duke e lidhur këtë qëndrim me teorinë e vonë të Wittgensteinit, Busse vëren: “Të njohësh kuptimin e një shenje gjuhësore, do të thotë të dish si mund të përdoret ajo, d.m.th. si mund të veprojmë me të, çfarë rregullash vlejnë për përdorimin e saj. Të kuptuarit e proceseve gjuhësore bazohet në njohjen e rregullave. Keqkuptimi ndodh atëherë kur partnerët në komunikim veprojnë sipas rregullave të ndryshme. Nëse ne dëshirojmë të përshkruajmë shenjën gjuhësore, duhet të marrim parasysh lidhjet e saj brenda një forme të jetës sociale. […] Ndjekja e këtyre rregullave është bazë për kuptimin e shenjave gjuhësore dhe, në këtë mënyrë, edhe të gjuhës. […]. Rregullat semantike, parë nga ana sociale, janë marrëveshje e grupeve sociale mbi përdorimin e shenjës gjuhësore.”[34]

Pra, një nga arritjet kryesore të këtij koncepti mbi kuptimin është përcaktimi i aktit të komunikimit si formë e veprimtarisë njerëzore. Me këtë qëndrim kapërcehet pozicioni i strukturalistëve që e përshkruajnë gjuhën si dukuri homogjene, të përdorur nga një folës ideal. Në teorinë pragmatike gjejnë vend dhe trajtohen edhe “faktorët që çrregullonin gjuhën”, mënjanimi i të cilëve shihej nga strukturalistët si fushë e performancës. Si pikë e dobët e teorive të aktit të komunikimit shihet barazimi i komponenteve semantike (elementeve semantike) me kushtet e përdorimit të fjalës.[35]

Gjurmë në semantikën praktike kanë lënë edhe teoria e akteve të komunikimit të Austin-it dhe Searle-it, si dhe teoria e maksimave të ligjërimit, e zhvilluar nga Grice.

Në rrjedhën e “Fazës pragmatike”, Shkolla e Postdamit përpunoi një koncept mbi kuptimin si rezultat të aktit të ligjërimit – përshkrimi i gjuhës sipas funksionit komunikativ të saj – thelbi i të cilit qëndronte në “mundësinë e të mësuarit të dijes mbi komunikimin.”[36]

> “Karakteri funksional i teorisë së integruar mbi gjuhën qëndron se ajo nuk ka si pikënisje mjete të veçanta gjuhësore, por efektet komunikative që synohen të arrihen, funksionin. Përshkrimi i mjeteve gjuhësore bëhet sipas formës, kuptimit dhe bashkëveprimit të tyre gjatë realizimit të efektit komunikativ, kushtëzimit të përzgjedhjes së tyre nga qëllimi, plani përkatës për realizimin e tij. Ky plan qartëson procedurat e aktit të komunikimit të varura prej tij.”[37]

Ky trajtim qartëson lidhjen e kuptimit me formën dhe qëllimet e komunikimit. Sipas këtij koncepti, kuptimi është pjesë e dijes që kushtëzon qëllimin dhe funksionin e thënies, madje, siç do ta shohim edhe në teorinë konjitiviste ato nuk mund të ndahen nga njëra-tjetra.

---

[33] Busse, Dietrich, *Textinterpretation: sprachtheoretische Grundlagen einer explikativen Semantik*. Opladen, fq.49.

[34] Busse, Dietrich, *Textinterpretation: sprachtheoretische Grundlagen einer explikativen Semantik*. Opladen, 1992, fq. 49-53.

[35] Shih, Reichmann, Oskar, *Historische Lexikographie*. In: Sprachgeschichte. Ein Handbuch zur Geschichte der deutschen Sprache und ihrer Erforschung, botuar nga, Werner Besch/ Oskar Reichmann/ Stefan Sonderegger, 1. Halbband, Berlin, New York 1984, fq. 460-492, fq. 454.

[36] Shih, Hartung, Wolfdietrich, *Linguistische Zugänge der sprachlichen Kommunikation*. In: Kommunikation und Wissen. Annährungen an ein interdisziplinäres Forschungsgebiet. Hrsg. v. W. Hartung, Berlin, 1991, fq. 1-90, këtu fq. 49.

[37] *FKS* 1981, 12.

Në kuadër të kësaj teorie, koncepti "dije semantike" bëhet qendror. Thelbësore për këtë koncept bëhet edhe përcaktimi i kuptimit si "konfigurim i dijes".
Schippani shkruan: "Kuptimi shihet si dije mbi të shenjuarin, si dije që rezulton nga bashkëlidhja e të shenjuarit me objektet (shenjën) në një situatë të caktuar komunikuese. Këto konfigurime në ndërgjegjen e njeriut lejojnë t`i referohemi me fjalë diçkaje, të shprehim me anë të mendimeve diçka; ata janë rezultat i proceseve përgjithësuese konjitive, ashtu si edhe komunikimi. Ata nuk janë kopje të botës, por rezultate të veprimtarisë krijuese, të vlerësimeve, të realitetit të përvetësuar në kushte të caktuara historike dhe sociale."[38]
Teza e parashtruar nga Schippani ngërthen në vetvete kuptimin si dije semantike, nga njëra anë dhe dijen semantike – pjesë e dijes enciklopedike – si dije që kushtëzohet nga përvoja sociale dhe kulturore e njeriut, nga ana tjetër. Është kjo pikëpamje që na lejon të shpjegojmë lidhjen e dukurisë së sfondit sociokulturor me kuptimin.

1.1.1.3 Kuptimi si rezultat i proceseve njohëse, mendore

Koncepti i "kuptimit, si rezultat i aktit të komunikimit", mundësoi edhe lidhjen e kuptimit, si dukuri të gjuhësisë, me shkencën e psikologjisë, e cila ka për objekt të saj hulumtimin, studimin e veprimtarisë njerëzore.
"Psikologjia konjitive përdoret sot si emërtim përmbledhës i atyre teorive të cilat përpiqen të interpretojnë proceset e përpunimit të informacioneve, të drejtimit të veprimeve të njerëzve në përqasje me vlerësimet dhe me dijen."[39]

Psikologët që studiojnë proceset konjitive, për të modeluar rezultatet e kujtesës dhe mendimit, e përdorin gjuhën si material dhe mjet shpjegimi. Kategoria qendrore e psikologjisë konjitive është dija. Kliks-i (Klix) shprehet se "dija njerëzore përbëhet nga konceptet dhe lidhjet e vendosura midis tyre. Kjo dije shkëmbehet me anë të gjuhës. Kjo është e mundur, pasi në kujtesë konceptet lidhen me fjalët përkatëse, që emërtojnë (shenjojnë) cilësitë e një koncepti."[40]
Ky këndvështrim mundëson trajtimin e konceptit të dijes edhe nga gjuhësia, dhe diskutimet mbi lidhjen e proceseve gjuhësore me ato konjitive.
Gjuhësia përdor modelet konjitive si pikënisje për vërtetësinë dhe rivlerësimin e arritjeve të saj, që i përfiton nga trajtimi i kuptimit si rezultat i aktit të komunikimit. Qasja holistike në gjuhësisë konjitiviste barazon kuptimin me konceptualizimin. Baldauf shkruan se „Sipas principit holistik, kuptimi duhet të kuptohet si 'fenomen mental', i cili do përshkruar në lidhje me tërësinë e strukturave konjitive dhe barazuar me konceptualizimin. Me konceptualizim kuptohet përpunimi i botës nga njeriu, formimi i konceptit në varësi funksionale nga njeriu dhe nga ndërveprimi i tij me mjedisin"[41]

Nëse e shohim kuptimin si konfigurim të dijes, duhet të relativizojmë edhe lidhjen e ngurtë midis formës e kuptimit. E reja e konceptit procedurial[42] është vendosja e

[38] Schippan, Thea, *Lexikologie der deutschen Gegenwartssprache.* Niemeyer,1992, fq. 130.
[39] Cituar sipas Heinemann, M./Viehweger, D., *Textlinguistik: eine Einführung*. Tübingen 1991, fq. 67.
[40] Klix, F., *Über Wissensrepräsentation im menschlichen Gedächtnis*. In: Gedächtnis – Wissen – Wissensnutzung. Berlin, 1984, fq. 9-73, këtu fq. 9.
[41] Baldauf, Christa, Metapher und Kognition. Grundlagen einer neuen Theorie der Alltagsmetapher. Frankfurt a. M.: Lang, 1997, f. 37.
[42] Koncepti procedurial i R-A de Beaugrande dhe W.U Dressler (1981) paraqet një model për përshkrimin e tekstit. Koncepti proceduarial orientohet drejt përcaktimit të tekstualitetit, të të gjitha

lidhjeve midis sistemeve të ndryshme të dijes, partnerëve (pjesëmarrësve) të aktit të komunikimit në hartimin e tekstit. Busse shkruan në lidhje me këtë:

> "Dija mbi mundësitë e përdorimit të një fjale do të ishte dija mbi lidhjen e saj me pjesë të tjera të dijes, me fjalë të tjera, me kuptimet e paraqitura me anën e fjalive apo teksteve, me qëllimet komunikative. Kjo dije do të ishte si dije e domosdoshme sociale, d.m.th., ndërvetjake. Ajo është e drejtuar dhe e përcaktuar nga funksioni semantik i thënies në aktin e ligjërimit/komunikimit, funksion i cili paramendohet të arrihet me anën e fjalës së përzgjedhur."[43]

1.1.2 Konotacionet

Trajtimet mbi konotacionet janë të shumta. Një trajtim i hollësishëm i tyre do të kapërcente kufijtë e këtij punimi. Në interes të temës sonë po paraqesim vetëm disa nga trajtimet e autorëve shqiptarë dhe gjermanë.
Në veprën "Prejardhja semantike e fjalëve në gjuhën shqipe", J. Thomai e trajton këtë dukuri në sythin "Ngjyrimi emocionues i fjalëve" si element, i cili "s'është kurdoherë i përgjithshëm, as i domosdoshëm e as i përhershëm për fjalën[44].... Ai bën pjesë në përmbajtjen leksikore të fjalës. Fjala krijohet për të dhënë jo vetëm sendin, realitetin, po edhe ndjenjat, dëshirat, synimet e vetë njeriut."[45]
Edhe Polenc-i (Polenz) i trajton konotacionet si elemente kuptimore të lidhura me ndjenjat, të cilat i pranëvihen komponenteve referenciale.[46]
Xh. Lloshi i trajton konotacionet nga një pikëvështrim tjetër. Ai i emërton si "përmbajtje shoqëruese e kuptimit themelor, informacion plotësues"[47], që na ndihmojnë të vendosim lidhjet me elementet jashtëgjuhësore. Informacioni plotësues, si pjesë e pandarë e komunikimit, shprehet me:

- "ngjyrimet subjektive, që na tregojnë për gjendjet e qëndrimet e folësit, për marrëdhëniet e tij me dëgjuesin, për individualitetin e tij.
- ngjyrimet funksionale, që na përçojnë të dhëna për fushën e veprimtarisë, mjedisin shoqëror etj.
- ngjyrimet shprehëse, që dëshmojnë se ligjëruesi ka pasur dhe një qëllim tjetër për të ndikuar, ose për origjinalitet."[48]

Edhe Schippan si Xh. Lloshi shprehet se elemente konotative janë jo vetëm elementet që lidhen me ndjenjat, por edhe ata që përcaktohen nga situata komunikative. Situata komunikative jep informacione shtesë, që nuk përfshihen në kuptimin denotativ. Këto elemente kuptimore japin informacion mbi:

---

cilësive të teksteve në tekst, i cili „nuk mund të trajtohet tërësisht si një përvijim morfemash apo simbolesh. Ai është shprehje e një aktiviteti njerëzor, ku një individ synon të krijojë një tekst dhe përgatit marrësit e tekstit në ndërtimin e marrëdhënieve të ndryshme. Shih, Dibra, Klodi/ Varfi, Nonda *Gjuhësi teksti*, Tiranë, 2005, këtu fq. 35 e në vijim.

[43] Busse, Dietrich, *Textinterpretation: sprachtheoretische Grundlagen einer explikativen Semantik*. Opladen, fq. 59.

[44] Jani Thomai e ndan dukurinë e ngjyrimit emocional në dy shtresa: në njërën shtresë ky ngjyrim është i ngjizur me kuptimin leksikor. Fjalë të tilla janë: *dashuri, tmerr, gëzim* etj. Shtresa tjetër përbëhet nga fjalë në të cilat ngjyrimi emocionues duket qartë që nuk është i ngjizur me kuptimin leksikor: në këtë rast ai është si element „shtojcë", „subjektiv", „individual", „i rastit", „jo i detyrueshëm", e, për pasojë, edhe jo si pjesë përbërëse e kuptimit leksikor. Shih, Thomai, J. (1989). *Prejardhja semantike e fjalëve në gjuhën shqipe*. Tiranë, 1989, fq 74.

[45] Thomai, Jani, *Prejardhja semantike e fjalëve në gjuhën shqipe*. Tiranë, 1989, fq. 73, fq 74.

[46] Shih, Von Polenz, Peter, *Deutsche Satzsemantik*. Berlin/New York, 1988.

[47] Shih, Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*. Tiranë, Toena, 1999, fq. 29.

[48] Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*. Tiranë, Toena, 1999, fq. 29.

- situatën emocionale në të cilin përdoret fjala;
- nivelin komunikativ në të cilin përdoret fjala;
- funksionet e fjalës;
- kontekstin social në të cilin përdoret fjala;
- regjistrin në të cilin përdoret fjala;
- zonën, krahinën në të cilin përdoret fjala;
- kohën në të cilin përdoret fjala;
- qëllimin e komunikimit dhe modalitetet e tij;
- ngjyrimin politik të fjalës.

Pra, konotacionet përfshijnë informacionet mbi situatën komunikative të fjalës. Ato janë tregues të sociolekteve, të krahinorizmave, të kohës dhe të ngjyrimeve politike dhe e përcaktojnë një fjalë në lidhje me këto veçori. Konotacioni mund të përcaktohet si kriter klasifikikimi që shërben për të dalluar dhe interpretuar sfondin sociokulturor.
Midis konotacioneve dhe sfondit sociokulturor ka një lidhje të tillë: nga njëra anë, duke pasur parasysh lidhjen e ngushtë të sfondit sociokulturor me kuptimin denotativ, mund të themi se prania e sfondit sociokulturor kushtëzon kristalizimin e konotacioneve; por, nga ana tjetër, konotacionet janë tregues të sfondit sociokulturor.

1.2 Presupozimet

Presupozimet (gjer. Präsupositionen; fr. présupposition; ang. presupposition) – në përgjithësi – janë supozime elementare, që mundësojnë kuptimin e fjalive dhe teksteve. Termi „presupozim“ përdoret në gjuhësi si emërtim për komponentet kuptimore që nuk shprehen gjuhësisht (jo eksplicite), por që nënkuptohen vetvetiu.

Nga trajtimet e derisotme të kësaj dukurie nuk mund të mos vihet re që ky koncept ka mbetur disi i papërcaktuar. Së pari, kjo shpjegohet me prejardhjen e termit. Ky term rrjedh nga latinishtja „praesupponere“ (parakuptohet, nënkuptohet). Me vlerë termi kjo fjalë përdoret fillimisht në logjikë. Gjuhësia e ka huazuar termin nga logjika. Ndodh shpesh që termat e huazuara nga logjika në gjuhësi nuk janë krejt të përshtatshëm për nocionet që mbulojnë. Lidhur me këtë Bußmann-i vëren: „Mbartja e koncepteve nga logjika në gjuhësi pa rregulla të sigurta përkthimi duhet kontrolluar. Raporti midis logjikës dhe gjuhësisë, bashkëveprimi i tyre në teorinë e gjuhëve njerëzore nuk është i qartë.“[49]
Me anë të konceptit „presupozim“ studiohet një objekt që është i dhënë vetëm në intuitën gjuhësore, që s’mund të përcaktohet drejtpërdrejt si diçka materiale, që s’mund t’i përcaktohen caqet.
Diskutimet për presupozimet që nga Strawson-i (“Introduction to logical theory”, London 1950), Çomsk-i (“Knowledge of language” New York, 1969), Garner-i (“Implicature, presupposition and logical form”, Bloomington, 1971) etj. kanë sjellë si pasojë një varg përkufizimesh e përshkrimesh. Ky koncept është përcaktuar në pikëpamje logjike, në kuadrin e teorisë mbi aktin e ligjërimit, të gramatikës gjenerative, pragmalinguistikës etj. Në përgjithësi dallohen presupozime semantike dhe pragmatike.
Presupozimet semantike lidhen me semantikën e fjalëve të veçanta ose të thënieve: Këtu bëhet fjalë për një kuptim të nënkuptuar, por jo të shprehur gjuhësisht. Kështu,

[49] Bußman, Hademud., *Die dreiwertige Logik der Sprache*, Berlin, 1991, fq.600.

p.sh., në fjalinë: “Klea arriti të shkonte për studime në Itali”, nënkuptohet, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, që Klea po përpiqej për të shkuar me studime në Itali. Pra, kuptimi i fjalës “arrij” parakupton kuptimin “përpiqem për të bërë diçka”.
Presupozimet pragmatike kanë të bëjnë me sfondin e përbashkët, me dijen e përbashkët që sjellin të dy partnerët e komunikimit. Xh. Lloshi i cilëson presupozimet pragmatike “sfond, në të cilin bëhet vlerësimi i domethënies kryesore të një teksti.”[50]
Në lidhje me këtë Busse thekson se “ka forma që kanë të bëjnë me dijen gjuhësore, të cilat nuk mund të kuptohen vetëm nga teksti apo fjalia, por nga bashkëveprimi i thënies në tekst me dijen që mbartin lexuesit, dëgjuesit.”[51]
Schippan-i i cilëson presupozimet pragmatike si “madhësi pragmatike”[52], të cilat lidhen me dijen jogjuhësore, zakonet, me përvojën sociale dhe kulturore dhe, si të tilla, edhe si elemente të analizës së tekstit. Në komunikimin real, konkret presupozimet janë parakushte për funksionimin e tij, sigurojnë kuptimin (jo mirëkuptimin), ato janë supozime, që në ligjërim apo edhe në tekst nënkuptohen. Presupozimet paraqiten në tekst apo bisedë “si vende bosh”, të cilat folësi, lexuesi i mbush me dijen që ai mbart në procesin e komunikimit apo të leximit.
Nga ana tjetër Busse[53] thekson se presupozimet nuk janë dije statike, por në situata të caktuara komunikative aktivizohen pjesë të caktuara të dijes që kanë lidhje me to.

Presupozimet janë të lidhura ngushtë me sfondin sociokulturor, ato janë pjesë e dijes gjuhësore, pra, parakushte të dijes dhe, si të tilla, ato mund të shihen edhe si pjesë e sfondit sociokulturor. Anasjelltas mund të argumentonim se, duke qenë se sfondi sociokulturor është pjesë përbërëse e dijes gjuhësore, mund të thonim se, si i tillë, ai mund të përcaktohet edhe si presupozim.
Presupozimet janë premisa që kushtëzojnë të kuptuarit, janë pjesë e kuptimit të synuar dhe të rrokur të thënies (në mënyrë implicite) si nga prodhuesi i thënies, tekstit, ashtu edhe nga marrësi i domethënies kryesore të një thënieje. Ato janë komponente ndërtuese të kuptimit dhe paraqesin parakushtet dhe parapëlqimet në të folur. Presupozimet, pra, janë pjesë e dijes sendore-nocionore, e cila përcaktohet nga konteksti social dhe kulturor. P.sh., fjala “*martohem*” në shoqërinë tonë para pak vitesh presupozonte, parë nga këndvështrimi i seksit femër, lidhje me një partner mashkull. Së fundmi, me njohjen edhe të martesave homoseksuale, kjo do të thotë edhe lidhje me partner të të njëjtit seks. Në shoqëritë civile perëndimore fjala “*martohem”* nënkupton të njëjtin informacion, aktivizon të njëjtën dije. Ndryshe nga martesa në institucione civile, ajo në institucione kishtare nënkupton lidhjen me një partner të seksit të kundërt, pasi institucionet fetare nuk e njohin martesën midis homoseksualëve.
Pra, kjo dije kushtëzohet nga faktorë socialë dhe kulturorë, të cilët ndikojnë në lindjen dhe kristalizimin e presupozimeve dhe bëhen pjesë e komponenteve kuptimore denotative.
Kështu, presupozimet kushtëzohen nga konteksti sociokulturor, nga ana tjetër edhe sfondi sociokulturor mund të ndikojë në lindjen e presupozimeve.

[50] Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*. Tiranë, 1999, fq. 307.
[51] Busse, Dietrich,*Textinterpretation: sprachtheoretische Grundlagen einer explikativen Semantik*. Opladen 1992, fq. 83 e në vijim.
[52] Shih, Schippan, Thea, *Lexikologie der deutschen Gegenwartssprache*. Niemeyer,1992.
[53] Busse, H., *Textinterpretation: sprachtheoretische Grundlagen einer explikativen Semantik*. Opladen 1992, fq. 83.

1.3 Përkufizimi i kuptimit si dije semantike

Teoritë e ndryshme mbi kuptimin, të skicuara më lart, lehtësojnë përkufizimin e kuptimit si dije semantike. Lidhja kuptim-dije semantike, dije semantike-dije enciklopedike, e përftuar në një sfond të caktuar sociokulturor, qartëson nga njëra anë ndikimin e këtij të fundit në rrokjen e kuptimit, nga ana tjetër domosdoshmërinë e përcaktimit të kuptimit si konfigurim të dijes.
Më poshtë do të përmendim shkurt ato qëndrime që qartësojnë të konceptuarit e kuptimit, të vlefshme për temën tonë.

- Nga modelet e shtjelluara nga strukturalistët mbi kuptimin u arrit në njohjen se kuptimi është njësi e ndashme në komponente semantike. Këto komponente semantike janë inventari me anë të të cilit gjuhësia përshkruan kuptimin e njësive gjuhësore si njësi të sistemit.
- Koncepti mbi kuptimin, si rezultat të aktit gjuhësor, qartësoi kushtëzimin e kuptimit të fjalës nga funksioni i saj, vuri theksin mbi përshkrimin e kuptimit gjatë përdorimit në kontekst dhe në një situatë komunikative. Me vlerë nga kjo teori është edhe pikëpamja se pjesë jo pak e rëndësishme e kuptimit është njohja e rregullave të përdorimit të fjalës dhe të situatës komunikative.
- Me anën e teorisë mbi kuptimin si rezultat i proceseve njohëse-mendore u arrit në përfundimin, se veprimtaria njerëzore, përfshirë këtu edhe aktin ligjërimor, drejtohet nga procese konjitive dhe se kuptimi duhet konceptuar si konfigurim specifik i dijes gjuhësore.

Për punimin tonë duhet ta përcaktojmë kuptimin si konfigurim të dijes semantike.
Konfigurimi i kuptimit si dije përfshin dijen statike (mbi sistemin, rregullat), dijen proceduriale (mbi mënyrën e ndërveprimit, aktin e komunikimit, dijen enciklopedike). Kuptimi është dija mbi:

- kuptimin referencial, si "klasë të objekteve, të cilave u referohet një formë (shenjë); pra dija mbi mënyrën dhe kushtet e lidhjes midis shenjës dhe të shenjuarit"[54];
- kushtet e përdorimit, këto janë "dije që nuk kanë të bëjnë me marrëdhëniet me objektet, çështjet, por që rezultojnë nga përdorimi i fjalës në një kontekst dhe situatë të caktuar."[55]
- traditat sociale, kulturore dhe historike, gjykimet dhe paragjykimet, këto janë "dija që – e mbështetur në gjuhë – lidhet me dijen mbi kuptimin, pa bërë pjesë në rrethin e ngushtë (bërthamën) të kuptimit referencial të fjalës."[56]

Edhe në semantikën konjitiviste „kuptimet përkufizohen si konfigurim njësish mentale që lidhen me format gjuhësore. Ato përmbajnë informacione, të cilat lidhen me procesin e komunikimit, dhe bëjnë të mundur t`i referohemi botës me mjete gjuhësore."[57]

[54] Schippan, Thea, *Lexikologie der deutschen Gegenwartssprache.* Niemeyer,1992, fq. 144.
[55] Schippan, Thea, *Lexikologie der deutschen Gegenwartssprache.* Niemeyer,1992, fq. 152.
[56] Po aty, fq. 153.
[57] Schwarz-Friesel, Monika, Einführung in die Kognitive Linguistik. 3., vollständig überarbeitete und erweiterte Auflage. Tübingen, A. Francke, 2008, f. 59.

Le ta qartësojmë këtë me një shembull. Kuptimi referencial ka të bëjë me dijen mbi të shenjuarin. Në fjalorin e gjuhës shqipe (FGJSH) jepet në këtë mënyrë kuptimi i fjalës *telefon* : "..... ; aparat i posaçëm me numra dhe me një dorezë, që shërben për të vendosur lidhjen, për të folur dhe për të dëgjuar; aparati dhe pajisjet e tjera që shërbejnë për këtë lloj ndërlidhjeje."[58] Çdo përdorues i këtij aparati i ka si pjesë të dijes përfytyrimet mbi paraqitjen e telefonit, p.sh., pajisjen e çdo telefoni me një receptor në formën e një guacke, një disku për formimin e numrave dhe, në kohët e sotme, edhe të tasteve dixhitale etj. Dija mbi kuptimin referencial e përdoruesve të thjeshtë është shumë më e vogël se e një tekniku telefonash; kufijtë midis dijes mbi kuptimin referencial dhe atij që ky referent ka për një specialist nuk janë të prera. Schippani vëren se "Në kuptimin denotativ përfshihen edhe ato komponente që kanë të bëjnë me qëndrimet e njerëzve ndaj të shenjuarit."[59] Për fjalën *telefon* mund të shënohen si vlera që i bashkëngjiten kuptimit referencial /i dobishëm/, /kursen kohën dhe punën/. Kuptimi i plotë i fjalës *telefon* përbëhet edhe nga komponente kuptimore që kanë të bëjnë me rregullat e përdorimit të saj, situatën komunikative. Nëse dikush thërret "Zoti Agron, telefoni!", personi në fjalë kupton që ka rënë zilja e telefonit dhe telefonuesi dëshiron të flasë me të. Ai do ta marrë receptorin në dorë dhe ndoshta do t`i përgjigjet "alo, urdhëroni".

Në komponetet kuptimore që kanë të bëjnë me situatën komunikative, siç e kemi përmendur, hyjnë edhe ngjyrimet (konotacionet). Nëse, p.sh., në gjermanisht në vend të fjalës "telefon" do të përdorej leksema tjetër "Fernsprecher", ky përdorim do të ishte tregues i kohës së përdorimit /e vjetëruar/ ose i fushës së funksionimit /administrative/. Ose, në të kundërt, përdorimi i termit "i phone" parakupton jo vetëm një aparat modern me kombinim mundësish për të telefonuar, naviguar, fotografuar etj, por është edhe tregues dhe shënjues i shtresës shoqërore dhe ekonomike që e përdor.

Kuptimi i ngjyruar (i mbishtresuar) nuk ka kufij të prerë me pjesë të tjera të dijes që nuk bëjnë pjesë në bërthamën kuptimore, por që janë të rëndësishme në rrokjen e kuptimit kompleks të fjalës. Dija që kanë njerëzit në Europë mbi telefonin, si një nga mjetet më të efekshme të komunikimit, mundëson edhe rrokjen e përmbajtjes së fjalisë "Që kur kam telefon, nuk po shkruaj më letra". Për përdorues të gjuhës, të cilët nuk kanë njohuri të tilla sociokulturore, rrokja e përmbajtjes së kësaj fjalie do të cënohej, edhe pse mund të njihej kuptimi i mjeteve gjuhësore të përdorura.

Nëse do të bënim një krahasim të përcaktimit të fjalës *telefon, celular* në FGJSH, me informacionet që i përftojmë nga konteksti sociokulturor, që paraqiten gjuhësisht nëpërmjet fjalës *telefon,* konstatojmë se këto komponente të dijes nuk janë të shënuara në fjalor. Megjithatë sfondi sociokulturor është i lidhur me kuptimin referencial dhe përcakton në mënyrë të ndjeshme dekodimin e leksemës në procesin e komunikimit.

1.3.1 Përcaktimi i specifikës së dijes semantike në raport me llojet e tjera të dijeve

Trajtimi teorik që i përshkruan kuptimet e fjalës si një kompleks njohurish, na mundëson vërtetimin e hipotezës, që në kontekste dhe situata të ndryshme, aktivizohen elemente të ndryshme të dijes, që në situata të caktuara, aktivizohen, aktualizohen vetëm elemente të veçanta, që kuptimet e fjalës nuk janë pasqyrime

[58] *Fjalori i Shqipes së Sotme Shqipe*, Tiranë 2002, fq. 1331.
[59] Schippan, Thea, *Lexikologie der deutschen Gegenwartssprache.* Niemeyer,1992, fq. 146.

statike të shënjuesit për formën, të cilat në ontogjenezën[60] dhe në filogjenezën[61] e tyre janë të pandryshueshme.
Sipas Schippanit kuptimet e fjalës konceptohen si " sasia e përbashkët e njohurive të shoqërisë, të cilat përzgjidhen dhe plotësohen nën ndikimin e situatës dhe të kontekstit."[62] Ata mund të përcaktohen si kompleks i njohurive/ dijeve, që lind nga pasqyrimi i objektit të shënjuar, nga vlerësimi i këtij objekti nga përdoruesit e gjuhës dhe nga përdorimi i leksemave. Pra, kuptimi paraqet njohuritë mbi përdorimin dhe perceptimin e leksemave. Ky koncept i kuptimit, i cili lidhet me karakterin procedurial dhe dinamik të komunikimit, na lejon të ngremë pyetje për ndërtimin e kuptimit të fjalëve në sistemin gjuhësor, për strukturën e ruajtjes (ngulitjes në tru) së tyre, dhe për kuptimet e fjalëve në gjuhën e folur. Me këtë lloj trajtimi të konceptit të kuptimit – trajtim të cilin gjuhësia e ka marrë nga psikologjia – na mbetet vetëm për të përcaktuar më saktë specifikën e dijeve/njohurive, të përcaktojmë lidhjet midis dijes mbi kuptimin dhe dijes enciklopedike. Nga diskutimet e derisotme për këtë çështje rezultojnë këto raporte:

- Si dije enciklopedike përcaktohet e gjithë dija njerëzore, të cilën e zotëron njerëzimi. Dija specifike për referentin, njohuritë profesionale janë pjesë e dijes enciklopedike.[63]
- Dija gjuhësore përfshin kuptimet, dhe elemente të dijes që lidhen me formën, me modele aktualizimesh të formës. Kjo parakupton që mund të përcaktohen si dije semantike vetëm ato elemente të dijes që lidhen me formën, kombinimet e tyre (p.sh. dija për pozicionin e gjymtyrëve të fjalisë).
- Kufiri midis dijes enciklopedike dhe dijes semantike paraqet vështirësi të mëdha, para së gjithash, se "të dyja i përkasin së njëjtës lloj dijeje, ato kanë karakter pasqyrues."[64] Schippan-i[65] shkruan në lidhje me këtë problem se e gjithë dija njerëzore e ka burimin në përvojën jetësore dhe procesin e pasqyrimit, i cili është rezultat i veprimtarisë praktike, komunikuese dhe konjitive. Prandaj nuk është e mundur as një ndarje strikte dhe as një përcaktim i dijes jashtëgjuhësore dhe i asaj mbi kuptimin. E domosdoshme – shton ajo – është të zbulohen marrëdhëniet e ndërsjellta midis dijes gjuhësore dhe asaj jashtëgjuhësore.

Lidhur me dy konceptet e sipërskicuara, Lutzeier-i shkruan: "Kuptimi gjuhësor leksikor përbëhet nga tërë faktet semantike të fjalëve, ndërsa kuptimi enciklopedik nga tërë faktet empirike mbi referentët. Në mënyrë hipotetike, ne mund të dallojmë lehtë fushën e kuptimeve gjuhësore nga ato jogjuhësore."[66]

---

[60] Ontogjeneza është historia e zhvillimit individual të organizmit që nga çasti i fekondimit. Shih, *Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe*. Tiranë, 2007, këtu fq. 414.
[61] Filogjeneza është procesi historik i zhvillimit të organizmave gjatë evolucionit të një lloji, të një gjinie ose të një familjeje. Shih, *Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe.* Tiranë, 2007, këtu fq. 192.
[62] Schippan, Th., *Probleme der semantischen Analyse,* në, Germanistische Mitteilungen, 27, 1988, fq. 8.
[63] Wotjak, Gerd, *Bedeutung und Wissenskonfiguration: Eine Quadratur des Kreises oder wie löst man den Gordischen Knoten*, në, ZfG, 8, 1987, fq. 703.
[64] Sih, po aty, fq. 703.
[65] Shih Schippan, Thea, P*robleme der semantischen Analyse,* në, Germanistische Mitteilungen, 27, 1988, fq. 7. Të njëjtin mendim ndan edhe Lutzeier, Peter Rolf.
[66] Lutzeier, Peter Rolf, *Linguistische Semantik.* Stuttgart, 1985, fq. 37.

1.3.2 Frame –model

Koncepti "frame" i përdorur në gjuhësinë e tekstit është një qasje për të shpjeguar mënyrën e lidhjes së dijes enciklopedike me atë gjuhësore. Koncepti "frame (konturi i dijes)" është një koncept i huazuar nga shkencat që studiojnë proceset njohëse, mendore. Ai përdoret për modelimin e proceseve me anën e të cilave ndërtohet kuptimi dhe mundësohet rrokja e tij. Sipas Heinemann/Viehwegerit, *frame* në psikologjinë konjitive përcaktohet si "sekuenca stereotipe e veprimit, mund të themi njëpasnjëshmëria vazhdimisht e përsëritshme e veprimeve."[67] *Frame* formojnë konturet për rrokjen e përmbajtjes, duke aktivizuar ato lloj informacionesh që kanë të bëjnë me skemat e ruajtura. Në këtë mënyrë, ato modelojnë pikërisht atë dije që lidhet me kuptimin e fjalës. E qartësojmë këtë koncept me një shembull: "*hap faqen* " përfshin dijen sipas së cilës hapja e saj do të thotë të mund të lexosh apo të shikosh diçka, dhe dijen mbi mënyrën e hapjes së saj nëpërmjet dorës. Në fushën e kompjuterit, kjo pjesë e dijes nuk mund të përdoret. Dija sociokulturore na ndihmon këtu për hapjen e një faqeje të re nëpërmjet një tasti. Ky shembull tregon se sfondi sociokulturor është i pranishëm edhe në modelimin e kontureve (frame). Prania e këtij sfondi i mundëson përdoruesve të kompjuterit reagimin përkatës për frazën "hap faqe të re", gjë që sqaron funksionin e sfondit sociokulturor si komponent i kuptimit.
Siç e përshkruam edhe në sythet më lart, kuptimi i fjalës mund të modelohet në mënyra të ndyshme. Këto modelime qartësojnë komponentet e kuptimit. Me modelin *frame,* sfondi sociokulturor paraqitet si komponent mendor (konjitiv) i kuptimit. Modelin e përshkruar më lart do ta përdorim për pjesën e analizës sonë, për të treguar se sfondi sociokulturor është kategori përbërëse e kuptimit, e cila drejton rrokjen e kuptimit në tekste.

1.4 Gjuha, proceset konjitive, emocionet

Gjuhësia konjitive hap shtigjet për ta parë kuptimin si konfigurim të dijes mbi bazën e proceseve konjitive, duke qëmtuar edhe vendin dhe rolin që luajnë emocionet në ngulitjen e kuptimit dhe dijes. Trajtimi dhe studimi i emocioneve, si kategori dhe vendi i tyre luajnë rol të rëndësishëm në receptimin e teksteve. Në gjuhësi studimi i emocioneve dhe ndjenjave ka pasur një vend shumë pak të rëndësishëm krahasuar me studimin e proceseve konjitive.[68] Por, në vitet e fundit, emocionet dhe ndjenjat janë bërë gjithnjë e më shumë objekt studimi i shumë disiplinave, ndër të tjera dhe i gjuhësisë. Studime në fushën e gjuhësisë neurologjike kanë dëshmuar, që emocionet dhe ndjenjat janë fenomene konstitutive jo vetëm të jetës dhe përvojës njërëzore, por janë edhe të paanashkalueshme edhe në kuptimin e proceseve konjitive.[69] Ishte pikërisht kjo rrymë në gjuhësi që në fillimet e saj trumbetonte një ndarje të proceseve konjitive nga faktorët emocionalë, domethënë trajtimin si sistem autonom të proceseve konjitive. Emocionet trajtoheshin në fillimet e kësaj rryme si faktorë që nuk duhet të merreshin në konsideratë në analizën e mjeteve gjuhësore. Ulrich shkruan:

---

[67] Heinemann, Wolfgang/Viehweger, Dieter, *Textlinguistik: eine Einführung.* Tübingen, 1991, fq. 71.
[68] Ndarja e mendjes nga trupi, e arsyes nga ndjenja ka karakterizuar gjithë imazhin e njeriut të kohës së re. Kërkime në shkecën e filozofisë, filologjisë dhe të konjicionit, por edhe konceptualizime të jetës së përditshme përshkohen nga një dualizëm i mendjes dhe trupit, i mendimit dhe ndjenjës. Në diskutimet në rrethet shkencore dhe joshkencore emocionet kishin statusin e dukurive shoqëruese me efekte negative. Shih, Schwarz-Friesel, *Sprache und Emotion*, 2007, f.281.
[69] Shih, Schwarz-Friesel, *Sprache und Emotion*, 2007, f. 278

> "Qasja konjtive në fillimet e saj krijoi një imazh paradoksal të njeriut. Nga njëra anë ajo rehabilitoi plotësisht vetëdijen…; nga ana tjetër, e cungoi marrëdhënien person-mjedis me një dimension thelbësor, përkatësisht atë të përjetimit të ndjenjave."[70]

Prurje dhe zbulime në shkencën e neurologjisë e lëkundën këtë pozicionim. Proceset konjitive nuk shihen më si sisteme autonome.[71] Këto sisteme nuk janë module plotësisht të pavarura, por ndikohen padyshim nga parametra kulturore.[72] Edhe strukturimi dhe konceptualizimi i botës nëpërmjet proceseve njohëse mendore bazohet në modele sociokulturore. Kjo njohje vërtetohet edhe nga analiza empirike.[73]

Pohimi bazë i gjuhësisë konjtive që mundëson edhe integrimin e emocioneve në gjuhë, është ai që e sheh gjuhën si një sistem njohjesh dhe dijesh të organizuara në shumë nivele (rrafshe). Kjo qasje e konsideron gjuhën si një pjesë të qenësishme të aktiviteteve mendore njohëse e paraqitur në neuronet e trurit njerëzor.

Qasja e gjuhësisë konjitive ndaj emocioneve mundëson trajtimin e emocioneve jo më si dukuri shoqëruese të gjuhës, por si sisteme të njohjes dhe vlerësimit; e për më tepër, nxjerr në pah edhe ndikimin e tyre në ngjizjen e kuptimit të njësive gjuhësore.

1.4.1 Emocionet si sisteme njohëse dhe vlerësimi

Nëse flasim për emocionet si sisteme të njohjes, më parë duhet të ndalemi në dallimin e tyre nga gjendjet e tjera të ngjashme apo të afërta me to. Për emocionet ka përkufizime të ndryshme në varësi të qasjes. Kështu ato konsiderohen në këndvështrime të ndryshme si fenomene afektive, psikofiziologjike apo motivuese, situative apo sindromatike, ekspresive apo adaptive.
„Emocionet" duhen ndarë nga „gjendjet afektive", „ndjesitë" apo „instinktet". „Ndjesitë" janë ndjeshmëritë që shoqërojnë gjendje apo procese, ato përfshijnë komponente elementare të përjetimeve, të ndjeshmërive. „Gjendjet afektive" janë trazime, gjendje agjitimi; një gjendje afektive duhet kuptuar si një gjendje emocionale intensive, së cilës i mungojnë komponentet emocionale të vetëdijshme; një gjendje trazimi, e cila ashtu si edhe reflekset nuk mund të kontrollohet nga njerëzit. „Instiktet" prezantojnë ato vlera të domosdoshme të njeriut të cilat sigurojnë një ndjesi të ekuilibruar të organizmit, të cilat nuk mund të kontrollohen në mënyrë të vetëdijshme.[74] Këto tri fenomene janë të lidhura me njëra-tjetrën, ato mund të ndërveprojnë dhe të shkaktojnë emocione. Psh., ndjenja e mungesës së ushqimit apo lëngjeve mund të shkaktojë uri apo etje, që vlerësohen nga organizmi si ndjesi e pakëndshme, çka mund të ndjehet emocionalisht si parehati, e frikë apo edhe pafuqishmëri.

---

[70] Ulrich 1982, 74.
[71] Roth 2003 dhe Adolphs 2003 vërtetuan që sistemi limbik i trurit, që është përgjegjës për përpunimin e infomacioneve emocionale ndërvepron fuqishëm me areale kortikale.
[72] Sipas qasjes në gjuhësinë konjitive emocionet e përjetuara nga njerëzit janë universale, disa parametra, si, shkalla e intesitetit, mënyra e shfaqjes së emocioneve, shkalla e aktivizimit të emocioneve janë të kushtëzuara nga kultura.
[73] Shih, Hirschfeld,, Lawrencw A./ Gelmann, Susan, A., *Mapping the Mind. Domain Specifity in Cognition und Culture*, Cabridge, Cambridge University Press, 1994; Nuyts, Jan, *Epimestic, modality, language und conceptualization. A cognitive pragmatic perspective*. Amsterdam, Benjamin, 2001; Wengeler, Martin, *Linguistik als Kulturwissenschaft*, Hildesheim et al., Olms, 2006.
[74] Në dallimin e tri fenomeve jemi mbështetur në punimin gjuhësor të Schwarz-Friesel, *Sprache und Emotion*, Tübingen, 2007, f. 50 e në vijim.

Emocionet, pra, mund të shprehen nëpërmjet mjeteve jogjuhësore, si gjendje apo ndjesi trupore, ose t'i artikulojmë përmes shenjave paraverbale dhe atyre gjuhësore. Por, ato mund t' i ndeshim dhe paralelisht, p.sh., nëse ndiejmë një zemërim të madh, do të reagojmë përmes shenjave jogjuhësore të gjesteve dhe mimikës, me gjendje fiziologjike që shprehin trazimin, zemërimin, si edhe me shenja gjuhësore duke e verbalizuar atë çka ndjejmë qoftë me mallkim apo me të bërtitur, etj. Emocionet shoqërojnë, pra, gjendje të caktuara të aktiviteteve (si, zemërim, hutim, pasiguri, vigjilence, lodhje), ato motivojnë, përkatësisht, shkaktojnë modele, skema sjelljeje apo veprimi. "Emocionet" rezultojnë të jenë procedura sjelljeje apo përjetimi komplekse të organizuara në shumë nivele.[75] Forma të caktuara të shprehjes së emocioneve janë universale, pra, të lindura, të tjera formohen nën ndikimin e faktorëve socialë; ato mund të jenë edhe specifike për role apo gjini të ndryshme.

Studime të ndryshme ndërkulturore dëshmojnë se "display rules", d.m.th., format e manifestimit, të shprehjes së gjendjeve emocionale që u nënshtrohen disa rregullave, janë të ndryshme. Në ceremonitë mortore, në Shqiprëri, shprehet pjesëmarrja në këtë fatkeqësi nga gratë, duke vajtuar ulur përqark arkivolit dhe nga burrat, përmes qëndrimit së bashku në vendin e fatkeqësisë. Ndryshe shprehet ky emocion, p.sh., në Belgjikë, ku njerëzit e shprehin përfshirjen e tyre emocionale në këtë fatkeqësi duke përplasur duart gjatë kortezhit mortor.[76]
"Emocionet", si kategori përjetimi, janë të lidhura pandashmërisht me funksionet e trupit të njeriut. Ky ndërveprim midis emocioneve dhe ndjenjave të trupit njerëzor shprehet gjuhësisht përmes shprehjeve frazeologjike, si:

> Zemra m'u helmua/ bë copë nga mërzia; zemra më lëngon. (Das Herz blutet/bricht mir vor Kummer)
> Ma fitoi zemrën. (Sein ganzes Herz gehört ihm/ihr.)
> Më qan zemra/shpirti. (Das Herz schnürt/krampft sich jemandem zusammen vor Mitleid.)
> M`u ngritën zorrët deri në grykë. (Jemandem hängt der Magen in der Kniekehle.)[77]

Emocionet duhen dalluar si kategori që janë të pranishme në organizmin e njeriut, në strukturën e personalitetit dhe në psikikën e tij, duke ndikuar në këtë mënyrë konceptualizimin e botës prej njeriut. Rrafshi i konceptualizimit të emocioneve shprehet me mjete gjuhësore.

Emocionet mund të kategorizohen përmes kriterit të përfaqësuesit më tipik të tyre, pasi, nga njëra anë, nuk mund të pretendojmë një ndarje të saktë të tipeve të ndryshme të emocioneve dhe, nga ana tjetër, as barazi midis përfaqësuesve të një klase.[78] Ndarja

---

[75] Shih, Schwarz-Friesel, Monika, *Sprache und Emotionen*, Tübingen, 2007, f. 57.
[76] Ky zakon ka qenë më parë edhe në Malësinë e Madhe, në veri të Shqipërisë.
[77] Krahasimi i gjegjësve të shqipes me gjermanishten dëshmon atë çka përshkruam në këtë syth, që shprehja e emocioneve, konkretisht, ajo gjuhësore mund të jetë e ndryshme në kultura të ndryshme. Ndjenja e „neverisë" shprehet në të dyja gjuhët me gjendje emocionale të përjetuara në raste ndjesish të tilla. E ndryshme është mënyra e kombinimit të organeve. Në shqip, ndjenja e neverisë perceptohet dhe përjetohet duke e lidhur me lëvizjen e zorrëve, në gjermanisht me atë të stomakut. Në një studim krahasues midis lidhjes apo kushtëzimit kulturor të shprehjeve metaforike me fjalë bazë, organet njerëzore në gjermanisht dhe në shqip dëshmohet një lidhje e tillë. Shih, Gladiola Sadiku 2013, f.155-163.
[78] Qasja aristoteliane për kategoritë sipas së cilës kategoritë janë paraqitja mentale e koncepteve abstrakte me kufij të qartë, të përshkrueshme kuptimisht si tërësi e përbërësve komponencialë, nuk mund të zbatohet për kategorizimin e emocioneve. Për të mundësuar një strukturim në kategori të

e emocioneve është e vështirë qoftë sipas kriterit të cilësive të brendshme – pra, sipas strukturës së tyre, - qoftë sipas kriterit të funksionit.[79] Ka gjithmonë probleme dhe raste që ndodhen në kufijtë e dy kategorive, të cilat dëshmojnë nga njëra anë që kategorizimi i emocioneve, por, nga ana tjetër edhe që ndarja në sistemin konjitiv nuk është e përvijuar qartë. P.sh., ndarja e kufijve midis emocioneve të tilla, si: ankth, frikë, panik, tmerr, drojë, tutë, merak, datë, lebeti, lemeri, llahtari është shumë e vështirë.
Në gjuhësinë konjitiviste pranohen si parametrat të domosdoshëm dhe thelbësorë për përshkrimin e emocioneve parametrat e intesitetit, kohëzgjatjes dhe vlerësimit.[80]
Shtjellimet e deritanishme nxjerrin në pah dy funksione të emocioneve: ato janë sisteme të njohjes dhe të vlerësimit. Si sisteme njohjeje, ato ruajnë modele të lindura, universale ose jo të lindura të sjelljes dhe të ndjenjave. Si të tilla, ato shoqërojnë aktivitetet konjitive. Si sisteme vlerësimi, ato përdoren nga organizmi për të gjykuar gjendje të brendshme apo të jashtme në varësi të situatës; për të marrë një vendim. Këto vlerësime kushtëzohen nga ndjenjat individuale, lidhen me impulse të veprimit, me aftësinë konjitive të individit ose me situatat përreth.
Emocionet kanë të bëjnë si me aktivitetet e ndërgjegjshme, por edhe me ato të pavetëdijshme të të gjithë organizmit njerëzor, çka do të thotë që ato shpesh janë të pandryshueshme.[81] Por, emocionet nuk përmbajnë vetëm komponente të pandryshueshme. Ato janë pjesërisht të ndikuara nga kultura dhe varen nga normat e vlerësimit dhe etike të një shoqërie. Këtë qasje e përkrahin edhe Grau dhe Keil. Sipas tyre, emocionet janë "procese kulturore komplekse, që kushtëzohen nga inovacionet e larmishme shoqërore dhe medio-teknike."[82]

Ky ndikim nuk prek të gjitha nivelet e emocioneve, por, pikërisht, atë kategori emocionesh që në introspektivë mund t'i përjetojmë, pra, ndjenjat. "Ndjenjat" janë vlerësime subjektive të gjendjeve emocionale të perceptuara në mënyrë të ndërgjegjshme. Edhe ndjenjat, ashtu si emocionet, kodifikohen me mjete gjuhësore.

---

emocioneve duhet të mbështetemi në qasjen e teorisë së prototipave, pra, në përcaktimin e përfaqësuesit më tipik dhe klasifikimin sipas shkallës së ngjashmërive me prototipin të elementeve të tjera të kategorisë.

[79] Tipologjizimi i emocioneve mund të bëhet duke u nisur nga struktura ose nga funksioni i emocioneve. Nëse do të nisemi nga struktura mund të dallonim emocione universale apo primare, që shfaqen në çdo kulturë dhe të tjerat që janë të fituara gjatë përvojës jetësore. Kategorizimi i emocioneve sipas funksionit të tyre bëhet mbi bazën e madhësive të cilat u referohen emocionet apo kushteve të situatës në të cilat lindin emocionet. Sipas këtij klasifikimi dallohen:emocione me ndihmën e të cilave njerëzit përkufizojnë marrëdhënien e tyre ndaj të tjerëve (dashuri, urrejtje, simpati, neveri, xhelozi); emocione, me anën e të cilave njerëzit u referohen sjelljes apo gjendjes së tyrë të brendshme (turp, pendim, komplekse, krenari); emocione të shkatuara nga faktorë të veçanta në situata të caktuara (hidhërim, gëzim, inat dhe interesim); emocione që lindin si reagim ndaj një kërcënimi dhe shkaktojnë simptoma të fuqishme të trupit (panik, tmerr, frikë).

[80] Intesiteti lidhet me shkallën e aktivizimit të emocioneve, e cila mund të jetë e fuqishme, e ngacmuar (e shkaktuar), e përmbajtur ose e qetë. Gjuhësisht ky parametër mund të kodohet me mbiemra që përcaktojnë dimensione, pjesëza, dhe/ose me pjesëza krahasuese. Kriteri i kohëzgjatjes përcakton emocionet që janë të përhershme në organizmin njerëzor nga të tjerat, por edhe rrjedhën kohore dhe ndryshueshmërinë e proceseve emocionale. Përshkrimi pozitiv apo negativ i një ndjenje sipas kritetit të vlerësimit do të thotë të përjetojmë vlerësimin subjektiv të vetvetes në një situatë dhe kohë të caktuar. Shih, Schwarz-Friesel, Monika, Sprache und Emotionen, Tübingen, 2007, fq. 71.

[81] Si aktivitete të pavetëdijshme emocionet nuk u nënshtrohen kontrolleve të ndërgjegjshme. Ato nuk mund të aktivizohen vetëdijshëm.

[82] Grau, Oliver/Keil, Andreas, *Mediale Emotionen. Zur Lenkung der Gefühle durch Bild und Sound.* Frankfurt am Main, Fischer, 2005, f. 14.

> "Gjuha shërben si mjet shprehës i ndjenjave dhe ndjesive tona. Me shenja gjuhësore i komunikojmë të tjerëve se si ndihemi, nëse jemi të mërzitur, inatosur, të lumtur apo të indinjuar. Gjuha na funksionon si mjet komunikativ, si instrument për të kodifikuar sipas përjetimeve personale gjendje emocionale subjektive."[83]

Funksionet e emocioneve, që janë relevante për gjuhën janë vlerësimi i të përjetuarës. Përjetimi mund të regjistrohet vetëm nëse më parë ka ndodhur një prezantim i vetëdijshëm, një konceptualizim, i cili është i lidhur në thelb me një konceptualizim të mëparshëm. Kur flasim për konceptualizim të ndjenjave, themi që kemi të bëjmë, padyshim, me procese konjitive.

Pjesë apo nënsisteme të sistemeve emocionale të vlerësimit janë edhe qëndrimet emocionale. Ato janë paraqitje e vlerësimeve në lidhje me fusha të caktuara referimi. Qëndrimet emocionale ndërthuren me konceptualizimin, ngërthejnë konceptualizimin e një fushe të caktuar që i referohemi. Bëhet fjalë për procese konjitive, që, si të tilla, janë të ndryshueshme dhe të formuara nën ndikimin e faktorëve socialë.

Qasja, sipas së cilës emocionet përfshijnë krahas komponenteve të pandryshueshme edhe komponente të ndikuara nga kultura dhe normat e vlerësimit të një shoqërie, është me vlerë për punimin tonë përqasës të evidentimit të vlerave të veprave të Kadaresë në shqip dhe në gjermanisht dhe, sidomos, në krahasimin e somatizmave me disa pjesë të trupti nga "Darka e gabuar" dhe "Gjenerali i ushtrisë së vdekur".

1.5 Koncepti, dija enciklopedike, emocionet

Koherenca e një teksti, pra përligjja e domethënies së një teksti, mundësia e njohjes së lidhjeve logjike të tekstit varet nga aktiviteti ynë mendor dhe nga dija enciklopedike e ruajtur në kujtesën tonë. Kjo mundësi njohjeje lidhjesh logjike drejtohet, padyshim, nga modeli i organizimit të botës së ruajtur në mendjen e receptuesit. Dija afatgjatë, e ruajtur në kujtesën afatgjatë ruhet dhe organizohet në formë konceptesh dhe marrëdhëniesh konceptore. Konceptet janë, si të thuash, bazat mbi të cilat operojnë proceset mentale, ato janë njësi të ruajtjes së informacioneve gjuhësore.[84] Si njësi procedurale të proceseve mentale ato u referohen përvojave dhe vlerës së njohjes dhe i prezantojnë ato në formën e një tipi ontologjik t (t: është qenie apo artefakt) me karakteristikat abstrakte që përcaktojnë kategorinë e referentëve apo edhe të entiteve të veçanta. Ndërthurja e koncepteve, marrëdhëniet midis tyre formojnë struktura komplekse të dijes të quajtura edhe skema.[85] Skemat prezantojnë informacione konceptuale mbi realie apo ndodhi të lidhura me njëra-tjetrën. Njësitë konceptuale të skemave, të konceptuara si variabla që prezantojnë karakteristikat tipike, marrin vlera konkrete në procesin e dekodimit, ose modifikohen në rast mospërputhjeje të konfigurimeve nga skema gjatë proceseve konjitive. Këtyre skemave u bashkangjiten edhe njohuri mbi emocionet, mbi format tipike të manifestimit të tyre, dukuri shoqëruese apo shkaktarë të tyre, etj.

---

[83] Schwarz-Friesel, Monika, Sprache und Emotionen, Tübingen, 2007, f. 11.

[84] Rryma të ndryshme gjuhësore kanë edhe qasje të ndryshme ndaj konceptit. Në strukturalizëm, Sosyri e sheh konceptin si pjesë të kundërt psikologjike të mbulesës tingullore të fjalës; Hjelmslevi e anashkalon përbërësen psikologjike të konceptit sosyrian dhe e paraqet domethënien mbi bazën e vlerës.

[85] Për skemat kemi folur edhe në sythet e mësipërme të punimit.

Gjatë proceseve produktive apo receptive të përdorimit të gjuhës përzgjidhen koncepte nga skemat, të cilat ngërthejnë dhe elemente jogjuhësore të dijes enciklopedike. Padyshim, një rol të rëndësishëm në këtë proces luajnë edhe faktorët emocionalë, që i bashkangjiten apo mbështjellin rrafshin e përmbajtjes së transmetimit të informacioneve. Pra, ekziston një lidhje e ngushtë midis strukturave gjuhësore, konceptuale dhe emocionale dhe thëniet apo formulimet e gjuhës mund të konsiderohen si gjurmë të proceseve konjitive dhe emocionale.

Për të paraqitur tërësinë e informacioneve që transmetojnë strukturat e tekstit, nuk mjafton vetëm mbështetja në funksionin pasqyrues të gjuhës dhe mënyrën e konceptualizimit të saj, por, siç e kemi trajtuar në pjesën e mësipërme edhe marrja parasysh e informacioneve të transmetuara në mënyrë implicite. Informacionet implicite në pjesën më të madhe pasqyrojnë vlerësime emocionale të marrësve të mesazhit të tekstit. Koncepte komplekse të emocioneve i ndeshim në formën e skemave mentale, më anën e të cilave mundësohet klasifikimi i përvojave individuale dhe fjalët emocionale i kodojnë këto përvoja.

Një qasje që bën të mundur gjetjen dhe përcaktimin e vendit dhe rolit të emocioneve është ajo konjitive, pohimi themelor e së cilës është që analiza e materialit gjuhësor mund të mundësojë edhe kapjen e gjendjeve apo proceseve konjitive dhe emocionale që janë themeli i çdo gjuhe.

Pikënisje e kësaj qasjeje është përkufizimi i gjuhës si një sistem dijesh dhe rregullash, parë nga ana funksionale si mjeti më i rëndësishëm, me ndihmën e të cilit paraqesim dhe i referohemi realitetit. Dija, edhe dija për forma të caktuara të shfaqjes dhe të kodimit të ndjenjave ruhet në formë konceptesh dhe manifestimesh gjuhësore të tyre. Përpos kësaj, njerëzit ruajnë në kujtesën episodike edhe forma të veçanta të përjetimeve të gjendjeve dhe proceseve emocionale të fituara nga përvoja e tyre individuale. E gjithë kjo dije, si edhe ajo konjitive, prezente në formën e skemave, prezanton imazhin e individit dhe të botës përreth, duke përfshirë edhe vlerësimet e tij. Pikërisht këtu ngërthehen qëndrimet emocionale si vlerësime të ruajtura në kujtesën afatgjatë për persona, ndodhi, realie.

Modeli i prezantuar parakupton, sigurisht, që si sistemet konjitive të njohjes, po ashtu edhe ato emocionale nuk janë fenomene plotësisht autonome dhe të izoluara nga njëra-tjetra. Ato paraqesin aspekte dhe sisteme të ndryshme të të njëjtit fenomen; të aktivitetit mendor njerëzor dhe të funksionit të ruajtjes të tij.[86] Këtë ndërveprim e ka vërtetuar neurologu Damasio përmes shembullit të pacientit të tij Elliot, mundësia për të marrë vendime e të cilit u lëkund, pas një operacioni për heqjen e një tumori në tru. Kjo sepse gjatë heqjes së masës tumorale ishin dëmtuar edhe qeliza të lobus frontalis (pjesë frontale të trurit), funksioni i së cilave ishte vlerësimi moral dhe ndjeshmëria.[87]

Të dyja sistemet dëshmojnë ndërveprime të shumëllojshme dhe reciproke. Informacionet emocionale mund të shkaktojnë fillimin e proceseve mendore, ose të lindin si rezultat i aktiviteteve konjtive. Por edhe aktivitete mendore mund të shoqërohen nga procese emocionale.

[86]Shih, Schwarz-Friesel, Monika, *Sprache und Emotionen*, Tübingen, 2007, f.112.
[87] Shih, Damasio, Antonio, R., *Descartes´Irrtum. Fühlen, Denken und das menschliche Gehirn*, München u.a., List, 1997, f. 66.

Kreu 2 Trajtimet teorike mbi kuptimin e teksit

2.1 Trajtimet teorike mbi kuptimin dhe përmbajtjen e tekstit

Për të shtjelluar objektin e studimit tonë, na duhet të shpjegojmë disa terma me të cilat do të operohet, dhe shpjegimi i të cilave do të çojë shkallë-shkallë në sqarimin e qëllimeve të synuara. Mund të fillohej me konceptin *kuptim teksti* apo *semantikë teksti*, si një proces i rëndësisë së veçantë në përqasjen që mund t`i bënim dy proceseve: *informimit* apo *interpretimit* dhe *analizës së komunikimit*. Kjo analizë nuk duhet të synojë vetëm zbulimin e asaj që quhet "individualiteti gjuhësor dhe artistik i autorit të tekstit", pasi pikënisje e analizës së kuptimit nuk është autori i tekstit, por vetë thënia.[88] Për të përcaktuar analizën e tekstit, duhet të përcaktojmë më parë qartë njësinë e analizës, tekstin. R. Ismajli shprehet se "Në rrugën drejt studimit shkencor të ligjëratës artistike dhe të ligjëratës në përgjithësi, nocioni i tekstit ka rëndësi të dorës së parë."[89] Për më tepër, gjuhësia, që nga gjysma e dytë e shekullit XX, vë në dukje rëndësinë e qëndrimeve sa më të orientuara drejt tekstit, sipas së cilit njerëzit komunikojnë me anë të teksteve dhe jo me anë të fjalive. Kjo gjë zhvendosi qendrën e studimit të gjuhësisë nga fjalia te teksti. Në lidhje me këtë kategori ka mendime e qëndrime të ndryshme si në mendimin gjuhësor shqiptar, ashtu edhe atë të huaj.
J. Thomai shkruan se "Tekst për analizë mund të jetë çdo thënie që ka një përmbajtje të plotë dhe të vetëqendrueshme.[…] Çdo tekst bazë përmban informacionin horizontal e pingul."[90] Domethënia pingule, "nënteksti", del nga domethënia horizontale, ajo nuk është përmbajtje e drejtpërdrejtë, por e nënkuptuar."[91] K. Dibra/ N. Varfi e përcaktojnë tekstin si "një strukturë hierarkike komplekse që përmban një numër *n* sekuencash – eliptike ose të plota – të të njëjtit lloj ose të llojeve të ndryshme."[92]
Në pragmatikën tekstore, [93] përcaktimi i tekstit shihet si "një varg, njëpasnjëshmëri gjuhësore e folur dhe e shkruar, që formon një njësi komunikimi."[94] Kjo parakupton që folësit (bashkëbiseduesit), për të shprehur atë që synojnë të thonë, të përdorin kodin gjuhësor në një mënyrë sa më të përshtatshme me situatën e caktuar. Ndërsa gjuhësia e tekstit[95] merr për objekt studimi tekstualitetin me përbërësit e tij, mes të cilëve më të rëndësishmit janë treguesit e kohezionit e të koherencës, që e bëjnë një tekst të mos jetë thjesht një vazhdimësi frazash.[96] Këto trajtime të tekstit janë bërë nga këndvështrime gjuhësore: teksti përcaktohet duke vënë këtë kriter kryesor: mjet komunikimi, ose një tërësi e organizuar shenjash gjuhësore, të cilat duhet të plotësojnë kritere të caktuara për të formuar një njësi si teksti.

---

[88] Shih, Thomai, Jani, *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1991, këtu, fq. 7.
[89] Ismajli, Rexhep, *Shumësia e tekstit*, Prishtinë, 1977, fq. 89.
[90] Thomai, Jani, *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1991, fq. 8.
[91] Po aty, fq. 13.
[92] Dibra, Klodeta/Varfi, Nonda, *Gjuhësi teksti*, Tiranë, Shblu, 2005, fq. 31.
[93] Sipas këtij këndvështrimi, teksti konsiderohet si njësi e përdorimit dhe e funksionimit të gjuhës dhe jo thjesht njësi përbërëse gjuhësore, që i nënshtrohet përshkrimit.
[94] Siouffi, Gilles/ Raemdonck Dan Van, *100 fiches pour comprendre la Linguistique*, Bréal, 1999, fq. 138.
[95] Gjuhësia e teksit si disiplinë e veçantë gjuhësore synon ta vështrojë tekstin në treguesit më qenësorë të shfaqjes dhe ekzistencës së tij. De Beaugreande dhe Dressler e përcaktojnë tekstin si një mundësi a rrethanë komunikative, që plotëson kritere të tilla të mëvetësishme, si: koherenca, kohezioni, ndërtekstualiteti, karakteri rrethanor, karakteri informues, qëllimi dhe pranueshmëria.
[96] Rastier, François, *Sens et textualité*, Paris, Hachette, 1989.

Por interpretimet dhe përkufizimet e teksteve mund të bëhen edhe nga këndvështrimet e semioticienëve, kulturologëve, estetëve etj.. Padyshim, edhe përcaktimet mbi tekstin, mbi cilësitë e tij, kriteret a parimet e përftimit të tekstualitetit etj., fitojnë ngjyresa të reja, që i bëjnë më të prekshme vlerat e tekstit.
Si më domethënës për punën tonë u zgjodh përkufizimi i Lechnerit, që e vështron tekstin si "një tërësi të strukturuar, që paraqet lidhje dialektike midis strukturave gjuhësore, gjuhëshoqëruese, jogjuhësore, të imazhit kompleks të realitetit, të situatës, fakteve, marrësit e dhënësit të një veprimtarie gjuhësore."[97]
Përkufizimet e shumta për tekstin kanë të përbashkët pohimin, se kuptimi i tekstit paraqet një kompleks kuptimesh të aktualizuara nëpërmjet shenjave gjuhësore të organizuara në tekst.
Një funksion vendimtar për ndërtimin e kuptimit të tekstit[98] kanë, sipas Lerchnerit[99], vetë tiparet e elementeve gjuhësore. Edhe nëse nuk i vlerësojmë si të tillë, ata përcaktojnë të kuptuarit e një teksti për lexuesin, në ndërgjegjen e tij.
Sipas një përkufizimi me drejtim psikolinguistik të tekstit, kuptimi i tij përcaktohet si "lidhje e motivit me qëllimin, një ekuivalent i kuptimit gjatë procesit konkret të individëve të veçantë, formë e ekzistencës së kuptimit në perceptimin individual, perceptim i cili mundësohet nëpërmjet marrëdhënieve që krijon individi me realitetin."[100]
Pra, kuptimi i një teksti nuk është një përmbajtje e detyrueshme, por lind gjatë raportit të informacionit të tekstit dhe asaj që rrok marrësi. Në një rast ideal, ka identitet midis asaj që transmetohet nga dhënësi dhe asaj që rroket nga marrësi. Por zakonisht kjo nuk ndodh. Teksti lind nga prodhues që gjenden në kushte, gjithsesi, të ndryshme nga marrësit e mesazhit, qoftë dhe në tregues të veçantë të këtyre kushteve, si p.sh., përvoja biografike-individuale, diferenca kohore etj..

Teksti letrar ka një kuptim të vetin të veçantë. Kjo veçanti qëndron në atë se teksti letrar nuk ka vetëm një kuptim, por ofron mundësinë e përmbajtjeve të ndryshme, realizuar nga lexues të ndryshëm, përmbajtje që mund të ndryshojnë nga ajo e synuar prej autorit. Këto lexime, kuptime të ndryshme të të njëjtit tekst letrar, janë realizime, aktualizime variabël të një konstanteje – teksit. Ky ndryshim midis kuptimit të synuar e atij të rrokur shënohet në letërsinë e sotme me emërtimin "diferencë hermeneutike."[101] Kjo diferencë është më e madhe dhe, për pasojë, marrësi paraqet mungesë kompetence tekstore, në rastet kur:

- teksti në gjuhën amtare paraqet distancë historike nga koha e sotme;
- teksti në gjuhën amtare paraqet diferencë ideologjike me këndvështrimin e marrësit;
- teksti është një përkthim nga një sferë tjetër kulturore.

[97] Lechner, G., *Sprachform von Dichtung*. Berlin, Weimar 1984, fq. 17.
[98] Këtu vlen të përmendet estetika receptive, që trajton varësitë thelbësore të teksteve artistike nga kontekstet ku ato shkruhen ose lexohen. Ajo merret veçanërisht me rolin e lexuesit si plotësues kuptimor-estetik. Objekt i saj nuk është vetëm vepra, por dhe procesi komunikues i saj me lexuesin. *Autori*, *vepra* dhe *lexuesi* janë tri madhësi me të cilat operon estetika receptive. Kjo estetikë bën dallimin midis tekstit dhe veprës letrare.
[99] Po aty, fq. 35.
[100] Leontjew, A.A., *Zur Psychologie der sprachlich-kommunikativen Einflussnahme*. Në, Probleme der Psycholinguistik. Berlin, 1975, fq. 59.
[101] Shih, Schutte, J., *Einführung in die Literaturtheorie*. Metzler, 2005.

Shqyrtimi i tekstit, tektit letrar, në varësi të kontekstit, situatave komunikative e thëniesore është futur si parametër në shqyrtimet e reja mbi tekstin. Kjo sepse "Konteksti bën pjesë në tekst, është pjesë e tij, ai çon në përftimin e kuptimit të tekstit, ashtu si teksti çon në efektin e tij.... Në tekst gjenden universale, arketipe, ideologema (thënie ideologjike sipas R. Bartit dhe J. Kristevës) që bëjnë 'kodin gjatë të shkruarit."[102]

Marrësi duhet të shkojë drejt tekstit i pajisur me një sasi kompetencash, si: njohje të mjeteve gjuhësore, njohje të modeleve të teksteve, strategji të deshifrimit të qëllimit e të kushteve të veprimtarisë komunikuese, koncepte e njohje historike, dije mbi sistemet shoqërore (edhe pse semantika e tekstit na mundëson të kuptuarit e tij edhe pa këto të fundit). Kjo (kthehemi tani në linjën fillestare), sepse teksti, përveç informacionit të shprehur gjuhësisht, përmban edhe informacion të pashprehur.
Të kalojmë në shpjegimin e termit *informacion i pashprehur gjuhësisht.* Etimologjikisht fjala *implikim* lidhet me fjalën latine *implicare*, që ka kuptimin: mbështjell, lidh. Prej këtej është zhvilluar kuptimi që kjo fjalë, tani me vlerë termi, ka në gjuhën frënge, konkretisht: *implicite*: qui est virtuellement contenu dans une proposition, un fait sans tres formellement exprimè[103], dmth., që përmbahet virtualisht në një fjali (jo realisht), një fakt që nuk shprehet gjuhësisht. Në terminologjinë gjuhësore gjermane termi ka zhvilluar dhe kuptime të tjera. Por mund të thuhet që kuptimi i sotëm i termit është ai që jepet në *Robert*, ku duket qartë lidhja me kuptimin e fjalës latine.
Edhe presupozimet bisedore, si edhe implikacionet lidhen me informacione të pashprehura gjuhësisht. Diferenca mes këtyre dy tipave të brendisë a informacionit është që presupozicionet janë informacione të planit të dytë, ndërsa implikacionet janë informacione të përvijuara në vetë domethënien e fjalëve dhe të frazave.
Hetimi, analiza e informacioneve të pashprehura gjuhësisht nga presupozimet apo implikacionet paraqet interes për punimin tonë, i cili është para së gjithash një punim përqasës. Në përkthimin e teksteve në gjuhë të huaja, siç do ta dëshmojë edhe analiza e disa veprave të Kadaresë, rrokja e informacioneve të tilla, luan një rol parësor. Në kristalizimin e informacioneve implicite është i padiskutueshëm ndikimi i sfondit sociokulturor, si pjesë e dijes, i përftuar në një kontekst të caktuar social dhe kulturor.

2.1.1 Semantika e tekstit

Në sythin II.1 theksuam që përkufizimet mbi tekstin janë të shumta. Sa të larmishme dhe të shumta janë teoritë mbi tekstin, po aq të begata janë edhe intepretimet dhe trajtesat mbi rrokjen e mesazheve që ato emetojnë. Studiuesi Plangarica shprehet: "Por nëse ata kanë krijuar dhe vazhdojnë të zgjerojnë hapësirat e një realiteti që shfaqet në elitën e shqyrtimeve dhe teorizimeve, mbetet po aq interesante edhe një hapësirë e dytë, ku tashmë nuk do të kërkohen, ndoshta, aq shumë teorizime e interpretime idesh, por analiza dhe shqyrtime vlerash, në kontekste konkrete, në realitete të përvijuara, që në përhershmëri emetojnë mesazhe që duhen receptuar."[104]

[102] Grivel, Ch., Production de l'internet romanesque. Un état du texte (1870/1880), un essai de constitution de la théorie, Volume complementaire. Mouton, 1973, f. 19-23, cituar sipas, Plangarica, Tomorr, Mbi lidhjet e gjuhësisë me letërsinë në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe letërsisë. Në, Konferenca e parë ndërkombëtare Arsimore e Shqipërisë, 7-8 dhjetor, 2012.
[103] Robert 1977, fq.
[104] Plangarica, Tomorr, *Në tekst për tekstin. Studime*. Elbasan, Sejko 2002, fq. 23

Semantika e tekstit është komplekse, çka pranohet në të gjitha diskutimet mbi të. Të diskutueshme në lidhje me të janë pyetjet: nga cilat elemente përbëhet ky kuptim kompleks, si mund të përshkruhet lidhja midis dijes gjuhësore dhe asaj jogjuhësore, cilat proceduara semantike shpien në ndërtimin e synuar të përmbajtjes së tij, nga cilat elemente realizohet kuptimi i synuar, çështje të cilat ndikohen dhe lidhen dhe me dukurinë e sfondit sociokulturor. Gjuhësisht paraqet vështirësi ndarja e semantikës së tekstit nga hermeneutika, si edhe gjetja dhe praktikimi i një sistemi metodologjik.

Në konceptin e J. Kristevës për tekstin, kuptimësia është një ndër parametrat më domethënës për përcaktimin dhe qasjen ndaj tij. Qasja ndaj tekstit si një përftesë dhe jo si një paraqitje parakupton dhe nënkupton tekstin si një hapësirë polisemike, ku ndërthuren shumë kuptime të mundshme.[105] Ajo dallon "kuptimin që i përket planit të prodhimit, të thënies, të komunikimit dhe punën kuptimore, që i përket atij në planin e paraqitjes, të përftimit, të shqyrtimit a të simbolizimit: është kjo punë që quajmë *sinjifiancë, domethënie, procesdomethënie* apo *kuptim në përvijim të vazhdueshëm* apo, më shkurt, *kuptimësi*."

Gjuhëtari Xh. Lloshi shprehet se analiza kuptimore e teksteve kërkon një ecuri metodologjike, përcaktimin e pikënisjes. Ai shton se "me një përgjithësim në vija të trasha do të kishim një shtrirje ndërmjet dy skajeve për secilën rrugë:

- Si pikënisje merret një mjet – ose tërësia e tekstit.
- Si pikënisje merret një dukuri që bie në sy – ose nisemi nga një skemë paraprake, apo nga një konstatim statistik.
- Si pikënisje merret një anë gjuhësore – ose një anë jashtëgjuhësore."[106]

Për të arritur deri te veçantia e realizimit të përmbajtjes, duhet të vendosim lidhjet midis elementeve të gjetura, duke i krahasuar ato edhe me elemente të ngjashme nga tekste të tjera, sidomos duke i krahasuar ato me variante të tjera, për po atë informacion. "Analiza tërësore e tekstit na jep një paraqitje tjetër të tekstit origjinal, në të cilin dalin të shpjeguara domethëniet e përmbyllura në origjinal…."[107]

Polenz, një gjuhëtar i njohur gjerman në fushën e kuptimit të tekstit, shprehet se, për të përshkruar përmbajtjen e tekstit duhet të mbahen parasysh "si premisat njohëse, mendore, ashtu edhe ato kulturore."[108] Kjo do të thotë që duhet të nisemi nga dija jogjuhësore dhe të paraqesim gradualisht, se ç`pjesë e dijes gjuhësore realizohet gjuhësisht. Ai përcakton si më poshtë llojet e dijeve, të cilat i përdor marrësi i mesazhit të emetuar për të nxjerrë përmbajtjen e një teksti:

- "Pjesa e dijes që i referohet dijes së përgjithshme: Dimë diçka për të gjitha objektet që kanë lidhje me një ndodhi, ngjarje, për të gjitha objektet që kanë referencë në realie. Këtu bëjnë pjesë "skema dhe modele"[109] për të cilat folëm edhe në sythin mbi modelimin e dijeve. Kjo është edhe pjesa e përbashkët e dijeve të dy partnerëve të komunikimit.

[105] Shih, *Dictionnaire des Genres et notions littéraire, Encyclopædia Universalis et Albin*, Paris, 2002, referuar sipas Tomorr Plangaricës, Në tekst për tekstin, Elbasan, 2005, f. 21.
[106] Lloshi, Xhevat, *Pragmatika dhe stilistika*. Tiranë, Toena 1999, fq. 19
[107] Po aty, fq. 19
[108] Polenz, Peter, *Deutsche Satzsemantik*. Berlin/New York, 1988, fq. 131 e në vijim.
[109] Shih, De Beaugrande, Robert-Alain/ Dressler, Wolfgang Ulrich, *Einführung in die Textlinguistik.* Tübingen, 1981.

- Konturi i dijes së një thënieje, që ka lidhje me kontekstin: Folësi/hartuesi i tekstit i referohet asaj pjese të dijes nga *pika A*, të cilën e vlerëson fillimisht të rëndësishme për të shprehur mendimin e tij.
- Pjesa e dijes me anë të së cilës folësi/hartuesi i tekstit shpreh gjuhësisht një pjesë të objekteve të referuara nga *pika B*, në mënyrë të tillë, që kjo veshje që ai i bën objekteve të referuara *në pikën B* të jetë edhe "pjesë e kuptimit gjuhësor, e mendimit të folësit apo hartuesit të teksteve".
- Pjesa e dijes, që sipas konvencioneve (marrëveshjeve) gjuhësore u referohet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë objekteve të referimit të *pikës B.* Këtu bëjnë pjesë kuptimet joreferenciale, jodenotative, që nuk kanë bazë sendore-nocionore. Edhe këto kuptime të emetuara nga testet janë pjesë e qëllimit të folësit/shkruesit.
- Pjesa e dijes që lidhet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë me kontekstin. Kjo pjesë e dijes nuk vishet nga folësi/shkruesi me mjete gjuhësore. Mendohet, se nisur nga konteksti (teksti dhe konteksti jogjuhësor), dëgjuesi/lexuesi e kupton qëllimin e folësit/shkruesit.
- Pjesa e dijes, që lidhet me interpretimin nga ana e dëgjuesit/lexuesit të asaj dijeje të shprehur nga folësi/shkruesi. Dëgjuesi/lexuesi mund të kuptojë, të pyesë, të ngrejë hipoteza, etj. në lidhje me qëllimin e folësit/shkruesit. Ajo lidhet me përvojat subjektive të marrësit të mesazhit të tekstit, me atë pjesë të dijes së cilës i referohet teksti."[110]

Ky përshkrim i dijes, i cili mundëson kuptimin e tekstit është me vlerë për analizën tonë, përcaktimin e kategorisë së sfondit sociokulturor, sepse interpretimet e tekstit që lidhen me përvojën subjektive të marrësit të mesazhit (domethënies) të emetuar, kushtëzohen nga sfondi sociokulturor. Dija enciklopedike, të cilën shkruesi apo folësi e përdor për të përshkruar kuptimin e leksemës, përcaktohet nga konteksti social dhe kulturor i folësit.

2.2 Veçantia e tekstit letrar dhe sfondi sociokulturor

Teksti letrar paraqet një formë të veçantë diskursive. Adam shkruan: "Përparësia e një teksti letrar është se ai është një hapësirë gjuhësore githnjë e re, madje e huaj, githsesi koherente dhe e zotërueshme, [...] por të cilën duhet ta rindërtosh...[111] Rindërtimi dhe interpretimi i një teksti letrar është i saktë, kur marrësi i mesazhit të emetuar e koncepton saktë përmbajtjen e tij. Përmbajtjen shoqëruese të kuptimit themelor autori Xh. Lloshi e quan *informacion plotësues.* Ai vëren se në fushën e stilistikës ky informacion është gjuhësor dhe jashtëgjuhësor.[112] Në „Stilistika dhe pragmatika" Xh. Lloshi arrin në përfundimin se „Forma gjuhësore e kumtimit, e ideve a e përmbajtjes së shprehur pasqyron edhe veçoritë e të menduarit e të situatës së komunikimit."[113] Ky pasqyrim mishërohet edhe gjuhësisht.

Një tregues i *informacionit plotësues* që shërben për rrokjen e saktë të semantikës së tekstit është informacioni sociokulturor. Ky informacion shërben si sfond ose rrethon si atmosferë objektet. Informacioni sociokulturor është një premisë e domosdoshme në interpretimin dhe në zbërthimin e teksteve të çdo lloj stili, është pjesë e pandarë e komunikimit.

Dukurinë e kontekstit sociokulturor do ta vëzhgojmë në rastin tonë në analizën e veprave në prozë nga Kadareja. Dhe kjo për arsyen e madhe, se krijimtaria e tij përmban gjuhë, sidomos leksik të markuar në pikëpamje sociokulturore. Hartimi dhe përvetësimi i tekstit letrar bëhet në mënyrë individuale. Kjo veçanti e bën këtë

[110] Shih, Polenz, Peter, *Deutsche Satzsemantik*. Berlin/New York 1988, fq. 133 e në vijim.
[111] Adam, J-M, Postface, në: Littérature e linguistique: Dialog ou coexistence? Le français aujourd'hui, Armand Colin/AFEF, décembre 2011a, f. 105, cituar sipas Plangarica, Tomorr, Mbi lidhjet e gjuhësisë me letërsinë në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe letërsisë. Në, Konferenca e parë ndërkombëtare Arsimore e Shqipërisë, 7-8 dhjetor, 2012.
[112] Shih, Lloshi, Xhevat *Stilistika dhe pragmatika*. Tiranë, Toena, 1999, fq 29.
[113] Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*. Tiranë, Toena, 1999, fq. 29.

strukturë një burim informacioni sociokulturor. Lidhur me këtë, Lerchneri thotë: „Letërsia operon më shumë me konceptime dhe formulime të veçanta – individuale, sesa me kuptime dhe formulime të përgjithshme. Këtu, në tekstin letrar, aktualizohen në një masë të madhe komponente kuptimore periferike, të cilat nuk luajnë pothuajse asnjë rol, p.sh., në një tekst shkencor.“[114]
Pikërisht në këto komponente kuptimore periferike bën pjesë dhe kuptimi sociokulturor.

Si veçori të tekstit letrar Busse nënvizon një lloj ndërprerjeje të koherencës tekstore me anë të vendeve bosh. „Këto vende bosh vendosen në tekst nga autorët me qëllim që t'u japin lexuesve mundësinë për të ndërtuar asociacione, për të imagjinuar përmbajtje që nuk janë dhënë në tekst në mënyrë eksplicite.“[115]
Këto vende bosh, siç i përshkruan Busse, janë hapësira manovruese për kuptimin dhe interpretimin e tekstit letrar ku është i pranishëm fiksioni.
Kështu, vendet bosh realizohen në tekst nga prodhuesit e mesazheve dhe plotësohen nga marrësit e mesazheve të emetuara. Busse flet për një gatishmëri dhe një prirje të përhershme për t'i mbushur hapësirat boshe. Kjo do të thotë se tekstit letrar i bashkangjitet gjithnjë një proces aktivizimi i informacionit sociokulturor.

2.2.1.1 Përcaktimi i kategorisë së sfondit sociokulturor si pjesë përbërëse e kuptimit

Implikacioni sociokulturor në kohët e fundit është bërë objekt i rëndësishëm studimi i semantikës. Teoritë semantike mbi kuptimin kanë arritur në njohje të reja mbi konceptin dhe kuptimin dhe e kanë përcaktuar sërish kuptimin. Kuptimi përkufizohet si dije specifike gjuhësore. Ky këndvështrim çoi edhe në rishikimin e raporteve të llojeve dhe sistemeve të ndryshme të dijes. Nga njëra anë, sfondi sociokulturor u përcaktua si komponent përcaktues i kuptimit, nga ana tjetër, njohuritë mbi konceptin e kuptimit, bën të mundur përcaktimin e kategorisë së sfondit sociokulturor.
Pol-i (Pohl) e përkufizon kategorinë e implikacionit sociokulturor si më poshtë:

- "Implikacioni semantik sociokulturor është pjesë përbërëse e kuptimit të leksemave;
- Implikacioni semantik sociokulturor duhet vështruar edhe i ndarë, edhe në lidhje me kuptimin referencial dhe të mbishtresuar (konotativ);
- Implikacioni semantik lind nga pasqyrimi i përgjithësuar i raporteve sociokulturore dhe denotative (sendore-nocionore).
- Implikacioni në sistemin gjuhësor është një mundësi, pra, një potencë që aktualizohet në tekst. Lidhja e leksemës me të tjerat krijon fushën leksikore.
- Aktivizimi i një lekseme të fushës leksikore në ndërgjegjen e marrësit të mesazhit të tekstit përcaktohet nga përvoja sociale dhe kulturore."[116]

Në bazë të analizave të materialeve gjuhësore tekstore është e vështirë të përcaktohet shkencërisht ajo pjesë e leksikut që është bartëse e sfondit sociokulturor. Qëllimi i punimit tonë është të përcaktojmë kategorinë e sfondit sociokulturor në aspektin teoriko-semantik, për ta përdorur më pas atë në rrokjen e kuptimit të veprave letrare të

[114] Lerchner, G., *Sprachform von Dichtung*. Berlin, 1986, fq.35.
[115] Busse, Dietrich, *Textinterpretation: sprachtheoretische Grundfragen einer explikativen Semantik*. Opladen, 1992, fq.184.
[116] Pohl, Inge, Identifikation und Wirkungsweise der semantischen Implikation soziokulturellen Hintergrundwissens (Teil I), botuar në, Gerhard Bartels/ Inge Pohl (botues), *Sprachsystem und sprachliche Tätigkeit*. Festschrift zum 65. Geburtstag von Karl-Ernst Sommerfeldt, Berlin, Bern, New York, Paris, Wien (Sprache – System und Tätigkeit 2), fq 243.

Kadaresë. Mënyra më e përshtatshme për ta përcaktuar gjatë analizës së teksteve sfondin sociokulturor, është ajo e lokalizimit sipas kategorive gjuhësore.

Sfondi sociokulturor mund të lokalizohet midis dijes gjuhësore dhe asaj jogjuhësore. Nëse do ta konceptonim kuptimin si dije semantike, atëherë edhe komponente të dijes sociokulturore do të paraqiteshin si pjesë përbërëse e kuptimit. Në fund të fundit, procesi i dekodimit, i rrokjes së kuptimit mundësohet vetëm nëpërmjet sfondit sociokulturor; kjo do të thotë, që mund të bënim një përcaktim të përshtatshëm të referentit, me ndihmën e sfondit sociokulturor. Prandaj sfondi sociokulturor është pjesë përbërëse e dijes mbi botën (enciklopedike), por që ka lidhje të drejtpërdrejtë me gjuhën. Për këtë arsye mund ta trajtojmë kategorinë e sfondit sociokulturor si pjesë të dijes gjuhësore. Pikërisht ky vështrim na ofron mundësinë për ta parë kategorinë e sfondit sociokulturor si kategori të përshkrueshme, çka do të thotë ta izolonim atë nga universi i dijes enciklopedike. Kategoria e sfondit sociokulturor, si pjesë përbërëse e kuptimit, përcaktohet nga këto veçori:

- Sfondi sociokulturor shënon kufirin midis dijes gjuhësore (midis dijes mbi kuptimin referencial) dhe asaj enciklopedike.
- Sfondi sociokulturor mund të trajtohet dhe të përshkruhet si pjesë përbërëse e kuptimit referencial.
- Sfondi sociokulturor përcaktohet nga faktorë shoqërorë, nga veçoritë e situatës dhe specifika e grupeve.
- Nga prania e sfondit sociokulturor, kuptimit referencial mund t`i bashkangjiten komponente kuptimore të veçanta.
- Sfondi sociokulturor ka, pikërisht nga lidhja e ngushtë që vendos me kuptimin referencial, funksion shenjues dhe drejtues në procesin e dekodimit dhe të rrokjes së përmbajtjes.[117]

2.2.1.2 Sfondi sociokulturor dhe ambiguiteti (dykuptimësia)

Ambiguiteti (dykuptimësia) është trajtuar nga gjuhëtarë të shumtë në punime të ndryshme.[118]
Kështu, Pinkali[119] u referohet teorive të filozofisë analitike të gjuhës, të cilat nisen në analizën kuptimore nga një e ashtuquajtur „gjuhë ideale“. Ai e trajton ambiguitetin si një nevojë për korrigjim të mangësive të gjuhës.
Përkundrejt këtij përcaktimi është trajtimi i ambiguitetit nga këndvështrimi i semantikës funksionale dhe pragmatike. Gjuhëtarët e këtij drejtimi e përcaktojnë shtrirjen, zgjerimin e kuptimit dhe rrokjen e tij si madhësi të ndryshueshme

[117] Shih, po aty, f. 246.
[118] Shih, Pinkal, Manfred, Kontextabhängigkeit, Vagheit, Mehrdeutigkeit, botuar në, Christoph Schwarze/ Dieter Wunderlich (botues) *Handbuch der Lexikologie*, Königstein/Ts. 1985, fq. 27-63, /Pinkal, Manfred, Vagheit und Ambuguität, botuar në, Arnim von Stechow/Dieter Wunderlich (botues), Semantik: *Ein Handbuch des zeitgenössischen Forschung. Semantik*, Berlin; New York, 1991,/ Wolfski, W. *Schlechtbestimmtheit und Vagheit. Tendenzen und Perspektiven.* Tübingen, 1980/ Wolf, D. *Zur Vagheit in der Entwicklung der Sprachzeichendeutung.* In: Diachrone Semantik und Pragmatik: Untersuchungen zur Erklärung und Beschreibung des Sprachwandels, Hrsg. v. W. Fleischer. Leipzig, 1991, fq 101-115/ Schippan, Thea, *Lexikologie und Lexikographie der deutschen Sprache*,Tübingen, Niemeyer, 1992/ Busse, Dietrich, *Textinterpretation: sprachtheoretische Grundlagen einer explikativen Sematik*, Opladen, 1992/ Rieger, Burghard, *Unscharfe Semantik: die empirische Analyse, quantitative Beschreibung, formale Repräsentation und prozedurale Modellierung vager Wortbedeutungen in Texten*. Frankfurt/M., Bern; New York; Paris.
[119] Shih Pinkal, Manfred, Vagheit und Ambuguität, botuar në, Arnim von Stechow/Dieter Wunderlich (botues), Semantik: *Ein Handbuch des zeitgenössischen Forschung. Semantik*, Berlin; New York, 1991, fq. 250.

individuale, situative, të kushtëzuar nga përvoja. Si rrjedhojë, vërejnë ata, ambiguiteti duhet të pranohet jo vetëm si një fenomen i gjuhës natyrore, por në funksionin e tij të konceptohet dhe të përcaktohet edhe si element ndërtues. Edhe brenda kësaj teorie jepen shkaqe të ndryshme që ndikojnë në lindjen e dukurisë së ambiguitetit.
Pinkali[120] e rendit dukurinë e ambiguitetit në strukturën e përshkrimit të polisemantizmit, duke e zgjidhur këtë problem nga pikëpamja e kategorive të trajtuara. Nga ana tjetër, Wolski i karakterizon gjuhët natyrore si të „përcaktuara keq", përkundrejt përcaktimeve të tilla si „ambige", „të papërcaktuara mirë".
Busse shton në lidhje me këtë se përcaktueshmëria jo e mirë është jo vetëm karakteristikë shtesë për gjuhën, por edhe pjesë ndërtuese e kuptimit të gjuhës, pjesë e cila mund të përcaktohet nëpërmjet rregullave të lojës.[121]

Shtrohet pyetja e lidhjes së sfondit sociokulturor me problematikën e ambiguitetit. Kategorinë e sfondit sociokulturor e përcaktuam si një konstrukt të lidhur me kuptimin referencial, sendësor e nocionor, i cili e merr "substancën" e tij nga dija enciklopedike (jashtëgjuhësore). Nëse kemi parasysh faktin që komponentet e dijes janë individuale, mund të themi se individuale është edhe baza e sfondit sociokulturor. Në këtë mënyrë mund të kushtëzojnë njëri-tjetrin sfondi sociokulturor dhe ndryshueshmëria e kuptimit.
Wolfi shprehet në lidhje me këtë se "Ambiguiteti nuk është produkt dytësor i shenjës gjuhësore dhe rrokjes së kuptimit, por shërben në funksion të rrokjes së kuptimit të shenjës dhe interpretimit të saj. Nga ana tjetër, ambiguiteti kushtëzon interpretimin, ndryshueshmërinë dhe procesin e rrokjes së kuptimit të shenjës gjuhësore. Interpretimi i shenjës gjuhësore është i mundur vetëm atëherë, nëse kuptimi nuk është i plotë dhe i përcaktuar përfundimisht, është i hapur, ç`ka do të thotë që ky kuptim është pjesërisht ambig dhe pjesërisht i papërcaktuar"[122].

2.2.2 Teksti, sfondi sociokulturor dhe konteksti

Shqyrtimi i tekstit, tektit letrar, në varësi të kontekstit, situatave komunikative e thëniesore është futur si parametër në shqyrtimet e reja mbi tekstin. Kjo sepse "Konteksti bën pjesë në tekst, është pjesë e tij, ai çon në përftimin e kuptimit të tektit, ashtu si tekti çon në efektin e tij.... Në tekst gjenden universale, arketipe, ideologema (thënie ideologjike sipas R. Bartit dhe J. Kristevës) që bëjnë 'kodin gjatë të shkruarit."[123] Nga ana tjetër, shqyrtimi i sfondit sociokulturor si parametër i domosdoshëm në vlerat e tekstit treguam se ishte po kaq i rëndësishëm.
Për të përshkruar lidhjet që vendosen midis sfondit sociokulturor dhe kontekstit, do të merremi me ato elemente sociokulturore që karakterizojnë kontekstin kulturor. Ammeri e përshkruan kontekstin kulturor me ndihmën e elementeve të kuptimit, me

[120] Shih, Pinkal, Manfred, *Kontextabhängigkeit, Vagheit, Mehrdeutigkeit*, botuar në, Christoph Schwarze/ Dieter Wunderlich (botues) Handbuch der Lexikologie, Königstein/Ts. 1985, këtu fq. 27 e në vijim.
[121] Busse, Dietrich, *Textinterpretation: sprachtheoretische Grundfragen einer explikativen Semantik*. Opladen, 1992, fq. 45.
[122] Wolf, Dieter, Zur Vagheit in der Entwicklung der Sprachzeichendeutung, botuar në Dietrich Busse (botues), *Diachrone Semantik und Pragmatik: Untersuchungen zur Erklärung und Beschreibung des Sprachwandels*, Tübingen 101-105, 1991, këtu fq. 109.
[123] Grivel, Ch., Production de l'internet romanesque. Un état du texte (1870/1880), un essai de constitution de la théorie, Volume complementaire. Mouton, 1973, f. 19-23, cituar sipas, Plangarica, Tomorr, Mbi lidhjet e gjuhësisë me letërsinë në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe letërsisë. Në, Konferenca e parë ndërkombëtare Arsimore e Shqipërisë, 7-8 dhjetor, 2012.

anë të situatave, konteksteve. Ai shkruan: "...atje ku për veprat letrare nuk na ndihmon më situata, konteksti i tekstit, na ndihmon konteksti kulturor (cultural background)", term të cilin ai e huazon nga Otto dhe Malinovski. Kontekstin kulturor ai e përshkruan si një "lidhje të të gjithë dijes sonë gjuhësore me ato elemente ndihmëse për të kuptuarin, të cilat janë zhvilluar mbi bazën e kulturës së përbashkët.[124] Ashtu si Ammeri, edhe Coseriu e përkufizon kontekstin jashtëgjuhësor si "gjithçka që ka të bëjë me traditat kulturore të një komuniteti. Termi "komunitet" përdoret si për një grup të vogël shoqëror, ashtu edhe për të gjithë shoqërinë njerëzore. Këtu numërohen, p. sh., mitologjia, … ...të gjitha faktet të cilat komuniteti i njeh si rezultat të punës së shkencëtarëve apo shkrimtarëve."[125]

Të njëjtin mendim me të ndan dhe Schippani, e cila e përcakton kontekstin kulturor si "përvoja e një komuniteti, që krijohet nga jeta e përbashkët, nga lidhjet e ndërsjella, nga kultura e përbashkët, tradita etj.."[126]

Pyetja, nëse konteksti është faktor përcaktues i kuptimit apo leksema mbart elemente të paqendrueshme, merr përgjigje nëse do të kemi parasysh se në kontekste të caktuara "nuk krijohen kuptime të reja të fjalës, por aktualizohen vetëm mundësitë që ekzistojnë në sistemin gjuhësor, në gjuhë (langue).[127] Wotjaku shprehet në lidhje me këtë çështje, se nëse do të ishte konteksti ai që do të përcaktonte kuptimin, atëherë do të kishim një pafundësi kuptimesh të leksemave në kontekse të ndryshme.[128] Kjo do të thotë që fjalët mbartin elemente në kuptimin e tyre, të cilat pasqyrojnë veçori të kontekstit socio-kulturor. Pra, mund të themi se sfondi sociokulturor është pjesë e semantikës (domethënies) së leksemave.

2.2.2.1 Roli i kontekstit sociokulturor në prodhimin dhe rrokjen e kuptimit të tekstit letrar

Në kapitujt e mësipërm trajtuam çështje të kuptimit të leksemave, marrëdhëniet e vendosura midis dijes gjuhësore dhe asaj enciklopedike, modelimin e dijes me anë të proceseve njohëse, mendore, për të zbuluar lidhjet apo ndikimin e sfondit social dhe kulturor në rrokjen e kuptimit, pra, për fjalët si treguese dhe bartëse të informacionit sociokulturor. Por fjalët e manifestojnë vlerën e tyre në tekst. Nuk mund të trajtohet dukuria e sfondit sociokulturor pa u marrë me tekstin. Vërtet fjala mund të përmbajë disa komponente kuptimore, disa konotacione e ngjyrime llojesh të ndryshme, por nga kombinimi i fjalëve në njësi më të mëdha komunikuese, sidomos në tekst, domethënia sociokulturore merr një përmasë tjetër më të gjerë e më shprehëse. Dihet që teksti operon me zgjedhjen e fjalëve jo vetëm në sistem, por edhe me kombinimin e tyre në struktura sintaksore. Forca e zgjedhjes buron nga zgjedhja dhe nga kombinimi i saktë. Në shumëllojshmërinë e teksteve, teksti letrar përmban më shumë informacion dytësor të llojit sociokulturor.
Duke iu referuar *Dictionnaire des Genres et Notions littéraires,* studiuesi T. Plangarica thekson: "Teoria aktuale e tekstit madje mënjanohet, shmanget prej *tekstit-thurimë* dhe kërkon të shqyrtojë endjen dhe procesin e përvijimit të saj, të shqyrtojë

[124] Ammer, Karl, *Einführung in die Sprachwissenschaft. Bd. 1*, Halle (Saale), 1958, fq.69.
[125] Coseriu, E., *Textlinguistik: Eine Einführung*. Tübingen, 1981, fq. 99.
[126] Schippan, Thea, *Einführung in die Semasiologie*. Leipzig, 1975, fq. 102.
[127] Lewandowski, Theodor, *Linguistisches Wörterbuch*. Heidelberg, Wiesbaden (3 Bde.), 1990, fq. 579.
[128] Wotjak, Gerd, *Bedeutung und Wissenskonfiguration: Eine Quadratur des Kreises oder wie löst man den Gordischen Knoten*. In: ZfG, 8, 1987, fq. 83.

tekstendjen, teksturën, në gërshetimin apo përftimin e kodeve, të formulave të kuptimeve në gji të të cilave subjekti vendoset dhe zhvendoset, bëhet dhe zhbëhet, duket dhe zhduket, si një merimangë që s`dallohet në rrjetën e endur prej saj vetë."[129]
Në këtë qëndrim bëhet akoma më e qartë rëndësia dhe vështirësia e përcaktimit të kuptimit të tekstit dhe lidhja e tij me elemente jashtëgjuhësore, siç është dukuria e sfondit sociokulturor. Për këtë arsye, në kapitujt në vijim do ta trajtojmë rolin e sfondit sociokulturor në rrokjen e kuptimit të tekstit.

2.2.2.2 Konteksti sociokulturor në tekstet historike

Aftësia për të kuptuar e për të interpretuar tekste është dukuri sociale, prandaj është e ndryshueshme. Këtu vlen të bëhet dhe një dallim midis *kuptimit* dhe *interpretimit* (të tekstit). Duke i dalluar këto dy koncepte, Busse thotë se të kuptuarit e tekstit është një proces intuitiv, ndërsa interpretimi është një proces i ndërgjegjshëm dhe aktiv për sqarimin e tekstit. Interpretimi nuk mund të reduktohet në të kuptuarit e tekstit.[130]
Duke qenë se të kuptuarit dhe të interpretuarit e teksteve janë të përcaktuara nga kushtet sociale, mund të thuhet që tekstet historike lexohen dhe interpretohen ndryshe nga lexuesit e sotëm, domethënë ndryshe nga lexuesit bashkëkohës të autorit të tekstit. Distanca kohore midis prodhimit dhe receptimit të tekstit e pakëson volumin e njohurive të përbashkëta midis prodhuesit dhe marrësit e mesazheve. Kur flasim për diferencë njohurish, kemi të bëjmë para së gjithash me njohuritë sociokulturore. Të kuptuarit e një teksti historik është i lidhur ngushtë me sqarimin e informacionit sociokulturor që përmban ai, të shprehur ose të pashprehur gjuhësisht. Përdorimi i fjalorëve historikë është në këtë rast një domosdoshmëri .

Ndikimi i sfondit sociokulturor në interpretimin e teksteve me ngjyrime sociale është i ndjeshëm. Edhe në kuadrin e gjuhës së sotme, konotacionet sociale të fjalorit luajnë rol të madh në interpretimin e teksteve. Kështu tekstet e krijuara në periudhën komuniste përmbajnë veçori të përdorimit të atëhershëm gjuhësor. Dekodimi i këtyre teksteve kërkon informacion për sfondin sociokulturor të kësaj kohe, krahas kompetencës vetiake gjuhësore. Veçoritë specifike të ligjërimit dhe të komunikimit të periudhës kohore në fjalë nuk duhen reduktuar vetëm në dukuri leksikore. Koha ka lënë gjurmë në të gjitha rrafshet gjuhësore, që nga ai fonetik deri në nivelin sintaksor dhe tekstor. Antroponimet, emërtimet e institucioneve shtetërore, emërtimet që shënonin dukuri politike-ideologjike, emërtimet e mallrave etj. përbëjnë klasa tematike që mbajnë shenjën e kohës.[131]

Edhe në analizën dhe interpretimin e veprës së Kadaresë "Prilli i thyer" është i domosdoshëm aktivizimi i sfondit sociokulturor, d.m.th. i njohurive mbi Kanunin,

---

[129] *Dictionnaire des Genres et Notions littéraires*, Encyklopædia Universalis et Albin Michel, 2-e édition, Paris 2001, cituar sipas Plangarica, Tomorr, *Në tekst për tekstin. Studime*. Elbasan, Sejko, 2002, fq. 22.

[130] Shih, Busse, Dietrich, *Textinterpretation: sprachtheoretische Grundfragen einer explikativen Semantik*. Opladen, 1992, fq. 187.

[131] Mbetet një detyrë e gjuhësisë së sotme trajtimi i sfondit sociokulturor në fjalorin dhe në gjuhën e periudhës komuniste, i cili deri tani ka qenë i ideologjizuar dhe politizuar nga regjimi socialist. Shumë tekste të prodhuara në atë kohë nuk mund të kuptohen dhe të interpretohen drejt pa shpjegime sociokulturore. Vlen të trajtohen fusha të tëra tematike, me gjithë raportet antonimike të vendosura mes leksemave të saj, kontekstet pragmatike, stilet tekstore dhe dukuri të tjera gjuhësore. Ky trajtim kërkon bashkërendim të punës midis gjuhëtarëve, sociologëve dhe psikologëve.

mbi dukurinë e gjakmarrjes në veri të Shqipërisë. Pa njohuri të tilla, nuk do të mund të kuptoheshin dhe interpretoheshin dukuri gjuhësore që prekin jo vetëm leksema të veçanta, kombinime të tyre në togje dhe formula kanunore, por edhe ato të rrafshit gramatikor dhe sintaksor.

2.2.3 Lokalizimi i informacionit sociokulturor në kategoritë gjuhësore

Sfondi sociokulturor luan një rol të rëndësishëm në receptimin e kuptimit dhe domethënies së teksteve. Por jo të gjitha fjalët e leksikut evokojnë të dhëna sociokulturore. Vetëm klasa të caktuara fjalësh, me atmosferën e tyre konotative, arrijnë të na çojnë në mjedise, në kohëra dhe në situata të caktuara kulturore. Në vijim ne do t`i emërtojmë këto klasa dhe do të përshkruajmë funksionin e tyre evokues sociokulturor, të cilat do t'i përdorim të grupuara edhe për analizën e veprave të Kadaresë.

2.2.3.1 Aktivizimi i njohurive metagjuhësore

Kategoria e informacionit sociokulturor është një kategori e ndërmjetme, ajo qëndron midis dukurive gjuhësore dhe atyre enciklopedike. Aktivizimi i informacionit sociokulturor bëhet shpesh në formë metagjuhësore.
Metakomunikimi mund të jetë i shprehur ose jo. Në metakomunikimin gjuhësor folësi përdor mjete gjuhësore, thënie, të cilat i saktëson, i korrigjon, i shpjegon, i modifikon po me mjete gjuhësore (për të qenë sa më i kuptueshëm nga dëgjuesi).
Metakomunikimi i pashprehur gjuhësisht (ose analog), por i nënkuptuar, bazohet në lidhjen midis partnerëve komunikues dhe është kryesisht jogjuhësor. Ai përbëhet nga sinjale të ndryshme trupore, jogjuhësore.
Si metakomunikimi i shprehur, ashtu edhe ai i pashprehur përdoren për të sqaruar situatat dhe përmbajtjet komunikative, për të shmangur keqkuptimet, për të korrigjuar gabimet e mundshme. Informacioni sociokulturor përmbush një funksion metakomunikativ dhe mund të shfaqet si dukuri metagjuhësore. Kështu, kjo kategori e ka vendin në zonën me konture jo të përcaktuara midis njohurive enciklopedike dhe atyre gjuhësore. Ajo shënon kufirin midis këtyre dukurive. Ky informacion, që përmbledh përvojën shoqërore të bashkësisë gjuhësore, përvojë historikisht e ndryshueshme, i bashkangjitet kuptimit denotativ.

2.2.3.2 Leksiku i gjuhës së përditshme

Leksiku i gjuhës së folur, si mjet i komunikimit në jetën e përditshme, është leksiku i ligjërimit bisedor. Edhe ligjërimi bisedor ka një mori elementesh leksikore që përmbajnë informacion sociokulturor. Ligjërimi i bisedave, me shoqërim idesh, të kujton ngjyresën sociale të përdoruesve të tij, njëkohësisht jep informacion mbi kohën dhe situatat ligjërimore. Është i njohur fakti që ligjërimi bisedor ka një gjallëri dhe shprehësi të veçantë. Si të shkruara, edhe të folura, njësitë leksikore të ligjërimit bisedor përmbajnë gjithnjë një atmosferë të pasur konotative. Këtu gjëllin edhe informacioni sociokulturor.
Leksema të këtij regjistri mund të jenë bartëse të sfondit sociokulturor. Në këtë regjistër është i dukshëm aktivizimi i dijes semantike – së bashku me sfondin sociokulturor – për të arritur rrokjen e kuptimit ose interpretimin e thënies.
Për të ilustruar mendimin mbi formacionin sociokulturor të leksikut të ligjërimit bisedor, po japim disa shembuj leksemash.

Leksemat "*kurs* (mësimor)" dhe "*dërgoj*" kanë marrë në kuadrin e cilësimeve të mëtejshme të dukurive përdorim të gjerë. Kuptimi denotativ i fjalës "*kurs*" përcaktohet në "Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe" si "tërësia e mësimeve që jepen brenda një kohe të shkurtër, për të kualifikuar a për të specializuar në një fushë të caktuar një grup punonjësish ose të rinjsh."[132] Nëpërmjet lidhjeve sintagmatike të kësaj fjale, në grupet `jam në kurs`, `ndjek kurs` ngulitet përdorimi i kësaj fjale në gjuhën e folur. Në këmbimet zyrtare takohen edhe shprehjet `dërgoj në kurs`. Kuptimi denotativ i leksemës `dërgoj` përcaktohet në fjalor: " nis një njeri që të shkojë diku; e nis dikë për të kryer një detyrë, për të mësuar."[133] Sfondi sociokulturor fshihet në leksemën "dërgoj" në anën administrative të veprimit, si edhe të përfshirjes në këtë kuptim të konotacioneve "me meritë", "në nderim", komponente këto të pashprehura gjuhësisht.

Po sjellim një shembull tjetër: kuptimi denotativ i "*gjykim*" është përcaktuar në Fjalor "mendim që formojmë për dikë a për diçka dhe që e shprehim si vlerësim përfundimtar."[134] Sfondi sociokulturor implikon informacionin e mbishtuar; në kohën e regjimit socialist, ky gjykim ishte pjesa kryesore e akteve (dosjeve) personale, e dokumenteve të individëve. Vlerësimi i dhënë nga persona të tjerë kishte rëndësi të dorës së parë për karrierën profesionale dhe personale të secilit. Sfondi sociokulturor ngulitet gjuhësisht nëpërmjet përcaktorëve mbiemërorë `i mirë` apo `i keq`. Dija ideopolitike e kohës së atëhershme do të ndihmonte në receptimin edhe të këtyre komponenteve të kuptimit në këtë leksemë, në rastet kur flitet për ndodhi apo ngjarje të asaj kohe.

Një leksemë tjetër që bart një sfond sociokulturor nga jeta e përditshme, është "pasaportë" si "letërnjoftim i posaçëm me të cilin pajiset ai që shkon me shërbim ose udhëton jashtë shtetit për një kohë të caktuar."[135] Për kohën e regjimit komunist, kjo leksemë bart edhe informacione të pashprehura, të tilla si: Pasaporta e udhëtimit bëhej atëherë kur dëshirohej të shkohej në Perëndim dhe shtete të tjera, dhe duhej të bëhej kërkesë për vizë. Mundësitë e udhëtimit për në Perëndim apo shtete të tjera ishin të kufizuara dhe të kushtëzuara (atëherë vetëm për udhëtime pune). Fjala "*pasaportë"* mbartte konotacionet "ideale", "me vlerë" dhe në shumë raste koncepti pasaportë kishte kuptimin e "lirisë për të udhëtuar".

Pa dashur të futemi në hollësi, mund të themi se në kohët e sotme komponentet kuptimore që bart leksema kanë ndryshuar për pjesën më të madhe të individëve. Këto komponente kushtëzohen nga konteksti sociokulturor i tanishëm, ku lirinë për të lëvizur me pasaportë e kanë të gjithë shqiptarët.

Në këtë fushë semantike mund të trajtonim edhe leksemën "arratisje", e shumëfolur në fillimet e viteve 90. Në "Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe" kuptimi denotativ i fjalës jepet: "marr malet dhe kapërcej kufirin për të shpëtuar nga një e keqe."[136] Komponenti kuptimor (sema) "lë vendin" nuk jepet në këtë fjalor. Sfondi sociokulturor i atëhershëm e mundëson aktivizimin edhe të këtij komponenti kuptimor. Kuptimi leksikor i fjalës shoqërohej gjithnjë nga konotacione negative, si `dënim, përndjekje të personit dhe familjarëve`, `internim`, `burgosje`. Për shkak të ngjyrimeve negative, fjala kishte pak a shumë natyrë tabuje. Vetëm në fillimet e viteve 90, me ndryshimin e konteksteve, ndeshen lidhjet sintagmatike më të shpeshta

[132] *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Tiranë, 1980, fq. 924.
[133] *Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*. Tiranë, 1980, fq 324.
[134] Po aty, fq 630.
[135] *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*. Tiranë, 1980, fq 1375.
[136] *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Tiranë 1980, fq. 58.

“arratisje në....” “arratisje me....”, përdorime që ngulitën edhe një sfond tjetër sociokulturor të kësaj fjale.
Shembujt e sipërpërmendur qartësojnë lidhjet e kontekstit sociokulturor me leksikun e gjuhës së përditshme dhe ndikimin e anasjelltë midis tyre.

2.2.3.3 Arkaizmat dhe historizmat

Shtresë tjetër bartëse e sfondit sociokulturor janë edhe arkaizmat. Si fjalë të vjetëruara ato ose janë zhdukur nga fjalori aktual i gjuhës, ose ekzistojnë në njësi frazeologjike, ose jetojnë diku në periferi të leksikut.
Lidhur me procesin e vjetërimit të fjalëve, J. Thomai shkruan: “Fjalët janë vjetëruar dhe kanë dalë nga përdorimi për shkak se kanë dalë fjalë të tjera për të emërtuar po ato sende a dukuri; këto fjalë të reja i kanë mënjanuar nga përdorimi emërtimet e para dhe i kanë hedhur në shtresën e fjalëve të vjetëruara. Këto fjalë, që vjetërohen për shkaqe të tilla gjuhësore, janë arkaizma të mirëfillta.”[137] Në fjalët e vjetëruara bëjnë pjesë edhe historizmat, të cilat janë fjalë “…që lidhen ngushtë me fatin e sendit a të konceptit që emërtojnë, lidhen me etapa të caktuara historike, ekonomike e kulturore, kurse sot përdoren për të dhënë me vërtetësi atë periudhë.”[138]
Schippani shkruan: „Fjalët tërhiqen në periferinë e fjalorit, vjetërohen dhe vdesin, domethënë nuk njihen më nga bartësit bashkëkohorë të gjuhës. Por ato vazhdojnë të jetojnë si arkaizma dhe historizma dhe përdoren si të tilla.“[139]
Ndërsa Ludwig Wittgensteini e krahason gjuhën dhe zhvillimet historike brenda saj me një qytet të vjetër: „Gjuha mund të krahasohet me një qytet të vjetër, ku bashkekzistojnë rrugica dhe sheshe, shtëpi të reja dhe të vjetra, shtëpi me pjesë të ndërtuara në kohë të ndryshme dhe rreth tyre një numër i madh lagjesh të reja periferike, me rrugë të drejta e të parregullta e me shtëpi standarde.”[140]

Shumë arkaizma mbijetojnë më gjatë në dialekte dhe në të folme. Prandaj klasifikimi i një fjale si arkaizëm varet dhe nga varieteti gjuhësor.

Fjalët e vjetruara mund të përdoren për qëllime stilistike. Ky përdorim qëllimor i fondit leksikor arkaik quhet arkaizëm i gjuhës.[141] Dukuria e arkaizimit është një fenomen i vjetër, tradicional stilistik që i ka rrënjët në antikitet. Marcus Fabius Quintilian-i, autor i librit „Institutio oratoria“, shkruan për një përdorim stilistik të përshtatshëm të mjeteve të vjetruara leksikore. Kjo është deviza dhe e stilistikave të reja.

---

[137] Thomai, Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*“, Tiranë, Dudaj, 2005, fq. 224.
[138] Po aty, fq 225.
[139] Schippan, Thea, *Lexikologie der deutschen Gegenwartssprache*. Niemeyer, 1992, fq. 242.
Duke u mbështetur në trajtimet e bëra nga studiuesit J. Thomai dhe Schippani, vërejmë shkaqe të ndryshme të vjetrimit të fjalëve, mes të cilave mund të përmendim:

- Vjetërimi ose zhdukja e fjalëve mund të paraqesë të njëjtën përmbajtje (shpërej – shpresoj) etj. Fjala zhvendoset për shkak të homonimisë (gjellë ‚jetë‘ – gjellë ‚gatesë‘).
- Ndikimi i faktorëve jashtëgjuhësorë: objekti që shënojnë këto fjalë zhduket nga jeta jonë e përditshme, bashkë me të del nga përdorimi dhe fjala (heshtë, shqytë, bej, aga). Këto fjalë quhen dhe historizma.

Vjetrimi bëhet edhe për shkaqe të brendshme gjuhësore. Fjala zëvendësohet nga një fjalë tjetër me tingëllim më modern që shënon të njëjtin objekt. Në shumë raste është i paqartë shkaku i vjetrimit të fjalëve.
[140] Wittgenstein, Ludwig, *Prototractus: En Early Version of Tractatus Logico-Philosophicus*, London Routledge/ Kegan Paul, 1971, fq. 20.
[141] Lloshi, Xhevat, Pragmatika dhe stilistika, Tiranë, 1999, f. 106-107.

Riaktivizimi i fondit arkaik leksikor mund të bëhet për arsye të ndryshme. Fjalët e vjetruara mund të jenë një mundësi shprehjeje, mund të mbushin një boshllëk në leksik. Kjo ndodh, p.sh., në raste puritanizmi gjuhësor, kur bëhen përpjekje për të nxjerrë nga gjuha të gjitha fjalët e huaja. Për t'i zëvendësuar ato përdoren shpesh fjalët e vjetruara (apostafat – nergut).

Me anë të përdorimit të arkaizmave (historizmave) synohet shpesh të jepet një ngjyresë historike. Arkaizimi i shërben, kështu, dhe thellimit ose zgjerimit historik të gjuhës. Ato shërbejnë gjithashtu për të karakterizuar personazhe me mënyrën e të folurit të tyre. Por arkaizimi në veprat letrare nuk mund të jetë vetëm me funksion ngjyrosës historik. Riaktivizimi i leksikut arkaik mund të bëhet për të shprehur ironi, qëndrim të distancuar etj.

Arkaizmat dhe historizmat mund të jenë bartëse të informacionit sociokulturor. Ato janë „mjete të domosdoshme të komunikimit mbi të kaluarën"[142] dhe shërbejnë për të aktivizuar njohuritë historike. Për të shpjeguar kuptimin e tyre duhet aktivizuar fondi i njohurive historike që është njëkohësisht fond njohurish sociokulturore.
P.sh.: Leksema "*plenum"* është një historizëm. Kuptimi denotativ i saj, sipas FGJSH 1984, është : „Organi më i lartë udhëheqës i Partisë ... , mbledhje ku marrin pjesë të gjithë anëtarët e këtij organi". Informacioni sociokulturor që emeton kjo njësi ka të bëjë me goditjet dhe spastrimet që ndërmerrte kreu i Partisë në këto mbledhje të frikshme. Në historinë e Shqipërisë kanë hyrë si ngjarje të zeza Plenumi IV e shumë plenume të tjera.
Edhe leksema " *zyrë strehimi"* është një historizëm, që krahas kuptimit nocionor „institucion që merrej me organizimin e shpërndarjes së banesave", mbart dhe konotacione negative, sidomos të llojit sociokulturor (por edhe ngjyrime emocionale). Ky koncept të kujton dhe padrejtësitë, privilegjet, korrupsionin dhe të tjera dukuri negative që shoqëronin ndarjen e banesave në atë kohë. Të kujton, gjithashtu, gjendjen e mjerueshme të strehimit, godinat standarde, punën shkel e shko etj.
Togu "*lufta e klasave"* shënon një nocion të vjetëruar, përderisa dukuria nuk ekziston më. Për brezat e sotëm sfondi sociokulturor që evokon leksema është ende i deshifrueshëm. Ky sfond është informacioni për luftën famëkeqe dhe çnjerëzore midis partisë dhe kundërshtarëve të vet politikë.
Njohuri historike specifike, të fituara gjatë përvojës në realitetin komunist shqiptar, i mbishtresohen kuptimeve denotative. Por këto njohuri mund të vjetrohen, domethënë ato nuk janë më pjesë përbërëse e përvojës së brezave të një kohe të caktuar. Këtu ndërhyn informacioni sociokulturor (në formë shpjegimi) dhe shfaq dinamikën e vet.

[142] Schippan, Th., Vepër e cituar, 1992, fq. 249 e në vijim.

Kreu 3 Dukuri leksiko-semantike dhe pragmatike në veprat “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Darka e gabuar”, “Prilli i thyer”

3.1 Analizë e dukurisë së sfondit sociokulturor duke u mbështetur në disa vepra në prozë të I. Kadaresë

3.1.1 Qëllimi i analizës

Pjesa e dytë e këtij punimi synon identifikimin dhe përshkrimin e informacionit sociokulturor në tekstin letrar, konkretisht në disa vepra në prozë të I. Kadaresë. Në medimin gjuhësor shqiptar kjo dukuri emërtohet si informacion plotësues.[143] J. Thomai në veprën e tij “Teksi dhe gjuha” e trajton si domosdoshmëri “vështrimin (te përmbajtja leksikore e fjalëve) jo vetëm të kuptimeve që lidhen me diçka nga realiteti, por edhe të ngjyrimeve që japin qëndrimin, vlerësimin, ndjenjat e folësit për atë që shënon fjala.”[144] Në lidhje me parametrat kryesorë të analizës së tekstit, J. Thomai shton, në po këtë vepër, se “Çdo tekst integrohet domosdo në struktura gjuhësore dhe jashtëgjuhësore, d.m.th. në kontekste sociale në kohë dhe hapësirë.”[145] Studiuesi T. Plangarica në “Në tekst për tekstin” thekson se “Veprat letrare janë produkte komplekse dhe, si të tilla, marrin statuse që përvijohen nga vlerat që ato ofrojnë pandërmjetshëm në visarin kulturor të një kombi. […] Për më tepër, teksti letrar me jetën e tij, krijon, gjithashtu, hierarkinë e vlerave duke rrezatuar pranë tij domethënie dhe përvojë.”[146]

Në të gjitha përkufizimet e gjuhëtarëve tanë, siç e trajtuam edhe në pjesën teorike të këtij punimi, gjejmë të shprehur mendimin, se sfondi sociokulturor luan një rol të padiskutueshëm në rrokjen e përmbajtjes së tekstit.

Në lidhje me rolin që luan sfondi sociokulturor në rrokjen e përmbajtjes së teksteve me distancë kohore, Pohl-i shprehet se “Identifikimi i njësive përbërëse të tekstit, bartëse të informacionit sociokulturor, mbi bazën e kompetencës gjuhësore individuale është kusht për një rrokje sa më të mirë të përmbajtjes së tekstit, kusht për t`iu afruar sa më shumë historicitetit të tij.”[147]

Pra, sfondi sociokulturor, si komponent kuptimor i mjeteve gjuhësore, drejton procesin e dekodimit të teksteve. Qëllimet e synuara në këtë syth të këtij punimi janë:

- Të vërtetohet domosdoshmëria e aktivizimit të sfondit sociokulturor për analizën komplekse të teksteve. Këtë do ta ilustrojmë me interpretime të fjalëve apo të grupeve të fjalëve apo fjalive e teksteve nga disa vepra në prozë të autorit I. Kadare. Nëpërmjet kësaj analize do të përshkruhet domosdoshmëria e aktivizimit të sfondit sociokulturor për arritjen e një interpretimi të tekstit sa më afër qëllimit të autorit.
- Krahas përshkrimit të dukurisë, do të analizojmë edhe funksionet e saj. Leximi, kuptimi i sfondit sociokulturor është një moment i rëndësishëm në

[143] Shih, Loshi, Xh., *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, Toena, 1999, fq. 29.
[144] Thomai, J., *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1992, këtu fq. 46.
[145] Thomai, J. Po aty, fq. 9.
[146] Plangarica, T. *Në tekst për tekstin*, *Studime*, Elbasan, Sejko, 2002, këtu fq. 54.
[147] Pohl, I., *„Identifikation und Wirkungsweise der semantischen Implikation soziokulturellen Hintergrundwissens (Teil II)“*. In: Studien zur Semantik. Hrsg. V. G. Bartels; I. Pohl. Frankfurt/M.; Berlin; Bern; Ney York; Paris; Wien (Sprache, System und Tätigkeit 4), 1992, fq. 30.

receptimin e tekstit letrar. Pa shpjegimin e sfondit sociokulturor, ose pa aktivizimin e njohurive për të, hapësirat boshe mbeten të paplotësuara.

- Të konstatohen dhe të kategorizohen mjetet gjuhësore. Nga studimi i shtresave të veçanta të leksikut do të mund të arrihet njohja mbi shkaqet e shfaqjes së sfondit sociokulturor në veprën e I. Kadaresë.

3.1.2 Metodat e analizës

Në rrugë induktive do të izolohen leksema të përshtatshme për punimin tonë nga veprat në prozë të shkrimtarit I. Kadare. Përzgjedhja e mjeteve gjuhësore do të bëhet mbi bazën e vlerësimeve tona dhe intuitës vetjake. Kompetenca gjuhësore mundëson njohjen e atyre elementeve gjuhësore, tregues të sfondit sociokulturor, që i bashkangjiten elementeve kuptimore referenciale dhe të cilat bëhen pjesë përbërëse e kuptimit të synuar nga autori. Pastaj do të ndajmë leksemat në grupe sipas kategorive gjuhësore të zbuluara më parë. Gjatë karakterizimit të grupeve të veçanta do të përshkruhen kategoritë gjuhësore, domethënë do të tregohen shkaqet që kushtëzojnë lidhjen e sfondit sociokulturor me këtë apo atë kategori.

3.1.3 Fondi leksikor – bartës i informacionit sociokulturor në prozën e Kadaresë

Fjalë dhe grupe fjalësh nga vepra të ndryshme të Kadaresë, që u përkasin një shtrese të caktuar, do t`i vendosim në fokus të analizës sonë në vijim, duke analizuar funksionet e tyre si bartëse të informacionit sociokulturor. Në këtë rast do të përpiqemi të shpjegojmë se si komponente kuptimore të përftuara nga informacioni sociokulturor, që i bashkangjiten bërthamës kuptimore të fjalëve janë të domosdoshme për zbërthimin e kuptimit të tyre. Do të përpiqemi, që nëpërmjet shembujve, të qartësojmë diferencën midis kuptimit në sistem, të paraqitur nga përcaktimi i fjalës në fjalor, dhe kuptimit të fjalës në tekst, diferencë kjo që mendojmë se vjen nga ndikimi i sfondit sociokulturor.

3.1.3.1 Fjalë të vjetruara

Vlera e fjalëve dhe e shprehjeve të vjetëruara rrjedh nga natyra e tyre e veçantë; ato mund të mbushin një boshllëk, por ajo që na intereson në punimin tonë është se ato evokojnë një periudhë të caktuar historike, çka sjell edhe aktivizimin e një sfondi të caktuar social dhe kulturor.
Siç e përmendëm, përdorimi i fjalëve të vjetruara në veprat letrare artistike ka vlera stilistike. Historizmat dhe arkaizmat përdoren për krijimet letrare për të dhënë ngjyresën historike, për të rikrijuar tiparet specifike të jetës së dikurshme, pra, për të evokuar atë pjesë të dijes që lidhet me sfondin sociokulturor të periudhës në fjalë.

Në veprat e Kadaresë ndeshen më shumë historizma e më pak arkaizma. Siç do të trajtohet më poshtë, fjalët e vjetruara shërbejnë, kryesisht, për paraqitjen e sfondeve historike të së kaluarës e për të karakterizuar edhe ndonjë personazh me anë të ligjërimit që përmban elemente leksikore të vjetruara.
Por duhet thënë se Kadareja, edhe kur trajton tema të së shkuarës, nuk e mbush ligjërimin e tij me fjalë të vjetruara, nuk e riprodhon me përpikmëri gjuhën e së shkuarës. Përdorimi me tepri i fjalëve të vjetruara do ta mërziste dhe do ta pengonte lexuesin. Ndër fjalët e vjetruara, arkaizmat janë fjalë me më shumë ngjyrim sociokulturor. Ato kontrastojnë me normën e gjuhës së sotme letrare, me barasvlerëset

e tyre të gjuhës së sotme, duke ndihmuar në evokimin e periudhës dhe në krijimin e sfondit sociokulturor.
Për historizmat në gjuhën e sotme nuk ka barasvlerëse. Por duke i ballafaquar ato me një perifrazë që shënon të njëjtin objekt të vjetruar, del në pah forca e tyre evokuese.

3.1.3.1.1 Arkaizmat

Në prozën e I. Kadaresë i ndeshim këto grupe fjalësh kryesisht në veprat me temë nga e shkuara e largët. Gjithsesi, duhet vënë në dukje se edhe në këto vepra mbizotërojnë me epërsi të padiskutueshme elementet e leksikut të sotëm ndaj mjeteve të vjetëruara.
Në novelën “Kronikë e një familjeje”, ku rrëfimi bëhet nga autori dhe ku, pothuajse, mungon ligjërata e drejtë, përdoren sistematikisht elemente leksikore të vjetruara në gjuhën e autorit, duke i dhënë mbarë ligjërimit një ton arkaik, për të paraqitur një atmosferë arkaike.[148]
Arkaizmat në ligjërimin e Kadaresë përdoren për të përmbushur funksione të ndryshme:

- Ato përdoren për të paraqitur me vërtetësi epoka historike të së shkuarës, për t`u dhënë ngjarjeve ngjyrimin e nevojshëm kohor. Sasia e arkaizmave që kryejnë funksione të tilla është e ndryshme në tekste të ndryshme. P.sh., në romanin “Kështjella” ka më shumë arkaizma e historizma sesa në novelën “Ura me tri harqe” e “Pashallëqet e mëdha” të marra së bashku.
  Kjo kushtëzohet nga tema dhe nga mënyra e paraqitjes. Në romanin “Kështjella”, autori e paraqet konfliktin e forcave ndërluftuese (shqiptarëve dhe turqve) duke u vendosur me kamerën e tij në kampin turk. Që andej këqyr objektin e tij, ushtrinë turke që vepron në afërsi, ndërsa ushtria shqiptare vështrohet nga larg. Paraqitja e saj bëhet me abstragime e përgjithësime letrare. Kështu mbrojtja shqiptare merr vlera simbolike. Kjo mënyrë paraqitjeje kushtëzon, në një masë të madhe, përdorimin e leksikut që referon jetën e përditshme të ushtrisë turke, në kulturën sociale dhe materiale të saj. Ndërsa në dy veprat e tjera “Pashallëqet e mëdha” dhe “Ura me tri harqe” trajtohet, gjithashtu, një temë historike, por paraqitja, rrëfimi rrjedhin në një formë tjetër. Forma kryesore paraqitëse është përshkrimi. Këtu mungon veprimi dinamik që ndeshim në veprën “Kështjella”. Sfondi sociokulturor ngre gjithmonë krye përmes rrëfimit, por mungon paraqitja e detajuar e kulturës materiale të kohës.

Le t`i vështrojmë më nga afër grupet e fjalëve të vjetruara që kanë shërbyer për tipizim epokash, ngjarjesh, personazhesh. Të tilla shfaqen në prozën e Kadaresë një sasi termash dhe fjalësh që shënojnë nocione të vjetruara në fusha të ndryshme veprimtarie, si:

- Emërtime të njësive administrative: *pashallëk, vilajet, guvernë, sanxhak, kaza, nahije, bajrak, principatë, konte, dukatë.*
- Emërtime armësh dhe mjetesh të tjera lufte: *dash i hekurt, përdredhore, gjoksore, breshkore, heshtë, çomangë, trinë, xunkxhi, dyfek, kobure.*

[148] Sadiku, Emine, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Kadaresë,* Tiranë, 1998, f. 76.

Në romanin “Kështjella”, ku janë përdorur edhe këto emërtime armësh dhe mjetesh të tjera lufte, me anë të tyre evokohet sfondi sociokulturor i shekullit XV. Evokimi i këtij konteksti historik të asaj periudhe lidhet me aktivizimin e dijes që lidhet me këtë periudhë, si: shqiptarët, nën drejtimin e heroit kombëtar, Skënderbeut, luftonin kundër turqve, të cilët ishin në atë kohë fuqi e madhe dhe kishin pushtuar pjesën më të madhe të vendeve qendrore të Ballkanit, tokave serbe dhe atyre hungareze. Sulmet e njëpasnjëshme të Perandorisë Osmane kundër Mbretërisë Hungareze bënë që kjo e fundit, në vitin 1442 e në vijim, të kalonte në një politikë kundërsulmesh të fuqishme kundër osmanëve.[149] Kësaj kryengritjeje iu bashkuan edhe shqiptarët nën drejtimin e Skënderbeut, kështjella mbrojtëse e të cilave ishte kalaja e Krujës. Në muret e kësaj kalaje zhvillohen edhe ngjarjet që shtjellohen në romanin “Kështjella”.

Është prania e emërtimeve të vjetruara, që është në kontrast me konceptin modern të lexuesve për armët – armë të cilat nuk përdoren më në kohët e sotme – që evokon këtë sfond historik. Për lexuesin, moria e *përdredhoreve, breshkoreve* etj. janë krejt primitive e qesharake në pretendimin e tyre. Sfondi historik dhe njohuritë metagjuhësore ndihmojnë në rrokjen e kuptimit të këtyre fjalëve. *Përdredhore*[150] shpjegohet në këtë mënyrë në *Fjalorin e Sotëm të Gjuhës Shqipe*: hist. …”mjet lufte me anë të të cilit hidheshin gurë, shigjeta etj. (sidomos gjatë sulmit në kështjella).”[151]

Nga njëra anë, evokimi i periudhës, ngjyrimi kohor krijon konturin e dijes në të cilën zhvillohet ngjarja; nga ana tjetër, sfondi sociokulturor na ndihmon të rrokim kuptimin e fjalës, të krijojmë përfytyrime mbi ndeshjet dhe mënyrën e sulmit dhe të mbrojtjes së ushtrive të atëhershme. Edhe aktivizimi i njohurive metagjuhësore, në rast mosidentifikimi të periudhës kohore, do të na ndihmonte të përcaktonim aksin kohor të zhvillimit të ngjarjeve. Vetë përcaktimi dhe shënimi i fjalës në fjalor, si shtresë e leksikut historik, mundëson identifikimin e fjalës si historizëm dhe ngjyrimin kohor të fjalës.

Përkthyesi Giuseppe di Siati përdor gjegjësen *Feldschlange*[152]në versionin e përkthyer gjermanisht. Në fjalorin gjermanisht Duden Online edhe kjo leksemë shpjegohet se është një mjet lufte i përdorur nga shekullin i 15-të deri në shekullin e 17-të. Identifikimi i kësaj fjale si historizëm bëhet duke aktivizuar sfondin sociokulturor, që mundëson aktivizimin e dijeve mbi mënyrën e luftimit në mesjetë. Duam të vëmë në dukje se leksema në gjermanisht është nga ana morfologjike një fjalë e përbërë, pjesët e së cilës vendosin lidhje varësie midis tyre. Në semantikë kuptimi i emërtimit konfigurohet nga aktivizimi i kuptimeve të leksemave përbërëse *Schlange –gjarpër* me *Feld – fushë*. Komponente kuptimore që lidhen me formën dhe veçoritë karakteristike (helmuese) të gjarprit i vishen emërtimit duke krijuar mjetin gjuhësor, metaforë. Komponente të tjera kuptimore në kuptimin e përgjithshëm aktivizohen nga fjala përcaktuese *Feld*, duke përcaktuar vendin në të cilin vendosej ky mjet, grupimin i cili e përdorte, artileria. Konteksti ligjërimor në roman qartëson fushën tematike të fjalës.

Në gjuhën shqipe emri *përdredhore* është, për nga mënyra e fjalëformimit, i prejardhur prej foljes *përdredh* në kuptimin e katërt të shënuar në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, online: rrotulloj e lakoj në drejtime të ndryshme, tund e lëviz. Prapashtesa –or(e) është një ndër prapashtesat që formon emra të vetave a të sendeve veprues,[153] d.m.th., përdredhore është mjeti me anë të së cilit realizohet veprimi që shpreh folja

[149] Shih, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*. Tiranë, 1984, fq. 967.
[150] Kadare, Ismail, Kështjella, Tiranë, 1981, f. 53.
[151] *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*. Tiranë, 1980, fq 1426.
[152] De Siati, Giuseppe, *Die Festung*, Frankfurt am Main, Wien, 1988, f. 56.
[153] Shih, Thomai, Jani, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2005, f. 149.

përdredh. Edhe në gjuhën shqipe është konteksti ligjërimor në roman, që qartëson fushën tematike të fjalës.

Përdorimi i togut të fjalëve *“dash i hekurt”* në veprën “Kështjella”, për herë të parë në kontekstin e sulmit të parë të ushtrisë otomane “[…] Nën atë pirg të ngritur shpejt e shpejt u strehuan ushtarët që goditnin me dashin e madh të hekurt, si edhe xhenierët dhe ushtarët myselemë që përpiqeshin të shkallmonin anët e portës së madhe”[154], aktivizon kontekstin historik të kohës dhe bën të mundur rrokjen e kuptimit edhe pa përdorimin e fjalorëve shpjegues: mjet i sulmit të ushtrisë otomane për marrjen e kalasë shqiptare, tra i madh i gjatë i hekurt, që mbahej nga shumë ushtarë, xhenierë, myselemë dhe që përdorej për të shkallmuar dhe shpërthyer portat e kështjellave; çka do të lejonte edhe hyrjen e ushtrisë otomane në kala.
Edhe pse kemi një përcaktim të ngjashëm të këtij grupi fjalësh në FGJSH “hist… Tra i madh me majë prej metali, që përdorej për të shpuar muret e kështjellave e për të shpërthyer portat e tyre”[155] rezulton një diferencë në kuptim (si mjet sulmi, që mbahej nga xhenierët, ushtarët, myselemët), diferencë që vjen pikërisht nga ngjyrimet kohore të fjalës. Gjegjësja gjermanisht *eisener Rammbock* (çarës muresh) nuk përcaktohet në fjalorin Duden Online si historizëm. Diferenca kuptimore midis dy leksemave në të dyja gjuhët është e madhe. Mungojnë komponentet kuptimore që përcaktohen nga aktivizimi i sfondit sociokulturor dhe njohurive metagjuhësore që lidhen me qëllimin e përdorimit, kohën e përdorimit dhe grupin e përdoruesve. Kuptimi që emeton në kontekst mundësohet vetëm përmes aktivizimit të sfondit historik, që e plotëson kuptimin leksikor me komponente të tjera të munguara, që janë të domosdoshme në receptimin e ligjërimit në këtë kotekst.

Përveç emërtimeve të armëve dhe mjeteve të tjera të luftës, të shumta janë edhe:

- termat e organizimit të ushtrisë otomane, si *akënxhi, azap, eshkynxhi, dallkëllëç, serdengjeshter, spahi, myselem, jeniçer, munaxhi, çaush, çaubash, veqilharxh, xhebelu*. Pothuajse të gjitha emërtimet e kësaj fushe tematike jepen në përkthim me të njëjtën formë, si fjalë të huaja, si psh., *Janitschar, Eschkindschi, Azapen, Sedengetschi, Myselem*. Ato përshtaten gjermanisht vetëm në rrafshin fonetik/grafematik. Kuptimi i këtij grupi leksemash arrihet vetëm përmes aktivizimit të dijeve historike mbi mënyrën e organizimit të ushtrive otomane, sepse në fjalorët përkatës të të dyja gjuhëve këto nuk janë shënuar si leksema. Përjashtim nga ky grupim bën grada ushtarake *çaush*, i shënuar si leksemë në fjalorin e gjuhës shqipe, i cili në gjermanisht jepet me termin ushtarak *Ordonnanzunteroffizier (*kandidat për nënoficer). Megjithatë edhe leksema në gjermanisht paraqet diferencë kuptimore me emërtimin në shqip. Ajo nuk identifikohet jashtë kotekstit si historizëm, prandaj në gjermanisht është i domosdoshmëm përfshirja e kotekstit dhe sfondit historik në rrokjen e kuptimit të emetuar në këtë vepër.
- terma që u përkasin institucioneve të organizimit shtetëror të asaj kohe: *xhandarmëri, bashki, prefekturë, nënprefekturë, Portë e Lartë; ose emërtime të vjetëruara institucionesh, si gjykatore* etj;
- emërtime njerëzish sipas punës që kryejnë, sipas detyrës, titullit, postit, fesë: *kont, kryezot, princ, dukë, pasha, trapxhi, tellall, bejlerbe, kalif, kadi, vali,*

[154] Kadare, Ismail, Kështjella, Tiranë, 1981, fq. 65.
[155] *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Tiranë, 1980, fq. 294.

timarli, qatip, kaur, bej, aga, hanxhi, nënprefekt, bujtinar, gjëmëtar, gjakës, gjakhurës, qehajai i gjakut, vezir, sanxhakbej, hafije, kryehafije, çengi, kryeçengi, hanëme, berebej

- emërtime veshjesh të vjetruara: *ferexhe, çitjane;*
- fjalë që shënojnë objekte të ndryshme materiale: s*ahat, han, hamam, defter, zhgun, mexhite, rub i zi, kredharak, mashalla, grosh;*
- terma të fushës së ekonomisë: *timar, çiflig, xheza, fajde, veqilharxh, taksë gjaku, hesap, e dhjetë;*
- fjalë që kanë të bëjnë me veprimtarinë shtetërore, me përfytyrimet dhe zakonet fetare: *ferman, katil-ferman, hair-ferman, vakëfname, xhehnem, xhenet, ahiret, gjynah, qitap, kanun.*

Pjesa më e madhe e fjalëve të vjetruara të përmendura janë turqizma dhe orientalizma. Sasia e bollshme e arkaizmave flet jo vetëm për kulturën e gjerë të shkrimtarit dhe për punën e tij serioze me leksikun, por edhe për atë që fjalët e vjetëruara luajnë një rol të pazëvendësueshëm: duke evokuar një kohë tjetër, ata e paraqesin atë me koloritin e nevojshëm dhe me pamje të vërtetë, dhe bëhen edhe bartëse të ngjyrimeve të kontekstit social dhe kulturor të kohës.

Fjalët e cituara lidhen me koncepte historike. Këto koncepte janë të shpjegueshme vetëm me aktivizimin e njohurive historike.

Arkaizmat dhe historizmat janë mjete të domosdoshme në komunikimin mbi të shkuarën.

Në përvojën e brezave të sotëm nuk janë të pranishme objekte të tilla si *timar, çiflig, han, trap, trapaxhi* etj. Përtej këtyre fjalëve e koncepteve, lexuesi i sotëm nuk sheh e nuk mund të gjejë referentë. Shpjegimi dhe të kuptuarit e tyre ndodh me anë të informacionit historik që ka, ose që grumbullon lexuesi.

Shpesh vetëm një fjalë term, ose jo term, zgjon në parafytyrim një atmosferë të tërë. Si shembull mund të sjellim: *taksë gjaku, han, tellall, ferman, kanun* etj..

Emërtimi *taksë gjaku* referon në një realitet ku rregullat e gjakmarrjes organizojnë jetën e bashkësisë njerëzore. Edhe pse lexuesi i sotëm, në shumicën e rasteve, nuk ka asgjë nga ai realitet në përvojën e tij, ai ka parafytyrimin e tij në formë informacioni të grumbulluar nga leximet, p.sh., nga leximi i “Prillit të thyer”, “Kanunit”, etj.. Pas këtij segmenti (taksë gjaku) shfaqet i tërë universi i gjakmarrjes.

Edhe emërtimi historik *han* zgjon parafytyrimin për infrastrukturën aq të thjeshtë e primitive të një të shkuare të largët. Domethënia dhe ekspresioni i sfondeve të tilla të thirrura në parafytyrim forcohet me anë të krahasimit me dukuri të sotme paralele, hotelet e standardit europian me pak ose me shumë yje.

Fjala *tellall*, në kuptimin nocionor, është për shkak të funksionit të njëjtë sinonime e pjeshme me mediat e sotme. Por ngjyrimet sociokulturore, bashkë me to edhe ato emocionale, i vendosin këto emërtime në marrëdhënie antonimie (J. Thomai e trajton dukurinë e antonimisë për shkak të ngjyrimit emocional të njësive leksikore sinonime, dhe e quan enantiosemi).[156]

Që nga *fermanët* e shtetit osman deri në ligjet e shteteve të sotme shtrihet një diferencë e madhe kohore dhe kuptimore. Fermani nuk shënon vetëm vendimin suprem, por dhe absurditetin, arrogancën dhe kriminalitetin e forcave të atëhershme pushtetore.

[156] Shih, Thomai, Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, Dudaj, 2005, këtu fq. 137.

Shembuj nga vepra të tjera të Kadaresë, të cilat përveç efektit të krijimit të skenave qesharake bartin edhe konotacione që lidhen me kohën, me mentalitetet njerëzore e me praktikat e ndryshme janë të shumtë. Po përmendim disa prej tyre:

> “Edhe emrin e kishin të pështirë: ekonomistë. (Kështu u thonin *veqilharxhëve* në vendet e *kaurit.*”[157]
> “Po thonë se ka dalë një Isuf, me një mjekër të kuqe, një Isuf Stalini.
> - *Myslyman* është ky? – pyeti Nazua”[158]
> “Një dervish përmendi yllin me bisht, kometën, siç i thoshin *kaurët*, që ishte shenjë e *allahut…*”[159]
> “Të tjerët ktheheshin të befasuar: a jeton në këtë botë, o njeri? Në s`lexon gazeta, *tellallët* a i dëgjon?”[160]

Aktivizimi i sfondit sociokulturor – mentaliteti anadollak dhe injorant i kohës - vë në dukje edhe tonin qesharak të këtyre segmenteve.

Duke u përdorur në ligjërimin e personazheve, arkaizmat ndihmojnë jo vetëm në portretizimin e tyre, por japin informacion edhe për formimin e për botën e tyre. P.sh., në një bisedë midis priftit, gjeneralit dhe një fshatari, shkrimtari e dallon fshatarin nga dy misionarët e huaj duke futur në ligjërimin e tij dhe arkaizma:

> “Kërkon paratë, - tha gjenerali, kur pa plakun që po ia bënte me dorë, - e shikoni? E dija unë.
> -Një *defter*, - tha plaku. – Se ç`shkruante nganjëherë në të”[161].

Gjuha e zgjedhur për fshatarin ndihmon jo vetëm portretizimin e tij, por edhe aktivizimin e informacionit social dhe kulturor të asaj kohe: fjala “*defter”* është dëshmi e asaj kohe kur për të mbajtur shënime mbaheshin disa tufa letrash të lidhura, por që nuk i ngjajnë domosdoshmërisht fletoreve të sotme. Kjo rrokje e kuptimit nuk përkon me shënimin në FGJSH “*fletore*”. Shpjegimi i fjalës “*defter”* në fjalor është: “1. vjet. Fletore; 2. hist. Regjistër i kadastrës; [162]3. përmb. bised. Tufë me pesëdhjetë fije letrash cigareje, të lidhura së bashku.” [163] Duke aktivizuar njohuritë mbi kohën (fshatarët e atëhershëm nuk mbanin fletore, të cilat përdoreshin nga shtresa më të larta shoqërore), ne rrokim kuptimin e emërtimit duke i bashkangjitur kuptimit referencial “diçka për të shkruar” edhe komponente kuptimore, “si të palidhura”, “të mbajtura jo si duhet dhe në vende jo të duhura, si në xhepa, jo fleta të tëra, por copa letrash të grisura”.
Përkthimi në gjermanisht me gjegjësen Heft (fletore)[164] i humb fjalës jo vetëm karakterin historik të saj, por edhe komponentet kuptimore që plotësohen, siç e përmendëm nga lexuesi.

Në veprat e Kadaresë përdoren dhe arkaizma për të plotësuar sfondin e një kohe të shkuar. Krahas mjediseve, botëkuptimit e psikologjisë së të shkuarës jepen edhe elemente gjuhësore të vjetruara të nxjerra nga tekste të autorëve tanë të vjetër::[165]

[157] Kadare, Ismail, *Emblema e dikurshme*, fq. 158.
[158] Kadare, Ismail, *Kronikë në gur*, fq. 69.
[159] Kadare, Ismail, *Koha e shkrimeve*, fq. 168.
[160] Kadare,Ismail, *Ura me tri harqe*, fq. 233.
[161] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, fq. 89.
[162] Kuptimi i tretë i fjalës “*defter*” sot është i rrallë në përdorim.
[163] *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Tiranë, 1980, fq. 299.
[164] Buchholz, Oda/Fieder, Wilfried, *General der toten Armee*, München, 1988, f. 86.
[165] Kjo ka të bëjë me ndërtekstualitetin, si një nga kriteret e tekstualitetit. Shih, Dibra, K/ Varfi, N, *Gjuhësi teksti,* Tiranë, Shblu, 2005, këtu fq. 39.

> “[…] Tue *kujtuom* se në *gluhën* tonë ende s`ka gja të *shkruam* për urën e Ujanës së Keqe dhe për *mënxyrën* që po vjen dhe e *nsë dashunës botës sanë*[…]”[166]
>
> *[...] vëllai em....[...]*[167]

Këto elemente gjuhësore të shënuara janë tregues të sfondit sociokulturor. Ato aktivizojnë komponente të dijes sociokulturore mbi prejardhjen, mënyrën e përdorimit dhe pjesërisht mbi zhvillimin e tyre në faza të caktuara. Pa aktivizuar dijen mbi kohën dhe realitetin social të kohës, nuk mund të rroket kuptimi i elementeve gjuhësore të huazuara nga tekste të autorëve tanë të vjetër.
Kombinimi i formave të vjetra me format e sotme është një mënyrë artistike të shprehuri. Elementet: *kujtuom, gluhë, e nsë dashunës botës sanë* ndihmojnë në ngjyrimin kohor të situatës. Bëhet fjalë për një kronikë të shkruar nga një murg nga fundi i Mesjetës. Elementet dhe lidhjet ndërtekstore janë me frazën e parë hyrëse të Mesharit të Gjon Buzukut. Autori me anë të kombinimit të elementeve gjuhësore të vjetra ka realizuar ngjyrimin kohor dhe njëkohësisht fragmenti është i kuptueshëm. Po të përdoreshin vetëm elemente të vjetëruara, do të bëhej më e theksuar referenca kohore, por do të vështirësohej receptimi i tekstit.

3.1.3.2 Fjalët e reja

Krijimi i fjalëve të reja është një nga burimet e shprehësisë në letërsinë artistike. Në letërsinë gjuhësore ka trajtime ku neologjizmat janë trajtuar si në aspektin gjuhësor, ashtu edhe në atë letrar. Në mendimin gjuhësor shqiptar mund të përmendim trajtimet e Jani Thomait në tekstin “Leksikologjia e gjuhës shqipe”, i cili jep të dhëna për neologjinë dhe neologjizmat në gjuhën shqipe. Ai dallon si grup më vete neologjizmat me vlerë stilistikore, fjalëkrijime të shkrimtarëve në vepra të ndryshme letrare-artistike.[168]
Po ky autor, në një artikull për neologjizmat e I. Kadaresë në librin “Koha e shkrimeve”[169], e vështron grupin e fjalëve të reja si mjet me vlerë stilistike dhe shprehësi të lartë.
Kurse studiuesi Ardian Vehbiu, në artikullin e tij “Fjalët e huaja, neologjizmat dhe ligjërimi”[170] trajton vetëm neologjizimat që kanë zëvendësuar fjalët e huaja.
Në këto trajtime dhe të tjera[171] theksohet vlera stilistike e fjalëve të reja. Por duhet të themi se përveç shprehësisë së lartë, neologjizmat janë edhe bartëse të informacionit social dhe kulturor. Kuptimi i tyre mund të rroket ose nëpërmjet aktivizimit të njohurive metagjuhësore, ose të njohurive që lidhen me sfondin social dhe kulturor. Le t`i vështrojmë më nga afër disa krijime të reja fjalësh në veprën e I. Kadaresë dhe t`i trajtojmë ato.

Në krijimtarinë e shkrimtarit I. Kadare spikat përdorimi i përzgjedhur i neologjizmave të krijuara prej tij. Ai shfrytëzon një numër të madh përftesash, të përdorura ose të

[166] Kadare, Ismail, *Ura me tri harqe*, f. 122.
[167] Kadare, Ismail, Darka e gabur, f.153.
[168] Shih, Thomai, Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë, Dudaj, 2005, f. 226 e në vijim.
[169] Shih, Thomai, Jani, *Krijimtaria gjuhësore e shkrimtarit shprehje e prirjeve të tij ideore dhe stilistike*, në: Drita, 25.01.1987, Tiranë, 1987.
[170] Shih, Vehbiu, Ardian, *Fjalët e huaja, neologjizmat dhe ligjërimi*, në: Gjuha Jonë 1, Tiranë, 1986.
[171] Shih, Sadiku, Emine, *Kadareja ky stilist i madh,* Tiranë 2000/ Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe gramatika*, Tiranë, Toena, 1999, f. 36.

papërdorura nga të tjerë, për ta ngarkuar dhe mbingarkuar fjalën që ajo të shprehë sa më shumë mendim dhe emocion e t`i përçojë këto sa më të plota te lexuesi. Fjala me ngjyrime e ngarkesa kuptimore bart këto komponente gramatiko-kuptimore që janë pjesë e njohurisë metagjuhësore. Në fushën e fjalëkrijimit, Kadareja vepron si njohës dhe lëvrues i talentuar i gjuhës. Kadareja i krijon fjalët e reja për të shprehur ato nocione që në gjuhën e zakonshme shënohen me togje fjalësh. P.sh., krijon njësinë *zonjëzim*[172] për *me u bërë zonjë; psehin*[173], *pse-në* për të dhënë fjalën pyetëse *pse, pranguar* për *duke qenë në pranga*[174], *grarrëmbyes* për *rrëmbyes grash.*
Röhm-i i përkthen neolgjizmat e sipërpërmenduara më së shumti me mjete fjalësore të ngulitura tashmë. P.sh., *psehin* me *was (pse);*[175] *praguar* me *gefesselt;*[176]*grarr*ëmbyes me togun *Frauen rauben*[177] (rrëmbej gra), *zonjëzim* me *Verdamung.*[178]

Duke i grupuar fjalët e reja të Kadaresë nga pikëpamja kuptimore, do të sqarojmë edhe lidhjet e tyre me sfondin social dhe kulturor.

Një grup të madh të neologjizmave përbëjnë fjalët që kanë ekuivalente në gjuhë. Në këtë rast, neologjizmi nuk shënon nocion të ri, por shërben si emërtim i ri i një nocioni jo të ri. Në planin onomasiologjik kemi dy variante emërtuese për të njëjtin referent.

Midis dy fjalëve, ekuivalenca kuptimore mund të jetë e njëjtë. Funksioni i neologjizmave në këtë rast është ta bëjë ligjërimin më të larmishëm.
Por, në shumicën e rasteve (dhe pikërisht kjo dukuri lidhet me punimin tonë), ekuivalenca kuptimore midis njësisë së re dhe asaj ekzistuese nuk është e plotë. Midis tyre ka dallime të ndryshme, dallime që mund të identifikohen nëpërmjet aktivizimit të njohurive metagjuhësore dhe sfondit social dhe kulturor. Dallimet janë:

- Dallime në ngjyrime kuptimore. P.sh.:

zymtor[179] *- i zymtë*	*(në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, online)*
turpanjoz[180] *– i turpshëm*	*(në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, online)*
i stërerrëti[181] *– i errëti*	*(në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, online)*

Në ballafaqimin e parë *zymtor – i zymtë*, dy njësitë shënojnë realie që dallohen nga përmasa ose shkalla e intesitetit të cilësisë. Fjala *zymtor* shënon shkallë intensiteti më të madhe se fjala *i zymtë*. Ky dallim i kuptimit dhe rrokja e kuptimit të fjalës së re arrihet nëpërmjet identifikimit të temës fjalëformuese të neologjizmit, *i zymtë* dhe gjetjes së komponenteve kuptimore që bëjnë pjesë në të. Këto elemente kuptimore, që bëhen pjesë e fjalës mbiemërore *zymtor*, mundësojnë rrokjen e kuptimit të fjalës së re dhe dallimit të saj me fjalën ekzistuese.

[172] Kadare, Ismail, *Darka e gabuar*, f.111.
[173] Kadare, Ismail, *Darka e gabuar*, f. 170.
[174] Kadare, Ismail, *Darka e gabuar*, f. 205.
[175] Röhm, Joachim, *Ein folgenschwerer Abend*, f. 148.
[176] Po aty, f. 181. Folja *fesseln (v*ë në pranga) është njësi e leksikalizuar, ajo është njësi e fjalorit gjermanisht.
[177] Po aty, f. 14.
[178] Po aty, f. 95.
[179] Kadare, Ismail, *Darka e gabuar*, f. 61.
[180] Po aty, f. 77.
[181] Po aty, f. 175.

Në krahasimin e fjalës *turpanjoz* me *turp,* dallimi ka të bëjë me formën e tyre të brendshme. Fjala *turpanjoz* motivohet, lidhet kuptimisht me emrin turp. Fjala *turpanjoz* shpreh cilësi sipas kuptimit të emrit *turp*. Shkalla e intesitetit të cilësisë është me përmasa më të mëdha se ajo që shënon mbiemri i leksikalizuar *i turpshëm*.

Dallohen për ngjyrimet e tyre kuptimore, në krahasim me fjalët sinonimike, formimet me parashtesën *stër-*.
Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, online, kemi këtë përcaktim të parashtesës *stër-*: “Parashtesë me të cilën ndërtohen fjalë të prejardhura: a) që tregojnë se diçka është me tepri, ka madhësi a përmasa të jashtëzakonshme ose është jashtë asaj që duhet, p.sh., i stërmadh(...), stërmundim; b) që shënojnë lidhje familjare me largësi prej tre brezave; p.sh. stërgjysh ....”
Formimet me parashtesën *stër-* te Kadareja, në pikëpamje morfologjike, janë emra, mbiemra, ndajfolje, folje. Për nga kuptimi ato shënojnë dukuri, veprime e tipare me përmasa jo të zakonshme. P. sh., *stërkeq* (khs. i keq); *i stërmoçëm* (khs. i moçëm); *i stërlavdishëm* (khs. i lavdishëm); *i stërmundimshëm* (khs. i mundimshëm); *i stërlargët* (khs. i largët); *i stërkeqet* (khs. i keqet). Formimet ndajfoljore me *stër-* janë jo vetëm neologjizma në kuptim, por edhe në modelin fjalëformues.
Dallimet kuptimore midis njësive të sipërpërmendura sinonimike identifikohen nëpërmjet aktivizimit të njohurive metagjuhësore ose edhe të dijes semantike mbi fjalën e re të shqyrtuar, siç ishte shembulli i fjalës *zymtor*. Ky dallim i kuptimit midis dy njësive mundëson edhe rrokjen e kuptimit të fjalës së re, kuptimi i së cilës rroket si tërësi e komponenteve kuptimore përbërëse të fjalës ekzistuese me elementet kuptimore që shërbejnë për dallimin e njësive të barasvlefshme, fjalës së re nga ajo përgjegjëse.

Po t´i krahasojmë neologjizmat e sipërpërmendura me gjegjëset në gjermanisht, do të rezultojnë dallime kuptimore me njësitë në shqip të Kadaresë. Gjegjësja në gjermanisht *düster* për *zymtor* dallon jo vetëm se ajo është njësi e leksikalizuar, por edhe se nuk emeton të njëjtën shkallë intensiteti të cilësisë si në shqip.

Neologjizmi në shqip *bjerrakohës*[182] është përkthyer në gjermanisht me *Tagedieben*.[183] Njësia *bjerrakohës* është formuar prej temave *bjerr* dhe *kohës*. Për zbërthimin e kuptimit të njësisë na ndihmojnë njohuritë metagjuhësore. Analog me formimin *bjerrakohës* në gjuhën shqipe është *bjerraditës* me kuptimin: ai që e humb kohën kot. Por, përmasa e komponentit kuptimor *humb* është, përsa i përket shtrirjes, e pakufizuar. Kjo do të thotë që intensitetet dhe ngjyrimet kuptimore të njësive në shqip janë të ndryshme. Përkthimi në gjermanisht Tagedieben (bjerraditë) ka dallime kuptimore në emetimin e intensitetit me njësinë në shqip.

- Midis dy njësive, me barasvlerë jo të plotë, mund të ketë dallime në ngjyrimin afektiv.

Njëra njësi përmban ngjyrime emocionale-vlerësuese, tjetra jo, ose kanë ngjyrime emocionale shkallësh të ndryshme; p.sh., *mjeran – i mjerë; zymtan, zymtor– i zymtë; shkurtan – i shkurtër; qelqan – i qelqtë; shurdhan – i shurdhër; vraparak – vrapues*

[182] Kadare, Ismail, *Darka e gabuar*, f. 84.
[183] Röhm, Joachim, *Ein folgenschwerer Abend*, f. 70.

Për të patur një ide më të plotë për ngjyrimet afektive të njësive neologjizma, po japim disa prej tyre në kontekstet ku janë vendosur: [...] *prapë me Doktor Gurameton, por, këtë herë zymtor e dramatik* [...][184] Fjala *zymtor* flet për një gjendje shumë të keqe emocionale.
Përkthimi në gjermanisht: [...] im anderen (Szenarium), *düsteren* und hochdramatischen[185] nuk e paraqet skenarin e mundshëm të zgjidhjes së darkës enigmë të përfytyruar nga fantazia aq dramatike dhe të zymtë-
Ose, p.sh., neologjizmi *mëkatnor* në *I ngjashëm me tundimin mëkatnor*, nuk përkthehet në gjermanisht nga Röhm-i. I tërë përshkrimi i katundeve minoritare greke paraqet vështirësi në përkthim për përkthyesin J. Röhm.
Po kështu, përkthimi i neologjizmit *shtrajtuar*[186] në gjermanisht dallon me gjegjësen *verzerrt*[187], e cila është njësi e leksikalizuar dhe nuk emeton të njëjtat vlera kuptimore, të njëjtat përmasa të veprimit si edhe në shqip.

- Njësitë e barasvlefshme (neologjizmi dhe fjala përgjegjëse në gjuhë) dallohen nga ngjyrimi stilistik.

Ato mbajnë shenjën e stileve të ndryshme, stile të cilat identifikohen nëpërmjet aktivizimit të njohurive metagjuhësore mbi stilet. Neologjizmat në veprën e Kadaresë janë të llojit stilistik, janë krijime letrare stilistike ose librore. Zakonisht, ato mbeten brenda veprës e nuk përhapen në ligjërimin e përditshëm. Pothuaj të gjitha neologjizmat e I. Kadaresë (me shumë pak përjashtime) kanë ngjyrime letrare artistike ose librore. Me ngjyrime të tilla ato u kundërvihen përgjegjëseve të tyre të stileve të tjera. Në grupin e neologjizmave dallohen për *ngjyrimet librore* formime, si: mbiemra me prapashtesën *–shëm; oz*; *turpanjoz* (khs. *i turpshëm*); *inatçor* (khs. *i inatosur*); *mynxyror* (khs. *i mynxyrshëm*); *vetëmor* (khs. *i vetëm*). Gjegjëset në gjermanisht nuk janë të shenjuara stilistikisht; ato përkthehen me njësi të leksikalizuara.

- Një grup fjalësh të reja nuk kanë përgjegjëse në gjuhë. Kësisoj, ato shënojnë nocione të reja. Këto nocione ose u përkasin përfytyrimeve e vizionit të autorit për botën, ose formojnë një nocion të ri me shoqërim idesh Ja disa shembuj nga ky grup fjalësh:

Neologjizmat e formuara me fjalëformim me përbërje në romanin "Darka e gabuar", si *grarrëmbyes, brinjathyes, fajshpërndarës, shkarrangjitje, dynetësh, rrokavajshëm, tjetërfartë, sipëraninë, kushedisatën, shkarrangjitje* formohen sipas modeleve të fjalëformimit, të pranishme në sistemin gjuhësor të shqipes. Po ndalemi në njësinë *dynetësh*, e përkthyer në gjermanisht me *Doppelnacht*. Analiza kuptimore e njësisë, siç do ta tregojmë edhe në kapitullin mbi elementet emergente të metaforave, mundësohet përmes aktivizimit të koncepteve prej të cilave ato përbëhen, por edhe nga ndërveprimi i këtyre koncepteve me elemente kuptimore të përftuara nga koteksti dhe konteksti. Në të dyja gjuhët kemi fjalëformim me përbërje: në shqip numërori dy bashkohet me emrin *natë*, në rasën rrjedhore shumës dhe në gjermanisht mbiemri i dyfishtë, i prejardhur prej numërorit dy, bashkohet me formën e rasës emërore njëjës të emrit natë. Koncepti që formohet me shoqërim idesh emërton një rrjedhë kohore dyzet e ca orëshe, e cila ndryshe nga rrjedha normale e kohës, përbëhet vetëm prej

[184] Kadare, Ismail, *Darka e gabuar*, f. 61.
[185] Röhm, Joachim, *Ein folgenschwerer Abend*, f. 50.
[186] Kadare, Ismail, *Darka e gabuar*, f. 16.
[187] Röhm, Joachim, *Ein folgenschwerer Abend*, f. 12.

netësh. Nga ndërveprimi i elementeve konceptuale përbërëse të kuptimit *natë* me numërorin *dy*, por edhe me komponente kuptimore që rrjedhin nga koteksti, arrijmë ta përcaktojmë kuptimin e neologjizmit në shqip. Në kotekst kemi mjaftueshëm komponente kuptimore të aktivizuara në këtë segment. Tregohet për darkën enigmatike, e cila krahasohet me përrallat. Përmendja e emrit *përrallë* na hedh në një parametër tjetër të qenësishëm të teksit: në intertekstualitetin. Me asociacion a shoqërim idesh, njësitë *ardhja e mëngjesit..., gjermanët e ngurosur, çngurosja,... ringjallja si në përrallë, ...një mijë vjet pritjeje* na hedhin në përrallën e Aurorës, takimi i shumëdëshiruar dhe i shumëpritur i së cilës me prindërit u realizua si në profecinë e shtrigës, e një fuqie të epërme të një qenieje jo të zakonshme. Gjithë ky skenar i aktivizuar në mendjen tonë nga përralla paraprihet në tekstin e Kadaresë nga elemente të tjera ndërtekstore që vijnë nga folklori shqiptar: njohja e vëllait nga motra prej një shenje të familjes. I gjithë ky sfond që krijohet nga lexuesi i tekstit të Kadaresë si rrjedhojë e ndërveprimit të elementeve të sipërpërmendura, i bashkangjit komponente konceptuale neologjizmit dynetësh të cilat jashtë kotekstit dhe kontekstit nuk do t´i përmendnim si elemente përbërës të kuptimit të tij. Dynetëshi emërton një kohëzgjatje kohore prej dyzet e ca orësh, gjatë së cilës ndodhin dukuri që herë mund të krahasohen me ngjarje, për shkak se duket të kenë elemente reale (si njohja e kolonelit me doktor Gurameton e madh, kujtimi prej tyre i bisedave studentore në Gjermani), dhe herë me vegullime, përfytyrime trillane, nëse do të krahasohej ajo çka ndodhte në qytet me atë që ndodhte në shtëpinë e Gurametos. Ky dynetësh, i emërtuar ndryshe edhe darka e mistershme, enigmatike, lemeri në trajtë darke është edhe një element mbi të cilin thuret dhe endet i gjithë romani i Kadaresë. Koherenca e këtij romani lidhet dhe drejtohet nga kuptimi i drejtë i kësaj ngjarjeje.

Ky neologjizëm kontekstual ka vlerë brenda një konteksti në të cilin e rrezaton kuptimin e tij. I rimarrë në kontekste të tjera, ai nuk e bën përshtypjen e parë.
Më poshtë po japim një listë neologjizmash të evidentuar nga “Darka e gabuar” në shqip dhe gjegjëset e tyre në gjermanisht:

	Darka e gabuar	Ein folgenschwerer Abend
1	*mëkatnor*	nuk përkthehet
2	(përfytyrim) i *shtrajtuar* (f. 12)	*verzerrtes* (Bild) (imazh i shfromësuar) (f. 12)
3	*gurane* (f. 18)	*Steinbruch* (gurore) (f. 14)
4	*grarrëmbyes* (f. 18)	*Frauen raubte* (rrë mbente gratë)(f. 14)
5	*brinjathyes* (f. 19)	nuk përkthehet
6	*tjetërfartë* (f. 23)	*absonderlich, abartig* (tjetërfartë , e tjetërllojshme)(f. 18)
7	*shkarrangjitje* rënkuese(f. 40)	mit ohrenbetäubendes *Rasseln und Kreischen* (me rrapëllimë dhe kërkëllimë shurdhuese)
8	*zymtor* (f. 61)	*düsteren*, hochdramatischen (të zymtë) (f. 50)
9	*dynetësh* (f. 72)	*Doppelnacht* (natë e dyfishtë) (f. 60)
10	*sipëraninë (f. 75)*	nuk përkthehet
11	sjella e druajtur, gati *turpanjoze* (f. 77)	Das schüchterne, fast *genierliche* Auftreten (sjellja e druajtur, pothuajse e përmbajtur) (f. 64)
12	*bjerrakohës* (f. 84)	*Tagedieben* (bjerraditë)(f. 70)
13	*zonjëzim* (f. 111)	*Verdamung* (zonjëzim)(f. 95)
14	fantazi *fajkërkues* (f. 124)	die nach *Schud forschende* Phantasie (fantazi që kërkon për fajin) (f.107)
15	*drithmuar* (f. 134)	*erschrak* (trandi) (f. 115)
16	*hierorja* (f. 137)	*Strahlkraft* (forca rrezatuese) (f. 118)
17	*qashtërinë* (f. 157)	*Glaubwürdigkeit* (besueshmërinë) (f. 137)
18	*psehin* (f. 170)	*was* (çfarë, kush)(f. 148)
19	*kërkëllimë* (f. 173)	*quitschend* (duke bërë kërr-kërr) (f. 151)

20	*kushedisatën* (f. 175)	*soundsovielten* (kushedisatën) (f. 152)
21	*stërrerrëti* (f. 175)	absoluter *Finsternis* (errësirë absolute) (f. 153)
22	*rrokavajshëm* (f. 183)	*ächzen* (onomatope: të bënte eh, të rënkonte) (f. 159)
23	*pranguar* (f. 205)	*gefesselt* (i prangosur)

Nga përqasja e e neologjizmave në shqip me gjegjëset në gjermanisht konstatojmë se vetëm njëri prej tyre jepet me një neologjizëm nga J. Röhmi. Duke i përkthyer me njësi gjuësore të leksikalizuara, përkthimet humbasin ato vlera që emetojnë në gjuhën shqipe neologjizmat e Kadaresë.

3.1.3.3 Fjalët e huaja (Huazimet)

Krahas leksikut shqip, në prozën e Kadaresë ndeshim edhe një grup fjalësh nga gjuhë të huaja. Kjo shtresë e leksikut përdoret për të karakterizuar personazhe, situata, gjendje, duke evokuar edhe një sfond tjetër social dhe kulturor, i ndryshëm nga ai nacional. Kjo është një dukuri e njohur në letërsinë artistike.

> “Për qëllime stilistike, në ligjërimin shqip përfshihen edhe fjalë të tëra nga gjuhët e huaja.[...] Huazimet, ashtu si shtresat e tjera, p.sh. dialektalizmat, i nënshtrohen një vlerësimi shoqëror dhe kulturor, prej të cilit mbeten ngjyrime stilistike në leksik dhe, rrjedhimisht, mund të shfrytëzohen po për ato synime dhe me po ato përftesa shprehëse.”[188]

Fjalët e huaja ndodh që të shpërndahen në thënie të ndryshme, ndodh të përdoren në togfjalësha me fjalë të huaja, si edhe fjali të tëra. Përdoren, gjithashtu, edhe ortograme gjuhësh të huaja për fjalë tonat.
Në përshtatje me tematikën që trajtohet, fjalët e huaja merren nga gjuhë të ndryshme, si nga frëngjishtja, latinishtja, gjermanishtja, italishtja, rusishtja, turqishtja, holandishtja e ndonjë gjuhë tjetër.
Fjalët në gjuhë të huaja në tekstet letrare referojnë në vende e në rrethe të tjera kulturore. Përdorimi i tyre bëhet për t`i dhënë rrëfimit më shumë siguri dhe vërtetësi. Si të thuash, ato argumentojnë autenticitetin e thënieve, vërtetësinë e rrëfimit. Si mjete me shprehësi të lartë, tërheqin menjëherë vëmendjen e lexuesit. Shpesh janë të panjohura për marrësit e mesazheve. Prandaj është i domosdoshëm një shpjegim metagjuhësor. Përdorimi i fjalëve të huaja bëhet shpesh për të karakterizuar personazhet. Fjalët e huaja të vëna në ligjërimin e tyre dëshmojnë për nacionalitetin ose për prirje kulturore.
Efekti i leksikut në gjuhë të huaj lidhet me aftësinë e tyre evokuese. Fjalët e huaja evokojnë një tjetër mjedis kombëtar, d.m.th. një sfond tjetër social dhe kulturor. Njohja e këtij sfondi përbën domosdoshmëri për rrokjen e kuptimit të fjalëve të huaja.
Përdorimi i fjalëve të huaja, në një sasi jo të papërfillshme, është veçori karakteristike e leksikut në ligjërimin e Kadaresë. Në gjithë krijimet në prozë të tij takohen fjalë të huaja. P.sh., në romanin “Dimri i Madh” përdoren fjalë të gjuhës ruse dhe të gjuhës frënge. Kjo gjë kushtëzohet nga tematika e nga situatat e paraqitura. Meqë linja kryesore e këtij romani shtjellon ndeshjen historike midis Partisë së Punës e politikës sovjetike, përdoren shpesh fjalë të gjuhës ruse.
Në novelën “Viti i mbrapshtë”, ku shtjellimi i linjës së turkofilëve (viti 1913) zë një vend të madh, përdoren shumë fjalë turke e turqizma.
Leksiku i romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” përmban një sasi fjalësh italiane, latine dhe huazime të tjera neolatine.

[188] Lloshi, Xh., *Njohuri mbi stilistikën shqiptare*, Tiranë, 1999, f. 111.

Leksiku i romanit “Darka e gabuar”, plani kryesor i së cilit është zhvillimi i darkës me kolonelin gjerman dhe zbulimi i enigmës së saj, fjalët e huaja janë në gjermanisht.
Fjalët e huaja mund t`i gruponim sipas gjuhës nga janë marrë. Një veprim i tillë do të ishte një veprim i thjeshtë, pa ndonjë interes të veçantë. Na u duk më me vend e më me interes t`i grupojmë fjalët e huaja sipas shërbimeve e përdorimeve që përmbushin. Para se të bëjmë një grupim të tillë, vlen të përmendim që fjalët e huaja të përdorura nga shkrimtari I. Kadare e ruajnë kuptimin e tyre origjinal dhe konotacionet që bartin në gjuhën nga janë marrë. Ky grup fjalësh bëhet pjesë e natyrshme e leksikut të veprave. Kjo liri veprimi arrin deri në krijimin e ndonjë kompozite me elemente të huaja e sipas një modeli të huaj si *Baklavakroniek.* Fjala krijohet sipas modelit të kompozimit në gjuhën gjermane: fjala përcaktuese qëndron para fjalës së përcaktuar. Edhe drejtshkrimi është si në gjuhën gjermane, me diftongun ie.[189]
Një krijim tjetër leksikor që rrjedh nga bashkimi i dy fjalëve të huaja është edhe *bon aksham*. (Fjala *bon* e gjuhës frënge bashkohet me fjalën *aksham* të turqishtes). Veç ngjyrimit humoristik, ky sajim mbart edhe konotacione shoqërore: bën pjesë në zhargonin e një grupi studentësh.
Në shumicën dërrmuese të rasteve, shkrimtari i përkthen fjalët e huaja. Në ndonjë rast, fjala e huaj nuk përkthehet (si në ndërtimin Islamo *nox*). Fjala e papërkthyer është një pikë e ligjërimit dhe ndodh në rastet kur bëhet fjalë për diçka që mendohet e njohur, e shpjegueshme me njohuritë e pasurinë kulturore gjuhësore të lexuesit. Kështu ndërtimi *Islamo nox* bëhet sipas modelit nata e Bartolomeut, nata e Valpurgës etj. Është fjala për netë ku ndodhin gjëra të frikshme. Evokimi i këtij sfondi mundëson të kuptuarit e fjalës së huaj të përdorur.
Fjalët e huaja sillen në ligjërim me shërbime të ndryshme. Në rastet më të shumta, ato përdoren për të paraqitur me vërtetësi mjedise, personazhe, epoka, d.m.th. për të evokuar një informacion të caktuar sociokulturor.

Ja disa shembuj për këtë:

“iu duk sikur në çastin e shkrepjes gryka e topit gjëmoi “*allah*”[190]
Gjermanisht: “als donnere bei der Mündung der Kanone das Wort “Allah”[191]

“Që larg vinte zëri i atij që këndonte: *Dynja, dynja.*”[192]
Gjermanisht: “Von weit her drang hin und wieder die Stimme eines Sängers zu ihnen:
Die Welt, die Welt.[193]

Fjalët *dynja, dynja,* të një kënge ushtarësh, ndihmojnë për të paraqitur kampin e ushtarëve turq. Fjala *dynja* evokon, së pari, një mjedis të huaj nacional, Turqinë. Përveç evokimit, ajo mbart edhe konotacione që lidhen me gjendjen psikologjike të ushtarëve: pesimizëm. Dy rreshta të një këngë në gjuhë të huaj japin krejt rënien morale të ushtrisë së huaj, panikun dhe pesimizmin e pafund të saj: “*Dynja, dynja, harram dynja.”*[194] Kjo rrokje e përmbajtjes rezulton nga evokimi me anë të fjalës së huazuar “dynja”, që përdoret në gjuhën shqipe dhe ka edhe statusin e arkaizmit. Po

[189] Huazimet ndeshen jo vetëm në leksik, edhe pse në këtë rrafsh ato janë më të dukshme, Ato ndeshen edhe në rrafshin fonetik- fonologjik dhe në atë sintaksor. Shih, Varfi, Nonda, *Mbi huazimet e shqipes*, në, Rreth huazimeve në shqipen standarde. Akte të seminarit të tretë. Tiranë, 2004. f. 7.
[190] Kadare, Ismail, *Kështjella,* f. 31.
[191] De Siati, Giuseppe, Die Festung, Kiel, 1988, f. 32
[192] Kadare, Ismail, *Kështjella,* f.32.
[193] De Siati, Giuseppe, Die Festung, Kiel, 1988, f. 33.
[194] Po aty, f. 31.

ashtu edhe fjala "haram". Kjo vlerë stilistikore që mbart fjala në shqip humb në përkthimin në gjermanisht. Gjegjësja "Die Welt, die Welt" (botë, botë) ka një kuptimi nocionor neutral, ajo nuk është e shenjuar stilistikisht.
Huazimi tjetër nga turqishtja "allah", i cili, në fakt, është një internacionalizëm emeton edhe në gjermanisht në një sfond tjetër kulturor dhe në një rreth të caktuar shoqëror.
Edhe shembulli i mëposhtëm, i cili në shqip paraqet një rreth biseduesish turq: "*Selam, efendilerë*, -përshëndeti Siri Selimi,"[195] ruan dhe transmeton të njëjtat vlera edhe në gjermanisht, sepse, siç shihet, edhe në përkthimin "*´Selam, Efendiler´*", grüßte er sie zum zweiten Mal. Es war Siri Selim", përdoren fjalë të huazuara.

Në romanin "Darka e gabuar" fjalët e huazuara janë, siç e përmendëm, nga gjuha gjermane. Fjalët e huaja të huazuara janë të regjistrave të ndryshëm: që nga ai thjeshtligjërimor deri tek ai libror.
Vënia në gojën e doktor Gurametos së madh të fjalëve sharëse të ligjërimit thjeshtligjërimor shërben për të shenjuar sfondin kulturor që e mbështjell atë. Ato fjalë dëshmojnë për një rreth të caktuar kulturor, që doktor Gurametoja i madh e kishte importuar nga koha e qëndrimit për studime në Gjermani.
Të njëjtat fjalë në gojën e Bufe Hasanit shërbejnë për të karakterizuar këtë personazh. Këto fjalë sharëse në gojën e një shqiptari, për të cilin në roman nuk tregohet të ketë pasur përvojë me kulturën gjermane, janë një përftesë e Kadaresë për të dalluar shqiparët e tjerë nga ai shqiptar, nënpunës dhe përfaqësues i shtetit shqiptar, që kishte ndërrmarrë një skandal moral të pashembullt për ta. Në të dyja rastet, njësitë e huazuara nga gjermanishtja nuk jepen në përkthim. Në rastin e parë, kur Kadare i vendos fjalët në gojën e doktor Gurametos së madh, përkthyesi e quan të tepërt përkthimin e të gjithë thënies me fjalë të huazuara. J. Röhmi nuk e përkthen tërë sekuencën që nga "Meqenëse doktor Gurametoja i madh... i tha ato në gjermanisht. Me fjalë të tjera, edhe mund të ndërhynte, po të ishte për punë Muschi dhe Arschloch-u.[196] Përkthimi i Röhmit mbaron me "...aber das hier ist ein ganz anderes Gebiet, von dem ich nicht das geringtse verstehe[197] (por kjo është një fushë krejt tjetër, prej së cilës unë nuk ia kam haberin fare).
Përkthimi i fjalëve sharëse që përdor Kadare për të dhënë atë çka mbetet nga historia e Bufe Hasanit dhe i tërë fragmentit që e përshkruan atë, devijon shumë nga origjinali. Röhmi i perifrazon në formë pyetjeje fjalët e huaja të përdorura nga Kadareja në roman. Këtë pyetje ai e vë në gojën e një fëmije çamarrok. Ja si jepet në përkthim i tërë fragmenti i Kadaresë:

> "Wären nicht ein paar Verdrießlichkeiten zu registrieren gewesen, zum Beispiel die unerwartete Frage eines kleinen Bengels: ´Mami, was hat der Herr Bufe denn mit dem deutschen Onkel im Rathauskeller gemacht?´, alles hätte noch einen schöneren Gang genommen"[198] (Gjithçka do të kishte pasur një ecuri më të mirë, nëse do të ishin të regjistruara disa gjëra të bezdishme, si p.sh., pyetja e papritur nga një çamarrok i vogël: "Mami, çfarë bëri zoti Bufe me xhaxhi gjermanin në bodrumin e bashkisë?"

Krahasimi i çështjes së Bufe Hasanit me marrëveshjen e *Munihut* dhe *Neville Chamberlain- it* evokojnë ngjarje, situata nga sfonde të tjera kulturore. Aktivizimi i tyre luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e domethënies së tekstit.

[195] De Siati, Giuseppe, Die Festung, Kiel, 1988, f. 200.
[196] Kadare, Ismail, *Darka e gabuar*, f. 77.
[197] Röhm, Joachim, *Ein folgenschwerer Abend*, f. 64.
[198] Röhm, Joachim, *Ein folgenschwerer Abend*, f. 66.

Fjala e përzgjedhur nga sfera kishtare *soma pneumatikon*[199] paraqet vështirësi për lexuesin e veprës, andaj Kadare jep edhe ekuivalenten në shqip, *trup frymor ose shpirtëror*. Edhe Röhmi e shpjegon përmes parafrazimit kuptimin e fjalës së huaj: ... *vom geistlichen und überirdischen Leib die Rede.*[200]
Të gjitha fjalët e huaja të përdorura në këtë roman nga Kadare jepen edhe me ortografinë e gjuhës gjermane.

Për të evokuar realitete, situata, kohëra, ngjarje, objekte, fjalë të huaja përdoren edhe në vepra të tjera. Ja disa shembuj:

> Pa shkronjat e huaja mbi beton *`Gott sei mit uns`*.[201]
> *Stoj! Prohodite*![202]
> Ishte shkruar fjala *“Tabir.”*[203]
> Nuk është testament i zakonshëm për një *vakëfname.*[204]
> Atëherë të gjithë e kuptuam se me *`oscurameton`* s`bëhej shaka[205];
> Ata trokisnin nëpër dyer duke lypur bukë*: Psomi, Psomi***.**[206]

Fjalët e huaja përdoren edhe për të karakterizuar personazhet, për të paraqitur veçori morale të tyre. P.sh., gjenerali, në romanin “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” përdor në të folur fjalë të huazuara nga gjuha frënge, si:

> ...–këtë punën tonë *mizerabël...*[207]

Filoturqit, personazhe në novelën “Viti i mbrapshtë” e mbushin ligjërimin e tyre me fjalë turke e turqizma. Turqizma përdoren edhe nga personazhe të moshuar dhe të paditur. Kjo ndihmon në paraqitjen e botëkuptimit e të padijes së tyre:

> Pastaj, Kus Babajt, që e paçim, iu rrëmbushën sytë sa zuri ngojë Turqinë, që *hainët* donin ta *bënin hasha*, po a *bëhet hasha nëna*, tha ai, nga që është plakë.[208]

Zgjedhja dhe aktivizimi i fjalëve të huaja kryejnë funksionin e aktivizimit dhe evokimit të një sfondi tjetër social dhe kulturor, duke ndihmuar edhe në rrokjen e kuptimit të tekstit ose të thënieve ose në portretizimin e personazheve.

3.2 Dritëhijet semantike: Përdorimi i teorisë së lakunave në analizën e romanit „Prilli i thyer“

3.2.1 Qëllimi

Shtjellimet e deritanishme mbi kuptimin si dije semantike e kushtëzuar nga faktorë shoqërorë, shtjellimet mbi ndikimin e sfondit sociokulturor në prodhimin e receptimin e teksteve janë shtysë për të trajtuar edhe probleme teorike dhe praktike që lindin si pasojë e tyre gjatë përkthimit të teksteve. Nga ana tjetër, shtjellimet e deritanishme

[199] Kadare, Ismail, *Darka e gabuar*, f. 154.
[200] Röhm, Joachim, *Ein folgenschwerer Abend*, f. 134.
[201] Kadare, I., *Dimri i madh*, f. 89.
[202] Po aty, fq. 460.
[203] Kadare, I., *Ura me tri harqe*, f. 461.
[204] Kadare. I., *Emblema e dikurshme*, f. 267.
[205] Kadare, I., *Kronikë në gur*, f. 70.
[206] Po aty, fq. 141.
[207] Kadare, Ismail, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 126.
[208] Kadare, I. *Koha e shkrimeve*, f. 314.

mbi veçantitë e tekstit letrar, estetikën receptive, madhësitë e estetikës, praninë e vendeve bosh në tekstin letrar ku objekti ose gjendja referojnë në sfonde e hapësira që nuk jepen në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekst,[209] e bëjnë trajtimin e problemeve që lindin gjatë transferimit të strukturave tekstore nga një gjuhë në tjetrën të pashmangshëm. Kështu, hulumtimi ynë në vijimësi do të ketë një pamje teorike-praktike, ku do të përzihen dhe përvojat vetjake në fushën e përkthimit.

Në qendër të trajtimeve qëndron teoria e lakunave, teori e cila përbën sferat qendrore të studimeve të sotme etnopsiko-linguistike. Njësia bazë e kësaj teorie është *lakuna (gjer. Lakune, ang. Lacuna, fr. Lacune)*. Kjo kategori shenjon ndryshimet kuptimore që shfaqen gjatë kontakteve ndërkulturore, qoftë në komunikimin tekstor, qoftë në komunikimin gojor në plan gjuhësor e kulturor. *Lakuna*, është kështu, një kategori që shënon dallimet ndërkulturore. Karakteri universal i kësaj kategorie ka mundësuar përdorimin e saj në fusha të ndryshme të kërkimeve gjuhësore e kulturore. Rezultati i këtyre përdorimeve është zhvillimi i një modeli teorik që ka si objekt dallimet ndërkulturore. Në etnolinguistikë, ky model trajtohet dhe përkufizohet si *teoria e lakunave*.[210]

Duke qenë se edhe përkthimi është një lloj komunikimi ndërkulturor, ku përqasen kultura të ndryshme në formë tekstesh, analiza dhe hetimi i dukurisë *përkthim* mund të bëhet edhe duke aktivizuar konceptet dhe formulat e teorisë së lakunave.
Qëllimi kryesor i këtij kapitulli është përdorimi i teorisë së lakunave në kuadrin e veprimtarisë përkthyese të teksteve letrare. Vëmendje të veçantë i kemi kushtuar analizës së përkthimit të romanit të I. Kadaresë “Prilli i thyer” në gjermanisht nga J. Röhm “Der zerrissene April”. Modeli i lakunave është përdorur si aparat teorik për të shpjeguar dukuritë dhe problemet e ndryshme gjuhësore-kulturore që dalin gjatë përkthimit. Karakteri taksonomik sistemor i modelit lakunor e bën atë të përshtatshëm në analizën e përkthimit dhe të teksteve të përkthyera ku nevojiten shpjegime dhe sqarime për elemente të caktuara semantike. Lidhur me këtë, Stolze thotë se një model i tillë është efekshëm në “kapërcimin e vështirësive në të kuptuarit e teksteve në gjuhë të ndryshme që përmbajnë detyrimisht dallime në konceptimin e realitetit, dallime të aspektit kulturor etj.”[211]
Krahas analizës së korpusit tonë, romanit “Prilli i thyer”, variantit origjinal dhe përkthimit gjermanisht “Der zerrissene April” do të merremi edhe me paraqitjen e disa koncepteve që lidhen me lakunat dhe aktivizohen gjatë shpalosjes së teorisë mbi to.
Kështu, do të shpjegohen shkurtimisht konceptetet me të cilat do të operohet. Do të ndalemi, ndër të tjera, edhe në shpjegimin e konceptit „kulturë, pasi trajtimi i termit lakunë parakupton sqarimin e konceptit *kulturë.* Kemi vënë re se edhe autoritete të sotme politike të fushës së kulturës e përdorin këtë koncept me kuptimin e artit ose të lidhur me artin. Ky është një përdorim i ngushtuar, madje i gabuar. Më poshtë do të japim formulimin dhe kuptimin e termit „kulturë“, duke theksuar se koncepti „kulturë“ mund të përcaktohet dhe si kod normash dhe konvencionesh të një shoqërie

[209] Shih, Iser, Wolfgang, *Der Akt des Lesens - Theorie ästhetischer Wirkung*, München, Wilhelm Fink Verlag, 1976, f. 53. Në këtë vepër Iseri nënvizon se “Qëllimi i teksteve letrare mund të përfytyrohet, vetëm se nuk jepet në mënyrë eksplicite dhe si pasojë është i pranishëm vetëm në aftësinë imagjinare të recipientit.
[210] Földes, Csaba, Interkulturelle Linguistik. Vorüberlegungen zu Koncepten, Probleme, Desiderata, Wien, 2003, f. 46.
[211] Stolze, Radegundis, Hermeneutisches Übersetzen, Gunter Narr Verlag, 1992, f. 77; 85.

të caktuar. Përkthyesi mund ta kryejë me saktësi detyrën e tij po qe se u përmbahet me ndërgjegje këtyre rregullave që përfshin kodi. Përkthimi është një dukuri komplekse që ngërthen aspekte gjuhësore dhe jo gjuhësore. Në të gjuha dhe kultura bashkëjetojnë në një proces kreativ.
Përkthyesi ndërmerr detyrën ta përçojë në gjuhën amtare kulturën e huaj. Kësaj kulture i shtohen dhe kuptimet eksplicite dhe implicite që përmban fjalori i përdorur. Kështu procesi i përkthimit nuk rrjedh pa komplikime. Por përkthimet janë shumë të rëndësishme e të domosdoshme për lidhjet dhe komunikimin midis popujve. Që përkthyesi të arrijë të ndërtojë një urë midis dy kulturash, duhet të zhvillojë strategji të tilla pune që synojnë një ekuivalencë midis teksteve, tekstit origjinal dhe tekstit të përkthyer. Ekuivalenca duhet të jetë e planit denotativ dhe e planit konotativ.
Në çastet e përkthimit, ku gjetja e një përgjegjësje të përshtatshme është problematike, shfaqen lakunat. Ne do t’i përkufizojmë, do t’i klasifikojmë lakunat dhe do të shtjellojmë mënyra, metoda dhe praktika për mënjanimin e tyre.

3.2.2 Dy fjalë mbi etnopsikolinguistikën

Historia e etnopsikolinguistikës fillon nga mesi i vitit 1960, kur gjuhëtari rus Leontjew themeloi shkollën psikologjike gjuhësore të Moskës. Kjo shkollë në teorinë dhe në argumentet e saj dallonte nga biheviorizmi psikolinguistik i viteve 50, i zhvilluar nga Osgood dhe Miller & Chomski. Por kërkimet intensive në fushën etnopsikologjike filluan dhjetë vjet më vonë, kohë kur etnopsikolinguistika u përvijua si një drejtim shkencor kërkimor më vete, në kuadrin e psikolinguistikës. Kjo ndodhi në Institutin Gjuhësor të Akademisë së Shkencave në Moskë. Leontjewi e shpjegon nevojën e ndarjes së etnopsikolinguistikës si disiplinë më vete, duke u nisur nga fakti se “…koncepti *psikolinguistikë* ishte zgjeruar shumë në kuptimin e tij, ai po bëhej gjithnjë e më shumë një nocion global, ku përfshihej jo vetëm psikologjia gjuhësore në kuptimin e ngushtë, por edhe teoria e komunikimit (psikologjia e komunikimit dhe e sjelljes gjuhësore). Prandaj për të shënuar fushën krejt speciale propozohet termi *etnopsikolinguistikë*.”[212]

3.2.2.1 Aspekte kulturore të psikolinguistikës

Problemi i relacionit midis gjuhës dhe mendimit (gjuhës dhe njohjes) gjendet në qendër të kërkimeve etnopsikolinguistike. Me këtë kuptohet ndikimi i gjuhës në veprimtarinë njohëse të bartësve të saj dhe anasjelltas. Ky problem është i lidhur edhe me faktin e segmentimit të ndryshëm të realitetit në gjuhë të ndryshme. Veprimtaria konkrete njohëse e njeriut shpaloset sipas modelesh, të cilat në trurin e njeriut janë ngulitur në formën e operacioneve mendore. Mendimi lind nën ndikimin e realitetit jashtëgjuhësor.[213]

Veprimtaria jashtëgjuhësore organizohet me anë të gjuhës në modele, në të cilat projektohen mendimet. Por veprimtaria konkrete njohëse nuk përcaktohet nga gjuha. Determinimi kalon nga veprimtaria mendore në atë gjuhësore. Kështu gjuha është mjet i mendimit, si dhe mjet i njohjes.[214]

[212] Leontjew, Alexej, *Psikolinguistische Einheiten und die Ergänzung sprachlicher Äusserungen,* Max Huber Verlag, 1977, f. 5- 14.
[213] Shih, Sorokin, Jurij Aleksandrovic, *Lakunen – Theorie. Zur Optimierung interkultureller Kommunikation,* botuar në, Sprache, Kultur Identität, Peter Lang, 1994, f. 167 – 173
[214] Shih, po aty, f. 167-173.

Dijet kulturore të njeriut paraqesin bërthamën e specifikës etnokulturore të mendimit. Po sipas autorëve të sipërpërmendur „ kompleksiteti i zhvillimit të shenjës gjuhësore, sidomos i asaj leksikore, u nënshtrohet ligjeve verbale dhe jo verbale (gjuhësore dhe jo gjuhësore). Kjo sjell, si pasojë, *asimetrinë* e shenjës gjuhësore. Ndikimi parësor është gjuhësor, ai dytësor ka në sfond realitetin jashtëgjuhësor.
Etnopsikolinguistika është një drejtim psikolinguistik, që e studion ligjërimin në aspekt etnokulturor.[215]

Kundërvënia e sistemeve gjuhësore dhe e konteksteve çon në përcaktimin e dallimeve kuptimore dhe përdorimeve kontekstore. Këto dallime janë quajtur *lakuna* në etnopsikolinguistikë

3.2.3 Sqarim i koncepteve. Aparati konceptual

Dukuria e lakunave lidhet ngushtë me veçoritë kulturore, me normat shoqërore dhe të sjelljes, me konvencionet, por mund të ketë dhe karakter gjuhësor. Në kohët e sotme, transferimi i një teksti nga një gjuhë në tjetrën nuk kërkon vetëm njohjen e një gjuhe të caktuar, por edhe të kulturës së popullit përkatës. Para se të fillojmë me rezultatet e hulumtimit të korpusit, do të prezantojmë e sqarojmë shkurt konceptet dhe termat përkatës me të cilët do të operohet. Siç kemi njoftuar në fillim të kapitullit, teoria mbështetëse e analizës është etnopsikolinguistika, që është një rrymë e shkencave konjitive. Për mendimin tonë, kjo mënyrë gjuhësore konjitive trajtimi është këndvështrimi më i përshtatshëm për të zbuluar „botët“ e I. Kadaresë dhe J. Röhmit, të përvijuara e përshkruara në romanin „Prilli i thyer“. Sepse këtu ndërthuren pazgjidhshëm gjuha dhe kultura.

3.2.4 Atelieja e kulturave dhe ligjërimeve të ndryshme në romanin “Prilli i thyer”

Në „Duden“ gjendet ky përcaktim i konceptit „kulturë“: Tërësia e arritjeve shpirtërore, artistike, materiale të një komuniteti, si shprehje e zhvillimit të lartë njerëzor.“[216]
Ndërsa në „Meyers Lexikon“, kulturë do të thotë: „Gjuha, feja, etika, institucionet, e drejta, teknika, arti, muzika, filozofia dhe shkenca. Kulturë është dhe evidentimi i modeleve të arritjeve të ndryshme individuale ose shoqërore.”[217]
Në bazë të mënyrave specifike të jetesës, njeriu konfrontohet me botën përreth dhe përvetëson modelet që do ta udhëheqin në interpretimin e saj. Ndryshimet në mënyrën e interpretimit të botës sjellin krijimin e boshllëqeve në tekstet e përkthyera. Siç pohon Kolleri, “Në gjuhë pasqyrohen dhe njëkohësisht transmetohen interpretimet e ndryshme të realitetit.”[218]
Prandaj mund të thuhet që aspektet gjuhësore dhe kulturore (këtu përfshihen dhe tiparet fonetike e gramatikore) nuk janë vetëm të varura nga kultura, por dhe të kushtëzuara prej saj. Shenjimet gjuhësore dhe kulturore janë shpesh të padiferencueshme.[219]

[215] Shih, Sorokin, Jurij Aleksandrovic, *Lakunen – Theorie. Zur Optimierung interkultureller Kommunikation*, botuar në, Sprache, Kultur Identität, Peter Lang, 1994.
[216] Duden, Universal Wörterbuch, 1996, f. 908.
[217] Meyers Lexikon, 1990, f. 257.
[218] Koller, Werner, *Einführung in die Übersetzungswissenschaft*, München, Wiebelsheim, Quelle & Meyer, 2001, f. 162.
[219] Po aty, f.164.

Kështu kulturë nuk do të thotë art. Kultura përfshin domene të ndryshme. Në kuadrin e kulturës, gjuha zë një vend të rëndësishëm, ajo mban gjithnjë shenjën e kulturës ku gjëllin.
Schröder e përcakton kulturën si një kod, i cili, si sistem konceptesh, vlerash dhe normash, është evident në ndjenjat, mendimet, veprimet dhe në ligjërim.[220] Kultura ka strukturën e vet, që përbëhet nga tufa rregullash dhe vlerash, të cilat formojnë kodin. Ato, që Schröder i quan koncepte dhe norma, realizohen nga individët e një bashkësie gjatë jetës, veprimit e komunikimit.
Në romanin e I. Kadaresë “Prilli i thyer” paraqiten disa përbërës kulturorë në kuadrin e një nënkulture. Po e quaj nënkulturë, në raport me mbarë kulturën shqiptare, e cila karakterizohet gjithashtu nga kodi i saj, nga rregullat dhe normat e përgjithshme, nga vlerat dhe konceptet. Kultura e krijuar nga banorët e zonave, ku vepron kanuni, dallohet ndjeshëm nga ajo e zonave të tjera shqiptare. Në romanin e I. Kadaresë prezantohet kjo kulturë në tërë komponentët dhe kompleksitetin e saj. Në të gjitha linjat ku rrjedh subjekti i romanit, synohet të jepen pjesë dhe aspekte të kësaj kulture. Duke folur për përbërës në paraqitjen letrare të subkulturës së Rrafshit (siç e quan shkurt dhe në mënyrë sinjifikative I. Kadareja zonën e Kanunit), e kam fjalën për figurat ose grupet e figurave që veprojnë në roman dhe që kanë prejardhje të ndryshme sociale gjeografike, për pasojë dhe kulturore. Konkretisht: Besiani dhe Diana janë kryeqytetas, përfaqësues të inteligjencës, vizitorë të rrafshit; mjeku dhe gjeometri janë gjithashtu të huaj në Rrafsh, por gjithsesi të vendosur atje, si ndihmës të Binak Alisë. Si të tillë ata përbëjnë një komponente kulturore më vete me shprehitë, idetë, veshjen, gjuhën etj. Ndërsa Gjorg Berisha është malësori autokton i Rrafshit. Në botën e brendshme dhe në pamjen e tij ai mbart tërë mentalitetin, psikologjinë, traditën, tragjedinë, historinë e shkuar dhe prezente të Rrafshit. Një “botë sui generis” është Binak Alia. Veçantia e tij ka të bëjë me faktin që ai i përket Rrafshit, gjendet atje, brenda dhe jashtë zonës, në tangenten e këtij rrethi zakonor. Kjo shpjegohet me punën e tij si shkoqitës asnjanjës i Kanunit. Të gjitha figurat kryesore të romanit paraqesin minibotë, rrethe kulturore të veçanta që shpalosen e zhvillohen gjatë rrjedhës së ngjarjeve. Njëkohësisht ato kanë të njëjtin funksion dhe mision. Detyra e tyre është të ftillojnë dhe ndriçojnë dukurinë e gjakmarrjes në aspekte të caktuara. Atë që e le pa plotësuar Gjorgu, e prezanton Besiani në bisedat me Dianën. Një këndvështrim më vete janë raportet e grupit të shkoqitësve (siç i quan Kadareja) me dukurinë dhe me “aktorët” e gjakmarrjes. I. Kadareja ka vendosur ta përshkruajë e ta analizojë me të gjitha hollësitë njerëzore e zakonore gjakmarrjen, duke iu përgjigjur përfundimisht pyetjes: “Ç’është gjakmarrja shqiptare sipas Kanunit të L. Dukagjinit?” Për këtë ai zhvillon në atelienë e tij letrare disa instrumente artistike me të cilat e zbulon dhe e rizbulon dukurinë. Në çdo rizbulim shfaqen pamje dhe aspekte të reja. Duke i vënë në shërbim të qëllimit të tij, ai shkon deri në skaj, deri në ezaurim të plotë të mundësisë shprehëse të instrumenteve. Me instrumente kuptojmë figurat (personazhet), përshkrimet, gjetjet, analizat e procedetë e gjithfarshme letrare-artistike. Edhe njëherë shkëlqen në këtë roman gjenia e I. Kadaresë. Gjetjet artistike janë të gjitha brilante e bindëse. Personazhet, peizazhi, moti shfaqen si në një skenë gjigande, ku luhet një tragjedi gjithëpërfshirëse reale. Që të bëhen zëdhënës të mesazhit kadarean, personat janë dhënë në mikrobotën e tyre që projektohet në jetën

[220] Shih, Schröder, Harmut, Lakunen und die latenten Probleme des fremdkulturellen Textverstehens. Anwendungsmöglichkeiten eines Modells der Enthnopsycholinguistik bei der Erforschung tesxtueller Aspekte bei der internationalen Produkterforschung, në, *Sprache und Kultur in der internationalen Marketingkommunikation*, (botuar nga) Bungarten, Theodor, Tostedt, (Antikon), 1994, f. 180- 202, këtu, f. 189.

dhe kulturën e Rrafshit. Ata kanë peshë, vërtetësi e vlerë artistike, sepse janë produkte dhe bartës të rretheve të caktuara kulturore. Besian Vorpsi është shkrimtari i kohës, që ka lexuar shumë për Kanunin. Njohuritë e tij mbi të janë krejt virtuale. Kanuni e tërheq me ekzistencën e tij të pazakontë, me mekanizmin e përsosur, me epikën njerëzore dhe zakonore; e tërheq aq shumë, sa vendos të kalojë atje muajin e mjaltit. Në njëfarë mase, ai është një “alter ego” i Kadaresë. Edhe ai, si I. Kadareja, synon të njohë (me siguri dhe të përshkruajë) të gjitha planet ku shfaqet Kanuni dhe Gjakmarrja si ligj i përgjithshëm, unik i Rrafshit. Edhe emri i Besianit është karakterizues dhe evokues. Një emër i tillë referon në rrethe qytetare të civilizuara tiranase. Duket që I. Kadareja i kushton kujdes emrit të personazheve. Emri i Dianës evokon gjithashtu rrethe qytetare. Ndërsa emri Gjorg është huazuar nga krijimtaria e folklorit shqiptar, nga “Kënga e Gjorg Golemit”. Të gjithë emrat e malësorëve të Rrafshit, janë të tillë që përdoren rëndom në shtresa të caktuara shoqërore. Vënia e emrave personazheve është shpesh një mjet ekspresiv. Le të kujtojmë emrin Mark Ukaçjerra, Zef Kryeqyqja e ndonjë tjetër, që, për shkak të forcës evokuese, janë gjetje speciale. Ndikimi evokues te këta emra nuk ka të bëjë me emrin vetë, por me mënyrën se si janë formuar: uk + çjerr; krye+ qyqe. Gjithsesi emra të tillë, edhe pse lidhen me ngjarje tragjike, përmbajnë doza humori. Binak Alia është një përjashtim i këndshëm, me emrin, me punën dhe me kulturën e tij. Ai nuk i takon as grupit “të të huajve”, as grupit të vendësve. Edhe pse i dhënë pa ndonjë sfond social- gjeografik, ai është figurë e kompletuar me profesionin e tij si shkoqitës i Kanunit, me moralin e tij prej njeriu paqësor, me prirjen kundër gjakderdhjes në një zonë ku derdhet pambarimisht gjak. Ndërsa dy ndihmësit e tij, gjeometri dhe mjeku janë qytetës që fati i ka hedhur në Rrafsh. Edhe ata janë dhe mbeten të huaj në ato anë, kultura e tyre profesionale është goditur përfundimisht nga doket kanunore.

Është tepër interesante qasja, takimi dhe ndeshja e kulturave të ndryshme në mjedisin e Rrafshit. Përpjekja për t’u përshtatur në kulturën kanunore dështon plotësisht në rastin e mjekut dhe gjeometrit. Ata vërtiten të nervozuar dhe të indinjuar nëpër Rrafsh pa gjetur forca të shkëputen. Tradita, mënyrat tradicionale të trajtimit të gjërave, triumfojnë mbi çdo aftësi e profesionalizëm të mjekut e gjeometrit. Logjika e tyre, kultura e tyre profesionale, qytetërimi i tyre bien në truall djerr. Në bisedat e tyre me Besianin e Dianën ata përdorin një gjuhë nervoze, me shprehje indinjate për realitetin kanunor, gjuhë të cilën nuk do ta kuptonin as malësorët, as Binak Alia, që e shikojnë dhe e interpretojnë botën krejt ndryshe.

Krejt ndryshe ndodh me çiftin Diana dhe Besiani, i cili është gjithnjë i etur për informacion të ri, dijet e tij virtuale aktualizohen në kontaktet konkrete me Kanunin dhe bartësit e tij. Por prapa kulisave epike, pas tërheqjes që ushtron kanuni si një kod ligjor krejt i veçantë, ai është në gjendje të shquajë dramën dhe tragjedinë që shkakton zakoni i egër dhe barbar i gjakmarrjes, ashtu siç konceptohet dhe propagandohet në Kanun.

Të gjitha personazhet në roman, si përfaqësues të nënkulturave të ndryshme, shfaqin karakteristika të kësaj nënkulture edhe në ligjërim. Sepse kultura/nënkultura lë gjurmë të thella dhe në gjuhë, se materia gjuhësore është në një lidhje ekzistenciale me realitetin objektiv. Strukturat gjuhësore janë pasqyrime dhe shenjime të strukturave të botës reale. Ekziston, siç e thekson edhe Schröder-i,[221] një korrespondencë midis

[221] Shih, Schröder, Harmut, Lakunen und die latenten Probleme des fremdkulturellen Textverstehens. Anwendungsmöglichkeiten eines Modells der Enthnopsycholinguistik bei der Erforschung tesxtueller Aspekte bei der internationalen Produkterforschung, në, *Sprache und Kultur in*

kategorive gjuhësore dhe tipave ontologjikë të jetës përreth. Strukturimi konceptual i realitetit pasqyrohet dhe jepet në strukturat përkatëse gjuhësore. Perceptimi i një fenomeni paraqitet si modelim gjuhësor i dukurive të realitetit të përditshëm.
Gjuha ka, sigurisht, logjikën dhe metafizikën e saj, por nuk mund të mohohet roli i realitetit objektiv e subjektiv në lindjen dhe formësimin e strukturave gjuhësore.

Mendimin tonë mbi raportin kulturë-gjuhë mund ta ilustrojmë me shumë shembuj e fakte: Janë domethënëse disa rituale kanunore ku gjuha ndjek besnikërisht relievin e mendimit stereotip, ku gjuha nuk riprodhohet në momentin e ligjërimit, por vjen në formula të gatshme, jo vetëm duke pasqyruar stereotipet e kulturës, por duke u bërë njësh me to.

> Vetë i zoti i saj printe me urë e me sëpatë, duke klithur sipas zakonit: *“I marrsha të ligat katundit dhe flamurit.”*[222]
> Ich will das Unheil vom Dorf und vom Banner nehmen.[223]

Këtu komunikimi bëhet me kulturë, jo me gjuhë, komunikimi është i mundur vetëm nëse marrësi i një mesazhi të tillë e zotëron kompetencën e duhur kulturore që ta zbërthejë atë.
Ose:

> …Ndërsa njerëzit po hynin në çdo dhomë të kullës dhe përplasnin këmbët për të treguar se hija e gjakut do të dëbohej nga çdo kënd i shtëpisë, xhaxhai plak i Gjorgut thirri befas: jo.”[224]

Edhe folësi me kompetencën më të shkëlqyer gjuhësore nuk do ta kuptonte mesazhin e mësipërm, po qe se do të mungonin shpjegimet përkatëse për domethënien e një skene të tillë, që ka të bëjë me një zakon kanunor.
Ndërtimet e figurshme, formulimet në formë batutash, që shkëmbejnë malësorët, sidomos në bisedat me Binak Alinë dëshmojnë gjithashtu për një lidhje organike të gjuhës me kulturën:

> “Desha ta di, përse ma derdhën atë miell?”
> Binak Alia i qe përgjigjur aty për aty: “Ç’donte mielli yt në thes të huaj?”[225]

Problemet në ndërtimin e domethënies së shprehjeve, formulave të mësipërme janë akoma më të mëdha, nëse i përqasim ato me me përgjegjëset e tyre në gjermanisht. Lexuesit gjermanofolës të romanit të përkthyer “Prilli i thyer” si bartës të një kulture tjetër, e cila nuk ka asnjë lloj lidhjeje me nënkulturën e paraqitur në roman, posaçërisht, me Kanunin, nuk krijon as përfytyrimin më të vogël nga leximi i gjegjëseve në gjermanisht.[226]

---

der internationalen Marketingkommunikation, (botuar nga) Bungarten, Theodor, Tostedt, (Antikon), 1994, f. 180- 202, këtu, f. 190.
[222] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 35.
[223] Röhm, Joachim, Der zerrissene April, Fischer Verlag, 2003, f. 36
[224] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 40.
[225] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 154.
[226] Më hollësisht, do t´i analizojmë këto formula në sythin “Klasifikimi i lakunave në “Prillin e thyer”.

3.2.5 Ligjërimi si kulturë

Gjuha është jo vetëm mjeti shprehës i vlerave kulturore në përgjithësi, por është dhe vetë një vlerë kulturore. Gjuha, realizimi i saj në ligjërim, ka një komponente kulturore, krahas komponentes biologjike. Të dyja komponentet janë të lidhura si pjesë të një së tëre.

Gjuhëtari i njohur E. Coseriu në librin e tij “Sprachkompetenz” merret posaçërisht me shtresën kulturore të ligjërimit, siç e quan ai:

> “Unser eigentliches Interesse gilt aber der kulturellen Schicht des Sprechens, d.h. dem Sprechen als kultureller Tätigkeit und dem tradierten Wissen, das diese Tätigkeit zugrunde liegt.“[227] (Interesi ynë i veçantë ka të bëjë me shtresën kulturore të ligjërimit, domethënë me ligjërimin si veprimtari kulturore dhe me dijen tradicionale që qëndron në themel të kësaj veprimtarie.)

Siç del nga trajtimet e tij, Coseriu e vështron ligjërimin gjuhësor si veprimtari kulturore. Ai thotë se ligjërimi nuk është vetëm një veprimtari psikofizike, por para së gjithash një veprimtari kulturore, një veprimtari që krijon kulturë. Gjuha prodhon diçka që mësohet dhe që bën traditë. Të dyja shtresat, ajo biologjike dhe ajo kulturore janë pjesë përbërëse të ligjërimit. Sepse, si veprimtari kulturore, ligjërimi duhet të manifestohet materialisht. Përndryshe ai nuk mund të ekzistojë dhe të përvetësohet nga subjektet marrës-dhënës. E thënë ndryshe, Coseriu e vendos ligjërimin ndër vlerat e tjera kulturore. Ai argumenton:

> “Bei allen Kulturgegenständen sind diese zwei Schichten zu unterscheiden, da Kulturgegenstände im Bewusstsein der Menschen existieren und zugleich in der Welt materiell realisiert sind. Im Bewusstsein des einzelnen existieren sie als Intention und Interpretation. Materiell müssen sie sich existieren, weil der Übergang von einem Bewusstsein zu einem anderen nur durch das Materielle möglich ist.“[228](Në çdo objekt kulturor dallohen këto dy shtresa, sepse objektet kulturore ekzistojnë në ndërgjegjen e njerëzve, dhe, njëkohësisht, të realizuara materialisht në realitet. Në ndërgjegjen e individit ato ekzistojnë si qëllime dhe interpretime. Ato duhet të manifestohen materialisht, sepse kalimi nga një ndëgjegje në tjetrën është i mundur vetëm me realizime fizike.)

Në këtë pikëpamje dallohen objektet kulturore nga ato natyrore, të cilat ekzistojnë vetëm në natyrë dhe nga ato matematike, që ekzistojnë vetëm në ndërgjegje.

Coseriu e shpjegon natyrën kulturore të ligjërimit duke e krahasuar atë me pikturën, muzikën, vallen etj.[229]

Në shtresën kulturore të ligjërimit, Coseriu dallon tri rrafshe[230]:

- Ligjërimi ka një aspekt të përgjithshëm, universal. Të gjithë njerëzit normalë, nga një moshë e caktuar, flasin. Edhe heshtja vetë është e lidhur dretpërdrejt me ligjërimin. Sepse „të heshtësh“, do të thotë të pushosh së foluri ose të mos kesh filluar të flasësh.
- Çdo ligjërim është i tillë në kuadrin e një gjuhe të caktuar.

[227] Coseriu, Eugenio, *Sprachkompetenz*, Gunter Narr Verlag, Tübingen, 2007, f. 65.
[228] Coseriu, E., *Sprachkompetenz*, Gunter Narr Verlag, Tübingen, 2007, f. 65.
[229] Coseriu, E., *Sprachkompetenz*, Gunter Narr Verlag, Tübingen, 2007, f. 70.
[230] Shih,Coseriu, E., *Sprachkompetenz*, Gunter Narr Verlag, Tübingen, 2007, f. 71

- Ligjërimi është gjithashtu individual.

Për të shënuar këtë veprimtari individuale, Coseriu propozon termin „Diskurs“. Në gjuhësinë gjermane përdoret për të njëjtin koncept, për të njëjtin rrafsh, termi „tekst“. Coseriu vëren se me termin “tekst” nënkuptohet një produkt dhe jo një veprimtari, siç është ligjërimi. Kjo mospërputhje mes termave të Coseriut dhe gjuhësisë gjermane lidhet me zgjerimin e çerdhes kuptimore të konceptit që shenjon kjo fjalë.[231] Maingueneau-ja vëren: “Shtimi/lulëzimi i termit diskurs duke nisur në vitet 1980 është simptomë e një modifikimi në mënyrën e të kuptuarit të ligjërimit, në veçanti nën ndikimin e rrymave të ndryshme pragmatike. Disa gjuhëtarë flasin edhe për një gjuhësi të diskursit, që e dallojnë prej një gjuhësie të gjuhës. Si i tillë, ai parakuptohet me këto veti: *diskursi parakupton një organizim përtejfrazor; është një formë veprimi përmes gjuhës; është ndërveprues; është i kontekstualizuar; i nënshtrohet rregullimeve në raport me normën; merr vlerë veçse në brendësi të një situate të ndërsjelltë të ligjërimit, në një interdiskurs*.”[232]

Veprimtaria ligjërimore, si çdo veprimtari kulturore, mund të shqyrtohet në tri aspekte:

- Si veprimtari, që përmbledh të folurit dhe të kuptuarit. Kjo veprimtari nuk mjaftohet vetëm me përsëritjen mekanike të njohurive gjuhësore, por është një veprimtari krijuese, që i përdor njohuritë ekzistuese si bazë për risitë, për arritjet e reja gjuhësore.
- Si dije, që mbështet një veprimtari, si kompetencë.
- Si produkt, që arrihet me anë të një veprimtarie.

Në dallimet e sipërpërmendura bëhet fjalë për të njëjtin objekt, të vështruar në tri këndvështrime dhe jo për tri objekte të veçanta.

Coseriu arsyeton më tej, duke thënë se tri rrafsheve të veprimtarisë ligjërimore u përgjigjen tri rrafshe të njohurive/dijeve gjuhësore:

- Njohuritë që kanë të bëjnë me ligjërimin në përgjithësi, me ligjërimin në çdo gjuhë, do ta quajmë „njohuri elokutive“ ose „kompetencë e përgjithshme ligjërimore“.
- Dija, e cila ka të bëjë me ligjërimin në një gjuhë të caktuar, të cilën do ta quajmë „dije idiomatike“ ose „kompetencë e një gjuhe të veçantë“.
- Dija, e cila ka të bëjë me ligjërimin individual dhe me prodhimin e teksteve në situata të caktuara, të cilën do ta quajmë „dije ekspresive“ ose „kompetencë tekstore“.

Produktet e secilit rrafsh dallohen njëri nga tjetri. Produkt i ligjërimit në përgjithësi është tërësia e shprehjeve gjuhësore. Ndërsa produkt i gjuhëve konkrete të veçanta

[231] Shih, Përnaska, Remzi/Plangarica, Tomorr, Mbi disa skaje filozofike-logjike-gjuhësore në fushën e sintaksës së shqipes, teorisë së të thënit/pragmatikë dhe gjuhësisë tekstore, në, Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “*Terminologjia në shkencat e ligjërimit*, Elbasan, 2013, f. 6.

[232] Maingueneau, Poche, Les termes clés de l`analyse de discours, Edition du Seuil, 2009, f. 46-47, cituar sipas Përnaska, Remzi/Plangarica, Tomorr, Mbi disa skaje filozofike-logjike-gjuhësore në fushën e sintaksës së shqipes, teorisë së të thënit/pragmatikë dhe gjuhësisë tekstore, në, Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “*Terminologjia në shkencat e ligjërimit*, Elbasan, 2013, f. 6.

është „gjuha e veçantë abstrakte“, që është dhe objekt i përshkrimit gjuhësor. Produkt i ligjërimit individual është teksti, i cili transmetohet me shkrim ose me shenja të tjera. Teoria e Coseriut jepet e përmbledhur në tabelën e mëposhtme[233]:

	KËNDVËSHTRIMI		
	Veprimtaria	Dijet	Produkti
RRAFSHI			
Rrafshi universal	Ligjërimi në përgjithësi	Dije elokutive	Tërësia e shprehjeve
Rrafshi historik	Gjuha e veçantë konkrete	Dije idiomatike	Gjuhët abstrakte të veçanta
Rrafshi individual	Diskursi/përftesa ligjërimore[234]	Dije ekspresive	Teksti

Një akt ligjërimor vendos lidhje me realitetin jashtëgjuhësor. Kjo lidhje shprehet me anë të kategorive të caktuara në gjuhë të veçanta. Kategoritë e caktuara të gjuhëve të veçanta shenjohen sipas kodeve përkatëse dhe bëhen produkt i ligjërimit individual.

Në çdo akt ligjërimor dallohen tri rrafshe përmbajtjeje: *shenjimi, kuptimi, domethënia*.[235]

Shenjimi (gjer. *Bezeichnung*, angl. *designation*, fr. *denomination*) që i përket rrafshit universal, është aftësia e elementeve gjuhësore për të dhënë/ shënuar diçka nga bota reale, qoftë vetë objektet, qoftë konceptet mbi to.
Kuptimi (gjer. Bedeutung ang.meaning, fr. signification), ka të bëjë me gjuhët e veçanta. Kuptimi është përmbajtja e dhënë gjuhësisht në një gjuhë të caktuar, është konkretizimi gjuhësor-semantik i procesit të shenjimit në gjuhët e ndryshme.
Ndërsa *domethënia (*gjer. *Sinn, ang. sense, fr.sens)* që transmetohet në rrafshin e diskursit, është përmbajtja e menduar, e synuar. Ajo realizohet me anë të shenjimit dhe kuptimit, del jashtë tyre duke rrjedhur në një diskurs individual që i përgjigjet qëndrimeve, qëllimeve, supozimeve të folësit.

Në rastin e analizave tona na intereson veçanërisht kjo shtresë ligjërimore, diskursi, që është shprehje e prirjeve individuale-ekspresive. Me anë të diskursit ligjëruesi shton në fondin kulturor gjuhësor prurjet e tij. Në këtë mënyrë, ai është bartës dhe krijues i kulturës ligjërimore. I trajtuar në kuadrin e rrafshit ligjërimor individual I. Kadare ka një status të veçantë, statusin e përdoruesit origjinal të rrafshit historik (gjuhës shqipe) dhe atë të krijuesit të risive të shumta si në planin e zgjedhjes, ashtu dhe në atë të kombinimit të njësive gjuhësore. Diskursi i tij letrar gjeneron përherë shprehësi. Ndër procedetë, që kanë prodhuar vlera kulturore ligjërimore, në prozën e tij, sidomos në romanin „Prilli i thyer“ do të rendisnim:

[233] Shih, Coseriu, E., *Sprachkompetenz*, Gunter Narr Verlag, Tübingen, 2007, f. 75.
[234] Termin *përftesa ligjërimore* e kemi përodur duke u mbështetur në propozimin e bërë nga dy gjuhëtarët Përnaska/Plangarica në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Terminologjia në shkencat e ligjërimit, Elbasan, 2013, f. 7.
[235] Shih, Coseriu, E., Sprachkompetenz, Gunter Narr Verlag, Tübingen, 2007, f. 79.

- Zgjedhja e mjetit të duhur për të realizuar harmoninë e nevojshme midis objektit real, konceptit dhe gjuhës, p.sh., përdorimi i leksemave specifike që kodifikojnë koncepte nga Kanuni, që lidhen me dukurinë e gjakmarrjes.
- Përdorimi i njësive gjuhësore me ngjyrime të forta emocionale, p.sh., shprehjeve dhe formulave nga Kanuni.
- Kombinimi, shpesh origjinal, i elementeve gjuhësore, i formave dhe strukturave gege.
- Pasurimi i rrafshit diastratik me sociolekte, idiolekte, profesionalizma
- Neologjia dhe neologjizmat origjinale në përshkrimin, sidomos, të personazheve.
- Alternimi i regjistrave ligjërimore në varësi të nënkulturës që paraqesin personazhet në roman.

Me diskursin e tij I. Kadareja është një krijues i pashoq vlerash kulturore ligjërimore. Në thesarin e kulturës sonë gjuhësore ai ka prurje brilante, që jo vetëm e pasurojnë fondin kulturor, por shërbejnë dhe si modele për folësit dhe shkruesit e gjuhës shqipe. Diskursi i Kadaresë, analiza dhe përshkrimi i tij, janë një teori e tërë mbi njohjen, përdorimin dhe krijimin e gjuhës.

Për të sjellë këtë larmi diskursi të Kadaresë në një gjuhë të huaj, siç është gjermanishtja, një rol të madh luan zotërimi i kodit kulturor. Njohja e strategjive dhe teorive të ndryshme për përkthimin e diskurseve do të mundësonte edhe njohjen e problemeve që lindin gjatë procesit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse autori dhe përkthyesi i një teksti u përkasin kulturave të ndryshme. Në raste të tilla, përkthyesi duhet të jetë i ndërgjegjshëm se problemet që lindin gjatë përkthimit, nuk janë vetëm gjuhësore, por edhe kulturore. Prandaj zotërimi i kodit kulturor është një kusht i domosdoshëm për një përkthim të suksesshëm. Kjo mënyrë shqyrtimi hedh dritë mbi përkthimin si proces dhe si koncept.

3.2.6 **“**Prilli i thyer nga qasje te ndryshme të teorisë së traduktologjisë

Si disiplinë më vete transatologjia lindi në shekullin e 20-të. Shumë gjuhëtarë dhe linguistë janë marrë me problemet e përkthimit. Në historinë e re të shkencës mbi translatologjinë janë përpunuar shumë teori. Mund të përmendim drejtimin e hershëm gjuhësor-krahasues që kishte si objekt bazë konceptin “ekuivalencë”. Më vonë u zhvilluan drejtime komunikative, funksionale, përshkruese. Drejtimet më të fundit teorike në këtë fushë janë të shenjuara nga globalizimi gjithnjë në rritje. Është fjala këtu për zhvillime teorike, si: sociotranslacioni, translacioni kulturor, translacioni estetik.
Mendimi më i përgjithshëm sot është ai që e sheh translacionin si një akt, si një veprim, si pjesë të një situate komplekse komunikimi, ku marrin pjesë veprues të ndryshëm, në role të ndryshme.
Figura qendrore e procesit është translatori, si ekspert për prodhimin e mesazheve ndërkulturore.

3.2.6.1 **“**Prilli i thyer” nën dritën e teorisë “skopos”

Modeli i translacionit të vështruar si një akt, si një veprim ka si koncept bazë teorinë “skopos”. Termi “skopos” rrjedh nga greqishtja dhe do të thotë “qëllim”. Çdo translacion fillon nga një tekst fillestar, i cili është prodhuar me një qëllim (skopos) të

caktuar. Edhe teksti që rrjedh nga translatimi i origjinalit i nënshtrohet një qëllimi (skopos). Në të dyja rastet qëllimi luan një rol të rëndësishëm. Katharina Reißi dhe Hans Vermeeri theksojnë madje se “ Die Dominante aller Transalatation ist der Zweck” (Gjithë translatacioni mbizotërohet nga qëllimi.).[236]

Teoria e „skopos-it“ është një zhvillim, një gjetje e Hans Vermmerit dhe Katharina Reiß, që ka përmasat e një teorie të përgjithshme në fushën e translacionit. Kjo teori vendos në qendër të studimit natyrën e qëllimshme të përkthimit si akt, si veprim. Kështu, ruajtja e vlerave ideo-estetike, qëllimi i autorit të tekstit fillestar, nuk janë më prioritare. Por mund të jenë të tilla, vetëm nëse janë pjesë të skopos-it. Arritja e qëllimit të translacionit merr rëndësi më të madhe nga vetë procesi i përkthimit. Thënia: „Qëllimi e justifikon mjetin“ këtu gjen fushë veprimi, por me kufizime, sepse qëllimet duhet të jenë (gjithsesi) të logjikshme e të argumentuara.“[237]

Qëllimi (skopos-i) i translatit (përkthimit) ndodh të devijojë nga ai i tekstit fillestar. Teksti fillestar ofron një përmbajtje, një informacion, i cili nga translatori dhe më pas nga marrësi rroket dhe interpretohet në mënyra të ndryshme. Translatori përgatit variantin e tij, i cili gjithashtu është një ofertë informative për marrësit e mesazhit. Skoposi (qëllimi) varet gjerësisht nga situata e lindjes së tekstit dhe situata mund të analizohet vetëm në kuadrin e kulturës. Në kultura të ndryshme, situatat funksionojnë ndryshe, kështu dhe skopusi i tekstit fillestar dhe atij të synuar mund të ndryshojnë, nganjëherë ndjeshëm. Teoria e “skoposit” pranon mundësinë e përkthimeve të ndryshme, duke i dhënë përkthyesit një fushë të gjerë lirie manovrimi. Vermeeri e sheh përkthyesin si një ekspert të komunikimit ndërkulturor, që i njeh veçoritë gjuhësore-kulturore të gjuhëve me të cilat operon. Ai vendos vetë se ç’qëllim do të ndjekë në punën e tij, që teksti i prodhuar nga ai të jetë funksional.[238]

Në kritikat që i janë bërë teorisë së „skoposit“ zakonisht atakohet mbivlerësimi që i bën kjo teori qëllimit dhe rolit dominant të kulturës në procesin e përkthimit. Kritikohet gjithashtu liria e madhe e përkthyesit si „dominuesi“ i procesit të përkthimit. Por Vermeeri, duke pranuar një lloj subjektiviteti të përkthyesit, thekson se përkthyesi duhet të punojë me përgjegjësi për të mos e shpërdoruar lirinë dhe subjektivitetin.[239]

Le të hedhim tani një vështrim në korpusin tonë, në tekstin e romanit “Prilli i thyer”, në origjinal dhe në përkthimin gjermanisht. Ta përshkruajmë dhe ta analizojmë atë sipas koncepteve e logjikës së teorisë së “skoposit”. Mendojmë që këtu kjo teori mund të konkretizohet më së miri. Teksti i I. Kadaresë, sigurisht, përmbush një funksion të caktuar, i nënshtrohet një skopusi të caktuar. Te I. Kadareja, në tekstin fillestar shqip, gjuha dhe kultura gërshetohen e mpleksen në mënyrë të tillë, sa nuk mund të flasësh për mbizotërim të njërës ose të tjetrës. Stili dhe informacioni kulturor përbëjnë njësoj vlera letrare artistike të veprës.

[236]Shih, Reiß, Katharina/ Veermer,Hans, *Grundlegung einer allgemeinen Translationstheorie*, Tübingen, Niemeyer, 1991, f. 96.
[237] Shih, po aty.
[238] Shih: Reiß, Katharina, Veermer,Hans, *Grundlegung einer allgemeinen Translationstheorie*, Tübingen, Niemeyer, 1991, f. 101.
[239] Në: Rüth, L.: Die Skopostheorie nach Reiß/Vermeer: Ein Überblick, http://www.academia.edu/405115

Paraqitja e një cope kulturë të së shkuarës shqiptare është qëllim i rrëfimit të I. Kadaresë. Këtu përfshihet dhe gjuha e rrëfimit. Përpiluesi i tekstit origjinal ka përdorur strategji dhe taktika të ndryshme për të realizuar synimin e tij. Këtu do të përmendnim personazhet, përshkrimet narrativo-psikologjike, gjetjet e sukseshme që sigurojnë organizimin, kompozicionin dhe koherencën e tekstit. Paraqitje të tilla dukurish kulturore historike janë të shoqëruara me vështirësi shkallësh e llojesh të ndryshme. Ato duhet të prezantohen bindshëm, përndryshe e humbasin peshën dhe forcën ndikuese. Distanca hermeneutike midis marrësit dhe informacionit të prezantuar e vështirëson receptimin, për më tepër, kur marrësi është një subjekt i një vendi dhe kulture të huaj.
Kadareja rrëfen në disa mënyra:

- Personazhet zbulohen vetë, zbulojnë botën e tyre dhe botën përreth me anë të veprimit, me anë të përjetimeve, me anë të ligjëratave të tyre.
- Autori shprehet edhe vetë mbi personazhet e tij.
- Një mënyrë tjetër është zbulimi reciprok i personazheve
- Paraqitjes autentike i shërbejnë dhe përshkrimi i disa ritualeve karakteristike për zakonin e gjakmarrjes.
- Një element i rëndësishëm i rrëfimit është dhe gjuha në përgjithësi e ngjyrosur me tone lokale-historike si dhe njësitë gjuhësore me vlerë të theksuar frazeologjike, emocionale, dialektore etj.

Si dhe në veprat e tjera në prozë të I. Kadaresë, edhe këtu përdoren linjat rrëfyese paralele, asociative. Krahas rrëfimit në një plan, rrjedh një tregim tjetër në një plan të shtuar për përforcim të planit fillestar.
Meqë tematika, gjakmarrja, është një dukuri tejet tragjike, gjuha e I. Kadaresë synon të jetë gjithashtu tejet afektive. Kjo arrihet me arsenalin e pafund të procedeve e përftesave stilistike që rezultojnë prej tyre. Dihet që I. Kadareja në këtë fushë është mjeshtër.
Të gjitha këto synime/realizime të marra së bashku përbëjnë skoposin e tekstit origjinal të romanit “Prilli i thyer”. Vlen të theksohet që I. Kadareja gjen sfondin, zotëron kompetencën e nevojshme kulturore-historike, është mjeshtër “par exellence” i rrëfimit gjuhësor letrar për të realizuar skoposin e vet. Duke qenë se gjakmarrja është një zakon shqiptar, ai e ka më të lehtë se përkthyesi gjerman përshkrimin autentik të saj. Në gjuhën dhe në kulturën shqiptare ai mbledh termat, frazeologjitë, traditat dhe bëmat që i duhen për të ndërtuar dhe formuluar tekstin e tij. Le të përmendim këtu disa leksema të veçuara, disa grupe fjalësh, disa shprehje dhe formula karakteristike për temën e gjakmarrjes shqiptare:

Leksema: kanun, kullë, gjak, besë, gjëmëtar, kësollëtar, pleqnar, gjëmë, gjakës, gjakmarrje, gjakhupës, dorëras, muranë, zhgul, pleqësim, gjakës, shkoqitje, i ngujuar, hupës, kësoll, etj.

Etnografizma: xhokë, tirqe, opingë, xhamadan, duvak, shajak, vorbë, xhubletë, flokëse, etj.

Togfjalësha: gjoba e plagosjes, kasnecët e vdekjes, shpërndaj mortin, laj gjakun, besë 24-orëshe, jap besën, marr hak, çel besën, besë e vogël, gris fytyrën, shkul flokët, shkelës i kanunit, gjaku i fundit, kullë e ngujimit, prerja e mikut në besë etj.

Shprehje gjuhësore: më ka zënë gjaku, gjaku i tij bie mbi ty, u ngrysën në gjak, buka e gjakut të pajtuar, gjysma e gjakut ishte larë, ta derdh atë grusht gjak, fajtori grihet katundisht, sa ditë ke në gjak, etj.

Formula kanunore: dy gisht nder në lule të ballit na i ka qitë i madhi zot; pushkë të bukur paska qitë; mos e thani lisin; udha duhet të jetë e gjerë sa shtiza e flamurit; shtëpia e malësorit është e zotit dhe e mikut; i marrsha të ligat katundit dhe flamurit, etj.

Me leksikun dhe gjuhën kanunore (të zakonit të gjakmarrjes) do të merremi më gjerësisht në kapitullin mbi lakunat.

Siç mund të shihet nga shembujt e rreshtuar në listat e mësipërme, përkthyesi i romanit të I. Kadaresë, J. Röhmi, e ka pasur shumë të vështirë të ndërtojë një tekst në përputhje të plotë me origjinalin.

Përgjegjëset gjermane ose e japin me afërsi kuptimin dhe vlerën e elementit gjuhësor në shqip, ose nuk e shprehin fare denotatin dhe atmosferën konotative të përgjegjëses shqipe. Edhe kur janë përkthime fjalë për fjalë, ato nuk e kanë domethënien kulturore të shprehjeve të I. Kadaresë. Shprehja “dy gisht nder në lule të ballit na i ka qitë i madhi zot”[240] është përkthyer fjalë për fjale: “Zwei Finger breit Ehre auf der Blume der Stirn gab uns der Schöpfer”[241]. Asnjë gjerman nuk do ta kuptonte këtë fjali të marrë jashtë kontekstit. Edhe brenda kontekstit, ajo nuk e ka kuptimin që ka thënia paralele shqipe për shqipfolësit. Në gjuhën gjermane nuk ekziston madje grupi “Blume der Stirn” (lule e ballit). Edhe formula tjetër : “I marrsha të ligat katundit dhe flamurit”[242] është përkthyer fjalë për fjalë: “Ich will das Unheil vom Dorf und vom Banner nehmen!”[243]. Ky lloj përkthimi i largohet shumë kuptimit të origjinalit. Edhe në këtë rast, lexuesi gjerman mbetet i pasqaruar, madje i pataksur. Dy formulat që citova në gjermanisht, i diskutova me lexues gjermanë, njëherë i citova jashtë kontekstit, pastaj brenda kontekstit. Shpjegimet e lexuesve gjermanë, ajo që ata mundën te merrnin nga shprehje të tilla, ishte ose një kaos kuptimor, ose një kuptim i largët nga ai i tekstit fillestar.
Më poshtë do të merremi më gjerësisht me përkthimin dhe me hollësi të përkthimit të tekstit në shqyrtim.
Meqë po diskutojmë për teorinë e skoposit vlen të thuhet se në procesin e përkthimit duhen ruajtur tërësia e funksioneve të tekstit fillestar. Por funksionet nuk janë statike.[244] Funksionet e tekstit të I. Kadaresë rroken ndryshe, zbulohen ndryshe nga lexues të ndryshëm. Çdo lexues e zbulon tekstin sipas mënyrës së vet. Edhe përkthyesi është një lexues në fazën fillestare të përkthimit. Më vonë ai vendos se cilat funksione do të mbeten dhe cilat jo. Në rastin e përkthimit të J. Röhmit, si në shumicën e përkthimeve të teksteve të shkruara letrare, skoposi i përkthimit nuk devijon shumë nga ai i tekstit fillestar. Përkthyesi synon të ruajë linjën e subjektit, t’u qëndrojë besnik përshkrimeve psikologjike dhe atyre të natyrës, përkthimi shpaloset duke ndjekur relievin mendor-ndjesor-emocional të origjinalit. Veç mund të flitet për një lloj devijimi minimal: ndërsa I. Kadareja ofron me tekstin e vet informacion

[240] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë 1981, f. 38
[241] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, Frankfurt am Main, 2003, f. 50.
[242] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë 1981, f. 35.
[243] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, Frankfurt am Main, 2003, f. 45.
[244] Shih, Vermeer, Hans J., *Aufsätze zur Translationstheorie*, Heidelberg, 1983, f. 79.

sociokulturor, gjuhësor, historik; rrezaton art, stil (me anë të përftesave të pafundme), J. Röhmi e vë theksin në ofertën informative sociokulturore. Përftesat fine të Kadaresë "zhurmohen" shpesh në përgjegjësen gjermane. Këtë mund ta ilustrojmë me shumë shembuj. Ja një rast:

> Së shpejti do të hynte prilli. Me gjysmën e tij të bardhë dhe me gjysmën tjetër të zezë. *Prillmort.* [245]
> Bald würde der April kommen. Mit seiner hellen und mit seiner dunklen Hälfte. *Todesapril.*[246]

Të dyja njësitë *prillmort – Todesapril* janë kompozita, fjalëformime me kompozim. Por marrëdhëniet midis elementeve të kompozuara janë të ndryshme. Te *prillmort*, elementet përbërëse janë të bashkërenditura, te *Todesapril* (prilli i vdekjes) elementi i parë përcakton kuptimisht të dytin, marrëdhënia është nënrenditëse. Mënyra e ndryshme e kombinimit të elementeve të njëjta kushtëzon dhe dallimet kuptimore e stilistike midis tyre. *Todesapril* (prilli i vdekjes) është një formim i zakonshëm, sipas modelesh të zakonshme kompozimi, me kuptimin e zakonshëm kategorial të lidhjeve të tilla. Përgjegjësja shqipe mbart ngjyrimet që i jep fakti i të qenit neologjizëm. Formimi shqip nuk ndjek ndonjë model të njohur a të përhapur.
Edhe ngjyrimet e ngjyresat që i japin tekstit kadarejan fjalët dhe shprehjet dialektore-lokale, fjalë që shfaqen aty-këtu, mu në mes të një pasazhi të dhënë me gjuhë letrare standarde, i mungojnë tekstit të përkthyer:

> …dhe pastaj shtegtimi qytet më qytet, me atë britmën e zvargur e të pikëllueshme *„dru me pre"*![247]
> …zogen sie von Stadt zur Stadt, den wehmütig gedehnten Ruf auf den Lippen: *„Holz zu schlagen!"*[248]

Midis „dru me pre" dhe „Holz zu schlagen" ka një dallim të madh. Dallojnë jo vetëm për shkak të koloritit dialektor që përmban elementi shqip, por edhe në pikëpamje sociokulturore. Përgjegjësja gjermane nuk të kujton kurrsesi druvarë që enden me sëpatë në qafë e kërkojnë të fitojnë ndonjë lek duke çarë drutë e të tjerëve. Profesion të tillë nuk ka në Gjermani. Në një diskutim me të rinj gjermanë, i pyeta se ç'kuptonin ata me një thënie të tillë. Në përgjigjet e tyre ishte i pamungueshëm pylli, prerje drush në pyll.
Neologjizmat, që spikasin shpesh në tekstin e I. Kadaresë, dhe që përbëjnë një tregues të rëndësishëm të stilit të tij, zakonisht nuk jepen me neologjizma në tekstin gjerman:

> Në netët e tij, copëra gjumi përpiqeshin t'i mbushnin ato *kaotikisht* …[249]
> In seinen Nächten, Schlaffetzen versuchten sie *chaotisch* zu füllen..[250]

Fjala *kaotikisht* nuk gjendet në fjalësin e Fjalorit të Gjuhës Shqipe.[251] Mund të flitet për një neologjizëm, për një stilemë që bie në sy për mënyrën e formimit jo sipas gjedhesh ekzistuese (formimi mbiemër + isht nuk është ekzistent në gjuhën tonë.

[245] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë 1981, f. 130
[246] Röhm, J., *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, Frankfurt am Main, 2003, f. 174.
[247] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë 1981, f. 130
[248] Röhm, J., *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, Frankfurt am Main, 2003, f. 174.
[249] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë 1981, f. 133.
[250] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, Frankfurt am Main, 2003, f. 179.
[251] Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1984, f. 490.

Prapashtesa -isht u shtohet zakonisht emrave abstraktë të cilësisë: trimëri + isht = trimërisht etj.).
Ndërsa përgjegjësja gjermane *chaotisch* është një fjalë e gjuhës së përditshme, që gjendet në çdo fjalor.[252]

Shembuj të tillë, ku elemente të stilit kadarean, nuk rishfaqen në tekstin e përkthyer, ka shumë. Një shenjë tjetër dalluese e stilit të I. Kadaresë është përdorimi i emrave abstraktë në vend të foljeve ose mbiemrave përgjegjës. J. Röhmi e jep në shumë raste këtë veçori, por jo gjithnjë:

> … *shkëputja* e mendjes së tij nga gjërat reale sa vente shtohej…[253]
> … sein Verstand von den realen Dingen *löste* immer mehr… [254]

Përgjegjësja gjermanisht do të thotë: *Mendja e tij shkëputej gjithnjë e më shumë nga gjërat reale.* Në rrafshin kuptimor logjik kemi ekuivalencë, në rrafshin stilistik, jo. Gjendja e shprehur me variantet *shkëpus- shkëputje* jepet më e theksuar me emrin prejfoljor *shkëputje.*

Pra, dy tekstet e krahasuara, romani „Prilli i thyer“ i I. Kadaresë dhe përkthimi i tij nga J. Röhmi „Der zerrissene April“ në pikëpamje të qëllimit kanë shumë funksione të përbashkëta. Edhe I. Kadareja, edhe J. Röhmi synojnë të prezantojnë një copë kulture (subkulturë) shqiptare, gjakmarrjen, sipas kanunit të Lekë Dukagjinit. Si lexuesi shqiptar, edhe lexuesi gjerman ndjek i befasuar informacionin e ofruar. I. Kadareja zotëron dhe ka grumbulluar materialin e duhur kulturor për shpalosjen e temës. Rrëfimi rrjedh me një gjuhë të pasur dhe ekspresive, që i shkon për shtat përmbajtjes, e cila përmes gjetjeve mjeshtërore arrin të ndikojë fuqimisht. Transmetimi i informacionit kanunor, i tragjedisë së gjakmarrjes në breza është qëllimi i përbashkët i të dyve, Kadaresë dhe Röhm-it.
Synimet stilistikore të Kadaresë janë gjithashtu pjesë e skoposit të tekstit fillestar. Përkthyesi synon në skoposin e tij të ruajë specifikën kulturore të tekstit fillestar, të zbulojë lakunat (diferencat kulturore-gjuhësore) midis teksteve, t’i zbërthejë, t’i rrafshojë ato e t’i bëjë të kuptueshme për marrësit. J. Röhmi, krahas metodave të tjera për rrafshimin e lakunave, përdor dhe një glosar, ku shpjegohen veçanërisht dhe konkretisht koncepte, fjalë dhe shprehje të tekstit origjinal të I. Kadaresë.

3.2.7 Përkthimi

W. Kolleri është i mendimit që përkthimi rezulton nga një operacion që zotëron veçori gjuhësore dhe tekstore. Në përkthim kalohet nga një gjuhë dhënëse në një gjuhë marrëse, duke vendosur lidhje ekuivalence. Përkthimi duhet të mbajë parasysh shumë faktorë. Këta faktorë kanë të bëjnë si me raportet gjuhësore-stilistike, ashtu dhe me raportet jashtëgjuhësore. Në përkthim luajnë një rol të rëndësishëm edhe kushte të gjithëfarshme, si dallime e ndryshime të vendeve, ku fliten gjuhët, normat stilistike dhe estetike, strukturat gjuhësore, etj. Në procesin e përkthimit, njohuritë kulturore janë të domosdoshme.
Siç kemi theksuar më lart, përkthyesi nuk merret vetëm me gjuhën, por dhe me kulturën e vendit përkatës. Prandaj sot shumë teoricienë të përkthimit kanë hequr dorë

[252] Shih, Langenscheidts Großwörterbuch, Berlin, München, 1998, f. 198.
[253] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë 1981, f. 134
[254] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, Frankfurt am Main, 2003, f. 180

nga termi “ndërmejtësues gjuhësor” duke e zëvendësuar atë me “translator”. Ky i fundit ka një kuptim më të gjerë, përfshin jo vetëm ndërmjetësimin gjuhësor, por edhe atë kulturor.[255]

Si mbikoncept termi translacion përmbledh edhe përkthimin me shkrim, dhe atë me gojë. Duke folur për translacion/translatim nënkuptohet edhe një lloj krijimtarie që duhet ta shoqëroje përkthimin. Emërtimi „ndërmjetësim gjuhësor“ nuk e përmban këtë komponente semantike.

Kështu, përkthimi (në kuptimin që ka fjala gjermane „übersetzen“, shënimi im, G. S.) është translatim i një teksti të shkruar nga një gjuhë në një gjuhë të huaj. Në këtë proces synohet një ekuivalencë. Siç theksojnë Reißi dhe Vermeeri procesi përmban transmetim gjuhësor, kulturor dhe krijueshmëri.[256]
I. Panasiuku e vë theksin gjithashtu në komponentin krijueshmëri në procesin e përkthimit. [257]
Teoricieni K. Dedecius e vështron përkthimin në pikëpamje shkencore-letrare. Ai thotë se përkthyesit shërbejnë si ura lidhëse midis njerëzve dhe kulturave. Duke lidhur brigje të ndryshme, ata mundësojnë komunikimin interkulturor, mundësojnë rrafshimin e honeve ndarëse.[258] Në këtë rast, përkthimi shihet më tepër si një lloj komunikimi.

3.2.7.1 Procesi i përkthimit

Për të kuptuar më mirë dukurinë aq të ndërlikuar të përkthimit, po përpiqemi të përvijojmë procesin që gjeneron përkthime. Reißi dallon shtatë procedura në një praktikë përkthimi:

- Përkthyesi vendos mbi detyrat që do të përmbushë teksti në gjuhën e huaj.
- Procesi i përkthimit rrjedh në dy faza: të kuptuarit me anë të analizës tekstore dhe pastaj riverbalizimi (shprehja gjuhësore).
- Dhënësi e përpilon tekstin dhe e ofron për komunikim.
- Komunikimi rrjedh gjatë receptimit të tekstit.
- Teksti mbushet, shenjohet nga stili tipik i autorit.
- Marrësi i tekstit e rrok përmbajtjen sipas koncepteve që zhvillon.
- Transferimi i përkthyesit në dhënës/ transmetues të ri. Ai ofron tani një tekst për lexuesit në gjuhën e huaj.[259]

Ndërsa I. Markovina e sheh rrjedhën e procesit të përkthimit si më poshtë:

> Hapi i parë është bartja e origjinalit në një gjuhë të huaj, si dhe në një kulturë të huaj. Në këtë proces duhet të paraqitet me besnikëri vetëdija e huaj. Gjatë

[255] Shih, Reiß, Katharina, Veermer,Hans, J., *Grundlegung einer allgemeinen Translationstheorie*, Tübingen, Niemeyer, 1991, f. 7.
[256] Shih më tej, Reiß, Katharina, Veermer,Hans,J., *Grundlegung einer allgemeinen Translationstheorie*, Tübingen, Niemeyer, 1991, f. 15.
[257] Shih, Panasiuk, Igor, *Kulturelle Aspekte der Übersetzung*, Münster, LIT Verlag, 2005, f. 258.
[258] Shih, Dedecius, Karl, *Die Kunst der Übersetzung*, Berlin, Logos, 2002, f. 10.
[259] Shih më tej, Reiß, Katharina, *Grundfragen der Übersetzungswissenschaft*, Wien, Universitätsverlag, 1995, f. 37.

> punës së tij, përkthyesi ka të bëjë me lakunat, të cilat duhet të eleminohen plotësisht ose pjesërisht.
> Në një hap të dytë, lexuesi lexon tekstin e përkthyer dhe interpreton përmbajtjen kulturore, që përmban ai, duke e krahasuar atë me kulturën/ njohuritë e veta.[260]

Sipas Veermerit përkthimi është një transferim interkulturor, që sharton elemente të një kulture në një kulturë tjetër.[261]

3.2.7.2 Përkthimi si komunikim ndërkulturor

Të kuptuarit midis kulturave të ndryshme është i mundshëm, edhe pse nuk ka një kod të përbashkët që të vepronte në të gjitha situatat.[262] Por shkalla e të kuptuarit është e ndryshme. Në një rast ideal, midis kulturash kemi përputhje të plotë dhe kjo ndodh kur interpretimi, segmentimi i realitetit nga bartësit e këtyre kulturave është identik. Ka tekste të përkthyeshme, edhe pse rrjedhin nga kultura të ndryshme. Këta mbulojnë (në përmbajtje) reciprokisht njëri-tjetrin. Por ka dhe raste kur përkthimi, transferimi nga një kulturë në tjetrën është problematik. Sa më e madhe të jetë diferenca midis kulturave, aq më e vogël është mundësia përkthyese e teksteve që manifestojnë kultura të tilla.[263]

Veç, nëse komunikimi do të jetë i mundshëm deri në një farë shkalle, lindin situata konfliktuale, sepse njerëzit kanë përvoja të ndryshme në fushën sociale dhe individuale. Komunikimi është një dialog midis vetëdijesh të ndryshme, vetëdije që janë të shenjuara nga ana konjitive dhe emocionale.

Sipas O. Kade-sit përkthimi është një lloj komunikimi njerëzor. Ajo që është specifike në këtë komunikim, është fakti që fazat marrëse/receptive dhe riprodhuese rrjedhin paralelisht në dy gjuhë. Një dukuri e tillë quhet ndërrim kodesh. Ky ndërrim kodesh nga gjuha fillestare në atë të synuar është çasti më i rëndësishëm i përkthimit. O. Kade vëren më tej që në këtë çast nuk kemi të bëjmë plotësisht me ndërrim kodi, por me kodifikim të ri.[264]

Gjatë komunikimit mund të ndodhin gabime, si në kodim, ashtu dhe në rikodim, çka shkakton keqkuptime ose moskuptim. Detyra e përkthyesit është që mesazhin ta formulojë në mënyrë të tillë, që të jetë i komunikueshëm. Në këtë proces kemi dekodim të tekstit në gjuhë të huaj, pastaj këmbimin e kodit dhe, në fund, realizohet teksti i përkthyer.[265]
Komunikimi rrjedh zakonisht në dy rrafshe, në një rrafsh implicit (diçka e menduar) dhe në një eksplicit (diçka e thënë). Që komunikimi të jetë i suksesshëm, duhet një kod i përbashkët, ose kodi i gjuhës së huaj duhet të jetë i njohur. Kjo gjë mund të jetë

[260] Shih, Markovina, Irina, *Interkulturelle Kommunikation*, Frankfurt/Main, 1993, f. 171-178.
[261] Shih, Vermeer, Hans, J., *Übersetzen als kultureller Transfer*, Tübingen, Uni-Taschenbücher, 1994, f. 34.
[262] Shih, Markovina, Irina, *Interkulturelle Kommunikation*, Frankfurt/Main, 1993, f. 171-178.
[263] Shih dhe, Koller, Werner, *Einführung in die Übersetzungswissenschaft*, Wiebelsheim, Quelle & Meyer, 2001, f. 164.
[264] Shih, Kade, Otto, *Kommunikationswissenschaftliche Probleme der Translation*, Wills, Wolfram(Hrsg), Darmdtadt, 1998, f. 199- 218.
[265] Shih, po aty, f. 202.

problematike, sepse kodet janë gjithnjë të lidhura e të varura nga kultura e bartësve të gjuhës. Përkthyesi merr përsipër të përçojë te marrësi edhe informacionin implicit me ndikimin përkatës. Dhe kjo është një detyrë tejet e vështirë.[266]

K. Dedeciusi e krahason rolin dhe rëndësinë e përkthyesit me shkëmbimin e lëndëve ose me qarkullimin e gjakut në organizmin e njeriut. Nëse këto dy procese nuk janë në rregull, atëhere njeriu sëmuret ose vdes.

> *Ohne Brücken keine Verständigung und ohne Verstätigung keine Einigung… Wer von Verstätigung spricht, muss wissen, dass es Verständnis voraussetzt und dass das Verständnis die vornehmste Funktion des Verstandes ist.* (Pa ura lidhëse, nuk ka marrëveshje dhe pa marrëveshje nuk ka mirëkuptim. Kush flet për marrëveshje, duhet të dijë që ajo kushtëzohet nga mirëkuptimi dhe mirëkuptimi është funksioni më fisnik i logjikës.)[267]

K. Dedeciusi thekson, gjithashtu, se me anë të teksteve të përkthyera njerëzit i kuptojnë më mirë kulturat e ndryshme dhe në situata konfliktuale reagojnë arsyeshëm. Është fjala jo vetëm për tekste letrare, por dhe për përkthime mesazhesh në fusha të ndryshme, që i shërbejnë bashkëpunimit midis popujve. Komunikimi nëpërmjet përkthimit është diçka paqesjellëse.
Të njëjtën pikëpamje mbron dhe H. Risku. Sipas saj, tekstet e përkthyera realizojnë një komunikim të suksesshëm, duke kapërcyer barrierat kulturore.

> Përkthimi, - thotë ajo,- interesohet për zgjidhjen e problemeve interkulturore. Përkthyesi vendos vetë në ç’mënyrë mund të arrihet zgjidhja.[268]

Përkthimet e mira përbëjnë një bazë të qëndrueshme për mirëkuptimin midis popujve dhe mundësojnë shkëmbimin kulturor.

3.2.8 Elemente kulturore në romanin “Prilli i thyer” dhe invariancat dhe ekuivalencat gjegjëse në gjermanisht

Problemi i përkthimit qëndron në kapërcimin e pengesave semantike (në pikëpamje semiotike, kulturore) midis gjuhëve. Por siç thotë Jakobsoni: „çdo përvojë konjitive, çdo segmentim semantik, gjuhësor i botës, çdo organizim gjuhësor sipas një kodi të caktuar mund të mbartet në secilën gjuhë ekzistuese.“[269]

Gjatë mbartjes, gjatë përkthimit, vetëm në raste të rralla arrihet ekuivalenca e plotë (kjo gjë është vërtetuar dhe në shumë analiza empirike). Ky problem i ekuivalencës së paplotë shpjegohet me karakterin e saj të përafërt. Për ta kuptuar më mirë karakterin e përafërt të ekuivalencës, le ta krahasojmë atë me parametrat e tjera të procesit përkthyes, invariancën dhe gjetjen e përshtatshme.
Ekuivalenca vështrohet si një lloj i veçantë i gjetjes të përafërt.

---

[266] Shih, Kade, Otto, *Kommunikationswissenschaftliche Probleme der Translation*, Wills, Wolfram(Hrsg), Darmdtadt, 1998, f. 199- 218.
[267] Dedecius, Karl, *Die Kunst der Übersetzung*, Berlin: Logos, 2002, f. 13.
[268] Risku, Hanna, *Transalatorische Kompetenz. Kognitive Grundlagen des Übersetzens als Experimenttätigkeit*, Tübingen, Satufenberg, 1998, f. 145.
[269] Shih, Jakobson, Roman, *Linguistische Aspekte der Übersetzung, Ausgewählte Texte*, Suhrkamp Verlag, f. 481- 491.

Gjetja e përshtatshme në përkthimin e një teksti të dhënë rrjedh nga lidhja midis tekstit të synuar dhe tekstit fillestar, gjatë përkthimit të të cilit ndiqet një qëllim (skopos) që e përshkon tërë dukurinë e procesin e mbartjes (përkthimit). Gjetja e përshtatshme është zgjedhja e mjeteve të shprehjes në gjuhën e synuar në përshtatje me elementet përgjegjëse në gjuhën fillestare. Gjetja e përshtatshme është, kështu, një proces, zgjedhja e mjeteve shprehëse është procesi që përfundon me rezultatin „ekuivalencë“. Ekuivalenca është rezultati, përfundimi i zgjedhjes. Ndërsa gjetja adekuate është një proces dinamik, ekuivalenca është një produkt, arritje statike.[270]

Për më tepër: ekuivalenca shënon lidhjen midis dy madhësive, të cilat kanë të njëjtën vlerë, të njëjtin rang (në rrafshet e veta) dhe u përkasin të njëjtave kategori. Ekuivalenca shënon një lidhje midis tekstit fillestar dhe tekstit të synuar, të cilët në kulturat përkatëse përmbushin të njëjtin funksion. Ekuivalenca është gjetja adekuate me funksionim të njëjtë të tekstit fillestar dhe atij të synuar.[271]

Ekuivalenca mund të jetë disa tipash:[272]

- Ekuivalencë denotative, në këtë rast kemi barazim të përmbajtjeve objektive të sendeve e dukurive;
- Ekuivalencë konotative: me këtë synohet që atmosfera subjektive- emocionale që rrethon denotatin të jetë e njëjtë;
- Ekuivalencë normative: në tekstin e përkthyer respektohen normat e zbatuara në tekstin origjinal;
- Ekuivalencë pragmatike: elementet gjuhësore përgjegjëse kanë dhe përdorim e shpërndarje të ngjashme;
- Ekuivalencë formale-estetike: teksti i përkthyer reflekton veçoritë artistike të tekstit origjinë.

Mund të flitet për kuptime ekuivalente, nëqoftëse ata arrijnë gradën më të lartë të invariancës. Në krahasim me ekuivalencën, invarianca është koncept i mbirenditur.
Invarianca është: elementi semantik që duhet të ruhet i pandryshuar, diçka, një thelb kuptimor që kalon domosdoshmërisht nga gjuha fillestare në gjuhën e synuar.
Invarianca vështrohet si *tertium comparationis* midis tekstit fillestar dhe tekstit të synuar. Kjo do të thotë: ky koncept shënon atë bërthamë kuptimore që duhet të mbahet, të ruhet gjatë përkthimit. Invarianti përcaktohet nga qëllimi i përkthimit (skoposit). Qëllimi përcakton dhe kushtet konkrete të përkthimit. Për ta dhënë më të qartë konceptin e invariancës, le të marrim disa shembuj nga I. Kadareja, psh.: *duvak*[273] është element etnografik.
Në Fjalorin e 1984-ës shpjegohet: „Copë pëlhure që përdorej për të mbuluar fytyrën e nuses ditën e dasmës. „[274]
J. Röhmi e ka përkthyer emrin në fjalë me *Schleier*.[275] Përgjegjësja e përdorur nga Röhmi ka këtë kuptim: „Ein dünnes Stück Stoff oder Netz, das eine Frau vor dem

[270] Shih, Reiß, Katharina,/Vermeer, Hans, J., *Grundlegung einer allgemeinen Transalationstheorie*, Tübingen, Niemeyer, 1991, f. 139.
[271] Shih, po aty, f. 140.
[272] Shih dhe Koller, Werner, *Einführung in die Übersetzungswissenschaft*, Wiebelsheim, 2001, f. 216.
[273] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë 1981, f. 24.
[274] Fjalori i Gjuhës Shqipe, Tiranë 1984, f. 235.
[275] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, Frankfurt am Main, 2003, f. 29.

Gesicht oder auf dem Kopf trägt“ (Një copë e hollë ose rrjetë që mban një grua para fytyrës ose në kokë)[276]

Siç shihet, midis dy njësive leksikore nuk ka ekuivalencë të plotë kuptimore. Fjala gjermane *Schleier* është përkthyer në fjalorin e Z. Simonit me: *vel.*

Fjala e dhënë në fjalorin e Z. Simonit është gjetja e përshtatshme e fjalës *Schleier.* Ndërsa objekti etnografik *duvak* është disi i ndryshëm kuptimisht nga *Schleier*. Kjo duket më qartë po të bëjmë një analizë të thjeshtë në pikëpamje të përbërësve semantikë. Përbërësin „që mbahet para fytyrës“, të dyja njësitë e kanë të përbashkët. Ndryshon materiali e funksioni: duvaku nuk bëhej nga material i hollë ose transparent, kishte funksion mbulues, fshehës të fytyrës. Ndërsa *Schleier* është prej materiali të hollë, ajo që e mban mund të shohë, por nuk mund të shihet nga të tjerët, funksioni është maskim, jo fshehje komplete. Në zgjedhjen e përgjegjëses gjermane është vepruar duke ruajtur disa nga tiparet kuptimore, është gjetur një *tertium comparationis,* elementi përgjegjës në kontekst t’i kujton të dyja objektet dhe nuk është as njëra dhe as tjetra. Në pikëpamje konotative, dallimi është dhe më i dukshëm. Fjala shqipe, si emërtim i një objekti etnografik, mban shenjën e arkaizmit gjuhësor, të kujton me asociacion një kohë dhe një kulturë të vjetër, madje dhe ambiente rurale, jo qytetare. Përgjegjësja gjermane është element bashkëkohor, neutral.
Shumica e emërtimeve të gjetura për të përkthyer objektet etnografike shqiptare janë gjetje të përshtatshme, por jo përgjegjëse ekuivalente, siç do të ishte: *mal = Berg* etj.
Fjala *xhokë* është përkthyer me *Umhan*g. Kuptimet që shprehin këto fjalë, kanë përbërës të njëjtë, por kanë dhe dallime denotative dhe konotative. Përsa i përket denotatit, fjala shqipe shënon „veshje të sipërme prej shajaku për gra e për burra, pa mëngë ose me gjysma mëngësh a me mëngë të gjata të hedhura prapa, që shkon deri në brez“[277]
Fjala *Umhang* ka kuptimin „ eine Art weiter Mantel ohne Ärmel“ (një lloj manteli i gjerë pa mëngë).[278]

Objektet që i kundërvihen njëri-tjetrit me anë të këtyre fjalëve, janë të ndryshme; kanë diçka të njëjtë (pa mëngë), por në shumicën e veçorive janë të ndryshme. Për të dhënë kuptimin e fjalës shqipe, autorët Buchholz/ Fiedler/ Uhlrich përdorin përshkrimin „dicker Vollmantel mit oder ohne Ärmel als Teil der albanischen Volkstracht“ (pallto e trashë prej leshi me ose pa mëngë, pjesë e kostumit popullor shqiptar). Përshkrimi e jep në mënyrë adekuate objektin shqiptar, *xhokën***.** Ndërsa gjetja e J. Röhm-it përmbush rregullin e *tertium comparationis*[279]. E treta krahasuese në këtë rast është veçoria e përbashkët e objekteve, e *xhokës* shqiptare dhe *Umhang*-ut gjerman.

Shembuj të tjerë do të ishin:

shtij – erschossen (vras); katund – Dorf; tirqe- Filzhosen, xhamadan- bestickte Weste, kullë – Turm, hajat – Seitenflügel; pleqësim – berühmte Entscheidungen; flokëse- Fransen etj.

[276] Langenscheidts Großwörterbuch, Berlin- München, 1998, f. 856.
[277] Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë 1984, f. 1368.
[278] Langenscheidts Großwörterbuch, Berlin- München, 1998, f. 1019.
[279] Koncepti *tertium comparationis* ka të bëjë me veçorinë/veçoritë e përbashkëta që i lidhin dy objekte, koncepte që krahasohen.

Duke i analizuar çiftet e fjalëve të sapocituara në përbërësit e tyre kuptimorë, do të vemë re se edhe këtu vepron rregulli i së tretës krahasuese. Kuptimet e fjalëve kanë të përbashkëta vetëm disa përbërës që përbëjnë dhe bazën e krahasimit.

3.2.9 Romani “Prilli i thyer” një lakunë e tërë

Siç e kemi thënë, koncepti *lakunë* u përdor për herë të parë në procesin e përkthimit në kuadrin e etnopsikolinguistikës ruse. Pararendës të teorisë së *lakunave* janë gjuhëtarët rusë Jurij Sorokin dhe Irina Markovina. Ndërsa A. Ertelt-Viethi e solli teorinë e lakunave në fushën e gjermanistikës. Kjo teori përdoret sot gjerësisht në shkencat e komunikimit ose në etnopsikolinguistikën europiane. Shkencat në fjalë merren me hulumtimin e veçorive specifike kulturore dhe me studime empirike sociologjike.[280]
Meriton të vihet në dukje fakti që teoria e lakunave po përdoret e sukseshme dhe e dobishme në shumë disiplina. Para së gjithash ka dhënë rezultate të prekshme në të kuptuarit e materialeve në gjuhë të huaj.

Termi *lakunë* vjen në gjuhësi nga fusha e mjekësisë, ku ka kuptimin “e thelluar/gropë” në sipërfaqen e organeve”. Origjinën termi e ka nga latinishtja *lacuna*, e përmban krahas kuptimit *boshllëk/zbrazëtirë,* dhe konotacionet *brimë, thellim, e çarë, greminë* etj. Në komunikimin ndërkulturor, lakunat mund të jenë një *greminë* në kuptimin metaforik, ku lexuesi, marrësi i mesazhit mund “të rrëzohet” dhe pa ndihmën e përkthyesit nuk mund të dalë. *Lakunat* mund të jenë dhe të çara, boshllëqe, thellime ku ndalet vëmendja, për shkak të moskuptimit, dhe duhet kërkuar se ç’dukuri fshihen pas këtyre. Këto boshllëqe duhen plotësuar me dije dhe njohuri nga kultura dhënëse.[281]
Me termin *lakunë* shënohet diçka që është e pranishme në një kulturë dhe mungon në tjetrën, me të cilën bëhet krahasimi. Është fjala jo vetëm për veçori gjuhësore, por dhe për veçori kulturore. Në pikëpamje etnopsikolinguistike, me *lakunë* kuptohet edhe shenja, edhe mungesa e shenjës. Astrid Ertelt-Viethi e përkufizon kështu dukurinë në fjalë:

> “Der Begriff *Lakune* bezeichnet etwas, das fehlt, das anders ist, eine Lücke in einem Text/ Kontext, die sich aus einer anderen Perspektive bzë. der Außenperspektive ergibt. *Lakunen* sind per definitionem zëischen (zumindest) Kulturen oder Kulturebenen angesiedelt.“[282](Koncepti *lakunë* shënon diçka që mungon, që është ndryshe, një boshllëk në një tekst/ kontekst ose një dallim, që zbulohet nga një këndvështrim i jashtëm. *Lakunat* instalohen midis dy kulturash ose midis dy rrafshesh kulturore.)

Me *Außenperspektive* (këndvështrim i jashtëm/ vështruar nga jashtë) kuptohet këtu fakti që *lakunat* krijohen, lindin nga krahasimi i dy a më shumë kulturave ose nënkulturave.
Përveç kësaj, *lakuna* është një madhësi semantike, një invariant kulturor kontekstual, që jep shkallën e mospërputhjes së kuptimeve të dy a më shumë sistemesh semiotike (kulturash).

[280] Shih, Ertelt-Vieth, Astrid, *Kultur modellieren aus empirisch- induktiver Sicht,* Verlag für interkulturelle Kommunikation, Frankfurt/Main, 1999, f. 121- 142.
[281] Shih më tej, Schröder, Harmut, *Interkulturelle Kommunikation,* Vorlesung am 30. Januar, 1997, f. 10.
[282] Ertelt-Vieth, Astrid, *Interkulturelle Kommunikation und kultureller Wandel,* Gunter Narr Verlag, 2005, f. 83.

Schröderi e përshkruan kështu problematikën e *lakunave:*

> „…man kann einerseits in eine Lakune hinein fallen, man kann über sie stolpern, gar in den Abgrund des Nichtverstehens stürzen, aus dem man ohne fremde Hilfe (z. B. Übersetzers) nicht mehr herausfindet; andererseits kann man in einer Lakune endecken, was sich in der Vertiefung des Textes noch alles verbirgt und damit die „Lücken" des fremdkulturellen Verstehens ausfüllen."[283] (Nga njëra anë mund të biesh në një *lakunë*, mund të pengohesh në të, mund madje të rrëzohesh në greminë dhe të mos dalësh dot pa ndihmën, p.sh., të përkthyesit. Nga ana tjetër, në një *lakunë* mund të zbulosh atë që fshihet në thellësi të tekstit dhe të plotësosh boshllëkun që lind në të kuptuarit e mesazhit të huaj.)

Markovina dhe Sorokini shtojnë se në rastin e *lakunave* kemi të bëjmë me elemente leksikore pa ekuivalencë ose me elemente specifike kulturore, që shfaqen në një kulturë, por në tjetrën - jo. Ato studiohen gjithnjë në këndvështrim të dyfishtë, gjuhësor dhe kulturor. Prandaj *lakunat* mund të karakterizohen si realie specifike, si procese ose gjendje që nuk përshtaten, nuk përputhen me raportet normale në një shoqëri të huaj.[284]

Lakunat lindin nga ballafaqimi i sistemeve gjuhësore dhe i konteksteve. Gjatë këtij ballafaqimi dalin në pah ndryshimet kuptimore dhe përdorimore të elementeve të sistemit.

Le ta ilustrojmë përkufizimin me një shembull të nxjerrë nga korpusi i hulumtuar:

> Së shpejti ai do të bëhej një *dorëras*.[285]

Në "Fjalorin e Gjuhës Shqipe" (Tiranë 1984) kjo fjalë nuk është hartuar, nuk përfshihet në fjalës. Me siguri, shkaku i mospërfshirjes është politiko-social. Dukuria e hakmarrjes shikohej (dhe është) e shoqëruar me ndodhi tragjike, me pasoja të rënda e katastrofale për familjet dhe fiset. Prandaj janë penalizuar edhe fjalë që lidhen me të. Shpallja *tabu* e elementeve të tilla në çfarëdo regjimi bie ndesh me parimet shkencore. Fjala *dorëras* duhej të përfshihej në Fjalor, si element me vlerë të veçantë etnosociolinguistike. Shkrimtari I. Kadare e ka shpjeguar në tekstin e vet kuptimin e kësaj fjale, e ka dhënë vlerën denotative dhe konotative të saj. Kjo ka qenë një lehtësi për përkthyesin, J. Röhm. Megjithatë, ky element leksikor përbën një *lakunë.* Në kulturën dhe në mentalitetin gjerman nuk ekziston gjakmarrja në kuptimin e në vëllimin që kishte ajo në Kanun, në mënyrën e realizimit të saj në Rrafshin Verior shqiptar. Përkthyesi e ka përkthyer fjalën *dorëras* me *Vollstrecker*. Le të shohim tani në fjalor për të njohur kuptimin e kësaj fjale: *vollstrecken* 'das Urteil eines Gerichts wird in die Tat umgesetzt' (një vendim i gjyqit ekzekutohet). Për rrjedhojë *Vollstecker* quhet personi që e realizon vendimin gjyqësor.[286]

Edhe pse përkthyesi është ndihmuar shumë nga teksti origjinal i I.Kadaresë, ku jepet një përshkrim glorifikues për *dorërasit*, përgjegjësja që ka gjetur ai për këtë fjalë të

[283] Schröder, Harmut, *Lakunen und die latenten Probleme des fremdkulturellen Textverstehens*, në Bungarten, Theodor (botues), Tostedt, Antikon, 1994, f. 180- 202.
[284] Ertelt-Vieth, Astrid, *Kultur modellieren aus empirisch- induktiver Sicht*, Verlag für interkulturelle Kommunikation, Frankfurt/Main, 1999, f. 121- 142; khs., Schröder, Harmut, *Interkulturelle Kommunikation*, Vorlesung am 30. Januar, 1997, f. 10.
[285] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 41.
[286] Shih, Langenscheidts Großwörterbuch, Berlin, 1998, f. 1097

leksikut kanunor, nuk e ka as peshën kuptimore dhe as atmosferën emocionale-evokative të fjalës shqipe. *Dorërasit* te I. Kadareja paraqiten si: „lulja e një fisi, palca dhe kujtesa e tij kryesore. Shumë gjëra harroheshin në jetën e fisit, njerëz dhe ngjarje mbuloheshin me pluhur, vetëm *dorërasit*, flakëzat e vogla të pashuara mbi tumulet e fisit, s'harroheshin kurrë."[287]

Ndërsa J. Röhmi përkthen: "Die *Vollstrecker* waren die Bäume einer Sippe, ihr Mark und die hauptsächlichen Objekte des Angedenkens. Vieles ging im Leben einer Sippe verloren, Menschen und Ereignisse deckte der Staub. Nur die Vollstrecker als die ewigen Lichter der Sippe wurden nie vergessen."[288]

Nuk dua të merrem me devijimet semantike emocionale të fragmentit të përkthyer, por vetëm me lakunën *dorëras.* Me gjithë devijimet e pritshme, J. Röhmi është përpjekur ta japë përshkrimin e Kadaresë me besnikëri, por gjuha dhe kultura gjermane nuk i ka dhënë mundësinë të japë të plotë, në vëllim kuptimor e në shprehësi, konceptin *dorëras*. Elementi përgjegjës *Vollstrecker* është një madhësi leksikore asnjanëse. Ajo ka si përbërës kryesor kuptimor semën „ekzekutues i një ligji gjyqësor", që lidhet në njëfarë mënyre me administratën shtetërore. Kjo semë i mungon konceptit *dorëras.* I mungojnë dhe përbërës të tjerë denotativë dhe konotativë. Po të përkthehet në shqip, fragmenti i cituar në gjermanisht nuk do ta ketë forcën evokuese dhe emocionale të origjinalit: „Ekzekutuesit ishin lisat e fisit, palca dhe objektet kryesore të kujtesës. Shumë gjëra harroheshin në jetën e një fisi, pluhuri mbulonte njerëz dhe ngjarje. Vetëm ekzekutuesit si drita të përjetshme të fisit nuk harroheshin kurrë."
Edhe pse lakuna *dorëras* është mënjanuar si në tekstin origjinal, edhe në përkthim (me anë të shpjegimeve që përmbajnë tekstet), ajo ruan ende elemente lakunore në tekstin e përkthyer, se elementi përgjegjës i gjuhës së huaj nuk jep gjithçka kuptimore, sociale, emocionale dhe pragmatike që përmban koncepti në shqip.

> Një shembull tjetër: „ Viti 1691: dyfishimi *i gjaqeve*… „[289]
>
> Përkthimi: "1691: die doppelte Zahl von *Bluttaten*"[290]

Në „Fjalorin e Gjuhës Shqipe", fjala *gjak* ka si formë shumësi *gjakra*, që përdoret zakonisht në shprehje të caktuara, si „u qetësuan gjakrat" etj. Në fakt, shumësi me – *ra* „gjakra" nuk është shumës i vërtetë, por shumës lloji. Fjala *gjak* shënon lëndë të panumërueshme, prandaj nuk mund të ketë formë shumësi. Forma e shumësit *gjaqe*, që përdoret në tekstin e I. Kadaresë, ka kuptimin e shumësisë së rasteve të gjakmarrjes. Në gjuhën gjermane, fjala përgjegjëse *Blut* përdoret vetëm në numrin njejës, nuk ka formë shumësi lloji. Në gjuhën gjermane, fjala *gjak* nuk e përmban në strukturën kuptimore kuptimin që ka në shprehje shqipe të llojit „e mori gjakun" („Një rast, kur duhej vrarë një pjesëtar i familjes a i fisit, me të cilin ishte dikush në hasmëri".)[291]

---

[287] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 41.
[288] Kadare, Ismail, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 54.
[289] Kadare, I., *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 15.
[290] Kadare, I., *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 154
[291] Fjalori i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1984, f. 370; khs. me Langenscheidts Geoßwörterbuch, Berlin, 1998, f. 176.

Prandaj forma morfologjike e shumësit në tekstin shqip përbën një *lakunë* për marrësin/ lexuesin gjerman. Duke mos pasur një përgjegjëse të përshtatshme, J. Röhmi e përkthen me kompozitën *Bluttat* (Mord), që shënon një vrasje në përgjithësi, një vrasje kriminale. Në formën e shumësit *gjaqe* kemi të bëjmë me një lakunë të rrafshit morfologjik-leksikor. Kapërcimi i vështirësisë në përkthim bëhet duke përdorur një element semantik të ngjashëm dhe të ndryshëm njëkohësisht. Ndryshimi midis tyre është edhe i rendit stilistik. Fjala gjermane *Bluttat* i përket stilit të shkruar, fjala shqipe *gjaqe* është marrë nga gjuha e folur. Etj.

I. Panasiuk e trajton kështu dukurinë në fjalë: “Me konceptin *lakunë* shënohet diçka që ekziston në një kulturë, ndërsa në tjetrën jo. Nuk është fjala vetëm për dukuri gjuhësore, por edhe për veçori kulturore. *Lakuna* është një dallim kuptimor i rrokur nga krahasimi i dy sistemeve semiotike, ose i elementeve të veçanta të këtyre sistemeve. *Lakuna* mund të jetë një leksemë, një pjesë teksti ose një tekst i tërë.”[292]

Edhe mbarë romani „Prilli i thyer“ i I. Kadaresë mund të trajtohet i gjithi si tekst - *lakunë*, krahasuar me përkthimin gjermanisht “Der zerrissene April”. Këtë mendim e mbështesim në tematikën e romanit. Në këtë vepër, Kadareja merret me dukurinë e gjakmarrjes shqiptare. Kjo dukuri, gjakmarrja, është shprehje e së drejtës dokesore shqiptare, ashtu sikundër është kodifikuar në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Ka qenë ushtruar dhe ushtrohet si mjet për të zbatuar drejtësinë fisnore në treva të gjera të Shqipërisë veriore e të Kosovës. Vrasja për të marrë gjak zakonisht kryhet sipas një riti e rregullash të caktuara dhe quhet plotësisht e përligjur nga bashkësia në fjalë. Edit Durhami e ka përshkruar kështu zakonin e gjakmarrjes:

> *„Ligji i pashkruar i gjakut është për shqiptarin si perëndia Furi i tragjedisë greke. Ai e shpie doemos në fundin e pamëshirshëm. Mallkimi i gjakut i varet mbi kokë qysh kur lind dhe e shpie në varr para kohe. Aq fort është mësuar me mendimin se duhet të qëllojë për të vrarë ose të qëllohet për t’u vrarë, sa që ky mendim ia prish gjendjen shpirtërore jo më shumë se ç’ia prish darkën e bollshme një tregtari të pasur në Europën Perëndimore fakti se „Njeriu është vdektar.“ Njeriu të cilit ia kanë poshtëruar nderin dhe ia kanë marrë , duhet ta dëlirë e ta vërë në vend. Pa e bërë këtë gjë, ai është i poshtëruar e pa vlerë në sytë e të tjerëve…“*[293]

I.Kadare flet në romanin e tij për gjakmarrjen ashtu siç sanksionohet në Kanun. Ai nuk e saktëson se për cilin kanun bëhet fjalë. Përveç Kanunit të Lekë Dukagjinit ka dhe kanune të tjera të ngjashme, si Kanuni i Maleve ose Kanuni i Malësisë së Madhe, një Kanun i Labërisë. (Me këtë të fundit I. Kadareja nuk merret.) Kanuni i Maleve, nga përmbajtja, është mjaft i ngjashëm me Kanunin e Lekë Dukagjinit. Kështu, fjala “Kanun” në romanin e Kadaresë shënon kodin e njohur të ligjeve të pashkruara që vepronte në terrenin e izoluar, pa ligje, të malësive të veriut, dhe është zbatuar në një pjesë të madhe të Shqipërisë veriore për shekuj me radhë. Qendra të Kanunit ishin Dukagjini, malësitë e Lezhës, Mirëditës, Shalës, Shoshajt, Nikaj-Mërturit, si dhe Rrafshi i Dukagjinit. Me anën e këtij kodi të lashtë fiset malësore qenë në gjendje të ruanin qetësinë, autonominë dhe mënyrën e tyre të jetesës, ndonëse nga dukja e jashtme pesë shekuj me radhë bënë pjesë në Perandorinë Osmane. Në Kanun, hakmarrja pranohej si mënyra kryesore për të kërkuar drejtësi e për të bërë drejtësi.

[292] Panasiuk, Igor, *Kulturelle Aspekte der Übersetzung*, LIT, Münster, 2005, f. 27.
[293] Durham, Mary Edith, *The Burden of the Balkan*. London, Edward Arnold, 1909, f. 41, 1928, f. 162-171.

Kjo sillte përjetësimin e gjakmarrjes. Një koncept i këtij ligji, që ende sot ngjall admirim, është *besa*, besnikëria ndaj fjalës së dhënë.[294]

Nga përshkrimi ynë i mësipërm dhe nga literatura mbi kanunin, del që Kanuni, në përgjithësi, dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit, në veçanti, kanë qenë kode ligjore popullore, sisteme të së drejtës dokesore shqiptare. Si të tilla, janë unike, unike është dhe gjakmarrja shqiptare, ashtu siç është kodifikuar në Kanun dhe siç synon ta prezantojë I. Kadareja në romanin e tij. Rrëfimi, paraqitja e kësaj hapësire të veçantë kulturore në një mjedis tjetër kulturor, ku kjo dukuri nuk ekziston, shoqërohet me vështirësi llojesh të ndryshme. Rrëfyesi, prezantuesi, duhet të jetë i pajisur me një kompetencë të mjaftueshme gjuhësore-kulturore, që të mund të përçojë në mënyrë të përshtatshme informacionin. Tekste të tilla, që kanë si temë trajtimi dukuri specifike kulturore, janë të mbushura me *lakuna*. Prania kryq e tërthor në tekst e *lakunave* e ngjyros tërë materialin tekstor. Prandaj thuhet që edhe një tekst i tërë mund të jetë një *lakunë* (sigurisht e zbërthyeshme dhe e analizueshme). Edhe teksti i I. Kadaresë është një *lakunë*. Por duke e shpallur një tekst *lakunë* nuk do të thotë që është pa interes të merremi më tej me zbulimin dhe analizën e *lakunave* të veçanta që gjëllijnë dhe veprojnë në të. Përkundrazi, zbulimi dhe hetimi i *lakunave* të veçanta shpjegon dhe hedh dritë mbi natyrën lakunore të mbarë tekstit.

3.2.9.1 Lakunat si sinjale të veçorive specifike kulturore në përqasjen e romanit të Kadaresë me versionin në gjermanisht

Lakunat shërbejnë si sinjale të pranisë së elementeve specifike në kultura të ndryshme. Gjatë krahasimit ndërkulturor këto elemente specifike shfaqen si *lakuna*, të cilat nga ana e tyre ngulitin dhe tregojnë shenjat specifike kulturore. Pa krahasim, nuk mund të dalë në pah karakteri specifik kulturor i një shenje. *Lakunat* kanë në natyrën e tyre veçori të shenjave dhe të simboleve.[295]

Mund të flasim për karakterin kulturor specifik të një shenje, vetëm kur ajo përbën një *lakunë*, e cila prodhohet gjatë transferimit ndërkulturor të shenjës. Të dyja dukuritë, *lakunat* dhe shenjat janë të lidhura ngushtë. Sepse *lakunat* shërbejnë si sinjale të veçorive specifike kulturore të shenjave. *Lakunat* janë jo vetëm sinjale të realieve specifike, por dhe të proceseve, gjendjeve specifike, të cilat janë të papajtueshme me përvojën e zakonshme të bartësve të një gjuhe/kulture tjetër.[296]

Atje ku shenjat paraqiten si *lakuna* gjatë krahasimit të konteksteve të ndryshme, atje ka gjithnjë një specifikë kulturore. Shenjat që prodhojnë një *lakunë*, emërtohen ndryshe nga autorë të ndryshëm: *spezialie, realie, kulturem, simbol*. Nuk po ndalem në autorët që i përdorin emërtimet e përmendura, për shkak se për mendimin e shumë studiuesve në këtë fushë dhe për mendimin tim, nuk ka ndonjë dallim thelbësor midis koncepteve që jepen me emërtimet e përmendura. Të gjitha dukuritë/shenjat: *realie, kulturem* etj. shfaqen në formë *lakune* gjatë krahasimeve gjuhësore/kulturore.

[294] Shih dhe, Elsie, Robert, *Leksiku i Kulturës Popullore*, Tiranë 2005, f. 99- 102.
[295] Shih më tej, Panasiuk, Igor, *Kulturelle Aspekte der Übersetzung*, LIT, Münster, 2005, f. 31-32.
[296] Shih më tej, Markovina, Irina/ Sorokin, Jurij Aleksandrovic., *Interkulturelle Kommunikation: Eliminierung kulturologischer Lakunen*, botuar në, Astrid Ertelt-Vieth (Hrsg): Sprache, Kultur, Identität, Frankfurt am Main, Peter Lang Verlag, 1993, f. 174- 177

P.sh.: Leksema *gjakhupës* shënon një person që është ndëshkuar për prerje në besë, për këtë është „grirë katundisht, duke shkuar *gjakhupës"*.[297]

Në tekstin origjinal të I. Kadaresë fjala me nocionin përkatës referojnë në një dukuri të veçantë, specifike kulturore. Përkthyesi nuk ka gjetur në gjuhën e tij një përgjegjëse njëfjalëshe ose një togfjalësh përgjegjës për elementin shqip dhe e ka përkthyer me parafrazim: *„sein Blut ging verloren"* (gjaku i tij humbi).[298]

Nga krahasimi i dy konteksteve del në pah vlera lakunore e elementit *gjakhupës.* Në kulturën dhe në jetën gjermane nuk ekziston ndonjë realie me këtë përmbajtje ose me një përmbajtje të ngjashme. Madje, po të mos ishte konteksti i gjerë, vështirë se do të kuptohej kjo fjalë në kontekstin e saj të ngushtë: "Der Mörder war von der Dorfgemeinschaft gemeinschaftlich getötet worden, sein Blut ging verloren". (Vrasësi u vra nga tërë fshati së bashku, gjaku i tij shkoi humbur.)[299]

Për t'i analizuar më mirë qasje të tilla, unë kam pyetur dhe lexues gjermanë. Në rastin e përmendur, pyetja ishte: Ç'kuptoni ju me një fjali të tillë? Përgjigjjet ishin pak a shumë të llojit: „Personi i vrarë kish humbur nderin, prandaj u vra dhe i humbi gjaku". Pa kontekstin e gjerë, askush nuk e vendos çastin e ligjërimit në një situatë gjakmarrjeje. Kjo është njëra anë e lakunës, ana kuptimore. Mospërputhja e kuptimeve leksikore të gjuhëve mbështetet në ndryshimet e segmentimit verbal të realitetit jo gjuhësor nga popuj të ndryshëm.[300]

Në zonat ku vepron Kanuni, segmentimi parësor i botës (ai denotativ) bëhet sipas rregullash, ligjesh dhe ligjshmërish krejt specifike. Që t'i kuptosh rregullat e jetës dhe të vdekjes, të botës në përgjithësi të rrafshit kanunor, duhet të jesh banor i atyre anëve. Përndryshe do të fillosh t'i gjykosh e paragjykosh ato.[301]

Por ajo që është më e rëndësishme, është ana emocionale-stilistike. Segmentimi dytësor verbal i botës së jashtme ka të bëjë me përcaktimin e sferave konotative. Lakunat shfaqen dhe në konotacionet si shprehëse specifike kulturore të vlerësimeve subjektive, të emocioneve etj. Problemi i lakunave lidhet ngushtë me funksionin emotiv të gjuhës.
Në krahasimin tonë: leksemat e gjuhës gjermane *Dorfgemeinschaft, gemeinschaftlich* janë kuptimisht asnjanëse. Ndërsa përgjegjëset shqipe *katund, katundisht* janë të markuara stilistikisht. I. Kadareja ka përdorur fjalën *katund* dhe jo *fshat* për shkak të përdorimit të saj të gjerë në pjesën veriore të Shqipërisë, në territorin geg, ku nuk përdoret fjala *fshat.* Edhe folja *töten* (vras) nuk e ka ngarkesën emocionale të përgjegjëses shqipe *grij*. Duke përdorur një metaforë, autori e ka intensifikuar mendimin dhe veprimin e shprehur nga kjo fjalë. *Ishte grirë* nuk është krejt ekuivalente me *ishte vrarë*. Ekuivalenca e tyre ka të bejë me kuptimin denotativ dhe jo me atë emocional konotativ.
Gjithsesi, përkthyesi është përpjekur ta shmangë karakterin lakunor të mbarë thënies e të fjalës *gjakhupës.* Megjithatë ka mbetur diçka lakunore. Leksema *gjakhupës* ka në

[297] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 35
[298] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 45
[299] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 45
[300] Shih më tej, Locke, John, *An essay concerning human understanding*, Ed. By Roger Woolhouse, Penguin Books 1997, f. 387.
[301] Shih dhe, Marku, A., *Një nobeliste për Shqipërinë*, Gazeta Shqiptare, Online, 23. 11. 2013

kuptimin e saj jo vetëm denotatin, që pasqyron korrelatin real, njeriun e ndëshkuar, por edhe shtresa konotative që referojnë në mentalitetin, në të folmen e një mjedisi të caktuar, etj. Lexuesi gjerman nuk mund ta marrë me mend se forma *gjakhupës* është term i zakonit të gjakmarrjes, si i tillë ka një përdorim të ngushtë, është formë dialektore (nuk ka hyrë në standard), përmban dhe ngjyrime vlerësuese negative, përbuzëse. Përgjegjësja gjermane, *sein Blut ging verloren* (gjaku shkoi humbur) është larg së qeni një përgjegjëse e përshtatshme, në pikëpamje përdorimore e konotative.

Një rast interesant është leksema *muranë.* Në „Fjalorin e Gjuhës Shqipe“, 1980 jepet ky shpjegim: „Grumbull gurësh në vendin ku është vrarë ose varrosur një njeri“.[302]
Në gjuhën gjermane nuk ekziston ndonjë fjalë përgjegjëse ekuivalente, nuk ekziston as dukuria e grumbullimit të gurëve atje ku është vrarë dikush. J. Röhmi nuk e përkthen fjalën, por e rijep pothuaj me të njëjtën pamje fonetike: *Murana*. Kjo është një mënyrë e njohur dhënieje e koncepteve dhe e shprehjeve gjuhësore që nuk kanë ekuivalente në gjuhën e synuar.
Në tekstin origjinal të I. Kadaresë gjendet një numër i madh fjalësh-emërtime objektesh etnografike që kanë shenjën e kulturës së një kohe të shkuar, të kohës kur gjakmarrja vepronte me forcën e ligjit. Pothuaj të gjitha këto emërtime përbëjnë lakuna për lexuesin gjerman. Përkthimi i tyre është bërë ose me një fjalë të përafërt kuptimisht (sipas principit “ e treta krahasuese) ose me parafrazim:

Emërtimi *xhubletë* është përkthyer me *Filzröcke; vorbë – Topf; krushkapari – Brautführer; i ngujuar – Eingeschlossener; opingë – Opanken; shajak – Filz, bucelë – Bottich; xhezve- kleines Gefäß; gurapesh – Gewichtsstein* etj.

Në të gjitha rastet gjetja është e përshtatshme, por nuk është ekuivalencë në kuptimin e barazisë denotative, sigurisht dhe vetkuptueshëm edhe të komponenteve konotative.

3.2.9.2 Klasifikimi i lakunave në “Prilin e thyer”

Teoria e lakunave ka përvijuar tashmë statusin e saj në kuadrin e etnopsikolinguistikës. Ky model teorik shërben sot si instrument për studimin e dallimeve kulturore. Objekt vëzhgimi i kësaj teorie janë tekstet si burim informacioni kulturor. Metoda e përcaktimit të lakunave e zhvilluar nga J. A. Sorokini,[303] shërben sot si mënyrë krahasimi midis kategorive gjuhësore, emotive dhe konceptore të kulturave të ndryshme.

Lakunat mund të klasifikohen sipas kriteresh të ndryshme. Një kriter do të ishte vështrimi i tyre brenda një gjuhe ose në procesin e përkthimit, midis dy gjuhësh. J. A. Sorokini dallon, sipas këtij kriteri vështrues, lakuna konfrontative dhe lakuna kontrastive.[304]

Lakunat konfrontative lindin gjatë krahasimit të dy teksteve, në gjuhë të ndryshme. Ndërsa lakunat kontrastive lindin gjatë krahasimit të teksteve që u përkasin së njëjtës kulturë e së njëjtës gjuhë. Edhe brenda një teksti në gjuhën amtare mund të lindin

[302] Fjalori i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1984, f. 745.
[303] Sorokin, Jurij Aleksandrovic, *Lakunen-Theorie. Zur Optimierung interkultureller Kommunikation*, Peter Lang, 1993, f. 127.
[304] Sorokin, Jurij Aleksandrovic, *Lakunen-Theorie. Zur Optimierung interkultureller Kommunikation*, Peter Lang, 1993, f. 134.

lakuna. Sorokin i quan tipat e mësipërm të lakunave përkatësisht *interkulturale dhe intrakulturale*. Lakunat intrakulturale janë zakonisht rezultate të zhvillimit diakronik të gjuhëve dhe kulturave. Gjatë rrjedhës kohore ndodhin zhvillime të ndryshme e të shumta, që sjellin lindjen e dukurive, objekteve, zakoneve, emocioneve, fjalëve të reja, që sjellin gjithashtu vjetërimin e atyre të mëparshme. Lexuesi i një kohe më të re ndeshet me plot të panjohura kur lexon një tekst autorësh të vjetër ose një tekst mbi një kohë të vjetër. Si shembull mund të sillnim romanet me temë historike të I. Kadaresë. Ato janë të mbushura me fjalë e terma të vjetëruara, të cilat pa një shpjegim të kujdesshëm do të mbeteshin lakuna të pamënjanuara.

Lakunat mund të jenë verbale dhe joverbale, e thënë ndryshe: gjuhësore dhe kulturore.
Lakunat gjuhësore mund të jenë: leksikore, stilistike, gramatikore
Lakunat kulturore mund të jenë: etnografike, psikologjike, që kanë të bëjnë me sjelljen, zakonet e grupeve etnike, etj.[305]

3.2.9.2.1 Lakuna leksikore në “Prillin e thyer”

Po t’i referohemi korpusit tonë, do të gruponim si lakuna leksikore fjalë si: *kanun, gjak, kullë, gjëmëtar, xhokë, gjakës, tirqe, pleqnar, flamur* (njësi administrative), *xhamadan, gjakhupës, dorëras, xhokë, vorbë, muranë, xhubletë, gurapesh, shkoqitje, i ngujuar, hupës etj*.

Përcaktimin e lakunave e kemi bërë duke u nisur nga pozicioni si lexues dhe nga krahasimi i tekstit origjinal me atë të përkthyer. Nga hulumtimet tona rezulton se ato elemente që janë lakuna intrakulturore, janë dhe interkulturore. Përkthyesi, si lexues i një lloji të veçantë, e ka më të lehtë të përcaktojë lakunat interkulturore, të çfarëdo lloji qofshin ato. Përcaktimi i lakunave është moment kyç në leximin dhe në përkthimin e një teksti. Përqëndrimi i vëmendjes në fjalët, objektet, dukuritë, kuptimet e panjohura sjell zbulimin e të çarave në përmbajtjen e tekstit. Pastaj vijon një fazë tjetër: e panjohura duhet të shpjegohet, të çarat duhet të mbushen, që leximi të rrjedhë pa probleme.
Konsiderata të tilla të bëjnë të mendosh që lloji dhe sasia e lakunave është e ndryshme në lexues të ndryshëm.

Krahas lakunave njëfjalëshe, në tekstin origjinal të I. Kadaresë gjenden dhe togfjalësha me vlerë lakunore (që shënojnë një nocion), shprehje gjuhësore që shënojnë lidhje nocionesh. Kemi qëmtuar dhe një grup formulash e formulimesh, që pas shprehjes gjuhësore fshehin një zakon kanunor (lakunë kulturore). Në këtë kuptim, lakunat kulturore janë të tilla për nga përmbajtja, ndërsa për nga shprehja janë gjuhësore.

Lakunat që shprehen me togfjalësha shënojnë gjithashtu koncepte që lidhen me zakonin kanunor të gjakmarrjes. Për nga ndërtimi janë bashkime dy emrash ose lidhje të një foljeje me një emër:

kasnecët e vdekjes, shpërndaj mortin, jap besën, çel besën, besë e vogël, besë e madhe, gris fytyrën, groshët e gjakut, taksa e gjakut, fisheku i pajës, bie në gjak, kullë

[305] Shih, Markovina Irina,/Sorokin, Jurij Aleksandrovic in Schröder: *Lakunen und die latenten Probleme des fremdkulturellen Textverstehens*, Tostedt, 1994, f. 182.

e ngujimit, shkoqitësi i kanunit, shtëpi besëprerë, miku i prerë, pajtim gjaku, të zotët e gjakut, çmimi i gjakut, hija e gjakut, gjysmë gjaku, taksë e mortit, rub i zi, vegshi i vatrës, kullë ngujimi, qehajai i gjakut, libri i gjaqeve, lisi i gjakut, lisi i tëmblit, gjak tek, vite gjakhupëse etj.

Natyra lakunore e të gjitha njësive të përmendura deri tani del më në pah duke krahasuar tekstet, shqip dhe gjermanisht. Sigurisht, edhe për lexuesin shqiptar, nocionet që shprehin fjalët e listuara janë nganjëherë të panjohura dhe i duhen shpjegime. Por lexuesi shqiptar zotëron dy kompetenca të rëndësishme, atë gjuhësore dhe atë kulturore. Kjo bën që të orientohet lehtë në botën që ofron vepra në gjuhën amtare. Unë personalisht shumë terma, zakone e rituale të gjakmarrjes i mësova gjatë punës me „Prillin e thyer“, edhe pse kam dëgjuar e kam lexuar shumë për gjakmarrjen shqiptare.
Gjatë përkthimit të një teksti përcaktohen dhe konfirmohen më mirë lakunat, sasia dhe lloji i tyre. Gjatë përkthimit të romanit „Prilli i thyer“, përkthyesi J. Röhm është ndeshur shpesh me lakuna gjuhësore. Duke dhënë barasvlerën semantike-kulturore të gjuhës gjermane, ai është përpjekur ta instalojë përmbajtjen e tekstit shqiptar në kulturën gjermane. Se rrokja e mesazhit të një teksti të lindur në një truall të huaj kulturor bëhet duke u nisur nga dijet vetiake të krijuara në truallin amtar kulturor. J. Röhmi shfrytëzon bagazhin e tij gjuhësor-kulturor për të prezantuar tekstin e I. Kadaresë. Në përkthimin e leksikut kanunor, që ka kryesisht natyrë lakunore, vërehet ndryshimi në kuptim, në shprehje e përdorim i njësive shqipe dhe atyre gjermane. Përgjegjëset e gjetura gjermane janë në përgjithësi elemente asnjanëse. Edhe nëse referojnë me asociacion në një mjedis jo të zakonshëm, ky është një mjedis i huaj, parafytyrimi për të është shumë larg realitetit (po të nisesh nga leximi i romanit të përkthyer). Kuptimi i njësive gjuhësore lidhet ngushtë edhe me formimin e tyre. Në këtë pikëpamje, gjetjet e J. Römit janë shpesh njësi të ndryshme në fjalëformim nga ato shqiptare. Qoftë edhe ky fakt flet për dallime morfokuptimore midis elementeve përgjegjëse. P.sh.: Shumë emërtime njëfjalëshe, fjalë të parme shqipe jepen në gjermanisht me fjalë të prejardhura ose të përbëra (kompozita):

besë – Ehrenwort, krushk – Hochzeitgeleit, pllajë – Hochebene, pritë – Hinterhalt, hajat – Seitenflügel, bjeshkë – Hochgebirge, Rrafsh – Hochebene, xhubletë – Filzröcke, frëngji – Schießscharten, varr – Grabstätte, xhokë – Umhang, mort- Leichengang etj.

Por ndodh edhe e kundërta, fjalëve të parme të gjuhës gjermane u përgjigjen fjalë të prejardhura në shqip:

hakmarrje – Rache, ndëshkim – Strafe, armiqësi – Fehde, bujtës – Gast, vdekje – Tod etj.

Dihet që gjermanishtja e ka shumë të zhvilluar formimin e fjalëve me prejardhje, por sidomos atë me përbërje. Krahasimi i mësipërm lë të kuptosh se midis gjuhëve nuk ka simetri, nuk ka raport 1:1, ekuivalencë absolute, në të gjitha pikëpamjet gjuhësore.
Lakuna leksikore janë dhe një sasi togfjalëshash. Interesant është dhe përkthimi i tyre. Është fjala për togje, të cilat shënojnë objekte, dukuri, qëndrime që kanë të bëjnë me gjakmarrjen shqiptare. Ndodh që përkthimi është bërë fjalë për fjalë.
P.sh.: *ins Blut fallen* për *bie në gjak.* Përkthimi në gjuhën gjermane nuk është ekuivalent i togut në gjuhën shqipe. Lexuesi gjerman e lidh kuptimin e togut me

veprimin konkret të rënies në një pellg me gjak. Edhe në kontekst, togu mbetet disi i izoluar në kuptimin e tij „gjerman“.

> Khs.: Der Priester *fällt nicht ins Blut.*[306]
> Prifti *nuk bie në gjak.*[307]

Lexuesi shqiptar, edhe pa ndihmën e kontekstit të afërt, të brendshëm dhe atij të jashtëm e kap menjëherë domethënien e togut dhe të fjalisë. Ndërsa lexuesi gjerman edhe me ndihmën e konteksteve të afërta e të largëta, vështirë se e rrok domethënien. Këtu lakuna mbetet, nuk kompensohet.
Një rast tjetër:

> Die mit der Versöhnung betrauten Vermittler, angeführt von Pater Nikë Prela, gingen mit einigen Freunden und Gefährten der Berisha, die in diesem Fall *“Herren des Blutes“* hießen, zu den Blutschuldnern, also den Kryeqyqe…[308]

Kadare e përshkruan skenën: Ndërmjetësit e pajtimit, bashkë me ca shokë e dashamirës të Berishajve, që në këtë rast quheshin *„të zotët e gjakut“*, i shkuan gjakësit, pra Kryeqyqëve…[309]

Pyetjes: ç’kuptoni ju me “Herren des Blutes” (jashtë dhe brenda fjalisë), dy lexues gjermanë iu përgjigjën: sojli, fisnikë, paraardhës fisesh fisnike.
Edhe këtu lakuna mbetet lakunë.

Ka plot raste të tilla. Në shembullin e mëposhtëm, lexuesit në fjalë nuk e kuptuan fare domethënien e togut *gjysmë gjaku,* as brenda dhe as jashtë fjalisë:

> Die Berisha hatten nun zwischen zwei Möglichkeiten zu wählen: entweder sie bezahlten die Buße, oder sie akzeptirten die Verëundung als *halbes Blut.*[310]

Në romanin e Kadaresë e gjejmë thënien në këtë formë: „Kjo do të thoshte se Berishajt mund të zgjidhnin një nga të dyja: ose të paguanin gjobën, ose ta quanin plagosjen sa një *gjysmë gjaku.*[311]

Mund të citonim dhe thënie të tjera:

> Kurse ai, *qehajai i gjakut*, siç e quanin, nuk më pëlqeu.[312]

Röhmi e përkthen: Aber der andere, den sie *Verwalter des Blutes* nennen, der hat mich nicht gefallen.[313]

Në “Fjalorin e Gjuhës Shqipe” fjala *qehaja* është shenjuar si arkaizëm. Nga shpjegimi i saj rezulton që është e konotuar negativisht, përmban ngjyrim emocional negativ:

[306] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 30.
[307] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 24.
[308] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 52
[309] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 40.
[310] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 54.
[311] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 41.
[312] Po aty, f. 102.
[313] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 136.

"kujdestari i pasurisë së një beu ose të një pronari, që u shërbente këtyre për të shtypur e shfrytëzuar fshatarët".[314]
Ndërsa fjala përgjegjëse gjermane *Verwalter* (administrator) është semantikisht anjanëse, ka vetëm diçka nga denotacioni të përbashkët (tertium comparationis) me leksemën shqipe. Atmosfera konotative, që ka të bëjë me vjetërimin e fjalës, me tiparet semantike negative, i mungojnë leksemës në gjuhën gjermanane. Kështu, efekti te lexuesi është i ndryshëm, lexuesi gjerman me gjetjen/fjalën që i ofrohet, nuk e merr tërë informacionin dhe afeksionin që përcjell kjo fjalë në tekstin origjinal të I. Kadaresë.
Siç e kemi theksuar për lexuesin dhe përkthyesin, J. Röhm, ka qenë tepër e vështirë ridhënia e tekstit të I. Kadaresë në gjermanisht. Në Gjermani nuk ekziston ndonjë paralele kulturore me gjakmarrjen kanunore shqiptare, për pasojë mungon sistemi terminologjik-leksikor që aktivizon kjo fushë, ky zakon. Megjithatë, romani i I. Kadaresë, i përkthyer nga J. Röhm, është pritur shumë mirë dhe është pëlqyer në Gjermani, nga lexuesi gjerman. Kjo ndoshta lidhet me temën e trajtuar, që është tepër ekzotike për lexuesin e një bote të tillë.

Po në grupin e lakunave leksikore kemi përfshirë edhe disa shprehje gjuhësore. I kemi quajtur shprehje, për t'i dalluar nga fjalët dhe togfjalëshat, grupe që i analizuam më sipër.
Nga ana ndërtimore, këto shprehje, ndryshe nga togfjalëshat, përmbajnë një folje në strukturën e tyre, çka u jep atyre natyrë fjalie. Kuptimisht ato shënojnë dukuri dhe procese që lidhen me zakonin e gjakmarrjes. Ja disa shembuj:

më ka zënë gjaku (das Blut hat mich befallen)
sa ditë ke në gjak (wie viel Tage bist schon im Blut)
zhgulin gurët e vjetër (die alten Grenzsteine ausgraben)
u ngrysën në gjak (in einer Blutfehde liegen)
gjysma e gjakut ishte larë (die halbe Blutschuld ja bereits beglichen war)
gjaku ndërron ngjyrë (das Blut verfärbt)
qëllonte të humbte ndonjë gjak (passierte, dass ein Blut verloren ging), Etj.

Si dhe në rastin e fjalëve e togfjalëshave, edhe në përkthimin e shprehjeve, që po shqyrtojmë, ndodh që kuptimi fillestar të humbasë gjatë përkthimit komponente kuptimore, emocionale dhe kulturore. Thënia:

- Ja, po *zhgulin gurët e vjetër* dhe po ngulin gurët e rinj të kufirit…[315], është përkthyer me: Jetzt werden *die alten Grenzsteine ausgegraben* und neue gesetzt…[316]

Folja *ausgraben* shënon procesin neutral të gërmimit të dheut për të nxjerrë diçka, në rastin tonë, gurë themeli. Ndërsa I. Kadareja ka përdorur foljen *zhgul.* Folja në gjuhën gjermane është përgjegjëse e foljes shqipe *shkul.*[317] Asaj i mungon ngarkesa emocionale negative, intensiteti dhe forca si tipare semantike të foljes *zhgul* (që do të thotë "shkul me rrënjë, me forcë, me përbuzje dhe inat").
Shprehja *u ngrysën në gjak* e marrë nga thënia „Dhe kështu, në mbarim të asaj dite tetori Berishajt *u ngrysën në gjak*" është përkthyer: „Und so *lagen* am Ende dieses Oktobertags die Berisha *in einer Blutfehde* mit den Kryeqyqe". Shprehjet e

[314] Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1984, f. 983.
[315] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 88.
[316] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 118.
[317] Shih, Fjalori i Gjuhës Shqipe, Tiranë 1984, f. 1164.

nënvizuara në shqip e në gjermanisht nuk janë sinonime të plota, ose ekuivalente semantike. Midis tyre ka marrëdhënie hiperonimie. Elementi gjerman, në pikëpamje kuptimore është i mbirenditur ndaj korrespondueses shqipe, sepse *Blutfehde*, vërtet e përmban përbërësin *Blut* (gjak), por kjo fjalë nuk ka të bëjë drejtpërdrejt dhe vetëm me gjakmarrjen.
Duke qenë se në kulturën gjermane zakoni i gjakmarrjes nuk ka ekzistuar si në Shqipëri ose në ndonjë vend tjetër të botës, ka qenë tepër e vështirë për përkthyesin të gjejë fjalësin e duhur për të dhënë atmosferën, ritualet dhe bëmat që lidheshin me gjakmarrjen. Përkthimi fjalë për fjalë jep një panoramë të përafërt, e cila plotësohet brenda konteksteve dhe me shpjegimet e nevojshme. Të marra jashtë çdo konteksti, shumë nga shprehjet e qëmtuara në përkthim janë pa kuptim e domethënie për lexuesin gjerman. Por edhe brenda konteksteve, ato nuk e kanë forcën shprehëse dhe ndikimin e përgjegjëseve shqipe. Jo vetëm karakteri lakunor, por edhe fakti që gjuhët nuk kanë simetri shprehëse, sjell ndryshime e dallime në realizimin gjuhësor të të njëjtit koncept, mentalitet a kulturë në përgjithësi. Po të përktheheshin shqip përgjegjëset gjermanisht të dhëna më lart, do të shihej dallimi, nganjëherë jo vetëm stilistikor-emocional.

3.2.9.2.2 Lakunat gramatikore në “Prillin e thyer”

Në klasën e lakunave gramatikore do të përfshijmë disa forma gramatikore që janë të veçanta karakteristike për gjuhën shqipe dhe që nuk kanë përgjegjëse në gjermanisht. Format kohore të mënyrës dëshirore dhe habitore janë të tilla. Madje format e mënyrës habitore gjenden, ndër gjuhët ballaknike, vetëm në gjuhën shqipe.[318]

> *Pushkë të bukur paska qitë*, thoshin pleqtë kur dikush e godiste hasmin ballë për ballë dhe në kokë.[319]
> *Einen Schuß aus gutem Gewehr* nannten es die Greise, wenn der Blutfeind von vorne in den Kopf getroffen wurde. [320]

Mjafton ballafaqimi i dy segmenteve përgjegjëse për të parë dallimin midis tyre dhe hendekun që hapet në një tekst, gjatë përkthimit, për shkak të veçorive specifike të gjuhës në të cilën ai është shkruar. Përgjegjësja gjermane *einen Schuß aus gutem Gewehr* nuk e përmban kurrsesi admirimin që shkakton një veprim i tillë. Përkthimi shqip i shprehjes gjermane është: *një e shtënë nga një pushkë e mirë.* Vlerat shprehëse të mënyrës habitore nuk ndjehen fare. Edhe rendi i fjalëve luan rol në kuptimin dhe në shprehësinë e thënieve. Në variantin shqip, togu *pushkë të bukur* është vendosur në krye, çka i jep një lloj theksimi kuptimor në kushtet kur ky tog është rema dhe jo tema (në pikëpamje të gjymtyrimit aktual). Në variantin në gjermanisht, togu përgjegjës *aus gutem Gewehr* qëndron në fund të shprehjes ku mungon fare folja. Veprimi jepet me një emër foljor *Schuß.* I dhënë me një emër foljor, veprimi nuk e ka natyrën aktive të foljes, nuk ka përcaktim vetor, kohor etj. Krahasimin mund ta shtrinim edhe te dy elementet e tjera të pranishme: *të bukur – të mirë (gut).* Janë mbiemra të dallueshëm kuptimisht dhe në ngjyrime emocionale.

Edhe mënyra dëshirore është një veçanti e gjuhës shqipe dhe paraqet probleme në përkthimin e saj në gjuhën gjermane:

---

[318] Shih, Schaller, Helmut, W., *Die Balkansprachen*, Heidelberg, 1975, f. 76.
[319] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 38.
[320] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 50.

I marrsha të ligat katundit dhe flamurit.[321]
Ich will das Unheil vom Dorf und vom Banner nehmen.[322]

Përkthimi shqip i gjetjes në gjuhën gjermane do të ishte:

Unë dua të marr të keqen e fshatit dhe të flamurit.

Një ballafaqim i thjeshtë i dy varianteve flet shumë: thënia gjermanisht nuk e përmban dëshirën e thekshme, që i jep formulës vlerën e një rituali të mbushur me emocione stereotipe, patologjike e cerebrale. Po si mund të përkthehej ndryshe? Vështirë t’i japësh Röhm-it mësime përkthimore. Megjithë peizazhin e ndryshëm gjuhësor midis gjermanishtes e shqipes, ai e ka bërë Kadarenë të flasë gjermanisht e të tregojë me forcë e bindshëm histori dhe realitete tipike për botën tonë. Veç, sipas mendimit tonë, përkthimi i dëshirores shqipe do të funksiononte më mirë me pjesëmarrjen e modales „mögen“ në grupin predikativ:

Möge ich das Unheil vom Dorf und vom Banner *nehmen*.

Një veçori tjetër gramatikore që duhet të mbahet parasysh në ballafaqimin e dy gjuhëve në fjalë, është dhe fakti që disa folje refleksive të një gjuhe kanë korresponduese aktive në gjuhën tjetër. Ja disa folje të nxjerra nga tekstet e krahasuara. Në listën e parë po japim foljet në gjuhën shqipe, në trajtë joveprore, të cilave u përgjigjen folje jo refleksive në gjuhën gjermane:

mendohem	*‚überlegen‘*
dëshpërohem	*‚verzweifeln‘*
kollitem	*‚husten‘*
fishket	*‚welken‘*
plakem	*‚altern‘*
kthehem	*‚zurückkehren‘*
nisem	*‚losgehen‘*
ngrihem	*‚aufstehen‘*
hidhem	*‚hinüberspringen‘*
lutem	*‚bitten‘*
mbetem	*‚verbleiben‘*
rritet	*‚wachsen‘*

Foljet e mëposhtme kanë formë veprore në gjuhën shqipe dhe vetvetore në gjuhën gjermane:

kundërshtoj	*‚sich weigern‘*
falenderoj	*‚sich bedanken‘*
nxitoj	*‚sich beeilen ,*
humb	*‚verloren gehen‘*
shpëtoj	*‚gerettet werden‘*
shkoj	*‚sich begeben‘*
ndryshoj	*‚sich verändern‘ ...*

[321] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 35.
[322] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 36.

Natyrë lakunore kanë dhe ndërtimet gramatikore me fjali të varura të nënrenditura. Në gjuhën shqipe, rendi i fjalëve në fjali të tilla nuk është i ngulitur si në gjermanisht, ku folja është gjithnjë në vendin e fundit:

> Doch es kam nicht dazu, weil ein greiser Onkel alles zum scheitern *brauchte.*[323]
>
> Mirëpo ai çast nuk erdhi kurrë, sepse një xhaxha plak u bë shkak që të prishej gjithçka.[324]

Në raste të tilla, shmangia e lakunave mbështetet në njohuritë paraprake sintaksore, njohuri që jepen në çdo libër mësimi të gjuhëve përkatëse.

3.2.9.2.3 Lakuna stilistike në “Prillin e thyer”

> *Lebendiges Gefühl der Zustände und Fähigkeit es auszudrücken macht den Poeten.* (Ndjenja e gjallë dhe aftësia për ta shprehur atë e bëjnë poetin poet.) Gëte Ekermanit, më 11 qershor 1825

Komponenti më i vështirë për t’u përkthyer është stili, e veçanta ligjërimore e shkrimtarit. A ndihet ligjërimi kadarean në romanin e përkthyer nga Röhmi? Pa dhënë një përgjigje të drejtpërdrejtë mund të thuhet që J. Röhmi përpiqet të imitojë stilin e I. Kadaresë. Komponenti më me peshë i ligjërimit artistik te I. Kadareja është leksiku shprehës. Ky është dhe mjeti më kryesor që rroket në këtë rast si përfaqësues i prirjeve individuale ideo-artistike të shkrimtarit. Në romanin e I. Kadaresë „ Prilli i thyer“ spikasin disa veçori psiko-intelektuale të tij, që kanë kushtëzuar në një masë të rëndësishme përdorimin aq të madh të mjeteve leksikore shprehëse. Shkrimtari I. Kadare shfrytëzon shumë burime shprehësie, në shumicën e rasteve ato janë origjinale. Shpesh shprehësia arrihet duke shmangur njësitë e konsumuara semantikisht e duke përdorur njësi sinonime në përmbajtje, por jo në shprehësi:

> Tani malësorët me ato çadra *të shkallmuara* qesharake dhe me thasët banalë të misrit sipër kurrizit, dukej sikur s’kishin ekzistuar kurrë.[325]
> Die Bergbewohner mit ihren lächerlich *löchrigen* Schirmen und den banalen Maissäcken auf dem Rücken schienen nie existiert zu haben.[326]

Ndërsa I. Kadareja i quan çadrat jo të prishura, por *të shkallmuara,* J.Röhmi i paraqet ato *löchrig* (me bira). Gjetja e Röhmit është më shprehëse se fjala e mundshme sinonime *kaputt.* Krahasuar me mbiemrin e përdorur nga I. Kadareja, është disi më e zbehtë emocionalisht.

Një dukuri tjetër stilistikore te I. Kadareja është dhe përdorimi i dendur i emrave abstraktë. Ata dalin shpesh në vend të mbiemrave ose të foljeve:[327]

> Kisha ishte mbi një *lartësi* shkëmbore.[328]
>
> Die Kirche stand *hoch auf einem Felsen*….[329] (Kisha ndodhej *lart mbi një shkëmb.*…)

[323] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 52
[324] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 40.

[325] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 58.
[326] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 76.
[327] Shih, Sadiku, Emine, *Kadareja ky stilist i madh*, Tiranë, 2000, f. 15.
[328] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 56.
[329] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 74.

Në përkthimin gjermanisht mungon emri abstrakt, kështu që pamja është më konkretisht e rrokshme se në variantin shqip.

> …Besiani ishte mbështetur në ndenjëse me një *buzëqeshje* lodruese në fytyrë.[330]

> … Besian sank zurück in seinen Sitz. *Ein Lächeln* spielte um seine Lippen. (Besiani u mbështet në ndenjëse. Një buzëqeshje lodronte në buzët e tij.) [331]

Fjala me kuptim abstrakt *buzëqeshje* jepet edhe në gjermanisht me një njësi abstrakte *Lächeln.* Përkthyesi ofron kështu një gjetje të përshtatshme.
Midis foljeve dhe emrave që shënojnë veprime a gjendje, ka dallime semantike, por kryesisht stilistike. Edhe në rastin e përdorimit të një emri abstrakt, për të shënuar cilësi, ky i fundit dallohet nga mbiemri përgjegjës semantikisht e në pikëpamje stilistike:

> Në të vërtetë pllaja ishte e ftohtë, dhe *kaltërimi* i Alpeve rreth e rrotull dukej sikur e ftohte ftohtë dhe me *grinë* e saj.[332]

Po me të njëjtin stil i është përgjigjur dhe J. Röhmi:

> Es war tatsächlich kalt auf dem Plateau, und *die Bläue* der Alpen ringsum ließ es in seiner *Grauheit* noch eisiger wirken.[333]

Emrat abstraktë të cilësisë të tekstit të I. Kadaresë janë përkthyer po me emra abstraktë.

Zakonisht përdorimi i emrave abstraktë, në vend të foljeve përgjegjëse, është veçori e ligjërimit libror. Por në gjuhën e I. Kadaresë nuk bien fort në sy gjurmët librore që lë përdorimi i dendur i emrave abstraktë. Në kontekstet kadareane emrat abstraktë mbajnë më së shumti shenjime stilistiko-artistike. Ata nuk përdoren për përgjithësim, për abstragim nga e zakonshmja, për të shprehur nocione abstrakte, por për poetizim; përdoren dhe për shkak të mundësisë që ata paraqesin, për t’u përcaktuar, për t’u cilësuar më tej:

> Në sytë e saj atij iu duk se pa një *shkarkim të shkurtër.*[334]

> Ein *unbekannter Funke* blitzte in seinen Augen auf.[335]

Një shenjë tjetër e stilit të I. Kadaresë është përftimi i stilemave me anë të zgjerimit (ekspansion).[336] Në raste të tilla, stilemat përmbajnë dy a më shumë fjalë, kuptimi leksikor i të cilave mbështetet në një nocion të vetëm. Stilemat me zgjerim japin më shumë informacion, por kryesisht më shumë emocion. P.sh.:

[330] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 57.
[331] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 75.
[332] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 83.
[333] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 112.
[334] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 84
[335] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 113.
[336] Shih, Sadiku, Emine, Kadareja – ky stilist i madh, Tiranë, 2000, f. 8.

> Flokët nisën t'i *shpërndaheshin e t'i rishpërndaheshin* prapë butësisht sipas lëkundjeve të karrocës.[337]
>
> Und wieder *floß* ihr Haar mit der Bewegung des Wagens.[338]

J. Röhmi e ka dhënë stilemën e I. Kadaresë me një fjalë të vetme *fliessen* (derdhet). Fjala është përdorur në kuptim të figurshëm. Kjo gjë ka mundësuar që përkthimi t'i qaset origjinalit. Atë që origjinali e jep në shprehësi me zgjerim, teksti i përkthyer e realizon me përdorimin e figurshëm të elementit të përdorur.

> Unë kam parë lloj-lloj varresh e varrezash, me gjithëfarë *shenjash e simbolesh* përsipër.[339]
>
> Ich habe in meinem Leben schon viele Friedhöfe und Grabstätten gesehen mit den verschiedensten *Zeichen und Symbolen* darauf.[340]

Stilema e përftuar me zgjerim në gjuhën gjermane është ekuivalente me përgjegjësen shqipe.

> Edhe sikur nusja të jetë duke vdekur, *zhargas e rrëshqanash* do ta çojnë në shtëpi të dhëndrit.[341]
>
> …dass die Braut im Sterben liegt… Sie auf dem Boden *schleifend, kriechend,* wird es sie ins Haus des Bräutigam bringen.[342]

Përkthyesi e ka realizuar stilemën si I. Kadareja vetë, me zgjerim. Të dyja trajtat (në Partizip Präsens) përforcojnë kuptimisht njëra tjetrën. Thënia e realizuar vetëm me një element nuk do ta kishte kurrsesi shprehësinë e thënies me dy elemente që formojnë një unitet stilistik.

Barazimi semantik është një dukuri tjetër e stilit të I. Kadaresë. Ligjërimi i tij përmban në sasi të dukshme ekuacione, ku barazohen fjalë kuptimesh të ndryshme. Si shenjë barazimi përdoret folja *është* ose ndonjë folje tjetër që shpreh identitet kuptimesh:

> Sepse miku për *shqiptarin* është *gjysmëperëndi*…[343]
>
> Weil des *Gast* für den Albaner ein *Halbgott* ist.[344]

Kemi një përkthim fjalë për fjalë, të saktë, ekuivalenca e stilemave është e plotë. Zakonisht ekuacionet semantike që ndërton I. Kadareja, jepen me saktësi kuptimore e shprehëse nga J. Röhmi.
Stili i I. Kadaresë është një shkollë më vete, ku mund të mësojnë të gjithë ata që ushtrojnë të shkruarin, në çdo lloj gjinie e fushe. Mund të rendisnim këtu edhe shumë procede stilistike, shumë përftesa e stilema. Por mjaftojnë edhe kaq sa kemi

[337] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 54.
[338] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 72.
[339] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 59.
[340] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 78.
[341] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 62.
[342] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 84.
[343] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 64
[344] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 86

përmendur për të nënvizuar origjinalitetin stilistik të shkrimtarit. Teksti gjerman rreh ta japë si në pasqyrë konceptimin dhe formulimin gjuhësor kadarejan. Kjo është një nga arritjet e përkthimit të J. Röhmit.
Po e mbyllim këtë paragraf mbi stilin dhe përkthimin e tij me një dukuri shumë të përhapur stilistike, dukuri me të cilën Kadareja operon mjeshtërisht. Është fjala për përsëritjen. Kjo është një dukuri e njohur në ligjërimin e përditshëm dhe në atë letrar artistik. Kadareja e shfrytëzon këtë burim shprehësie duke i dhënë ngjyra origjinale:

> Mark Ukaçjerra … kërkonte *fletë pas flete* dhe *kolonë pas kolone* rrjedhën e lisit të gjakut.[345]

> Mark Ukaçjerra… verfolgte *Seite um Seite, Spalte um Spalte* den Stammbaum des Blutes zurück.[346]

J. Röhmi e ka dhënë dukurinë e përsëritjes dhe elementet që përsëriten me besnikëri.

Elementet që përsëriten mund të gjenden në distancë, jo vetëm pranë njëri- tjetrit:

> Është *e frikshme*, natyrisht, s'ka si të mos jetë *e frikshme*…[347]

> Natürlich ist es *furchterregend*, das kann gar nicht anders sein…[348]

Efekti i përsëritjes, që shërben për ta dhënë cilësinë sa më intensive, jepet në rastin e përkthimit me të gjithë thënien, të cilën do ta përkthenim:

> Sigurisht është e frikshme, nuk mund të jetë ndryshe.

3.2.9.2.4 Lakunat kulturore në „Prillin e thyer"

Lakunat kulturore janë objekte etnografike, zakone, shprehi, rituale etj. Për t'i shqyrtuar në tërësinë e tyre, po i ndajmë lakunat në:

- Objekte materiale dhe
- dukuri mendore-psikologjike.

Objekte materiale janë veshjet, orenditë shtëpiake, shtëpitë, pjesët përbërëse të shtëpive, pajisjet etj. P.sh.: *xhokë, tirqe, opinga, duvak, shajak, vorbë, xhubletë, flokëse, kullë, groshët e gjakut etj***.**

Për grupin e fjalëve të sapocituara kemi folur dhe në paragrafin mbi lakunat leksikore. Këtu do të ndalemi posaçërisht në grupin e lakunave kulturore që kanë të bëjnë me zakone e rite tipike për gjakmarrjen shqiptare. Siç e kemi përmendur më lart, edhe lakunat kulturore kanë formën e tyre gjuhësore. Në këtë kuptim, edhe ato janë lakuna gjuhësore. Por gjuha e tyre ndryshon nga gjuha e thënieve të zakonshme, kuptimi i të cilave projektohet në një kohë të caktuar. Si lakuna kulturore kam trajtuar disa formula e formulime, kuptimi i të cilave nuk lidhet e nuk fiksohet në një kohë të caktuar, por ka vlerë të ngahershme, gjithëkohore (në kuptimin, sa kohë gjëllin e vepron kanuni). Lakunat kulturore nuk lindin në momentin e ligjërimit. Ato hyjnë në

[345] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 114.
[346] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 152.
[347] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 104.
[348] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 139.

ligjërim si njësi të gatshme, të paktën kuptimisht. Për nga kuptimi, ato shënojnë zakone, shprehi, rregulla, ligje, rite, sjellje, qëndrime etj. Formula të tilla mund të trajtohen si lakuna kulturore, përderisa përbëjnë shprehi, mentalitete e psikologji karakteristike për një etni. Për lexuesin e huaj ato janë zakonisht të panjohura, të pakuptueshme, shpesh të çuditshme, në mos absurde. P.sh.:

> Udha duhet të jetë e gjerë sa shtiza e flamurit.[349]
>
> Die Strasse muss so breit sein wie eine Fahnenschaft lang.[350]

Formula shpreh një rregull të kanunit. Përkthimi në gjuhën gjermane është bërë fjalë për fjalë. (S’kish si të bëhej ndryshe). Lexuesi gjerman e rrok kuptimin e përgjithshëm si shumë kuptimesh të fjalëve të veçanta dhe fantazon e parafytyron një rrugë me një gjerësi të caktuar. Por mbetet e paqartë arsyeja, pse-ja. Edhe nëse është thjesht një vendim planimetrik, përsëri e ka enigmën brenda tij: Ç’kuptim ka një rrugë me gjerësi sa shtiza e flamurit, ku qëndron simbolika ose domethënia e saj? Madje një formulim i tillë është lakunë dhe për lexuesin shqiptar. As në tekstin e I. Kadaresë, as në përkthimin e J. Röhmit nuk jepet ndonjë shpjegim për këtë rregull të kanunit. Ndoshta Kanuni vetë ka ndonjë shpjegim. Ose:

> Në shtëpi nuk hyhet pa thirrur dhe pa u përgjigjur kush.[351]
> Niemand darf ein Haus betreten ohne Zuruf und Antwort.[352]
>
> Shtëpia e malësorit është e zotit dhe e mikut.[353]
> Das Haus des Hochländers gehörte nach dem Kanun zuerst Gott und dem Gast und dann erst den Bewohner.[354]

Në shembullin e fundit vihet re përpjekja për ta mënjanuar lakunën. Për këtë J. Röhmi bashkë me përkthimin, jep dhe një shpjegim. Ja ç’thotë ai në përkthimin e tij:

> Shtëpia e malësorit, sipas Kanunit, i përkiste së pari zotit dhe mikut, pastaj të zotit.

Midis origjinalit dhe përkthimit kemi këto dallime:

- J. Röhmi përdor kohën e shkuar në vend të së tashmes së origjinalit.
- Fjalia në gjuhën gjermane përmban sintagmën *sipas Kanunit*, që i mungon origjinalit
- Thënia në gjuhën shqipe është një pohim absolut, pa krahasime, ndërsa përgjegjësja në gjuhën gjermane shpreh një raport e një hierarki midis *zotit, mikut dhe të zotit të shtëpisë.*

Duke e ndryshuar formën dhe përmbajtjen e thënies së njohur shqiptare, J. Röhmi i lejon vetes të shpjegojë dhe të interpretojë. Dhe gjatë interpretimit, ai e çmitizon dhe e “deheroizon” disi mikpritjen shqiptare.

---

[349] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 22.
[350] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 26.
[351] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 22.
[352] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 26.
[353] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 22.
[354] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 24.

Në biseda me lexues gjermanë të romanit "Der zerrissene April" dëgjon mendime dhe shpjegime nga më të ndryshmet për formulat që shprehin urime e dënime në kuadrin e gjakmarrjes, të paraqitur nga I. Kadareja. Urimi kur lind një foshjë: "*me jetë të gjatë e ta vraftë pushka!*"[355] është përkthyer: *Ein langes Leben, und dass ein Gewähr dich töte*.[356]

Së pari, duhet thënë që përkthimi: „Jetë të gjatë dhe të vraftë pushka" nuk është i saktë. I. Kadareja dhe formula e Kanunit nuk i drejtohen bashkëbiseduesit, por prindit të një fëmije të sapolindur. Me të drejtë lexuesi gjerman në këtë rast nuk e kupton thënien, sepse kombinimi i konceptit „jetë e gjatë" me „vrasjen nga pushka" është një bashkim elementesh kontradiktore.

Në klasën e lakunave kulturore përfshihen dhe ritet e zakonet, të dhëna ashtu siç i kërkon kanuni. Ky grup ritualesh kanunore përbëjnë lakuna edhe për lexuesin e sotëm shqiptar, edhe për lexuesin shqiptar të çdo kohe që nuk e njeh kanunin dhe praktikat kanunore. Si I. Kadareja, ashtu dhe J. Röhmi i përshkruajnë gjuhësisht këto zakone. Përshkrimet e të dyja teksteve janë, zakonisht, ekuivalente. Karakteri lakunor lidhet jo me qartësinë e dhënies së ritualit, por me pse-në e tij, me origjinën dhe domethënien e tij. Ritualet, zakonet paraqiten në formë skenarësh. Në faqen 40, I. Kadareja paraqet një skenë pajtimi midis dy familjeve në hasmëri: Berishajve dhe Kryeqyqëve, pajtim që nuk u arrit dot:

> …Mirëpo ai çast nuk erdhi kurrë, sepse një xhaxha plak u bë shkak që të prishej gjithçka. Dhe kjo ndodhi pas drekës, ndërsa njerëzit, sipas zakonit, hynin në çdo dhomë të kullës dhe përplasnin këmbët për të treguar se hija e gjakut do të dëbohej nga çdo këndi shtëpisë, xhaxhai plak i Gjorgut thirri befas: jo.[357]

> …Doch es kam nicht dazu, weil ein greiser Onkel alles zum Scheitern brachte. Das war kurz nach dem Mittagessen. Als die Männer durch sämtliche Räume des Turmes gingen und überall mit den Füssen trampelten, um den Schatten des Blutes aus allen Winkeln zu vertreiben, rief Gjorgs betagter Onkel plötzlich: Nein![358]

Zakoni i dëbimit të hijes së gjakut me anë të përplasjes së këmbëve është i panjohur jo vetëm për lexuesin e huaj, por dhe për atë shqiptar që nuk e njeh në detaje kanunin. Lexuesi/marrësi i mesazhit do të kishte dashur shpjegime të mëtejshme për t'i kuptuar më mirë skena të tilla. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për skena të tjera, si përcaktimi i kufijve të arave dhe fshatrave, udha e krushqve etj.

3.2.10 Eliminimi i lakunave në tekstin e përkthyer në gjermanisht të romanit „Prilli i thyer**"**

Atje ku shfaqet një lakunë, lindin intuitivisht ose të ndërgjegjësuara forma për mbushjen e kompensimin e saj.[359]
Nëse nuk do të ndodhte mbushja ose kompensimi i lakunave, lexuesi do të mbushej me pakënaqësi për vështirësitë e lindura gjatë leximit. Para vështirësish të tilla,

[355] Kadare, Ismail, Prilli i thyer, Tiranë, 1981, f. 59
[356] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 79.
[357] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 40
[358] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 52.
[359] Shih, Sorokin, Jurij Aleksandrovic, Zur optimierung interkultureller Kommunikation, botuar në, Astrid Ertelt-Vieth (botues.), *Sprache, Kultur, Identität*, Frankfurt/Main, Berlin, 1993, f. 167- 178.

lexuesi ose do të pushonte së lexuari, ose do të kapërcente pjesën e pakuptueshme për të. Po të kuptohen lakunat, nuk do të ketë më boshllëqe në tekst ose pjesë të paqarta kuptimisht. Ekziston gjithnjë mundësia e interpretimit kulturor të lakunave dhe e zbulimit të aspekteve të reja dhe interesante të tyre. Me mbushje të thellimit të krijuar nga lakuna kuptohen zakonisht komente, shpjegime. Me anë të tyre jepet kuptimi i fragmentit të paqartë. Lidhur me këtë, Markovina thotë:

> “Das Füllen kann im Umfang und Tiefe unterschiedlich sein, es hängt von der konkreten Situation des Verkehrs und von der Grösse der kulturellen Distanz zwischen den Kommunikanten ab.“[360](Mbushjet mund të jenë të ndryshme në vëllim dhe në thellësi. Kjo varet nga situata konkrete e komunikimit dhe nga distanca kulturore midis personave komunikues.)

Një mundësi tjetër e mënjanimit të lakunave është kompensimi. Në këtë rast, elementi lakunë zëvendësohet nga një element i barasvlershëm i gjuhës së synuar. Markovina thotë që kompensimi shoqërohet me humbje, por është një mjet i mirë për të kuptuar kulturën e kombeve të tjera.[361]
Mund të thuhet që gjatë trajtimit/kapërcimit të lakunave, përkthyesit praktikojnë mënyra të ndryshme. Ja disa prej tyre:

- Transliterim/transkriptim: fragmenti jepet si citat, i përkthyer fjalë për fjalë.
- Parafrazim: lakuna shpjegohet brenda tekstit, duke përdorur kllapat për materialin shpjegues. Nëqoftëse shpjegimi është i gjatë, është mirë të përdoren shënimet në fund të tekstit të përkthyer.
- Përdorim neologjizmash: kur nuk ekziston ndonjë përgjegjëse e përshtatshme.
- Transformim i strukturave sintaksore, etj.

Strategjitë për kapërcimin e lakunave janë të shumta dhe varen gjithnjë nga situata konkrete. Mendojmë se nuk mund të propozohet një metodë si e vetme dhe absolute. Le t’i referohemi dhe njëherë Markovinës. Ajo e quan përkthyesin “zëdhënës” të autorit të origjinalit. Ai përdor të njëjtin ton me autorin dhe duhet të ketë parasysh se të gjitha fjalët e tekstit origjinal janë të rëndësishme për autorin. Secila fjalë ka vlerën dhe ritmin e tyre. Në përmbajtjen e tyre përfshihen dhe asociacionet e konotacionet, që kanë rëndësi të veçantë për kontekstin.[362]

Po, lidhur me këtë, E. Marktstein thotë: „Ein literarischer Text ist, ein Text, in dem kein Wort entfernt werden darf, ohne dass die ästhetische Aussage verändert wäre.“[363] (Teksti letrar është një tekst i tillë, ku asnjë fjalë nuk mund të hiqet, pa cënuar vlerën estetike të tij.)

E. Marktsteini vë në dukje vështirësinë e përkthimit të tekstit letrar. Ajo thotë se nuk është e lehtë të gjenden elemente ekuivalente dhe të formulohen fjalitë në mënyrë të përshatshme, kundrejt tekstit origjinal. Nëse lidhjet e fjalëve nuk do t’i përgjigjen origjinalit, do të pasojnë shtrembërime si në planin estetik, ashtu dhe në atë kuptimor. Megjithë vështirësitë e shumta, përkthimi është gjithsesi i mundur.

---

[360] Markovina, Irina, Interkulturelle Kommunikation: Eliminierung der kulturologischen Lakunen“, në, Ertelt-Vieth, Astrid (botues) *Sprache, Kultur, Identität,* Frankfurt am Main, 1993, f. 78.
[361] Shih, po aty, f. 176.
[362] Shih, po aty, f. 153.
[363] Markstein, Elisabeth, Erzählprosa, në, *Handbuch Translation*, Tübingen, 1998, f, 246.

Lidhur me fjalët lakunore, që mund të jenë të papërkthyeshme, W. Kolleri mendon se kuptimi i tyre duhet hetuar në kontekst. Nganjëherë kuptimi sqarohet pasi të jetë lexuar i gjithë teksti. Ai flet edhe për shprehitë e aftësitë interpretuese, që fiton lexuesi, gjatë e pas leximit. Fjalët dhe shprehjet e pakuptueshme në fillim të leximit ftillohen e sqarohen gjatë leximit. Kështu, teksti kuptohet gjithnjë e më mirë.[364]
Ka mendime teorike që pranojnë si mënjanimin e lakunave (çlakunizimin), ashtu dhe lënien e tyre në statusin lakunor. Një mendim të tillë përfaqëson Panasiuk. Sipas tij, përkthyesi e vendos vetë, nëse do t’i përkthejë dhe shpjegojë lakunat, ose jo. Tekstet e lakunizuara (ku lakunat nuk rrafshohen) emetojnë shumë njohuri mbi kulturat e huaja. Por mund të prodhojnë dhe keqkuptime. Prandaj Panasiuk rekomandon që përkthyesi të mundohet e t’i përkthejë lakunat, të gjejë përgjegjëset e përshtatshme të tyre. Kështu ai i jep lexuesit një tekst që përmban mendimet dhe estetikën e materialit origjinal. Nga ana tjetër, lexuesi është në gjendje ta kuptojë dhe ta interpretojë më mirë tekstin e ofruar.[365]

Përkthyesi J. Röhmi i përdor të gjitha mundësitë dhe rrugët për mënjanimin e lakunave të gjithëgjendura në romanin shqip të I. Kadaresë. Në punën me lakunat, në përkthimin dhe në të kuptuarit e tyre, vlen mendimi i W. Kollerit i përmendur pak më sipër.[366]

Përkthyesi, si lexuesi fillestar i një vepre letrare, gjatë leximit të tekstit grumbullon informacionin, i cili e ndihmon për ta kuptuar tekstin në përgjithësi. Megjithatë ka gjithnjë fjalë dhe segmente të pakuptueshme. Disa prej tyre mbeten të tilla (lakuna), edhe pas përfundimit të tërë përkthimit. Në tekstin e përkthyer të J. Röhmit mund të listohen si lakuna të mbetura fjalë të vetme, grupe fjalësh, shprehje etj. Si të tilla do të përmendnim: *bujtës, hajat, gurapesh, dorëras, kullë ngujimi, besë e vogël* etj. Megjithatë, në rrjedhë dhe në fund të përkthimit/leximit, lakunat nuk e kanë më atë paqartësinë dhe misterin e fillimit. Më tepër mund të flasim për lakuna në planin konotativ.
Strategjia kryesore që përdor J. Röhmi për mbushjen e boshllëkut lakunor është ajo e shpjegimit të tyre në një glosar në fund të librit. Glosari përmbledh ato fjalë që, sipas përkthyesit, përbëjnë probleme kuptimore për lexuesin gjerman. Të tilla janë *kanun, kullë, opinga, lek, qindarkë, grosh, flamur, kulla e Oroshit* etj. Për fjalët e glosarit jepet një shpjegim i pasur leksikor, historik, etnografik. Përveç glosarit jepet dhe një listë e fonemave të gjuhës shqipe me shqiptimin përkatës. Në përkthimin e J. Röhmit emrat e përveçëm ruajnë pamjen autentike fonetike. Që lexuesit t’i ndiejnë e t’i shqiptojnë saktë këto kategori fjalësh, përkthyesi ndihmon me listën e tingujve të gjuhës shqipe, që përbëjnë problem në shqiptimin e në artikulimin e gjermanishtfolësve.
Një strategji tjetër që përdor J. Röhm për mënjanimin e lakunave është shpjegimi i tyre brenda tekstit ose në fund të faqes (fusnota). Është shumë e rëndësishme të theksojmë se teksti origjinal i I. Kadaresë përmban shumë analiza dhe shpjegime për dukurinë e gjakmarrjes, për zakonet dhe bëmat që lidhen me të. Po të mungonin shpjegime të tilla, edhe lexuesit shqiptarë do ta kishin të vështirë ta kuptonin tekstin në hollësitë e tij. Kjo mënyrë paraqitjeje i ka dhënë dorë dhe përkthyesit gjerman në

[364] Koller, Werner, *Einführung in die Übersetzungswissenschaft*, Wiebelsheim, 2001, f.177.
[365] Panasiuk, Igor, *Perspektiven der Anwendung des Lakunen-Modells in der Translationswissenschaft*, Münster, 2005, f. 257.
[366] Shih, po aty, f. 177.

punën e përkthimit. Sigurisht, shpjegimet e I. Kadaresë janë jo vetëm të vërteta sociale- historike, por edhe parashtrime subjektive- letrare.
Strategjia kryesore që ndjek J. Röhmi në shmangien e lakunave, është synimi për të gjetur përgjegjësen e përshtatshme. Në këtë synim do të futnim edhe rezultatet e përkthimin fjalë për fjalë, edhe ato të përkthimit të lirë. Siç kemi thënë dhe në analizat e paragrafeve të mësipërme, ekuivalenca e njësive gjuhësore të tekstit origjinal me ato të tekstit të përkthyer zakonisht nuk është e plotë. Kështu mund të flasim vetëm për gjetje të përshtatshme sipas parimit të së tretës krahasuese.[367]

Mendimin tonë mund ta ilustronim me shumë shembuj nga tekstet në fjalë: Në faqen 74 I. Kadareja përdor emërtimin *vegshi i vatrës.*[368] J. Röhmi e ka përkthyer emërtimin me një fjali *„den Kessel über dem Feuer verrücken“*[369] (e zhvendos kazanin mbi zjarr). Nuk mund të thuhet që kjo është gjetja e saktë, por është një shpjegim për momentin e dhënë nga J. Röhmi.

Emërtimi *rub i zi* i tekstit shqip është dhënë me *das schwarze Band.* Në pikëpamje denotative kemi ekuivalencë, por në pikëpamje konotative jo. Fjala *Band* ka si ekuivalente kuptimore në shqip fjalën *shirit.* Leksema *rub* është një lakunë edhe për lexuesin shqiptar. Kuptimi dhe vlera e saj përcaktohen brenda dukurisë së gjakmarrjes. Në tekstin e I. Kadaresë përdorimi i kësaj njësie ka një funksion të caktuar. Midis mjeteve të tjera karakterizuese kjo fjalë shërben për t’i dhënë rrëfimit ngjyra autoktone historiko-sociale. Ky funksion nuk mund t’i atribuohet njësisë përgjegjëse të gjuhës gjermane e cila i përket leksikut asnjanës. Fjala shqipe nuk gjendet në “Fjalorin e Gjuhës Shqipe”.[370]

3.2.11 Leksiku kanunor në romanin”Prilli i thyer”dhe në gjegjësen në gjermanisht

Listat e fjalëve, togfjalëshave, shprehjeve dhe formulave, që kemi qëmtuar e mbledhur në dy variantet e romanit „Prilli i thyer“ të shkrimtarit I. Kadare, përbëjnë fjalësin e zakonit të gjakmarrjes ashtu siç e ka mbledhur, konceptuar e përshkruar autori i romanit. Ka njësi gjuhësore si: *plagos, viktimë, i vdekuri, pritë, shtij, vras, vrasës, i vrari* e shumë të tjera, që duket sikur i përkasin leksikut të përgjithshëm dhe jo posaçërisht leksikut të dukurisë „gjakmarrje“. Ne i kemi përfshirë në leksikun kanunor me bindjen e plotë se njësi të tilla marrin në situatat dhe në kontekstet ku gjëllin e paraqitet gjakmarrja, kuptime specifike. Në kuadrin e gjakmarrjes, vrasja nuk është si çdo vrasje. Sado tragjike dhe shfarosëse, e kryer me armët e zakonshme, ajo justifikohet e mbrohet nga Kanuni. Edhe vrasësi nuk është vrasës i rëndomtë, por një zbatues „korrekt“ i kanunit, i rregullave mbi gjakmarrjen. Edhe arsyet e vrasjes nuk janë „motive të ulëta“. Siç e thotë dhe I. Kadareja, vrasësi shpesh herë ka lëkundje hamletiane para se të vrasë. Edhe nëse disa nga fjalët e listuara gjenden shpesh në ligjërimet e zakonshme, apo në gjuhën e kriminalistikës, prapëseprapë, të përdorura në sferën kanunore të gjakmarrjes, ato shenjohen ndryshe, ato shënojnë diçka tjetër të ngjashme e të ndryshme njëkohësisht.
Nëpërmes ballafaqimit me përgjegjëset gjermanisht del shpesh në pah që elementi në gjuhën gjermane nuk e ka krejt përmbajtjen denotative dhe konotative të njësisë në gjuhën shqipe. Grupimin e leksikut kanunor e kemi bërë sipas kriterit të numrit të

[367] Shih pragrafin mbi lakunat leksikore, f.
[368] Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Tiranë, 1981, f. 74.
[369] Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Fischer Verlag, 2003, f. 98.
[370] Shih, Fjalori i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1984, f. 1033.

elementeve gjuhësore në romanin në shqip. Kështu, leksikun kanunor e kemi grupuar në: leksema, togfjalësha, formula dhe fjali.

Leksema		
	Kadare: Prilli i thyer	*Röhm: Der zerrissene April*
1	plagos (f.8)	verwunden (f. 7)
2	shënjestër (f.8)	zielt auf seinen Kopf (f. 8)
3	viktima (f.9)	Opfer (f. 8)
4	pushkë (f.9)	Gewehr (f. 8)
5	i vdekuri (f.9)	erschossener (f. 8)
6	pritë (f.9)	Hinterhalt (f. 8)
7	shtij (f.11)	erschossen (f. 11)
8	katund (f. 11)	Dorf (f. 16)
9	vrasës (f. 12)	Mörder (f. 17)
10	vras (f. 12)	töten (f. 17)
11	i vrari (f. 12)	der Getötete (f. 17)
12	ndërmjetës (f.12)	Unterhändler (f. 17)
13	besë (f.12)	Ehrenwort (f. 18)
14	gjak (f. 13)	Blut (f. 18)
15	Kanun	s`ka përgjegjëse (f. 18)
16	dërgatë (f.13)	Abordnung (f. 18)
17	lajm (f. 13)	Neuigkeit (f. 18)
18	varrim (f.13)	Bestattung (f. 18)
19	kullë (f. 13)	Turm (f. 18)
20	gjëmëtar (f. 13)	Letittragende (f. 18)
21	kësollëtar (f.13)	Trauergast (f. 18)
21	xhokë (f.13)	Umhang (f. 18)
22	gjakës (f. 13)	Bluträcher (f. 18)
23	tirqe (f.14)	Filzhosen (f. 19)
24	gjëmë (f.15)	Kummer (f. 20)
25	pleqnar (f.16)	Dorfältesten (f. 21)
26	ndëshkim (f.16)	Strafe (f. 21)
27	gjakmarrje (f.18)	Blutrache (f. 23)
28	flamur (f.18) njesi ushtarake dhe administrative bajrak fisnore	Banner
29	opingë (f. 21)	Opanken (f. 26)
30	malësor (f. 22)	Hochländer (f. 27)
31	karvan (f. 23)	Karavane (f. 28)
32	karvanarë (f. 22)	Ohne Entsprechung (pa përkthim)
33	krushk (f.23)	Hochzeitsgeleit (f. 28)
34	xhamadan (f. 23)	bestickte Weste (f. 28)
35	krushkapar (f. 24)	Geleitführter (f. 29)
36	duvak (f. 24)	Schleier (f. 29)
37	prift (f.24)	Priester (f. 30)
38	han (f. 24)	Herberger (f. 30)
39	armiqësi (f. 25)	Fehde (f. 32)
40	përcjellës (f. 27)	Begleiter (f. 33)
41	bujtës (f. 27)	Gast (f. 34)
42	në gjak (f. 27)	in einer Blutfehde (f. 35)
43	varr (f. 27)	Grab (f. 35)
44	jetë (f. 28)	Leben (f. 35)
45	pllajë (f.33)	Hochebene (f. 42)
46	gjakhupës (f. 35)	sein Blut ging verloren (f. 45)
47	(miku) u pre (f. 35)	der Gast geschädigt worden war (f. 45)
48	pabesi (f. 35)	Treubruch (f. 45)
49	veçimi (ose lëçitja) (f. 36)	Ächten oder Ausschellen (f. 47)
50	mort (f. 36)	Leichengang (f. 47)

51	ndëshkim (f. 36)	Bestrafung (f. 47)
52	i korituri (f. 39)	der Entehrte (f. 51)
53	vrasës (f.40)	Mörder (f. 52)
54	hakmarrje (f. 41)	Rache (f. 53)
55	dorëras (f. 41)	Vollstrecker (f. 53)
56	armiqësi (f.41)	Feindschaft (f. 54)
57	shtij (f. 41)	Schießen (f. 54)
58	plagos (f. 41)	verwunden (f.54)
59	plagë (f. 41)	Wunde (f. 54)
60	vrasje (f. 43)	Mord (f. 56)
61	i plagosuri (f. 42)	der Mann, den Gjorg verwundet hatte (f. 54)
62	pritë (f. 43)	Hinterhalt (f. 56)
63	armik (f. 43)	Feind (f. 56)
64	hajat (f. 45)	Seitenflügel (f. 59)
65	shajak (f. 46)	Filz (f. 60)
66	xhokë (f. 46)	Umhang (f. 60)
67	katund (f. 46)	Dorf (f. 61)
68	vorbë (f. 47)	Topf (f. 61)
69	princ (f. 48)	Prinz (f. 63)
70	pritës (f. 49)	der Ëartende (f. 64)
71	zanë (f. 53)	Fee (f. 69)
72	shtojzovalle (f. 53)	Elfe (f. 69)
73	Rrafsh (f. 53)	Hochebene (im Norden) (f. 69)
74	malësor (f. 54)	Hochländer (f. 71)
75	muranë (f. 59)	ein Totenmal, eine Murana (f. 77)
76	varr (f. 59)	Grabstätte (f. 78)
77	bjeshkë (f. 59)	Hochgebirge (f. 78)
78	krushkapari (f. 62)	Brautführer (f. 83)
79	xhubletë (f. 83)	Filzröcke (f. 110)
80	gurapesh (f. 85)	Geëichtsstein (f. 114)
81	zhgul (f.88)	ausgraben (f. 118)
82	pleqësim (f. 90)	berühmte Entscheidungen (f. 120)
83	gjakës (f. 91)	Bluträcher (f. 121)
84	shkoqitje (f. 95)	schëierige Fälle (f. 127) (s. Tekstin)
85	frëngji (f. 96)	Schießscharten (f. 129)
86	i ngujuar (f. 96)	Eingeschlossener (f. 129)
87	vrasës/ gjakës (f. 102)	Mörder/Blutnehmer (f. 137)
88	flokëse (f. 103)	Fransen (f. 138)
89	rrafsh (f. 104)	Hochland (f. 139)
90	radhor (f. 113)	Konvolut (f. 151)
91	vrasje (f. 115)	Morde (f. 153)
92	gjaqe (f. 115)	Blutrachefälle (f. 153)
93	dorëras (f. 115)	Vollsträcker, der Mann…. (me parafrazim…154)
94	besa (f. 117)	Ehrenëort (f. 156)
95	gjakmarrja (f. 117)	Blutrache (f. 156)
96	miku (f. 117)	Gastfreundschaft (f. 156)
97	gjakmarrjelogjia (f. 117)	Blutracheologie (f. 157)
98	vdekje/mort (f. 119)	Tod/Sterben (f. 159)
99	hupësat (f. 117)	Verlorene (f. 159)
100	gjakhupës (f. 119)	Verëirkt (f. 159)
101	kësollet (f. 119)	Bestattungen (f. 160)
102	gjakës (f. 121)	Rächer (f. 162)

Togfjalëshat		
	Kadare: Prilli i thyer	*Röhm: Der zerrissene April*
1	tytë e pushkës (f.8)	Lauf des Gewehrs (f. 7)

2	gjoba e plagosjes (f.8)	die Buße für die erste (f. 7)
3	zgjoj nga gjumi i vdekjes (f.9)	ins Leben zurückzurufen (f. 9)
4	kasnecët e vdekjes (f. 11)	Herold des Todes (f. 11)
6	shpërndaj mortin (f.11)	den Tod bekannt geben (f. 12)
7	laj gjakun (f. 12)	das Blut rächen (f. 12)
8	besë 24-orëshe (f.12)	24 Stündige Ehrenwort (f. 12)
9	stërkala gjaku (f.12)	verspritzte Blut (f. 13)
10	masat e mbrojtjes (f.12)	Schutzmassnahmen (f. 13)
11	jap besën (f. 12)	Ehrenwort leisten (f. 13)
12	marr hak (f.13)	schießen um sich zu rächen (f. 13)
13	çel besën (f.13)	Ehrenwort besiegelt/gegeben (f. 14)
14	besë e vogël (f.13)	kleines Ehrenwort (f. 14)
15	besë e madhe (f.13)	großes Ehrenwort (f. 14)
16	derdhet gjak (f. 13)	Blutvergießen (f. 14)
17	ceremoni e përmortshme (f. 13)	Totenfeier (f. 14)
18	gris fytyrën (f.13)	sich die Wangen zerkratzen (f. 14)
19	shkul flokët (f.13)	sich die Haare raufen (f. 14)
20	drekë e mortit (f.13)	Leichenmahl (f. 14)
21	besë tridhjetëditëshe (f.14)	dreißigtätiges Ehrenwort (f. 16)
22	shkelës i kanunit (f.16)	Kanunverletzer (f. 18)
23	gjaku i fundit (f.16)	jüngstes Blut (f. 18)
24	marrja e gjakut (f.18)	Blutrache (f. 20)
25	groshët e gjakut (f.19)	Blutgroschen (f. 21)
26	taksa e gjakut (f. 19)	Blutsteuer (f. 22)
27	derdhja e gjakut (f.19)	das Blut vergossen ist (f. 22)
28	marr gjak (f. 20)	Blutrache vollziehen (f. 23)
29	fisheku i pajës (f. 23)	Mitgiftpatrone (f. 28)
30	bie në gjak (f. 24)	ins Blut fallen (f. 30)
31	jap gjak (f. 25)	Blut geben (Blut nehmen) (f. 31)
32	amaneti i fundit (f. 26)	der letzte Wille (f. 32)
33	kullë e ngujimit (f. 26)	Fluchtturm (f. 32)
34	pajtim gjaku (f. 26)	Blutfehde beizulegen (f. 32)
35	mekanizmi i gjakmarrjes (f. 27)	Räderwerk der Blutrache (f. 35)
36	qerthull i gjakmarrjes (f. 28)	Räderwerk der Blutrache (f. 36)
37	hyn gjaku (f. 28)	Das Blutt Zutritt verschaft hatte (f. 36)
38	Kulla e Oroshit (f. 29)	Turm von Orosh (f. 37)
39	shiriti i zi (f. 29)	das schwarze Band (f. 37)
40	shkoqitësi i kanunit (f. 32)	Ausleger des Kanuns (f. 41)
41	shtëpi besëprerë (f. 35)	Haus eines Treubrüchigen (f. 45)
42	prerja e mikut në besë (f. 35)	Schädigung eines Gastes (f. 45)
43	miku i prerë (f. 35)	Schädigung des Gastes (f. 45)
44	katund besëshkelës (f. 36)	treubrüchiges Dorf (f. 46)
45	(nuk e) lau gjakun (f. 36)	die Blutschuld nicht begleichen mochte (f. 46)
46	shkulja e fshatrave (f. 36)	Dörfer ausgelöscht wurden (f. 47)
47	prerja e mikut (f. 36)	Gastfreundschaft verletzen (f. 47)
48	djegiet e shtëpive (f. 36)	ein Haus niedergebrannt (f. 47)
49	lënia e tokave djerr (f. 36)	Verwüstung der Äcker (f. 47)
50	prerja e druve në kopsht (f. 36)	Abschneiden der Obsbäume im Garten (f. 47)
51	lënia pa ngrënë (f. 36)	ohne Essen lassen (f. 47)
52	dhomë e miqve (f. 37)	
53	çështje e gjakut (f. 37)	die Frage des Blutes (f. 49)
54	shenjat e gjakut (f. 39)	die Blutflecken (f. 50)
55	derdhje e gjakut (f. 39)	Blutvergiessen (f. 51)
56	pajtim gjaku (f. 39)	Versöhnung des Blutes (f. 51)
57	pajtim gjaku (f. 39)	Beilegung der Blutfehde (f. 52)
58	ndërmjetësit e pajtimit (f. 40)	Die mit Versöhnung betrauten Vermittler (f. 52)
59	të zotët e gjakut (f. 40)	Herren des Blutes (f. 52)

61	çmimi i gjakut (f. 40)	Höhe des Blutgeldes (f. 52)
62	hija e gjakut (f. 40)	Schatten des Blutes (f. 52)
63	makina e gjakut (f. 40)	Maschinerie des Blutes (f. 53)
64	mekanizmi i gjakut (f. 40)	Mechanismus des Blutes (f. 53)
65	dështim i pajtimit (f. 41)	gescheiterte Versöhnung (f. 53)
66	gjysmë gjaku (f. 41)	ein halbes Blut (f. 54)
67	paguaj gjobën (f. 41)	Buße bezahlen (f. 54)
68	llogaria e gjakut (f. 41)	perkthyer krejt ndryshe….. (f. 54)
69	llogaria e gjakut (f. 42)	Bilanz des Blutes (f. 55)
70	marrja e gjakut (f. 42)	Blutrache (f. 55)
71	kullë princërore (f. 44)	fürstlicher Turm (f. 58)
72	taksë e mortit (f. 45)	Blutsteuer (f. 59)
73	shirit i zi (f. 46)	schwarzes Band (f. 60)
74	pagues i taksës (f. 46)	um die Todessteuer zu entrichten (f. 60)
75	llambë vajguri (f. 46)	Petroleumlampe (f. 61)
76	kupë druri (f. 47)	Holznapf (f. 61)
77	paguesit e mortit (f. 47)	wer in den Turm kommt, um die Blutsteuer zu bezahlen (f. 62)
78	paret e gjakut (f. 47)	das Blutgeld (f. 62)
79	Bjeshkët e Namuna (f. 52)	die Verëünschten Almen 68
80	Rrafshi i Veriut (f. 52)	Hochland (f. 68)
81	rub i zi (f. 57)	das schwarze Band (f. 75)
82	shenjë e vdekjes (f. 57)	Zeichen des Todes (f. 75)
83	kushtetutë e vërtetë e vdekjes (f. 59)	ein Grundgesetz des Todes (f. 79)
84	karvan krushqish (f. 62)	Hochzeitsgeleit (f. 83)
85	gjëma më e madhe (f. 66)	Weltuntergang (f. 88)
86	vegshi i vatrës (f. 74)	den Kessel über dem Feuer verrücken (f. 98)
87	ndarje kufijsh (f. 76)	ein Grenzproblem (f. 105)
88	Shtegu i Ujkut (f. 80)	Wolfssteige (f. 106)
89	ngulja e kufijve (f. 82)	die Festlegung der Grenzen (f. 110)
90	shkoqitës kanuni (f. 84)	Kanunsausleger (f. 112)
91	mbartësit e gurapeshit (f. 85)	Steinträger (f. 114)
92	gur kufiri (f. 86)	Grenzstein (f. 115)
93	palët e grindësve (f. 87)	streitenden Parteien (f. 116)
94	sherr e pezmatim (f. 90)	Streit und Zank (f. 121)
95	këmisha e përgjakur (f. 93)	das Rache gebietende Hemd (f. 124)
96	marr shpagim (f. 95)	Vergeltung fordern (f. 126)
97	i thirrur për gjyqësi (f. 95)	zum Schiedsrichter berufen (f. 127)
98	t’i shkulet porta (f. 95)	die Tür soll herausgerissen (f. 127)
99	stinët e paratë e gjakut (f. 95)	die ersten Monate der Blutfehde (f. 128)
100	kullë ngujimi (f. 96)	Fluchtturm (f. 129)
101	gjakut të dhënë	gegebenes Blut (f. 129)
102	gjakut të marrë (f. 97)	genommenes Blut (f. 129)
103	interpretues kanuni (f. 100)	Ausleger des Kanun (f. 134)
104	Kulla e Oroshit - vigjiluese e kanunit (f. 100)	der Turm von Orosh ist Hüter (f. 134)
105	qehajai i gjakut (f. 102)	(f. 102)
106	punët e gjakut (f. 112)	Sache des Blutes (f. 150)
107	libri i gjaqeve (f. 113)	Buch des Blutes (f. 151)
108	gjaqet e gjithë rrafshit (f. 113)	alle Blutfehden des Hochlandes (f. 151)
109	gjaqet e pashlyera (f. 113)	Fälle noch nicht abgegoltenen Blutes (f. 152)
110	lisi i gjakut (f. 113)	Stammbau des Blutes ….. (f. 152)
111	lisi i tëmblit (f. 113)	Stammbau der Milch ,,, (f. 152)
112	gjak i tepërt…gjak tek (f. 114)	immer noch ein Blut übrig, ein Blut voraus, ein (f. 153)
113	gjak i jashtëm për kanunin (f. 115)	das Blut war dem Kanun fremd (f. 153)

114	vite gjakhupëse (f. 115)	Jahre des verlorenen Blutes (f. 115)
115	industria e gjakut (f. 117)	Blutindustrie (f. 157)
116	gjaku si mall (f. 117)	Ware Blut (f. 157)
117	mekanizmi i gjakmarrjes (f. 117)	Mechanismus der Blutrache (f. 157)
118	gjaqet e vjetra/ e reja (f. 119)	die frischen/ alten Blutfehden (f. 160)

Shprehje		
	Kadare: Prilli i thyer	*Röhm: Ein zerrissener April*
1	më ka zënë gjaku (f.9)	das Blut hat mich befallen (f. 8)
2	zgjoj nga gjumi i vdekjes (f.9)	ins Leben zurückzurufen (f. 8)
3	lajmëroj mortin (f.11)	den Tod bekannt geben (f. 12)
4	gjaku i tij bie mbi ty (f. 26)	sein Blut fällt auf dich (f. 33)
5	ti je i larë nga gjaku (f. 26)	du bist frei von seinem Blut (f. 33)
6	gjaku rëndon mbi … (f. 27)	das Blut fiel auf die Berisha (f. 34)
7	u ngrysën në gjak (f. 27)	in einer Blutfehde liegen (f. 34)
8	mbi kë rëndonte gjaku i fëmijës (f. 33)	auf wen das Blut des Kindes kam (f. 42)
9	kërkoj pajtimin e gjakut (f. 39)	fordert die Versöhnung des Blutes (f. 51)
10	buka e gjakut të pajtuar (f. 40)	Mahl des versöhnten Blutes (f. 52)
11	pi një pikë gjak (f. 40)	einen Tropfen Blut trinken (f. 52)
12	të quheshin të pajtuar përjetë (f. 40)	dass man sich ewige Versöhnung gelobte (f. 52)
13	atëherë gjaku vazhdon (f.40)	dann wirkt das Blut fort (f. 53)
14	gjysma e gjakut ishte larë (f. 42)	die halbe Blutschuld ja bereits beglichen war (f. 54)
15	ta derdh atë grusht gjak (f. 43)	um dieses bisschen Blut zu vergießen (f. 56)
16	vigjëlonte që të mos shkelej kanuni (f. 44)	über den Kanun wachte (f. 58)
17	kur e ke bërë vrasjen (f. 48)	wann hast du deinen Mord begangen (f. 63)
18	sa ditë ke në gjak (f. 49)	wieviel Tage bist schon im Blut (f. 65)
19	dorëzohet si mik (f. 62)	als Gast einkehren konnte (f. 85)
20	i jam prerë mik (f. 62)	man habe seinen Gast geshädigt (f. 86)
21	që iu pre mik në besë të tij (f. 64)	der als sein Gast und unter dem Schutz seines Ehrenwortes geschädigt worden war (f. 86)
22	u fut në qerthullin e gjakmarrjes (f. 64)	er geriet in den Strudel der Blutrache (f. 86)
23	miku është gjysmëperëndi (f. 64)	der Gast für den Albaner ist Halbgott (f. 86)
24	…dhe të dorëzohet mik (f. 65)	und sich der Gastfreundschaft anvertraut (f. 87)
25	prerja e mikut në besë (f. 65)	wagt es also jemand, einen Gast anzurühren, der unter seinem Ehrenwort steht… (f. 88)
26	qenë vënë në ndjekje të gjakësit (f. 66)	hatten sich unverzüglich an die Verfolgung des Mörders gemacht (f. 89)
27	prek vegshin e vatrës (74)	den Kessel über dem Feuer verrücken (f. 98)
28	a ka pasur sherr të vjetër për këta kufij (f. 80)	Ist der Grenzstreit alt (f. 107)
29	sherri dhe gjaku s’janë mehur (f. 80)	Streit und Blutvergießen nehmen kein Ende (f. 107)
30	fajtori grihet katundisht (f. 81)	Geschieht ein Mord als Folge des Grenzverrückens, wird der Täter durch das Dorf hingerichtet. (f. 109)
31	shuhet sherri (f. 84)	Streit hört nicht auf (f. 112)
32	zhgulin gurët e vjetër (f. 88)	die alten Grenzsteine ausgraben (f.118)
33	kishte bërë vrasjen (f.92)	vor ein paar Tagen getötet hat (f. 123)
34	gjaku ndërron ngjyrë (f. 93)	das Blut verfärbt (f. 124)
35	e ka bërë vrasjen para 4-5 ditësh (f.93)	den Mord erst vor vier oder fünf Tagen begangen hat (f. 125)
36	mund të lahej me gjak (f. 95)	konnte nur durch Blut gesühndt worden (f. 128)
37	ta shkulim prej bjeshkëve të tij (f. 99)	aus seinem Mutterboden im Hochland Herauszureißen (f. 133)

38	shlyerjet nga të dyja palët (f. 113)	Tilgungen auf beiden Seiten (f. 152)
39	vrasja e larë me vrasje (f. 114)	Mord, vergolten mit Mord (f.152)
40	keni gjak për të shlyer (f. 114)	Ja, ihr habt Blut zu vergelten (f. 152)
41	qëllonte të humbte ndonjë gjak (f. 114)	passierte, dass ein Blut verlorenging (f. 153)
42	ajo ditë do të kishte mbetur pa gjak (f. 115)	ein Tag ohne jedes Blut, wäre…(f. 154)
43	desh mbeti pa vdekje (f. 116)	wäre beinahe ohne Tod geblieben (f. 154)
44	larja e vdekjes me vdekje (f. 116)	Tod sei nur mit Tod zu vergelten (f. 156)
45	nuk e kapte gjaku (f. 119)	die vom Blut nicht betroffen war (f. 159)
46	sikur graria të binte në gjak (f. 119)	Was wäre, wenn Frauen ins Blut fallen würden wie die Männer (f. 160)
47	Priftërinjtë nuk binin kurrë në gjak (f. 119)	Priester, die nie ins Blut fielen (f. 159)

Formula		
	Kadare: Prilli i thyer	*Röhm: Der zerrissene April*
1	i kthen trupin mbarë dhe i vendos pushkën te koka (f.10)	Dreht ihn auf den Rücken und legt ihm das Gewehr an den Kopf (f. 9)
2	Shtëpi quhet një kullë, një kasolle, a gjithçka tjetër, mjaft që të ketë caranin e vatrës e të qesë tym. (f. 22)	Ein Haus heißt Haus, wenn aus dem Schornstein einer Heimstatt Rauch aufsteigt. (f. 26)
3	Në shtëpi nuk hyhet pa thirrur e pa u përgjigjur kush. (f. 22)	Niemand darf ein Haus betreten ohne Zuruf und Antwort. (f. 26)
4	Udha duhet të jetë e gjerë sa shtiza e flamurit. (f.22)	Die Strasse muß so breit sein wie eine Fahnenschaft lang. (f. 26)
5	Në udhë kalon njeriu, kalon bagëtia, kalon i gjalli, kalon dhe i vdekuri. (f. 22)	Der Mensch benutzt die Strasse , und so auch das Vieh; der Lebende benutzt sie wie der Tote. (f. 26)
6	Shtëpia e malësorit është e zotit dhe e mikut. (f. 27)	Das Haus des Hochländers gehörte nach dem Kanun zuerst Gott und dem Gast und dann erst den Bewohner.. (f. 34)
7	I marrsha të ligat katundit dhe flamurit (f. 35)	“Ich will das Unheil vom Dorf und vom Banner nehmen!” (f. 45)
8	Dëbimi prej flamurit me rob e me robi (f. 36)	…wurden die Schuldigen mit Angehörigen und Besitz aus dem Banner ausgestoßen… (f. 47)
9	Heqja e armëve të krahut a të brezit për një apo dy javë (f. 36)	Die Waffen vom Arm oder Gürtel für eine oder zwei Wochen entziehen (f. 47)
10	Lidhja dhe burgosja në shtëpi (f. 36)	Im Haus binden und gefangen setzen (f. 47)
11	I vdekuri kërkon shpagim (f.38)	Der Tote fordert Vergeltung (f. 49)
12	Dy gisht nder në lule të ballit na i ka qitë i madhi zot (f. 38)	Zwei Fingerbreit Ehre auf der Blume der Stirn gab uns der Schöpfer 50
13	Pushkë të bukur paska qitë … ose pushkë të pabukur (f. 38)	Einen Schuß aus gutem Gewehr nannten es die Greise, wenn der Blutfeind von vorne in den Kopf getroffen wurde. Und einen Schuß aus schlechtem Gewehr, wenn die Kugel bauch oder Schenkel traf, gar nicht zu reden vom Rücken (f. 50)
14	Ia jepnin filxhanin e kafes për nën gju (f. 39)	Ihm die Kaffeetasse unter dem Knie hindurch reichen (f. 50)
15	Mos e thani lisin (f. 39)	Laßt die Eiche nicht verdorren (f. 51)
16	(foshnja) me jetë të gjatë e ta vraftë pushka (f. 59)	Ein langes Leben , und dass ein Gewehr dich töte (f. 79)
17	Fisheku me t’lumtë dora (f. 62)	Patrone der gesegneten Hand (f. 88)
18	buka m’u gjet për dreq (f. 72)	Das Brot sühnt den Schaden (f. 98)
19	Eshtrat e varrit dhe guri i kufirit nuk lozin kurrë (f. 81)	Totengebein im Grab und Grenzsteine rührt man nicht an (f. 108)
20	U mor me gjak e me kokë të lënë. (f. 82)	Das Land ist mit Blut und Totenschädel

		gewonnen. (f. 110)
21	Po rrejta, i mbajtsha në atë jetë gur e baltë në shpirt (f. 88)	Und belog ich euch, so sollen Stein und Erde noch im Jenseits auf meine Seele drücken (f. 118)
22	Gjaku lahet veç me gjak (f. 116)	…das Blut nie verlorengehe und nur durch Blut getilgt werden könne (f. 156)
23	Mos derdh gjak, se do të përgjakesh edhe ti pastaj (f. 116)	Wenn du fremdes Blut vergießt, bezahlst du mit deinem eigenen dafür (f. 156)
24	Gjaku, po zuri vitin e dymbëdhjetë, është si lisi, nuk e shkul dot kollaj. (f. 120)	Das Blut, wenn es ins zwölfte Jahr geht, ist wie ein Eichbaumm, den reißt man nicht mehr so leicht aus. (f. 160)

3.3 Në kufijtë e gjuhës. Funksioni ikastik i ligjërimit në romanin „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

3.3.1 Funksioni ikastik i gjuhës në tekstin letrar

Në këtë kapitull do të trajtojmë një dukuri tepër interesante, që luan rol të rëndësishëm në ndërtimin, në mesazhin e në analizën e tekstit letrar, dukuri, që është pak e trajtuar në gjuhësinë moderne.[371] Është fjala për funksionin ikastik të shenjave gjuhësore. Ky funksion ka të bëjë me paraqitjen e drejtpërdrejtë të realieve me anë të sinjifiantëve/ shenjuesve. Në një plan më të gjerë është fjala për relacionet midis shenjave materiale dhe „objekteve“ të shprehura prej tyre. Elementi ikastik mund të jetë një tingull, një fjalë, një fjali ose një bllok i tërë thëniesh. Ne do t’i qëmtojmë këto elemente në korpusin tonë, do t’i analizojmë dhe do të vëmë në dukje funksionin e tyre në tekstin letrar.
Problematika në linja të trasha është trajtuar që në lashtësi nga Platoni. Në dialogun „Kratylos“ ai trajton filozofikisht raportin midis tingujve dhe objekteve që ata shënojnë.
Objekt i vëzhgimeve tona do të jenë komponente formale, që me anë të organizimit specifik paraqesin ngjashmëri shkallësh e llojesh të ndryshme me realiet e shënuara, synojnë efekte estetike të veçanta. Është fjala për tingujt e të folurit, më gjerë për planin e shprehjes, efekti i të cilëve është i padyshimtë, përderisa ata janë gjurmë të trupit në gjuhë. [372] Një funksion të tillë shenjave gjuhësore ia njeh edhe gjuhëtari Xhevat Lloshi, i cili pohon se “i gjithë spektri i vetive të tingujve të gjuhës edhe ndërthurjet e tyre, denduria e shpërndarja fshehin mundësi për vlera shprehëse.”[373]

Me anë të veprimit të veçantë të shenjuesve mund të shprehet ajo që është e pathënshme. Mendimi mbi ndikimin estetik të planit të shprehjes vendos në fokus marrësin e mesazhit të tekstit letrar. Roli i tij në një tekst letrar është i një rëndësie të veçantë. Teoritë më të fundit mbi analizën e tekstit letrar, si ato hermeneutike, estetika receptive etj. i kanë dhënë prej kohësh marrësit të mesazhit vendin dhe statusin që i takon.
Vëzhgimet tona do të përqëndrohen në çështje, si:

[371] Edhe në gjuhësinë shqipe kjo dukuri është shumë pak e studiuar. Shih, për këtë, Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, Toena, 1999, f. 54.
[372] Shih, Schneider, Stefan, *Eine Studie zur Musikalität der Lyrik*, Berlin 2009.
[373] Shih, Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, Toena, 1999, f. 54.

- A kanë shenjat gjuhësore krahas kuptimit (dhe funksioneve që lidhen me kuptimin) edhe një funksion ikastik/evokativ që mbështet, plotëson dhe përforcon kuptimin?
- A mund të marrë shenja gjuhësore brenda tekstit funksion ikastik/evokativ?
- Ç'ndikim kanë strukturat me funksion ikastik në domethënien e në shprehësinë tekstore. Etj.

Problematika, sidomos gjatë trajtimit empirik, do të vendoset në një kuadër më të gjerë: në kuadrin e motivimit të shenjës gjuhësore. Shenjat e motivueshme e japin drejtpërdrejt realitetin, ato të pamotivueshme, e japin në mënyrë simbolike me anë të shenjuesit arbitrar/konvencional (khs.: hekurudhë me udhë: kuptimi i shenjës *hekurudhë* motivohet prej dy shenjave prej të cilave ajo përbëhet, *udhë* është e pamotivueshme).

Në veprën epokale të F. de Saussure „Cours de lingistique generale"[374] thuhet: „Raporti që lidh të shenjuarin me shenjuesin, është i çfarëdoshëm. Meqë shenja s'është veç një lidhje asociative midis shenjuesit dhe të shenjuarit, mund të thuhet që shenja gjuhësore është konvencionale." Teoria e Saussure-it e sundoi mendimin gjuhësor europian gjysmë shekulli. Studime që pranonin dhe të kundërtën, lidhjen e natyrshme midis shprehjes dhe përmbajtjes (rasti i onomatopeve etj.) nuk patën jehonë, duke u vlerësuar si të gabuara, ose që kishin një objekt tejet të ngushtë. Ishte tepër e vështirë të ngriheshe kundër tezës së Saussure-it mbi lidhjen shenjues – i shenjuar. Vetëm pas shumë vitesh guxoi gjuhësia të diskutonte ndryshe mbi raportin në fjalë. Në fillim u shfaqën zëra të veçantë: Benvenisti në vitin 1939, Spang Hanssen, 1954, Roman Jakobson, 1965. Në kritikën ndaj Saussure-it një rol të madh luajti ndikimi i veprës së Charles W. Morrisit.[375] Sipas Morrisit, një shenjues lidhet sipas rregullash semantike me të shenjuarin, dhe ndodh shumë rrallë që rregullat semantike të realizojnë lidhje arbitrare. Zakonisht ato synojnë të paktën një motivim të pjesshëm të formës nga përmbajtja. Motivimi mund të jetë ikastik/ ikonik ose indeks/simtomatik. Motivimi ikonik shfaqet në rastet kur shenjuesi dhe i shenjuari kanë ngjashmëri ose veçori të përbashkëta. Motivimi indeks del në rastet kur shenjuesi dhe i shenjuari vendosin midis tyre lidhje shkakore, hapësinore, kohore etj.[376]

Morrisi dhe Peirsi theksojnë gjithashtu që motivimi i shenjës nuk është i plotë, absolut, por relativ. Një mendim të tillë e hodhi madje dhe Saussure-i, çka shihet në një botim më të vonë të Kursit: „Shenja mund të jetë relativisht e motivuar."[377]

Përgjigjja e pyetjeve që lindin në këtë rast dhe trajtimi i çështjeve të tjera do të shoqërohet me argumente dhe ilustrime të ndryshme.

Dukuria e funksionit ikastik të gjuhës nuk do të vështrohet vetëm në planin imitues drejtpërdrejt të natyrës, por dhe në aftësinë evokuese të organizimeve të caktuara tingëllore. Këto do të përfshijnë dhe asociacionin si përqasje dy a më shumë elementesh të krahasueshme, që evokojnë e përforcojnë reciprokisht njëri-tjetrin.[378]

[374] Saussure, Ferdinand, *Cours de linguistique generale*, Lausanne und Paris, 1916, f. 100.
[375] Morris Charles, W., *Grundlagen der Zeichentheorie*, München, 1972.
[376] Shih, Morris Charles, W., *Grundlagen der Zeichentheorie*, München, 1972, f. 191.
[377] Saussure, Ferdinad, *Cours de linguistique generale*, Lausanne und Paris, 1931, f. 156.
[378] Shih, Bußmann, Hademud, *Lexikon der Sprachwissenschaft*, Stuttgard, 2002, f. 101.

Një mendim të tillë ndan edhe Lloshi, kur flet për tri lloje përftesash të vlerave shprehëse, emotive dhe estetike të tingujve të gjuhës dhe të ndërthurjeve të tyre.[379]

Kapitullin e kemi quajtur „*Në kufi të gjuhës“* për shkak se procedetë dhe instrumentet e shqyrtuara nuk kanë të bëjnë me kuptimin (denotativ, konotativ, gramatikor), por me një funksion tjetër të gjuhës, i cili realizohet jashtë kuptimit. Është si të thuash margjinal. Gjuha jonë e ndërtuar me fjalë dhe fjali të kuptimshme përbën një sistem. Brenda këtij sistemi ekzistojnë materiale dhe mundësi që, të organizuara, ndikojnë në forcën shprehëse të thënieve, pa u përfshirë në funksionimin e zakonshëm të njësive gjuhësore leksikore. Kështu ato rrezikojnë të dalin jashtë sistemit. Dukuri dhe mjete të tilla u largohen funksioneve leksikore-gjuhësore dhe bien në një terren kufitar, që është vështirë të përcaktohet. Ne do të merremi me përshkrimin dhe analizën e mjeteve të tilla si dhe me funksionet e tyre.

Një vend të veçantë në studimin tonë do të zërë paraqitja e mjeteve dhe funksioneve ikastike që kemi hasur dhe vërejtur në romanin e I. Kadaresë “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, teksti shqip dhe përkthimi gjermanisht.
Në kapitull do të kenë vendin e tyre dhe teoritë e mendimet e ndryshme që lidhen me këtë fushë, sigurisht ato më kryesoret.

3.3.2 Funksion ikastik i gjuhës që nga lashtësia

Diskutimet mbi funksionin ikastik të gjuhës shtrihen që nga lashtësia. Vepra e Platonit, “Kratili”, mbahet si fillimi i filozofisë gjuhësorë. Në bisedën letrare-fiktive marrin pjesë tre persona: Sokrati (mësuesi i Platonit), filozofi Kratil, dhe miku i tij Hermogjen. Tema e diskutimit është lidhja e emrave (shenjave) me objektet e emërtuara. Kratili është i mendimit që fjalët lidhen me sendet, rrjedhin nga natyra e sendeve. Hermogjeni mbështet hipotezën mbi lidhjen konvencionale midis emërtimeve dhe sendeve. Sokrati merret me diskutimin dhe vlerësimin e të dyja koncepteve. Pas vëzhgimit të premisave teorike dhe shembujve të shumtë, Sokrati arrin në përfundimin se në dhënien e emrave, të dukurive dhe objekteve ka konvencionalizëm, por dhe natyrshmëri. Kjo do të thotë që emërtimet e realieve janë bërë me marrëveshje, por përmbajnë dhe diçka nga sendi vetë, shprehin një esencë të tij. Dialoguesit janë të një mendjeje përsa i përket procesit fillestar të emërtimit. Ky proces është kryer nga një ose disa emravënës. Çështje e diskutueshme është nëse emrat janë të motivueshëm ose jo. Platoni flet për “vërtetësi” dhe mendon me këtë etimologjinë e fjalëve (greq. etimo = i vërtetë, i drejtë). Së pari, Sokrati përpiqet të gjejë argumente për të provuar pozicionin e Kratilit kundër Hermogjenit. Ai bën shpjegimin etimologjik të shumë fjalëve. Për fjalën *poseidon* ai paraqet disa etimologi:

Emri fillestar	Kuptimi fillestar	Shpjegimi	Përshtatja e tingujve
Posi- desmos	Pranga këmbësh	Deti pengon dikë, mban dikë që të mos lëvizë	Fjala paraqet ndryshime fonetike në të gjitha format e saj

[379] Shih, Lloshi, Xhevat, *Pragmatika dhe stilistika*, Tiranë, Toena, 1999, f. 54.

Polla eidos	Që di shumë	Zoti di shumë	
[h]o seidon	Tronditës	Poseidoni shkakton dhe tërmetet	

Çështja e diskutuar midis Kratilit dhe Hermogjenit shfaqet kështu në dy variante:

- Shenjat janë krejt konvencionale
- Shenjat janë krejt të motivueshme

Formulime të tilla përjashtojnë njëra-tjetrën, prandaj Sokrati synon drejt një kompromisi me të dyja palët. Në bisedën e tij me Hermogjenin, Sokrati thekson kufizimin e arbitraritetit të shenjës. Sokrati sqaron se konvencioni i propozuar nga Hermogjeni nuk mund të jetë krejt arbitrar. Gjithçka në një send i përgjigjet esencës së tij, po kështu dhe emri. Sokrati operon me etimologjinë e shumë fjalëve për të provuar vërtetësinë e tezës që shenjat gjuhësore janë të motivueshme, jo konvencionale. Ai analizon etimologjikisht një sasi fjalësh, etimoni i të cilave rezulton një fjalë onomatopeike, e motivueshme. Ky fakt e kufizon vërtetësinë e thënies se shenja gjuhësore është krejt arbitrare-konvencionale.

Në bisedën e tij me Kratilin, Sokrati thekson idenë që ikoniciteti nuk është absolut, por i kufizuar. Me termin ikonicitet kemi emërtuar shenjën e motivueshme. Kratili mendon që emërvënësi fillestar i ka shenjuar sendet duke u nisur nga qenia, esenca e tyre. Sokrati e vë në diskutim këtë ide, duke arsyetuar se nga emri nuk mund të mësojmë gjithçka për sendin. Na duhet ta studiojmë atë në shumë pikëpamje.

Çështja e asociacionit *i shenjuar-shenjues*, e motivimit ose e arbitraritetit të shenjës gjuhësore përbën edhe sot një nga problemet themelore të gjuhësisë.[380]

Coseriu ishte ndër linguistët e parë që studioi një funksion të veçantë të shenjës gjuhësore në tekst në veprën e tij „Textlinguistik”. Që në fillim të kapitullit, ai thotë:

> *„Wir wollen uns nun einer Art von Relationen zuwenden, die für den Aufbau des Sinns im Text sehr wichtig sein kann, der jedoch in der modernen Linguistik ledier nur sehr geringe Aufmerksamkeit geschenkt wird. Es geht um die ikastische Funktion des Zeichens, um die direkte Nachachmung der bezeichneten Sache durch das Signifiant eines einzelnen Zeichens bzw. durch die Signifiants eine Zeichenkette; letztendlich also um die Relation zwischen den materiellen Zeichen, d.h. den Zeichenträgern, und den bezeichneten Sachen.“*[381](Tani t’i drejtohemi një lloj lidhjeje, që mund të jetë tepër e rëndësishme për ndërtimin e kuptimit të tekstit, por, që gjuhësia moderne i ka kushtuar një vëmendje minimale. Është fjala për funksionin ikastik të shenjës, për imitimin drejtpërdrejt të objektit të shënuar me anë të shenjuesit të një shenje të vetme ose të shenjuesve të një varg shenjash; së fundi, është fjala për lidhjen midis shenjave materiale, bartësve shenjorë dhe objekteve të shenjuara.)

Coseriu e analizon dukurinë në disa aspekte. Së pari, përqëndrohet në planin e shprehjes, në substancën e shprehjes. Fillon me përshkrimin e imitimit me anë të onomatopeve. Gjuha me natyrën e saj tingëllore është në gjendje të imitojë zërat dhe zhurmat e natyrës. Por, vëren Coseriu, edhe në rastin e tingullimitimeve nuk kemi ngjashmëri absolute. Edhe në këtë rast tipik për imitimin e botës me anë të tingujve gjuhësorë, ligji i arbitraritetit të shenjës nuk thyhet krejt. Coseriu dhe autorë të tjerë,

[380] Informacionin mbi dialogun “Kratil” të Platonit e kemi marrë nga: Arens Hans, Sprachwissenschaft, der Gang ihrer Entwicklung von der Antike bis zur Gegenwart, I, Fischer Verlag, 1969, f. 3-12.
[381] Coseriu, Eugenio, *Textlinguistik*, Tübingen, 1994, f. 111.

që janë marrë me këtë çështje, bëjnë fjalë për realizimin e një ngjashmërie relative. Kështu, funksioni ikastik i shenjës do vështruar në të shumtën e rasteve si dukuri relative.
Për Coseriun, konteksti luan një rol të rëndësishëm në manifestimin e ikonicitetit të shenjave gjuhësore. Ndodh shumë shpesh, thotë ai, që një shenjë nuk ka asnjë funksion ikastik në gjuhë, por në tekst e fiton një të tillë. Këtë mendim e ilustron me një varg të poetit latin Ennius:

At tuba terribli sonitu tarantatara dixit[382]

Përkthimi pak a shumë është ky: Dhe një trumpetë me zë të frikshëm bënte *tatarata*.

Në këtë varg ikastik është vetëm fjala *tarantatara* si imitim i tingujve që nxjerr trumpeta. Fjala *tuba* (trumpetë) është në një farë mënyre në gjuhë fjalë onomatopeike. Në vargun e Enniusit të gjitha fjalët mbartin, shprehin diçka imituese. Kjo realizohet me anë të aliteracionit, me anë të përsëritjes së *t-së* në çdo fjalë të vargut, madje dhe në lidhëzën *at* (por). I gjithë vargu është ikastik.
Coseriu jep dhe shembuj të tjerë, ku fjalët nuk kanë në vetvete forcë, veçori ikastike, por e fitojnë atë në tekst. Ai citon, p.sh., një varg të një poeti kroat (Nazor). Unë po jap këtu përkthimin gjermanisht, për ta përkthyer pastaj në shqip:

und (es) zirpt, zirpt (die) Zikade, auf (der) Verzweigung der schwarzen Pinie
(dhe këndon, këndon gjinkalla në degën e pishës së zezë…)

Në vargun e cituar, asnjë element nuk është drejtpërdrejt ikastik. Edhe fjalët me origjinë onomotopeike (zirpen, Zikade) janë gramatikalizuar dhe kanë humbur diçka nga funksioni ikastik. Ndërsa fjalët e tjera nuk janë as direkt, as indirekt ikastike. Por në këtë varg, për shkak të substancës fonike, ato evokojnë këngën e gjinkallës. Kështu, shenjat gjuhësore mund të mos jenë ikastike, por bëhen të tilla në tekst.
Nëse do t’i grumbullojmë dhe shqyrtojmë së bashku çështjet pro dhe kundër ndikimit të substancës fonetike në kuptimin e shenjës gjuhësore, do të rezultojë kjo problematikë, e do të lindin pyetje të tilla:

- A mund të shpjegohet kuptimi i shenjës gjuhësore me përbërjen e saj tingëllore?
- A mund të paraqesë shenja gjuhësore funksion ikastik krahas kuptimit të saj?
- A mund të marrë në tekst një funksion të tillë, kur jashtë tekstit nuk e ka atë?
- A ka të njëjtin funksion ikastik shenja edhe në përkthim?

Për pyetjen e parë, Coseriu thotë: përgjigjja mund të jetë pozitive ose negative.

Për pyetjen e dytë, përgjigjja është:

„*Diese Annahme kann nicht kategorisch abgelehnt werden.*“ (Pohimi nuk mund të refuzohet kategorikisht.)

Për çështjen e tretë, ai thotë:

[382] Ennius, Annalen, 140.

„An dieser letzten Annahme kann nicht der geringste Zweifel bestehen…dies sehr wohl der Fall sein kann." (Nuk ka pikë dyshimi në vërtetësinë e një pohimi të tillë… kjo gjë mund të ndodhë shumë shpesh.)

Këtë tezë të Coseriut, mbi funksionin ikastik të fituar brenda tekstit, e kemi shfrytëzuar shpesh në argumentimet e në analizat tona. Në funksionin imitues të prodhuar në tekst, zakonisht, marrin pjesë sekuenca shenjash dhe jo një shenjë e vetme. Kështu, në vargun e sipërcituar nga Ennius-i, lidhëza *at* (dhe, por) nuk do të kishte asnjë funksion ikastik, nëse vargu nuk do të përmbante fjalë të tjera që kanë të gjitha në përbërje tingullin *t.*
Vlen të vihet në dukje që disa nga shembujt e zgjedhur për ilustrim nga Coseriu, të përkthyera në shqip, nuk manifestojnë funksione ikastike.
Në vëzhgimet e tij Coseriu trajton dhe dukurinë e sinestezisë, që rezulton nga kombinimi i dy mënyrave perceptuese: shikimi dhe dëgjimi. Si ilustrim të kësaj dukurie, për të shpjeguar forcën evokuese të saj, Coseriu sjell një varg të famshëm të poetit Luis de Gongora:

> *infame turba de nocturnas aves*[383]

Përkthimi në gjermanisht thotë: *Ruchlose Schar von nächtlichen Vögeln* (Tufa e paqetë e zogjve të natës)
Shfaqja dy herë e rrokjes *tur* (turba, nocturnas) krijon përshtypjen e errësirës. Përjetimi sinestezik realizohet me anë të fqinjësisë së pjesëve të njëjta të shenjuesve të ndryshëm.
Në një paragraf përmbledhës Coseriu shkruan:

> *„Überall dort, wo es um die Nachahmung durch ein Zeichen kraft seiner phonischen Substanz geht – sei es die unmittelbare Nachahmung durch das Lautbild, die mittlelbare durch die Artikulation oder die synästhetische Nachahmung, – hat man zwischen der potentiellen ikastischen Funktion in der Sprache und der aktuellen ikastischen Funktion im Text zu unterscheiden. Wo die historische Bedeutung eines Zeichen und seine potentielle ikastische Funktion scheinbar überhaupt nichts zu tun haben, kann im Text schliesslich doch ein Bezug hergestellt werden."*[384] (Kudo që shfaqet imitimi me anë të substancës fonike të një shenje, qoftë tingullimitim direkt, qoftë imitim indirekt me anë të artikulacionit ose imitim me anë të sinestezisë, duhet bërë dallimi midis funksionit ikastik potencial në gjuhë dhe funksionit ikastik aktual në tekst. Edhe në rastet kur kuptimi (historik) i fjalës nuk ka në dukje asnjë lidhje me funksionin e saj potencial ikastik, mund të vendoset në tekst një lidhje e tillë.)

Në një paragraf të veçantë Coseriu trajton dhe çështjen e imitimit me formën e shprehjes (sipas terminologjisë dhe koncepteve glosematike të Hjelmslevit):

> *„Nun hat der Ausdruck des Zeichens jedoch auch eine Form. Unter „Form des Zeichens", „Ausdrucksform" hat man im engeren glossematischen Sinn zunächst den systematischen Ort zu verstehen, der jedem zeichenhaften Element im gesamten Gefüge von Oppositionen im Bereich des Ausdrucks einer Sprache zukommt."*[385] (Shprehja e shenjës ka dhe një formë. Me formë të shenjës, formë të shprehjes, në kuptimin glosematik, do të kuptojmë, së pari, zonën e tingujve, ku një gjuhë e caktuar zgjedh opozicionet që do të përcaktojnë sistemin fonologjik.)

Me fjalë të tjera, Hjelmslevi përfshin në planin e formës së shprehjes fonologjinë, dukuritë fonologjike.

---

[383] Coseriu, Eugenio, *Textlinguistik*, Tübingen, 1994, f. 117.
[384] Coseriu, Eugenio, *Textlinguistik*, Tübingen, 1994, f. 118
[385] Coseriu, Eugenio, *Textlinguistik*, Tübingen, 1994, f. 118.

Coseriu përmbledh në formën e shprehjes edhe aspekte të tjera, si ato mbisegmentore. Edhe këto veçori luajnë rol në përmbajtjen e teksteve, sidomos atyre poetike. P.sh.: një ritëm i shpejtë në rrjedhën e ligjërimit evokon shpejtësinë reale.
Në veprën e tij „Stilistika dhe pragmatika“ Xhevat Lloshi i grupon vlerat shprehëse, emotive dhe estetike të tingujve të gjuhës në tri përftesa, të cilat mbështeten në variacionet tingullore, organizimet tingullore dhe lidhjen e tyre me kuptimin. Në secilin grup numërohen nëngrupe. Aspektet gjuhësore të përmendura lidhen edhe në trajtimin e tij jo vetëm me tingujt, si shqiptimi, por edhe me ato mbisegmentore, si ritmi. Një grup të veçantë përbën edhe simbolizmi tingullor, i cili ka të bëjë me shoqërimet tingull-kuptim.[386] Ai shton, se dukuritë që lidhen me funksionin ikastik të gjuhës prekin jo vetëm poezinë, por edhe prozën.

Në punimin tonë ne jemi mbështetur gjerësisht dhe në mënyrë krijuese në konceptet e Coseriut mbi raportin e substancës dhe formës tingullore (të shprehjes) me kuptimin e shenjës, si dhe në konceptin e tij mbi aftësinë dhe forcën evokuese si dukuri ikastike.

Koncepti i Stefan Schneiderit mbi muzikalitetin në gjuhën e poezisë jepet në mënyrë sinjifikative me thënien:

> „Niemand wundert sich, wenn wir eine Sprache als klangvoll bezeichnen. Die Forschung ist hier weniger sicher.“[387](Askush nuk do të çuditet, nëse gjuhën do ta quajmë tingëlluese. Kërkimet këtu nuk janë të sigurta.)

Shprehja e mësipërme është një nga hipotezat e punimit të S. Schneiderit. Në këtë punim, ai përpiqet të provojë e të argumentojë hipotezën në fjalë.

3.3.3 Pasthirrmat dhe onomatopetë

Teoritë mbi origjinën e gjuhës të shekullit të 18-të referojnë gjithnjë te pasthirrmat dhe onomatopetë. Këto forma të shprehjes afektive trajtohen si shenja të gjalla vokale, si mbeturina të një periudhe paragjuhësore të kohës sonë gjuhësore.[388]

Një trajtim të veçantë u bën këtyre mjeteve gjuhësore Charles de Brosses në „Traite de la formation mechanique des langues“.
G. Genette e ka trajtuar çështjen në formë reflektimesh mbi këtë grup shenjash të motivueshme. Këndvështrimi i tij është historik. Ai i analizon këto elemente duke filluar nga *Kratili* i Platonit deri në teoritë gjuhësore e teorike të shekullit të 20-të.[389]
Implikacionet gjuhësore e teorike të këtij grupi janë bërë disa herë objekt studimi në gjuhësinë moderne.

Por nuk mund të merresh me studimin e kësaj klase pa u ndalur veçanërisht në mendimin e në analizat e Rousseau-it. [390] Mendimi i Rousseau-it mbi këtë çështje rrjedh si diskutim e si kundërvënie ndaj teorisë shumë të përhapur në atë kohë të Charles de Brosses. Ky i fundit ishte president i parlamentit të Dizhonit. Në vitin 1751 de Brosses mban dy referate para Akademisë së Shkencave të Bukura. Referatet

[386] Shih, Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, Toena, 1999, f. 54, 59.
[387] Schneider, Stefan, *Eine Studie zur Musikalität der Lyrik*, Berlin 2009, f. 9.
[388] Shih më hollësisht, Trabant, Jürgen, *Historische Antropologie der Sprache*, Frankfurt am Main, 1998, f. 115
[389] Shih, Genette, Gérhard, *Figures*, Paris, 1976, f. 205- 221.
[390] Shih, Rousseau et Voltaire en 1978, *Actes du Colloque international de Nice*, Geneve/Paris 1981.

merreshin me çështje etimologjike. Këto punime u bënë burime të shumë shpjegimeve teorike të enciklopedisë franceze. Sidomos në shpjegimin e termave *pasthirrmë* dhe *onomatope* jepen pjesë të tëra nga referatet e presidentit. Në formë të botuar mendimet mbi klasat e përmendura gjenden në përmbledhjen „Traite de la formation mechanique des langues et des principes physiques de l’etimologie“[391]

Autori, Ch. de Brosse thotë se dorëshkrimi i një vepre të tillë ekzistonte shumë vite para botimit; gjatë kësaj kohe kishte kaluar dorë më dorë ndër njerëzit e botës së letrave. Edhe Rousseau-i e ka njohur materialin e de Brosse-it para se të botohej. Në veprën e vet “Essais sur l’origine des langues” ai i referohet edhe de Brosse-it për çështjen e pasthirrmave dhe onomatopeve, madje vërejtjet e tij në këtë fushë janë një distancim i ndërgjegjshëm ndaj pozicionit të de Brosse-it.
Ch. De Brosse dhe pasuesi i tij N. Beauzée theksojnë veçanërisht natyrshmërinë dhe karakterin fizik njerëzor të këtyre klasave. Ja si shprehet Beauzée:

> “Les interjections sont des expressions dy sentiment dictées par la nature, et qui tienne a la constitution physique de l’organe de la parole: la meme espece de sentiment doit donc toujours operer dans la meme machine de meme mouvement organique et produire constamment le meme mot sous la meme forme.”[392] (Pasthirrmat janë shprehje të ndjenjave të diktuara nga natyra që realizohen në sajë të ndërtimit të organit të të folurit: e njëjta ndjenjë kërkon të njëjtin veprim të “makinës” njerëzore, të njëjtën lëvizje të organeve të të folurit. Për të njëjtën ndjenjë prodhohet e njëjta fjalë me formë të njëjtë.)

Funksioni i pasthirrmave ka të bëjë me shfaqjen e ndjenjave, shprehjen e tyre. Ato janë “language du coeur” (gjuha e zemrës). Për të dy autorët e sipërpërmendur pasthirrmat janë shenja të pastra natyrore, që manifestojnë reaksione trupore të domosdoshme. Ato rezultojnë nga organet e të folurit, që kanë një ndërtim të caktuar.
Një pranim i tillë shpall jo drejtpërdrejt natyrën e tyre universale. I njëjti ngacmim do të sillte kudo dhe gjithnjë të njëjtin reaksion trupor, të njëjtën formë tingëllore.
Lidhjen midis natyrores, trupores dhe universales në rastin e pasthirrmave e thekson edhe Ch. De Bross në „Traite de la Formation mechanique des langues et des principes physiques de l’etimologie“:

> “Elles n’expriment pas des objets exterieur, mais des affections interieurs”[393](Ato nuk shprehin objekte të jashtme, por ndjenja të brendshme.)

Edhe Ch. De Brosse-i pranon që pasthirrmat kanë natyrë afektive, ato rezultojnë nga raporte fizike midis ndjenjave shpirtërore dhe pjesëve të instrumentit vokal. Ky raport është identik kudo që ka njerëz me aparat folës

3.3.4 Efekte ikastike-evokative në “Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

Në paragrafët, që vijojnë, do të bëjmë një analizë të romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”. Në fakt, analiza do të jetë një interpretim i mbështetur në funksionin ikastik

[391] Shih, Raymund, Wilhelm, *Die Sprache der Affekte*, Tübingen, 2001, f. 254. Në këtë vepër trajtohen pikëvështrimet e autorëve, si: N. Beauzee, Ch. de Brosses mbi çështjen e gjuhës së afekteve, mbi funksionin dhen natyrën e shenjave gjuhësore (onomatoveve, pasthirrmave) që shprehin afekte.
[392] Beauzee, Nicolas, Grammaire, botuar në, Encyclopedie francaise, VII, 1757, “Interjection”, f. 827 – 829. Ne nuk kemi pasur në dorë burimin origjinal të thënies së mësipërme, por e kemi nxjerrë atë nga një studim voluminoz dhe shumë interesant: Raymund, Wilhelm, *Die Sprache der Affekte*, Tübingen, 2001, f. 262.
[393] Cituar sipas, Raymund, Wilhelm, Die Sprache der Affekte, Tübingen, 2001, f. 257

të shenjave gjuhësore. Ne do ta zbulojmë mesazhin e tekstit duke hetuar e shpjeguar elementet gjuhësore që paraqesin veçori ose forcë ikastike (ikonicitet). Si të tilla do të trajtohen tingujt, grupet e tingujve që shenjojnë e shprehin drejtpërdrejt zhurma e dukuri të tjera të realitetit që lidhen drejtpërdrejt me to, pa ndërmjetësimin e kuptimit etj. Të tilla janë: onomatopetë, fjalët onomatopeike, pasthirrmat, aliteracioni, etj. Forcë ikastike do të konsiderohet edhe aftësia e veçantë evokuese, paraqitëse, vizatuese e mjeteve gjuhësore. Këtu përfshihen dhe asociacionet si mjete shpjegimi e theksimi, etj.

Manovrimet gjuhësore fillojnë me punën në boshtin e zgjedhjeve. Nga bazamenti zgjidhen ato fjalë e mjete gjuhësore që paraqesin e përçojnë në mënyrë realiste-natyraliste pjesët përbërëse të spektaklit. Zgjedhja është vetëm njëra anë e manovrimit. Ajo pasohet nga kombinimi. Gjatë kombinimit lindin mundësi e vlera të tjera paraqitëse e shprehëse. I. Kadareja është model i rrallë në punën e zgjedhjeve në sistem dhe kombinimit në ligjërim. Pas zgjedhjes e kombinimit lindin gjithëfarë peizazhesh, portretesh e përshkrimesh, që referojnë gjallërisht në realitet, që ndikojnë te marrësi si të ishin dukuri vitale të botës sonë. Madje ndodh që ndikimi i tekstit letrar të jetë më i fortë se ai i ndodhive të ndryshme të realitetit.

Për të realizuar synimin tonë analizues, mbështetur dhe në ikonicitetin e mjeteve gjuhësore, kemi dalluar disa komponente letrare të tekstit të I. Kadaresë. Këto komponente janë shtresa të materialit letrar ose plane, ku shpaloset mendimi letrar, stili, atmosfera e tablove të ndryshme. Elemente të tilla rriten së bashku e formojnë një unitet përmbajtjesor. Në bazë të përdorimit e funksionit të mjeteve gjuhësore me funksion ikastik kemi dalluar këto rrafshe:

- *Peizazhe natyrore*
- *Peizazhe psikologjike*
- *Peizazhe tingëllore*
- *Portrete*

Çështjet do të analizohen duke evidentuar elementet ikastike, forcën ikastike (ikonicitetin) dhe funksionin e tyre.

3.3.4.1 Peizazhe natyrore

Një përbërëse e rëndësishme letrare e tekstit të I. Kadaresë është peizazhi natyror. Natyra zë një vend të rëndësishëm në këtë roman, jo vetëm si sfond, por dhe si skenë e si atmosferë, që i mban dhe i shoqëron figurat në veprimet, bëmat dhe gjendjet e tyre. Në emër të autenticitetit e të stilit lirik, I. Kadareja ndalet gjatë në përshkrimin, në “pikturimin” e natyrës. Midis rrëfimeve, ligjërimeve, dialogëve, veprimeve, paraqitjeve psikologjike ndërhyn shpesh peizazhi natyror, nganjëherë dhe papritur. Kështu alternohen planet paraqitëse, kalohet nga tablotë e bëmave e gjesteve njerëzore në përshkrime të natyrës:

- Na e vranë, - ia bëri njëri me zë të ngashëryer. – Na e vranë Reizin.
- *Letra e serës kërciste mbi çati.*[394]

[394] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 162.

Këmbime të tilla të pamjeve janë, madje, veçori të stilit të I. Kadaresë. Efekti është i padyshimtë. Dhimbja e pamasë njerëzore, e shprehur edhe nga epiteti *të ngashëryer* vendoset në një sfond natyror të shqetësuar, që e përcjell atë më të plotë e pa kufi. Sfondi natyror që shoqëron dhimbjen njerëzore e fiton forcën e tij evokuese përmes përsëritjes, në thënien përshkruese, të bashkëtingëlloreve mbylltore, të pazëshme, ndërdhëmbore *t* dhe *s* dhe alternimeve të tyre, tingullimitime këto të kërcitjes së letrës së serës.

Në gjermanisht përkthehet:

> “Sie haben unseren Reiz umgebracht”, sagte einer, höchst erregt, “sie haben ihn uns weggenommen.”
> *Die Dachpappe schlug gegen die Bretter*.[395]

> “*Der Fetzen Teerpappe klatschte in unregelmäßigen Rhythmus auf das Dach.*
> Was haben sie uns bloß angetan”, sagte einer mit brüchiger Stimme. “Sie haben uns Gjoleka genommen." [396]

Përkthyesit përpiqen të transmetojnë strukturat gjuhësore të shqipes me po atë forcë evokuese edhe në gjermanisht. Përshkrimi i dhimbjes njerëzore nuk është i njëjtë në të dyja versionet në gjermanisht. O. Buchholz-i dhe W. Fiedler-i përdorin epitetin *erregt*, shqip, *i shqetësuar*, i cili ndryshon në përcaktimin e shkallës së dhimbjes dhe përjetimit të saj, krahasuar me origjinalin në shqip, *të ngashëryer*. Ndryshime në ngjyrimet kuptimore ka edhe midis variantit në gjermanisht *wegnehmen*, shqip *marr* me foljen e përdorur nga Kadareja *vras.*
Ndërsa përzgjedhja nga J. Röhm-i i epitetit *brüchig*, shqip *i mekur* dhe kombinimi i tij me emrin *Stimme*, shqip *zë*, është më afër origjinalit të Kadaresë; strukturat gjuhësore të shprehjes së thënies mbi vdekjen e Reizit janë më larg origjinalit. J. Röhm-i përdor formën pyetëse, “Çfarë na kanë bërë”. Devijimi tjetër i pashpjeguehëm nga origjinali është edhe ndryshimi i emrit nga Reiz në Gjoleka.

Përsa i përket strukturave të tjera me vlerë evokuese në këtë pasazh, mund të themi se në të dyja variantet në gjermanisht përsëritja e tingujve të pazëshëm, ndërdhëmborë, si: t, f, p, sh evokon një sfond natyror, po kaq të shqetësuar sa edhe ndjenjat e njerëzve, si në shqip.

Ajo që na intereson konkretisht në këtë paragraf (në pajtim me objektin), është funksioni ikastik i ligjërimit, roli i mjeteve të ndryshme në realizimin e këtij funksioni. Por edhe fakti, që poeti-prozator I. Kadare e vë në objektiv natyrën, ndalet me vëmendje e përkushtim në përshkrimin/pikturimin e saj, duke i dhënë forcë të paparë evokative: është një shfaqje e karakterit ikastik të paraqitjeve natyrore. Teksti fiton vizatimin, ngyrat e tonet e pikturës:

> Rri dhe vështroj *ujin e qetë*, që rrjedh, duke marrë me vete herë *një gjeth*, herë një *shkarpë*, herë *asgjë*, vetëm ca *pasqyrime*. [397]

[395] Buchholz, Oda /Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f.154.
[396] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 196.
[397] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 106.

Gjermanisht:

> Ich sitze da und schaue auf das ruhig *dahinfließende Wasser*, das manchmal *ein Blatt* oder *einen Zweig* mit sich führt, manchmal aber *gar nichts* außer ein paar *Spiegelbildern.*[398]

> Dann sitze ich da und schaue auf *das Wasser*, das *bedächtig dahinströmt* und manchmal *ein Blatt* mitnimmt ab und zu auch *einen Zweig*, meistens aber nur ein paar *Spiegelbilder.*[399]

Vetëm një sy artisti mund të rrokë e të japë me besnikëri peizazhe të tilla. Karakteri ikastik (ose ikoniciteti) ka të bëjë, së pari, me tërë skenën e rrjedhjes së ujit. Lexuesi tronditet, kur gjendet para teksteve të tilla, që pikturojnë me gjuhë. Peizazhi të merr me vete e të hedh atje, ku një vijë uji rrjedh përmes pyllit. Është forca evokuese e ndërtimeve të tilla që të lë të mahnitur. Elementet e veçanta: *gjeth, shkarpë, asgjë, pasqyrime* të renditura në varg referojnë në realitet drejtpërdrejt dhe jodrejtpërdrejt me forcën pasqyruese dhe evokuese. Te I. Kadareja, vargjet e fjalëve, kudo që shfaqen, mbartin gjithnjë një aftësi lidhëse-referuese ndaj realitetit, një forcë evokuese të padyshimtë.
Përshkrimi i natyrës, realizimi i tablove natyrore bëhet në mënyrë realiste ose në mënyrë impresioniste. Secila mënyrë paraqitjeje implikon një koncept mbi botën me mjetet gjuhësore specifike stilistike. Koncepti realist mbi përshkrimin e natyrës kufizohet ose shpesh përzihet me konceptin natyralist dhe atë impresionist.
Peizazhi i mësipërm paraqitet në ditarin e një ushtari dezertor. Un-i rrëfyes përshkruan natyrën e soditur nga një pikëvështrim statik. Në një kornizë hapësinore vendosen disa elemente: *vijë uji, gjeth, shkarpë, asgjë, pasqyrime*. Mënyra e lidhjes dhe e shprehjes së tyre arrin të japë dhe lëvizjen, gjendjen reale të një rrëkeje që rrjedh qetësisht dhe mbart gjithëfarësoj prurjesh. Realiteti i “vizatimit” plotësohet nga leksema *pasqyrime* që nënkupton një rrafsh tjetër, sfondin e tablosë. Pasqyrimet lidhen me objektet përreth: *pyllin, qiellin, malin*, etj.

Leksemat gjegjëse në variantin e O. Buchholz/ W. Fiedler-it evokojnë peizazhin natyror me leksema që, përsa i përket shkallës së ekuvalencës, janë shumë afër origjinalit. Dallimet në ngjyrimet kuptimore, midis *vijë uji* dhe *dahinfließendes Wasser*, shqip *uji që rrjedh përtej* dhe *ein Blatt*, shqip, një gjethe, nuk e zbehin forcën evokuese të shprehjes së lëvizjes së qetë të një rrëkeje uji, që të tërheq për gjithfarë meditimesh, edhe në variantin në gjermanisht.

Në variantin e J. Röhm-it mungon elementi gjuhësor *asgjë,* i shprehur në gjermanisht. Në këtë mënyrë forca evokuese e mjeteve gjuhësore për të shprehur qetësinë e ushtarit dezertor në meditim nuk përforcohet, si në variantin shqip.

Shembuj të tjerë: Pikturim me anë të gjuhës

> Hëna, që gjer tani ishte munduar më kot të dilte, po e *kullonte* dritën e saj nëpër shtresat e *sfungjerta* të reve e të mjegullës, dhe retë *të ngopura e të njomura* prej saj, pa mundur ta mbanin më, kishin filluar ta *pikonin* dritën ngadalë, qetësisht e në mënyrë uniforme, nëpër skajet e horizonteve dhe mbi gjthë fushën e pamatë. Tani qielli dukej *si i lyrshëm* dhe, bashkë me të, horizontet, fusha dhe xhadeja ngjanin *sikur ishin të pikuar me qumësht*.[400]

[398] Buchholz, Oda /Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 103.
[399] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 132.
[400] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 47.

Gjermanisht:

> Dem Mond war es bisher noch nicht gelungen, durch Wolken und Nebelschwaden zu dringen, doch nun strahlte er plötlich auf, und die Wolken, prall und übervoll von seinem Licht begannen langsam, ruhig und gleichförmig seinen Widerschein über den Horizont und über das Weite Tal zu gießen. Jetzt wirkte der ganze Himmel wie mit Sahne übergossen, und gleichzeitig sahen der Horizont, das Tal und die Straße aus, als seien sie mit milchigen Tropfen übersät.[401]

> Nachdem der Mond sich lange vergeblich bemüht hatte, durch die Wolken und den Nebel zu dringen, goß er sein Licht in die schwammigen Schichten hinein, bis sie davon getränkt waren und es nicht mehr halten konnten, und ein sanfter, gleichmäßiger Schimmer sich in dem weitem Raum ausbreitete. Der Himmel wirkte wie eingefettet, und der Horizont, die Ebene und die Landstraße, als hätte man sie mit Milch übergossen.[402]

Bukuria e peizazhit është mahnitëse. Soditësi e rrok peizazhin nga toka. Tabloja shpaloset e madhërishme dhe e paanë që nga qielli e deri poshtë në fushë e në xhade. Peizazhi i parë i përket kohës kur misionarët italianë kërkonin eshtrat e ushtarëve të rënë në Shqipëri. Menjëherë pas këtij përshkrimi piktoresk vijon një paraqitje tjetër e ngjashme, paraqitja e një nate me qiell e me hënë misterioze. Asociacioni na hedh menjëherë para 20 vjetësh. Ndërsa në rastin e parë soditësi i peizazhit është vetë lexuesi, në rastin e dytë soditësi drejtpërdrejt është një ushtar, një personazh anonim i romanit. Të dyja pjesët përshkruese lidhen me asociacion.

> Qëllonin netë të tilla vjeshte kur qielli bëhej i padurueshëm, i fundosur i tëri në dritën indiferente, *të përqarë* e irrituese të hënës. Rrinim shtrirë në tokë dhe, me siguri, secili mendonte: Ç’është ky qiell kështu, *nëna ime!*[403]

Gjermanisht:

> Es gab Herbstnächte, in denen der Himmel unausstehlich war und vollkommen im gleichgältigen, *trostlosen* und irritierenden Licht des Mondes versank. Wir lagen ausgestreckt auf der Erde, und gewiß dachte jeder: „*O Gott*, was für ein Himmel![404]

> Es gab Herbstnächte, in denen einem der Himmel unerträglich wurde, ertrunken in dem *höhnischen*, heruasfordernden und verletzden Licht des Mondes. Wir lagen ausgestreckt auf dem Boden, und wahrscheinlich dachte jeder: *Bei meiner Mutter*, was ist bloß für ein Himmel?[405]

Referimi me asociacion në një tablo të ngjashme të së shkuarës e përforcon vërtetësinë dhe forcën ndikuese të dukurive astronomike të pikturuara gjuhësisht. Nëse do të shtrohej pyetja: si realizohet ikoniciteti në dy pasazhet e paraqitura, përgjigjja do të ishte:

- Me anë të përshkrimit tejet të detajuar e romantik, paraqitja të kujton një pikturë.
- Me anë të figuracionit (metafora: kulloj dritën, pikoj dritën; epitete: e sfungjerta, retë e njomura, qiell i padurueshëm; krahasime: si i lyrshëm, sikur ishin të pikuar me qumësht). Figurat shquhen për forcën evokuese.
- Me anë të pasthirrmës: *nëna ime*!

[401] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 44.
[402] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 60.
[403] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 47
[404] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 44-45.
[405] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 60-61.

- Personifikimit (re të ngopura, dritë e përqarë/ indiferente).

Nëse do t`i përqasnim mjetet me anën e të cilave realizohet ikoniciteti në shqip me ato që përdoren në gjermanisht, do të vërejmë se:

- përshkrimi është po kaq i detajuar dhe romantik, sa edhe në gjuhën shqipe;
- jo gjithnjë janë të njëjta bashkëshoqërimet e imazheve në krijimin e figurës së metaforës;
- jo gjithnjë përzgjidhen të njëjtat kombinime leksemash;
- figurat e përzgjedhura ndryshojnë në ngjyrime kuptimore nga varianti në shqip;
- pasthirrma *nëna ime* nuk ka ekuivalente në gjuhën gjermane (O. Buchholzi/ Ë. Fiedler e përkthejnë *O Gott,* shqip, *o zot* dhe, J. Röhmi, *bei meiner Mutter*. Përzgjedhja nga J. Röhm-i e një shprehjeje frazeologjike (përkthimi literal, si te nëna ime) me kuptimin, *si në shtëpi,* ia rrit ikonicitetin, që lidhet me shprehjen e dëshirës për të qenë në shtëpi, shprehjes në gjermanisht, krahasuar me atë në shqip.

Mjete të tjera, që ndihmojnë në realizimin e funksionit ikastik në peizazhet natyrore të tekstit kadarean, janë:

- Onomatopetë
- Fjalët onomatopeike
- Aliteracioni
- Asociacioni
- Personifikimi
- Mjetet mbisegmentore (intonacioni a melodika e thënies)
- Pasthirrma *pikë e zezë*
- Foljet performative
- Etj.

Efekt i veçantë ikastik zhvillohet me paraqitjen e dukurive dhe objekteve të veçanta natyrore. Këtu do të përmendnim, së pari, fenomene atmosferike, si *era, shiu, bora.* Këto janë të gjithëgjendshme në rrëfim. Janë pjesë përbërëse e atmosferës së përgjithshme jetësore. Meqë jeta rrjedh e paqetë, me lodhje, tensione e nervozizëm, edhe natyra kundërpërgjigjet e turbullt, e ashpër (duke reflektuar shqetësimin njerëzor). Një raport i tillë, ku jeta dhe natyra ndikojnë reciprokisht, është burim i përhershëm force evokuese. Natyra i ngjan jetës, është po aq dëshpërimsjellëse sa ajo. Efekti ikastik realizohet më tej me mjete të tilla:

- Me përsëritjen rëndom të fjalës që shënon dukurinë atmosferike. P.sh.: Fjala *erë* është përdorur aq shumë, sa nuk mund ta sjellësh dot në parafytyrim aksionin e gjeneralit, pa e shoqëruar me erën. Në romanin e I. Kadaresë fryn vazhdimisht erë, që nga mbërritja e gjeneralit deri në largimin e tij:

  Era e lagur iu përplas në fytyrë...[406]
  Der regennasse Wind peitschte ihnen heftig ins Gesischt,..[407]
  Ein feuchter Wind schlug ihen entgegen...[408]

[406] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 11.
[407] Buchholz, Oda,/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 9.

Frynte vazhdimisht.[409]
Der Wind wehte unablässig.[410]
Es windete unentwegt.[411]

Era, që shoqëron kudo personazhet dhe bëmat e tyre, merr vlera simbolike. Ajo simbolizon shqetësimin, gjendjen e turbullt shpirtërore. Kështu *era* e tekstit kadarean fiton forcë ikastike në dy drejtime. Së pari, me përsëritjen pa fund të fjalës, ajo të kujton erën e vërtetë; së dyti, ajo evokon botën e paqetë shpirtërore të dy misionarëve të huaj. Edhe nëse prifti ka një lloj qetësie të jashtme në krahasim me gjeneralin, prapë se prapë edhe ai është i prekur nga një mision i tillë i përzishëm, për më tepër, në një vend të huaj.

Shembuj të tjerë:

... ku të njomte shiu e të rrëqethte *era.*[412]
...wo der regen sie durchnäßt hatte und *der Wind* sie hatte frösteln lassen.[413]
... wo einen der Regen durchnäßte und der eisige *Wind* erschaudern ließ.[414]

Mushamaja e gjeneralit kërciste nga *era*.[415]
Der Regenmantel des Generals flatterte im *Wind.*[416]
Die Mantelschöße des Generals flatterten im *Wind*.[417]

Fryn *erë* e ftohtë.[418]
Es weht ein kalter *Wind.*[419]
(Mungon) “mein Rücken ist schon eiskalt.”[420]

Kur zbritën, frynte *erë* dhe plepat fëshfërinin. [421]
Als sie ausstiegen, war es sehr *windig*, und die Pappeln rauschten.[422]
Als sie ausstiegen, hörten sie die Pappeln im *Wind* rauschen.[423]

Nga deti frynte *erë* e fortë.[424]
Von der See her wehte ein kühler *Wind.*[425]
Vom Meer her blies ein kalter *Wind.*[426]

Mbi to kishin nisur të frynin *erërat* e dimrit.[427]
Darüber hinweg fegten jetzt die *Winterstürme.*[428]

[408] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 11.
[409] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 235.
[410] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 220.
[411] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 295.
[412] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f.128.
[413] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 124.
[414] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 157.
[415] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 129.
[416] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 124.
[417] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 157.
[418] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 130.
[419] Buchholz, Oda,/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 126.
[420] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 158.
[421] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 131.
[422] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 126.
[423] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 159.
[424] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 137.
[425] Buchholz, Oda,/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 132.
[426] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 166.
[427] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 143.

> ...über die schon winterliche *Winde* fegten.[429]

Siç shihet, shembujt e mësipërm i kemi nxjerrë nga një bllok i kufizuar faqesh. Nga përqasja e varianteve të gjermanishtes me origjinalin e Kadaresë, vëmë re disa ndryshime në lidhje sintagmatike të fjalës *erë* në shqip dhe në gjermanisht. Dallimi i parë lidhet me sintagmën në shqip: *të rrënqethte era*, e përkthyer në versionet në gjermanisht:

- *...hatte der Wind frösteln lassen*, përkthimi literal i së cilës është: *i pati lënë era të rrënqetheshin*, dhe
- *...der eisige Wind erschaudern ließ,* në shqip, *i la era të rrënqetheshin.*

Përpos dallimeve në formën e foljes në shqip dhe në gjermanisht (vetore vs. vetvetore) diferencat kuptimore lindin, edhe nga ngjyrimet e ndryshme kuptimore të temave motivuese të foljeve në gjermanisht (*Frost*, shqip *ngricë* vs. Schauder, shqip *rrënqethje,* por edhe nga ndryshimet në kohët e foljeve midis variantit shqip dhe atyre në gjermanisht (*kohë e pakryer* vs. *e kryer e tejshkuar* vs. *kohë e pakryer*). Në variantin në shqip, *era* vepron dhe është subjekt që ndikon te përjetuesi, ndërsa në variantet në gjermanisht *era* nuk përshkruhet në çastin veprues, në gjermanisht përmes përdorimit të formës *sich lassen + folje në formën e infinitivit* jepet një rezultat i përfunduar dhe jo një proces në veprim. Këto dallime ndikojnë, padyshim, edhe në forcën evokuese që ka era në variantin shqip dhe në ato gjermanisht.

Shembulli *kërciste nga era* dhe përkthimet *flatterte/n im Wind* (valëvitej në erë) kanë diferenca kuptimore që rrjedhin nga dallimet kuptimore të emetuara nga foljet *kërcas* dhe *valëvitej*. Kuptimet referenciale, por edhe ngjyrimet konotative janë të ndryshme në variantet e përmendura.

Sintagma në shqip *fryn erë* që ndeshet në disa nga shembujt e mësipërm përkthehet në gjermanisht me sintagma të ndryshme, konkretisht: *der Wind weht*, përkthimi literal shqip, *fryn erë; ist windig*, përkthimi literal shqip, *është ershëm*[430] (me erë); *der Wind bläst*, përkthimi literal shqip, *fryn erë; der winterliche Wind fegt*, përkthimi literal shqip, *të fshin era e dimrit.* Siç shihet dallimet midis varianteve shqip dhe gjermanisht janë në ngjyrimet kuptimore të emetuara, por edhe në llojin e lidhjes kuptimore të fjalëve në sintagma (kuptim i drejtpërdrejt vs. kuptim figurativ).

Në paralelizëm me *erën* si dukuri atmosferike, Kadareja përshkruan edhe ndjenjën e gjeneralit gjatë vështrimit dhe studimit të listave të gjata të ushtarëve. Në:

> Nga ato lista të gjata, pothuajse të pafundme, filloi të frynte një erë urrejtjeje dhe hakmarrjeje.[431]
> Aus diesen langen, fast endlosen Listen ëehte ihm ein Hauch von Haß und Rachsucht entgegen.[432]
> Aus den schier endlos langen Listen ëehte ihm Rachedurst entgegen.[433]

[428] Buchholz, Oda,/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 138.
[429] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 172.
[430] Fjala *ershëm* nuk ekziston në gjuhën shqipe, por ne e kemi përdorur për të treguar, se në gjermanisht formohet një ndajfolje e prejardhur nga emri *erë.*
[431] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 128.
[432] Buchholz, Oda,/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 123.
[433] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 155.

përshkruan ndjenjat e gjeneralit. Ato nuk janë statike.

Shembulli dëshmon se *erë* në shqip është polisemike, ajo mund të përdoret edhe në kuptimin figurativ, ndërsa në gjermanisht, jo. Për të emërtuar këtë koncept, në gjermanisht përdoret një shenjë tjetër, konkretisht, *Hauch*.

Ndryshimet kuptimore të analizuara deri tani ndikojnë edhe në forcën evokuese të emetuar nga njësitë e analizuara.

Edhe *shiu* nuk u ndahet personazheve tanë. Më shumë se 40 situata në 150 faqe shoqërohen me shi. Fjala *shi* shfaqet shumë shpesh. Lexuesi e priste këtë. Se gjenerali shprehet që në fillim:

> … Atij i qe dukur gjithmonë se misioni i tij mund të kryhej vetëm në *shi.*[434]
> Das rührte daher, daß er sich schon immer vorgestellt hatte, seine Mission sei nur bei *Regen* durchzuführen.[435]
> Seine Mission, so wie er sie sich vorstellte, setzte *Regen* voraus.[436]

Prandaj peizazhi me shi ishte për të diçka e pritur, madje e mirëpritur:

> Mbi tokën e huaj binte borë dhe *shi* përzier bashkë … Pra ishte vjeshtë dhe *shiu* kishte kohën e vet… Gjenerali e dinte që në Shqipëri vjeshta është e lagësht dhe me *shi*…Atij nuk do t’i dukej ky *shi* i papritur…[437]

> *Regen*, mit Schneeflocken vermischt, ging auf die fremde Erde nieder....Es war Herbst, und der *Regen* hatte seine Zeit.....er wußte daher, daß der Herbst in Albanien feucht und *regnerisch* ist. ...hätte ihn *der Regen* nicht überrascht.[438]

> Schneeflocken mischten sich in den *Regen*, der auf die fremde Erde niederging. ...Inzwischen hatte mit dem Herbst die *Regenzeit* begonnen,.... ...daß die Herbste in Albanien naß und *regnerisch* waren. ...wäre *der Regen* keine Überraschung für ihn gewesen.[439]

Duke u përsëritur aq shumë, duke u shfaqur nga situata në situatë, duke shoqëruar tërë misionin e zhvarrimit, fjala *shi* merr vlerë simboli, simbolizon diçka të pazakonshme, dëshpëruese. Edhe ky element leksikor e shfaq funksionin ikastik në dy aspekte: duke u përsëritur, dukuria fiton vërtetësi, realitet. Ky fenomen real, që shoqëron nga fillimi deri në fund aktin funebër e makabër të zhvarrimit të ushtrisë, fiton dhe vlerë evokative. Në tekst, shiu shfaqet, zakonisht, kur punët nuk ecin mirë, kur gjërat paraqesin anën e tyre të vështirë:

> Të bisedonte më mirë për ato ditë të zymta që i kaluan xhadeve dhe çadrave, ku të njomte *shiu* dhe të rrëqethte era.[440]
> Mbasdite nisi një *shi* i imët.[441]
> *Pikat e shiut* binin të rralla mbi baltën e kuqe.[442]

[434] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f.9.
[435] Buchholz, Oda / Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 7.
[436] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 9.
[437] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 9.
[438] Buchholz, Oda,/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 7.
[439] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 9.
[440] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 128.
[441] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 159.
[442] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 163.

Në shembujt e përzgjedhur me leksemën *shi* konstatojmë se kjo fjalë emeton të njëjtat vlera kuptimore edhe në variantet e përkthyera në gjermanisht, duke pasur edhe të njëjtat vlera evokuese si edhe në variantet shqip. Ndryshimi i vetëm formal midis varianteve në gjermanisht dhe në shqip është përdorimi në gjermanisht i ndajfoljes së prejardhur nga emri *shi*.

Një mjet tjetër gjuhësor që përdoret për të çliruar forcë ikastike në emërtimet e dukurive atmosferike, është prozopopeja, personifikimi i dukurisë:

> *Era* vërshëllente si në skëterrë.[443]
> **...**wo der *Wind* heulte, wie in der Hölle.[444]
> ... um ihn zurückzuholen in seine von höllischen Winden durchtobten Schluchten.[445]
>
> Ulërimë *ere*. Ditë e natë. Duket sikur botës i ka mbetur vetëm *era*.[446]
> Der Wind heult. Tag und Nacht.Es scheint auf der Erde nur noch den Wind zu geben.[447]
> Der Wind heult Tag und Nacht. Die ganze Welt sheint nur aus Wind zu bestehen. [448]

Folja *vërshëllej* është njëkohësisht fjalë onomatopeike, kështu që efekti ikastik është i dyfishtë.

Personifikimi i dukurisë së erës është edhe në variantet e përkthyera në gjermanisht, por jo me emër, por me foljen *heulen* (ulërij), duke humbur, në këtë mënyrë, karakterin abstrakt që ka kombinimi në variantin e Kadaresë. Ajo që na bie në sy nga dy shembujt e mësipërm, është përkthimi i foljes *vërshëllej* me *ulëras* në variantet gjermanisht, edhe pse në gjermanisht ekziston folja përkatëse *pfeifen* (vërshëllej). Kjo përzgjedhje në gjermanisht çon në diferenca në vlerat kuptimore të emetuara nga togjet në shqip dhe në gjermanisht. Funksioni evokues i fjalës *erë* në lajmërimin e mosecjes mirë të punëve është më intensiv në përkthimin në gjermanisht. Semantika e foljes *ulëras* parakupton përbërëse kuptimore që vijnë si rezultat i një ndjenje inati apo mërzitjeje shumë të madhe, krijuar nga një gjendje shumë e vështirë. Këto përbërëse nuk gjenden të ngërthyera në kuptimin e foljes, në shqip, *vërshëllej*. Duke qenë fjalë onomapatope, folja *vërshëllej* asocion dhe evokon jo vetëm zhurmën e erës, por edhe gjendjen e turbullt të krijuar në çastin e ligjërimit.

Duke marrë vlera simbolike, fjalët që shprehin dukuri atmosferike, në tekstin e I. Kadaresë fitojnë, siç del edhe nga shpjegimet e deritanishme, pamje e dimensione ikastike, sepse bëhen shenja të motivueshme të domethënieve shoqëruese të kuptimeve të tyre parësore.

Objekte të veçanta të natyrës zënë një vend të spikatur në peizazhin natyror. Të tilla janë: *mulli, vijë uji, plep, fortino* e ndonjë tjetër. Jashtë tesktit ato nuk kanë vlerë iksatike, nuk kanë ikonicitet. Por brenda tekstit i zhvillojnë këto vlera. Kështu, *mullinjtë***,** kudo që shfaqen, simbolizojnë pjesën paqësore të jetës, evokojnë “bukën”:

> Vija e ujit ishte jazi i një *mulliri.*[449]

[443] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 171
[444] Oda Buchholz/ Wilfried Fiedler, General der toten Armee, f. 162.
[445] Röhm, Joachim, General der toten Armee, f. 213.
[446] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 92.
[447] Oda Buchholz/ Wilfried Fiedler, General der toten Armee, f. 88.
[448] Röhm, Joachim, General der toten Armee, f. 118.
[449] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 91.

> *Der Bach* führte mich zu dieser Mühle, es war der Mühlbach.[450]
>
> Kur u ktheva, pashë një njeri te pragu *i mullirit.*[451]
> Als ich zurückkehrte erblickte ich auf der Stelle vor der *Mühle* einen Mann.
>
> Dëgjoj zhurmën e *jazit të mullirit* dhe ëndërroj gjithfarë gjërash.[452]
> Ich höre das *Murmeln des Mühlbachs* und träume von allerlei Dingen.[453]
>
> Kemi shumë punë. Fshatarë nga të gjitha anët. Sa herë që dëgjoj tringëllimën e zileve të kafshëve, gëzohem.[454]
> Wir haben viel zu tun. Bauern von überallher. Jedesmal, wenn ich das Läuten der Viehglocken vernehme, freue ich mich.[455]
> Wenn ich die Viehglocken höre, ist mir etwas leichte ums Herz. Meistens bin ich aber bekümmert.[456]

Ekuivalenca në rrafshin semantik dhe pragmatik e fjalëve që asociojnë pjesën paqësore të jetës, bukën, midis varianteve në shqip dhe gjermanisht është pothuajse e plotë. Me të njëjtat ngjyrime kuptimore vijnë të përkthyera fjalët edhe në variantet gjermanisht.

Vija e ujit në tekstin e I. Kadaresë është simbol i paqes, qetësisë:

> Asgjë tjetër nuk më kujtonte në mënyrë kaq të përmbledhur ditët e paqes, sesa ato *vija uji.*…Ato më thërrisnin. Unë ndieja gurgullimën e tyre të përjetshme dhe me siguri pranë ndonjë *vije uji* të fshatit, më lindi, në fillim turbull-turbull dhe pastaj gjithmonë e më qartë ideja e dezertimit.[457]
>
> Nichts anderes erinnerte mich wohl mit solcher Eindringlichkeiten wie diese *Wassergräben*. ...Sie wühlten etwas in mir auf. Sie schienen in mir einen Urinstinkt zu wecken. Sie riefen nach mir. Ich hörte ihr ewiges Murmeln, und sicherlich war es an einem solchen *Wassergraben*, daß mir – zuerst verschwommen und dann immer klarer – der erste Fluchtgedanke kam.[458]
>
> Ich weiß auch nicht, weshalb diese langsam fließenden, mit der Hacke angelegten Wasserläufe albanischer Dörfer mich so verwirrten. Wahrscheinlich, weil sie mich an friedlichere Zeiten erinnerten. ....Es (*das Wasser*) reizte mich. Rief verschütttete Gefühle in mir wach. .... und vermutlich ist der Gedanke an Disertion bei solch einem ständ plätschernden *Dorfkanal* in mir entstanden, erts vage und unbestimmt, dann immer klarer.[459]

Aftësia simbolizuese është ikoniciteti. Një fjalë e caktuar brenda tekstit shënon dhe diçka të ndryshme nga kuptimi i saj i zakonshëm, çka ndodh në çdo shfaqje të saj. Kështu ajo shërben si shenjë ikonike e domethënies dytësore (vijë uji = paqe = qetësi= idil).
Krahasimi i elementeve gjuhësore me funksion ikastik në pasazhin e mësipërm shqip me përkthimet gjegjëse në gjermanisht, dëshmon për disa vështirësi të përkthyesve në lidhje me gjetjen e ekuivalenteve gjegjëse me domethënie të njëjtë edhe në përkthim.

[450] Buchholz, Oda / Fiedler, Wilfried, General der toren Armee, f. 87.
[451] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 92.
[452] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 96.
[453] Buchholz, Oda/ Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 93.
[454] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 95.
[455] Buchholz, Oda/ Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 91.
[456] Röhm, Joachin, *General der toten Armee*, f. 120.
[457] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 106.
[458] Buchholz, Oda/ Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 103.
[459] Röhm, Joachin, *General der toten Armee*, f. 132.

Duket se në gjermanisht është i pamundur kombinimi i fjalëve *vijë dhe ujë* për të emërtuar *drejtimin apo rrjedhën të ujit në formë vije.* Në variantet e përkthyera në gjermanisht gjejmë për këtë sintagmë tri forma: *Wassergrab* (gropë uji), *Dorfkanal* (kanal fshati), *Wasser* (ujë). Në rastet e tjera në roman gjejmë edhe përkthimet *Wasserlauf*[460] (rrjedhë uji), *das Bach*[461] (përrua). Të gjitha gjegjëset në gjermanisht të leksemës vijë uji dallojnë në komponente kuptimore, nëse do t`i krahasonim me vlerat përdorimore që fiton leksmema *vijë uji* në tekstin e Kadaresë. Ato nuk emetojnë të gjitha komponentet kuptimore të shprehura drejtpërdrejt ose të nënkuptuara në tekstin e Kadaresë. Të tilla janë: *e drejtë, e njëtrajtshme, lineare*, që të fton për meditim. Si të tilla, variantet në gjermanisht nuk kanë të njëjtën forcë evokuese si në variantin në shqip të Kadaresë

Ndërsa *plepat* (në tekstin tonë) shënojnë krahas drurit edhe idenë e kufirit, ndarjes:

> Nga e djathta ishte një rradhë *plepash* të lartë dhe po të vështrosh në atë drejtim, mund të dallosh, tutje, ndërtesat e fermës së një beu dhe më tej akoma një *mulli.*[462]
>
> Dëgjoheshin *plepat që fështërinin.*[463]

Me anë të fjalës onomatopeike *fështërinin* plepat rroken në një situatë të natyrshme, ku imitohet zhurma reale.

Fortinot si simbole të luftës i shkaktojnë gjeneralit një frikë të përhershme. Ato shpesh personifikohen, paraqiten me mimikë e shprehje njerëzore:

> Kaloi, thoshte me vete, kur vetura ikte nga zona e qitjes, por në kthesën tjetër përsëri dilte një *fortino*, sikur mbinte nga toka, dhe prapë vetura për disa sekonda binte në zonën e qitjes…*Fortinot* ishin të heshtura e të braktisura. Po t'i shikoje me vërejtje ato dukeshin nga larg si skulptura egjiptiane, me një shprehje herë përbuzëse dhe herë enigmatike. Në qoftë se e çara ishte vertikale, *shprehja e fortinos bëhej e egër dhe kërcënuese*… Kur e çara qëllonte horizontale, atëherë *fortinoja kishte një mimikë indiferente e mospërfillëse.*[464]
>
> Vorbei, dachte er, wenn er das Auto aus dem Schußfeld war, aber in der nächsten Kurve tauchte wieder *ein Bunker* vor ihnen auf, wie au fem Boden gewachsen, und wieder bewegte sich das Auto einige Sekunden lang im *Schußfeld*. ...*Betonbunker* lagen *schweigend* und *verlassen* da. Wenn man sie aufmerksam betrachtete, sahen sie vom Weiten wie ägyptische Skulpturen aus, bald mit einem verächlichen Ausdruck, bald rätselhaft, je nachdem wie die Schießscharten lagen. Waren sie vertikal, *wirkte der Bunker wild und drohend wie ein Ungetümm*. Waren sie dagegen horizontal angeordnet, dann *zeigte der Bunker eine gleichgültige und geringschätzige Miene*.[465]
>
> Geschafft, dachte er, wenn das Auto vorbei war, aber an der nächsten Kurve wuchs ein Bunker aus dem Boden, und erneut durchquerte das Auto für einen Moment den Schußbereich. ... Dann standen die *Bunker stumm* und *verlassen* da. Von Weitem wirkten sie, wenn man aufmerksam hinschaute wie ägyptische Skulpturen, mit einem manchmal verächtlichen, manchmal rätselhaften Ausdruck, je nach Form und Beschaffenheit der Schießscharten.

[460]Buchholz, Oda/ Fiedler, Buchholz, *General der toten Armee*, f. 87.
[461] Buchholz, Oda/ Fiedler, Buchholz, *General der toten Armee*, f. 87; Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 116.
[462] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 131.
[463] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 135.
[464] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 40.
[465] Buchholz, Oda/ Fiedler, Buchholz, *General der toten Armee*, f. 36.

> Verliefen die Schießscharten vertikal, erschien *der Bunker* wie ein *wildes* und *bedrochliches* Ungetüm. Verlief die Öffnung horizontal, sprach aus der *Mimik des Bunkers Verachtung*.[466]

Personifikimi, figurat dhe karakterizimet e tjera e japin dhe e shprehin objektin me vërtetësi dhe shprehësi të veçantë. Fjalët personifikuese atributive *të heshtura***,** *të braktisura* evokojnë me besnikëri fortinot shqiptare të të gjitha kohërave të pasluftës. Ndërsa elementet e tjera figurative karakterizuese *e egër, kërcënuese, një mimikë indiferente, mospërfillëse* referojnë në perceptimin dhe konceptimin e gjeneralit. Ato shprehin sidomos reagimin e tij ndaj objekteve që lidhen drejtpërdrejt me luftën.

Një efekt të ngjashëm evokues zgjojnë te lexuesit edhe gjegjëset e fjalëve në gjermanisht. Me gjegjëset *Bunker,stumm, verlassen, ëild, bedrochlich, Verachtung, geringschätzig, gleichgültig,* të shkruara me shkronja italike në paragrafët në gjermanisht, zgjojnë të njëjtat asociacione edhe në gjermanisht. Me dallime të pakta në ngjyrim është çifti i fjalëve *Bunker* (gjer.) – *fortino* (shqip). Edhe në gjuhën shqipe ekziston fjala *bunker,* por Kadareja parapëlqen të përdorë fjalën *fortino,* e cila nuk bën pjesë në fjalësin shqip. Ajo është një variant sinonimik i fjalës *fortifikatë*, nga i cili dallon nga vlera më e fuqishme ekspresive. Kuptimet e shënuara në fjalësin e Gjuhës Shqipe për të dyja këto lema do të ishin:

> *fortifikatë (usht.): vend i fortifikuar, pozicion zjarri i fortifikuar me mure të trasha, zakonisht prej betonarmeje.*
> *Bunker: militärische Schutzanlage; (unterirdisch angelegter) Schutzraum für die Zivilbevölkerung im Krieg (strehim ushtarak; strehim i nd*ërtuar nëntokë për popullsinë civile në kohë lufte); *në shqip: strehim i posaçëm, zakonisht i futur përgjysmë, me mure të trasha të trasha e me frëngji, që shërben si frëngji zjarri.*

Nga krahasimet e komponenteve a përbërëseve kuptimore të të dyja leksemave konstatojmë shumë përafri në përbërësit konceptualë që lidhen me materialin e ndërtimit të tyre, me qëllimin dhe fushën e përdorimit. Elementet konceptuale që lidhen me formën e ndërtimit janë të ndryshme: *fortinot* janë vende të mbrojtura me mure të trasha, kurse *bunkerët* janë strehime, zakonisht të futura përgjysmë. Mund të themi që vëllimi kuptimor i fjalës *fortino* përmbledh atë të lemës *bunker.*
Dy fjalët ndryshojnë edhe në ngjyrimet kuptimore dhe në forcën evokuese të tyre: *bunker* në shqip të evokon gjithë sfondin që lidhet me kohën e ndërtimit të tyre, me regjimin socialist të atëhershëm. Ndërsa, *fortino* është neutrale. Pikërisht, efektin asociativ që emeton kjo fjalë në gjermanisht, ka dashur ta shmangë Kadareja (duke marrë parasysh kohën në të cilin është shkruar romani).

Interesant, po ashtu, shfaqet edhe përdorimi i leksemës *malet***;** objekti dhe koncepti mbi to shoqërohet vijueshëm me emocionet e mesazhmarrësit, gjeneralit. Ai nuk i sodit kurrë indiferent këto copa të relievit shqiptar:

> *Malet* po largoheshin gjithmonë e më tepër. Konturet e tyre bëheshin më pak *abstrakte***,** më pak *kërcënuese*. Gjenerali i vështronte në mënyrë të tillë sikur t'u thoshte: "Tani mbaroi presioni juaj. Ju ika, ju ika!"… Pastaj në orët e dremitjes…i dukej sikur *malet do të zgjatnin dorën e tyre të akullt* për ta kthyer përsëri atje *në grykat e tyre, ku era vërshëllente si në skëterrë.*[467]

[466] Röhm, Joachim, *Der General der toten Armee,* f. 51.
[467] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 171.

> *Die Berge* entfernten sich immer mehr, ihre Umrisse wurden *abstrakter*, verloren das *Drohende*. Der General betrachtete sie, als wollte er zu ihnen sagen: Jetzt ist es Schluß mit den Druck, den ihr auf mich ausgeübt habt. Gleich bin ich euch entronnen! Doch dann, in den Dämmerstunden befielihm in Auto eine dumpfe Angst. Ihm war auf einmal, als *würden die Berge ihre eisigen Hände nach ihm ausstrecken*, um ihn *in ihre Schlünde zurückzuholen*, wo *der Wind heulte wie in der Hölle*.[468]

> Ihr Abstand zum *Hochgebirge* ëuchs ständig, und seine Silhouette verlor an *Bedrochlichkeit.* Es konnte ihn nun nicht mehr unter Druck setzen. Er war noch einmal davongekommen. Dennoch befiehl ihn während der Stunden, die er dösend im Auot verbrachte, immer wieder eine unbestimmte Beklommenheit. *Das Gebirge schien mit eiskalten Händen nach ihm zu greifen,* um ihn zurückzuholen in seine *von höllischen Winden durchtobten Schluchten*.[469]

Paraqitja realiste dhe surealiste e maleve referon në psikikën e sëmurë të gjeneralit. Për të, ata nuk janë vetëm pjesë e kërcyer e relievit, ku moti është i egër, por dhe burim ankthi dhe frike. Të tillë forcë evokuese kanë edhe gjegjëset në gjermanisht. Gjegjëset në gjermanisht *Berge (male), Hochgebirge (malësi e madhe), abtrakkter (më abstrakte), das Drohende (kërcënuesja), Bedrohlichkeit (kërcënim), Gebirge (malësi), eisig (i akullt), eiskalt (të ftohta akull), Hölle (skëterrë), höllisch (i skëterrshëm)* ndihmojnë në përshkrimin e natyrës shqiptare me të gjitha veçantitë e veta, veçanti të cilat në psikikën dhe në nënvetëdijen e gjeneralit zgjojnë gjithfarë ankthesh aluçinative. Ato lartësi dhe hone të peizazhit natyror shqiptar shkaktojnë të njëjtin emocion te gjenerali: frikën se do të hakmerren ndaj tij. Shkalla e dramacitetit të përjetimeve të gjeneralit dallon në intensitetin e ndryshëm që emetojnë fjalët me funksion jo të njëjtë sintaksor në variantet gjermanisht dhe në origjinal: *Hölle* (skëterrë) vs. *höllisch* (i skëterrshëm) vs. *skëterrë;* në përdorimin me funksion të ndryshëm sintaksor të fjalës *kërcënues* si përcaktor vs. *das Drohende* (kërcënuesja) si kundrinor i drejtë vs. *Bedrochlcihkeit* (kërcënim); në përshkrimin më të egër të natyrës nga J. Röhmi: *Hochgebirge* (malësi e madhe), *Gebirge* (malësi) vs. *male*; në ngjyrimet e ndryshme kuptimore *të akullt* në shqip vs. *eiskalt* (i ftohtë akull). Pra, edhe në përkthimin në gjermanisht, fjalët e analizuara na hedhin me funksionin e tyre evokativ në përjetimet e gjeneralit, veçse dramaciteti i të përjetuarës përcillet me shkallë të ndryshme nga varianti shqip.

Daullja, instrumenti tradicional i festave me këngë e me valle, i lajmërimeve të mëdha, e trazon veçanërisht psiqikën e gjeneralit. Gjëmimi i saj do ta ndjekë që nga dasma deri në fund të romanit. Simbol ngjarjesh të zhurmshme, daullja do të mbetet kujtimi i fundit nga vendi ku u end vite të tëra me detyrën makabre të grumbullimit të eshtrave të të rënëve:

> Ç'blinin vallë ushtarët për kujtim kur largoheshin nga Shqipëria? Befas ai njeriu i vogël zuri t'i binte prapë *daulles* brenda në kokën e tij, në fillim me ritëm të ngadaltë, pastaj gjithmonë e më shpejt, më shpejt, më shpejt. Vetëm se tani nuk qe ulur më galiç në kokën e tij, por qëndronte në këmbë, *i bardhë, i zi, i shkëlqyer, me xhokë të kuqe* dhe me shirita të zinj, kurse në kokë mbante *një qeleshe*. Qëndronte më këmbë duke i *rënë daulles,* atje në vitrinë, i tëri prej porcelani, plot reflekse dhe gjenerali nuk ia hiqte sytë. Ai tregoi me dorë.
>
> - Malësorin me *daulle?*- pyeti shitësja.
>
> Gjenerali pohoi me kokë. [470]

[468] Buchhoilz, Oda/ Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 161-162.
[469] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 213.
[470] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 207

> Was mochten wohl die Soldaten zur Erinnerung gekauft haben, wenn sie Albanien verließen? Plötzlich begann das kleine Männlein in seinem Kopf die *Trommel zu schlagen*, anfangs langsam, dann immer schneller. Nun *hockte* es jetzt nicht mehr an seinem Kopf, sondern es stand da, *schwarz und weiß und glänzend, in einem braunen Hirtenumhang mit schwarzen Zierschnüren*, und auf dem Kopf trug es die *weiße Albanerkappe*. Es stand da und rührte die Trommel, dort im Schaukasten, ganz aus Porzellan, das das Licht vielfältig reflektierte, und der General konnte den Blick nicht von ihm wenden. Er zeigte mit der Hand darauf.
> “Den *Malsoren* mit der Trommel?” fragte die Verkäuferin.
> Der General nickte.[471]
>
> Auf einmal hörte er, wie der kleine Mann in seinem Kopf wieder die *Trommel* zu schlagen begann, erst langsam, dann immer schneller und schließlich in rasendem Tempo. Doch nein, er *kauerte* gar nicht in seinem Kopf, sondern stand leibhaftig vor ihm, schwarzweiß und glänzend, mit roten *Bommeln* und schwarzen *Litzen*, ganz aus schimmernden Porzellan. Der General mußte ihn unentwegt anschauen. Er zeigte mit dem Finger darauf.
> “*Den Hochländer* mit der Trommel?” fragte die Verkäuferin.
> Der General nickte.

Në këto pasazhe do të ndalemi në përqasjen e disa njësive gjuhësore në shqip dhe në gjermanisht, që emetojnë domethëniet jo të njëjta në të tria variantet e përqasura. Ato janë: *daulle, duke i rënë daulles, malësorin me daulle, rri galiç, i bardhë, i zi, i shkëlqyer, me xhokë të kuqe dhe me shirita të zinj, kurse në kokë mbante një qeleshe, malësor*. Disa prej këtyre fjalëve të përdorura për përshkrimin e veshjeve të malësorëve i kemi analizuar edhe në kapitullin e lakunave dhe i kemi quajtur lakuna etnokulturore. Është e qartë se edhe në këtë pasazh fjalë të tilla paraqesin një problem në përkthim. Variantet e përkthyera në gjermanisht nuk përshkruajnë dhe japin të gjithë koloritin e veshjes karakteristike malësore, prandaj ato emetojnë domethënie jo të njëjta. Të tilla njësi gjuhësore janë:

- *xhokë e kuqe* vs. *brauner Hirtenumhang* (mbështjellë e barinjve ngjyrë kafe) vs. *roter Bommel* (zbukurime që vendosen te këpucët apo te kostume tradicionale dhe kapele ose te veshje balloje)
- *shirita të zinj* vs. *schwarze Zierschnüre (shirita të zinj zbukurimi) vs. schwarze Litzen (kordele të zinj)*
- *qeleshe e bardhë* vs. *Albanerkappe (kapele shqiptare)*

Siç shihet edhe nga ripërkthimet në shqip të varianteve në gjermanisht, të gjitha gjegjëset ekuivalente në gjermanisht emetojnë një kuptim dhe domethënie tjetër, krahasuar me vlerat kuptimore në shqip. Njësi të tilla gjuhësore janë dhe do të mbeten gjithnjë një lakunë, një greminë për përkthyesit.

Në fragmentet e analizuara nuk emetojnë të njëjtat domethënie edhe njësitë gjuhësore:

- *rri galiç* vs. *hocken* (rri ulur në stol) vs. *kauern* (rri galiç)
- *malësor* vs. *Malsor* vs. *Hochländer* (njeri që banon në malësi)

Asociacioni që zgjon tek lexuesi gjerman fjala *Hochländer* nuk është i njëjtë si ai që zgjon te lexuesi shqiptar fjala malësor. Informacioni shoqërues i kuptimit nocionor mbi virtytet dhe karakteritika e malësoreve nuk emetohet nga gjegjësja gjermanisht. Nga ana tjetër, edhe leksema me formën tingullore *Malsor*, ashtu siç e përkthejnë dhe e sjellin O. Buchholz/ W. Fiedler, paraqet vështirësi për t`u kuptuar nga lexuesi

[471] Buchholz, Oda/ Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 194.

gjerman. Kjo lemë me këtë formë tingullore nuk është pjesë e asnjë fjalori të gjuhës gjermane.

Diferencat në kuptim midis varianteve në shqip dhe në gjermanisht, ngjyrimet jo të njëjta kuptimore midis tyre bëjnë që edhe funksioni ikastik të mos jetë i njëjtë në të dyja gjuhët që përqasim.

3.3.4.2 Peizazhe tingullore

3.3.4.2.1 Tabloja 1

Në romanin „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ ka disa skena, që ne po i quajmë tablo, ku paraqitet një grup duke kënduar (ose këngë të kënduara në grup). Këtu shkrimtari e përdor gjuhën mjeshtërisht për të dhënë këngën, muzikën, tekstin, si dhe interpretuesit. Gjuha synon të pamundurën, t’i japë të kënduarit dhe këngëtarët, ashtu siç do të paraqiteshin ata para dëgjuesve konkretë. Për dëgjuesin fjalët dhe mjetet e zgjedhura janë prezantuese tingullore, madje ato, deri në një farë mase, identifikohen me tingujt e natyrës. E. Coseriu thotë lidhur me këtë:

> Es handelt sich also um Zeichen, die von ihrer Finalität her ikastisch sind, um Zeichen, die ausdrücklich dafür da sind, durch ihre Substanz die Naturlaute ëenn nicht getreu zu reproduzieren, so doch zu evozieren.[472] (Është fjala për shenja, që, për nga qëllimi, janë ikastike, për shenja, të cilat prandaj përdoren, që me substancën e tyre, edhe nëse nuk i riprodhojnë, i evokojnë tingujt natyrorë.)

Kënga dhe grupi[473] jepen të receptuara nga gjenerali dhe prifti. Kjo mundëson që përshkrimi gjuhësor të rroket si realitet, si diçka krejt e ngjashme me realitetin. Gjuha synon të imitojë me gjithçka të kënduarin e një kënge me iso. Veç në tekstin e I. Kadaresë, lexuesi i rrok krejt tingujt, ison, fjalët, zërat dhe kombinimin e tyre. Rrok gjithashtu efektin e këngës në një natë me shi. Ndikimi i tablosë është i gjallë dhe dramatik:

> Jashtë në errësirën e natës u dëgjua një këngë. Në fillim fare ngadalë, e lindur nga zëra të ulët, të trashë, pastaj fort e më fort, kënga erdhi e u përplas te çadra siç përplaset shiu, apo era, në ato netë vjeshte, dhe u duk sikur çadra u rëndua dhe u rrëqeth.[474]

Gjermanisht:

> Draußen, im Dunkel der Nacht, erklang ein Lied. Zuerst verhalten, leise getragen von tiefen, kräftigen Stimmen, dann stärker und stärker, und das Leid schwoll so machtvoll an, daß es gegen die Zeltwände *prallte* wie Regen und Sturm in den Herbstnächten, und das Zelt schien sich zu *erbeben* und sich *zu ducken*.[475]

> Draußen im Dunkel der Nacht wurde ein Lied ausgestimmt. Es setzte leise ein, hervorgebracht von tiefen rauhen Stimmen, gewann dann immer mehr an Kraft und schlug schließlich gegen die Zeltwände wie ein Regenguß oder ein nächtlicher Herbststurm. Das Zelt *erzitterte* unter der Wucht. [476]

[472] Shih, Coseriu, Eugenio, *Textlinguistik*, Tübingen, 1994, f. 112.
[473] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 78.
[474] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 78.
[475] Buchholz, Oda/ Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 74.
[476] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 100.

Përngjasimi me një skenë reale është realizuar nëpërmjet aftësisë e strategjisë së përgjithshme ikastike-imituese të ligjërimit të I. Kadaresë në dhënien e kësaj tabloje. Mjete të tjera me vlerë ikastike janë dhe fjala onomatopeike: *rrëqeth* dhe fjalët: *rënkoj*, *përplas*. Funksioni ikastik i tyre sjell ndikimin e veçantë të momentit te dëgjuesit letrar (prifti dhe gjenerali) dhe te dëgjuesit/ lexues. Kënga, mënyra e të kënduarit nuk mund të kalonte pa u vënë re nga dy të huajt. Folja *rrëqeth*, përveç natyrës onomatopeike, ka dhe kuptim të figurshëm, objekti, çadra animizohet, personifikohet. Domethënë, çadra ku jeton gjenerali dhe prifti, reagon si qenie e gjallë nën tingujt e këngës, rrëqethet. Personifikimi, prosopopea, është një mjet shprehës ikastik. Me anë të saj synohet përngjasimi i objekevee me qeniet e gjalla.[477]
Të gjitha mjetet shprehëse me funksion ikastik në shqip janë edhe në gjermanisht. Gjegjësja e sjellë nga Buchholz/ Fiedleri në gjermanisht për fjalën *rrëqeth, erbeben* (dridhem) ka natyrë onomatopeike. Ndërsa ajo që përdor J. Röhmi, jo.

Për ta plotësuar tablonë, I. Kadareja i kthehet disa herë këngës dhe këngëtarëve:

> Kënga vinte e zvargur dhe e ngadaltë dhe isoja e mbështillte nga të gjitha anët si me një gunë të butë e të ngrohtë, sikur donte ta mbronte nga errësira dhe nga lagështia e natës. Pastaj isoja u tret ngadalë dhe nga gjiri i saj u ngrit vetëm një zë.[478]

Përshkrimi përfshin edhe pamje vizuale. Rrokësi i percepton elementet e këngës: ison, melodinë e zvargur etj. në atmosferën me shi dhe errësirë. Isoja personifikohet duke u paraqitur si mbështjellëse konkrete dhe si mbrojtëse e këngës. Edhe alternimi i isos me këngën janë përshkrime të hollësishme që ta sjellin pranë skenën me tingujt që e përshkojnë atë. Me një materie gjuhësore-shkrimore, që përbëhet nga mjetet gjuhësore: këngë e zvargur, isoja e mbështillte nga të gjitha anët, si një gunë e butë dhe e ngrohtë, isjoa u tret ngadalë dhe nga gjiri i saj u ngrit vetëm një zë, është dhënë bota tingëllore e këngës si një realitet që shpaloset gjatë receptimit. Është interesante dhe vendndodhja e dëgjuesit-tregues. Ai nuk gjendet në mesin e këngëtarëve, në mjedisin ku nis e përhapet kënga, ai është vendosur në distancë. Nga distanca, ai e percepton dhe e ndjen këngën “të zvargur”. Distanca i ka hequr asaj gjallërinë dhe tingëllimin e zakonshëm. Përshkrimi besnik, autentik i rrjedhjes së këngës të kujton, të bën të përjetosh një realitet me tinguj, muzikë e këngë nga ato me iso. Dëgjuesi lexues i rrok këto këngë nga një distancë akoma më e madhe, kohore, hapësinore, zakonore, kulturore. Megjithë këtë distancë hermeneutike, teksti i I. Kadaresë ka tingëlluar në veshët tanë sa herë që e kemi lexuar. Përngjasimi i situatës me këngë të romanit me një situatë të tillë të jetës reale është i padiskutueshëm. Ndikimi i tablove të tilla tingëlluese është real. Ndikimi i drejtpërdrejtë manifestohet te gjenerali dhe prifti, që janë dëgjuesit dhe interpretuesit letrarë të këngës. Ata janë tejet të tërhequr dhe të interesuar për këngët, për domethënien e tyre:

- *Ai,- tha gjenerali. – E dëgjoni?*
- *Po.*
- *Ka zë të mirë. Përse flet kjo këngë?*
- *Është këngë e vjetër ushtarësh, - tha prifti.*
- *Këngë e rëndë.*
- *Po.*
- *A mund t’i dalloni fjalët?*
- *Sigurisht, flet për një ushtar shqiptar të vrarë në Afrikë.*[479]

[477] Shih, Coseriu, Eugenio, *Textlinguistik*, Tübingen, 1994, f. 96.
[478] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 79.
[479] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 79.

Pak më poshtë vijon përkthimi që i bën prifti këngës së famshme “Mbeçë, more shokë, mbeçë”.
Pak më poshtë do të merremi dhe me përkthimin. Tani do të ndalemi në faktin e citimit të një pjesë të këngës. Citatet, formulimet origjinale të llojeve të ndryshme, kanë gjithnjë forcë të veçantë evokative. Ato referojnë në burimet autentike duke shtuar frymën e vërtetësisë së tekstit:

> Unë mbeta i vrarë, o kamaradët e mi, mbeta në kuotën përtej urës së Qabesë.[480]

Citati ka referim të dyfishtë, forcë të dyfishtë evokative. Së pari, evokon këngën historike me tragjedinë që ndryn brenda saj. Së dyti, evokon momentin e receptimit të këngës nga misionarët e huaj dhe përkthimin e priftit. Edhe përkthimi vetë është tepër evokues. Vetëm një i huaj do t’i transformonte kështu fjalët e këngës dhe do t’i mbushte rreshtat me terma ushtarake, që nuk i përmban origjinali. Një përkthim korrekt nuk do të shkaktonte aq humor.
Në tekstin gjermanisht përkthimi i priftit është dhënë kështu:

> Man hat mich getötet, meine Kameraden, ich bin gefallen, hinter der Brücke bei der Kaba.[481]
> Der Tot hat mich ereilt, Kameraden, auf der Höhe jenseits der Kaaba Brücke.[482]

Po t`i sillnim përkthimet e mësipërme përsëri në shqip, do të kishim:

> Mua më vranë, shokët e mi, unë rashë përtej urës së Qabesë.
> Vdekja më rrëmbeu, kamaradë, në koutën përtej urës së Qabesë.

Duket qartë transformimi që ka pësuar kënga tejet artistike e tragjike shqiptare nga përkthimi në përkthim. Prifti me përkthimin e tij e zhvesh dukshëm këngën nga poezia e saj fine, përkthimi gjerman e zhvesh akoma më tej dhe e katandis në një raportim të thjeshtë klishe, të përgjithshëm, si ata të zakonshmit në kohë luftrash („Rënë për atdhe në Stalingrad“).
Duke dëgjuar përkthimin dhe shpjegimin e priftit mbi këngën dhe shërbimin ushtarak të shqiptarëve në Jemen, gjenerali përjeton befas diçka të shkuar. Sapo ia befi midis rreshtash fjala shkretëtirë, ai u përfshi nga kujtime që e hodhën menjëherë atje, në shkretëtirë:

> *- Domethënë këngë për shkretëtirën, - tha si nëpër gjumë gjenerali dhe në kujtesën e tij, si një qilim verbues, i pafund, u shpalos shkretëtira. Ai u mundua të ecte përsëri mbi këtë qilim, ashtu si një çerek shekulli më parë, kur marshonte i veshur me uniformën e togerit.*[483]

Zinxhiri evokues zgjatet me hallka të reja. Nga historia tragjike shqiptare, nga momenti i përjetimit e përkthimit të këngës kalohet me asociacion në shkretëtirën afrikane, ku gjenerali shërbente gjatë luftës. Asociacioni është një mjet stilistik tejet ndikues. Zgjimi i asociacioneve është tregues i karakterit ikonik (ikastik) të segmentit tekstor, sepse realizon lidhjet që vendosin tingujt, segmentet gjuhësore me domethëniet e tyre. Në këtë rast ky segment shërben si shenjë ikonike (ikastike) e përmbajtjes së thënies asociative. Atje ku situatat lidhen me asociacion, kemi përforcim të ndikimit të tekstit te marrësi. Kënga e vjetër shqiptare, e kënduar nga

[480] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 79.
[481] Buchholz, Oda,/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, Kiel, 1988, f. 76.
[482] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 101.
[483] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 79.

grupi i punëtorëve, e shtriu pushtetin e saj gjithë natën mbi dëgjuesit virtualë dhe ushtron pushtet gjithë kohën mbi ne, dëgjuesit realë.

> Përjashta kënga zvargej, sikur do të këputej, pastaj prapë e merrte veten dhe vinte e shtypte faqet e pjerrëta të çadrës.[484]

Kënga këtu rroket si forcë, si presion që shtyp e drithëron. Madje animizohet me segmentin *pastaj prapë e merrte veten.*
Paraqitja me materie gjuhësore-shkronjore e tingujve, e melodisë dhe e gjithçkaje që përmban një këngë është diçka tepër e vështirë, por dhe mjaft domethënëse dhe shprehëse. Një paraqitje e suksesshme e sjell këngën të gjallë në veshët e lexuesve/dëgjuesve. Dhe ndodh që kohë të tëra nuk të ndahet nga mendja melodia e demonstruar.

Kur lexon fjalë të tilla:

> Jashtë kënga u tendos e u hap gjer në fund si llastik dhe pastaj u këput.[485]

përjeton e percepton fundin që vjen me zgjatje të zërit dhe të isos, pastaj gjithçka ndërpritet menjëherë. Përngjasimi i paraqitjes me fjalë të shkruara dhe këngës me komponentet e saj muzikore është tejet evident. Forcën ndikuese të përshkrimit e rrit dhe aliteracioni që shtrihet në disa paragrafë dhe që thekson përjetimin e veçantë të këngëve nga dëgjuesit drejtpërdrejt dhe më gjerë nga lexuesi/ dëgjuesi:

> Në fillim u ngrit vetëm zëri i lartë, i dredhur, tronditës i punëtorit të vjetër…[486]

Shfaqja e tingullit-shkronjë *r* në disa fjalë njëra pas tjetrës zgjon idenë e dridhjes. Emocioni vjen e rritet duke u përforcuar me zgjerimin semantik *melodioze dhe dominuese:*[487]

> …ajo u ngrit melodioze dhe dominuese në gjirin e natës…[488]

Përjetimi i atmosferës së mbushur nga këngët shprehet e rrjedh në dialogjet midis priftit e gjeneralit, ku nuk mungojnë aliteracionet e fjalët onomatopeike, që shenjojnë më së miri emocionet dhe shprehin ndikimin e veçantë të atij lloji këngësh:

- Ka diçka *gërryese* në këto këngë të zgjatura, të zgjatura, - tha gjenerali.
- Po, tamam *gërryese*. Janë zëra primitivë.
- Unë *rrëqethem* prej tyre. Ose, që të jem më i saktë, më fusin frikën.[489]

Leksemat *gërryese, rrëqethem* janë elemente onomatopeike (rrjedhin nga onomatopetë: grrr, rrqth). Ndërsa aliteracioni ka të bëjë me përsëritjen rëndom të tingujve *r, rr*, tinguj që imitojnë dridhjen në përgjithësi dhe atë njerëzore në veçanti.
Dihet që onomatopetë (edhe fjalët onomatopeike) janë të markuara nga kultura e bartësve të një gjuhe, nuk janë imitime krejt natyrore të zërave dhe zhurmave të realitetit. Këtë e vënë në dukje edhe E. Coseriu, Rousseau[490] etj.

[484] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 79.
[485] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 80.
[486] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 80.
[487] Mbi zgjerimin semantik shih, Teichmann, Emine, *Kadareja, ky stilist i madh*, Tiranë, 2000, f. 46.
[488] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 80.
[489] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 80.

E. Coseriu shkruan:

> „In der Entensprache sagen alle Enten dasselbe, auf französisch sagen sie hingegen couin-couin, auf Deutsch quak-quak, auf dänisch rap-rap und im Rumänischen mak-mak. Entsprechendes gilt für viele andere lautmalende Wörter. Bei dieser Art von „Malerei" handelt es sich also offenbar doch um eine streng stilisiernde Manier, die der Tradition der jeweiligen historischen Sprache verpflichtet ist, keineswegs um eine natürliche Imitation."[491] (Në gjuhën e tyre të gjitha rosat thonë të njëjtën gjë. Por, në frëngjisht, ato thonë couin-couin, në gjermanisht quak-quak, në danisht rap-rap, në rumanisht mak-mak. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për tingullimitime të tjera. Në këto lloj „vizatimesh" tingullore bëhet fjalë për një mënyrë krejt të stilizuar, që çdo gjuhë është e detyruar tradicionalisht ta respektojë, dhe aspak për imitime të natyrshme.)

Një mjet tjetër që luan rol në realizimin e ngjashmërisë me një realie, janë dhe fjalët që shënojnë koncepte karakteristike të objektit real. Në rastin që po analizojmë, këtu do të përfshinim fjalë si: *zë, iso, ia kthen, ngrihet, bie, këputet* etj.
Forca ikastike, evokuese e figurave letrare është e padyshimtë. Ato evokojnë drejtpërdrejt objektin që emërtojnë së pari:[492]

> Zëri i punëtorit të vjetër u ngrit mbi të tjerët lart e më lart, derisa qëndroi një çast pezull dhe, befas, *u këput e ra* dhe humbi midis zërave të tjerë, si një *shkëndijë* që bie përsëri mbi *prushin* e vatrës.[493]

Krahasimi dhe metafora (si shkëndijë, prush, u këput e ra), që përdoren për të karakterizuar zërin e punëtorit (që këndon), bëjnë që skena e përshkruar t'i ngjasë gjithnjë e më shumë një pamjeje të gjallë, të ndezur nga muzika, me ndikim të veçantë e të përforcuar te marrësi/dëgjuesi. E njëjtë është skena që evokon edhe përkthimi në gjermanisht nga Buchholz/Fiedleri i pjesës së sipërpërmendur.

> Die Stimme des alten Arbeiters übertönte die der anderen lauter und immer lauter, bis sie für einen Augenblick gleichsam in der Schwebe verharrte, doch dann brach sie plötzlich ab und verlor sich zwischen den anderen Stimmen, wie *ein Funke*, der wieder in die *Kaminglut* zurückfällt.[494]

Në rastin e metaforës/epitet *e gjerë*:

> Kjo ishte një këngë *e gjerë* dhe e trishtuar.[495]

kemi një sinestezi. Kënga, që perceptohet zakonisht me organin e dëgjimit, rroket, konceptohet dhe e shtrirë në hapësirë. Fjala *i/e gjerë* ka si kuptim kryesor "që ka shtrirje të madhe në hapësirë në njërën nga përmasat (në gjerësi)…". Edhe kuptimet e tjera të kësaj fjale përshkohen nga semantema *shtrirje hapësinore.*[496]

Me anë të sinestezisë objekti fiton një dimension të ri që nuk e ka normalisht. Nëpërmjet konkretizimit të mëtejshëm të objektit, që perceptohet në mënyra të ndryshme, sinestezia ndikon dukshëm në rritjen e shprehësisë së thënies. Madje në

[490] Shih, Rousseau et Voltaire en 1978, *Actes du Colloge international de Nice,* Geneve/Paris, 1981, f. 55.
[491] Coseriu, Eugenio, *Textlinguistik*, Tübingen, 1994, f. 112.
[492] Shih dhe, Schneider, Stefan, *Eine Studie zur "Musikalität der Lyrik"*, Berlin, 2009, f. 457.
[493] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 81, 82.
[494] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 79.
[495] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 82.
[496] Shih, *Fjalori i Gjuhës Shqipe,* Tiranë, 1984, f. 381.

thënien e mësipërme, elementi *i gjerë* mund të interpretohet dhe si tregues kohe; kënga mund të vështrohet kështu si e hapësirshme, e vëllimshme (e gjerë), e gjatë (e trishtur, po që po). Kjo shtesë në interpretim përforcohet dhe nga sekuenca vijuese:

> Kjo ishte një këngë *e gjerë* dhe e trishtuar .
> Ik e ik.[497]

Një mjet interesant shfaqet në ligjërim: një folje e përsëritur që tregon lëvizje. Forca e saj ikastike ka të bëjë me natyrën e figurshme; me evokimin e një lëvizjeje që zgjat e nuk dihet ku dhe kur merr fund. Ideja e diçkaje që rrjedh e rrjedh e shoqëron soditjen e çastit. Ka dhe diçka tjetër që jepet me përsëritjen *ik e ik,* e panjohura. Soditësi nuk ka më informacion për këngën, për përmbajtjen e saj (*Ai dëgjonte këngën dhe mundohej të nxirrte me mend kuptimin e saj*). Prandaj ai distancohet nga mundimi për të rrokur kuptimin, stakohet së brendshmi dhe rrok vetëm zgjatjen e dukurisë në kohë. Sinestezia është e pranishme edhe këtu. Lëvizja që rroket me sy, gërshetohet me tingujt muzikorë, që perceptohen me vesh. Kështu kënga rroket e shtrirë në kohë e në hapësirë. Bashkimi *këngë e gjerë* është një nga ato lidhjet origjinale të fjalëve që realizon I. Kadareja në boshtin e kombinimeve.
Është tepër interesant përkthimi i këtij paragrafi në gjermanisht:

> Er lauschte dem Lied und versuchte, sich dessen Inhalt vorzustellen. Es *w*ar *ein getragenes Lied. Weg, nur Weg.*[498]

Përkthyesi gjerman flet për një këngë *të zvargët,* jo *të gjerë.* Ekuivalenca është e pjesshme, ose mund të flitet për një ekuivalencë sipas parimit të së tretës krahasuese. Jo të gjithë përbërësit semantikë janë të njëjtë. Fjala *e zvargët* në „Fjalorin e gjuhës shqipe“ ka kuptimin: *vijon më shumë se zakonisht, zgjatet e zvarritet, shtrihet në një gjatësi të madhe.*[499]

Në kuptimet e fjalës *i gjerë* në “Fjalorin e Gjuhës Shqipe” vetëm njëri prej tyre, kuptimi i gjashtë, është i afërt me atë të fjalës *i zvargët: që ka përhapje a shtrirje të madhe, që ka përmasa të mëdha.*[500]

Ky kuptim i përbashkët i bën fjalët të krahasueshme dhe përkthimin të arrirë, të përshtatshëm. Megjithatë elementit përgjegjës të përkthimit i mungojnë asociacioni, sinestezia dhe evokimet që zgjon përgjegjësja e gjuhës shqipe *e gjerë.* Ndërsa segmenti *ik e ik* jepet në gjermanisht me *ëeg, nur ëeg*. Përkthimi gjermanisht ka semantikë të ndryshme nga përgjegjësja shqipe. Ndërsa përsëritja e foljes *ik* në gjuhën shqipe jep idenë e diçkaje të zgjatur në kohë dhe në hapësirë (folja *ik* tregon lëvizje, e cila automatikisht lidhet me kohën, ndodh në kohë), përgjegjësja në gjermanisht shënon po ashtu lëvizje, por një lëvizje të dëshiruar, të kërkuar, të urdhëruar „sa më shpejt larg prej këtej“, virtuale, jo reale. Duke dhënë diçka të ndryshme kuptimisht nuk i përmban as asociacionet që evokon segmenti shqip.[501]

---

[497] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 82.
[498] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, General der toten Armee, Kiel, 1988, f. 79.
[499] Fjalori i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1984, f. 1403.
[500] Shih, po aty, f. 381.
[501] Mbi kuptimin e sinestezisë shih dhe: *Lexikon der Sprachwissenschaft,* Stuttgart, 2002, f. 671.

Në përkthim mungon edhe epiteti tjetër *e trishtuar*. Kjo mungesë bën edhe mosrrokjen e kuptimit në përkthim të gjendjes emocionale që transmetohet në rreshtat e këngës në shqip.

Krejt ndryshe përkthehet pasazhi i shqyrtuar deri më tani nga përkthyesi tjetër i këtij romani Joachim Röhm. Ai e jep idenë e zgjatjes në kohë dhe në hapësirë të këngës me mjete leksikore si më poshtë:

> Es ëar ein ëenig *in die Länge gezogenes*, *freudloses* Lied. Man ëollte am liebsten ëeglaufen, ëenn man es hörte.[502]

Përkthimi *Ishte një këngë pak e zgjatur në gjatësi, një këngë jo e gëzueshme. Kur e dëgjoje atë, do të doje më mirë të ikje* shfaq diferenca të dukshme nga origjinali i Kadaresë. Përkthimi i metaforës *e gjerë* me togun *pak e zgjatur në gjatësi* humb në transmetimin e elementeve kuptimorë të gjerësisë, të vëllimit. Po ashtu edhe sintagma tjetër *do të doje më mirë të ikje* ka semantikë pothuajse krejt të ndryshme nga kuptimi i foljes *ik.* Ndërsa përdorimi i fojes *ik* në shqip përforcon idenë e shtrirjes në kohë të këngës së dëgjuar, përkthimi gjermanisht i referohet procesit që ndodh kur dëgjon këtë këngë, dmth, ikjes, largimit nga vendi ku këndohej dhe dëgjohej kënga. Një përkthim i tillë jo i përshtatshëm bën që në gjuhën gjermane të mungojë jo vetëm forca evokuese dhe asociacioni i rrokur nga origjinali i Kadaresë në shqip, por madje të rroket krejt ndyshe kuptimi i emetuar nga Kadareja nga pasazhi i analizuar.
Edhe përdorimi në gjermanisht i epitetit tjetër *freudloses* për të dhënë idenë e trishtimit që transmeton kënga e kënduar nga punëtorët, edhe pse është dhënë sipas parimit të së tretës së krahasueshme, nuk është krejt identik me epitetin në shqip „i trishtuar“. Kuptimi i fjalës në gjermanisht *freudlos* ndërtohet nga kuptimet e semave *Freude* (gëzim) dhe *los* (pa). Ndërsa në shqip kuptimi *i trishtuar* vendos marrëdhënie antonimie me sememën *i gëzuar*, nuk mund të pohojmë të njëjtën marrëdhënie kuptimore të vendosur midis fjalës së prejardhur *freulos* dhe përbërësve të saj *Freude* dhe *los*. Kuptimi *jo i gëzueshëm* nuk është identik me i trishtuar. Në lidhje me kundërvënien kuptimore të antonimeve, gjuhëtari J. Thomai shkruan:

> “Po të hyjmë më thellë në kundërvënien kuptimore të antonimeve të gjuhës shqipe, do të vërejmë se kuptimi i njërës fjalë nuk është thjesht një mohim i kuptimit të fjalës së dytë. Fjala e dytë është antonim i fjalës së parë jo vetëm kur e përjashton kuptimin e fjalës së pare (dmth. kur kuptimi i saj nuk është si kuptimi i fjalës së parë), por edhe kur pohon kuptimin e kundërt.”[503]

Kjo do të thotë që kur përcaktojmë këngën me anë të epitetit *jo të gëzueshme,* vetëm sa e kemi mohuar mbiemrin *e gëzueshme*, por nuk kemi pohuar të kundërtën.

3.3.4.2.2 Tabloja II

Në tekstin e I. Kadaresë i takojmë jo rrallë përshkrimet gjuhësore që synojnë të imitojnë këngët, që të kujtojnë këngët, këngëtarët, melodité. Në tablonë e parë ne paraqitëm një ekspoze të tillë. Pasi e përshkroi njëherë atmosferën me këngë në të gjitha hollësitë e saj, autori u kthehet hera-herës çasteve të tilla, por nuk ndalet gjatë. Megjithatë, çasteve të tilla nuk u mungon gjallëria, ngjashmëria e synuar me jetën e gjallë.

[502] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 105.
[503] Thomai, Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2005, f. 137.

Në analizën tonë kemi përfshirë vetëm paraqitje të tilla që janë përfaqësuese e domethënëse për dukurinë me funksion ikastik që po përshkruajmë.
Diku, nga fundi i romanit (f. 177 – 192), gjendemi përsëri në një atmosferë me muzikë. Ligjërimi kadarean e ka zhvilluar tashmë aftësinë që të japë në formën e tingujve dhe fjalëve të shkruara, muzikë dhe gjithëfarë zhurmash e zërash të natyrës e jetës së gjallë. Skena për të cilën do të bëjmë fjalë përshkruan një dasmë tipike fshati. Ajo vjen e gjallë në perceptimin dhe parafytyrimin e lexuesit. Në këtë rast kemi dy fusha perceptimi, dy fusha të ndryshme fizike: kënga dhe vallja. Ato perceptohen njëkohësisht si një akt sinestezie audio-vizive. Sinestezia e prodhuar realizohet në rrafshin e tingujve të shkruar ose në rrafshin e fjalëve. Edhe tërë spektakli që gjëllin, ndriçon e tingëllon në tekst, realizohet vetëm me materie gjuhësore. Po ç’janë ato mjete e maniera çudibërëse që bëjnë të dëgjosh violinën, gërrnetën, daullen, të shohësh valltarët, vallet, lëvizjet e vrullshme në faqet e mbushura me shkronja e fjalë të romanit? Ndër mënyrat e rrëfimit letrar, këtu do të përmendnim si veçori të dukshme të tekstit mënyrën e paraqitjes së detajuar. Në tablonë që po analizojmë, kjo mënyrë prezantimi vlen edhe për këngët, por sidomos për vallet, për muzikën në përgjithësi, për orkestrën, për dasmën si burim tingujsh e zhurmash. Një mënyrë tjetër paraqitjeje është kompozimi i pamjeve, këmbimi i planeve: në fokus herë vihet një grup dasmorësh, herë një grup tjetër, herë individë, herë gjenerali dhe herë prifti. Kamera drejtohet në të gjitha segmentet, në të gjitha çastet, pamjet dhe zërat e dasmës. Një mënyrë tjetër interesante “xhirimi” e spektaklit është pozicionimi i rrëfyesit, i cili disa herë e sheh, e merr pamjen nga larg, disa herë nga afër. Kjo lidhet ngushtë me soditësin. Kështu spektakli paraqitet, në pjesën më të madhe të pamjeve të tij, ashtu siç i shfaqet soditësit, që është një i huaj. Para syve të tij shpaloset festa me këngë, valle, hare e zhurmë. Tërë konceptimi dhe prezantimi i skenës së dasmës përmban diçka nga reagimi perceptiv-ndjesor i gjeneralit ndaj saj. Pak a shumë, dasma jepet ashtu siç i shfaqet dhe i fanitet gjeneralit. Fakti, që në shumicën e rasteve çastet dasmore jepen nën prizmin e përshtypjeve të soditësit të mrekulluar, flet për ndikimin e fortë të këtij evenimenti tek ai. Ndikimi është maksimal, efekti është i papërballueshëm, aq sa soditësi, spektatori do të bëhet vetë aktor i spektaklit, do patjetër të ngrihet dhe ngrihet në valle.
Tani të merremi pak me objektet e përshkrimit të detajuar. Po fillojmë me orkestrën. Daullja është instrumenti sundues për nga forca tingëlluese. Gjëmimi i saj shoqërohet nga tingujt e violinës e të gërnetës:

> Vetëm kur daullja filloi të binte prapë plot buçimë dhe jehonë dhe kur violina ia mori me një tingull të mprehtë…,ai nisi të përqëndrohej.[504]
>
> Daullja buçiti prapë. Gërneta ia mori me të qarë. Violinat e ndoqën pas.[505]
>
> Daullja buçiti prapë si gjëmim topi. Gërneta ia mori me të qarë, violinat e ndoqën pas me zëra të hollë, si zëra grash.[506]
>
> Daullja sa vente gjëmonte më me tërbim, zëri i gërnetës vinte valë-valë…dhe telat e violinave vërtiteshin të gjallë si gjarpërinj. Ritmi i daulles sa vente bëhej më i shpeshtë dhe tani, përmes ngashërimit të violinave dukej sikur dikush rrokulliste shpella.[507]

[504] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 178.
[505] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 181.
[506] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 185.
[507] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 185.

Në të gjitha pasazhet përshkrimi natyralist shoqërohet me atë impresionist. Të dyja këndvështrimet, natyraliste dhe impresioniste, ndikojnë në dhënien e skenave me gjallërinë e vërtetësinë që i karakterizon realisht. Forca evokuese e paraqitjeve të tilla është e padiskutueshme. Rreshtat e përshkrimeve të hedhin në botën e tingujve. Një rol të rëndësishëm këtu luan përsëritja, janë të paktën katër pasazhe që merren me instrumentet e me tingëllimin e tyre. Nga pasazhi në pasazh mprehet dhe bëhet më i gjallë tingëllimi. Duke përsëritur e theksuar rolin e çdo instrumenti në orkestër, tingëllimin e tyre specifik, ofrohet njëkohësisht një realitet muzikor që përjetohet gjithashtu si i tillë edhe nga spektatori drejtpërdrejt, edhe nga lexuesi. Ndikimi i veçantë i pasazhit të mëposhtëm lidhet me sinestezinë, me kombinimin e dritërave dhe tingujve, dy dukuri që rroken me organe të ndryshme shqisash, por fqinjërojnë në ndërgjegje.

> Në gjoksin e tij gjenerali ndjeu një avull të ngrohtë. Atij iu duk se po çlodhej në një banjë dritërash dhe tingujsh. Dhe këto dritëra dhe tinguj… po ia hiqnin nga trupi i tij gjithë atë baltë varrezash…[508]

Mjete të tjera shprehëse gjuhësore, që përmbajnë forcë ikastike janë dhe:

- *Fjalët onomatopeike*: *buçet, buçimë, rrokullis, gjëmoj, gjëmim.* Të gjitha këto fjalë, sipas pikëpamjes së Platonit, evokojnë dukshëm në realiet e botës. Po t'i analizosh ato sipas po këtij këndvështrimi mbi motivimin ose jo të shenjës gjuhësore, ato rezultojnë të motivueshme, me etimologji të qartë. Etimoni shpjegon kuptimin e tyre. Përbërja tingëllore jep diçka nga zhurmat a nga tingujt që janë zhvilluar më pas në fjalë me kuptim e me formë gramatikore. Kujtojmë që në bisedën e tij me Kratilin Sokrati thekson idenë që ikoniciteti nuk është absolut, por i kufizuar. Me termin ikonicitet kemi emërtuar shenjën e motivueshme.[509]

Të motivueshme janë edhe fjalët e prejardhura. Ato motivohen me temën e tyre formuese dhe evokojnë direkt ato: *shtrembër- shtrembëroj, urrej- urrejtje, rënkoj-rënkim* e shumë të tjera.

Mjete të tjera, që luajnë rol në funksionin ikastik të pasazheve janë figurat e shumta letrare, si metafora, prozopopea, krahasimi, personifikimi, sinestezia, aliteracioni, etj.

> Pastaj daullja *heshti,* telat *u shkrehën* dhe gjithçka ishte e magjishme…[510]

> Tani dasma iu duk *si një organizëm* i madh amorf dhe i fuqishëm, që *merrte frymë, lëvizte, murmurinte, vallëzonte* dhe e *mbushte* gjithçka përreth me një afsh të ngrohtë, *dehës* dhe *të mjegullt.*[511]

Në thënien e sapocituar vlen të theksohet, që dasma e soditur nga larg, e konceptuar si një dukuri e përgjithshme, personifikohet, jepet *si një organizëm.* Siç kemi thënë, personifikimi është një nga mënyrat e efektshme për t'u dhënë dukurive e objekteve letrare ngjashmëri me realiet që ato shënojnë.

Le ta shohim se si jepen figurat me funskion ikastik në pasazhet e mësipërme në gjermanisht.

---

[508] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 180.
[509] Shih, Coseriu, Eugenio, *Textlinguistik: Eine Einführung*, Tübingen, 1981, f. 56.
[510] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 185.
[511] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 178..

O. Buchholz/W. Fiedler:

> Dann verstummte die Trommel, die Saiten entspannten sich, und alles war wie verzaubert.[512]
>
> Die Hochzeit wirkte auf ihn wie ein großer, mächtiger amorpher Organismus, der atmete, sich bewegte, murmelte, tanzte und alles ringsum in einen warmen, berauschenden Atem *hüllte*.[513]

Edhe përkthyesit O. Buchholz/W. Fiedler japin dhe përshkruajnë skenën e mësipërme në gjermanisht me mjete të tilla gjuhësore, që i veshin instrumenteve karakteristika njerëzore, si *verstummte (heshti), pushuan* (folja përdoret vetëm për njerëzit). Krahasimi ëie *ein amorpher Organismus* (si një organizëm amorf) e shpreh drejtpërdrejt ndjesinë e të përjetuarit të dasmës si një qenie me veçantitë njerëzore, si: marr frymë *(atmete*), pëshpëris (*murmeln*), kërcej *(tanzte*). Edhe atmosfera e krijuar nga dasma është si ajo që mund të krijohet nga një organizëm me frymë dhe jetë: *in einen warmen, berauschenden Atem* (...mbështillte me një frymë të ngrohtë dhe magjepsëse). Në këtë mënyrë, edhe lexuesi gjerman i variantit të J. Röhm-it e rrok dhe e përjeton dasmën njëlloj si lexuesi shqiptar që lexon përshkrimin e Kadaresë.

Ndërsa J. Röhm-i përpiqet t´i japë përmasa mitike rrokjes e perceptimit të dasmës nga gjenerali. Ai e quan dasmën jo si organizëm amorf, por si *riesenhaftes Geschöpf*[514]*(*një krijesë gjigjante), që merrte frymë (*atmete*), lëvizte (*beëegte*), gulçonte (*keuchte*) dhe mbushte gjithçka me avullin/afshin e tij trullosës/mpirës (*mit einem betäubenden Brodem erfüllte*). Shihet qartë se varianti i J. Röhmit është më larg origjinalit. Krahasimi i dasmës me një krijesë gjigjante ndikon edhe perceptimin e saj më madhështor, më pak realist nga dëgjuesi në roman, por edhe nga lexuesi i romanit.

Në pasazhet muzikore nuk mungojnë as aliteracionet:

> …këngët e ashpra të burrave që të kujtonin rrokullisjen e muzgjeve në pjerrësitë malore dhe këngët e zgjatura, të përmallshme grarishte, që dukej sikur mbështeteshin në supet e mëdha të këngëve të burrave dhe ecnin bashkë kokulur përjetësisht.[515]

Në materialin gjuhësor që ka zgjedhur e kombinuar I. Kadareja vihet re përsëritja e tingujve të caktuar, në rastin e këngëve të burrave përsëritet dridhësja *rr*, në paraqitjen e këngëve grarishte përdoren fjalë që përmbajnë të përsëritur vibranten *r* e *sh*- në e shurdhër.
Shfaqja e tingullit *rr* në fjalët me rëndësi kuptimore-emocionale *burrave, rrokullisje, pjerrësi* evokon idenë e diçkaje të fortë, të lëvizshme e të zhurmshme; ndërsa në karakterizimin që u bëhet këngëve të grave, shfaqen rëndom tingujt *r* e *sh* që mund të thuhet se simbolizojnë butësinë, bashkëlëvizjen, urtësinë.[516]

[512] Buchholz, Oda/ Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 175.
[513] Buchholz, Oda/ Fiedler, Wilfried, General der toten Armee, f. 167, 168.
[514] Röhm, Joachim, General der toten Armee, f. 223.
[515] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 179.
[516] Siç e theksuam edhe më lart, kjo dukuri ka lidhje me simbolizmin tingullor. Shoqërimet tingull-kuptim janë burim shprehësie. Psh., dhëmboret e grykoret të japin përshtypjen e rrokullisjes, buzoret shpërthimet dhe goditjet me jehpnë të mbytur. Shih, Lloshi, Xhevat, Stilistika dhe pragmatika, Tiranë, 1999, f. 59.

Edhe në përkthimin gjermanisht mund të flitet për një lloj aliteracioni, por tingujt, që përsëriten dhe asociacionet, që zgjon dukuria, janë të ndryshme nga ato në variantin shqip:

> …die rauhen Gesänge der Männer, die an die Dämmerung über den Gebirgshängen erinnerten, und die gedehnten, schwermütigen Frauenlieder, die sich gleichsam auf die breiten Schultern der Männerlieder stützen und die ständig gesenkten Hauptes an ihrer Seite schritten.[517]

I. Kadareja vjen në prozë nga poezia; romanin e tij “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” e ka shkruar në rini, në moshën 26 vjeç. I. Kadareja është prozator, por njëherazi edhe poet. Madje poezia i ka qëndruar pranë dhe shoqëruar përgjatë tërë jetës, duke sjellë në visarin e poezisë shqipe modele poetike të pakapërcyeshme. Kjo gjë ka kushtëzuar dhe disa veçori të stilit e të gjuhës së tij. E kam fjalën këtu për figuracionin e pasur dhe ekspresiv, për muzikalitetin, për impresionizmin në përshkrim etj. Edhe aliteracioni si mjet efektbërës perdoret rëndom në poezi. Një nga mënyrat që prodhon muzikalitet është dhe përdorimi i fjalive me gjatësi të ndryshme, alternimi i tyre:[518]

> Gjenerali vështroi vallen. Pastaj vështroi priftin. Pastaj prapë vallen. Pastaj priftin. Vallen. Priftin. Vallen.[519]
>
> Der General blickte zu den Tanzenden, dann zu dem Priester hinüber, dann wieder zu den Tanzenden. Dann zum Priester. Zu den Tanzenden. Zum Priester. Zu den Tänzern. Aber...
>
> Der General schaute auf die Tanzenden.Dann auf den Priester. Dann wieder auf die Tanzenden. Den Priester. Die Tanzenden. Priester. Tanz. Und dann...[520]

Meqë fjalitë e cituara përmbajnë pothuaj të njëjtat fjalë, duhen lexuar me intonacione të ndryshme për t’i dalluar nga njëra-tjetra. Linjat e ndryshme intonacionore prodhojnë muzikalitet. Segmentimi i rrjedhës ligjërimore me ritëm ndikon në këtë rast edhe në anën semantike, duke vendosur lidhje kuptimore plotësuese. Fjalë të caktuara përsëriten, fjalitë vijnë duke u shkurtuar, duke rritur në këtë mënyrë dramacitetin e gjendjes emocionale të përjetuar nga gjenerali.

Xh. Lloshi, po ashtu, e pohon faktin se “Segmentimi i rrjedhës ligjërimore me ritëm ndikon edhe në anën semantike, duke vendosur lidhje kuptimore plotësuese.”[521]

Përqasja e përkthimeve me origjinalin tregon se J. Röhm-i i qëndron më besnik ritmit të origjinalit. O. Buchholz/ W. Fiedleri bashkojnë tri fjalitë e para të origjinalit në një fjali. Në këtë mënyrë, ritmi nuk i ngjason atij në shqip dhe nuk ka atë domethënie plotësuese si varianti i Kadaresë.

Si mjet theksimi, si mjet me forcë të veçantë ndikuese që përforcon realitetin e gjërave, është dhe përsëritja, jo e fjalëve dhe e sintagmave, por e pasazheve të tëra:

> Daullja binte prapë me një buçimë të shurdhër, dhe gërneta ngjirej e ngashërehej dhe e përshkonte dasmën tejpërtej. Burrat ia kishin marrë këngës në tryezë dhe gjenerali ndjeu prapë

[517] Kadare, Ismail, *General der toten Armee*, Kiel, 1988, f. 169.
[518] Shih, Schneider, Stefan, *Eine Studie zur Musikalität der Lyrik*, Berlin, 2009, f. 197.
[519] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 185.
[520] Röhm, Joachim, General der toten Armee, f. 232.
[521] Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999, f. 58.

> muzgjet që rrokulliseshin nëpër male dhe këngën e përmallshme kokulur grarishte, që shtrëngohej dhe i merrej fryma prej këngës së burrave.[522]

Përsëritja e përshkrimit të këngëve i bën ato akoma më tingëlluese, akoma më të ngjashme me këngët e një dasme reale.

Një mjet tjetër që synon ngjashmëri me dukuritë e botës sonë është dhe përdorimi i leksemave në vargje, i enumeracionit:

> Gjenerali hodhi sytë e turbulluar përreth dhe pa përsëri tërë atë mizëri njerëzish që *lëviznin, vallëzonin, qeshnin…*

Me anë të renditjes të disa foljeve jepet jo një skenë, por një spektakël i gjithë. I realizuar në film, ky përshkrim do të përbëhej nga disa plane dhe do të nxirrte krejt në pah vitalitetin dhe vërtetësinë e çasteve të tilla.

Spektakli i dasmës përmban, veç këngëve edhe valle, madje valleve u kushtohet vëmendje e veçantë për t’i dhënë të detajuara në autenticitetin e tyre. Kushdo që ka parë në skenë a në natyrë koncerte me valle popullore shqiptare, do t’i rinjohë ato menjëherë në spektaklin kadarejan. Kaq ngjashmëri kanë ato të romanit me këtë lloj arti popullor. Madje shfaqjet e valleve në spektaklin e dasmës në roman bartin diçka me shumë epicitet, emocion, vrull, energji. Kjo shpjegohet, ndër të tjera, dhe me soditësin, mesazhmarrësin. Dihet që mesazhmarrësi ka pjesën e rolin e tij në veprën a në shfaqjen artistike. Ai i jep përjetimet e veta pjesës, reagimi i tij logjik-emocional i shtresohet planeve prezantuese të gjithë atmosferës së veprës artistike. Në rastin tonë marrësi, soditësi i spektaklit është një i huaj që mrekullohet nga ai art madhështor. Skena rroket si një magji, si një ekstazë koreografike:

> Atij iu duk se ky rreth ishte i zjarrtë. Dy-tri herë zgjati duart dhe i tërhoqi në çast sikur t´i digjeshin. Vallja vërtitej përpara tij si një fugë. Plaku që e hiqte, ulej e ngrihej mbi gjunjë, përplaste njërën këmbë në dysheme, sikur thoshte “kjo është kështu dhe kështu do të mbetet”, vërtiste shaminë e bardhë, kur shkëputej prej shokut, rrotullohej dhe thyente gjunjët dhe dukej sikur do të binte përdhe i kositur nga drapri, pastaj prapë ngrihej dhe prapë këputej e binte si i goditur nga rrufeja dhe prapë ringjallej në çast nën gjëmimin e bubullimave…[523]

Një valle nuk mund të jepet më e gjallë se kaq me materie gjuhësore. Është një pikturë që flet e që tingëllon. Nëse do të ndiqnim një për një lëvizjet dhe gjestet e dhëna në përshkrim, do të mund ta kërcenim dhe ne vallen. Pasazhi përmban elementet e rëndësishme të një dukurie të tillë siç është vallja, gjë që e bën atë të ngjashme me një valle reale. Gjestet rrjedhin në kohë në një rend të caktuar, njëri pas tjetrit. Valltari ka në dorë një shami që e vërtit. Nuk mungon as ritmi, në kuptimin e përsëritjes së rregullt të një lëvizjeje dhe në kuptimin e shpejtësisë.[524]

Figuracioni i përdorur: *i kositur nga drapri, si i goditur nga rrufeja, ringjallej, nën gjëmimin e bubullimave* ndihmon gjithashtu në realizimin e një skene me vërtetësi jetësore.

[522] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 190.
[523] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 185.
[524] Në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”,online, vallja përshkruhet, si një lloj kërcimi, gjatë të cilit bëhen lëvizje të rregullta të trupit e të gjymtyrëve.

Përkthimi në gjuhën gjermane është bërë me një besnikëri të veçantë. Përgjegjëset e gjetura nga përkthyesit famozë O. Buchholz/ W. Fiedleri janë të përshtatshme gjuhësisht dhe stilistikisht:

> Der Reigen erschien ihm wie ein feuriger Kreis. Ein paarmal streckte er die Hände aus, zog sie aber gleich wieder zurück, als hätte er sich verbrannt. Der Reigen drehte sich vor ihm wie ein Wirbelsturm. Der Alte, der ihn anführte, ging in die Knie und reckte sich wieder, er stampfte mit einem Fuß auf den Boden, als ob er sagen wollte: So ist es, und so wird es bleiben, schwenkte sein weißes Tuch, sobald er sich von den Gefährten löste, drehte sich und beugte die Knie, und er sah aus, als ob er zu Boden fallen müsste, *wie von der Sichel gemäht*. Dann erhob er sich abermals, sank erneut zusammen und fiel wieder, wie vom Blitz getroffen, um gleich darauf im Getöse des Donners wiederaufzustehen…[525]

Edhe në përkthimin gjermanisht është ruajtur ritmi, që i jep përshkrimit edhe muzikalitet, edhe plastikë. Figurat e përdorura në gjermanisht *wie vom Sichel gemäht* (si i kositur nga drapri), *wie vom Blitz getroffen* (si i goditur nga rrufeja), *im Getöse des Donners wiederaufzustehen* (për t`u ringjallur nën gjëmimin e bubullimës) e paraqesin skenën e valles po aq me vërtetësi sa edhe në origjinalin e Kadaresë.

Jo kaq besnik variantit të shqipes qëndron përkthimi i këtij pazazhi nga J. Röhmi.

> Er stand da und ëartete auf die Gelegenheit, sich in den Kreis einzureihen, der sich vor ihm drehte wie ein Feuerring. Mehrmals streckte er die Hand aus, zog sie aber sogleich wieder zurück, weil er fürchtete, sich zu verbrennen. Vor ihm flackerten die Flammen. Der Alte, der den Reigen anführte, sank auf die Knie und sprang wieder auf, strampfte mit dem Bein auf den Boden, als wolle er sagen: „Seht,so ist es und so bleibt es!“, schëenkte sein ëeißes Tuch, löste sich von seinem Tanzpartner, drehte sich um die eigene Achse, beugte erneut das Knie, sank dann *wie wiedergemäht zu Boden*, stand *sofort wieder auf* und *knickte wieder ein und stürzte erneut wie vom Blitz getroffen hin*, doch nur, *um unter den Donnerklängen der Trommel sogleich wieder zum Leben zu erwachen.*

Diferencat në rrafshet gjuhësore, stilistikore, por edhe përshkrimi i valles me konstrukte fjalish jo të njëjta me ato të origjinalit të Kadaresë ndikon në mosruajtjen e ritmit dhe muzikalitetit të përshkrimit. Figuracioni që transmeton J. Röhm-i në gjermanisht: *wie wiedergemäht zu Boden* (në dysheme si i kositur), *stürzte erneut wie vom Blitz getroffen* (dhe u rrëzua përsëri si i goditur nga rrufeja), *um unter den Donnerklängen der Trommel sogleich wieder zum Leben zu erwachen* (për t`u ardhur në jetë përsëri nën tingëllimat bubullitëse të daulles), si edhe dhënia e emrit valle përmes *Feuerring* (rreth zjarrtor), shtimi i fjalisë *vor ihm flackerten die Flammen* (para tij flakëronin valët) e paraqesin jo me shumë realitet vallen shqiptare dhe zgjojnë jo të njëjtat asociacione te lexuesi gjerman, si origjinali në shqip.

Është me shumë interes të theksojmë, që paraqitjet, përshkrimet e romanit „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ evokojnë me gjithëfarë asociacionesh përjetimet dhe ngjarjet e gjithëllojshme të botës e jetës sonë. Por ndodh dhe e kundërta, jo vetëm me këtë roman, por me tërë veprën e I. Kadaresë. Në shumë çaste, në jetën tonë të përditshme, përjetimet, veprimet, bëmat tona na hedhin me asociacion në truallin e artit kadarean. Kjo është dëshmia më e plotë e raportit solid dhe reciprok midis jetës dhe artit.

[525] Kadare, Ismail, *General der toten Armee*, Kiel, 1988, f. 175.

3.3.4.2.3 Plaka Nicë - një klithmë dëshpërimi

Siç duket njeriu ka një kufi, pas të cilit nuk ka më komunikim verbal, por klithmor

Në kuadrin e studimit tonë, plaka Nicë do të karakterizohet duke u nisur nga reagimet e saj ndaj situatës ku është gjendur si spektatore e dasmës. Është vërtet diçka e veçantë personi Nicë dhe marrëdhënia e saj me gjendjen përreth. Në pamjen piktoreske që na jepet në roman, burrat dhe gratë e moshuara janë vendosur në sfond të dasmës. Ose kështu rroket vendosja e tyre prej gjeneralit:

> Ai i pa me radhë pleqtë me mustaqe të mëdha që rrinin këmbëkryq mbi minder, bisedonin shtruar dhe thithnin çibukët e tyre të gjatë … plakat e veshura me të zeza, me fytyra të përvuajtura e të nemitura, me sy të mallëngjyer e të dhimbshëm, si një radhë ikonash të zbehta.[526]

Në përkthimin e O. Buchholz/ W. Fiedler-it gjermanisht, portretet janë dhënë si në origjinal, janë vizatuar si një kopje besnike e një tabloje origjinale. Vlen të përmendet që për objektin a për fjalën “minder”, në gjermanisht jepet përgjegjësja e goditur *gepolsterte Bank* (stol i veshur), që nuk është gjithsesi e njëjta gjë. Objekti mungon në kulturën gjermane, prandaj prezantimi i tij në përkthim bëhet me një togfjalësh me kuptim të përafërt:

> Er musterte der Reihe nach die alten Männer mit den grossen Schnurrbärten, die auf den gepolsterten Bänken saßen… sie plauderten gemütlich und rauchten ihre langen Pfeifen… und schliesslich die schwarz gekleideten Greisinnen mit ihren leidgeprägten, stummen Gesichtern und den Augen voll Rührung und Schmerz. Sie wirkten wie eine Reihe bleicher Ikonen.[527]

Më larg origjinalit është varianti i përkthyer nga J. Röhm-i. Konstruktuktet sintaksore të variantit të Röhm-it japin informacionin në formë më të ngjeshur; ai nuk e tregon pamjen e vëzhguar nga gjenerali në fjali të thjeshta, të cilat kanë formën e një ligjërimi bisedor gjatë të cilit tregohet. Këtë përshkrim të portreteve ai i jep në stilin tekniko-shkencor. Në gjermanisht, shenjuese e këtij stili janë konstuktet e fjalive me pjesore në funksionin e përcaktorit. Konkretisht, përkthimi i J. Röhm-it është:

> Er sah die mit gewaltigen Schnurbärten geschmückten Greise mit untergeschlagenen Beinen auf der Wandbank sitzen und sich geruhsam unterhalten, wobei si hin und wieder an ihren langen Pfeifen zogen.[528]

Ripërkthimi literal i variantit të Röhm-it është:

> Ai pa ulur pleqtë e zbukuruar me mustaqet e mëdha, me këmbët mbledhur në stolin në mur dhe ata bisedonin të qetë, ndërkohë që herë pas here ata thithnin çibukët e tyre.

Siç zbulohet edhe nga ripërkthimi i përkthimit të J. Röhm-it, dendësia e informacionit i humb tablosë së përshkruar nga Kadareja qartësinë dhe ikonicitetin e saj. Po ashtu, diferenca më të mëdha kuptimore evidentojmë edhe nëse krahasojmë kuptimet/domethëniet gjegjëse: *minder* vs. *Wandbank*. Edhe përshkrimet e figurave të pleqve, të përvuajtura, të nemitura, nuk jepen në përkthimin e J. Röhm-it.

[526] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 179.
[527] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 168
[528] Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 223, 224.

Skena të kujton një pikturë me protrete, madje dhe vetë shkrimtari i karakterizon gratë si një “radhë ikonash të zbehta”. Por pamja, në dukje aq e qetë, e ka shqetësimin brenda. Nica, atje midis plakave të nemitura, fillon të shqetësohet, të trazohet, të reagojë. Prania e gjeneralit e nxjerr atë nga shushatja e zakonshme pleqërore. Është tepër interesant komunikimi i saj. Ajo vjen në skenë me një monolog të brendshëm, variantet gjermanisht të të cilit janë një prezantim i përshtatshëm i atij shqip:

> Unë nuk e di i cilës ushtri je ti…[529]
> Ich weiss nicht, von welcher Armee du bist…[530]
> Ich weiß nicht, zu welcher dieser Armee du gehörst.[531]

Monologu ndërtohet me materie gjuhësore të menduar. Komunikimi i plakës Nicë rrjedh në disa etapa e shkallë. Brenda monologut të brendshëm lindin, së pari, tinguj të artikuluar vetëm me lëvizje të buzëve:

> po rri këtu dhe po lëviz buzët duke të mallkuar ngadalë, fare ngadalë, që të mos dëgjojë njeri…[532]

Përkthimi, në të dyja variantet gjermanisht, rrjedh sipas formulës 1:1, domethënë fjalë për fjalë. Dallimi i vetëm në variantin e J. Röhm-it është përkthimi i sintagmës lëviz buzët me foljen *murmeln* (mërmëris), e cila është me natyrë onomatopeike, çka e rrit forcën ikastike të përkthimit.

> … darum sitze ich hier, in der Ecke und bewege die Lippen und verfluche dich leise, ganz leise, damit niemand es hört…[533]
> Aso sitze ich in meiner Ecke und murmle vor mivh hin, verfluche dich, aber nur leise, damit niemand es hört.[534]

Nica vazhdon të reagojë me gjuhë të brendshme. Janë disa monologë të saj para shpërthimit. Dihet që njerëzit e përmbajnë veten, zakonisht i përmbajnë emocionet deri në një farë pragu. Pastaj vjen nxjerrja jashtë e emocionit me anë mjetesh gjuhësore ose jogjuhësore. Nica bluan e ribluan përbrenda indinjatën për gjeneralin që merr pjesë në gëzimin e dasmës, vuan tmerrësisht nga kujtimet e hidhura që i ngjall ai ushtarak i huaj. Nën trysninë e ndjenjave dhe emocioneve negative që ajo nuk i mposht dot më, reagon fuqishëm. Jo me mjete gjuhësore kuptimplote, por me pasthirrma:

> …kur njerëzit po ktheheshin nëpër vende, u ndie një rënkim. Gjeneralin sikur e shpoi diçka. …Të gjithë e ndien atë rënkim. Askujt nuk mund t’ia merrte mendja se rënkimi i plakës Nicë mund të ishte aq i fortë.
> - *Oi, oi,*- qau ajo me zë të hollë…[535]

Në gjermanisht:

> ... doch gerade als die Tanzenden zu ihren Plätzen zurückkehrten, hörte man ein Stöhnen. Dem General war als durchbohrte ihn etwas.... – jeder hatte das Stöhnen vernommen. Keinem wäre es in dem Sinn gekommen, daß die alte Nica so laut stöhnen konnte:
> - “*O-i, o-i!*” klagte sie mit hoher Stimme...[536]

[529] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë, 1981, f.179.
[530] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 169.
[531] Röhm, Joachim, General der toten Armee, f. 225.
[532] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë, 1981, f. 180.
[533] Kadare, I. Der General der toten Armee, München, 1990, f. 169
[534] Röhm, Joachim, General der toten Armee, f. 225.
[535] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë, 1981, f. 186

Dhe gjithnjë reagimi i plakës Nicë do të bëhet me mjete shprehëse afektive. Në të gjitha skenat me Nicën nuk ka thënie e ligjërime të saj të formuluara me fjalë të zakonshme, të kuptimshme. Komunikimi i saj është afektiv. Edhe kur ajo komunikon diçka verbalisht (në momentin që sjell thesin), nuk jepet ligjërimi i saj, shprehjet e saj, por shfaqet vetëm reagimi i njerëzve të dasmës. Komunikimi me anë të pasthirrmave dhe onomatopeve është një mundësi shumë e mirë e shprehjes së ndjenjave. Lidhur me këtë, Rousseau thotë se: *pasthirrmat dhe onomatopetë kanë gjithnjë origjinë shpirtërore.*[537]

Po sipas Rousseau-së pasthirrmat janë imitime të ndjesive të natyrshme, por përmbajnë në vetvete edhe konvencionalizëm të përcaktuar nga kultura. Edhe onomatopetë nuk janë imitime krejt natyrore, edhe në to ka konvencionalizëm socialkulturor. Të njëjtin mendim mbron dhe E. Coseriu. Me këtë mendim, Rousseau-i i kundërvihet Nicolas Beauzee-së, i cili në përmbledhjen e tij mbi veprën e Ch. de Brosses, pranon që pasthirrmat janë shprehje të natyrshme të ndjenjave të kushtëzuara nga trupi njerëzor.[538]

Qëndrimi se në onomatopetë ka konvencionalizëm sociokultuor mbështetet edhe nga analiza e përkthimeve të pasthirrmave të plakës Nicë. O*i* në gjuhën shqipe përdoret për të shënuar përafërsisht zërin e njeriut kur qan.[539] *O-i* jepet e qara e plakës Nicë në gjermanisht nga Buchholz/Fiedleri dhe *ah, ah*[540] përdor Röhmi si gjegjëse në gjermanisht. Përkthimi në dy mënyra të ndryshme i onomatopesë lidhet me mungesën e një onomatopeje në gjuhën gjermane që shënon të qarën. Në rastin e përkthimit të Buchholz/Fiedlerit kemi një kombinim të pasthirrmës *o,* shprehëse e ndjenjës së gëzimit, të mallit, të frikës, më së shumti e lidhur me fjalë të tjera me pasthirrmën *i*, shprehëse e ndjenjës së neverisë. Për këtë arsye përkthyesit përdorin vizën ndarëse. Ata e shoqërojnë onomatopenë me foljen *klagen*, e cila është e ligjërimit libror dhe ka kuptimin e të shprehurit të dhembjes me zë të lartë.

Jo kaq e përshtatshme është gjegjësja e përdorur nga Röhmi. *Ah* sipas shpjegimit të fjalorit Duden online përdoret për të shprehur ndjenjën e mahnisë, habisë, gëzimit dhe të të kuptuarit të menjëhershëm. Asnjë prej këtyre ndjenjave nuk emeton onomatopeja në shqip *oi.*

Fjalët, që plaka Nicë ia përplas gjeneralit para se të largohej nga dasma, nuk jepen në ligjëratë të drejtë. Madje nuk është e qartë, nëse i tha apo jo ndonjë mendim të artikuluar gjuhësisht. Varianti shqip dhe ato gjermanisht japin të njëjtën situatë me mjete ekuivalente:

> …por ajo thirri dhe u shkëput dhe erdhi e ndaloi përpara gjeneralit. Ai pa fytyrën e shtrembëruar nga urrejtja dhe nuk kuptoi asgjë. Ajo seç i thërriti, i bëri gjeste, i ulëriu mu në fytyrë dhe ai ndenji para saj dyllë i verdhë…[541]
>
> …doch sie schrie, riß sich los und blieb vor dem General stehen. Er sah das hasserfüllte

[536] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *General der toten Armee*, f. 175.
[537] Rousseau, Jean –Jacques, *Essai sur l'origine des langues. Texte établi et annoté par Ch. Porset*. Bordeaux, Ducros, 1968, f. 33.
[538] Shih, Raymund, Wilhelm, *Die Sprache der Affekte*, Tübingen, 2001, f. 333.
[539] Shih, Fjalor i gjuhës shqipe, online, fjala oi.
[540] Shih, Röhm, Joachim, *General der toten Armee*, f. 233.
[541] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 186.

> Gesicht und begriff gar nichts. Sie rief ihm etwas zu, gestikulierte, schrie ihm etwas ins Gesicht, und er stand wachsbleich vor ihr.[542]
>
> ...doch sie schrie und riß sich los und kam auf den General zu und blieb vor ihm stehen. Er sah ihre ausgelösten Züge und begriff gar nichts. Sie gestikulierte, kreischte, schrie ihm etwas ins Gesicht, doch er stand nur leichenblaß da.[543]

Ekuivalencë të pjesshme vendosin në përkthimin e J. Röhm-it mjetet gjuhësore e *shtrembëruar nga urrejtja* vs. *ausgelösten Züge* (përvijime të lëna të lira), *thërras* vs. *kreischen* (çirrem), *dyllë i verdhë* vs. *leichenblaß* (i bardhë si kufomë). Mosshprehja në mënyrë të drejtpërdrejtë, eksplicite e shkakut të shtrembërimit të fytyrës, dhënia me intensitet më të lartë e zemërimit përmes foljes *çirrem* e japin portetin e plakës Nicë më të egërsuar dhe të inatosur se në origjinal. Nga ana tjetër, edhe ndikimi dhe perceptimi i këtij portrteti te gjenerali është më i fuqishëm se në variantin shqip. Përdorimi i mbiemrit *i bardhë si kufomë,* në variantin e J. Röhm-it, ndikojnë në pikturimin e një portreti të gjeneralit shumë të frikësuar; ai ngjet me kuformat.
Duam të vemë në dukje në këtë pasazh edhe një lakunë tjetër gjuhësore, që është njëkohësisht edhe lakunë kulturore, dhe lidhet me konceptualizime dhe përcaktime të ndryshme të ngjyrës së fytyrës në raste frike. Gjermanët nuk e perceptojnë dhe konceptualizojnë ngjyrën e fytyrës *dyllë të verdhë*, por *të zbehtë si dylli*[544]

Nuk ka asnjë thënie të Nicës të dhënë në ligjëratë të drejtë. Përmbajtja e mendimeve, ndjenjave, e tërë reagimeve të saj jepet ose me monologë të brendshëm, ose me pasthirrma, a fjalë onomatopeike, ose me ligjëratë të zhdrejtë:

> Ti po ngrihesh në valle? Ti guxon të ngrihesh në valle? Po vë buzën në gaz?...
> Du wagst es, dich zum Tanz zu erheben? Und lächelst noch dabei …[545]
> Du wagst es tatsächlich zu tanzen? Wie du grinst![546]

Në përkthimin e O. Buchholz/W. Fiedler-it, si edhe në atë të J. Röhm-it, mendimet dhe monologët e brendshëm formulohen disi më ndryshe. Kadareja e përsërit pyetjen në gojën e plakës Nicë, duke shprehur të përforcuar në këtë mënyrë habinë të shoqëruar nga zemërimi. Përkthyesit O. Buchholz/W. Fiedleri nuk e transmetojnë në të njëjtën shkallë zemërimin, si Kadareja. Ndryshe nga dy përkthyesit e parë, J. Röhm-i përdor ndajfoljen *tatsächlich* (me të vërtetë) për të shprehur të përforcuar ndjenjën e zemërimit të saj. Edhe dhënia e pyetjes *Po vë buzën në gaz?* duke nënkuptuar njëherazi mllef dhe habi, shpreh në mënyrë më të hapur mospëlqimin e saj për veprimin e gjeneralit, çka implikon edhe një ndjenjë zemërimi më të fortë.

> …por plaka Nicë vajtoi përsëri… u dëgjua një e thirrur e saj…prapë vaji i saj u ngrit mbi zërat… por plaka Nicë klithi dhe më fort…[547]
> Die alte Nica jedoch stieß erneut einen Klageruf aus…man vernahm auf einmal einen lauten Schrei von ihr… und wieder erhob sich ihr Klagen über die anderen… doch die alte Nica schrie noch lauter…[548]
> Doch die alte Nica begann erneut zu klagen. ... nun war sogar ein Schrei zu vernehmen. ... bis sich schließlich das Jammern der Alten wieder über die Stimmen erhob ...[549]

[542] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee, München*, 1990, f, 181
[543] Röhm, Joachim, *Der General der toten Armee*, f. 234.
[544] Varianti i Oda Buchholz/ Wilfried Fiedlerit.
[545] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 174.
[546] Röhm, Joachim, *Der General der toten Armee*, f. 232.
[547] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 186.
[548] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 176.

Do të ndalemi vetëm në dallimet kuptimore të elementeve gjuhësore midis tri varianteve, që ndikojnë në përshkrimin apo dhënien në mënyra jo të njëjta të dhimbjes së plakës Nicë. Ato janë: *e thirrur* vs. *Klageruf* (e thirrur në formë vaji) vs. *zu klagen* (të vajtoj); *vaji u ngrit* vs. *erhob sich ihr Klagen* (u ngrit vaji i saj) vs. *das Jammern sich über die Stimmen erhob* (u ngrit vaji mbi zërat); *klithi më fort* vs. *schrie noch lauter* (klithi më fort) vs. *war sogar ein Schrei zu vernehmen* (madje u perceptua një klithmë). Siç shihet nga ripërkthimi i përkthimeve, komponentet jo të njëjta kuptimore lidhen me mënyrën jo të njëjtë të të shprehurit të ndjenjave të brendshme.

Ndërsa përkthimi i mëposhtëm i përgjigjet origjinalit në të gjithë komponentët:

> Ajo thotë se ka vrarë dikur një oficer madhor nga tanët dhe pyet a jeni ju ai gjenerali që mbledh eshtrat e ushtarakëve.[550]

> Sie sagt, sie habe einen höheren Offizier, einen von den unseren getötet. Sie fragt, ob Sie der General seien, der die Gebeine der Soldaten zusammensucht.

Nuk gjendet asnjë mesazh fjalësor i Nicës. Reagimi i saj është joverbal. Ajo reagon me gjeste *(me fytyrën e shtrembëruar nga urrejtja),* me fjalë afektive onomatopeike (*thërriti, ulëriu).* Është një reaksion i natyrshëm i një personi të ngacmuar thellë në plagët e tij, një reaksion me britma. Në sajë të një komunikimi dhe të një reagimi të tillë, plaka Nicë përbën një figurë të spikatur, të dalluar nga figurat e tjera të romanit, jo vetëm nga jeta, nga fati, por dhe nga mënyra se si ngacmohet, nga ndjeshmëria ndaj ngacmimeve, e para së gjithash, nga mënyra se si reagon. Reagimi i saj është fund e krye emocional. Te monologët dhe reagimet e tjera të Nicës vihet re rëndësia e roli i mjeteve paragjuhësore (gjeste, pasthirrma, onomatope) për të karakterizuar situatat dhe personazhet vepruese në këto situata. Mjete të tilla komunikimi japin natyrshmërinë e reaksioneve spontane, evokojnë ligjërimin me ngjyra primitive të njerëzve emocionalë. Pas gjithë atyre ligjëratave e ligjërimeve, herë filozofike, herë të zgjatura e të argumentuara, herë të shkurtra e me një logjikë të prerë, herë si në drama, herë si në jetën e përditshme etj., vjen një lloj i veçantë ligjërimi, ai i plakës Nicë. Këtu emocionet jepen me materie gjuhësore, që shprehin vetëm ndjenja. Me Nicën, në tërësinë e saj njerëzore-ligjërimore, romani arrin kulmin.

Reagimi, sjelljet e Nicës krijojnë një atmosferë të shqetësuar e të zhurmshme. Pas largimit të saj gjithçka është në lëvizje, në tension e në çudi. Kjo skenë jepet po ashtu e përthyer në prizmin ndjesor-emocional të gjeneralit. Figuracioni është i fuqishëm:

> Gjithë ky grumbull njerëzish, që në fillim i ishte dukur *si një korije e shumëngjyrshme, fjalëshumë,* tani ishte kthyer papritur në *një pyll të ngrysur dimëror.* Tundeshin kokat, krahët, duart, gishtat e thatë përkuleshin sa andej-këndej *si degët e zhveshura* nga rrebeshi,...[551]

> Diese Menschensammlung, die ihm zu Beginn *wie ein bunter, rauschender Hain* erschienen war, hatte sich für ihn auf einmal *in einen finsteren Winterwald* verwandelt. Da bewegten sich Köpfe, Schultern, Arme und knochige Finger, die *wie vom Sturmwind* entlaubte,....[552]

> Die Menschenmenge, die bisher einem *farbenprächtigen, von Worten summenden Hain* gegliechen hatte, war schlagartigzu einem *düsteren Winterwald* geworden. Köpfe wurden

[549] Röhm, Joachim, Der General der toten Armee, f. 234.
[550] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 191.
[551] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 187.
[552] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 144.

> geschüttelt, Arme, Hände und dürre Finger flogen auf und ab wie entlaubte Zweige im Hagelschauer,...[553]

Krahasimet, metaforat, epitetet e vitalizojnë përshkrimin, duke e bërë më ndikues, më efektbërës. Elementet e natyrës, të përdorura për krahasim e për karakterizim, sjellin në pasazh natyrshmërinë e tyre, Figurat, si krahasimet, metaforat, metonimitë, prozopopeja, evokojnë zakonisht realiet, imazhet, konceptet e të cilave lidhen me to. Forca ikastike në këtë rast ka të bëjë me aftësinë dhe forcën evokuese të figurave, si dhe me ndikimin e veçantë. Konkretisht: krahët, duart, gishtat e dasmorëve, të krahasuara me *degët e zhveshura nga rrebeshi* fitojnë tjetër formë e përmbajtje. I gjithë përshkrimi ka ngjyra të një pikture surealiste dhe kjo: falë figurave.
Me të njëjtin kolorit vjen përkthimi i figurave nga J. Röhm-i dhe O. Buchholz/W. Fiedler-i. Röhm-i i krahason krahët, duart, gishtat e dasmorëve me *degët e zhveshura nga rrebeshi*, ndërsa O. Buchholz/ W. Fiedler-i me degët e zhveshura nga stuhia.

Por ajo që na intereson veçanërisht, është pjesa apo fjalia e fundit e përshkrimit:

> … dhe pastaj mbi të gjitha këto, me një *“krra”* të thatë fluturonte shqetësimi.

Kadareja e përdor shpesh këtë manevrim. Pikërisht në mes të ligjërimit të realizuar me mjete të zakonshme shenjore gjuhësore (siç janë fjalët kuptimplote, fjalët shërbyese etj.) plas një onomatope (ose pasthirrmë). Efekti është i veçantë. Në rastin tonë shqetësimi animizohet dhe këlthet si shpend: *krra*.

Në përkthimin gjermanisht:

> … und dann flatterte über das Ganze mit einem trockenen *Krächzen* die Unruhe hinweg.[554]
> ...und über allem kresite trocken krächzend die Sorge. [555]

Si përgjegjëse e onomatopesë „krra“ jepet fjala onomatopeike „krächzen“, që ka kuptimin *krakërin* (korbi)[556]

Në pikëpamje denotative është dhënë përmbajtja e elementit shqip, me saktësi, por i mungon diçka nga ngjyrimi afektiv-evokativ i origjinalit. Onomatopeja është gjithnjë imitim më i përshtatshëm i tingujve natyrorë, është element më efektbërës se fjala përgjegjëse onomatopeike. Kjo ndodh edhe për shkak të kontrastit që lind gjatë përdorimit të tyre në një kontekst me fjalë e shprehje të leksikut të zakonshëm, me format përkatëse gramatikore.

3.3.4.3 Portrete

Portretet e I. Kadaresë në romanin “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” në pikëpamje vizatimore-fizike janë të kursyera në linja e tipare. Më shumë se portrete të plota fizike, ato janë karaktere të spikatura. Në galerinë e portreteve mund të dallojmë: portrete individuale, të veçanta dhe portrete të përgjithshme, tipike. Në grupin e parë përfshihen portretet e personazheve kryesore me veprim e ndikim të veçantë. Të tillë

[553] Röhm, Joachim, *Der General der toten Armee*, f. 235.
[554] Buchholz, Oda/ Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 176.
[555] Röhm, Joachim, *Der General der toten Armee*, f. 235.
[556] Shih, Simoni, Zef, *Wörterbuch Deutsch- Albanisch*, Hamburg, 1997, f. 414.

janë: gjenerali, prifti, gjeneral-lejtnanti gjerman, specialisti shqiptar, kryetari i bashkisë (shoqërues i gjeneralit gjerman) e ndonjë tjetër. Portrete në përgjithësi përbëjnë vizatimet e ushtarëve, fshatarëve, personave episodikë, etj.
Mendojmë që analiza më e përshtatshme që mund t’u bëhet portreteve te “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, është ajo ikastike. Sepse çdo portret i I. Kadaresë në këtë roman perceptohet si një vetë e caktuar, me pamjen karakteristike. Sepse, çdo portret të I. Kadaresë, mund ta plotësosh duke përdorur funksionin ikastik dhe forcën evokuese të mjeteve gjuhësore.
Sipas teorisë së Ch. Morrisit, shenja ikonike ngjason me objektin, të cilit i referohet. Ndërsa U. Ecoja nuk flet për shenja dhe objekte, por për ngjashmëri në perceptimin e shenjave dhe të objekteve përkatëse. Sipas tij, shenjat ikonike paraqesin disa veçori të objektit të paraqitur.[557]

Në kuptimin e Ecos, shenja ikonike nuk duhet të jetë domosdo fotografi e objektit që shënon. Por perceptimi i saj duhet të ngjasë me perceptimin e objektit të dhënë.[558]

Me anë të perceptimit hyn në lojë soditësi, perceptuesi dhe tërë dukuria merr ngjyra subjektive interpretative. Në këtë pikëpamje mund të soditen portretet e I. Kadaresë në romanin „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“. Kjo, sepse I. Kadareja lë shumë hapësirë për interpretim, për parafytyrim gjatë perceptimit, kur është fjala për portretet e personazheve të veta. E kemi fjalën këtu për portretet fizike. Te I. Kadareja ndodh një fenomen interesant. Kur vizaton, portretizon personat, vepron shpejt, hedh disa penelata dhe i le pamjet të plotësohen nga lexuesi. Lexuesi e plotëson pamjen me eksperiencën dhe fantazinë e vet. Në skicat e vizatuara të personazheve theksohet gjithnjë diçka, një tipar ose një gjendje. Është pikërisht ky theksim, çasti që i jep pamjes realizëm, e lidh me botën reale të tipareve a gjendjeve, të kujton veçoritë konkrete të njerëzve realë. P. sh., personazhi i priftit nuk jepet asnjëherë si portret me detaje. Jepet vetëm ngjyra e syve dhe kjo theksohet me anë të një krahasimi:

> … tha prifti me një ton të njerëzishëm dhe e vështroi me sytë e tij bojë hiri. Në atë çast gjeneralit iu duk se ngjyra e syve të priftit ishte tamam *si ekrani i televizorit* në fund të sallonit. *Si një televizor*, që nuk punon kurrë, mendoi.[559]

> … sagte der Priester höflich und sah ihn mit seinen *grauen* Augen an. Der General hatte das Gefühl, als hätten die Augen des Pristers genau dieselbe Farbe wie der Bildschirm des Fernsehapparates am Ende des Salons. Wie ein *Fernsehgerät*, das niemals angestellt wird, dachte er.[560]

> ...und schaute ihn aus grauen Augen an. Der General stellte fest, daß sie die Farbe des Fernsehschirms hinten im Salon hatten. Wie ein abgestellter Fernsehapparat, dachte er. Nein, eher wie ein Bildschirm, auf dem ständig das gleiche unverständliche Programm läuft.[561]

Përkthyesit O. Buchholz/W. Fiedler dhe J. Röhm-i përpiqen ta japin portretin e priftit sa më afër atij që përshkruan Kadareja. Veç kuptimi i shprehur nga folja „punoj“ nuk mund të jepet i plotë me anë të foljes „anstellen“ (vë në punë).[562]

[557] Morris, Charles, *Grundlagen der Zeichetheorie*, Berlin, 1988, 201
[558] Eco, Umberto, *Einführung in die Semiotik*, München, 1972, f. 230
[559] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 25
[560] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 22.
[561] Röhm, Joachim, *Der General der toten Armee*, f. 32.
[562] Shih,Simoni, Zef, *Wörterbuch Deutsch- Albanisch*, Hamburg, 1997, f. 47.

Në rastin e tekstit shqip, folja është në diatezën veprore, ndërsa në variantin e O. Buchholz/ W. Fiedler-it është zgjedhur diateza pësore për të dhënë të njëjtin veprim. Ndryshimi i diatezës bën që në variantin gjermanisht të theksohet vepruesi, ndërsa në variantin shqip veprimi, që konceptohet madje si një gjendje e objektit, televizor.[563] Edhe në variantin e J. Röhm-it nuk është i rëndësishëm evidentimi i vepruesit, por cilësia e televizorit, *e vënë në punë* (*angestellter*). Për mendimin tonë, kjo diferencë kuptimore e foljes sjell edhe disa dallime në efektin evokues që ka krahasimi i syve të priftit ngjyrë hiri me televozorin.
Mendojmë se ka edhe diferenca kuptimore në dhënien e ngjyrës së syve midis variantit shqip dhe atyre gjermanisht: *ngjyrë hiri* vs. *grau (gri)*. Ngjyra e hirit, e përdorur nga Kadareja, të hedh me asociacion në imazhin e hirit të zjarrit, të diçkaje që mbetet pas djegies. Pikërisht, këto karakteristika të portretit të priftit synon Kadareja të emetojë përmes përdorimit të mbiemrit ngjyrë hiri. Ndërsa në përkthimet në gjermanisht këto asociacione mungojnë: *gri* nuk ka të njëjtin efekt evokues si *hi*.

Në tekst përmendet disa herë ngjyra e hirit të syve të priftit. Kjo ngjyrë e përforcuar me krahasimin *si ekrani i televizorit…”* evokon një veçori reale dhe e nxjerr portretin nga abstraksioni i skicës në dritën e realitetit.

Kjo teknikë e theksimit të një tipari fizik përdoret edhe në rastin e vizatimit të një personazhi episodik, një vajze të re shqiptare, që pret të fejuarin në stadiumin ku bëjnë gërmime të dërguarit gjermanë:

> Ajo kishte një mushama të bukur *blu*, kurse sytë i kishte akoma më të kthjellët, megjithëse pak të ftohtë, por mua më duket se nuk kam parë sy më të bukur.[564]
> Sie hatte einen hübschen blauen Regenmantel, aber ihren Augen waren von einem noch schöneren *Blau*, wenn auch ein bißchen kühl. Ich glaube, ich habe in meinem Leben niemals schönere Augen gesehen.[565]
> Sie trug einen hübschen *blauen* Mantel, und auch ihre Augen waren *blau*, allerdings eine Spur heller und vielleicht auch ein bißchen kühl. Ich glaube, nie haben mich Augen mehr beeindruckt.[566]

Mund të thuhet pa hezitim se të dyja variantet janë simetrike, si në semantikë ashtu dhe në pikëpamje afektive- evokuese.

Vajza nuk bën asgjë përveç se pret të fejuarin. Nuk jepet asnjë informacion tjetër përveç ngjyrës së mushamasë dhe të syve. E megjithatë, ajo të mbetet në mendje, ushtron një ndikim e një tërheqje të çuditshme. Rob i këtij ndikimi është dhe gjenerallejtënanti, jeta e të cilit në Shqipëri është shenjuar nga mbresat e pashlyeshme, që i ka lënë ajo. Ndoshta informacioni i kursyer e rrit dendësinë e forcës ndikuese. Megjithatë mund të thuhet që nëpërmes ngjyrës së syve, vajza e romanit fiton vërtetësi. Secili lexues, duke u nisur nga perceptimi i portretit të dhënë, krijon në fantazi, në parafytyrim, figurën e një vajze të ngjashme me atë të I. Kadaresë. Ajo e parafytyrimit mund të ketë gjithëfarësoj veçorish, vetëm sytë i ka blu, shumë të bukur dhe shumë mbresëlënës. Me anë të një tipari të vetëm, gjithësesi të theksuar, krijohet

[563] Lidhur me ndryshimin semantik veprore- pësore shih dhe, Bußmann, Hademud, Lexikon der Sprachwissenschaft, Stuttgart, 2002, f. 500.
[564] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 219
[565] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 205, 206.
[566] Röhm, Joachim, *Der General der toten Armee*, f. 274.

ngjashmëria me realitetin. Këtu luan rol dhe ndikimi apo magjepsja që i atribuohen tiparit. Vetëm një ekzistencë reale ushtron tërheqje e magjepsje.

Gjenerali italian portretizohet më shumë së brendshmi. Për pamjen e jashtme nuk ka shumë të dhëna. Do të përmendja vetëm një element që del disa herë për të paraqitur së jashtmi ndjenjën e brendshme të madhështisë:

> Gjenerali veshur me *uniformën e madhe* vështronte si binin flokët e dëborës mbi çimenton e lagët. [567]
> Der General, in *Galauniform*, sah zu, wie die Schneeflocken auf den nassen Zementboden niedergingen.[568]
> Der General in seinem *prächtigen Uniform* beobachtete den Schnee bei seinen kurzlebigen Bemühungen.[569]

Është shumë interesant përkthimi gjermanisht, ku "unifoma e madhe" është dhënë me "Galauniform" (uniformë parade) dhe prächtigen Uniform (uniformë madhështore)[570]

Ndërsa në variantin shqip dhe në përkthimin e J. Röhm-it, semantika e fjalës lë shumë vend bosh për t'u plotësuar nga lexuesi (çdo të thotë në fund të fundit „uniformë e madhe, uniformë madhështore"?); në variantin e O. Buchholz/W. Fiedler-it, kufijtë kuptimorë janë të përcaktuar, uniformat festive të oficerëve madhorë janë standarde.

Uniforma e madhe, një element më shumë i parafytyrueshëm se i perceptueshëm, nuk mund të identifikohet me asnjë veshje të caktuar. Por mund të imagjinohet me gjithëfarësoj gradash e kopsash karakteristike për uniformën e një oficeri madhor. Megjithatë, si veshje, është diçka konkrete që i jep vërtetësi e realitet edhe personit që e mban.

Brenda teknikës së tij paraqitëse të portreteve fizike I. Kadare ka dhënë dhe gjenerallejtënantin. Edhe portreti i tij dallohet nga mungesa e krahut. Nuk jepet asgjë tjetër për pamjen e tij, veç mungesës së një krahu. Kjo e bën atë lehtësisht të identifikueshëm në morinë e personazheve të romanit:

> Gjenerali vështroi *dorën e tij të vetme*, me të cilën mbante çibukun dhe mëngën boshe të kapotës ushtarake të futur në xhepin e majtë.[571]
> Der General blickte auf dessen *eine Hand*, die die Pfeife hielt, und auf den leeren Ärmel der Uniformjacke, der in die linke Tasche gesteckt war.[572]
> Der General warf einen Blick auf die einzoge Hand seines Kollegen, mit der er die Pfeife hielt, und dann auf den leeren Ärmel, der in der Tasche seiner Uniformjacke steckte.

Në variantin gjermanisht të O. Buchholz/F. Fiedler-it mungon fjala përcaktuese *e vetme*, kuptimi i së cilës është dhënë me anë të ndërtimit specifik të fjalisë së parë dhe numërorit *eine* (një):

> Der General blickte auf dessen eine Hand…(vështroi në njërën dorë të tij)

[567] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 234.
[568] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 220.
[569] Röhm, Joachim, *Der General der toten Armee*, f. 295.
[570] Shih, Simoni, Zef, Wörterbuch Deutsch- Albanisch, Hamburg, 1997, f. 280.
[571] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë, 1981, f. 51.
[572] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 48.

Koteksti që vijon, mundëson të kuptuarin e numërorit një, si të vetme (mënga tjetër ishte futur bosh në xhepin e majtë).

Mungesa është po aq karakterizuese sa dhe pasja e një tipari. Portreti, që shfaq mungesën e një tipari apo pjese fizike-trupore, është po aq real sa ai që jepet duke theksuar vetëm një tipar. Të dyja mënyrat janë ndikuese, në të dyja rastet portretet ngjasojnë me figurat reale të njerëzve.

Masën e të moshuarve shkrimtari e ka paraqitur duke i mëshuar penelit në vizatimin e ballit, të syve dhe të duarve. Në raport të zhdrejtë me rolin e tyre të vogël, episodik në roman, jepet një përshkrim i detajuar i pamjes së tyre:

> Fshatari kishte fytyrë të hequr dhe *sy të përhimë*… Gjenerali vuri re se gishtat i kishte të *rreshkur e të thatë si eshkë.*[573]
> Der Alte hatte ein hageres Gesicht und *graue Augen.* Er holte gelassen seinen Tabaksbeutel hervor, stopfte seine Pfeife und zündete sie mit einem Feuerstein an. Der General bemerkte, dass seine *Finger knochig und die Haut trocken war.*[574]
> Der Bauer hatte eingefallene Wangn und aschgraue Augen. ...Der General bemerkte, daß die Haut an seinen Fingern verschrumpelt und knochentrocken war.[575]
>
> Plaku thithi përsëri çibukun dhe në ballë iu formuan ca *rrudha të thella.*[576]
> Der Greis sog wieder an seiner Pfeife, auf seiner Stirn bildeten sich ein paar *tiefe Furchen.*[577]

Teksti në gjermanisht i O. Buchholz/W. Fiedler-it përmban të tjera leksema për të dhënë të njëjtin imazh. Gishtat jepen *eshtakë* (knochig), lëkura *e thatë* (trocken), mungon krahasimi *si eshkë.* Dallimet kanë të bëjnë me vetë gjuhët, me realizimet gjuhësore dhe jo me protretin e përshkruar, që është njëlloj domethënës dhe evokues në të dyja gjuhët.
Ndërsa varianti i J. Röhm-it i ngjet përshkrimit që jep Kadareja në të gjitha rrafshet.

3.3.4.4 Peizazhe psikologjike

Termi i përdorur për të emëruar këtë paragraf i përshtatet më së miri përshkrimit të botës së brendshme të gjeneralit. Ky është personazhi, psikologjia e të cilit është pikturuar me të gjitha ndjenjat, emocionet, trazirat, luhatjet e me të gjitha elementet e tjera që gjëllijnë e vlojnë në shpirtin e një ushtaraku në vend të huaj, të ngarkuar me një detyrë makabër.
Tabloja psikologjike e gjeneralit përmban të vendosura pranë e pranë ndjenja si: krenari, madhështi, përbuzje, patetizëm, reflektime të forta, frikë, ëndrra.
Në përshkrimin psikologjik të gjeneralit emocionet dhe reflektimet me asociacion zënë një vend të konsiderueshëm. Kjo mënyrë reagimi e zbulon gjeneralin si një karakter, tip psikologjik. Para se të merremi me mënyrën asociative të lindjes dhe të shprehjes së ndjenjave te gjenerali, le të ndalemi shkurt te dukuria, te termi i fushës së psikologjisë *asociacion.* Termi shënon shoqërimin e ndërgjegjshëm ose të pandërgjegjshëm të ideve ose ndjenjave. Ky term me konceptin përkatës rrjedh nga

[573] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë, 1981, f. 85.
[574] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 82.
[575] Röhm, Joachim, *Der General der toten Armee*, f. 109, 110.
[576] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë, 1981, f. 183.
[577] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 114.

antikiteti. E gjejmë te Platoni[578], por më gjerësisht trajtohet nga Aristoteli. Në veprën “Über das Gedächtnis und die Erinnerung” (Mbi kujtesën dhe kujtimet) Aristoteli thekson se „mendimet e ndjenjat përcaktohen nga realiteti e nuk jepen nga zoti.“[579]

Kështu, lidhja e parafytyrimeve është një princip psikologjik që realizohet sipas ligjesh të caktuara.
Aktivizimi i asociacioneve është një dukuri e natyrshme psikologjike. I dhënë në letërsinë artistike përmban edhe dimensionin real, të natyrshëm, por edhe funksionin e veçantë artistik. Asociacioni përdoret rëndom si mjet për intensifikim. Një ide/ ndjenjë e shoqëruar nga një tjetër e krahasueshme me të, përforcohet, fiton më shumë vërtetësi. Le ta ilustrojmë këtë me momente psikologjike të gjeneralit:

> Gjenerali u mbështet në krevatin portativ, kurse prifti hapi një libër dhe nisi të lexonte. *Ç’të ketë bërë vallë me të venë e kolonelit?* Tha me vete gjenerali, duke vështruar profilin e priftit…[580]
> Dann streckte sich der General auf seinem Campingbett aus, während der Priester ein Buch aufschlug und zu lesen begann. *Was mag er bloß mit der Witwe des Obersten angestellt haben?* Fragte sich der General und betrachtete das Profil des Priesters…[581]

Me mjetet përkatëse të secilës gjuhë është paraqitur e njëjta skenë, e njëjta situatë. Përkthimi jep një tablo ekuivalente të tekstit origjinal.

Në pikëpamje ikastike në prezantimin psikologjik të gjeneralit mund të dallohen disa shtresa a plane me vlerë simboli:

1. Reflektime, reagime me asociacione
2. Kujtimet si shtresa emocionale
3. Ëndrrat

Ja dhe disa skena të tjera përjetimesh intensive ku janë të pranishme dhe asociacionet:

> Refleksi i dritës së copëtuar prej grilave i rrotullohej vazhdimisht mbi kokë dhe ai mbylli sytë që të mos e shikonte më. Por, duke mbyllur sytë, iu kujtua më qartë dhoma e madhe, e zhveshur e kuartierit, dhe rekrutët e hutuar që rrinin në këmbë para tryezës së gjatë, krejt lakuriq, si qirinj të bardhë, të bardhë[582].
> Die Lichtreflexe, von den Jalousiestäbchen zerschnitten, drehten sich über seinem Kopf. Er schloß die Augen, doch nun sah er alles noch deutlicher vor sich: den großen, kahlen Raum und die verschüchterten Rekruten, die nackt wie weiße, schneeweisse Kerzen vor dem langen Tisch standen.[583]
> Streifen bunten Lichts drangen durch die Jalousien herein und huschten über alle vier Wände. Wieder einmal mußte er an den großen Raum in einen Militärgebäude denken, in dem er vor über zwanzig Jahren zusammen mit anderen Mitgliedern der Musterungskommission an einem langen Tisch gesessen hatte.[584]

[578] Platon, *Phaidon, Berlin*, 2013, kapit. 18, 19.
[579] Aristoteles: Kleine Naturwissenschaftliche Schriften, Reclam, 1997, pjesa e dytë, f. 36. Aristoteli formulon dhe ligjet mbi bazën e të cilave vepron asociacioni: Ligji i ngjashmërisë, ligji i kontrastit, ligji i lidhjes kohore dhe hapësinore. Teoritë e sotme mbi asociacionet janë mbështetur fuqimisht mbi analizën e Aristotelit
[580] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 183
[581] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 69.
[582] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 216.
[583] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 200.
[584] Röhm, Joachim, Der General der toten Armee, f. 271.

Asociacioni i përshkruar në tekstin shqip jepet besnikërisht edhe në tekstin e përkthyer nga O. Buchholz/W. Fiedler-i. Në këto variante ballafaqohen dy segmente ligjërimore, segmenti i parë që shërben si shenjues, është ai që jep gjeneralin në dhomën e hotelit me grila të mbyllura. Segmenti i dytë është parafytyrimi i ushtarëve të rekrutuar për luftë, para njëzet vjetësh, që shërben si i shenjuar.
Në variantin e Röhm-it, segmenti i dytë ligjërimor, d.mth., ai që lidhet me asociacionet e zgjuara nga ulja e grilave, nuk jepet i përshkruar aq hollësisht si në shqip. Në të mungojnë përshkrimet e ushtarëve: *krejt lakuriq, si qirinj të bardhë, të bardhë*.
Grilat e dritares janë elementi i ngjashëm midis dy situatave. Në një pasazh tjetër jepet më shumë informacion mbi situatën e rekrutëve. Ata kalojnë në një kontroll radiografik. Grafia e eshtrave të kraharorit lidhet me asociacion me shiritat e grilave.

Momente të tjera:

> Pastaj kishin çikur gotat dhe, nën tringëllimën e lehtë të kristaltë, ishte ndier gjëmimi i largët i topave.[585]
> Dann hatten sie miteinander angestossen, und in das leichte, kristallene Klirren hatte sich ferner Kanonendonner gemischt.[586]

Po të përkthehej varianti gjermanisht në shqip, do të kishim: „Pastaj kishin përplasur gotat dhe në tingëllimën e lehtë të kristaltë ishte përzier gjëmimi i largët i topave.“ Varianti shqip me „ishte ndier“ nënkupton edhe një subjekt që e rrok tingëllimën, çka mungon në shprehjen gjermane; megjithatë asociacioni i realizuar me përqasjen e dy planeve të ndryshme kohore është i pranishëm në të dyja variantet.

Në organizimin e mozaikut psikologjik të gjeneralit nuk mungojnë dhe kujtimet. Në këtë pikëpamje për gjeneralin vlen thënia lapidar e Aristotelit “Das Erinnern spielt sich im Herz ab“ (Kujtimet zhvillohen në zemër.)[587]

Kujtimet jepen në pasazhe që alternohen me rrëfimin në kuadrin e subjektit. Si përjetime mentale të ngjarjeve dhe eksperiencave të kaluara, kujtimet e pasurojnë subjektin me ngjarje të reja, njëkohësisht janë tregues të një bote të pasur shpirtërore. Në rastin e gjeneralit, ai është gjithnjë i rrethuar nga kujtimet. Kjo lidhet me tipin e tij, dhe me mënyrën e rrëfimit me retrospektiva:

> Atij iu duk se kjo kishte ndodhur shumë kohë më parë dhe jo në gushtin e atij viti, në një nga ato mbasditet e mrekullueshme kur dielli skuqet si një sy i madh, i lodhur dhe aty- këtu nëpër cepat e horizontit, të lehta e të pasigurta, dridheshin njollat e para të mbrëmjes…[588]

Teksti i përkthyer nga O. Buchholz/W. Fiedler-i dhe ai i J. Röhmit ndjekin në mënyrë adekuate relievin konceptor dhe figurativ të origjinalit:

> Ihm war, als sei das schon vor langer Zeit geschehen, und nicht erst im August dieses Jahres, an einem dieser herrlichen Spätnachmittage, an denen die Sonne zu einem roten Ball wird und wie ein großes, müdes Auge aussieht, während hier und da in den fernen des Horizontes zart und unruhig die ersten dunklen Tupfer des Abends aufflackern...[589]

[585] Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Tiranë 1981, f. 171.
[586] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 200.
[587] Aristoteles: Kleine Naturwissenschaftliche Schriften, Reclam, 1997, pjesa e dytë, f. 38.
[588] Kadare, Ismail, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë 1981, f. 73.
[589] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 70.

> Alles schien unendlich weit zurückzuliegen. Dabei hatte ihre Begegnung erst vor kurzer Zeit stattgefunden, an einem schönen Nachmittag im August dieses Jahres, an dem die Sonne wie ein großes, müdes rotes Auge am Himmel hing ....[590]

Edhe ëndrrat bëjnë pjesë në panoramën psikologjike të gjeneralit. Ëndrrat, si aktivitet psikik gjatë gjumit, shoqërohen me pamje të gjalla dhe ndjenja intensive. Në tekstin e I. Kadaresë, ëndrrat, që i prishin gjumin gjeneralit, janë simbole të dramave shpirtërore të përjetuara gjatë ditës. Edhe pse funksioni i ndërgjegjes është i kufizuar gjatë ëndrrës, përmbajtja e tyre është shenjuese e ndodhive të jetuara me ndërgjegje të plotë:

> Mbrëmë kam fjetur keq, -tha gjenerali,- kam parë një ëndërr të çuditshme… Pashë në ëndërr atë prostitutën… M’u shti në ëndërr. Vetëm se nuk ishte e gjallë, por e vdekur dhe e shtrirë në arkivol. Kurse përjashta prisnin radhën te dera e shtëpisë publike plot ushtarë, të shtrirë dhe ata në arkovole… Pastaj pashë kolonelin Z…[591]
> Letzte Nacht habe ich schlecht geschlafen”, sagte er, “ich hatte einen seltsamen Traum… Ich habe von dieser Prostituierten geträumt… Sie ist mir in Traum erschienen. Sie lebte nicht mehr, sie lag tot im Sarg. Draußen aber, vor der Tür des Bordells, warteten viele Soldaten in einer Schlange, und auch sie lagen in Särgen… Und dann habe ich Oberst gesehen… [592]

Edhe pse në të dyja variantet dukuria e ëndrrës jepet si shenjë e një ngjarjeje të përjetuar, ose e mbresave që ka lënë një ngjarje, shprehja e tyre gjuhësore nuk bëhet sipas raportit 1:1. P.sh., midis segmenteve *kam parë një ëndërr të çuditshme* vs. *ich hatte einen seltsamen Traum* (kisha *nj*ë ëndërr të çuditshme), *m`u shti në ëndërr* vs. *habe von einer Prostituierten geträumt* (kam ëndërruar për një prostitutë) ka dallime në përbërjen leksikore dhe në veçoritë gramatikore të përbërësve. Dallimi nuk e ka cënuar aspak rrëfimin e ëndrrës në gjermanisht; ajo përmban po ato çudira dhe absurditete si në shqip.

Prifti është portreti i dytë më i kompletuar përsa i përket prezantimit psikologjik. Për nga bota e brendshme ai nuk e ka atë pasuri ndjenjash dhe emocionesh të gjeneralit. Madje gjenerali shprehet për të:

> Ky prift është prej metali… Megjithatë do të isha kurioz të dija se sa metalik ka qenë me gruan e bukur të kolonelit Z.[593]

Përkthimet në gjermanisht thonë të njëjtën gjë:

> Dieser Priester ist wie aus Metall… Dennoch würde ich zu gern wissen, ob er sich bei der hübschen Frau des Obersten Z. so gegeben hat…[594]
> Der Priester ist wie aus Stahl.. Trotzdem würde ich gerne wissen, ob er der schönen Gattin von Oberst Z. Gegenüber auch so kühl geblieben ist.[595]

Por priftit nuk i mungon informacioni dhe dijet psikologjike. Manifestimet psikologjike në rastin e tij nuk jepen si prodhim shpirtëror, por si informacion i përftuar nga leximi i psikologëve të njohur. Dhe këtë informacion ai e shfrytëzon për

[590] Röhm, Joachim, Der General der toten Armee, f. 93.
[591] Kadare, Ismail, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, 1981, f. 116.
[592] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 112.
[593] Kadare, Ismail, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, 1981, f. 26.
[594] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 24.
[595] Röhm, Joachim, Der General der toten Armee, f. 33,34.

të analizuar historinë dhe natyrën shqiptare. Interpretimet e tij në suazën e teorive të njohura psikologjike, klasifikimi që ai u bën shqiptarëve, janë shenja të përbuzjes, të urrejtjes së tij ndaj tyre.
Te prifti, atje ku duhej të gjeneronin emocionet, reflektimet e reagimet ndaj realitetit konkret, janë magazinuar njohuritë e marra nga librat dhe interpretimi tepër subjektiv e armiqësor. Ai është vërtet metalik. Nga fillimi deri në fund nuk manifeston asnjë luhatje e dridhje (po të mos merrnim parasysh qëndrimin idhnak ndaj humbjes së thesit me eshtrat e kolonelit Z).
Arsenali psikologjik i priftit, edhe pse i një lloji tjetër nga ai i gjeneralit, funksionon si shenjë e qëndrimit të tij ndaj shqiptarëve:

> Kjo ndodhi sepse shqiptarët prej natyre janë të prirur për luftë. Ata e përqafojnë atë me ndërgjegje të plotë. Lufta është bërë pjesë organike e këtij kombi, ajo ia ka helmuar damarët si një njeriu të alkoolizuar[596]
>
> Das war so, weil die Albaner von Natur aus kriegsbegeistert sind. Sie lieben den Krieg geradezu. Der Krieg ist zu einem organischen Bestandteil dieses Volkes geworden, er hat seine Adern vergiftet…[597]
>
> „Die Albaner haben einen natürlichen Hang zum Krieg“, ... „Für sie ist er etwas Selbstverständliches. Sie sind gewissermaßen abhängig davon. Es ist wie bei einem Trunksüchtigen: Wenn der Alkoholspiegel in seinem Blut zu niedrig ist, geht es ihm schlecht. Die ganze psyche der Albaner..“[598]

Mendimi dhe patosi i priftit jepen më të spikatur në variantin e O. Buchholz/W. Fiedler-it: në të shqiptarët paraqiten jo thjesht *të prirë për luftë*, por *entuziastë për luftë*. Përkthimi thotë: *Ata e dashurojnë luftën krejt hapur*, ndërsa I. Kadareja shprehet *Ata e përqafojnë atë me ndërgjegje të plotë*.

Në variantin e J. Röhm-it, mendimet dhe vlerësimet e priftit ndaj shqiptarëve janë më afër origjinalit të Kadaresë. Mjetet gjuhësore: *einen natürlichen Hang zum Krieg (një prirje për luftë*), si edhe krahasimi i dëshirës së luftës me dëshirën për pije i një të alkoolizuari evokojnë asociacione të ngjashme me ato që zgjon varianti i Kadaresë.

[596] Kadare, Ismail, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, 1981, f. 122.
[597] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, *Der General der toten Armee*, f. 117.
[598] Röhm, Joachim, Der General der toten Armee, f. 148, 149.

Kreu 4 Metaforat në romanet „Darka e gabuar“ dhe „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

4.1 Metaforat në tekstet letrare

Metaforat si pjesë e strukturave tekstore luajnë një rol të veçantë në rrokjen e kuptimit të teksteve, të cilat i kemi përcaktuar në sythin mbi përmbajtjen e tekstit si “një tërësi të strukturuar, që paraqet lidhje dialektike midis strukturave gjuhësore, gjuhëshoqëruese, jogjuhësore, të imazhit kompleks të realitetit, të situatës, fakteve, marrësit e dhënësit të një veprimtarie gjuhësore.”[599] Duke marrë parasysh karakteritikat e teksteve letrare, do të qëmtojmë rolin e metaforave, të cilat krahas vlerave estetike, shërbejnë edhe si mjet i njohjes, pikëmbërritje e proceseve të të menduarit në kërkim për njohjen. Ato paraqesin interes për studim, sepse jo vetëm dëshmojnë vlera artistike/estetike të veprës, por, edhe sepse, si mjet dhe mënyrë shenjimi i realiteteve të panjohura përmes të njohurave, ngjizin veçanësi në secilën gjuhë. Përqasja e metaforave në gjuhë të ndryshme ndriçon edhe diferencat në modelet gjuhësore.

4.1.1 Vlerat njohëse dhe estetike të metaforave

> *Bota na largohet në metafora gjithnjë e më ngacmuese (Stanislaw Jercy Lec)*

Tekstet letrare përmbajnë zakonisht një numër të madh dhe një larmi metaforash. Përcaktimi i rolit që luajnë metaforat në tekstet letrare kushtëzohet nga koncepti i autorëve apo rrymave të ndryshme letrare mbi letërsinë. Çështja e ka pikënisjen që në përcaktimin e veçorive të qenësishme të letërsisë dhe dallimit të saj nga llojet e tjera të teksteve (artikuj gazetash, fjalime politike, guida turistike). Identifikimi i ndryshimeve në strukturat gjuhësore të teksteve letrare nga të tjerat është i pamjaftueshëm për dallimin midis llojeve të ndryshme të teksteve. Funksioni komunikativ i teksteve letrare, në ndryshim nga llojet e tjera të teksteve, nuk përcaktohet nga një situatë e caktuar konkrete. Ai kushtëzohet nga ndryshimet historike të publikimeve dhe receptimit të tyre. Ky kushtëzim i funksionit komunikativ nga parametra historiko/shoqërorë pranohet nga studiuesit e letërsisë si një mjet i rëndësishëm njësues për tekstet letrare. Kriter tjetër njësues i të gjitha zhanreve të teksteve letrare, i pranuar nga të gjithë studiuesit e teksteve, është ai i fiksionit.[600] Modeli i realitetit tekstor i ndërtuar mbi një hipotezë, përfytyrim, nuk prezanton botën reale. Si i tillë, ai nuk mund të gjykohet mbi bazën e aparatit të logjikës formale: mbi bazën e kriterit të vërtetësisë apo jovërtetësisë. Shkrimtarja Juli Zeh e përshkruan procesin skicues të realitetit tekstor në mënyrë metaforike si recetë gatimi. Ajo shkruan:

> “Marrim njerëz, ngjarje, ide, mendime, që janë veçanërisht mbresëlënëse për autorin. Krijojmë një botë artistike, e cila është pak a shumë e ngjashme me botën e vërtetë, i nxehim të gjithë përbërësit në shkallën më të lartë të përfytyrimit, gjithçka e kalojmë përmes një sitë dhe e veshim me gjuhë. E zbukurojmë sipas shijes me pak humor, melankoli apo disfatë dhe e ofrojmë të freskët.”[601]

[599] Shih, Lechner, G., Sprachform von Dichtung. Berlin, Weimar 1984, fq. 17.
[600] Fiksionaliteti nuk është i pranishëm në disa zhanre të teksteve letrare, si psh.: autobiografi, ditare.
[601] Juli Zeh, Zur Höhle mit der Authentizität! Die Zeit 39,21.09.2006, f. 59.

Në ndërtimin e këtij realiteti tekstor, metaforat kanë padyshim një rëndësi të madhe, sepse ato paraqesin një botë të ndërtuar jo sipas rregullave. Ato krijohen, pikërisht, nga mosrespektimi i rregullave konvencionale të gjuhës. Duke qenë përftesa, që shpërfillin rregullat konvencionale të gjuhës, metaforat kanë funksion drejtues dhe karakter modelues në skicimin e botës tekstore, të modelit tekstor.[602] Veçoria e ligjërimit poetik/artistik, në të cilin gjuha nuk është pasqyrim i realitetit statik, por një përafri drejt botës që ndryshon dhe e metaforave, si krijime poetike, që synojnë ta rrokin realitetin me karakterin e tij ndryshues, i jep metaforave një status të veçantë në studimin e ligjërimit artistik dhe në ndërtimin e realitetit tekstor.
Por, koncepte të ndryshme, aparate të ndryshme konceptimi të letërsisë (p.sh. koncepti i letërsisë në klasicizëm) kanë ndikuar edhe në qasje të ndryshme përsa i përket rolit dhe funksionit të metaforave. Koncepti i letërsisë së autorëvë apo rrymave të ndryshme letrare kushtëzon edhe raportin dhe marrëdhëniet e tyre me konceptin e metaforës. P.sh. poezia Konkrete, një rrymë letrare në poezi, e mohon vlerën përshkruese të metaforave. Përkrahësit e një qasjeje të tillë, mbështetur në logjikën e koncepteve, e shohin thelbin e metaforave në përdorimin “anormal”, duke i mohuar shprehjeve me kuptim metaforik në këtë mënyrë natyrën diskursive me argumentin se ato janë vetëm “zbukurim, dekor, parfum.”[603] Por, metaforat nuk mund dhe duhet të kuptohen vetëm si figura letrare si në retorikën klasike. Ato janë „shprehje e drejtëpërdrejtë e përjetimit (fiktiv apo real) në të gjitha facetat“[604], „shprehje e ndjenjave,“[605] me vlerë diskursive për të gjithë tekstin. Ricœur e përcakton këtë vlerë, si “mode plus fondamentale de reference”[606] Kjo qasje ndaj metaforave nuk haset vetëm në letërsinë moderne. Hugo von Hoffmanstahl në fillim të esesë së tij „Shprehje figurative“ shkruan:

> „Jo rrallë dëgjojmë se: një vepër qenka zbukuruar me shprehje të figurshme, një vepër përmban shumë figura. Ky këndvështrim ngërthen qasjen e gabuar, sipas së cilës figurat – metaforat – nuk qenkërkan gjë tjetër veç diçka e panevojshme për substancën e vërtetë prej së cilës ndërtohet vepra, një zbukurim i jashtëm. Por, e “panevojshmja”, shprehja figurative është thelbi dhe qënia e çdo poezie: çdo krijimtari përshkohet tej për tej nga mjete të tilla.”[607]

Metaforat e paleksikalizuara, përkundrejt të leksikalizuarave, nuk kufizojnë përzgjedhjen, kombinimin e fushave konceptuale për përshkrimin e efekteve të përjetimit. Efekti i të përjetuarës shprehet përmes risive, të rejave. Lirinë e pakufizuar të kombinimit të fushave konceptuale Musili e ilustron me një shembull:

[602] Ricoeur-i propozon përkundrejt një “verite unnivoque” të kategorive “e vërtetë – e gabuar” të logjikës një konceptim „i kundërt – jo i kundërt“ të ligjërimit metaforik: ajo është një lindje, një realitet dinamik në zgjerim të vazhdueshëm. Shih, Ricoeur, Paul, *Die lebendige Metapher*, München, Fink, 1986, f. 19.
[603] Shih, Nicolas Born, cituar sipas, Müller-Richter, Klaus/Larcati, Arturo (botues), *Die Streit um die Metapher. Poetologiche Texte von Nietsche bis Handtke.* Mit kommentierenden Studien. Darmstadt, WGB, 1998.
[604] Wilhelms, Gottfried, *Die Metapher – „Kern um Wesen aller Poesie“ oder „Schminke, Parfüm“? Zur Problematisierung der bildlichen Rede in der modernen Literatur*, në, Deutsche Viertelsjahrbericht 62, f. 549-569.
[605] Shih, Schwarz-Friesel, Monika, *Sprache der Emotion*. Tübingen, Francke, 2007a.
[606] Ricoeur, Paul, *Die lebendige Metapher*, München, Fink, 1986, f. 13.
[607] Hugo von Hoffmansthal, 1897, in: GWRA I, f. 234, cituar sipas, Müller-Richter, Klaus/Larcati, Arturo (botues), *Die Streit um die Metapher*. *Poetologiche Texte von Nietsche bis Handtke.* Mit kommentierenden Studien. Darmstadt, WGB, 1998.

> […] një shkrimtar mund të krahasojë një mbrëmje të caktuar nëntori në krijimtarinë e tij me një copë të leshtë të butë; një shkrimtar tjetër mund të krahasojë në të njëjtën mënyrë një copë të leshtë të tillë me një mbrëmje nëntori. Në të gjitha rastet, ngacmimi gjendet në pasurimin e fushës perceptive të ndjenjës dhe përfytyrimit me pjesë të një të reje. Copa, natyrisht, nuk është mbrëmje nëntori, por ngjan në efektin e saj me të, dhe kjo është një trukim i vogël i këndshëm.”[608]

Kadare në “Darka e gabuar” e përshkruan ankthin e palës së tretë të shqiptarëve ndaj pushtimit gjerman *një ankth të veçantë nazik, një maçok të ngopur, mendjemadh dhe disi të pafytyrë*.[609] Duke përdorur të tria metaforat, Kadare përshkruan dhe referon në cilësitë e palës së tretë, e cila ndryshe nga dy të parat nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimet në qytet – ajo nuk është mbështetëse dhe aleate e askujt. Mbi karakterin egoist dhe paturpësinë e saj referojnë metaforat maçok mendjemadh dhe i pafytyrë. Po këto metafora: maçok i ngopur, mendjemadh dhe i pafytyrë mund të përdoren për të emërtuar drejtpërsëdrejti një njeri i cili ka tiparet e fodullëkut, mosmirënjohjes.

Metaforat ngërthejnë pikërisht si rezultat i kombinimit të fushave të ndryshme të perceptimit një strukturë të dyfishtë: një strukturë të domethënies artistike[610] (që i korrespondon vlerave estetike të tekstit) dhe një strukturë semantike. Nga kjo strukturë e dyfishtë zbërthehet dhe përmbajtja, rezulton e reja që shpreh metafora. Sinestezia, p.sh., është shembulli më i skajshëm përsa i përket kombinimit të fushave të perceptimit shumë të largëta, ku kalohet nga një fushë perceptimi në një tjetër.[611]

Kadareja në romanin e tij “Dimri i madh” flet për *fraza që squllen*[612], apo *qartësi të mprehtë* të një diskutanteje. Frazat, në rastin e parë të rrokshme me anë të dëgjimit, jepen me një gjendje e cila nuk rroket vetëm me veshë, por edhe me të prekur. Frazat që squllen i përkasin ligjërimit të një diskutanteje. Të nyjëtuara në një gjendje emocionale të tronditur dhe në prag të një disfate të sigurt, ato e paraqesin ligjërimin të deformuar dhe plastik. Shembuj të tjerë nga proza e Kadaresë përqasin kombinime fushash perceptimi, ndër të cilat njëri është më i prekshëm se tjetri. Psh, perceptime të rrokshme me anë të dëgjimit me ato të rrokshme me anë të shqisave të të parit, si, *fishkëllima bojëhiri*[613], *zë poroz*[614] apo edhe kombinime të perceptimeve të shqisave të të ndjerit me ato vizuale, si, *shije e mprehtë.*[615]

Është, pikërisht, kjo njëkohëshmëri e të ndryshmeve, kjo lidhje e dy imazherive/konceptualizimeve të ndryshme, ajo çka përbën edhe vlerën njohëse të metaforave. E reja perceptohet dhe konceptualizohet me shoqërim idesh dhe imazherie/të një imazhi/koncepti/dukurie të njohur.
Përveç vlerës njohëse dhe pasqyrimit të përvojës, metaforat në tekstet letrare përmbajnë edhe ngjyrime vlerësuese dhe emocionale. Mund të themi, p.sh., që në ballafaqimin njeri-kafshë, në përgjithësi, përftohen emocione keqësuese, shprehen vlerësime denigruese. P.sh.,

[608] Musil, Rede zur Rilke-Feier,
[609] Kadare, Darka e gabuar, f. 13.
[610] Shih, Ricoeur, Paul, *La metafore vive*, 1975.
[611] Shih, Lloshi, Ismail, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.
[612] Kadare, Ismail, *Dimri i madh*, f. 287.
[613] Kadare, Ismail, *Ura me tri harqe*, f. 465.
[614] Kadare, Ismail, *Ura me tri harqe*, f. 433.
[615] Kadare, Ismail, *Koha e shkrimeve*, f. 257.

I ka bërë me siguri të gjitha llogaritë gjarpri.[616]
Kështu do të jetë edhe ngjitja jote zvarranik.[617]
Do të krrokasin edhe ca ditë ato sorra.[618]
I dukej vetja lakuriqnate.[619]

Në shembujt me metaforat e mësipërme përqasen fjalë të ligjërimit të përditshëm, por të dy sferave të ndryshme. Metafora g*jarpër* është e bisedave të zakonshme. Kadare e shfrytëzon këtë mundësi të gjuhës së gjallë, krijon dhe ballafaqime të reja në ndërtimet e reja, si: *njeri-zvarranik, njeri lakurinate*.

Në romanin “Darka e gabuar”, Kadare, gjendjen e qytetit të Gjrokastrës me zonat përreth saj në prag të pushtimit gjerman, e përshkruan:

> Për *mendjemadhësinë e pafre* të këtij qyteti kishte shpjegime të ndryshme. Më i përkori lidhej me *vetminë e tij*. Ithtarët e këtij shpjegimi, duke e kuptuar me veten se ai ngjante i pamjaftueshëm, nguteshin të shtonin se fjala “i vetmuar”, në këtë rast, kërkonte një plotësim. I rrethuar nga zona të gjera, që kishin *marrëdhënie të ftohta* me të, qyteti *ngjante për to i huaj*, për të mos thënë *armiqësor*[620].

Në këtë pjesë të shkëputur nga romani i Kadaresë jepet përshkrimi hamulli, katrahurë i situatës në qytet dhe rrethinat përreth tij, si edhe i marrëdhënieve të rrethinave me vetë qytetin, çka ndikonte edhe në qëndrimin e ndryshmëm të tyre ndaj gjermanëve. Metafora *mendjemadhësi e pafre* jep një vlerësim emocional të gjithë gjendjes psikologjike të gjirokastritëve, të cilët duke mbivlerësuar zonjërinë e qytetit nuk vendosnin marrëdhënie të mira as me Labërinë, as me Lunxhërinë dhe ende më pak me zonat minoritare greke. Për të përshkruar qëndrimin dhe lidhjen e rrethinave të Lunxhërisë, Labërisë dhe Lazaratit ndaj Gjirokastrës, autori përdor metafora të shumta. Lazaratin ai e përshkruan *katund kryeneç dhe idhnak*[621]; “katundet e Labërisë janë të pafundme për qytetin për shkak *të ashpërsisë*”, katundet e Lunxhërisë janë njëlloj të huaja për qytetin, por për një shkak të kundërt me atë të Labërisë, *butësisë*, “trazimin e katundeve të minoritarëve grekë të *shpërfillur* që prishte drejtpeshimin shpirtëror të qytetit e quan *trazim tinëzar.”*[622]
Metaforat *kryeneç dhe idhnak, ashpërsisë së katundeve të Labërisë, i huaj për shkak të butësisë, trazim tinëzar* japin një tablo të karakterit dhe gjendjes emocionale të rrethinave që përmenden në roman. Nëpërmjet tyre autori bën dhe një vlerësim për banorët e këtyre zonave, vlerësim i cili rroket nëpërmjet aktivizimit së dijeve sociokulturore mbi pozitën gjeografike dhe historikun e formimit të këtyre rrethinave.[623]

Gjegjëset e përkthyera në gjermanisht nga Röhmi janë:

[616] Kadare, Ismail, Koha e shkrimeve, f. 67.
[617] Po aty, f.72.
[618] Kadare, Ismail, Gjakftohtësia, f.132.
[619] Kadare, Ismail, Emblema e dikurshme, f. 248.
[620] Kadare, Ismail, Darka e gabuar, f. 15.
[621] Po aty, f.16
[622] Shih, Kadare, Ismail, Darka e gabuar, f. 16
[623] Për problemin e emocionalitetit dhe vlerësimit nëpërmjet metaforave kemi folur në sythin „Vlerat njohëse dhe estetike të metaforave“.

…*mendjemadhësi* e pafre	...zügellose Hochmut[624]
…katund *kryeneç* dhe *idhnak*	...ein *halsstarrigeres* und *hitzköpfigeres* Dorf[625]
...*ashpërsisë* së katundeve të Lunxhërisë	...weil sie nicht weniger *abweisend* wirkten[626]

Edhe në gjegjëset në gjermanisht *zügellose Hochmut* (mendjemadhësinë e pafre), *ein halsstarrigeres und hitzköpferigeres Dorf* (një fshat kokëfortë dhe gjaknxehtë) gjejmë vlerësime të banorëve të zonave përkatëse. Ajo që duam të theksojmë, është se vlerësimet e transmetuara në variantin gjermanisht mbi Lunxhërinë nuk përkojnë në të gjitha komponentet me ato që transmetojnë metaforat në origjinal. Kjo diferencë rezulton nga dallimet kuptimore midis varianteve gjegjëse në të dyja gjuhët: *kryeneç* përkundrejt *kokëfortë* dhe *idhnak* përkundrejt *gjaknxehtë*. Dallime më të mëdha kuptimore ka në variantin në gjermanisht të metaforës ashpërsi. Röhmi e përshkruan marrëdhënien e Lunxhërise me Gjirokastrës jo normale „*sepse ajo nuk dukej më pak refuzuese*“. Nga përkthimi i variantit të Röhmit në shqip dalin dallime të dukshme kuptimore të emetuara në të dyja gjuhët.

Përmbledhtazi, themi se metaforat janë fenomen tekstor me natyrë të gjerë, një princip poetik në thurjen e të gjithë tekstit.

4.2 Të kuptuarit e metaforave si fenomen i pikëtakimeve të të dy analizave: semantikore dhe pragmatike

Ndërthurja e analizës semantike me atë pragmatike është e domosdoshme për analizën e metaforave në tërë kompleksitetin e tyre. Një analizë vetëm semantike do të përjashtonte qëmtimin e elementeve pragmatike në interpretimin e metaforave. Përpos kësaj, mosanaliza e kontekstit mund të na çonte shpesh deri në pamundësi të identifikimit të metaforave ose dhe pamundësi në interpretim. Nga ana tjetër, një analizë vetëm pragmatike e këtij fenomeni do të nënvlerësonte ndikimin e informacioneve semantike eksplicite të shprehura në kotekst. Përtej kësaj, një analizë vetëm pragmatike mund të rrezikojë të fshijë dallimin midis vlerës së thënies që synohet të shprehet me anën e metaforës dhe ilokucionit (qëllimit të thënies) që ngërthen përmbajtja e thënies.

Metafora të paleksikalizuara mund të na shfaqin një problem që lidhet me raportin që vendos kuptimi i fjalisë, i llogaritur si shumë vetëm e përbërësve kuptimorë prej të cilëve përbëhet – kuptim i cili nuk varet nga konteksti – me kuptimin e zgjeruar të thënies në varësi të kontekstit. Modelimi në këtë mënyrë i të kuptuarit të metaforave na mundëson të përvijojmë konturet e analizës semantike dhe pragmatike, të përcaktojmë marrëdhëniet midis tyre, si edhe të ndihmojmë në qartësimin e funksionimit të kësaj zone, ku ndërthuren analiza semantike me atë pragmatike.
Në këtë kuadër do të përpiqemi të sqarojmë edhe një koncept tjetër, të domosdoshëm për interpretimin e metaforave, konceptin e emergencës.

[624] Röhm, Joachim, Ein folgenschwerer Abend, f. 12.
[625] Po aty, f. 13
[626] Po aty, f. 12.

4.2.1 Identifikimi i shprehjeve me kuptim metaforik, hapi i parë i analizës

Identifikimi i një shprehjeje si metaforike në një kontekst të caktuar është një vendimmarrje pragmatike. Një shprehje mund të përdoret në një kontekst të caktuar me kuptim metaforik, nëse ajo, së paku, nuk përdoret me kuptimin referencial të saj të leksikalizuar. Përpos këtij kriteri duhet të shqyrtojmë edhe kritete të tjera për të mundësuar dallimin e metaforave nga metonimia.

Vendimmarjen për përcaktimin e kuptimit metaforik të një shprehjeje nuk mund ta marrim vetëm mbi bazën e analizës semantike të fjalisë. Në rrafshin e analizës semantike të fjalisë mund të identifikojmë thyerje të rregullave të kombinimit të fjalëve, çka në sematikën e fjalisë shërben si kriter i qenësishëm i identifikimit të një metafore.[627] Po e ilustrojmë këtë me një shembull:

> Dhelpra idhnake po flet.
> Ujqërit dhe dhleprat do të ishin më pak idhnakë me to.[628]

Në shembullin *Dhelpra idhnake po flet* është e qartë që në përcaktimin e argumentit, i cili në këtë rast shprehet me frazën emërore *dhelpra idhnake*, nuk respektohen rregullat e kombinimit semantik; ai kombinohet me kallëzuesin e fjalisë *flet*. Në këtë shembull të izoluar nga konteksti nuk mund të themi se cila prej gjymtyrëve, fraza emërore apo kallëzuesi, është përdorur me kuptim metaforik. Po sjellim dy kontekste të ndyshme, të cilat mundësojnë dallimin e gjymtyrës së përdorur me kuptim metaforik.

> Një njeri i djallëzuar dhe dinak shprehet dhe diskuton para një grupi të irrituar me të, njëri prej të cilëve thotë: Pushoni, dhelpra idhnake po flet.
>
> Një grup gjuetarësh shohin një dhelpër e cila sapo fillon të hapë gojën. Në këtë cast, njëri prej gjuetarëve thotë: Pa zhurmë, dhelpra idhnake po flet.

Në dy shembujt e sipërpërmendur identifikojmë gjymtyrë të ndryshme si metaforë, në njërin rast ndeshim metaforën *dhelpër idhnake*, për të emërtuar një njeri, cilësitë e së cilit janë të ngjashme me ato të dhelprës, në tjetrin, gjymtyrën kallëzuesore, e cila i vesh cilësi të nyjëtimit edhe kafshëve, për të treguar dhe referuar mbi reagimin e dhelprës.

Përtej këtyre dy mënyrave të ndryshme të leximit dhe identifikimit të metaforës është edhe një mënyrë tjetër leximi, sipas së cilës e gjithë shprehja (grupi emëror dhe ai foljor) është përdorur me kuptim metaforik.

> *Dhelpra idhnake flet edhe kur fle.*

Kjo mundësi leximi arrihet nëse grupi emëror përdoret si anaforë për njeriun që karakterizohet nisur nga cilësitë e dhelprës dhe, nga ana tjetër, frazën *flet edhe kur fle* si një përcaktim të karaktetit të njeriut dinak. Fraza *flet edhe kur fle* identifikohet si shprehje metaforike, nisur nga mosrespektimi i kriterit të kombinimit të kuptimeve të leksemave *flet dhe fle*.

---

[627] Kittay, E. F., Metaphor. Its Cognitive Force and Linguistik Structure. Oxford, Clarendon, 1987.
[628] Kadare, Ismail, *Darka e gabuar*, f. 24.

Të gjithë shembujt e sjellë tregojnë se për identifikimin e metaforave nuk mjafton vetëm analiza semantike e kombinimit të fjalëve apo konstatimi i mosrespektimit të kombinimit të fjalëve, grupeve foljore sipas kuptimit të tyre.

Në vepra me fiksion trill apo edhe në përralla, në të cilat kombinimi i kuptimeve të drejtpërdrejta që cënojnë rregullat e kombinimit të kuptimeve nuk duhet interpretuar si përdorim i gabuar,[629] shembulli *Dhelpra idhnake flet edhe kur fle* nuk është metaforë.

Pra, kriteri i respektimit, përkatësisht cënimit të rregullave të kombinimit të kuptimeve të fjalëve nuk është i përshtatshëm për të identifikuar, hetuar përdorimin metaforik të një shprehjeje, apo edhe për të konstatuar nëse kemi një përdorim metaforik.

Procesi i identifikimit të metaforave bëhet akoma më i vështirë në rastet, kur konstatojmë kuptime metaforike edhe kur respektohen rregullat e kombinimit të kuptimeve të fjalëve, çka dëshmon se ky kriter nuk është kusht i domosdoshëm në gjetjen dhe ngjizjen e një kuptimi metaforik.

> Dhe këtu vinin dy-tri proverba, ndër të cilat nuk mungonte ai i *dhisë ngordhalaqe që mbante bishtin përpjetë*.[630]

Këtu është e gjithë thënia metaforë „*dhi ngordhalaqe që mban bishtin përpjetë*“. Interpretimi i metaforës do të ishte: „Njerëz të dobët e pa vlera, por të krekosur“. Kemi të bëjmë me dy plane kuptimore: kuptimi i dhënë me shprehjen e nënvizuar dhe kuptimi i rrokur nga një marrës i pajisur me kompetencën e duhur sociokulturore.

> Kështu që gjatë gjithë shekujve shqiptarët s‘ kanë bërë gjë tjetër veçse *kanë luajtur një pjesë teatrale të përgjakshme.*[631]

Në shembullin e shkruar me shkronja italike, metafora e nënvizuar ka gjithashtu ndërtim fjalie. Rrokja e saj si metaforë ka të bëjë me interpretimin e thënies në kontekst dhe jo me leximin e të kuptuarit të drejtpërdrejtë të segmentit “shqiptarët kanë luajtur një pjesë teatrale të përgjakur”.

Shembujt e dhënë ilustrojnë se e qenësishme në leximin e kuptimeve metaforike është dekodimi i një domethëniejeje, e cila, krahasuar me një domethënie të kuptimeve të drejtpërdrejta, na rezulton e mundshme dhe koherente për kontekstin që qëmtojmë. Së dyti, ilustruam me anë shembujsh që mosrespektimi i rregullave të kombinimit të kuptimeve të fjalëve nuk është kriter i mjaftueshëm dhe as i domosdoshëm në leximin, dekodimin e kuptimit metaforik të një shprehjeje.

Jo vetëm identifikimi i metaforave bëhet mbi bazën e ndërthurjes së të dyja analizave, por edhe parafrazimi i kuptimit metaforik mundësohet nisur nga e njëjta qasje.

[629] Shih, Schwarz-Friesel 2006, f. 69; Skirl/Schwarz-Friesel 2007, f. 54.
[630] Kadare, Darka e gabuar, f. 13.
[631] Gjenerali I ushtrisë së vdekur, 125.

4.2.2 Parafrazimi i kuptimit metaforik si ndërthurje e analizave semantike dhe pragmatike

Një nga çështjet thelbësore të çdo teorie të dekodimit të kuptimit të metaforave është diskutimi mbi mundësinë e parafrazimit të kuptimit metaforik dhe modelimi i këtij kuptimi, nëse kjo mundësi është e pranishme.[632] Premisë e domosdoshme në diskutimin e kësaj çështjeje është sqarimi i termit parafrazë, dmth. përcaktimi i saktë i termit parafrazë dhe i komponenteve që paraqesin kuptimin metaforik.

Termi parafrazë e një shprehjeje metaforike parakupton kuptimin e drejtpërdrejtë të një thënieje, kuptim i cili ngërthen të njëjtën përmbajtje me atë të shprehjes me kuptim metaforik.[633] Thënë ndryshe, parafraza ka në një kontekst të caktuar, të njëjtin kuptim si edhe shprehja me kuptim metaforik.

Në gjuhësi termi parafrazë u referohet marrëdhënieve sinonimike midis fjalive.[634] Në gramatikën transformuese të sintaksës gjenerative “parafrazimi paraqet një proces elementar, me ndihmën e të cilit mund të konstatohet identiteti semantik i fjalive të ndryshme, fjali të cilat së bashku formojnë një klasë parafrazash të strukturës së thellë.”[635] Në parim mund të dallojmë marrëdhënie parafrazimi në rrafshin sintaksor, leksikor, të dëftimit[636] (deiktikë) dhe paradigmatik.[637]
Përdorimi i termit parafrazë edhe për rastet kur ky term shënon lidhje midis thënies që parafrazohet dhe qëllimit të thënies së parafrazuar i kalon kufijtë e semantikës së fjalisë, së thënies. Shembulli *Bën ftohtë! Të lutem mbylle dritaren*![638] dëshmon një marrëdhënie midis dy fjalive përtej kufijve të akteve të drejtpërdrejta të ligjërimit: ato dëshmojnë për lidhjet që vendosen midis planit të përmbajtjes dhe qëllimit (ilokucionit) të thënies. Në një situatë të caktuar ligjërimi me anë të thënies *bën ftohtë* përtej konstatimit, synohet të realizohet një kërkesë, një urdhër: mënjanimi i shkakut të krijimit të kësaj gjendjeje, pra, mbyllja e derës (dritares). Mund të themi, që qëllimi i synuar nga folësi (kërkesa) është parafrazë e qëllimit të realizuar me mjete gjuhësore, me fjalë. Pra, ai është dhe mbetet vetëm një problem i pragmatikës, sepse problemi që hetohet lidhet me qëllimin (ilokucionin) e thënies, me qëllimin e komunikimit.

Në lidhje me metaforat mund të themi, se parafrazë e një shprehjeje metaforike është një thënie, kuptimi i së cilës rroket nga marrësi i mesazhit si kuptim i drejtpërdrejtë i

[632] Shih, Radtke 2001:, f. 37-41; Nogales 1999, f. 215; Carston 2002, f. 356.
[633] Skirl, 2009, f. 133.
[634] Shih, Glück, 2005a, f.474.
[635] Glück, Helmut, Paraphrase, në, Glück, Helmut (botues), 2005, f. f. 474.
[636] Termin dëftim autori Lloshi e përdor si sinonim të fjalës „deiktikë“. Ai dallon 5 lloje dëftimi: dëftimi i personit, i kohës, i vendit, i ligjëratës ose i tekstit dhe dëftim shoqëror. Edhe në punimin tonë këto dy fjalë do të përdoren si sinome të njëra-tjetrës. Shih, Lloshi, Xhevat, Stilistika dhe pragmatika, Tiranë, 1999, f. 302.
[637] Bussmann, 2002, f. 497; Lang 1977. Në fjalorët gjuhësorë të Glückut Bussmannit anashkalohet problemi që lind duke e përkufizuar parafrazën nga njëra anë si marrëdhënie sinonimike midis fjalive, dhe nga ana tjetër, duke dalluar marrëdhënie parafrazimi në rrafshin deiktik, paradigmatik dhe sintaksor, marrëdhënie që gjithsesi nuk mund të prezantojnë marrëdhënie sinonimike.
[638] Shembulli i përmendur sillet që në fillimet e studimeve në fushën e pragmatikës, për të trajtuar një nga tri çështjet e rëndësishme të objektit të studimit të kësaj disipline, pikërisht, raportin që vendoset midis thënies dhe qëllimit, që synohet të realizohet përmes saj. Shih, Linke, Angelika/Nussbaumer, Markus/ Portmann, Paul R., Studienbuch Linguistik, Tübingen, 2001, f. 199.

fjalëve prej të cilave ajo përbëhet. Përmbajtja e kësaj parafraze është e njëjtë me atë të shprehjes me kuptim metaforik[639] e cila parafrazohet.
Kushti që kuptimi i parafrazës rroket në mënyrë të drejtpërdrejtë përjashton mundësinë që kjo parafrazë të jetë edhe vetë një shprehje me kuptim metaforik, edhe pse kjo në princip është e mundshme.
Qasjet e ndryshme mbi mundësinë apo pamundësinë e parafrazimit të shprehjeve metaforike e kanë pikënisjen te përkufizimi i termit parafrazë dhe konceptit metaforë. Qasja e parë e termit parafrazë e sheh atë si mundësi për të shprehur të njëjtën përmbajtje si ajo e shprehjes me kuptim metaforik. Ky grupim i mohon karakterin referencial metaforave dhe nuk e shtron aspak për diskutim edhe problemin e parafrazimit.[640] P.sh., Davidsoni rreh t' i shohë metaforat asgjë më shumë se interpretimi i fjalëve prej të cilave ato përbëhen, pra, interpretimi literal i tyre. Ky qëndrim nuk është i drejtë, pasi edhe shprehjet metaforike realizojnë përmbajtje, e cila mund të realizohet dhe me shprehjet, kuptimi i të cilave është i drejtpërdrejtë. Siç kemi treguar edhe në shtjellimet dhe kapitujt e tjerë, edhe fjalët dhe shprehje të veçanta shprehin dhe realizojnë përmbajtje të cilat duhet të specifikohen në një kontekst të veçantë. Edhe shprehje me kuptim të drejtpërdrejtë ngërthejnë komponente kuptimore të cilat në një kontekst të caktuar ligjërimor nënkuptojnë diçka më shumë apo më specifike se vetëm kuptimi leksikor i tyre. Përkundrejt një vështirësie të tillë, marrësi i mesazhit arrin ta kuptojë përmbajtjen duke kombinuar kompetencën e tij gjuhësore me dijet sociokulturore. Ky qëndrim e ndihmon atë të rrokë edhe kuptimin e shprehjeve metaforike. Nëse në gazetat e kohëve të fundit shqiptare do të shkruheshin shprehje nga të dyja kampet politike: ju *jeni buldozerë të kusarisë*, asnjëri nga marrësit shqiptarë të mesazhit nuk do të ndalonte në vështirësitë që paraqet rrokja e kuptimit leksikor të fjalës buldozer ("traktor me një thikë të gjerë e të fortë përpara, që shërben për të gërryer, për të sheshuar ose për të shtyrë dheun[641]), siç propozon dhe gjuhëtari Davidson. Ata do ta rrokin kuptimin e shprehjes metaforike "bulldozer i kusarisë", me ndihmën e komponenteve të tilla kuptimore si: TË FUQISHËM PËR TË VENDOSUR, TË PANDALSHËM NË KUSARI, TË PAMËSHIRSHËM NË KËTO VEPRIME.
Qasja sipas së cilës mjetet me kuptim metaforik transmetojnë një përmbajtje është edhe në përputhje me kriterin informues të të gjitha llojeve të teksteve (edhe nëse ky funksion është për nga shkalla e rëndësisë i dorës së dytë).[642] Me përjashtim të metaforave absolute, shprehjet e tjera metaforike mund të parafrazohen, sepse ato ngërthejnë një përmbajtje, e cila mund të transmetohet me anën e parafrazës, që ka të njëjtën përmbajtje si ajo e shprehjes metaforike. Mbështjellja e konceptit parafrazë me kushte të panevojshme vjen se nga një parafrazë nuk mund të pritet që të shprehë të

[639] Me termin *kuptim metaforik* kuptojmë çdo lloj shprehjeje e cila përmban të paktën një element, kuptimi i të cilit rroket nga marrësi i mesazhit si metaforik.
[640] Davidsoni rreh t' i shohë metaforat asgjë më shumë se interpretimi i fjalëve prej të cilave ato përbëhen, pra, interpretimi literal i tyre. Shih, Davidson, Donald (1984). What Metaphors Mean (1978). në: Davidson, Donad (Hg.): *Inquiries into Truth and Interpretation*. Oxford: Clarendon, S. 343-370.
[641] Shih, Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, online.
[642] Raste të mosrespektimit të kriterit informues të shprehjeve me kuptim metaforik, dmth, të mostransmetimit të përmbajtjeve përshkruese (deskriptive) janë shumë të rralla në situatat ligjërimore të jetës përditshme. Këto raste janë të kufizuara vetëm për disa lloje tekstesh letrare. Në rryma të caktuara të lirikës moderne, psh., Lirika Hermeneutike, ndeshim më shumë raste të përdorimit të shprehjeve metaforike pa përmbajtje descriptive. Metafora të tilla quhen në teorinë e letërsisë *metafora absolute*. Shih, Davidson, Donald (1984). What Metaphors Mean (1978). në: Davidson, D. (Hg.): *Inquiries into Truth and Interpretation*. Oxford: Clarendon, S. 343-370

gjithë spektrin e mundshëm të përmbajtjeve që ngërthen shprehja metaforike në të gjitha rrafshet gjuhësore.

Ndërsa në qasjen e dytë, në përkufizimin e konceptit parafrazë përtej elementeve të kuptimit të shprehjes, pra, elementeve që janë pjesë e analizës semantike, përfshihen edhe dukuri që lidhen me mënyrën e perceptimit të kësaj shprehjeje nga marrësi i mesazhit, si: asociacionet, emocionet, pra, dukuri që kanë të bëjnë me qëlllimin e thënies. [643]

Është e kuptueshme që nuk mund të ketë asnjë parafrazë e cila të arrijë të shkaktojë të njëjtin reagim te marrësi i mesazhit, të ketë të njëjtën vlerë stilistikore, komunikative, pragmatike dhe kognitive.[644] Thelbi i shprehjeve metaforike qëndron në paraqitjen e realieve, ndodhive në mënyrë të tillë, që me ndihmën e tyre të realizohen efekte të veçanta stilistikore, pragmatike dhe konjitive, të cilat i kapërcejnë ato të vlerës së kuptimit referencial të tyre.

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi që argumentet e sjella kundër parafrazimit të shprehjeve metaforike nuk qëndrojnë. Përmbajtja e shprehjeve metaforike mund të jepet me thënie, kuptimi i drejtpërdrejtë i njësive gjuhësore prej të cilave ajo përbëhet, është i njëjtë më atë të shprehjes metaforike. Përmbajtja e parafrazave ndërtohet nga elemente kuptimore të shprehura në mënyrë drejtpërdrejtë, të cilat rezultojnë gjatë procesit të të kuptuarit të shprehjeve metaforike.

4.2.3 Komponente kuptimore emergente si pjesë e përmbajtjes së thënieve

Përpara se të kalojmë në sqarimin e çështjes se ç‘pjesë të përmbajtjes së shprehjeve metaforike zënë elementet kuptimore emergente në vëllimin e koncepteve të veçanta prej të cilave ndërtohet shprehja metaforike, e shohim me vend të trajtojmë fillimisht se çfarë nënkupton koncepti *komponente konceptuale emergente.*
Fjala emergent e ka prejardhjen në gjuhën latine (emergere) dhe do të thotë dalja, lindja, zhvillimi i karakteristikave, strukturave të reja të një sistemi si pasojë e bashkëveprimit të elementeve përbërëse të tij. Për herë të parë ai është përdorur nga Lewesi, i cili në punimin e tij me titull “Problem of Live and Mind” dallon efektet emergente nga ato rezultative të një sistemi. Ai i karakterizon efektet emergente të tilla që “nuk kanë lidhje me shumën e efekteve të komponenteve të sistemit prej të cilave ai përbëhet.[645]

Me termin *emergent* në gjuhësi përcaktohet shfaqja, lindja e veçorive të reja për të gjithë dukurinë, veçori të cilat nuk mund të përftohen apo rrjedhin nga karakteristikat, veçoritë e komponenteve të veçanta prej të cilave ajo përbëhet dhe as nga kombinimi i tyre. Lidhur me problemin që ne qëmtojmë, me procesin e të kuptuarit të metaforave, termin emergent Skirl e përkufizon:

---

[643] Shih, Radtke, Burkhard, *Metapher und Wahrheit*, Berlin, Logios, 2001. Ai thekson se „Një thënie mund të jetë parafrazë e një shprehjeje vetëm në rastet kur ajo shpreh jo vetëm të njëjtën përmbajtje, por ka edhe të njëjtin ndikim te marrësi i mesazhit, psh. zgjon të njëjtat emocione, asociacione.“
[644] Po aty.
[645] Stephan, Achim/ Beckermann, Ansgar, 1994, f. 46. Në diskursin e sotëm ky term përdoret jo vetëm në gjuhësi, por edhe në fusha të ndryshme të filozofisë, të teorisë së vetëorganizimit, të sinergjitikës, të teorisë së kaosit, në qasjen kibernitike të ndërthurjes së sistemeve, marrëdhënieve dhe rezultateve që vijnë nga përpunimi i informacioneve, etj.

> “Veçori emergente janë ato komponente kuptimore të cilat nuk janë komponente përbërëse të kuptimit të leksemave të veçanta që qëmtojmë, dhe as komponente të koncepteve të tyre. Ato nuk janë të njëjta me kombinimin e këtyre koncepteve, por lindin gjatë procesit të dekodimit të metaforave.”[646]

Koncepti i komponenteve emergente do t’u referohet në punimin tonë komponenteve kuptimore emergente, të cilat i ndeshim në procesin e të kuptuarit (receptimit) të metaforave, p.sh., metaforave të paleksikalizuara (inovative). Në rrafshin e semantikës leksikore ato janë emergente përkundrejt kuptimit të fjalëve dhe përmbajtjes së koncepteve që shoqërojnë këto kuptime. Në lidhje me sematikën e thënies, ato janë emergente përkundrejt përmbajtjes së thënies së llogaritur si shumë e njësive përbërëse të saj. Përsa i përket semantikës së tekstit do të qëmtojmë komponente emergente informacionet që nuk rrjedhin apo rezultojnë nga analiza e informacioneve kuptimore të tekstit.[647]

Rolin e komponenteve konceptuale emergente në ndërtimin e përmbajtjes së thënies së një shprehjeje me kuptim metaforik mund ta shpjegojmë në kuadrin e teorisë konjitive.

Domethënia e një thënieje projekton strukturat semantikore në strukturat e referimit. Në procesin e të kuptuarit të metaforave është i nevojshëm rishikimi i strukturave të referimit të sapopërmendura: Përpos ndërthurjeve të elementeve kuptimore prej të cilave përbëhet thënia, në këto struktura referimi ngërthehen (shtohen) edhe komponente kuptimore emergente. Kjo qasje është bindëse edhe nga ana psikologjike, po të mbajmë parasysh, që gjatë procesit të të kuptuarit aktualizohen në mënyrë të ndërgjegjshme njëkohësisht jo vetëm kuptimi i fjalëve, por edhe kuptimi i thënies.
Pra, komponentet kuptimore emergente aktualizohen edhe gjatë procesit të referimit. Riinterpretimi i marrëdhënieve të koncepteve të veçanta të shprehura në mënyrë eksplicite në semantikën e thënies gjatë procesit të referimit, na drejton në procesin e të kuptuarit të metaforave drejt formimit (lindjes) të komponenteve kuptimore emergente.
Kjo qasje është e rëndësishme edhe për një studim përqasës, si i yni. Secila gjuhë ka veçori dhe modele karakteristike për konceptualizimin e botës, pasqyrimin e përvojës. Krahasimi i koncepteve në gjuhët që përqasim, konkretisht, në gjuhën shqipe dhe atë gjermane, na ndihmon të zbulojmë edhe veçantitë që mbartin ato, duke hetuar dhe qëmtuar ngjashmëritë, dallimet në koncepte të veçanta dhe në riinterpretimin e tyre në rrafshin e semantikës së thënies, në strukturat e referimit, që siç e kemi theksuar kushtëzohen nga sfondi sociokulturor.

4.3 Modeli i botës së tekstit dhe komponente konceptuale emergente në procesin e të kuptuarit të metaforave në „Darka e gabuar“

Ky kapitull rreh të tregojë vendin e elementeve konceptuale emergente, vendin e tyre në rrokjen e kuptimit të tekstit, si edhe raportin e modelit të realitetit tekstor në lidhje me elementet konceptuale emergente, konceptin ad hoc, siç do ta emërtojmë në vijim.

---

[646] Skirl, Helge, *Emergenz als Phänomen der Semantik am Beispiel des Metapherverstehens. Emergente konzeptuelle Merkmale an der Schnittstelle von Semantik und Pragmatik,* Tübingen, Günter Narr Verlag, 2009, f. 15.
[647] Shih, po aty, f. 24.

4.3.1 Teoria konjitive e të kuptuarit të metaforave në tekst

Në pjesën e parë të punimit kemi treguar që rrokja e kuptimit të tekstit është një proces konjitiv dinamik, gjatë të cilit marrësit e mesazhit pasurojnë informacionet semantikore të shprehura në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekst, me informacione konceptuale nga kujtesa afatgjatë e tyre: realiteti tekstor ndërtohet nga marrësit e mesazhit, si një proces i ndërthurjes së analizës induktive mbi bazën e tekstit me procesin e analizës deduktive.
Modeli i realitetit tekstor, siç e emërton atë gjuhëtarja Schwarz,[648] na paraqet një kombinim të formësuar mendërisht të informacioneve të tekstit me informacione të aktivizuara nga teksti, të ruajtura në kujtesën afatgjatë. Një qasje e tillë na lejon të inkuadrojmë edhe modelimin e pikëprerjeve të semantikës me pragmatikën, sepse realiteti tekstor i ndërtuar si më sipër paraqet një strukturë komplekse referenciale që prezanton jo vetëm realiet, ndodhitë e tekstit, por edhe marrëdhëniet midis tyre. Kur flasim për realie, ndodhi, duhet të kemi parasysh se kemi jo vetëm një paraqitje (projektim mental) mendore të realieve, ndodhive të veçanta të perceptuara nëpërmjet shqisave, por edhe të entiteve të tyre. P.sh., nëse flasim për figurën e Gurametos së madh dhe të vogël në romanin “Darka e gabuar” të Kadaresë, projektojmë mendërisht të gjithë individët që mbartin karakteristikat e këtyre dy personazheve të Kadaresë. Me fjalë të tjera, ne nuk projektojmë vetëm koncepte të individëvve (token), por edhe të klasave, ku ato bëjnë pjesë (types).[649]

Në shprehjet metaforike të tipit “X është një Y” koncepti i shprehur nga X na prezantohet si një individ (ndodhi e veçantë) e tipit (klasës) së përcaktuar nga Y.

P.sh., marrëdhënia e shprehur në “fjala ishte mortje e shkuar mortjes”[650] vlerësohet mbi bazën e dijes enciklopedike nga rrokësit e mesazhit e gabuar. Nisur nga dija se një fjalë nuk mund të jetë kurrë një mortje, si edhe nga principi i bashkëpunimit komunikativ, sipas së cilit informacionet e ofruara nga teksti duhet të jenë të kuptueshme nga përmbajtja dhe të lidhura logjikisht me informacionet e shprehura deritani në tekst, marrësi i mesazhit rrok kuptimin e shprehjes metaforike mbi bazën procesit të ndërveprimit të konceptit të shprehur nga metafora, me modelin e realitetit tekstor të formuar. Pra, përcaktimi i referimit të shprehjeve metaforike mund të karakterizohet si një fenomen i vendosjes së koherencës tekstore, e cila në gjuhësinë e tekstit

> “përkufizohet si lidhje, përshtjatje e përmbajtjes, saktësisht si vazhdimësi semantiko-konceptuale, dmth, bëhet fjalë për të gjitha marrëdhëniet që transmeton një tekst në mënyrë eksplicite dhe implicite, prej të cilave ndërtohet përmbajtja dhe vazhdimësia e tekstit. […]Kjo vazhdimësi konceptuale (si tërësia e marrëdhënieve të mundhsme midis pjesëve të tekstit) formohet në mendjen e marrësit të mesazhit përmes proceseve të bazuara në tekst dhe atyre të bazuara në dije.[651]

[648] Shih, Schwarz-Friesel, Monika, *Indirekte Anapher. Studien zur domänengebunen Referenz und Kohärenz im Deutschen.* Tübingen, Niemeyer, 2000, f. 40.
[649] Shih, po aty, f. 60.
[650] Darka e gabuar, f. 20.
[651] Schwarz-Friesel, Monika, Kohärenz versus Textsinn: Didaktische Facetten einer linguistischen Theorie der textuellen Kontinuität, në, Scherner, Maximilian/ Ziegler, Arne (botues), *Angewandte Textlinguistik. Perspektiven für den Deutsch- und Fremdsprechenunterricht*. Tübingen, Günther Narr, 2006, f. 63 -75, këtu, f.64.

Për shprehjet metaforike marrësit e mesazhit të tekstit projektojnë një strukturë referimi e cila është në përshtatje dhe mund të integrohet në modelin e realitetit tekstor, në mënyrë të tillë që teksti të jetë koherent.[652]
Kuptimi i shprehjeve metaforike rroket në varësi të informacioneve të kotekstit me dijet konceptuale të aktivizuara nga koteksti, të cilat janë pjesë e modelit të realitetit tekstor të ndërtuar dhe projektuar mendërisht.[653]

Kategorizimi i dijes konceptuale që përdorim për të shpjeguar kuptimin e metaforave dhe vendin që zë ajo në raport me dijen enciklopedike, leksikore dhe së fundmi me modelin e realitetit tekstor është një çështje e cila në gjuhësinë konjitive ka zënë një vend të rëndësishëm.

4.3.1.1 Kuptimi i metaforave dhe modeli i realitetit tekstor

Për shpjegimin e kuptimit të metaforave është e rëndësishme të tregojmë se ç'lloj dijeje është dija e përdorur për të rrokur kuptimin e metaforave, ç'pjesë të komponenteve kuptimore zënë komponentet konceptuale emergente, të cilat, siç treguam, lindin gjatë rrokjes së kuptimit të metaforave të reja të paleksikalizuara.

Modeli i propozuar nga gjuhëtarët Skirl dhe Schwarz-Friesel[654] për pasqyrimin e komponeteve kuptimore të shprehjeve metaforike ndërtohet me kushtëzimin e mëposhtëm: një përbërës mund të jetë semantik ose konceptual. Bazuar edhe në përkufizimin e Schwarzit mbi fushën konjitive, të cilën po e emërtojmë me KD,[655] përbërës të kuptimit të një njësie gjuhësore të shënuar në fjalorë janë komponente konceptuale të lidhura me këtë njësi gjuhësore. Nisur nga çka thamë deri tani, modeli i propozuar përmban një sasi komponentesh kuptimore nga fusha konjtive që po e shënojmë me M(KD), në të cilën referon shprehja metaforike. Për shprehjet metaforike të tipit X është një Y, sfera konjitive përcaktohet nga Y. Kjo sasi komponentesh kuptimore të sferës konjitive M(KD) përmbledh një sasi elementesh kuptimore të shënuar në fjalorë $M(KD^{fjalorë})$ të Y. Përpos kësaj, aty përfshihen edhe komponente konceptuale të lidhura apo aktivizuara nga komponentet konceptuale të shënuara në fjalorë, që i shënojmë me $M(KD^{koncept})$. Skematikisht çka përshkruam, do ta paraqesim si më poshtë:

[652] Shih, Skirl,Helga, Metaphorical Anaphors. A Phenomenon of the Sematics-Pragmatics Interface. Në, Schwarz-Friesel, Monika/ Consten, Manfred/Knees, Mareile (botues), *Anaphors in Texts. Cognitive, formal and applied approaches to anaphoric reference.* Amsterdam, Philadelphia, Benjamins, 2007, f. 54.
[653] Shih, Skirl,Helga, Metaphorical Anaphors. A Phenomenon of the Sematics-Pragmatics Interface. Në, Schwarz-Friesel, Monika/ Consten, Manfred/Knees, Mareile (botues), *Anaphors in Texts. Cognitive, formal and applied approaches to anaphoric reference.* Amsterdam, Philadelphia, Benjamins, 2007, f. 64.
[654] Skirl, Helge, Emergenz als Phänomen der Semantik am Beispiel des Metapherverstehens. Emergente konzeptuelle Merkmale an der Schnittstelle von Semantik und Pragmatik, Tübingen, 2009, f. 149-151.
[655] Schwarz e përdor emërtimin sferë, fushë konjitive për koncepte komplekse, për skema komplekse konjitive , të cilat prezantojnë dijen enciklopedike. Shih, Schwarz-Friesel, Monika, *Indirekte Anapher. Studien zur domänengebundenen Referenz und Kohärenz im Deutschen.* Tübingen, Niemeyer,2000, 37-39. KD është shkurtimi me iniciale për termin në gjermanisht Kognitive Domäne.

<table>
<tr><td colspan="2">Sfera konjtive (SK)
[→x është një Y, që përcaktohet nga Y]
$M(KD) = M(KD^{fjalorë}) \cup M(KD^{koncept})$</td></tr>
<tr><td>Kuptimi i shënuar në fjalorë

përbërës kuptimorë

$M(KD^{fjalorë}) = \{S^{KD}_{1,} S^{KD}_{2,} \ldots S^{KD}_{m}\}$</td><td>Përmbajtja e konceptit

komponente konceptuale

$M(KD^{koncept}) = \{K^{KD}_{m+1,} K^{KD}_{m+2,} \ldots, K^{KD}_{n}\}$</td></tr>
</table>

Strategjia:
← **Përzgjedhja e përbërësve**

↑

↑

Dija semantikore (eksplicite)

Dija pragmatike (implicite)

<table>
<tr><td>Koteksti
potenciali kuptimor që transmetohet në nivelin e fjalisë dhe të tekstit

$M (MRT^{kotekst}) = \{S^{MRT}_{1,} S^{MRT}_{2, \ldots,} S^{MRT}_{k}\}$</td><td>Kontekst
dija konceptuale enciklopedike;
dija mbi llojin e tekstit dhe diskursit
$M (MRT^{kontekst}) = \{K^{MRT}_{1,} K^{MRT}_{2, \ldots,} K^{MRT}_{l}\}$</td></tr>
<tr><td colspan="2">Modeli i realitetit tekstor (MRT)
$M(MRT) = M(MRT^{kotekst}) \cup M(MRT^{kontekst}) \cup M (SK)$</td></tr>
</table>

Të gjitha referimet e metaforave përfshihen në modelin tekstor të tekstit të shënuar me TRM. Ai përmbledh komponentet kuptimore të sferës konjitive. Përpos këtyre, në të përfshihen komponente kuptimore që rrjedhin nga koteksti, të shënuara në model me $MRT^{kotekst}$, si edhe komponente konceptuale që rrjedhin nga konteksti, të shënuara nga $MRT^{kontekst}$. Sasia e komponenteve kuptimore të kotekstit lidhet me dijen semantikore, pra me komponente kuptimore që shprehen në mënyrë eksplicite nga leksemat dhe që janë të shënuara dhe në fjalorë. Përjashtuar nga kjo dije janë sasia e komponenteve kuptimore të shprehjes gjuhësore Y (që lidhet me kotekstin). Shprehjet gjuhësore që janë përreth Y janë pjesë e kotekstit. Sasia e komponenteve konceptuale të kontekstit, shënuar me $MRT^{kontekst}$ përmbledh të gjitha komponentet që rrjedhin gjatë procesit të kuptimit të tekstit, pra, të gjitha ato komponente të prezantuara në realitetin tekstor të tekstit, që nuk janë të shprehura në mënyrë eksplicite në tekst nëpërmjet leksemave apo kuptimeve në fjalorë, por nga aktivizimi i koncepteve të tjera që aktivizohen nga konceptet e aktivizuara nga koteksti apo komponentet kuptimore leksikore. Këto komponente konceptuale aktivizojnë edhe dijen enciklopedike, si, p.sh., dijen mbi llojin e tekstit, diskursit. Nëpërmjet proceseve deduktive në formën e inferencave mund të ndërtohen komponente konceptuale, çka luan një rol të madh në ndërtimin e komponenteve emergente.

Sasia e komponenteve të aktivizuara në kotekst varet shumë nga aktiviteti i lexuesit dhe ng aftësitë konjitive të tij. Konstrukti ideal i një modeli të realitetit të kontekstit është ai, që përmbledh ato komponente të mjaftueshme dhe të nevojshme, për të pasuruar informacionet eksplicite të teksit (të ndërtuara përmes proceseve induktive) nëpërmjet proceseve deduktive në mënyrë të tillë, që të mund të ndërtohet dhe

prezantohet mendërisht një model i realitetit tekstor, në të cilat gjenden të projektuara edhe nënspecifikime të teksit.

Le ta konkretizojmë këtë model të ndërtimit të kuptimit të epitetit me kuptim metaforik *e gabuar* në titullin e romanit të Kadaresë “Darka e gabuar”. Thënia “Darka është e gabuar” referon në një fushë konjtive e cila do të përmbledhë komponente kuptimore të përcaktuara nga *e gabuar*. Aktivizimi i dijes sematike mbi kuptimin e shënuar në fjalorë për lemën *e gabuar* angazhon përbërës kuptimorë, *si jo i përpiktë sipas rregullave, i shtrembër, në kundërshtim me të vërtetën, i gënjyer, i papërputhshëm me normat a me rregullat morale të vendosura nga shoqëria*. Këto përbërës kuptimorë aktivizojnë koncepte, si normë, rregulla, drejtësi, e vërtetë, të cilat janë pjesë e fushës konjitive konceptuale që përmbledh të gjitha këto komponente. Dija eksplicite e transmetuar në romanin “Darka e gabuar”, d.m.th. dija nga koteksti i shton këtyre përbërësve kuptimorë dhe konceptualë, elementet: tmerr, lemeri, enigmë, mister, e pazbuluar. Të gjitha këto komponente ndërtojnë një model të realitetit tekstor të kotekstit. Ky model i realitietit tekstor të kotekstit aktivizon dijen implicite, pragmatike, e cila e verifikon modelin e ndërtuar nga dija eksplicite e kotekstit. Dija implicite, që përfshin dijen mbi llojin e tekstit, konkretisht, letërsi artistike, roman, dija mbi stilin e autorit, konkretisht, stilin e të shkruarit të Kadaresë, dija e përftuar në një sfond të caktuar sociokulturor, konkretisht, dija, se ata që bashkëpunuan me pushtuesit gjermanë, u quajtën tradhtarë, si edhe analogjia e vendosur midis kësaj darke dhe “Darkës së fundit” nga bibla, që Jesu Krishti pati me apostujt e tij një natë para kryqëzimit, bën, që domethënia e epitetit metaforë *e gabuar* të pasurohet nga ky aktivizim me komponente kuptimore, si, fatale, që të çon në ndëshkim, eleminim, asgjësim, vdekje.

4.4 Metaforat në “Darka e gabuar” të Kadaresë dhe gjegjëset e tyre në gjermanisht

Skicimi i teorive të ndryshme për mundësinë e përkthimit të metaforave na mundëson edhe përvijimin e kornizës së përgjithshme për vlerësimin e përqasjen e vlerave semantiko-leksikore midis origjinalit në shqip të Kadaresë “Darka e gabuar” dhe përkthimit të tij nga Joachim Röhm “Ein folgenschwerer Abend”. Do të hetojmë nëpërmjet shembujve të përzgjedhur se ç´lloj ekuivalence vendosin të dyja variantet. Në një tekst letrar siç është “Darka e gabuar”, ekuivalenca formale-estetike luan një rol të veçantë. Analiza konkrete e metaforave do të dëshmojë se cilat prej vlerave formale-estetike ruhen në përkthim.

Modeli i Koller-it për marrëdhëniet e ndryshme të ekuivalencës na mundëson qartësimin e problemit të ruajtjes apo shkallëve të ndryshme të saj të stilit të autorit në përkthimin e metaforave. Nëse midis origjinalit dhe përkthimit mungon ekuivalenca, atëherë është e domosdoshme të përdorim modelin e ekuivalencës së propozuar nga Kurth-i. Prandaj, në analizën e vlerave formale-estetike, si edhe në gjykimin e ruajtes së stilit të autorit do të përdorim një ndërthurje të modeleve të ekuivalencës së propozuar nga dy autorët e sipërpërmendur. Një qasje e tillë mundëson qartësimin e problemeve të hasura nga përkthimi i gjuhës shqipe në gjermanisht, dhe, veçanërisht, i metaforave.

4.4.1 Evidentimi i marrëdhënieve të ekuivalencës së vlerave formale-estetike të metaforave në variantet shqip dhe gjermanisht të romanit “Darka e gabuar”

Siç e përmendëm edhe më lart, modeli i ekuivalencës së propozuar nga Koller-i (2001) do të përdoret për krahasimin e varianteve të metaforave në shqip dhe në gjermanisht. Në rastet kur metafora e gjuhës shqipe nuk ka ekuivalencë në gjuhën pritëse, përkatësisht gjermane, do të krahasojmë strukturat gjuhësore në gjermanisht të përdorura nga përkthyesi Joachim Röhm për dhënien dhe transmetimin e metaforave të shqipes. Kjo, sepse mungesa në metafora ekuivalente në gjuhën pritëse e detyron përkthyesin të zbulojë dhe zbatojë strategji të reja. Në raste të tilla, përkthyesi duhet të thërrasë në ndihmë kompetencën e tij gjuhësore dhe njohjen e kuptimit dhe përdorimit të metaforave. Por sa prej vlerave formale-estetike ruhen gjatë këtij procesi do ta shohim më nga afër në sythin në vijim.

4.4.1.1 Ekuivalencë e plotë

Ekuivalencë të plotë vërejmë në rastet kur metaforat në gjuhën amtare përputhen me ato në gjuhën pritëse, jo vetëm në rrafshin morfologjik e sintaksor, dmth., formë dhe kuptim, por edhe në rrafshin pragmatik. Kjo do të thotë që në metaforën e gjuhës pritëse transmetohen të njëjtat vlera formale-estetike dhe i njëjti stil, përdoret e njëjta figurshmëri. Nga analiza e metaforave në versionin e përkthyer në gjermanisht të romanit “Darka e gabuar” është e vështirë të konstatojmë raste të ekuivalencës së plotë. Kjo përligjet, sigurisht, po të kemi parasysh, së pari, diferencën e madhe midis gjuhëve shqip dhe gjermanisht,[656] por edhe vetë stilin dhe figurshmërinë e arrirë të shkrimtarit I. Kadare dhe posaçërisht të veprës së tij “Darka e gabuar”.

a. Ti më dhe një urdhër *në një gjuhë të vdekur*.[657]
   Varianti i Röhm-it
   Du hast mir *in einer toten Sprache* einen Befehl erteilt.[658]
   Përkthimi i variantit të Röhm-it:
   Ti më ke dhënë një urdhër në një gjuhë të vdekur

b. Italia *kishte rënë në gjunjë*, (...).[659]
   Röhmi-i:
   Italia *ging auf den Knien*, (...)[660]
   Përkthim i variantit të Röhm-it
   Italia kishte rënë në gjunjë

c. ...Nga gryka e Tepelenës *era e veriut frynte* përherë më *armiqësore*[661]
   Röhm-i
   ...Aus der Schlucht von Tepelena w*ehte der Nordwind* zunehmend *feindlich herüber.*[662]
   Përkthimi i variantit të Röhm-it
   Nga gryka e Tepelenës frynte era e veriut në përherë e më armiqësore.

Në shembujt e dhënë kostatojmë ekuivalencë të plotë në rrafshin formal dhe semantiko-leksikor, dmth. metaforat e gjuhës amtare, *në një gjuhë të vdekur, kishte*

[656] Të dyja gjuhët u përkasin familjeve të ndryshme të gjuhëve.
[657] Darka e gabuar, f. 53.
[658] Ein folgenschwerer Abend f. 43.
[659] Darka e gabuar, f. 10.
[660] Ein folgenschwerer Abend, f. 7.
[661] Darka e gabuar, f. 34.
[662] Ein folgenschwerer Abend, f. 27.

rënë në gjunjë, era e veriut frynte armiqësore janë ekuivalente me atë të gjuhës pritëse jo vetëm në formë, edhe në rrafshin semantiko-leksikor, por edhe në atë pragmatik. Në rrafshin morfo-sintaksor metaforat i ndeshim me të njëjtën formë në të dyja gjuhët, edhe pse formalisht kemi mospërputhje të kohëve foljore, në *a* koha e kryer e thjeshtë në gjuhën shqipe jepet në kohën e kryer dhe në *b, c* pikërisht e kundërt: koha e kryer e shqipes transmetohet në gjermanisht me formën e kohës së kryer së thjeshtë. Ne mendojmë se kjo ka lidhje me mospërputhjen e kuptimit leksikor të këtyre kohëve në shqip dhe në gjermanisht.[663]
Në rrafshin semantikor transmetohet i njëjti informacion: në shembullin *a* momenti i bisedës së doktor Gurametos mbi lirimin e pengjeve, në *b* dorëzimin pa kushte të Italisë përballë Gjermanisë dhe në shembullin e fundit kemi një përshkrim përmes metaforës *armiqësore* të situatës gjeopolitike të qytetit të Tepelenës ndaj atij të Gjirokastrës. Në këtë mënyrë, këto metafora arrijnë të zgjojnë të njëjtat efekte dhe të emetojnë të njëjtat vlera estetike që kanë në shqip edhe në rrafshin pragmatik.
Në shembullin *a* metafora *në një gjuhë të vdekur* vjen në situatën kur Gurametoja i madh, pas momenteve të para të takimit me kolonelin dhe shkëmbimeve të bisedës mbi shpjegimin e arsyes së goditjes së truprojës gjermane i kërkon kolonelit Schwabe të lirojë pengjet në shqip, dhe, pastaj edhe në latinisht. Lexuesi, duke e lexuar metaforën mbi gjuhën e vdekur në të cilën është dhënë urdhri, mund të mendojë se është përdorur nga shkrimtari për të hequr ndoshta paralele midis gjuhës dhe fatit të pengjeve. Por, shkrimtari kundër kësaj pritshmërie të lexuesit lë që gjatë bisedës së mëtejshme të dy ish studentëve të përmenden mundësitë dhe hipotezat e mundshme mbi këtë mënyrë të urdhërdhënies. Hamendësimet mbi:

- Shpërfilljen ndaj gjuhës gjermane
- Mallin për vitet studenteske
- Përcaktimin e kësaj gjuhe si gjuhë asnjanëse.

Përgjigjen e këtyre hamendësimeve nuk e gjejmë edhe në vijim. Edhe pse urdhri u dha në një gjuhë të që nuk flitet, udhri u ekzekutua. Pengjet u liruan.

Me gjithë ekuivalencën e plotë nuk mund të mohojmë që ndryshimet midis gjuhëve në rastin që shqyrtojmë, çojnë në vështirësi në përkthimin e metaforave. Ekuivalencë të plotë në strukturë, semantikë, leksik dhe në stil kemi vetëm atëherë kur metaforat më së shumti internacionale p.sh., përhapen përmes të njëjtës mënyrë, me të njëjtën mënyrë huazimi. Këto metafora kanë të njëjtin kuptim në gjuhën amtare dhe në atë pritëse, dhe elementet gjuhësore të saj si fjalë të veçanta përkojnë plotësisht ose pjesërisht midis tyre.

4.4.1.2 Ekuivalencë e pjesshme

Flasim për ekuivalencë të pjesshme kur metaforat në gjuhën amtare dhe në atë pritëse përkojnë pjesërisht në formë, kuptim apo në funksion. Kjo ndodh, kur në gjuhën pritëse nuk ekziston një imazh i njëjtë apo i ngjashëm me atë të gjuhës amtare. Në këtë rast, përkthyesi përdor një metaforë që emeton një imazh apo figurshmëri të ngjashme në gjuhën pritëse. Kjo metaforë rrjedh ose nga një rrafsh figurativ tjetër i

[663] Shih, Plangarica, Tomorr, Mbi invariantet kohore-aspektore të së pakryerës së kryerës së thjeshtë dhe së kryerës në gjuhën shqipe, në, Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me rastin e 100-vjetorit të lindjes së studjuesve Aynije Desnickaja, Shën Petersburg, Rusi, 20/30 shtator 2012.

ndryshëm nga ai i gjuhës amtare, ose devijon në formë, në semantikë apo në funksion nga metafora e gjuhës amtare. Pra, mund të kemi ndryshime ose në rrafshin stilistikor (p.sh., një fjalë e ligjërimit të shkujdesur përkthehet me një fjalë në gjermanisht, që i përket jo të njëjtit regjistër), ose në aspektin semantikor apo pragmatik midis metaforave në të dyja gjuhët. Këto të fundit lidhen edhe me figurshmërinë e leksemave përbërëse të metaforave.
Për shkak të diferencave kulturore dhe gjuhësore të shqipes dhe gjermanishtes, por edhe të stilit të autorit, shumë metafora të romanit “Darka e gabuar” përkthehen nga Röhm sipas kësaj mënyre. Nga kjo procedurë e pëkthimit ndeshemi me metafora në gjuhën pritëse të cilat mund t`i grupojmë sipas kriterit të shkallës së figurshmërisë në:[664]

1.1.1 Metafora, shkalla e figurshmërisë së të cilave është më e lartë në gjuhën pritëse
1.1.2 Metafora, shkalla e figurshmërisë së të cilave është më e ulët në gjuhën pritëse
1.1.3 Metafora me devijim të figurshmërisë në regjistër, në stil

T´i analizojmë këto grupime të metaforave

4.4.1.2.1 Metafora, me shkallë figurshmërie më të lartë në gjuhën pritëse

> ... Ky teprim i fantazisë e, sidomos përfytyrimi i doktor Gurametos së madh, me veglat e kirurgjisë në duar, duke bërë prerje trupash midis darkës, ndihmuan që rikthimi i mendjes së ikur të bëhej më shpejt dhe qyteti të fitonte prapë atë për të cilin më së shumti ishte krenar, gjykimin e ftohtë.[665]
>
> Röhm-i
> ... Diese Entgleisungen der Phantasie (man stellte sich vor, der große Doktor Gurameto mit dem Skalpell in der Hand am Eßtisch, Leichen zerschnippelnd, während die Gäste gemütlich tafelten!) förderten die Wiedererlangung der zerstobenen Vernunft, und die Stadt erhielt zurück, worauf sie in den letzten sechshundert Jahren stolz gewesen war, nähmlich ihre kühle Urteilskraft.[666]
>
> Përkthimi i variantit të Röhm-it
>
> Këto shkarje/rrëshqitje të fantazisë (përfytyrohej, doktor Gurametoja i madh me skalpelë në dorë në tavolinën e ngrënies, duke prerë copa-copa kufoma, ndërkohë që miqtë hanin e pinin) ndihmuan rikthimin e arsyes së shkapërdarë dhe qyteti mori përsëri (fitoi), atë për të cilin kishte qenë krenar gjashtëqind vitet e fundit, gjykimin e ftohtë.

Në shembullin e cituar struktura sintaksore e fjalisë në shqip, periudhë me dy fjali të varura kundrinore, njëra prej të cilave zgjerohet me një fjali përcaktore, dhe një fjali kryesore në të cilën evidentojmë një rrethanor të veçuar të mënyrës, jepet në

[664] Procedurën tonë të përkthimit të metaforave sipas gradës së figurshmërisë e mbështesim në teorinë e Kurth-it, 1995, e cila, duke u bazuar në konceptin e ekuivalencës së propoyuar nga Koller, koncept për të cilin kemi folur në sythin 3.3.7, parakupton tri strategji përkthimi të metaforave. Ato janë: përkthim fjalë për fjalë; zëvendësim i imazherisë, parafrazim apo çmetaforizim. Shih, Kurth, Ernst-Norbert, *Metapherübersetzung. Dargestellt am grotesken Metaphern im Frühwrk Charl Dickens in der Wiedergabe deutscher Übersetzung*. Frankfurt am Main, Peter Lang, f.88.
[665] Darka e gabuar, f. 34.
[666] Ein folgenschwerer Abend, f. 26.

gjermanisht përmes një periudhe të përbërë nga dy fjali të bashkërenditura, fjalia e dytë e së cilës lidhet me një fjali përcaktore, dhe e para specifikohet përmes një fjalie të ndërkallur në formën e një periudhe me fjali të nënrenditur kohore. Përkthimi në gjermanisht i pjesës së nënrenditur kundrinore/ftilluese *që rikthimi i mendjes së ikur të bëhej më shpejt* me një konstrukt prejpjesor *die Wiedererlangung der zerstobenen Vernunft* është veçori e zakonshme e gjuhës së shkruar gjermane. Përdorimi i fjalive të bashkërenditura me ngjyrim shkak-pasojë në vend të nënrenditurave i vesh fjalisë në gjermanisht vlera të tjera përdorimore krahasuar me shqipen: në gjermanisht shkarja e fantazisë, përfytyrimet e pazakonta ndihmojnë rikthimin e arsyes së shkalafitur, shkapërndarë, dmth., qartësimin e situatës dhe, si pasojë, qytetit, njerëzve u rikthehej gjykimi i ftohtë.
Diferencat në rrafshin semantikor vërehen midis leksemave shqip-gjermanisht *teprim-Engleisung* (shkarje) dhe mbiemrave prejfoljorë *së ikur* dhe *zerstobenen*. Në fjalorin “Duden, 10 bändige Wörterbuch der deutschen Sprache”, por edhe në atë gjermanisht-shqip të Zef Simonit[667] *Entgleisung* është shënuar si leksemë me kuptim figurativ çka nuk mund të pohohet për emrin e shqipes *teprim.*
Nga ana tjetër, edhe dallimet kuptimore midis mbiemrit prejpjesor *i ikur,* metaforë e leksikalizuar, dhe *zerstoben* i evidentojmë po të analizojmë kuptimet dhe elementet konceptuale të të dyja leksemave. Kuptimi në kontekst i fjalës polisemike *i ikur* është shënuar në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe online” e ligjërimit bisedor. Shpjegimi i kuptimit të saj jepet përmes marrëdhënieve sinonimike me fjalët: i *marrë, i çmendur*. Gjegjësja në përkthim *zerstoben* na emeton një kuptim metaforik inovativ në bashkëvajtje me emrin *Vernunft* (arsye). Kuptimi i saj në fjalor ngërthen sema kuptimore: *humb, zhduket, shpërndarë në copa*. Në kontekst, kuptimi ngërthen edhe elemente kuptimore si: e paaftë për të gjykuar dhe vendosur për mënyrën dhe shkakun e darkës së përfolur. Interferenca e dijeve tona – pamundësia e njëkohëshme e shtrimit të darkës dhe operacioneve me thikë në tryezën e ngrënies – i shton këtij kuptimi edhe elementin kuptimor *i marrë.*

> Por kjo hamendje nuk e pati të gjatë. [668]
>
> Röhm-i:
> Diese Deutung der Vorgänge war indessen kein langes Leben beschieden.[669]
>
> Përkthimi i variantit të Röhm-it
> Këtij interpretimi të ngjarjeve nuk mund t`i jepej një jetëgjatësi e madhe.

Në përkthimin e Röhmit *hamendje* ka si gjegjëse togfjalëshin *Deutung der Vorgänge*. Në rrafshin semantik, kuptimi i fjalës *hamendje* ndërtohet mbi bazën e semave kuptimore: vlerësim a përfundim i arritur me përafërsi, jo mbi bazën e të dhënave të sakta, por, sipas gjasës, që mund t`i ofrohet së vërtetës, ndërkohë që gjegjësja e përkthimit të Röhm-it parakupton një shpjegim a sqarim të diçkaje të errët, të dhënave ashtu siç e kupton vetë personi. Nga analiza e elementeve konceptuale përbërëse të kuptimit del qartë se interpretimi mund të ndërtohet mbi bazën e hamendësimit. Nëse do t´i përqasnim fjalët në gjermanisht e shqip mbi bazën e koncepteve bazë të

[667] Simoni, Zef, *Wörterbuch Deutsch-Albanisch*, Hamburg, Buske, 1997, f. 219.
[668] Darka e gabuar, f. 32.
[669] Ein folgenschwerer Abend, f. 25.

pranuara nga Pinker-i[670] si primitivë të kuptimit të fjalëve: shkak, kohë, hapësirë, mënyrë, entitete njerëzore vs. jonjerëzore, ngjarje vs. gjendje, drejtim etj., gjejmë ndryshime jo vetëm në primitivët konceptualë kohorë, interpretimi vjen pas hamendësimit, – por edhe në ato të mënyrës, – interpretimi është lexim i të dhënave dhe fakteve sipas mënyrës, konceptit, botëkuptimit vetjak. Ndërsa hamendja ndërtohet pas shqyrtimit të të dhënave të cilat mund t´i përafrohen së vërtetave, fakteve dhe mund të shërbejnë edhe si mjet për interpretim.
Strukturat e tjera gjuhësore *nuk e pati të gjatë* të shënuara si frazeologjizëm në „Fjalorin frazeologjik të gjuhës shqipe“ të Jani Thomait, me kuptimin e pamundësisë për të vazhduar gjatë[671] dhe gjegjësja e përkthimit të Röhm-it *kein langes Leben bescheiden* kanë devijime jo vetëm në mjetet gjuhësore përbërëse kuptimore, por edhe në regjistrat gjuhësorë. Folja *bescheiden* i përket ligjërimit libror në gjermanisht, ndërsa në shqip folja *kam* mbi të cilën ndërtohet shprehja frazeologjike nuk është e shënjuar stilistikisht. Shprehja frazeologjike e leksikalizuar në shqip përkthehet dhe jepet përmes një kuptimi metaforik inovativ që emeton folja *bescheiden,* e kombinuar me *kein langes Leben* dhe *Deutung der Vorgänge.* Semat kuptimore: *me qenë pjesë e një ndodhie, realiteti* implikojnë dhe ngërthejnë elementin kuptimor *në mënyrë të pavullnetshme, pa dëshirë apo synim të tillë.* Dija jonë enciklopedike mbi pamundësinë për një jetë të gjatë të një hamendjeje (hamendja kthehet në provë ose rrëzohet), por edhe e faktit që një njeri i vetëm nuk mund të kundërshtonte a t'i bënte karshillëk përmes një fejese një ngjarjeje të ndërmarrë nga një shtet i fuqishëm, siç ishte Gjermania asokohe, e rrit pritshmërinë tonë si lexues, që, pikërisht, kthesa, hedhja poshtë e hamendjes të ndodhë shpejt dhe në mënyrë të vetëkuptueshme.

4.4.1.2.2 Metafora, shkalla e figurshmërisë së të cilave është më e ulët në gjuhën pritëse

a. ...Pije kafen me tjetrin mirë e bukur, kur ai, befas, mbyllte sytë përgjysmë e të prishte gjakun me fjalët: dëgjo gjer tani isha Çelo Nallbani, po dije që sot e tutje jam "Ujku" ose "Poli i Veriut"[672]
Varianti i Röhm-it
Es konnte passieren, daß man gemütlich mit einem alten Bekannten Kaffee trank und dieser einen, die Augen leicht zusammengekniffen, plötzlich mit der Mitteilung überfiel: „Hör zu, ab heute bin ich nicht mehr Çelo Nallbani, sondern „Der Wolf“ oder „Nordpol“[673]
Përkthimi i variantit të Röhmit
Mund të ndodhte, që pije kafe rehatshëm me një të njohur të vjetër dhe pikërisht ky, me sytë të mbyllur lehtë, papritur të të sulmonte me njoftimin (të të njoftonte krejt papritur): "Dëgjo, që nga sot unë nuk do të jem më Çelo Nallbani, por "Ujku" ose "Poli i Veriut".

Shprehja frazeologjike e shënuar si njësi në fjalorin e shprehjeve frazeologjike të Jani Thomait *të prishte gjakun* është përdorur në një situatë fiktive gjatë ngritjes së hipotezës mbi shkakun e mundshëm të lirimit të pengjeve. Ndodhemi në një situatë të imagjinuar, ku nuk ndajmë dot realen nga imagjinarja, nuk dimë as ç`ndodh brenda

[670] Ekzistojnë modele të ndryshme të semantikës kognitive për përcaktimin e njësive universale konceptuale përbërëse të kuptimit, të quajtur edhe primitivë të kuptimit. Një nga këto është edhe modeli i paraqitur nga Pinker-i. Ai propozon gjashtë primitivë konceptualë. Shih, Pinker, Pinker, Steven, *The Language Instinct: Hoë the Mind Creates Language*. Neë York: HarperCollin, 2007, f. 75.
[671] Shih, Thomai, J., Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe, f. 387.
[672] Darka e gabuar, f. 60.
[673] Ein folgenschwerer Abend, f. 48.

shtëpisë së Gurametos së madh, por as jashtë, në qytet. E tërë situata e dhënie-marrjeve të ndërsjellta midis këtyre ndodhive, përshkruhet dhe imagjinohet duke “ndërmendur” histori nga më të ndryshme mbi lirimin e pengjeve dhe “pengëtimet”. Historia e pëngëtimeve dhe përpjekja për të hamendësuar emrat e personave që kishin shtënë mbi patrullën gjermane lidhet me pamundësinë për t`i evidentuar ato. Asokohë ishte e modës në qytet mbajtja dhe ndërrimi i nofkave. Kadare e përshkruan këtë situatë shumë mjeshtërisht, duke përdorur herë figura letrare të leksikalizuara, herë kreative, por edhe duke ndërthurur thënie nga mençuria dhe urtësia popullore, - të tilla janë: *kur s’ke pulën ha sorrën,* - me pak detaje historike dhe kujtime mbi kohën e përbashkët të Gurmetos me kolonelin Schwabe dhe shprehje apo formula nga tekste të tjera, si: *mos u gëzo o i gëzuar, shi atëherë kur u kërthndez, shpresa u pre si thikë.*
Në fillim të kreut të pestë ai na sinjalizon për çka do të përshkruajë në të gjithë kreun me një fjali: *Nga kjo përkitje (dhënia e marrja e ndodhive) të dyja ndryshonin prore, gufmoheshin, treteshin e shtrajtoheshin, shkurt, i shfaqeshin njëra-tjetrës ashtu siç nuk ishin*. Metaforat, *gufmoheshin, treteshin e shtrajtoheshin* shprehin në mënyrë figurative atë që vijon e përshkruar më pas, përkatësisht momentin në situatën imagjinare, kur koloneli Schwabe i përmallur nga shoqëria e vjetër me Gurameton, me gotë shampanje të shkumëzuar pranon lirimin e pengjeve pa kushte; momentin, kur ai e fajëson mikun shqiptar për besëngrënie; momentin e diskutimit dhe të formësimit të gabuar të bisedës për shkak të Jakoelit hebre.
Në situatën e hamendësimit të emrave të përmendur për lirimin e pengjeve, fjalia në *a* me strukturën e një periudhe me dy fjali të bashkërenditura, në njërën prej të cilave lidhet një fjali e nërenditur kohore, me një ligjëratë të drejtë të lidhur me pjesën e dytë kryesore të fjalisë vjen në gjermanisht me strukturën e mëposhtme: një fjali kryesore pavetore (*es konnte passieren*) shoqërohet me dy fjali kundrinore homogjene të pranëvëna me lidhëzën *und* (dhe), në njërën prej të cilave lidhet ligjërata e drejtë e përbërë prej tri pjesësh fjalish të bashkërenditura, njëra prej të cilave është eliptike nga ana sintaksore, asaj i mungon kallëzuesi. Si në shqip dhe në gjermanisht, ligjërata e drejtë lidhet dhe specifikon më afër shprehjen frazeologjike *të prishte gjakun* dhe *mit der Mitteilung überfallen*, por ndërsa në shqip mund të themi se paraprihet nga një shprehje frazeologjike me kuptimin e një foljeje psikologjike (më turbulloi), në gjermanisht kuptimi i shprehjes frazeologjike jepet me anën e një “verbum dicendi”.[674] Në Fjalorin Frazeologjik të Gjuhës Shqipe shënohet në grupin e shprehjeve frazeologjike me leksemë bazë *gjak*, si kuptim i saj *më turbulloi.*[675] Me anë të saj përshkruhet jo vetëm gjendja psikologjike e bashkëbiseduesit rrëfimtar në momentin e ligjërimit, por edhe pallogaritshmëria dhe shkalla e prekjes nga ky trazim. Komponente kuptimore të leksemës *gjak*, të tilla, si: *një ind lidhor i lëngshëm, i cili me ndihmën e zemrës dhe enëve të qarkullimit të gjakut mirëmban funksionet e organeve të tjera të trupit nëpërmjet transportit të oksigjenit dhe lëndëve ushqyese*, të kombinuara me komponentet e foljes *prish: bëj që diçka të mos punojë më, e dëmtoj sa të mos hyjë në punë; e nxjerr jashtë përdorimit, e bëj të papërdorshme,*[676] emetojnë mënyrën, masën dhe shkallën e mosfunksionimit të ekuilibrit të brendshëm të trupit. Kjo gjendje vjen si pasojë e plasjes së një thënieje që nuk e pret rrëfimtari.

[674] Verbum dicendi është një emërtim i një grupi foljesh që quhen folje të komunikimit, në të cilin hynë folje të tilla, si, them, deklaroj, parashtroj. Paraprise të ligjëratave të drejta nuk janë vetëm ky grup foljesh, por edhe „verba cognitanti“ dhe foljet psikologjike.
[675] Thomai, J., Fjalor frazeologjik i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1999, f. 381.
[676] Fjalor i gjuhës së Sotme Shqipe, online.

Në gjermanisht jepet gjendja e të qenit i papërgatitur drejtpërdrejt me anën e ndajfoljes *papritur*. Folja überfallen (sulmoj, bombardoj), e kombinuar me emrin Mitteilung (lajm, mesazh) emeton pallogaritshmërinë e rrëfimtarit me këtë thënie. Ky njoftim në formë sulmi mund të shkaktojë ndjenjë trazimi, por ndryshe nga varianti në shqip, nuk jepet në mënyrë eksplicite. Ky informacion në gjuhën gjermane vjen si rezultat i inferencës së lexuesit; dihet që ndërrimi i emrave të njerëzve, të destinuar për t´u mbajtur gjatë gjithë jetës, do të shkaktojë trazim, konfuzion. Edhe shkalla e këtij trazimi është një element me të cilin lexuesi duhet ta plotësojë vetë kuptimin e kësaj shprehjeje.
Në rrafshin pragmatik ndryshon edhe shkalla e figurshmërisë së shprehjeve në shqip dhe gjermanisht. Efektet e emetuara në të dyja gjuhët janë të ndryshme.

b. Ose thjesht të shqiptonte formulën e vjetër për *druvezën e turpnueme*. Pas së cilës, siç e kërkonte Kodi, të dilte në dritare, për me lajmërue gjindjen se miku gjerman i kishte turpnue druvezën.[677]
Përkthimi i Röhm-it
Oder daß er sich einfach der berühmten Formel vom „*geschändeten Tisch*“ bedienen und dann nach dem alten Brauch ans Fenster treten würde, um vor allen Leuten zu verkünden, der deutsche habe das Gastrecht mißbraucht.[678]
Përkthimi i variantit të Röhm-it
Ose që ai thjesht të përdorte formulën e njohur të *tavolinës së përdhosur* dhe pastaj sipas zakonit të vjetër do të dilte në dritare, për të njoftuar para të gjithë njerëzve, miku gjerman *paska shpërdoruar (keqpërdorur) mikpritjen.*

Do të ndalemi në këtë shembull, në të cilin metaforat *druvezën e turpnueme* dhe *kishte turpnue druvezën* janë shumë të shenjuara si nga ana formale, por edhe semantikisht dhe stilistikisht. Ato lidhen me një dukuri shumë specifike shqiptare, siç është Kanuni i Lekë Dukagjinit, një përmbledhje e ligjeve, rregullave, zakoneve shqiptare të Shqipërisë së Veriut në një libër, në rrjedhën e disa qindvjeçarëve, para dhe pas jetës së Lekë Dukagjinit.

Në Kanunin e Lekë Dukagjinit është kodifikuar e drejta dokesore shqiptare. Ligjet e "Kanunit" kanë shërbyer për më shumë se pesëqind vjet si mënyra e themeltë e sjelljes shoqërore dhe vetëqeverisjes për fiset e Shqipërisë së Veriut e të Kosovës.

Konteksti i ligjërimit në roman përkon me fillimin e darkës, me takimin e parë midis dy ish-miqve studentë, të cilët gjatë takimeve në “Tavernë” kanë diskutuar mbi traditat e popujve prej nga vinin, por edhe i kanë treguar njëri-tjetrit të fshehta të mëdha që nuk ia dinin të tjerët. Duket se këtij “koloneli me maskë” Kanuni i Lekë Dukagjinit mbi mikpritjen i ka lënë mbresa të mëdha, ndaj edhe e ndeshim shpesh të përmendur nga ai gjatë darkës. Në Kanun dy nga katër shtyllat janë mikpritja dhe nderi, të cilat shërbejnë edhe në kohën e rrëfimit si pikë reference për të gjykuar dhe përligjur veprimet e të dyja palëve në darkë.
Mund të themi, pra, se ai është tipik për mendësinë e shqiptarëve dhe si i tillë edhe të gjitha leksemat dhe shprehjet metaforike që i përkasin këtij lloj teksti kanë ngjyrime të dukshme formale, semantike dhe stilistikore, që lidhen me tërë rrethanat historike dhe kulturore vendase. Për pasojë, edhe përkthimi i tyre në gjuhë të huaj paraqet vështirësi.[679]
Le të merremi më konkretisht me analizën e tyre:

[677] Darka e gabuar, f. 50.
[678] Ein folgenschwerer Abend, f. 40.
[679] Kanunin dhe ligjin e gjakmarrjes e kemi shtjelluar më gjerë në kapitullin mbi lakunat dhe evidentimin e tyre në veprën „Prilli i thyer“ të Kadaresë.

Shprehja *druvezë e turpnueme* është një variant i gjetur nga shkrimtari në Kanunin e Lekë Dukagjinit për *me koritë trevezen*.
Formalisht metaforat *druvezën e turpnueme* dhe *kishte turpnue druvezën* formohen nga lidhja e leksemës *druvezë* në funksionin e përcaktorit dhe të kundrinorit të drejtë me format e ndryshme morfologjike të foljes *me turpnue*, e cila njëherë shfaqet në funksion atributiv të përcaktorit me formën e saj të pjesores dhe herën tjetër në funksionin e kallëzuesit në kohën më se të kryer. Të dyja leksemat janë të dialektit geg. Në këtë formë dialektale janë shkruar edhe fjalë të tjera në këtë shembul, *me lajmërue, gjindjen*.
Analiza fjalëformuese e leksemës *druvezë* është tepër interesante: një rrënjë e burimit serb që emërton drurin, e formuar nga bashkimi i bashkëtingëlloreve *d, r, v,* (дрва)bashkohet me një morfemë fjalëformuese shqiptare *-ezë*. Shtimi i zanores *u* midis tri bashkëtingëlloreve bëhet për lehtësim shqiptimi dhe në analogji me shumë raste të tjera të ngjashme. Prapashtesa *-ezë* modifikon kuptimin e fjalës *dru* sipas kuptimit të kësaj prapashtese. Emrat e formuar me këtë prapashtesë tregojnë mënyrë a mjet që formohen sipas rrënjës që lidhet me prapashtesën, psh., *trapezë* është tavolinë që formohet sipas kuptimit të *trapez* si formë gjeometrike, apo *dorezë* nga *dorë*.[680]
Nga mënyra e fjalëformimit, kuptimi leksikor i fjalës *druvezë* formohet mbi bazën e konceptit të leksemës *dru*, që përbëhet prej primitivëve kuptimorë të lëndës *dru*, mjetit dhe qëllimit që përdoret, dmth., tavolinës që shërben për të ngrënë. Në kontekstin e ligjërimit, kur më parë koloneli ka përmendur fjalët Lekë Dukagjin, si edhe të darkës së shtruar për nder të tij, kësaj lekseme u vishen edhe elemente konceptuale të nderimit të mikut nga mikpritësi, si edhe të respektimit të tavolinës dhe të rregullave të jetës. Dija jonë mbi Kanunin, në kreun e nëntëmbëdhjetë të të cilit me titullin „Nderan shoqnore“, në artikullin nëntëdhjetë e gjashtë mbi „Mikun“, thuhet „Shpija e Shqyptarit âsht e Zotit e e mikut“, dhe në artikullin e nëntëdhjetë të këtij kreu mbi „Të sjellnut e të zot't të shpis me miq në shpi“ përcakton që „Miku xên kryet e vendit në trevezë (sofer), mandej i hîn ndorja“ i lidh këto elemente konceptuale edhe me mikpritjen shqiptare, duke i shtuar atyre elementin konceptual se mikpritja është për t`u trajtuar si sjellje shoqërore dhe jo vetëm familjare. Kjo do të thotë që është e kuptueshme që edhe thyerja e rregullave nga miku të jetë e përcaktuar po ashtu si mikpritja me kode dhe ligje me vlerë shoqërore. Turpi i mosrespektimit të rregullave si mik i familjes është edhe turp (koritje) për mbarë shoqërinë. Këtë kuptim e emeton edhe metafora në shqip, me tërë veçoritë morfologjike, semantikore, stilistikore në tekstin *b*.
Në gjermanisht të dyja format *druvezë e turpnueme* të romanit në shqip na jepen me dy shprehje të ndryshme: *geschändeten Tisch* dhe *habe das Gastrecht mißbraucht*. Shohim se leksema me kuptim të figurshëm *druvezë* njëherë përkthehet me *Tisch* (tavolinë) në kuptimin e vendit ku bëhet mikpritja, kuptim figurativ i cili jepet edhe në fjalorin e gjuhës së sotme gjermane, Duden Online, dhe njëherë në kuptimin e së drejtës dhe ligjeve që konstituojnë mikpritjen, *Gastrecht* (mikpritja). Edhe këtë kuptim e gjejmë po ashtu në fjalorin e gjuhës gjermane. Konstatojmë, pra, që kuptimi i metaforave përcaktohet nga konteksti dhe nuk është shumë e kuptimeve figurative të leksemave prej të cilave përbëhet shprehja metaforike, apo i njëjtë në të gjitha rastet, pavarësisht kontekstit.[681]

[680] Gramatika e Gjuhës Shqipe I, Tiranë 2002, botim i Akademisë së Shkencave, fq. 65, si edhe Xhuvani, A., - Çabej, E., Prapashtesat e gjuhës shqipe, Tiranë, 1962 dhe në A. Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980.
[681] Për këtë çështje kemi folur në kapitullin mbi metaforat, kur i kemi përcaktuar se kuptimi i metaforave ndodhet pikërisht në pikëprerjen e semantikës me pragmatikën.

Analiza morfologjike, semantikore e leksemave në gjermanisht *Tisch dhe Gastrecht* nuk emeton vlera të njëjta me variantin e shqipes. Përpos faktit që të dyja leksemat janë pjesë e fjalorit të sotëm gjerman dhe nuk janë të shenjuara, dmth., pa konotacione ato gjenden në fjalësin e gjuhës standarte gjermane. Njëlloj mund të analizonim edhe leksemat *geschändeten* dhe *habe mißbraucht.* Forma pjesore e foljes *schänden* në funksionin e përcaktorit dhe folja *mißbrauchen* në kohën e kryer të mënyrës lidhore nuk janë të shenjuara në asnjë prej rrafsheve që i kemi analizuar format e shqipes. Çështja që duhet të sqarojmë është përdorimi i mënyrës lidhore *habe mißbraucht* në vend të formës së foljes në shqip në kohën më se të kryer të mënyrës dëftore. Në gjermanisht përdoret format e foljes në lidhore për të dhënë një formë të ligjëratës së drejtë, në rastet kur dëshirojmë të distancohemi si rrëfyes nga ajo çka po japim në formën e ligjëratës së zhdrejtë dhe ta shenjojmë shprehjen e dhënë si pjesë të marrë nga një tekst apo ligjërim tjetër.[682] Në variantin e Kadaresë nuk e gjejmë këtë distancim në thënien në formën e ligjëratës së zhdrejtë, ai e lidh pjesën e fjalisë paraprijëse – fjali e nënrenditur qëllimore - në të cilën kemi një folje të komunikimit (dicendi) me pjesën në të cilën jepet formula e cituar me lidhëzën ftilluese *se*.

c. ...E gjendur për herë të parë midis një dendësie mashkullimi të rrezikshëm, të gjithë kalorës e, njëkohësisht, të fejuar të vdekjes, ka rënë në dashuri mekshëm e me ngut me ta, si njeriu që do ta mbushë zbrazëtinë e ardhshme, të paskaj...[683]
Varianti i Röhm-it
...Sie, die zum ersten Mal auf engem Raum mit einer Horde gefährlicher Männer zusammen ist, alle von sehr ritterlichem Benehmen und mit dem Tod verlobt, hat sich vage, flüchtig in sie verschaut, als gelte es gleichsam im Vorgriff, eine künftige, endlos erscheinende Leere zu füllen...[684]
Përkthimi i variantit të Röhm-it
Ajo, për herë të parë në një hapësirë të ngushtë me një hordhi burrash të rrezikshëm, të gjithë me sjellje kalorsiake dhe të fejuar me vdekjen, është dashuruar vetëtimthi me ta, si të ishte në pritje, për të mbushur një zbrazëti të ardhshme, në dukje e pafund.

Në shembullin *c* evidentojmë në variantin në shqip të romanit një mori metaforash, si, *dendësi mashkullimi të rrezikshëm, të gjithë kalorës, të fejuar të vdekjes*, dhe një krahasim *ka rënë në dashuri mekshëm e me ngut* me ekspresivitet të lartë në gjuhën shqipe. Gjegjëset e tyre në gjermanisht për të cilat konstatojmë që nuk janë të gjitha metafora, janë përkatësisht: *auf engem Raum mit einer Horde gefährlicher Männer, alle von sehr ritterlichem Benehmen, hat sich vage, flüchtig in sie verschaut.*
Le t`i analizojmë më nga afër këto metafora në rrafshin gramatikor, semantikor dhe atë pragmatik. Metafora kreative *dendësi mashkullimi të rrezikshëm* është një gjetje shumë ideale e Kadaresë. Edhe pse fjala *mashkullim* është e formuar sipas një gjedheje të njohur në morfologji – formim me temë foljen *mashkullon* dhe prapashtesën -im – kjo fjalë nuk gjendet e shënuar si leksemë e Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe 1980, 2004, por as e Fjalorit Online të Gjuhës Shqipe. Emrat e formuar me prapashtesën -im janë cilësuar si emra abstraktë me kuptimin e veprimit, por edhe të rezultatit.[685] Kuptimi i leksemës *mashkullon* që shërben si temë fjalëformuese për fjalën që analizojmë, jepet: *pjell meshkuj(për bagëtitë).* Sipas këtyre kuptimeve të prapashtesës kuptimi i mundshëm i fjalës mashkullim do të ishte: një emër abstrakt me kuptimin e veprimit ose një shenjim i rezultatit. Pyetjes së lindur prej këndej se cili prej këtyre kuptimeve të mundshme emeton kjo fjalë, mund t´i përgjigjemi nëse

[682] Shih, Duden Grammatik, Band 4. Mannheim, 2005, f. 1127.
[683] Darka e gabuar, f. 67.
[684] Ein folgenschwerer Abend, f. 55.
[685] Shih, Thomai, J., *Leksikologji e gjuh*ës *shqipe*, Tiranw, 2005, f. 150.

shqyrtojmë kontekstin dhe lidhjet e saj me fjalë të tjera në shembullin *c*. Lidhja me leksemën *dendësi*, të cilën ajo e përcakton më nga afër në funksionin e përcaktorit, si edhe me mbiemrin *i rrezikshëm* në funksionin e përcaktorit për emrin mashkullim, e përjashton mundësinë e shenjimit të rezultatit, dhe lejon deshifrimin e kuptimit si emër abstrakt i veprimit, sipas foljes fjalëformuese. Shqyrtimi i tërë kontekstit në të cilin formulohet kjo metaforë, një vajzë e re midis një turme ushtarësh të lodhur e të drobitur nga lufta, të ardhur nga lufta me Greqinë, të cilëve u mungojnë, ndoshta prej kohësh të gjitha kënaqësitë, hap edhe mundësi të tjera për dekodimin e kuptimit të kësaj fjale: përmes saj, shkrimtari rreh të emetojë edhe mundësinë potenciale të shfrenuar të mashkullimit të ushtarëve. Ai e përdor sigurisht këtë për të përshkruar gjendjen fizike, psikike dhe emocionale të ushtarëve. Përpos kësaj, shkrimtari jep edhe një vlerësim negativ të tyre (në fjalor leksema *mashkullon* shenjohet si fjalë që përdoret për bagëtitë). Në këtë kotekst, edhe fjala dendësi e gjendur në fjalor me kuptimin e shpeshtësisë përçon dhe thekson masën potenciale të rrezikshmërisë të mashkullimit.
Edhe metaforat *kalorës* dhe *të fejuar të vdekjes* përdoren për të përshkruar ushtarët. Leksema *kalorës* në kuptimin figurativ të shenjuar në fjalor, *njeri fisnik që lufton me vetëmohim e me trimëri për një çështje të madhe*, emeton vlera pozitive. Por në situatën ligjërimore, kur flitet për ushtarë, të cilët u kishin thyer brinjët Greqisë dhe Serbisë[686], konotacionet pozitive që transmeton kjo fjalë zbehen. Ato nuk mund të përkufizohen si njerëz fisnikë, por si kavie, specie, të cilët nuk venë në punë arsyen, por instinktin. Arsyeja, karakteristika thelbësore dalluese e qenieve shtazore nga njeriu nuk është veçori që mund t'u shkruhet ushtarëve që kanë hyrë në këtë luftë qorrazi, si një kope që ndjek urdhërat e bariut.
Metafora *të fejuar të vdekjes* është interesante se formohet duke bashkuar dy koncepte komplementare me njëra-tjetrën: jetën dhe vdekjen. Fejesa është lidhje midis dy palëve. Elementet konceptuale të ndërtimit të kuptimit të saj janë: lidhje, jetë, lumturi. Lidhja e saj me leksemën *vdekje* e bën edhe më të qartë atë çka shpjeguam më lart, ushtatarët në kotekstin e lëgjirimit jetojnë lumturinë e momentit, sipas motos: *carpe diem*. Ata jetojnë duke shijuar të tashmen, e nesërmja për to mund të mos ekzistojë. Ata, në momentin e të pranuarit të rolit të ushtarit, janë njëkohësisht të lidhur me vdekjen.

Në variantin në gjermanisht të Röhmit metafora *dendësi mashkullimi të rrezikshëm* është përkthyer me togun *hordhi burrash të rrezikshëm,* i cili nuk përkon nga ana formale me metaforën e Kadaresë, por ka devijime të dukshme në rrafshin semantikor dhe pragmatik me metaforën në shqip. Në rrafshin semantikor dallojnë *dendësi* me *hordhi* që është e shenjuar si fjalë me konotacion negativ, zhvlerësuese. Elementi kuptimor *ngushticë* që nënkupton leksema *dendësi* është shprehur në gjermanisht në mënyrë eksplicite me anë të togfjalëshit *auf engem Raum* (në një hapësirë të ngushtë) Nga ana tjetër leksemat *mashkullim* dhe *burrë* kanë marrëdhënie kuptimore ngjashmërie, por nuk janë të njëjta në kuptim. Leksema *burrë* është hiperonimi i leksemës *mashkullim,* prandaj edhe vëllimi kuptimor i saj është më i gjerë.
Edhe diferencat midis emërtimit të ushtarëve *kalorës* në shqip dhe sjelljes së tyre kalorsiake ndërtohen mbi bazën e ndryshimeve dhe marrëdhënieve kuptimore të vendosura midis tyre: në shqip, vëllimi kuptimor është më i madh se në gjermanisht. Leksema *kalorës* aktivizon dhe emeton një sfond më të gjerë të dijeve që kanë të bëjnë me këtë shtresë të shoqërisë mesjetare, që ka lufuar me guxim dhe trimëri, por

[686] Darka e gabuar, f. 20.

edhe me stilin e veshjes së tyre. Nga ana tjetër, në roman kjo leksemë nuk mundëson bashkëngjitjen e elementeve kuptimore apo vlerave pozitive për këta ushtarë. Kjo sjellje është e kaluar në kohë dhe nuk mund të kontribuojë në vlerësimin pozitiv të ushtarëve. Ata janë vetëm një hordhi individësh të cilët rastësisht gjenden në një darkë, apo siç e përcakton edhe Kadare *në një lemeri në trajtë darke*. Në gjermanisht ngushtohet kuptimi i *kalorës*, vetëm në *sjellje kalorsiake*. Sjellja kalorsiake mund të thuhet se është në kohën e Luftës së Dytë Botërore e kaluar në kohë.

d. Gjithë ajo bardhësi shtrojash, dantellash e perdesh, që here pas here, në vend të mahniste, të ngjethte mishtë, kujtime inçestesh e nusesh, që e kishin humbur nderin, e pleqsh që jepnin shpirt nën një antidiell, në hajatet e mëdha, nuk shlyheshin lehtë nga kujtesa.[687]
Varianti i Röhm-it
Das blendende Weiß der Betten, Spitzendecken und Vorhänge, das einen mehr erschreckte als betörte, die Erinnerung an Inzestvergehen und unehrenhafte Bräute, an Greise, die unter der Antisonne geräumiger Windfänge ihren Geist aushauchten, diese ganzen Dinge ließen sich nicht so leicht aus dem Gedächtnis löschen.[688]
Përkthimi i varinatit të Röhm-it
E bardha verbuese e shtrojave, e dantellave dhe e perdeve, e cila çdonjërin më shumë e trembte se sa e argëtonte, kujtimi i proceseve të incesteve dhe nuseve të pandershme, pleqve që jepnin shpirt nën antidiellin e hajateve të mëdha, të gjitha këto gjëra nuk mund të fshiheshin lehtë nga kujtesa.

Ky shembull është përzgjedhur nga grupi i shembujve të metaforave me figurshmëri më të vogël në gjuhën pritëse, për të krahasuar përkthimin e metaforës së leksikalizuar nga shqipja në gjermanisht. Bëhet fjalë për metaforën *të ngjethte mishtë*, e përdorur gjatë përshkrimit të mëkateve të brendshme, përpos atyre të dukshmeve, të jashtmeve. Këto mëkate ndodhin brenda shtëpive gjirokastrite. Përfytyrimi i këtyre lloj shtëpive duket se nuk është i huaj edhe për përkthyesin. Ai arrin të transmetojë në gjuhën pritëse elemente zbukurimi, arkitekturore, karakteristike të shtëpive të atëhershme shqiptare, si: dantellë, hajat i madh. Jo kaq i arrirë është përkthimi i togut *bardhësi shtrojash*, i cili ka si gjegjës në gjermanisht togun *e bardha rrezatuese* e shtretërve. Në përqasjen e variantit shqip me atë në gjermanisht konstatojmë se *bardhësi* përkthehet me *e bardha rrezatuese*. Në shqip, intesiteti i së bardhës jepet përmes prapashtesës *-si*. Si në variantin në shqip, ashtu edhe në gjermanisht ka shërbyer si rrënjë *e bardhë*. Ndërsa në shqip janë të pranishme për ngjyrat dy mënyra fjalëformimi të emrave që kanë si rrënjë ngjyrën përkatëse, në gjermanisht kjo është e pamundur. Emrat përkatës të ngjyrave formohen përmes fjalëformimit me konversion, dmth., formimit të emrit nga mbiemri, duke vendosur vetëm nyjen shquese *das (das Weiße)*. Edhe në shqip është i mundur fjalëformimi i emrit *e bardhë* nga mbiemri *i/e bardhë*. Por shkrimtari ka parapëlqyer të përdorë *bardhësi*, për të dhënë intesitetin, masën e së bardhës. Në shtëpitë shqiptare të atëhershme mbizotëronte ngjyra e bardhë. Edhe zbukurimet, elementet arredues edhe shtresat, shtrojat ishin të bardha. Përdorimi i saj krijon një kontrast të dukshëm me fjalën mëkat. E bardha është edhe mishërim i së pafajshmes, i së pastrës, i së paprekurës nga mëkatet. I gjithë ky sfond që hap përdorimi i saj krijon një antitezë me mëkatet që përshkruhen më pas: sa mahnitëse është bardhësia e shtëpive nga jashtë, po aq dridhëruese janë mëkatet që ndodhin brenda tyre. Për të dhënë këtë dridhërimë, autori përdor shprehjen me kuptim metaforik *të ngjethte mishtë*, e cila në fjalorin frazeologjik të Jani Thomait shënohet nën lemën *mish* me formën përfaqësuese *m'u ngjeth (m'u drodh) mishi (mishtë)* me kuptimin *u tmerrova, u mallëngjeva*. Në kontekstin tonë, kuptimi i emetuar *u*

[687] Darka e gabuar, f. 64.
[688] Ein folgenschwerer Abend, f. 52.

tmerrova e përgatit lexuesin për morinë e mëkateve brenda shtëpive: inçeste, nuse me nder të humbur, pleq të cilët për të larë pikërisht mëkatet e tyre vdisnin jo si të gjithë njerëzit, por në një *antidiell*.

Edhe togu tjetër në këtë shembull *nuk shlyheshin lehtë nga kujtesa* i ndërtuar mbi bazën e kuptimit metaforik të leksikalizuar të leksemës *shlyej* e përforcon edhe më shumë masën e mëkateve të përshkruara brenda shtëpive. Ato nuk mund të fshihen aq lehtë nga kujtesa. Ashtu si fshirja me gomë e diçkaje të shkruar lë gjurmë, po ashtu lë të gërvishurat e tij edhe mëkatimi brenda shtëpive. Në shpjegimin e fjalës *shlyej* me kuptim figurativ jepen dhe ngërthehen komponente konceptuale të heqjes së masës ndëshkimore ndaj dikujt. Pikërisht edhe në kotekstin para shembullit, por edhe pas tij gjejmë mundësi të lidhjes së masës ndëshkimore që ngërthen kuptimi i fjalës *shlyej* me ndëshkimet dhe pushkatimet që bëheshin në qytet si rezultat i veprimit të ndërmarrë nga gjirokastritët: të shtënit, - *të ngrënit në besë të patrullës gjermane,* siç thotë koloneli gjerman. Mendojmë që kjo është arsyeja e përdorimit të kësaj fjale nga autori në vend të foljes *harroj*.

Të gjitha këto kuptime të emetuara nga metaforat e analizuara në romanin në shqip vijnë të përkthyera nga Röhmi në gjermansisht me devijime. Le t´i shohim në veçanti:

Siç e përmendëm edhe më lart *bardhësi* ka si gjegjëse në gjermanisht *e bardha verbuese*. Masa e intesitetit të munguar në kuptimin e fjalës *e bardha* kompesohet në përkthimin në gjermanisht përmes përdorimit të fjalës *verbues,* që në funksionin sintaksor të përcaktorit në shembullin që analizojmë shenjon dhe emeton kuptimin e së bardhës që të bën të mos shohësh qartë, që të vret a të vesh sytë, që të verbon, pasi shtrojat dhe dantellat, perdet janë shumë të bardha. Në rrafshin morfologjik, në të dyja gjuhët, përcaktorët e emrit *bardhësi* vendosen në rasa të ndryshme, në shqip në rasën rrjedhore dhe në gjermanisht, për shkak të mungesës së kësaj rase, në rasën gjinore. Edhe në gjuhën shqipe përcaktori mund të shprehet me emër në rasën gjinore, por vetëm në trajtën e shquar. Kjo është edhe arsyeja e përdorimit të rasës rrjedhore në vend të gjinores në shqip. Në gjermanisht, përcaktorët homogjenë *der Betten, Spitzendecken und Vorhänge (e shtrojave, dantellave dhe perdeve)*janë në trajtën e shquar. Përdorimi i shquarsisë në vend të pashquarsisë shenjon edhe diferenca në rrafshin kuptimor apo paqartësi, mospërputhje të shenjimit me kontekstin. Kadareja nuk flet për shtroja të numëruara, të përcaktuara apo të përmendura më parë, andaj edhe nuk mund të përdorë trajtën e shquar. Në gjermanisht nuk është e mundur shprehja e përcaktorit me emër në trajtën e pashquar në rasën gjinore pa parafjalë. Kjo mundësi është e rezervuar për emra në rasën dhanore me parafjalën *von.* Për mendimin tone, përdorimi i kësaj forme, dmth., përcaktor në rasën dhanore me parafjalë do të kishte qenë më korrekt dhe më ekuivalent në rrafshin semantikor sesa i gjinores.

Bardhësia e cila në variantin e Kadaresë *të ngjeth mishtë,* në përkthim e humb figuracionin e saj. Ajo, në fakt, çmetaforizohet duke e emërtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë procesin dhe gjendjen që përjeton çdonjeri që jeton në këto shtëpi apo ndeshet me këtë të bardhë. Folja *ershrecken* (tremb) nuk emeton si gjegjësja në shqip *të ngjethte mishtë* po atë masë të drithërimës dhe nuk është e shenjuar në asnjë rrafsh gjuhësor, siç shpjeguam për togun frazeologjik në shqip. Në fjalorin Duden Online[689] kuptimi i foljes *erschrecken* jepet si më poshtë:

- in Schrecken versetzen (e bëj të ketë frikë)

[689] Duden online, lema erschrecken (schwaches Verb)

Komponenti konceptual i ndryshimit të gjendjes së qetësisë në frikë transmetohet dhe përçohet nga folja e përzgjedhur në gjermanisht *erschrecken.* Mund të themi se ky qëllim i shprehjes frazeologjike të shqipes *të ngjeth mishtë* është lexuar dhe kuptuar nga përkthyesi Röhm. Në gjermanisht, e njëjta formë infinite e foljes *erschrecken* mund të shprehë dy aspekte të ndryshme të foljes *tremb*: i pari, gjendje, dmth., gjendjen e prejkohshme të të pasurit të ndjenjës së frikës dhe i dyti, ndyshim gjendjeje, dmth., kalimin nga gjendja e jofrikës në atë të frikës. Ndërsa ndryshimi i gjendjes emetohet vetëm nga përdorimi i foljes, komponenti konceptual që lidhet me masën e ndryshimit të gjendjes nuk emetohet dhe humb në përkthimin në gjermanisht.

Shprehja tjetër frazeologjike *shlyej nga kujtesa* përkthehet në gjermanisht me *sich aus dem Gedächtnis löschen lassen* (mund të fshihen nga kujtesa). Edhe pse shprehja *fshij nga kujtesa* e përdorur në gjermanisht është variant i *shlyej nga kujtesa,* mund të themi se kemi diferenca në rrafshin morfologjik mids varianteve shqip dhe gjermanisht. Le t`i analizojmë format morfologjike të të dyja varianteve:
Në shqip, folja e kësaj shprehjeje është në diatezën pësore, dmth., asgjë nuk mund të kryejë rolin e kryefjalës, të ketë funksionin e saj, për të mundësuar harresën e gjithë asaj skene mëkatesh të skicuara në fjalinë paraprirëse. Në gjermanisht folja përdoret në formën *sich lassen + foljen löschen* (fshij) në formën e infinitivit. Përdorimi i kësaj forme të foljes është një mundësi shprehjeje e diatezës pësore me foljen modale (mund) në gjermanisht. Ajo njihet në literaturën gjuhësore gjermane si „Passiversatzform (formë zëvendësuese e pasivit)“[690]. Pra, ajo mund të zëvendësojë formën pasive *mund të fshihen*. Në kapitullin mbi kuptimin dhe përdorimin e foljeve modale thuhet se „duke përdorur një fjalë me folje modale, folësi nuk shprehet drejtpërdrejt mbi vërtetësinë e ndodhisë, por e paraqet atë si të domosdoshme apo relativisht të mundshme në krahasim me sfondin e ligjërimit, norma të caktuara, dëshira, rrethane faktesh, etj.[691] Më tej veçohen dallimet kuptimore midis foljeve modale, duke përmendur disa dimensione dalluese ndihmëse:

- shkallën e modalitetit, dmth., domosdoshmërinë/ detyrimin (müssen, sollen, ëollen) përkundrejt mundësisë/lejimit (können, dürfen, mögen);
- modalitetin e sfondit të ligjërimit, i cili mund të jetë epistemik (dmth. t`i referohet dijes së folësit) ose jo epistemik (dmth, t`i referohet normave, dëshirave, qëllimeve apo fakteve);
- origjinën apo burimin e sfondit të ligjërimit, e cila te foljet modale sollen (duhet) dhe dürfen (lejohet) gjendet jashtë subjektit (ekstrasubjektiv) dhe te folja wollen (dua) duhet kërkuar gjithmonë brenda vepruesve (intrasubjektiv).[692]

Kuptimi që transmeton në përkthimin e Röhmit forma e foljes *sich lassen + infinitivin e foljes me kuptim leksikor,* e cila është e barasvlefshme me formën passive të foljes modale *mund* + pjesoren e foljes me kuptim leksikor, është ai që lidhet me përdorimin si intrasubjektiv po ashtu edhe ekstrasubjektiv të saj, dmth., burimi i harresës, fshirjes së mëkateve nuk është as mundësi e përjetuesve të mëkateve që ndoshin brenda hajateve të mëdha, por as mund të kërkohet dhe të pretendohet të bëhet nga faktorë të tjerë konkretë të jashtëm. Pra, në formën e foljes së përdorur në gjermanisht gjenden të leksikalizuar në semantikën e formës së foljes faktorë të jashtëm apo të brendshëm që ndikojnë në harresë, ndërsa në shqip përdorimi i formës së foljes që analizojmë hap vende bosh që duhen plotësuar vetë nga lexuesi mbi bazën e dijes së tij, të koteksit dhe më gjerë kontekstit.

[690] Shih, Duden. Die Grammatik, Band 4, Mannheim, 2005, f. 556.
[691] Po aty, f. 563.
[692] Po aty, f. 564.

4.4.1.2.3 Zhvendosja e figurshmërisë

a. ..Që Italia, ndërkaq, po pësonte mbi shpinë atë pezëm, *këtë e dinte dhe bufi*, por askush s'mund ta parashikonte ç'do të bëhej me dy pjesët e tjera: Abisininë dhe Shqipërinë. Disave u dukej e natyrshme që *mllefi*, si zakonisht, *ishte më i lehtë të binte mbi zezakët e Abisinisë*, në kohën që kishte të tjerë, që mendonin se me zezakët e gjorë *s'nxirrej dot asnjë duf*, sepse ata, si me duf, si pa duf, *punët i kishin pasur gjithmonë keq*.[693]

Röhm-i
Welches Donnerwetter auf Italien niederging, *sah auch der Dümmste*, aber was auf die anderen beiden Teile zukam, Abessinien und Albanien, war schwer abzusehen. Einige meinten, die Neger in Afrika w*ürden am meisten Dresche beziehen*, das sei bloß natürlich, während andere einwandten, bei den armen Schwarzen *könne* man unmöglich *irgendwelchen Ärger abladen*, weil *es ihnen* ohnehin schon mehr als *dreckig gehe*.[694]

Varianti i përkthyer i Röhm-it
Se çfarë stuhie do të binte mbi Italinë, këtë e shihte edhe më budallai, por e vështirë për t'u parë ishte ajo çka do t'i vinte dy pjesëve të tjera, Abisinisë dhe Shqipërisë. Disa mendonin se zezakëve në Afrikë do t`u jepej më shumë dajak, kjo s´ishte gjë tjetër veçse diçka e natyrshme, ndërkohë që të tjerë ngrinin kundërshtimin, që tek zezakët e mjerë mund t´u shkarkohet pamundësisht (është e pamundur të shkarkohet) ndonjë zemërim, se atyre sidoqoftë u ecën më shumë se keq.

Këtë shembull e kemi përzgjedhur nga grupi i metaforave që vijnë të përkthyera në gjermanisht me zhvendosje të figurshmërisë, për të treguar se metaforat, shprehjet frazeologjike me vatër leksikore një emërtim kafshe apo shpendi janë specifike për gjuhë të ndryshme.

Që në fillim të shembullit që analizojmë konstatojmë se bufi konceptualizohet [695] në kulturën shqiptare si shpend me karakteristika dhe veçori negative. Ai, në kuptimin e figurshëm, në figurën e metaforës, simbolizon njeriun e trashë nga trupi dhe nga mendtë, të padituri. Të gjitha shprehjet frazeologjike me vatër leksikore leksemën *buf* emetojnë një kuptim që lidhet me të konceptuarin e bufit si shpend i plogët, përtac, i fjetur, i trashë nga mendja. Këtë konceptualizim e gjejmë në shprehjet frazeologjike si: buf kënete; sy bufi; sheh si buf; rri si buf; e di edhe bufi; leshtë e ujkut, thonjtë e bufit; bufi mburr zogjtë e tij. Një konceptualizim të ngjashëm të bufit ndeshim edhe në kulturën indiane.[696]

Por jo në të gjitha kulturat gjejmë të njëjtin konceptualizim mbi bufin me atë të gjuhës shqipe. Në Greqinë e lashtë, të dëgjuarit e klithmave të bufit ishin shenjë paralajmeruese e një ndodhie të kobshme: vdekje, tragjedi, shkatërrim. Edhe në Testamentin e Vjetër, bufi shihet si figurë e shkatërrimit të menjëhershëm. Ky koncept me komponente të tilla kuptimore që ngërthen leksema *buf* gjendet dhe emetohet edhe në veprën Makbetit, dramën "Julius Cesar", kur të klithurat e bufit shihen si lajmëtare të vdekjes. Edhe Lady Makbeti dëgjon në dramën "Makbet" bufin, ndërkohë që burri i saj vret mbretin legjitim. Ndryshe nga sa më lart, konceptohet bufi në Zvicër, ku shihet, madje, si lajmëtar i ndodhive të mira, i lindjes së një fëmije. Si mishërim i dijes dhe urtësisë, konceptohet figura e bufit e stampuar në emblemen e

[693] *Darka e gabuar*, f. 11.
[694] *Ein folgenschwerer Abend*, f. 8.
[695] Shih, Sadiku, G., *Sprach- und Kulturgebundenheit der Metapher, botuar në, Sprachendiversität und Interkulturalität,* Oberhausen, Athena, 2013, f. 154-162.
[696] *Lexikon der Redensarten. Herkunft und Bedeutung deutscher Redewendungen.* München, 2005, f. 115.

muzeut “Deutsches Museum”, në Gjermani, museu më i madh në botë për shkencat natyrore dhe teknike, si shoqërues i perëndeshës Athena.

Çka përshkruam më lart mbi konceptualizimin e bufit në kulturën gjermane shpjegon edhe devijimin e figurshmërisë në përkthimin e shprehjes frazeologjike me vatër leksikore fjalën metaforë *buf,* me zëvendësimin e saj me variantin *e sheh edhe më budallai stuhinë,* që shpie, padyshim, edhe në humbje të vlerës stilistikore të variantit në gjermanisht, krahasuar me atë në shqip.

Ndryshime në regjistër konstatojmë edhe në shprehjen tjetër frazeologjike të përdorur në këtë shembull të përzgjedhur. Shprehja në shqip *mllefi ishte më e lehtë të binte mbi zezakët* dhe gjegjësja në gjermanisht *die Neger in Afrika würden am meisten Dresche beziehen* rezultojnë të kenë dallime jo vetëm në mjetet gjuhësore përbërëse. Në fjalorin Duden Online fjala *Dresche* është e shenjuar përsa i përket stilit të ligjërimit. Ajo është e ligjërimit të shkujdesur, salop. Ndërsa kuptimi i leksemës *mllef* është neutral. Zhvendosja lidhet jo vetëm me ndryshimet në regjistrat e ligjërimit, por vjen edhe si rezultat i ndryshimeve që kanë midis tyre kuptimet e leksemave *mllef* dhe *Dresche* (dajak). Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, kuptimi i leksemës mllef përcaktohet:

- Zemërim a inat i madh që na është grumbulluar përbrenda e duam ta shfrejmë, duf, mëri
- Hidhërim i thellë.

Dajaku (Dresche) është një nga mënyrat për të shfryrë zemërimin, mllefin, por jo e vetmja. Në kontekstin historik të zhvillimit të ngjarjeve që rrëfehen në roman, kur Italia kishte humbur dhe Gjermania përgatitej të hynte në territoret nën hegjemoninë apo pushtimin italian të deriatëhershëm, është e pritshme, të ketë ndryshime territoresh dhe pushtime nga shteti fitues. Në këtë kontekst, Gjermania pritej të shkelte edhe Shqipërinë dhe Etiopinë, që njihej në politikën e jashtme si Abisinia, për të realizuar ëndrrën e saj, shtetin e madh, “das dritte Reich”. Nisur nga faktet historike – historia e kolonializimit të Etiopisë dhe rezistencës së etiopianëve kundër kolonializimit dhe më pas pushtimit italian – pritej një rezistencë më e madhe e kësaj popullsie, kështu që edhe përgatitja e gjermanëve për t’ u hakmarrë pritej të ishte edhe më e madhe. Pra, *nxjerrja e mllefit* nënkupton hakmarrjen, si edhe *dhënien e dajakut (Dresche beziehen)*. Nën këtë shpjegim shprehjet *nxjerr mllefin* dhe *Dresche beziehen* (jap dajak) janë shprehje sinonimike kontekstuale jo të plota.

Shprehja tjetër *nuk nxirrej dot asnjë duf* na vjen e përkthyer nga Röhmi në gjermanisht *den Ärger abladen.* Nga krahasimi i variantit në shqip të Kadaresë me atë të gjermanishtes konstatojmë devijime në intesitetin e zemërimit që do të shkarkohej te zezakët. Nga krahasimi i semave respektive të fjalëve *duf* dhe *Ärger* (zemërim) mund të themi se në kuptimin e leksemës në shqip luan një rol edhe sasia dhe intesiteti. Është pikërisht kjo semë që mundëson dallimin e kuptimit të fjalëve sinonime në shqip *zemërim* me *duf.*

Dallime të dukshme në shembullin e mësipërm midis versionit të Kadaresë dhe variantit të Röhmit kemi edhe në rrafshin morfologjik, në kategoritë gramatikore të pothuajse të gjitha foljeve. Foljet e shembullit të fjalisë së dytë në shqip vijnë të gjitha të përkthyera nga Röhmi në mënyrën lidhore (*würden …beziehen; sei; könne … abladen; es gehe*). Kjo është, siç e kemi sqaruar edhe në shembuj të tjerë, një mënyrë e gjuhës gjermane, për të sinjalizuar një thënie të huaj në ligjërim. Përdorimi i kësaj mënyre në gjuhën gjermane është i rezervuar për gjuhën e shkruar. Në ligjërimin e folur ndodh rëndom përdorimi i mënyrës dëftore në vend të lidhores. Ndryshe nga gjuha gjermane, në gjuhën shqipe janë foljet paraprirëse, foljet e komunikimit

(mendoj, them) sinjalizuese të ligjëratës së huaj në rrëfim. Ndryshimet në modalitetin e foljeve sjellin edhe mënyra interpretimi të ndryshme në rrafshin kuptimor përsa i përket qëndrimit të rrëfimtarit ndaj ngjarjes së treguar dhe referimit të vlerës së vërtetësisë së thënieve. Mënyra dëftore kumton vlerë vërtetësie të ngjarjes, duke kumtuar edhe qëndrimin e rrëfimtarit; lidhorja një distancim, një mosdeklarim qëndrimi të rrëfimtarit ndaj ndodhisë.

b. Tek ndaheshin me njëri-tjetrin, shkëmbenin fjalët e fundit, një pjesë e të cilave ishin kundër komunistëve, që, ashtu si herë tjetër, kishin bërë provokimin, e pastaj ia kishin mbathur, e një pjesë kundër atyre që me çdo kusht kërkonin paqen me ujkun.[697]

Varianti i Röhmit
Beim Abschied gab es noch *heftige Wortwechsel*, die einen verfluchten die Kommunisten, die wie üblich erst provoziert und dann *Fersengeld gegeben* hatten, und die andreren hetzten gegen jene, die dem Wolf am liebsten geradewegs *in den Arsch kriechen wollten*.[698]

Përkthimi i variantit të Röhmit
Gjatë ndarjes kishte shkëmbime të ashpra fjalësh, disa mallkonin komunistët, të cilët, si zakonisht, provokonin fillimisht, dhe pastaj ia jepnin këmbëve dhe të tjerët shfrynin kundra atyre që do të dëshironin më mirë t'ia lëpinin prapanicën (t'i nënshtroheshin) edhe ujkut vetë.

Nëse krahasojmë variantin e shqipes me gjegjësin në gjermanisht mund të themi se kemi ndyshime në të gjitha rrafshet gjuhësore. Nga ana formale, strukturat sintaksore nuk janë plotësisht ekuivalente. Fjalia e nënrenditur kohore *tek ndaheshin me njëri tjetrin* përkthehet me një gjymtyrë fjalie, rrethanor kohe, strategji e njohur në gjuhën e shkruar gjermane. Nga ana tjetër, edhe fjalitë homogjene të nënrenditura përcaktore *një pjesë e të cilave ishin kundër komunistave* dhe *një pjesë kundër atyre,* ku e dyta është nga ana sintaksore eliptike (mungon folja, nuk përsëritet) vijnë në gjermanisht si fjali të plota të nënrenditura përcaktore, në të cilat gjejmë dy folje të ndryshme, që kuptimisht janë sinonime kontekstuale. Foljet në kohën e pakryer *verfluchten* (mallkonin) dhe *hetzten* (shfrynin) janë gjegjëse të strukturave të gjuhës shqipe *ishin kundër komunistëve dhe kundër atyre….* Kuptimet e emetuara nga strukturat respektive në të dyja gjuhët ndryshojnë. Foljet *verfluchen* (mallkoj) me kuptim[699] *sich heftig über eine Person oder Sache ärgern und sie verëünschen* (të nxehesh shumë me dikë dhe t`i urosh fatkeqësi) dhe *hetzen* me kuptim *Hetze gegen jemanden, etëas betreiben; Hass entfachen, schüren; Schmähreden führen, lästern* (nxitje kundër dikujt; të nxjerësh urrejtjen, të ngacmosh dikë; të bezdisësh dikë), e cila mbart edhe elemente konotative zhvlerësuese, shenjojnë një nga mënyrat për të shprehur kundërshtinë ndaj dikujt. Por ato e specifikojnë saktësisht mënyrën e shprehjes së kundërshtisë, çka nuk shprehet në variantin e Kadaresë. Koteksti në roman implikon apo hap vende bosh për të hamendësuar veprime dhe qëndrime të tilla ndaj grupimeve të ndryshme të krijuara në Gjirokastrën e pragluftës me Gjermaninë.
Dallime ka edhe midis elementeve gjuhësore në shqip dhe ekuivalenteve në gjermanisht, si, *shkëmbenin fjalët e fundit*, krahasuar me *gab es noch heftige Wortwechsel*, si edhe *ia kishin mbathur,* krahasuar me *Fersengeld gegeben hatten*. Në rastin e parë, përpos mospërputhjeve në llojin e pjesës së ligjëratës dhe funksionin sintaksor të saj (folje në rolin e kallëzuesit *shkëmbej*, përkundrejt emër me funksionin e kundrinës *shkëmbim)* kemi edhe një ndryshim në rrafshin leksikor të mbiemrit në rolin e përcaktorit për leksemën *fjalët,* në variantin e Kadaresë, dhe atë të Röhm-it.

[697] Darka e gabuar, f. 21.
[698] Ein folgenschwerer Abend, f. 16.
[699] Duden online, lema verfluchen.

Fjalët në variantin e Kadaresë janë *të fundit* dhe në përkthimin e Röhmit *shkëmbimi i fjalëve është i ashpër*. *Heftig* (të ashpra) në përkthimin gjermanisht është sigurisht një metaforë e leksikalizuar dhe nuk emeton të njëjtin kuptim si *i fundit* në shqip. Mendojmë që përdorimi i mbiemrit metaforë *heftig* për të përcaktuar shkëmbimin e fjalëve në gjermanisht lidhet me pamundësinë e kombinimit në këtë gjuhë të mbiemrit *i fundit* me *Wortwechsel* (shkëmbim fjalësh). Është mospërputhja e stukturave sintaksore që përmendëm më lart ajo që kushtëzon edhe përzgjedhjen e përcaktorit nga përkthyesi J. Röhm.
Edhe strukturat përkatëse në të dyja gjuhët *mbath* dhe *Fersengeld geben* janë ekuivalente të pjesshme, për shkak të ndryshimeve në rrafshin morfologjik; një folje vjen e përkthyer me një shprehje metaforë me kuptim të leksikalizuar *Fersengeld geben* (fjalë për fjalë: i jap këmbëve, thembrave). Duhet të themi këtu se leksemën *Fersengeld* e ndeshim vetëm në këtë formë dhe në këtë kombinim, ajo është morfemë e ngurosur. Shprehja frazeologjike në gjermanisht është e ligjërimit të shkujdesur.

Shprehja tjetër metaforë *bëj paqe me ujkun* përdoret për të përshkruar atë grup njerëzish në qytetin e Gjirokastës të cilët ishin kundra luftës. Ajo i referohet situatës në prag të pushtimit gjerman në këtë qytet. Me shumë mjeshtëri, autori e përshkruan atë që në fillim të kapitullit, duke bërë një panoramë jo vetëm të pozitës gjeografike të qytetit përkundrejt rrethinave, Labërisë, Lunxhërisë, Lazaratit, por edhe të qëndrimit të gjirokastritëve ndaj banorëve të këtyre rrethinave. Në qytetin e Gjirokastrës, i cili pritej të ishte vendkalimi, apo –pushtimi i gjermanëve të ardhur nga Greqia, kishte ndarje të qëndrimeve të banorëve. Komunistët ishin, sigurisht, *plot zjarrmi e ngut* për luftë. Kombëtaristët pretendonin se “*Shqipëria s’kishte pse të futej në grindje verbazi, pa parë volinë e saj*”.[700] Reagimi i grupimit të parë ndaj ndodhisë së hyrjes së gjermanëve në qytet ishte ashtu siç pritej: provokim me zjarr, me armë. Kemi, pra, shtënie ndaj pararojës gjerman, veprim i bërë sipas të gjitha gjasave nga komunistët. Në paralelizëm me ndarjen e qëndrimeve të grupeve të ndryshme ndaj pushtimit, në këtë fragment, përshkruhen edhe mendime të ndryshme të njerëzve të ndodhur në kafenetë e qytetit në momentin e ngjarjes. Një pjesë nga ato ishin kundër komunistëve, një pjesë kundër kombëtaristave. Qëndrimin e këtyre të fundit autori e përshkruan përmes shprehjes *me çdo kusht kërkonin të bënin paqe me ujkun*.
Shprehja *paqe me ujkun* është shprehje frazeologjike. Kuptimi i fjalës *paqe*, ndërtuar mbi bazën e elementeve konceptuale *jo grindje, jo luftë, jo turbullira, jo armiqësi, mirëkuptim për të vendosur qetësi* është i papërputhshëm me ato mbi bazën e të cilave ndërtohet kuptimi i leksemës ujk *armiqësi, egërsi, pamëshirshmëri, gllabërim i më të dobtëve, keqdashje*. Në rrafshin leksikor, kombinimi i komponenteve konceptuale të të dyja leksemave emeton kuptimin e një mirëkuptimi, logjikisht të pamundur për shkak të veçorive apo karakteristikave armiqësore, ose të paktën jopaqësore të personit me të cilin dëshirohet të arrihet ky mirëkuptim. Këto vlera që emeton semantikisht kjo metaforë në kontekst do të përcaktonin dhe përshkruanin vlerat e personave të cilët do ta dëshironin me çdo kusht këtë mirëkuptim: kombëtaristët. Ata e shihnin goditjen e gjermanëve si shenjë të prishjes së paqes së ëndërruar me ta.
Në gjermanisht, kjo shprehje metaforike vjen e përkthyer në një regjistër tjetër. Kuptimi i shprehjes *in den Arsch kriechen wollen* përshkruhet në Duden, Redewendungen[701] nën vatrën leksikore të leksemës *Arsch* (prapanicë) si më poshtë:

[700] Darka e gabuar, f. 20.
[701] *Duden, Redewendungen.* Wörterbuch der deutschen Idiomatik. In: *Der Duden in zwölf Bänden.* 2., neu bearbeitete und aktualisierte Auflage. Band 11, Dudenverlag, Mannheim/Leipzig/Wien/Zürich 2002, vatra e leksemws Arsch.

sich Menschen mit einem übertrieben freundlichen Wohlwollen unterwerfen, um sich eigene Vorteile zu verschaffen oder zu sichern; vor keiner Erniedrigung zurückschrecken (t'i nënshtrohesh njerëzve me një miqësi dhe dashamirësi të tepruar, për të arritur apo siguruar përfitime për veten; të mos trembesh nga asnjë poshtërim). Leksema *Arsch* (prapanicë) është sigurisht e ligjërimit të shkujdesur, salop. Ajo është e shenjuar stilistikisht, çka nuk mund ta pohojmë për leksemën respektive të shqipes *ujk*. Duhet të themi këtu se edhe në variantin në gjermanisht është përdorur leksema ujk, por ajo përdoret për të shtuar masën e poshtërimit dhe pranimit të nëpërkëmbjes së kombëtaristëve nga gjermanët. Në këtë mënyrë, intesiteti i vlerësimit keqësues të kombëtaristëve nga përkthyesi është akoma edhe më i madh.
Edhe leksema *kriechen* (strukem, servilosem), e përdorur në kuptimin e nënshtrimit emeton elemente kuptimore keqësuese. Kuptimit referencial (denotativ) të nënshtrimit i mbishtohen elemente kuptimore, konotacione, përmes së cilave përkthyesi vlerëson negativisht personat, dmth., kombëtaristët. Një vlerësim negativ të tyre e gjejmë edhe në variantin shqip të Kadaresë, pasi edhe të bërit e paqes me ujkun nënkupton apo shenjon procesin e arritjes së marrëveshjes duke pranuar si palë të marrëveshjes, edhe armikun, të ligun, duke poshtëruar kësisoj edhe vetveten. Po të krahasojmë kuptimet në shqip dhe gjermanisht konstatojmë përpos ndryshimeve në stil, në regjistër, edhe në vëllimet kuptimore. Kuptimi që emeton shprehja *bëj paqe me ujkun* është një nga format dhe mënyrat e të servilosurit, nënshtrimit, dmth. variantit gjegjës në gjermanisht *in den Arsch kriechen wollen*.

c. I kërkonin gjithkund, te përroi, te gremina, te stanet e barinjve, gjersa kohë më pas, një përshpërimë e lehtë si shushurimë mëndafshi *ngulte këmbë* se ato kishin përfunduar brenda shtëpive të larta të qytetit.[702]

Varianti i Röhmit
Man suchte überall nach ihnen, an den brausenden Wildbächen, in den schroffen Bergspalten, in den Almhütten der Hirten, bis endlich nach langer Zeit *ein seidenartig raschendes Tuscheln die Oberhand gewann*, das besagte, sie seien in den hohen Häusern der Stadt gelandet.[703] (S.14)

Përkthimi i variantit të Röhmit
Për to kërkonin gjithkund, te përrenjtë e rrëmbyeshëm të shkumbëzuar, tek honet e maleve të thepisura, tek kasollet e barinjve, derisa pas shumë kohësh një *pëshpërimë e llojit të fëshfëritjes së mëndafshit doli fitimtare*, thoshte atë, që ato paskërkëshin përfunduar në shtëpitë e larta të qytetit

Në shembullin e përzgjedhur janë përdorur dukshëm më shumë përcaktorë në gjermanisht, krahasuar me variantin e Kadaresë. Përcaktorët *të rrëmbyeshëm, të shkumëzuar* dhe male *të thepisura* e bëjnë përshkrimin e peizazhit të Lunxhërisë edhe më interesant dhe më tërheqës. Midis një peizazhi të tillë kaq të bukur dhe frikëndjellës, mund të ndeshim edhe ndodhi enigmatike, zhdukje apo përpirje të grave të bukura të Lunxhërisë. Shpjegimi i kësaj dukurie dukej i pamundur në këtë hapësirë të pafundme që fillon që nga përrenjtë, ngjitet te kasollet e barinjve, për të përfunduar pastaj te greminat (në gjermanisht *te honet e thepisura*). Zgjidhja e këtij misteri nuk mund të artikulohej në tinguj, por vetëm në pëshpërimë, që Kadare i krahason me shushurimën e mëndafshit. Krahasimi i Kadaresë me pjesëzën krahasuese *si* jepet me një strukturë tjetër në gjermanisht: seidenartig (e llojit të mëndafshit). Përkthimi i një krahasimi në shqip me struktura në gjuhën gjermane, si psh. *të llojit të, të ngjashme*

[702] *Darka e gabuar*, f. 18.
[703] *Ein folgenschwerer Abend*, f. 14.

me, dukej, që semantikisht janë ekuivalente me krahasimin është një strategji e ndeshur shpesh edhe në përkthimin e J. Röhmit.
Përpos përdorimit të shtuar të epiteteve në përshkrimin e peizazhit të Lunxhërisë për të rritur dramacitetin e asaj që ndodhte në këtë zonë, konstatojmë edhe dallime në përdorimin e shprehjeve frazeologjike midis variantit të Kadaresë dhe përkthimit të J. Röhmit. *Pështpërima që ngulte këmbë* e Kadaresë vjen në gjermanisht e përkthyer me *pështpërimë që del fitimtare*. Kuptimisht këto shprehje janë ekuivalente të pjesshme. Figurshmëria e strukturave gjuhësore në të dyja gjuhët formohet nga kombinimi i leksemës *pështpërimë* me shprehjen frazeologjike *ngul këmbë* apo *dal fitimtar*, që përdoret vetëm për frymorë dhe qenie të arsyeshme që mund të veprojnë.

4.4.1.3 Metaforizimi

Metaforizimi[704] është një strategji e përkthimit të një fjale apo togfjalëshi në gjuhën pritëse me një metaforë. Një përkthim i tillë përdoret kur dëshirojmë të shenjojmë emocionalisht një thënie në gjuhën pritëse. Kjo procedurë përkthimi përhap përdorimin e metaforave në tekst dhe dëshmon për një kompetencë të përkthyesit në zotërimin e metaforave.
Le të analizojmë disa shembuj:

a. Përpara se të mbaronin fjalën, sytë e hetuesit rus u ndriçuan si shpuzë.[705]

Përkthimi i Röhmit
Die Augen ihres russischen Kollegen begannen zu funkeln.[706]

Përkthimi i variantit të Röhmit
Sytë e kolegut të tyre rus filluan të xixëllonin.

b. ...Sytë e çelët si prej kukulle të rusit vështronin të qeshur.[707]

Përkthimi i Röhmit
Ein ironisches Lächeln spielte um die hellen Puppenaugen des Russen.[708]

Përkthimi i variantit të Röhmit
Një e qeshur ironike vezullonte rreth syve të çelët prej kukulle të rusit.

Në shembullin *a* dhe *b* kemi në variantin në shqip një krahasim. Kadare i përdor ato për të përshkruar hetuesin rus që kishte ardhur për të zbardhur çështjen e Gurametos së madh pas pamundësisë së hetuesve shqiptarë dhe hetuesit gjerman për të detyruar doktorët të deklaronin dhe të pohonin komplotin e madh hebraik. Në fillim të mbërritjes së këtij hetuesi në aeroportin e qytetit, impakti që zgjon ai te hetuesit shqiptarë, Shaqo Mezini dhe Arian Ciu, ishte zhgjënjyes. Por ishte përgatitja dhe mjeshtëria e tij për të arritur atë që duhej, ftohtësia e akullt në gjykim deri në mizori, e konstatuar që në fillim të bisedës me rusin, ajo çka çmeriste Shaqo Mezinin dhe Arian Ciun. Admirimin për të, e shprehnin në vështrimet dhe qëndrimet ndaj tij. Por edhe pse ndihet ky vlerësim në qëndrimet e hetuesve shqiptarë, vlerësimi i shkrimtarit për hetuesin rus është negativ. Duke i krahasuar në shembullin *a* sytë e tij me shpuzën,

[704] Kjo strategji e përkthimit që Kurth-i (1995, f. 188) e quajti metaforizim të ri, Toury (1995, f. 83) e emërtoi *non- metaphor into metaphor, dmth., jo-metafora në një metafor*ë.
[705] *Darka e gabuar*, f. 157.
[706] *Ein folgenschwerer Abend*, f. 136.
[707] *Darka e gabuar*, f. 158.
[708] *Ein folgenschwerer Abend*, f. 137.

shkrimtari ka dashur të zgjojë te lexuesi pikërisht idenë e rrezikshmërisë së tij. Koncepti i shpuzës i aktivizuar nga leksema, ka këto komponente: MBETJE E IMËT E ZJARRIT; KUPTUESHMËRI; MPREHTËSI. Në kotekst gjejmë një mundësi të tillë interpretimi të cilësive të hetuesit rus. “Rusi e kapte çdo gjë aty për aty, thua se kishte vite që merrej me atë dosje”[709], shkruan Kadare. Por menjëherë pas kësaj vjen edhe thënia tjetër “… dhe nuk e fshihte që kishte përvojën e proceseve të Moskës, për të cilat diheshin ende pak gjëra”, e cila bën një modifikim dhe pasurim të konceptit shpuzë, me elemente tilla: RREZIKSHMËRI; MIZORI. Kjo vjen, padyshim, nga aktivizimi i sfondit sociokulturor. Dimë për torturat dhe politikat çnjerëzore të kohës së atëhershme të Stalinit, politika që duhet të injektoheshin edhe në Shqipëri si aleate e Bllokut të Lindjes. Duke bashkëvepruar edhe me komponente që vijnë nga aktivizimi i konceptit SHPUZË, arrijmë në një element tjetër konceptual të shpuzës, që lidhet me djegien dhe njëkohësisht edhe me pasojat që mund të linte një proces i tillë. Pra, përmes këtij krahasimi, Kadare synon që të bëjë një vlerësim me konotacion negativ të hetuesit rus.

Në përkthimin e J. Röhmit gjejmë një metaforë të leksikalizuar: *die Augen begannen zu funkeln* (sytë filluan të xixëllojnë). Në fjalorin Duden Online jepet si shpjegim për temën fjalëformuese të foljes *funkeln* emri *Funke* (xixë), kuptimi leksikor i së cilës sigurisht e përmban idenë e shkëndijës që mund të ndezë një zjarr dhe të djegë. Pra, komponenti konceptual i rrezikshmërisë jepet edhe në përkthimin në gjermanisht. Por në gjermanisht vlerësimi për kolegun rus nga ana e hetuesve shqiptarë jepet përmes metaforës *funkeln* (xixëllonin) dhe jo krahasimit, figurë që vlerëson të krahasuarën më zbehtë sesa metafora. Kjo, mendojmë ne, është edhe arsyeja e përdorimit nga Kadareja e figurisë së krahasimit për përshkrimin e hetuesit rus.

Në shembullin *a*, përpos ndryshimeve në përdorimin e figuracionit, konstatojmë edhe ndryshime në sintaksën e fjalive.

Thënia në variantin e Kadaresë ka strukturën e një fjalie të përbërë, fjalia e nënrenditur e së cilës është kohore, dmth, në aspektin kohor ajo ndodh pas asaj çka ndodh në fjalinë kryesore. Ky aspekt kohor është synuar të jepet edhe në gjermanisht, edhe pse në përkthim struktura e thënies është e një fjalie me një konstrukt në formën e infinitivit *zu funken*. Në Duden Grammatik gjejmë këtë përkufizim për përdorimin e kësaj formë foljore: „In satzwertigen Infinitivphrasen gibt es kein finites Verb.“[710] Më tej, në kapitullin mbi konstrukte të tilla gjejmë të shpjeguar se këto konstrukte përmbajnë një folje e cila drejton një folje tjetër në formën e infinitivit.[711] Në këtë rast, kuptimi leksikor i foljes së parë është zbehur, ajo shërben në shembullin tonë për të treguar mënyrën e veprimit (die Aktionsart), dmth, përcakton aspektin kohor durativ të foljes që mbart kuptimin leksikor në fjali. Në rastin konkret, fillimin e veprimit, çastin kohor të xixëllimit të syve të hetuesit rus. Në gjermanisht aspekti kohor i shprehur nga folja është durativ, dmth, nuk përcaktohet koha në krahasim me momentin e ligjërimit në rrëfim. Në shqip, aspekti kohor i ndodhisë kufizohet përkundrejt çastit të ligjërimit në rrëfim, ai ndodh para se hetuesit shqiptarë të mbaronin së foluri. Kjo mënyrë përkthimi bën që densiteti i informacioneve në variantin gjermanisht të jetë më i ngjeshur.

Diferencat e sipërpërmendura në *a* midis varianteve në shqip dhe në gjermanisht ndikojnë edhe në mënyrën e receptimit të thënieve dhe të vlerësimit të personazhit, hetuesit rus dhe atyre shqiptarë, nga lexuesi.

[709] Darka e gabuar, f. 156.
[710] *Duden Grammatik, Band 4*, Mannheim, 2005.
[711] Shih, po aty, f. 858, 1314.

Në shembullin *b* kemi ndryshime të dukshme në strukturën sintaksore që vjen e përkthyer në gjermanisht. Shprehja e gjymtyrëve të fjalisë dhe funksionet sintaksore të tyre duket se janë përmbysur në përkthimin në gjermanisht. Kryefjala *sytë* gjendet në funksionin e rrethanorit të vendit në përkthim, po kështu përcaktori kallëzuesor në variantin në shqip vjen në përkthim në funksionin e kryefjalës. Ndajshtimi i shprehur me emër në rasën rrjedhore (prej kukulle) është pjesë e një fjale të përbërë në përkthim, fjalë e cila luan, siç e përmendëm, funksionin e rrethanorit. Në gjuhën gjermane është shumë produktiv formimi i fjalëvë të përbëra me strukturë emër + emër, në të cilën emri që vendoset në fillim të strukturës së kompozitës e përcakton emrin e pasvendosur. Kjo strukturë i mundëson përkthyesit përdorimin e metaforës *Puppenaugen*. Jashtë kontekstit, kompozita e variantit në gjermanisht *sy kukulle* mund të emetojë edhe konotacione pozitive, dmth., ajo mund të shprehë bukurinë dhe brishtësinë e personit, sytë e të cilit krahasohen me atë të kukullës. Këtë mundësi interpretimi ka dashur, sipas mendimit tonë, duke përdorur figurën e krahasimit të shmangë Kadareja në variantin në shqip. Vlerësimi i hetuesit është negativ, për këtë arsye Kadareja nuk përdor figuracion që mund të emetojë sadopak vlera pozitive vlerësimi. Për mendimin tonë, krahasimi eleminon aktivizimin e komponenteve pozitive të konceptit *kukull*. Kur krahasojmë sytë e njeriut me atë të kukullës, aktivizojmë jo vetëm elemente konceptuale që lidhen me pamjen e jashtme, por edhe ato që përcaktojnë karakterin dhe personalitetin e personazheve në rrëfim që krahasohen me të. Koncepti KUKULL aktivizon edhe elemente konceptuale si MËNYRË PËR T`U ARGËTUAR; E DREJTUAR DHE KOMANDUAR NGA TË TJERËT; PA MENDIME, IDE.[712] Këto elemente konceptuale që lidhen me vlerësimin e personaltetit të hetuesit rus ka synuar të japë edhe shkrimtari në rrëfimin e tij.

Përmbysja e rendit të gjymtyrëve të fjalisë në përkthim shoqërohet edhe me ndryshim të peshës së informacionit që mbartin ato në fjali. Në shqip, gjymtyrët që mbajnë peshën më të madhe të informacionit, si edhe që duhen theksuar më shumë, vendosen në fillim të fjalisë. Gjymtyra e fjalisë në funksionin e predikatit kallëzuesor *të qeshur* paraqet edhe remën e fjalisë, dmth, informacionin e ri që sjell rrëfimtari. Siç e dimë, kjo gjymtyrë vendoset në marrëdhënie rrethanore me foljen në funksionin e kallëzuesit dhe në marrëdhënie përcaktore me emrin, kryesisht në funksionin e kryefjalës. [713] Në shembullin *b,* ajo përcakton emrin *sytë*, por edhe mënyrën e veprimit të vështrimit. Nëse e analizojmë këtë gjymtyrë tek përkthimi i J. Röhmit, ajo na shfaqet në funksionin e kryefjalës, e vendosur në fillim të fjalisë. Kuptimisht nuk janë të njëjta një emër abstrakt *ein Lächeln* i formuar me anën e konversionit, dmth., nga folja përkatëse, me një mbiemër *i qeshur*, i cili përcakton emrin sytë. Pra, diferencat kuptimore janë të mëdha. Përkthyesi e përcakton të qeshurën që vërehet rreth syve prej kukulle të rusit, ai e quan atë ironike, çka nuk e gjejmë te Kadareja.
Duam të shtojmë këtu se edhe rendi i gjymtyrës së fjalisë *rreth syve prej kukulle* njihet në literaturën gjuhësore gjermane si rend i përmbysur i fjalisë. Progresioni temë – rema përcaktohet si i zakonshëm në gjuhën gjermane. Gjymtyra që mbart informacionin më kryesor, që duhet të theksohet, vendoset në gjermanisht në fund të fjalisë. Kadzadej shkruan se:

> Im Deutschen wird die Stellung der Funkstionteile weitgehend vom Mitteilungwert ihrer Inhalte bestimmt, wobei das Satzglied mit dem höchstem Mitteilungswert dem Satzende

[712] Elemente të tilla konceptuale gjejmë edhe në shprehjet: *kukull e të tjerëve*.
[713] Shih, *Gramatika e gjuhës shqipe 2*, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, f. 241.

zustrebt.[714](Në gjermanisht, rendi i vendosjes së gjymtyrëve të fjalisë përcaktohet ndjeshëm nga vlera informative e tyre, ku gjymtyra me vlerë informative më të madhe tenton të vendoset në fund.)

Kjo zhvendosje e rendit të gjymtyrëve të fjalisë ndikon dhe në emetimin e mesazhit dhe në receptimin e e tij nga lexuesit shqiptarë dhe gjermanë.

4.4.1.4 Çmetaforizimi

Në përkthimin e metaforave kemi çmetaforizim[715] atëherë kur një metaforë e gjuhës amtare përkthehet me një shprehje jo metaforike apo me një parafrazë normale. Kjo procedurë njihet ndryshe në teorinë e përkthimit edhe si neutralizim i figurshmërisë. Përkthyesi e përdor këtë mënyrë, kur metafora e gjuhës amtare nuk ka ekuivalencë në gjuhën pritëse ose kur kuptimi i tyre, për shkak të ndryshimeve në figurshmëri midis gjuhës amtare dhe pritëse, është i panjohur për lexuesin e gjuhës pritëse. Prandaj mund të themi se çmetaforizimi është i lidhur me metaforat që lidhen me kulturën e një gjuhe. Përveç kësaj, kjo procedurë përdoret edhe kur përkthimi fjalë për fjalë i metaforës së gjuhës amtare nuk është i kuptueshëm apo i mundur në gjuhën pritëse.

a. Atë pasdite të paharrueshme, kur tanket dhe autoblindat, pas *shkarrangjitjes rënkuese* hynë në qytet, prej njërës autoblindë, atje te sheshi i Bashkisë, kishte dalë komandanti i divizionit gjerman, koloneli Fritz von Schëabe, mbajtës i Kryqit të Hekurt.[716]

Varianti i J. Röhm
An jenem denkëürdigen Nachmittag, als die Tanks und anderen Kettenfahrzeuge mit *ohrenbetäubendes Rasseln und Kreischen* die Straße zur Stadt heraufgekommen waren und schließlich auf dem Rathausplatz angehalten hatten, war dem Führungspanzer der deutsche Divisionskomandeur und Ritterkreuzträger Oberst Fritz von Schwabe entstiegen.[717]

Përkthimi i variantit të J. Röhm
Në atë pasdite të paharrueshme, kur tanket dhe automoblindat ngjitnin rrugën drejt qytetit me rrapëllima dhe kërkëllima shurdhuese dhe, në fund, kishin ndaluar te sheshi i Bashkisë, koloneli Fritz von Schëabe, komandanti i divizionit dhe mbajtës i Kryqit të Hekurt i kishte zbritur autoblindës kryesuese.

Metafora kreative *shkarrangjitje rënkuese* parafrazohet në këtë përkthim me togfjalëshin *ohrenbetäubendes Rasseln und Kreischen (rrapëllima dhe kërkellima shurdhuese).* Në romanin e Kadaresë evidentojmë një metaforë kreative, emri i prejardhur i së cilës përkthehet me togfjalëshin e përbërë prej fjalësh onomatopeike *Rasseln und Kreischen* (rrapëllimë dhe kërkëllimë). Nëse në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe online” koncepti mbi të cilin ndërtohet kuptimi leksikor përbëhet prej primitivëve kuptimorë të ndryshimit të vendndodhjes, të mënyrës si ndodh kjo zhvendosje, me vështirësi, si edhe të mjeteve prej të cilave ndodh kjo zhvendosje, me duar dhe këmbë, të vendit ku ndodh kjo kacavjerrje, në një të përpjejetë, në variantin gjermanisht kemi onomatope, pra, motivim të shenjimit. Në kontekst, kuptimi i emrit, kombinuar me mbiemrin *rënkuese* në funksionin e përcaktorit ka jo më kuptimin e ndryshimit të vendndodhjes përmes kacavjerrjes, por përckatimin e ngjitjes së tankeve dhe autoblindave përmes motorëve, si *të vështirë dhe tepër të ngadaltë*, të njëllojtë për nga krahasimi, si edhe atë të ngjitjes me duar dhe këmbë. *Shkarrangjitja* ishte jo

[714] Kadzadej, B., *Deutsche Syntax*, Tiranë, Shtëpia botuese e librit universitar, 2006, f. 82.
[715] Çmetaforizimi në kuadrin e teorisë së përkthimit mund të krahasohet me parafrazimin.
[716] Darka e gabuar, f. 40.
[717] Ein folgenschwerer Abend, f. 31.

vetëm e ngadaltë, por edhe e dhimbshme. Afrimi i tankeve dhe automobilave drejt qëllimit, dmth., drejt qytetit do të sillte edhe dhembje, probleme që sinjalizojnë për një ngjarje, ndodhi, e cila do të gjykohej e turpshme apo enigmë. Në përkthimin në gjermanisht kjo zhurmë me rrapëllimë dhe kërkëllitje përcaktohet vetëm në masën e saj, aq e lartë, sa mund të thuhet, shurdhuese.
Në shembullin që analizojmë, edhe fjala *shkarrangjitje* është një neologjizëm që krijon Kadareja. Ajo formohet prej emrit të prejardhur nga folja *ngjis* dhe nga forma *shkarra.* Është, në fakt, sipas mendimit tone, një krijim në analogji me emrin shkarravitje. Kuptimi i neologjizmit të krijuar nga Kadareja emetohet duke analizuar tri komponente të përdorura nga Kadareja në ngjizjen e kësaj fjale, e cila ka të bëjë edhe me llojet e dijeve që skicuam në modelin e interpretimit të metaforave. Modeli i formimit të emrave të prejardhur me prapashtesën –je, asociacioni që vendos forma *shkarrë* me *zhgarrë,* dhe fuqia simbolizuese e aliteracionit që evokon alternimi i tingullit rr dhe sh, si dy tinguj që përdoren për të dhënë goditje me jehonë të mbytur; dhe shpërthimet japin dhe emetojnë kuptimin e ngjizur të neologjizmit.

b. Madje, do të ishin kundër të tretëve që s’mungonin në kësi rastesh e që si të përmbajtur që ishin, mendonin se ishte vështirë të gjykohej dikush që gjendej brenda, nga të jashtmit, e po kështu këta, nga i brendshmi, e kështu me radhë, gjersa *lëmshi mbështillej* përsëri e gjendej dikush që thoshte: more vërtet, çbëhet vallë atje brenda?[718] (fq.61)

Varianti i Röhm-it
Diese – jede für sich und beide gemeinsam – standen gegen eine dritte Gruppe, die es wie immer in solchen Fällen gab. Um Besonnenheit bemüht, wies sie darauf hin, es sei von außen schwer zu beurteilen was sich drinnen abspielte, und umgekehrt. So ging es weiter, bis jemand in die allgemeine Kakophonie hinein sagte: Also,ich würde schon gerne wissen, was da drinnen wirklich vorgeht.[719] (S.49)

Përkthimi i variantit të Röhm-it
Këta – secili për vete dhe të dy së bashku – ishin kundër një grupimi të tretë, që sigurisht si në të gjitha rastet ekzistonte. I kujdesur për përmbajtshmëri, ky grupim tregonte se ishte e vështirë të gjykohej nga jashtë çfarë ndodhte brenda, dhe anasjelltas. Kështu vazhdohej, derisa dikush, në kakofoninë e përgjithshme, fliste: Atëherë, unë do të dëshiroja të dija tashmë, çfarë ndodh vallë atje brenda?

Situata që përshkruhet në pjesën që analizojmë ka lidhje me hamendësimet mbi ndodhitë e mundshme brenda shtëpisë së Doktor Gurametos së madh gjatë darkës me kolonelin. Pyetja që ndizte hamendësimet lidhej me faktin nëse Doktor Gurametoja i madh e kishte thënë emrin e personit që kishte qëlluar pararojën gjermane. Një ndarje në tri grupe e mendimeve, gjykimeve e kemi ndeshur, siç e kemi përshkruar, gjatë gjithë romanit të Kadaresë. Edhe në këtë hamendësim nuk mund të ndodhte ndryshe.
Krahasimi i origjinalit me përkthimin dëshmon, në rrafshin sintaksor, dallime në formulimin dhe dhënien e mendimeve. Siç duket nga krahasimi, përkthyesi shpreh tërë përshkrimin e ngjarjes së rrëfyer nga Kadareja në një fjali me shumë pjesë fjalie të nënrenditura, në fjali më të thjeshta. Në rrëfimin e Kadaresë ngjarjet tregohen brenda një njësie të vetme sintaksore, duke u vendosur në lidhje varësie me njëra-tjetrën. Në përkthimin e Röhmit lexuesi duhet të plotësojë vetë marrëdhëniet që vendosin pjesët e rrëfimit me njëra-tjetrën.

[718] Darka e gabuar, f. 61.
[719] Ein folgenschwerer Abend, f. 49.

Një dallim tjetër midis të dy varianteve kemi edhe në përkthimin e metaforës *lëmshi mbështillej*, një metaforë e leksikalizuar, në kuptimin *dikujt apo diçkaje po i vjen fundi*. Një konceptualizim i tillë për të dhënë fundin e dikujt apo diçkaje të vështirë, të ngatërruar nuk mund të shprehet në gjuhën gjermane përmes kombinimit të kuptimeve të leksemave *lëmsh* dhe *mbështjell*. Kombinimi i elementeve konceptuale të leksemës *lëmsh*, NGATERRESË; PËSHTJELLIM; GJATËSI E SPËRDREDHUR me elementet konceptuale të leksemës *mbështjell*, GRUMBULLIM; RRADHITJE DREJT FUNDIT TË DIÇKAJE për të emërtuar gjuhësisht procesin e shkuarjes drejt fundit të një ndodhie nuk ekziston në gjuhën gjermane. Prandaj, përkthyesi e jep me fjalinë *so ging es weiter*, e cila emërton procesin e vazhdimësisë së ndodhive të përshkruara në fjalitë e mësipërme. Por, ajo nuk u referohet të gjitha elementeve konceptuale që lidhen me kuptimet e leksemave *lëmsh* dhe *mbështjell*. Pra, gjetja e përkthyesit Röhm nuk emeton të gjitha efektet që synon të japë Kadareja me metaforën *lëmshi mbështillej*.

c. Ishin larguar ata që do të largoheshin, një pjesë drejt katundeve të Lunxhërisë, të tjerë drejt Malit të Gjerë, atje ku *ujqërit* dhe *dhelprat*, pas mendjes së tyre, do të ishin më pak *idhnakë* me ta.[720]

d.

Varianti i J. Röhm
Wegegangen war, wer weggehen sollte, manche zu den Dörfern der Lunxhëria, andere zum großen Berg, wo die Wölfe und Füchse vermutllich anständiger mit ihnen umgehen würden als die Eindringlinge.[721]

Përkthimi i variantit të J. Röhm
Ishin larguar, ata që duhej të largoheshin, disa në fshatrat e Lunxhërisë, disa në Malin e madh, ku ujqërit dhe dhelprat do të silleshin më mirë me ta sesa pushtuesit.

Kadareja përshkruan me këtë fjali gjendjen e qytetit të Gjirokastrës në prag të pushtimit gjerman. Në këtë hulli, herë në pamjen e heshtjes, e herë të një katrahureje të shkaktuar pas goditjes së pararojës gjermane, sjellja e qytetarëve të Gjirokastrës ishte e pashpjegueshme dhe e paarsyeshme. Disa mendonin të largoheshin drejt krahinave të tjera edhe pse, siç Kadareja e përshkruan më parë, Gjirokastra, dmth. edhe banorët e saj kishin pasur marrëdhënie “të ftohta dhe të huaja” me banorët e rrethinave të tjera për shkak të butësisë, ashpërsisë apo edhe qëndrimit ekuilibërprishës.[722] E gjithë kjo panoramë e përshkruar e relievit të rrethinave rreth Gjirokastrës dhe marrëdhënieve të tyre me qytetin rizgjohet edhe njëherë në fjalinë e mësipërme. Lunxhëria i pret banorët e qytetit pasi është e butë. Edhe në Malin e Gjerë mikpritja, qoftë edhe e kafshëve të saj, dhelprave dhe ujqërve, do të ishte më e durueshme se e gjermanëve, që ndjeheshin të ngrënë në besë. Një karakterstikë e sjelljes njerëzore, pikërisht, të qenët i idhnuar prej një sjelljeje lënduese, u vishet kafshëve. Përshkrimin e gjermanëve përmes sjelljeve të tyre më çnjerëzore se vetë qeniet jonjerëzore apo kafshët e egra mishngrënëse, siç ishin ujku dhe dhelpra, Kadare e jep me metaforën *ujqër dhe dhelpra idhnakë*. Koncepti i leksemës në funksionin e përcaktorit kallëzuesor *idhnakë* përbëhet nga ato komponente që lidhen me gjendjen emocionale: INAT, ZEMËRIM; masën e gjendjes së përcaktuar: I MADH, mënyrën e reagimit ndaj gjendjes së krijuar: I RRËMBYER, I ASHPËR. Të gjitha këto elemente konceptuale i aktivizon edhe koteksti i përshkruar para dhe pas fjalisë që

[720] *Darka e gabuar*, f. 24.
[721] *Ein folgenschwerer Abend*, f. 15.
[722] Shih, *Darka e gabuar*, f. 15.

analizojmë. Inati dhe zemërimi i ujqërve dhe dhelprave, të dyja metafora për gjermanët, pritej të ishte i madh dhe i rrëmbyeshëm. Në gjuhën pritëse struktura sintaksore e fjalisë ruhet, por përdoret një figurshmëri tjetër. Rrafshi figurativ vendoset duke krahasuar sjelljen e kafshëve, ujqërve dhe dhelprave, me atë të njerëzve. Krahasimi bëhet jo më duke u nisur nga mënyra e reagimit të papërmbajtshëm, të inatosur dhe të zemëruar, por më në përgjithësi. Kjo sjellje e këtyre kafshëve do të ishte më e mirë se e pushtuesve. Nëse në shqip nuk përmendet entiteti që krahasohet me kafshët, por lihet të nënkuptohet, në gjermanisht kemi një krahasim të shprehur.

4.5 Somatizmat në veprën e Kadresë dhe ekuivalentet në gjermanisht

Në këtë syth do të përpiqemi të analizojmë disa shprehje frazeologjike në veprën e Kadaresë, një nga pjesët përbërëse të të cilave është një emërtim i një pjese të trupit dhe përkthimin e tyre në gjermanisht. Këto shprehje njihen edhe si *somatizma*.

Në lidhje me shprehjet frazeologjike Jani Thomai shkruan: „Njësia frazeologjike është nga forma, një strukturë e hapur me dy ose më shumë leksema, nga përmbajtja me kuptim të njësuar, tërësor e të figurshëm dhe nga funksioni (ose nga kuptimi kategorial) barasvlerëse e fjalës në rrjedhën e ligjërimit.“[723] Ai shton se tipare plotësuese të njësisë frazeologjike janë ngurosja e gjymtyrëve të strukturës, ngjyrimi i theksuar emocional dhe kufizimi ligjërimor. Nga përkufizimi dalin si vlera të njësive frazeologjike jo vetëm ato nominative, por edhe ato ekspresive. Është pikërisht kjo vlerë e dytë, që na shtyn të qëmtojmë dhe analizojmë këto njësi në të cilat elementi konotativ është thuajse i përhershëm, madje dominues, në veprën e Kadaresë.

Veçanti të njësive frazeologjike Jani Thomai përcakton mënyrën e lindjes së njësisë frazeologjike jo si shenjuese të drejtpërdrejtë të realies, apo ndodhisë, “por si shenjuese e ndërmjetësuar, “simbolike” nëpërmjet një tropi gjuhësor”.[724]
Të njëjtin qëndrim mban edhe Christine Palm në lidhje me mënyrën e formimit të njësive frazelogjike. Ajo shkruan se ato janë emërtime jo arbitrare, por të motivuara, edhe pse ndoshta ky motivim nuk është i dukshëm në stadin e sotëm të studimit të gjuhës. Është kjo veçori e shprehjeve frazeologjike që përligj edhe një lidhje të motivuar midis shenjës dhe të shenjuarit, lidhje e cila shpesh bazohet mbi dukurinë e metaforës dhe metonimisë.[725] Nëpërmjet tyre konceptualizohen, -shton ajo, “madhësi mendore”, “si psh., emocione, qëndrime, pikëpamje. ”[726]

Kërkimet dhe studimet mbi veçoritë stilistikore dhe tekstore të njësive frazeologjike edhe pse të pakta në numër janë po aq të vjetra sa edhe studimet mbi to. I pari koncept “mundësitë tekstore të frazeologjizmave” është sjellë nga І. І. ČERNYŠEVA[727] dhe daton në vitin 1974.

[723] Thomai, J., Fjalor frazeologjik i gjuhës shqip, Tiranë, Shkenca, 1999, f. 7.
[724] Shih, po aty, f. 8.
[725] Shih. Palm, Ch., Phraseologismen. Eine Einführung. Tübingen, Narr, 1997, f. 1.
[726] Shih, po aty, f. 1.
[727] ČERNYŠEVA zitiert nach DOBROVOL’KIJ: „Koncepti i mundësive tekstore të frazeologjizmave nuk është i ri. Ai vjen nga I. I. Černyševa. Ajo fliste për të parën herë, pikërisht edhe 10 vjetë para DOBROVOL’SKIJ. Që nga ajo kohë ky term është përdorur në të gjitha punimet mbi frazeologjinë“. DOBROVOL’SKIJ 1987, f. 69.

Funksionet stilistikore, pragmatike të këtyre shenjave nuk mund të studiohen pa studiuar ato tekstore. Gjuhëtari gjerman Wolfgang Fleischer, i njohur në fushën e studimeve mbi frazeologjinë, numëron si funksione strukturuese tekstore të frazeologjizmave veçoritë e mëposhtme:

- Strukturën sintaksore si togfjalësh dhe mundësinë e ndarjes së tij në gjymtyrë përbërëse, variabilitetin sintaksor-strukturor;
- Ndarjen në komponente semantike me variacion deri në autonomi semantike të elementeve përbërës, apo edhe deri në fjalëformim me prejardhje të njësive të tjera;
- Karakterin difuz të kuptimit në pjesën më të madhe të njësive frazeologjike;
- Sinoniminë e zhvilluar mirë brenda sistemit frazeologjik;
- Ekspresivitetin mjaft të zhvilluar, që bazohet në figurshmërinë dhe konotacionet, mundësinë e rritjes së ekspresivitetit.[728]

Ndër funksionet pragmatike të frazeologjizmave, W. Fleischer numëron ato veçori të frazeologjizmave që ndikojnë në arritjen e një efekti më të madh të frazeologjizmave për realizimin e qëllimit të dërguesit të mesazhit.[729] Në këtë grup ai veçon:

- Shenjim të marrëdhënieve, statusit social të partnerëve në komunikim;
- Nënvizim të qëndrimit emocional të dërguesit ndaj ndodhisë, ngjarjes;
- Distancim duke përdorur ironinë apo shpotinë;
- Efekt eufemizues;
- Ndikim më të madh të argumentimit që realizohet nëpërmjet qartësisë, të mbajturit mend më lehtë, si edhe theksimit emocional;
- Lehtësim të komunikimit nëpërmjet karakterit stereotip (veçorive klishe) të frazeologjizmave.[730]

Veçoritë dhe fuksionet tekstore, strukturore, pragmatike të frazeologjizmave janë studiuar më së shumti në tekste publicistike, gazetareske dhe letrare.[731] Frazeologjizmat janë studiuar në korpuse të perlave të letërsisë artistike, si Goethe, Max Frisch, Martin Walser, por edhe në korpuse të letërsisë triviale.

Tekstet letrare të çdo autori nga ana stilistikore duhet të shenjohen nga individualiteti dhe e veçanta. Kjo do të thotë që shkrimtarët përpiqen në krijimtarinë e tyre të krijojnë një stil individual. Por në letërsinë artistike ndeshim shpesh frazeologjizma ose përdorimin e tyre si lojë gjuhësore, edhe pse ato njihen si material i gatshëm gjuhësor, dhe, si të tilla, nuk mund të karakterizojnë stilin individual të një shkrimtari. Kjo kontraditë në dukje shpjegohet nga A. Christophe, si më poshtë:

[728] Shih, Fleischer, Wolfgang, Phraseologie der deutschen Gegenwartssprache, Tübingen, Niemeyer, 1997, f. 213 e në vijim.
[729] Shih, po aty, f. 218.
[730] Po aty, f. 218.
[731] Shih, BURGER, Harald, Phraseologie in der Presse, në, Nicole FERNANDEZ BRAVO et al (botues), *Phraseme und typisierte Rede*. S. 77-89; MALA, Jiřina, Stilistische Funktionen der Phraseologismen in publizistischen Textsorten, URL: www.phil.muni.cz/stylistika/studie/publizistischen.doc. Zugriff vom 25.08.2008 ; BURGER, Harald Phraseologie (und Metaphorik) in intertextuellen Prozessen der Massenmedien, në, PALM-MEISTER, Christine (botues), *Europhras 2000*, Internationale Tagung zur Phraseologie vom 15.-18. Juni 2000 in Aske/Schweden, f. 5-13

> Frazeologjizmat njihen në shkencë si forma kolektive të komunikimit. Në këtë mënyrë, tekstet letrare paraqiten si forma kolektive të komunikimit, të drejtuara nga rregulla të paracaktuara. Këtu del qartë çfarë roli marrin frazeologjizmat në tekstet e letërsisë artistike, ku duhet të gërshetohet individualja dhe e veçanta, dhe, pikërisht, si simbol i përdorimit të pashmangshëm të formulimeve të gatshme. Si rrjedhojë, përdorimi i frazeologjizmave është në të njëtën kohë shprehje e konvencionalitetit në gjuhë, por edhe një sfidë e shkëlqyer për kreativitet.[732]

4.5.1 Frazeologjizmat me pjesë të trupit në romanet “Darka e gabuar” dhe Gjenerali i ushtrisë së vdekur”

Ndër frazeologjizmat e shumta të përdorura në veprën e Kadresë kemi zgjedhur, pra si objekt të studimit në këtë syth një grup të veçantë: somatizmat. Arsyeja e përzgjedhjes së somatizmave lidhet me faktin e thjeshtë se në frazeologjizmat me pjesë trupi gjejmë të shprehur më së miri mendësinë dhe kulturën e një etnie, “simbolikën e gjuhës së trupit, si edhe traditita dhe paragjykime”,[733] çka mundëson një përqasje të kulturave.

Leksemat që emërtojnë pjesët e trupit janë më të vjetrat e fjalorit të një gjuhe. Si të tilla, komponente konceptuale të tyre kanë shërbyer si bazë për formimin e kuptimit të figurshmëm metaforik të pjesëve të trupit. Nga ana tjetër, somatizmat janë edhe pikë projektimi e koncepteve apo kuptimeve metaforike. Ato përshkruajnë sjellje njerëzore, emocione njerëzore, veprime dhe karakteristika të tyre. Földes shkruan se “somatizmat shërbejnë zakonisht për të shprehur cilësi emocionale, mendore, veprime të njerëzve, pasqyrojnë marrëdhënien e njeriut me mjedisin, shprehin simbolikën e gjuhës së trupit, si edhe tradita dhe paragjykime.”[734]

Për Ullmann-in somatizmat janë “metafora antropologjike“, që emërtojnë cilësi që lidhen me pamjen e njerëzve, karakteristika të tyre, ndjenja dhe emocione të tyre, por jo së fundmi edhe sjellje dhe mentalitete të njerëzve të caktuar dhe komuniteteve apo shoqërive të caktuara njerëzore.[735]

Siç e përmendëm edhe më lart, do të ndalemi veçanërisht në analizën e somatizmave që kemi skeduar nga romanet në shqip “Darka e gabuar” dhe “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” dhe gjegjesve të tyre në gjermanisht. Kjo analizë synon nxjerrjen në pah të koncepteve metaforike mbi bazën e të cilave ndërtohen somatizmat në të dyja gjuhët që përqasen, si edhe dallimet në vlerat stilistikore të emetuara nga variantet në shqip dhe gjermanisht.

4.5.1.1 Somatizmat në „Darka e gabuar“ dhe „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“

Përpara se të ndalemi në analizën e somatizmave të evidentuara në veprën e Kadaresë është e nevojshme të përkufizojmë termin *koncept metaforik*, që do ta përdorim në

[732] Christophe, A., 2004, f. 25.
[733] Shih, Földes, Csaba, Über die somatischen Phraseologismen der deutschen, russischen und ungarischen Sprache. Versuch einer konfrontativen Analyse, në, *Germanistisches Jahrbuch DDr-UVR. Hrsg. vom Deutschlektorat beim Kultur- und Informationszentrum der DDR in Budapest. Bd. 4*. Budapest. 1985, f. 18-40, këtu, f. 21.
[734] Po aty, f. 21.
[735] Shih, Ullmann, Stephen, *Semantics. An Introduction on the Science of Meaning*. Oxford, Basil Blackwell, f. 214.

vijimësi, i cili është përkufizuar nga Lieberti nisur nga shembulli i konceptualizimit të metaforës *burim parash* që ka si pikënisje burimin e ujit:

> Auf der konzeptuellen Ebene gilt, dass eine Konzeptualisierung vorliegt, wenn es ein Paar von Konzepten gibt, dessen zweite Komponente als projiziert von der ersten identifiziert wird. Ein Konzept ist dabei selbst als Paar zu verstehen, bestehend aus einer *Strukturfolie* – hier also die des lienearen Wasserwegs <Anfang,*>, <Weg,*>, <Ende,*> [...] und ein Lexemmenge, hier [Quelle, Fluß, Meer, Regen, Geëässer, Ëolken]
> deren Elemente den „slots“, d.h. den Leerstellen, die hier mit „*“ gekennzeichnet ëurden, der Strukturfolie zugeordnet sind.[736] (Në rrafshin konceptual mund të flasim për një koncept metaforë, nëse ka një çift konceptesh, komponenti i dytë i të cilit, identifikohet si i projektuar nga i pari. Një koncept duhet të kuptohet vetë si çift, i përbërë prej një strukture – këtu, pra, ajo e rrugës lineare të ujit <fillim,*>, <rrugë,*>, <mbarim,*>, [...] dhe një sasie leksemash [burim, rrjedhë, det, reshje, ujëra, re], elementet e së cilës i bashkëlidhen sloteve, dmth., vendeve bosh të strukturës, të shënuara këtu me „*“.)

Përkufizimi i Leibertit shpjegohet në këtë mënyrë: Metaforat formohen nga ndërveprimi me botën, përpunimi i saj, duke krijuar, në këtë mënyrë, një sistem konceptual. Leiberti emërton si koncept metaforik mekanizmin, me anën e të cilit një koncept abstrakt, e konceptojmë me ndihmën e kocepteve konkrete ose anasjelltas Projektimi metaforik ndodh nga sfera konkrete, fizike, sferë e cila quhet edhe sfera dhuruese, burimore në drejtim të sferës abstrakte, jofizike, e quajtur edhe sfera pritëse, qëllimore.

Kjo lloj qasjeje e fiton njohjen e saj në kuadrin e teorisë kognitiviste. Në gjuhësinë kognitiviste, gjuha është pjesë e kognicionit, i cili është koncepti i përgjithshëm që përfshin edhe gjuhën.[737] Gjuha paraqet jo vetëm një nënsistem, por edhe një fenomen shoqërues, epifenomen të proceseve kognitive.[738] Në këtë mënyrë gjuhësia kognitive e sheh gjuhën jo vetëm si mjet njohës, por në të njëjtën mënyrë edhe si rezultat i njohjes së botës, pasqyrë e kësaj njohjeje.[739]

Nga inventarizimi i shprehjeve frazeologjike me një pjesë trupi si përbërëse të tyre kemi konstatuar se në veprën e Kadaresë „Darka e gabuar“ gjejmë somatizma me pjesët e mëposhtme të trupit:

a. gojë
b. sy
c. dorë
d. gisht
e. këmbë

Për arsye të ndeshjes së shpeshtë të frazeologjizmave me gjymtyrë bazë *shpirt* dhe *mendje* në dy romanet e Kadaresë kemi trajtuar në këtë syth edhe frazeologjizma me komponentet e sipërpërmendur.

[736] Liebert, Wolf-Andreas, *Metaphernbereiche der deutschen Alltagssprache. Kognitive Linguistik und die Perspektiven einer kognitiven Lexikographie.* Frankfurt a. Main, Lang, 1992, f. 6.
[737] Shih, po aty, f. 40.
[738] Shih, Schwarz, Monika, *Einführung in die kognitive Linguistik,* Tübingen, Francke, 2008, f. 53.
[739] Shih, Roos, Eckhard, *Idiom und Idiomatik. Ein sprachliches Phänomen im Lichte der kognitiven Linguistik und der Gestalttheorie*. Aachen, Shaker, 20012, f. 121.

f. shpirt
g. mendje

Përfytyrimet tona të përditshme metaforike bazohen në imazhe. Për të gjitha somatizmat në veprat “Darka e gabuar” dhe “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” mund të themi se konceptet metaforike të tyre janë të lidhura me imazhe dhe përfytyrime që kemi për pjesët përkatëse të trupit. Ato pasqyrojnë funksione të organeve me të cilat lidhen, madhësinë dhe gjendjen e tyre. Kështu, p.sh., goja është për të folur, shprehur mendime, sytë për të parë, për të shquar, duart për të kapur, vepruar, këmbët për të lëvizur. Nga ana tjetër, nëpërmjet somatizmave shprehen dhe përshkruhen gjendje emocionale, karaktere, veprime. Emocionet që verbalizohen përmes somatizmave mund të jenë më universale. Megjthëse emocionet dhe komponentet emocionale në pamje të parë të krijojnë përshtypjen të jenë universale, “ato janë – shprehen Grau/Keil, - procese kuturore, të cilat u nënshtrohen risive të shumëllojshme shoqërore, tekniko-mediale”.[740] Për këtë Damasio jep një sqarim neurobiologjik: “Emocionet janë reagime trupore si pasojë e gjendjeve neurale, të cilat variojnë pa dyshim në varësi të kulturave dhe përvojave, sepse ndonjëri mund të frikësohet nga gjëra, të cilat nuk frikësojnë të tjerët”.[741] Këtu duhet të qëmtojmë dy aspekte: Nga njëra anë, emocioneve u jepen rëndësi jo e njëjtë në grupe kulturore të ndryshme. Disa kultura mbështesin shprehjen emocionale dhe vlerësojnë pozitivisht shprehjen e tyre, në disa të tjera, njerëzit socializohen dhe janë të përmbajtur në shprehjen e emocioneve. Nga ana tjetër, në gjuhë të ndyshme emocionet kodohen në rrafshe të ndryshme të sistemit të gjuhës dhe lidhen apo vendosin lidhje me imazhe të ndyshme, konceptualizohen ndryshe.[742]

4.5.1.1.1 Metodologjia e analizës

Bazë për analizën tonë kanë shërbyer dy romanet e Kadaresë “Darka e gabuar” dhe “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” dhe përkthimet e tyre në gjermanisht. Për librin “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” përqasen tri variante: origjinali i Kadaresë, varianti i përkthyer nga J. Röhm dhe ai i përkthyer nga O. Buchholz/W. Fiedler.

Për të analizuar njësitë frazeologjike të përzgjedhura jemi nisur nga pyetja se mbi bazën e cilit koncept metaforik janë ndërtuar kuptimet e somatizmave në gjuhën shqipe. Gjegjësja në gjermanisht do të përqaset me atë të gjuhës shqipe. Nga kjo përqasje mendojmë të evidentojmë dhe sqarojmë çështjen e koncepteve universale dhe ato specikfike në secilën gjuhë.

Gjatë përqasjes së varianteve të somatizmave në shqip dhe në gjermanisht do të synojmë t`i japim përgjigje pyetjeve:

- cili koncept metaforik shërben si bazë për ndërtimin e somatizmave të skeduara në variantin në shqip dhe në përkthimin e tij në gjermanisht;
- ç´lloj ekuivalence vendosin midis tyre konceptet metaforike të somatizmave të përzgjedhura nga variantet e hetuara.

[740] Grau, Oiver/ Keil, Andreas, *Mediale Emotionen. Zur Lenkung von Gefühlen durch Bild und Sound*, Frankfurt, Fischer, 2005, f. 14.
[741] Damasio, Antonio, *Selbst in der Mensch: Körper, Geist und die Entstehung des menschlichen Bewusstseins*, München, Siedler, 2011, f. 134 e në vijim.
[742] Shih, po aty, f. 134 e në vijim.

Për përgjigjen e pyetjes së dytë kemi hartuar tabela me somatizmat e skeduara nga korpuset, në njërën prej kolonave të së cilës kemi shkruar edhe llojin e ekuivalencës së vendosur. Rastet e ekuivalencës së plotë janë shembuj në të cilat konceptet metaforike mbi të cilat ndërtohen somatizmat dhe mjetet gjuhësore shprehëse të tyre janë të njëjta midis origjinalit dhe përkthimit/varianteve të përkthimit. Raste të ekuivalencës së pjesshme kemi klasifikuar ato shembuj konceptet metaforike të të cilave janë të njëjta ose aktivizohen nga leksema që i përkasin së njëjtës fushë leksikore.
Shënimi “aspak”i referohet mungesës së koncepteve metaforike në përkthim, d.m.th., emërtimit të drejtpërdrejtë në gjermanisht dhe pa koncepte metaforike të procesit, ndodhisë, që në veprën e Kadaresë në gjuhën shqipe shenjohet me një somatizëm.

Në disa raste do të ndalemi për t`i analizur somatizmat në drejtim të stilit dhe të veçorive tekstore të tyre.

4.5.2 Somatizmat me pjesë të trupit të njeriut *gojën*

Te romani “Darka e gabuar” gjejmë frazeologjizmat e mëposhtme me pjesë përbërëse të tyre *gojën*:

Tabela 1

I. Kadare “Darka e gabuar”	*J. Röhm „Ein folgenschwerer Abend“*	*Lloji i ekuivalencës*
..*goja* kishte nisur të lëshonte lëng, si ujkut përballë një qengji.[743]	..und ëahrscheinlich *tropfte ihr bereits das Maul* wie dem Wolf beim Anblick eines zärten Lämmleins...[744] (dhe ndoshta asaj tashmë goja i pikonte ashtu si ujkut gjatë shfaqjes së një qengj të njomë).	e pjesshme
... i la të gjithë *gojë*hapur [745]	... machte alle sprachlos [746] (i la të gjithë pa fjalë)	e pjesshme
...Kjo fjalë ishte në *gojë të të gjithëve*[747]	Alle teilten diese Meinung[748] (të gjithë ndanin këtë mendim .	e pjesshme
...siç thoshin *gojët e liga*[749]	... wie *böse Zungen* behaupteten [750] (siç pretendonin gjuhët e liga).	e pjesshme

Tabela 2

I. Kadareja	J. Röhmi	O. Buchholzi/ B. Fiedleri	Lloji i ekuivalencës
O, si do të mbeteshin *gojë* hapur shqiptarët që mbanin kaq shumë ombrella në duar...[751]	Keine Frage, die Albaner, diese Ansammlung von Schirmträgern *würde das große Staunen überkommen*[752] (Pa diskutim, shqiptarët një turme ombrellambjatësish do t’i mbulonte habia e madhe)...	Pah, diesen Albanern, von denen so viele mit Regenschirmen herumliefen, *würden vor Staunen die Augen übergehen*[753] (Ah, këtyre shqiptarëve, prej të	-aspak -aspak

[743] *Darka e gabuar*, f. 12.
[744] *Ein folgenschwerer Abend*, f. 8.
[745] *Darka e gabuar*, f. 21.
[746] *Ein folgenschwerer Abend*, f. 16.
[747] *Darka e gabuar*, f. 77.
[748] *Ein folgenschwerer Abend*, f. 64.
[749] *Darka e gabuar*, f. 106.
[750] *Darka e gabuar*, f. 91.
[751] *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 13
[752] Röhm, J., *General der toten Armee*, f. 15.
[753] Buchholz, O.,/Fiedler, W., *General der toten Armee*, f.12.

		cilëve shumica vërdalliseshin me ombrella, do t'u dilnin sytë nga habia) ...	
… nuk e *hapi gojën*, vetëm na vështronte sikur donte të thoshte...[754]	...aber er *tat den Mund nicht auf* [755] (nuk e hapi gojën).	... aber er tat den Mund nicht auf [756] (nuk e hapi gojën).	-e plotë -e plotë
...një *fjalë goje* koleg, por pa mendojeni pak më konkretisht[757]	So einfach ist das nicht, Herr Kolege[758] (kaq e lehtë nuk është kjo, zoti koleg)...	... das sagt sich so leicht, Herr Kolege, aber stellen sie sich doch einmal konkret vor...[759] (kjo thuhet kaq lehtë, zoti koleg, por përfytyrojeni njëherë konkretisht)...	-aspak -aspak

Nga hetimi i rasteve të nxjerra nga dy romanet e Kadaresë në shqip dhe varianteve të tyre të përkthyera në gjermanisht konstatojmë se *goja* në gjuhën shqipe konceptualizohet me kuptim të figurshmëm metaforik, si:

- Organ që ka lidhje me shqisën e shijimit, me të ngrënin dhe, si e tillë, drejton proceset që sinjalizojnë këtë ndjenjë apo shijim.

Në njësinë frazeologjike *goja kishte nisur t`i lëshonte lëng* gjejmë konceptualizimin e këtij organi si pikënisje e të ushqyerit, i lidhur ngushtë me shqisën e të shijuarit.[760] Në gjermanisht gjegjësja ekuivalente e plotë me gjuhën shqipe do të ishte: *jmdm läuft das Wasser im Mund zusammen*[761] (dikujt i formohet uji në gojë). Krahasimi që vijon pas shprehjesh frazeologjike në gjermanisht lejon përkthyesin të përzgjedhë leksema sinonime për të transmetuar të njëjtin konceptualizim të gojës. Kur themi leksema sinonime kemi parasysh që sigurisht ka ndryshime në rrafshe të ndryshme të kuptimeve të emetuara. Diferenca kuptimore konstatojmë jo vetëm midis leksemave gjegjëse *gojë – das Maul* (emërtim i organit për përtypje vetëm te kafshët) *lëshoj lëng – tropfen* (pikon), por edhe në formulimin e krahasimit në të dyja gjuhët. Në shqip forma e krahasimit është eliptike (mungon shprehja e veprimit), në gjermanisht veprimi shprehet me emër të prejardhur nga folja përkatëse *anblicken → Anblick*. Gjymtyra e fjalisë në gjermanisht *beim Anblick* (gjatë vështrimit) ka vlerën e një fjalie të nënrenditur kohore me ngjyrime kushtore, e cila përcakton kohën dhe rastin kur ndodh procesi i lëngëzimit të gojës. Mjetet leksikore për shprehjen e krahasimit kushtëzojnë në gjermanisht edhe përzgjedhjen e leksemës për emërtimin e organit përtypës: *das Maul*. Në gjuhën gjermane kjo leksemë emërton këtë organ vetëm tek kafshët. Në rastet kur përdoret për emërtimin e organit të njerëzve, emeton komponente konotative vlerësimi negative, që i bashkëngjiten atyre denotative.

[754] *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 160.
[755] Röhm, J., *General der toten Armee*, f. 194.
[756] Buchholz, O.,/Fiedler, W., *General der toten Armee*, f. 153.
[757] *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 212.
[758] Röhm, J., *General der toten Armee*, f. 267.
[759] Buchholz, O.,/Fiedler, W., *General der toten Armee*, f. 199.
[760] Në shqip ky konceptualizim gjendet edhe në njësitë frazeologjike si: *ma do barku*.
[761] Shih, Duden Redewendungen, Band 11, f. 843.

Ekspresiviteti i somatizmit *kishte filluar t'i lëshonte lëng* qëndron në vlerësimin negativ të personave që janë subjekte të këtij procesi, dmth., të ushtrisë gjermane. Edhe në gjermanisht transmetohet i njëjti vlerësim.

Interesant është konceptualizimi i gojës në të dyja gjuhët si organ i aparatit të të folurit që përdoret për të nyjëtuar. Shprehja frazeologjike e Kadaresë *hap gojën* përkthehet me një somatizëm me të njëtën pjesë përbërëse edhe në gjermanisht *tat den Mund auf.*

Somatizma me pjesë të trupit të njeriut shërbejnë jo vetëm për të treguar konceptualizime të pjesëve të trupit të njeriut në kultura dhe etni të ndryshme, por edhe për të emërtuar dhe shprehur sjellje njerëzore, gjendje, veprime dhe karakteristika të njeriut.

Kinegramet,[762] e përdorura me organin *gojë* shërbejnë jo vetëm për të përshkruar mimikën e fytyrës, por edhe për të vlerësuar proceset/veprimet si pozitive apo negative.

Në të dyja romanet e Kadaresë „Darka e gabuar“ dhe „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ kemi evidentuar njësinë frazeologjike *lë, mbetem gojëhapur*, që shpreh ndjenjën emocionale të habisë. Variantet shqip dhe gjermanisht të shprehjes së kësaj ndjenjeje janë:

shqip	gjermanisht
- i la të gjithë *gojë*hapur	machte alle sprachlos[763]
- O, si do të mbeteshin *gojë* hapur shqiptarët	würde das große Staunen überkommen[764]
	würden vor Staunen die Augen übergehen[765]

Nga përqasja e gjegjesve në të dyja gjuhët konstatojmë:

- Variante të ndryshme në gjuhën shqipe të kombinimit të leksemave *gojë* dhe *hapur*: njëherë si kompozitë *gojëhapur*, njëherë si togfjalësh i tipit *emër + mbiemër*. Të dyja format emërtojnë emocionin e habisë.
- Në gjermanisht nuk mund të shprehet ndjenja e habisë përmes një somatizmi me pjesë të trupit të njeriut *gojën*. Përkthyesit përdorin njësi frazeologjike ose somatizëm me pjesë tjetër të trupit të njeriut: *syrin*. Shkalla e idiomaticitetit të shprehjes në gjermanisht është më e lartë. Ndërsa në shqip shprehja e ndjenjës së habisë përmes somatizmave me pjesë të trupit *gojën* ka lidhje me shprehjen dhe mimikën e fytyrës, pozicionin e gojës, në gjermanisht kjo lidhje nuk është kaq e dukshme. Somatizmi *würden die Augen übergehen(i dolën sytë)* i përdorur nga përkthyesit Fiedler/Buchholz është në shqip polisemik. Ai përdoret për të përcaktuar një gjendje shumë të mundimshme, një tmerr apo

[762] Dobrovol´skij/Pirainen e quajnë grupin e frazeologjizmave të cilat kanë si mekanizëm motivimi sjellje të konvencionalizuara jogjuhësore, siç janë gjestet apo pozicionimi i pjesëve të trupit si grupi i somatizmave që kanë element motivues kinegramet.[762] Dobrovols´kij, Dimitrij/ Piirainen, Elisabeth. Zur Theori der Phraseologie. Kognitive und kulturelle Aspekte. Tübingen, 2009, f. 27.
[763] Röhm, Joachim, Ein folgenschwerer Abend.
[764] Röhm, Joachim, General der toten Armee.
[765] Buchholz, Oda/Fiedler, Wilfried, General der toten Armee.

edhe një ndjenjë habie. Ekspresiviteti i këtij somatizmi qëndron në ironizimin e gjeneralit dhe në vënien në lojë të misionit të tij të zhvarrimit.

- Në kotekste të ndryshme, e njëjta njësi frazeologjike emeton kuptime jo të njëjta. Në romanin „Darka e gabuar“ togu që shqyrtojmë përkthehet *machte alle sprachlos* (i la të gjithë pa fjalë). Në gjermanisht konceptualizohet, pra, pamundësia e nyjëtimit të fjalëve si rrjedhojë e habisë. Dmth, masa e habisë kushtëzon pamundësinë e të menduarit dhe të të shprehurit. Në shqip, njësia frazeologjike *lë gojëhapur* lidhet me mimikën e fytyrës në rastet e kaptimit të njeriut nga ndjenja e habisë. Ky shpjegim qartëson edhe lidhjen dhe konceptualizimin jo të njëjtë të ndjenjës së habisë në romanin në shqip dhe në gjermanisht: në shqip ajo lidhet me mimikën e fytyrës, ndërsa në gjermanisht me proceset konjitive që drejtojnë artikulimin e mendimeve. Ekspresiviteti që konstatuam në rastin e romanit „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ mungon në përdorimin e somatizmit në romanin „Darka e gabuar“.
  Përkthimi i somatizmit të Kadaresë në romanin „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ nga përkthyesit gjermanë në dy mënyra të ndryshme tregon dhe receptimin dhe konceptualizimin jo të njëjtë të tij edhe nga folës të së njëjtës gjuhë. Buchholz/Fiedleri e konceptualizojnë dhe e emërtojnë këtë ndjenjë drejtpërdrejt në përkthimin e tij. Masën dhe intensitetin e saj ai e thekson në mënyrë të dyfishtë: përmes përcaktimit të habisë nga mbiemri i madh dhe përdorimit të metaforës së leksikalizuar *mbuloj*.
  Röhmi e përkthen të njëjtën njësi frazeologjike me një somatizëm me pjesë të trupit të njeriut *syrin*. Edhe ai e konceptualizon dhe lidh shprehjen e ndjenjës së habisë me pamjen dhe mimikën e fytyrës, por, ndryshe nga Kadare, me sytë. Përpos kësaj, ai përdor dhe leksemën *habi,* e cila emërton drejtpërdrejt ndjenjën përkatëse. Dallime midis origjinalit në shqip dhe përkthimit nga Röhmi ka edhe në regjistrin e gjuhës: folja *übergehen* është e stilit libror, kështu edhe gjithë togu është i ligjërimit libror. Në shqip, njësia frazeologjike është e ligjërimit bisedor.
  Pra, themi si edhe për metaforat, që përkthyesit e somatizmave në romanet e hetuara duhet të kombinojnë dijen semantike me atë komunikativo-pragmatike në diskurs.

- Somatizmi *një fjalë goje,* i skeduar nga romani “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, që lidhet me konceptualizimin e procesit të artikulimit të fjalëve si të vështirë, edhe pse në dukje jo të tillë, mungon në përkthimin në gjuhën gjermane. Mjetet gjuhësore të përdorura nga përkthyesit në të dyja variantet *so einfach ist das nicht (nuk është kaq e lehtë); das sagt sich so leicht (thuhet kaq lehtë)* shprehin drejtpërdrejt (mbi bazën e parimit të kombinimit të kuptimit të leksemave të sintagmës) mendimin e gjenerallejtënantit lidhur me pyetjen e shtruar nga gjenerali italian mbi mundësinë e kthimit të eshtrave të ushtarëve italianë, të marrë nga varrmihësit gjermanë.

- Somatizmi *në gojë të të gjithëve* i referohet gjendjes së të qenurit i njohur.

Një konceptualizim i tillë gjendet në veprën e Kadaresë “Darka e gabuar” në shprehjen frazeologjike *kjo fjalë ishte në gojë të të gjithëve.*
Një konceptualizim për gojën si organ që të bën të njohur, gjendet edhe në gjermanisht në shprehjen frazeologjike *in aller Munde sein* (në gojë të të gjithëve, shumë i njohur), shprehje e cila e ka origjinën nga libri i shkrimtarit Theodor Thieß

“Im Reich der Dämonen”.[766] Por, përkthyesit e dy veprave të sipërpërmendura e transmetojnë të njëjtin konceptualizim me mjete të tjera gjuhësore: ose e emërtojnë procesin e të shprehurit të mendimeve me një frazeologjizëm, shkalla e idiomaticitetit të të cilës është më e vogël se në somatizmin në shqip, si: *alle teilten diese Meinung mit.* Njësia frazeologjike *alle teilten diese Meinung mit* (të gjithë ndanin këtë mendim) emërton procesin e kumtimit të mendimeve. Asnjë prej elementeve përbërëse të kësaj sintagme nuk mbart, ngërthen apo emeton vlerësim të këtij procesi. Ndërsa somatizmi në gjermanisht *in aller Munde sein (në gojë të të gjithëve)* implikon arritje, suksese që çojnë në njohjen dhe vlerësimin e të gjithëve.

Somatizmi në gjermanisht *böse Zungen haben* gjegjës i somatizmit *gojët e liga* emërton një vlerësim të personave që artikulojnë këto mendime.
Gjegjësët përkatëse në shqip dhe gjermanisht shprehin a përdoren për të vlerësuar në të njëjtën mënyrë njerëzit që artikulojnë, duke u nisur nga organe, pjesë të ndryshme të trupit, të cilat janë në raportin pars pro toto (gjuhë-gojë). Somatizmi *siç thonin gojët e liga* implikon një vlerësim të kumtimit të mendimeve. Ai implikon që thëniet janë të pambështetura dhe keqdashëse. Në kotekst, Kadare e përdor këtë thënie për të ironizuar tërë situatën tragji-komike të krijuar në qytetin e pasluftës, në momentin e vendosjes së rendit të ri, kur kishte nisur lufta kundra gjithçkaje që mbante erë borgjeze, madje edhe dy lavireve që në atë kohë shiheshin si mbeturina të rendit të mëparshëm.
Dallime në njësitë frazeologjike gjegjëse në shqip dhe në gjermanisht që analizojmë, paraqesin foljet *them* dhe gjegjësja në përkthim *behaupten*. Përdorimi i foljes *behaupten (pretendoj)* implikon edhe dinstancim të rrëfimtarit nga thënia e përdorur. Kuptimi i foljes *behaupten* ngërthen elemente kuptimore të të shprehurit të mendimeve, gjykimeve të pavërteta si të vërteta.

4.5.3 Somatizma me syrin

Tabela 1: Darka e gabuar

	I. Kadare	J. Röhm	Lloji i ekuivalencës
1	Njerëzit s`po *u besonin syve*[767]	Die Leuten *trauten ihren Augen* nicht[768]	e plotë
2	...me ca *sy të menduar*[769]	...mit *einem nachdenklichen Blick* [770]	e pjesshme
3	...*një hije* e pashpjegueshme *i kalonte* herë pas here *në sy*[771]	...doch *ging* hin und wieder ein unerklärlicher *Schatten über sein Gesicht*[772]	e pjesshme
4	...*me sytë* e saj *të qeshur*[773]	... ihre *lachenden Augen*[774]	e plotë
5	... *Sytë iu mjegulluan* prapë[775]	...*Sein Blick verschleierte sich*, seine Stimme wurde sanft[776]	e pjesshme
6	...me *sy të çakërritur*[777]	...mit *zusammengekniffenen Augen*[778]	e plotë

[766] Shih, Duden Redewendungen, Band 11, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 2002, f. 524.
[767] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 12.
[768] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 9.
[769] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 41.
[770] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 31.
[771] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 43.
[772] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 33.
[773] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 48.
[774] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 38.
[775] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 48.
[776] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 38.
[777] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 53.

7	...*Sytë* e të dyve, që gjer atëherë *nguleshin si gozhdë*, nisën t`i *shmangen* njëri-tjetrit[779]	...*Die Blicke* der beiden, die bisher *ëie verschweißt* gewesen waren, *mieden sich* nun.[780]	e pjesshme
8	...*sytë* e të dyve, *të ftohtë e ngurrues janë mbërthyer* me njëri-tjetrin[781]	...Beider *Blicke, kalt und unnachgiebig, sind* ineinander *verhackt*[782]	e pjesshme
9	...Me kthjellimin e mendjes, sytë, gjithashtu, po f*itonin aftësinë të shikonin* ato që duhej të shihnin[783]	...Am Ende aber klärten sich Blick und Verstand, und man *gewann die Fähigkeit* zurück, *die Dinge so zu sehen, wie sie waren*[784]	e pjesshme
10	...Kosova me Çamërinë nuk ishin veçse *hedhje pluhuri në sy*[785]	...- wenn wir unseren Verstand nicht zusammennehmen	Aspak
11	...*me sy të buhavitur*[786]	...*mit verquollenen Augen*[787]	e plotë
12	...si të donte enkas *ta hante sysh* atë, qyteti kishte cytur ngasjen e kundërt, kishte cënuar nderin e gjermanit kokëverdhë[788]	... mungon	Aspak
13	...Mos *shqyeni sytë*[789]	...Was *schaut ihr* so *überrascht*[790]	aspak
14	...Gjirokastra, *me tejqyrat në sy*, nuk priste veç mbarimin e karvanit çam, por ai, si ta bënte enkas, dukej se po pillte vetveten[791]	...Gjirokastra wartete also, die *Ferngläser vor den Augen*, auf das Ende des Çamentrecks, doch dieser gebar wie zum Trotz immerfort neue Abkömmlinge[792]	e plotë
15	...*Sytë* e doktorit *ishin ngulur* në zbrazëti[793]	...*Der Blick* des Doktors *ëand* ins Leere[794]	e pjesshme
16	...Sytë e Gurametos *u bënë akull*[795]	...Gurametos *Blick wurde eisig*[796]	e pjesshme
17	...*Në sytë e tij* doktor Gurametoja i madh, më në fund, kishte rënë.[797]	...Endlich hatte der große Doktor Gurameto eine Blöße gegeben.[798]	Aspak
18	...si çdo gjë kur teprohej, mu midis ngazëllimit ndodhi ajo që quhej *ngrënia në sy*[799]	...wie so häufig *folgte auf den Überschwung die kalte Dusche*[800]	Aspak
19	...*Sytë* prapë *i shkuan rrëshqitazi* te veglat e vjetra të torturës.[801]	...wieder *schweifte sein Blick über* die alten Folteräerkzeuge[802]	e pjesshme

[778] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 43.
[779] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 55.
[780] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 44.
[781] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 65.
[782] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 53.
[783] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 73.
[784] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 60.
[785] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 75.
[786] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 75.
[787] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 62.
[788] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 77.
[789] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 97.
[790] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 83.
[791] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 102.
[792] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 88.
[793] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 134.
[794] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 116.
[795] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 136.
[796] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 118.
[797] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 136.
[798] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 118.
[799] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 120.
[800] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 103.
[801] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 140.
[802] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 121.

20	...i burgosuri *picërroi sytë*[803]	...Der Gefangene *runzelte die Stirn*[804]	Aspak
21	...*sytë* e hetuesit rus *u ndriçuan si shpuzë* [805]	...*Die Augen* ihres russischen Kollegen *begannen zu funkeln*[806]	e plotë
22	...hetuesit shqiptarë *shqyen sytë*[807]	...die albanischen Agenten *schauten* ihn *bewundernd an*[808]	Aspak
23	...*Sytë* e çelët si prej kukulle të rusit *vështronin të qeshur*[809]	...Ein ironisches Lächeln spielte um die hellen Puppenaugen des Russen[810]	e plotë
24	...Por adhurimi në sytë e tyre vazhdonte të ishte aq i dukshëm, saqë tjetri, me *sytë* e tij *të qelqtë prej kukulle*, qeshi[811]	...Doch die beiden trugen ihre Beëunderung so offen zur Schau, *dass das Lachen nicht aus seinem gläsernen Puppenaugen wich*[812]	e plotë
25	...*Sytë* e hetuesit e ato të të burgosurit *u ndeshën* në një grimë kohe[813]	...Der Gefangene *ërarf* den Agenten *einen kurzen Blick zu*[814]	e pjesshme
26	...*Sytë* e tij *të zbrazët u ngulën* mbi hetuesit, si për të marrë vesh diçka. Por *të tyret* ishin po aq *të zbrazët*[815]	...*Sein Blick richtete sich* fragend *auf* die Agenten, doch *deren Augen waren ebenso leer* wie seine.[816]	e plotë
27	...Të gjithë e dinin, e ndienin praninë e tij, veç *sytë s´e kapnin* dot[817]	...Alle wußten darum, alle spürten seine Gegenwart, nur *sehen konnte man es nicht*[818]	Aspak
28	...*Në sytë* e Arjan Ciut iu duk se dallonte *një shenjë të pazbërthyeshme*[819]	...*In Arjan Cius Augen* glaubte er *einen undeutbaren Schimmer* zu entdecken.[820]	e plotë
29	...Arjan Ciu s´dinte ku t´*i çonte sytë*[821]	...Arjan Ciu *vermied seinen Blick*[822]	e pjesshme
30	...*Sytë* e të dyve *ngrirazi vështronin* fytyrën e të burgosurit[823]	...*Beider Blicke hingen wie festgefroren* an Gesicht des Gefangenen[824]	e pjesshme
31	Herë njërit, herë tjetrit *sytë u nguleshin* në larginë,[825]	Immer wieder *schauten* sie in die Ferne, dorthin,.[826]	e pjesshme
32	Dy-tri herë iu afrua dritares, *për të ndjekur me sy* gjarpërimin e tyre sipër burgut[827]	... Mehrmals ging er zum Fenster und *schaute zu*, wie sich oberhalb des Gefängnisses Blitze über den Himmel schlängelten[828]	e pjesshme

[803] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 152.
[804] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 132.
[805] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 157.
[806] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 136.
[807] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 157.
[808] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 137.
[809] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 158.
[810] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 137.
[811] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 158.
[812] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 138.
[813] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 162.
[814] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 141.
[815] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 166.
[816] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 145.
[817] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 177.
[818] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 154.
[819] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 181.
[820] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 158.
[821] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 182
[822] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 158.
[823] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 185.
[824] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 161.
[825] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 185.
[826] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 161.
[827] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 171.
[828] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 149.

33	...*Sytë* e të burgosurit ngjanin edhe më *të turbullt* prej moskuptimit[829]	...Der Gefangene schaute ihn *aus matten Augen* verständnislos an[830]	e plotë

Gjenerali i ushtrisë së vdekur
Tabela 2

	I. Kadare	J. Röhm	O. Buchholz/ W. Fiedler	Lloji i ekuivalencës
1	...gjenerali i *kishte ngulur sytë* grumbullit të plisave që sa vinte rritej në këmbët e punëtorit[831]	*Der Blick* des Generals *blieb auf* immer größer werdenden Erdhaufen vor den Füßen des Arbeiters gerichtet[832]	Der General *starrte auf* den wachsenden Erdhaufen zu Füßen des Arbeiters.[833]	-e pjesshme -e pjesshme
2	...një mitralim *nën sytë e tyre indiferentë*[834]	*Zu gleichgültigen Blicken* unter getuschten wimpern hervor klang es wie Maschinengewehrfeuer[835]	*Unter* ihren *gleichgültigen*, mit Lidschatten *bemalten Augen* hatte es beinahe wie das Rattern von Maschinnengewehren geklungen.[836]	-e pjesshme -e plotë
3	…që vështronin *me sy të shqyer* sikur të qe ngjallur Krishti[837]	…und starrten ihn wie ein wiederauferstandenen Jesus Christus *mit aufgerissenen Augen* an[838]	...blickten ihn *mit großen Augen* ungläubig an, als sei Christus wiederauferstanden.[839]	- e plotë - e plotë
4	Djali i vogël *kishte shqyer sytë nga habia* mu përpara gjeneralit.[840]	Der kleine Junge stand vor dem General und *staunte* ihn *mit weit aufgerisennen Augen*[841]	Der kleine Junge stand *staunend, mit weit aufgerissenen Augen* dicht vor dem General.[842]	- e plotë - e plotë
5	Shiko o derëzi, ... më *nguli* ata *sy të rreptë dhe shpues*[843]	- Mungon	Hör mal, du Unglücksrabe, ... und *musterte* mich mit *einem strengen, durchdringenden Blick*[844]	- aspak - e pjesshme
6	*Përpara syve* filluan t'i *vallëzonin* përsëri reflekset e mërzitshme të tokës[845]	*...Vor seinen Augen* begannen schon wieder in verdrießlichen Steinwüsten verstreute Gräber *zu tanzen*[846]	*...vor seinen Augen tanzten* erneut die immer wiederkehrenden Reflexe des Bodens und der Gräber[847]	- e plotë - e plotë

[829] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 174.
[830] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 152.
[831] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 14.
[832] Röhm, J., General der toten Armee, f. 17.
[833] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 12.
[834] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 31.
[835] Röhm, J., General der toten Armee, f. 39.
[836] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 28.
[837] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 63.
[838] Röhm, J., General der toten Armee, f. 81.
[839] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 60.
[840] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 85.
[841] Röhm, J., General der toten Armee, f. 110
[842] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 83.
[843] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 91.
[844] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 87.
[845] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 118.
[846] Röhm, J., General der toten Armee, f. 143.
[847] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 113.

7	*...sytë i shkrepëtinë nga zemërimi...*[848]	*mit zornig funkelten Augen...*[849]	*...seine Augen funkelten zornig...*[850]	- e plotë - e plotë
8	*...ngriti sytë të shuar* në drejtim të kodrinave...[851]	*...wandte* seine *hellen, trüben Augen* der Hügelkette *zu* ...[852](S.171)	*...blickte mit* seinen weißlich *erloschenen Augen...*[853]	- e plotë - e plotë
9	*...duke perënduar sytë e lodhur...*[854]	...um das Gefühl der Beklommenheit wiederkehren zu lassen...[855]	*Die müden Augen fielen* ihm beinahe *zu...*[856]	- aspak - e plotë
10	Ndërsa ai fliste, *sytë e akullt të priftit, nuk i ndaheshin...*[857]	Während er redete *maß ihn der Priester mit einem eißigen Blick....*[858]	*..die eiskalten Augen des Priesters starr...*[859]	- e pjesshme - e plotë
11	Tani ai ndjente si kalamajtë i *kishin ngulur sytë* që *u shkëlqenin nga* një heshtje e gëzuar[860]	Jetzt *bemerkte er* auch die Kinder, die ihn *in stummen Vergnügen anstrahlten*.[861]	*..ihre Augen*, die *von einer stillen Freude wiederglänzten...*[862]	- e pjesshme - e plotë
12	Diçka nga rroba e zëzë e tij nisi t´*i vallëzonte përpara syve*[863]	Die schwarze Soutane begann bereits *vor seinen Augen zu tanzen*.[864]	Die schwarze Soutane *tanzte vor seinen Augen...*[865]	- e plotë - e plotë
13	*...sytë e tij takuan* prapë *sytë e priftit...*[866]	*Ihre Blicke kreuzten sich.*[867]	*...seine Augen suchten den Blick des Priesters,...*[868]	- e pjesshme - e pjesshme
14	…ju *sheh* dot *me sy*[869]	...sie *könne* ihren *Anblick nicht ertragen,...*[870]	...ihren *Anblick* nicht *ertragen könnte,...*[871]	- e pjesshme - e pjesshme
15	Gjenerali *hodhi sytë e turbulluar* përreth dhe pa përsëri atë mizëri njerëzish që lëviznin, vallëzonin, qeshnin[872]	Der General *ließ seinen besorgten Blick* über die sich drängende, tanzende, lachende Menge *wandern,...*[873]	Der General *ließ seinen Blick* rasch über die Männer und die jungen Burschen *gleiten....*[874]	- e pjesshme - e pjesshme
16	*sytë e gjeneralit rrëshqitën* nga plaka	Der Blick des Generals *wanderte von der alten*	*..die Augen* des Generals *hushten über die Alte*	- e pjesshme - e plotë

[848] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 134.
[849] Röhm, J., General der toten Armee, f. 163.
[850] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 129.
[851] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f.142.
[852] Röhm, J., General der toten Armee, f. 171.
[853] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 137.
[854] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 169.
[855] Röhm, J., General der toten Armee, f. 209.
[856] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 159.
[857] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 175.
[858] Röhm, J., General der toten Armee, f. 220.
[859] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 165.
[860] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 178.
[861] Röhm, J., General der toten Armee, f. 223.
[862] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 168.
[863] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 181.
[864][864] Röhm, J., General der toten Armee, f. 226.
[865] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 170.
[866] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 189.
[867] Röhm, J., General der toten Armee, f. 238.
[868] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 178.
[869] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 189.
[870] Röhm, J., General der toten Armee, f.238.
[871] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 178.
[872] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 190.
[873] Röhm, J., General der toten Armee, f. 240.
[874] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 177

	Nicë dhe *u ngulën* te thesi[875]	*Nica zu dem Sack,...*[876]	*hinweg* und *blieben an dem Sack haften.*[877]	
17	*..hodhën sytë* nga lindja[878]	...und *schauten nach* Osten.[879]	...und *blickten nach* Osten.[880]	- e pjesshme - e pjesshme
18	Prifti e *vështroi me sy të egër*[881]	Der Priester *warf ihm einen zornigen Blick zu*[882]...	*..mit einem zornigen Blick...*[883]	- e pjesshme - e pjesshme
19	...dhe gjenerali nuk ia hiqte sytë[884]	Der General mußte ihn unentwegt anschauen.[885]	..der General konnte den Blick nicht von ihm wenden....[886]	- e pjesshme - e pjesshme
20	*..duke e ndjekur me sy* të fejuarin[887]	...und *schaute* ihrem Verlobten beim Training *zu.*[888]	..und *verfolgte ihren Verlobten mit den Blicken...*[889]	- e pjesshme - e pjesshme
21	*sytë* i kishte akoma më *të* kthjellët, megjithëse *pak të ftohtë*[890]	...und auch ihre *Augen* waren blau, allerdings eine Spur heller und *ein bißchen kühl.*[891]	*..ihre Augen* waren von einem noch schöneren Blau, wenn auch *ein bißchen kühl...*[892]	- e plotë - e plotë
22	Tjetri përsëri ia *nguli sytë* e tij *të habitur*[893]	Der andere *schaute* ihn *fragend an*, sagte aber nichts.[894]	Sein Gesprächspartner *blickte* ihn wieder *erstaunt an.*[895]	- e pjesshme - e pjesshme
23	*..nguli sytë i habitur*[896]	Der General *schaute ihn verwundert an.*[897]	*..starrte* ihn *verdutzt an.*[898]	- e pjesshme - e pjesshme
24	*..sytë i shkëlqyen*[899]	*Seine Augen* begannen zu *glänzen.*[900]	*..seine Augen glänzten.*[901]	- e plotë - e plotë

Numri i somatizmave të gjetura në romanet e marra për analizë për këtë qëllim është relativisht i lartë, krahasuar me somatizma me pjesë të tjera të trupit. Hetimi i somatizmave të përzgjedhura dhe të paraqitura në tabelat 1 dhe 2 tregon se somatizmat me pjesë të trupit të njeriut *syrin* përdoren jo vetëm për të konceptualizuar këtë shqisë, por edhe për të përshkruar, shprehur ndjenja, emocione dhe vlerësime.

[875] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 192.
[876] Röhm, J., General der toten Armee, f. 242.
[877] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 182.
[878] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 196.
[879] Röhm, J., General der toten Armee, f.248.
[880] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 186.
[881] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 199.
[882] Röhm, J., General der toten Armee, f.252.
[883] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 189.
[884] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 205.
[885] Röhm, J., General der toten Armee, f. 260.
[886] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 194.
[887] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 219.
[888] Röhm, J., General der toten Armee, f.274.
[889] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 205.
[890] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 219.
[891] Röhm, J., General der toten Armee, f. 274.
[892] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 206.
[893] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 221.
[894] Röhm, J., General der toten Armeef. 278.
[895] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 208.
[896] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 226.
[897] Röhm, J., General der toten Armee, f. 285.
[898] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 212.
[899] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 230.
[900] Röhm, J., General der toten Armee, f. 291.
[901] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 217.

Sasia e somatizmave që përdoren për përshkrimin e gjendjeve emocionale dhe shprehjen e ndjenjave, emocioneve është më i lartë se rastet e njësive frazeologjike të cilat konceptualizojnë këtë organ si shqisë të të parit dhe si aftësi për të parë.
Le t'i shohim më nga afër njësitë frazeologjike me pjesë të trupit të njeriut *syrin* në dy romanet e sipërpërmendur.
Syri qëndron:

- Për të konceptualizuar të parin, shikimin

Në somatizmat: *sytë nguleshin; sytë iu mjegulluan, sytë i shmangen njëri-tjetrit; sytë ishin ngulur; sytë i shkuan; sytë u ndeshën; sytë u nguleshin; sytë s'e kapnin, s'di ku t' i çoj sytë, sytë vështronin, sytë nguleshin, për të ndjekur me sy;i kishte ngulur sytë, sytë e gjeneralit takuan sytë e priftit, sytë rrëshqitën dhe u ngulën; hodhën sytë nga lindja, nuk ia hiqte sytë, duke e ndjekur me sy* shprehen aspekte, intensitete, kohëzgjatje të ndryshme të procesit të të parit, të shikimit. Është më së shumti folja shoqëruese e cila përcakton kuptimet e ndryshme të emetuara nga somatizmat e sipërpërmendur. Kështu psh., foljet *ngul, ndjek, nuk i heq sytë* përcaktojnë kohëzgjatje të konsiderueshme të vështrimit dhe aspekte të ndryshme të procesit të të shikuarit: fillim, vazhdim. Foljet e tjera, si *shmang, shkuan rrëshqitazi*, *rrëshqitën, hedh* përcaktojnë një kohëzgjatje të shkurtër të procesit dhe e paraqesin vështrimin në momente të ndryshme. Dallimi tjetër midis somatizmave të sipërpërmendur qëndron edhe në shkallën e ndryshme të ekspresivitetit që emetojnë. Ky ekspresivitet theksohet kur koncepti metaforik që ndërtohet mbi bazën e aftësisë së syrit për të parë kombinohet edhe me metafora të tjera, siç janë *ishin ngulur në zbrazëti, shkuan rrëshqitazi, për të ndjekur gjarpërimin.*
Përqasja e somatizmave të mësipërme me gjegjëset në gjermanisht dëshmon se në përkthim mungojnë somatizma të të njëjtit lloj. Në gjuhën gjermane, koncepti i të parit shprehet në rastet e qëmtuara drejtpërdrejt përmes emrit që emërton procesin e të parit: vështrimin. Sintagmat *Blick* (vështrim) + folje, si: *meiden* (shmang), *wand ins Leere* (iu drejtua zbrazëtirës), *hingen* (nguleshin), *schweifen* (rrëshqet) ose edhe + *sein* (me qenë) + ndajfolje (*wie verschweißt* - si të salduara) shprehin përmes kombinimeve të emrit *vështrim* me metaforat, intesitete dhe kohëzgjatje të ndryshme të të parit.
Në gjermanisht, në shumicën e rasteve të evidentuara *syri* që qëndron për vështrimin përkthehet me emrin vështrim. Përpos emrit që transmeton në përkthim veprimin e të parit ndeshim edhe folje si: *schauen (shikoj), zuschauen, starren(ngul)* që verbalizojnë vështrimin.Të gjitha rastet kur kjo shqisë konceptualizohet si aftësi për të pare, ekuivalenca e vendosur midis varianteve shqip-gjermanisht është e pjesshme.
Kërkimi edhe në fjalorët *Duden Redewendungen, Fjalori frazeologjik gjermanisht-shqip, Lexikon der Redensarten*[902] dëshmon se në gjuhën gjermane nuk gjejmë somatizma me *syrin*, në të cilat kjo shqisë qëndron për të parin.

Në shumë raste, në romanet e analizuara gjejmë somatizma në të cilat syri qëndron për të konceptualizuar vështrimin, por, nga ana tjetër, në të njëjtën thënie shërben edhe për të shprehur gjendje emocionale. Shembujt: *sytë e ftohtë dhe ngurrues janë mbërthyer (8), sytë e tij të zbrazët u ngulën (26), më nguli ata sy të rreptë dhe shpues (5), ngriti sytë të shuar (8), kishin ngulur sytë që u shkëlqenin (11), hodhi sytë e turbulluar (15), vështroi me sy të egër (18), nguli sytë i habitur (23)* përkthehen në

[902] Shih, *Duden Redewendungen*, Band 11, f. 69-79; *Lexikon der Redensarten. Herkunft und Bedeutung deutscher Redewendungen*, Gütersloch/München, 2005, f. 34-38; *Fjalori frazeologjik gjermanisht-shqip*, Tiranë, 1998, f. 20-24.

gjuhën gjermane përmes kombinimeve të emrit *vështrim* me epitetet metafora dhe foljen më së shumti me kuptim metaforik. Të gjitha këto shembuj dëshmojnë edhe njëherë se është e pamundur në gjermanisht që leksema *sy* të mund përdoret për të konceptualizuar vështrimin. Nga ana tjetër mund të pohojmë se emri *Blick* në gjermanisht mund të kombinohet me epitete metafora që e përcaktojnë dhe cilësojnë mënyrën e vështrimit.

Në somatizmat *një hije e pashpjegueshme i kalonte herë pas here në sy* (3), *sytë fitonin aftësinë të shikonin (9), hedhje pluhuri në sy (10), sy të menduar (2), përpara syve filluan t´i vallëzonin* (6) *diçka nga rroba e zezë e tij nisi t'i vallëzonte përpara syve* (12) syri qëndron për procese konjitive, që lidhen me të menduarin (9) apo paaftësinë për të menduar (10), me aftësinë për të imagjinuar jorealen, të pakapshmen, shfaqjen e asaj që ndodh në nënvetëdije.
Një konceptualizim që e vendos *syrin* në lidhje me proceset konjitive që ndodhin në imagjinatë, gjejmë edhe në përgjegjeset ekuivalente të plota në variantet e përkthyera gjermanisht, si: *vor seinen Augen tanzten erneut die immer wiederkehrenden Reflexe des Bodens und der Gräber (6), die schwarze Soutane tanzte vor seinen Augen (12).*
Si në romanin në shqip, ashtu edhe në përkthimet në gjermanisht këto thënie përdoren për të treguar gjendjen e turbullt të gjeneralit në çaste dehjeje, çaste gjatë të cilave në nënvetëdije luhen ato skenare të përjetuara si trauma apo të dëshiruara si ëndrra nga gjenerali. Janë dy momente thelbësore në misionin e gjeneralit. Reflekset e tokës shqiptare vallëzojnë para syve të gjeneralit, i cili është sfilitur së kërkuari dhe së nxjerri prej saj ushtarët e armatës së tij. Ai përjeton një vegulli.
Interesant te Kadareja është edhe kombinimi i foljes *vallëzoj* me togun *reflekse të mërzitshme*. Në kuptimin e foljes *vallëzoj* ngërthehen elemente kuptimore që i referohen një gjendjeje të gëzueshme, të hareshme. Por në vetëdijen e gjeneralit kanë filluar të luhen pikërisht ato skenare makthe që ai ka përjetuar në shtegtimin e tij mesjetar të deritanishëm: nga njëra anë, gëzimi për zhvarrimin e gjetjen e disa ushtarëve të tij, nga ana tjetër, disfata që ai ndien dhe përjeton kur sheh ushtarët e tij të zhvarrosur në thasë najloni, pra, ushtrinë e tij si ushtri thasësh blu me shirita të bardhë.
Të njëjtën gjendje përjeton ai edhe në momentin e përballjes me plakën Nicë. Rroba e zezë e priftit që i vallëzon para syve është me ngjyrë të njëjtë me atë të plakës Nicë. Kjo rrobë vallëzon po ashtu si edhe përjetimi i çastit në dasmë, kur kërcehet. Paralelizma të tillë shprehen shumë mjeshtërisht nga Kadareja përmes variantit të somatizmit *rroba e zezë e priftit nisi t´i vallëzonte para syve*.
Röhmi dhe Buchholz/Fiedleri i përkthejnë thëniet e Kadaresë duke e dhënë në gjermanisht me një somatizëm me të njëtin koncept metaforik si edhe në shqip. Të dyja thëniet e përkthyera nga O. Buchholz/ W. Fiedleri janë ekuivalente të plota me ato të gjuhës shqipe. Kemi konstatuar që J. Röhmi nuk i qëndron aq besnik variantit të Kadaresë në shqip në thënien *vallëzonin përpara syve reflekset e mërzitshme dhe mbi to varrezat.* Ai e jep thënien në gjuhën gjermane thjesht duke zëvendësuar, duke e plotësuar kallëzuesin me kundrinorin *verstreute Gräber (varre të shpërndarë)* dhe duke përcaktuar mënyrën e kryejes së veprimit të vallëzimit, përkatësisht *në gurë shkretëtire të zymtë* (in verdrießlichen Steinwüsten).

Ndërsa konceptualizimi i syrit si imagjinatë është i pranishëm në të dyja gjuhët, në gjermanisht mungon konceptualizimi i syrit si aftësi, paaftësi për të menduar, për të qartësuar mendimet. Somatizmat *sytë fitonin aftësinë të shikonin ato që duhej të shihnin*, *hedhje pluhuri në sy* nuk përkthehen me gjegjëse ekuivalente në gjermanisht.

J. Röhmi e parafrazon kuptimin e somatizmit dhe e vendos në lidhje me fjalën *Verstand* (logjikë) në shprehjen: *wenn wir den Vertsand nicht zusammennehmen (*nëse ne nuk e përdorim lojikën).

Sytë konceptualizohen edhe si këndvështrim, gjykim. Somatizmi *në sytë e tij ai kishte rënë* i gjetur në romanin „Darka e gabuar“, nuk ka gjegjës në përkthim, edhe pse në gjermanisht e gjejmë të konceptualizuar në të njëtën mënyrë verbalizimin e këndvështrimit. Në *Duden Redewendungen* jepet si njësi frazeologjike shprehja: *in jemandes Augen steigen/sinken (të biesh apo të ngrihesh në sytë e dikujt).*[903] Röhmi përkthen somatizmin me një shprehje frazeologjike të ligjërimit libror: *eine Blöße geben* (tregoj pikën e dobët), e cila devijon në figurshmëri dhe në kuptim nga varianti në shqip. Somatizmi në shqip implikon një qëndresë të doktor Gurametos deri në çastin e ligjërimit dhe, më pas, një thyerje të tij, por me vështirësi. Në gjermanisht folja *tregon* nuk implikon shkallë të lartë qëndrese deri në çastin e thyerjes: ajo nënkupton një natyrshmëri të rrjedhjes së veprimit.
Somatizmi tjetër *në sytë e* përkthehet me një gjegjës me ekuivalencë të plotë në gjermanisht.
Koncepti sipas së cilit *syri* është pasqyrë e proceseve konjitive, gjykimeve që ndodhin në tru apo imagjnatave në nënvetëdije shërben si mekanizëm motivimi për grupin e somatizmave që hetuam më sipër dhe është i pranishëm në të dyja gjuhët. Kjo prani shpjegon edhe ekuivalencën e plotë të vendosur në këto raste.

Somatizmi *ha në sy/ ha në sysh,* dhe varianti *ngrënia në sy,* në të cilin kombinohen leksema *sy* me folje apo emra të fushës leksikore të shijimit flet për një kombinim të fushave leksikore të shqisave të ndryshme. Edhe këtu mund të flasim për dukurinë e sinestezisë. Kombinimi i foljeve, emrave që verbalizojnë të ushqyerin, ngrënien me perceptime që vijnë nga shqisat ndjesore, pamore apo edhe me vlerësime që arrihen si rezultat i shqisave të shikimit nuk është i huaj për kulturën shqiptare. Në kulturën shqiptare është e pranishme metaforika e të ushqyerit, e të ngrënit, në formën *besimi është ushqim*, në shprehjet *s´ma ha zemra, të bësh dikë për vete është të hash*, në: *ma hëngri zemrën*; *ndjenjat janë ushqim*, p.sh.: *ma ngopi zemrën.*[904] Aftësia evokuese që ka somatizmi në shqip përforcohet nga kombinimi i metaforikës së të ngrënit, të pranishëm në gjuhën shqipe me konceptin e lakmisë së cilës i referohet gjymtyra *sy*. Mendojmë se mekanizimi i motivimit për *ha në sy* e ka origjinën nga kultura orientale, turke, sipas së cilës në sytë, në vështrimin e njerëzve ka fuqi magjike për t´u shkaktuar njerëzve të tjerë fatkeqësi, vdekje apo dëmtim të pasurisë. Kjo bestytni është një nga më të vjetrat dhe më të përhapurat dhe e ka origjinën në vendet e Lindjes. Traditat dhe paragjykimet vijnë që nga lashtësia, nga sumerët dhe babilonët. Fjalë si „IG-HUL“ me kuptimin *syri i keq* datojnë që në shekullin 300 para Krishtit. Kjo formë, ky përfytyrim është përcjellë nga kultura orientale përmes turqve në Shqipëri.[905]
Në gjermanisht lakmia koceptualizohet përmes shikimit në shprehjen frazeologjike *böser Blick* (vështrim i keq). Edhe në gjermanisht është e pranishme metafora e të shijuarit përmes syrit në somatizmin *jmdn mit den Augen essen/verschlingen* (të hash/përpish dikë/diçka me sy) apo edhe në: *die Augen sind größer als der Magen* (sytë janë më të mëdhenj se stomaku). Por në somatizmin në gjermanisht nuk

[903] Shih, *Duden Redewendungen, Band 11,* f. 74.
[904] Shih, Sadikaj, Sonila, *Metaphorische Konzepte in somatischen Phraseologismen des Deutschen und Albanischen*
[905] Shih, Wikipedia.de, fjala: böser Blick.

verbalizohet lakmia, por dëshira e madhe për të patur dhe arritur dikë/diçka, pa implikuar keqndjelljen apo dëshirën e lakmisë.

Në të dyja gjuhët janë të pranishme konceptet sipas të cilave sytë janë shprehja e jashtme e gjendjes së brendshme të dikujt, janë pasqyrë e mendjes dhe e shpirtit, e mendimeve, ndjenjave, emocioneve të pashprehura, dmth., shprehja e abstraktes përmes konkretes. Andaj në somatizmat e qëmtuara të Kadaresë gjejmë të shprehura gjendje emocionale, si:

- Gëzim, p.sh., *me sytë e saj të qeshur (4), sytë u ndriçuan si shpuzë (21), sytë vështronin të qeshur (23), sytë i shkëlqenin nga një heshtje e gëzuar (11)...*
- Zemërim: *me sy të çakërritur (6), sytë i shkrepëtinë nga zemërimi (7), me sy të egër(18)...*
- Dashuri/Urrejtje: *nuk ju sheh dot me sy (14)…;*
- Plogështi, lodhje, si: *sy të buhavitur (11), picërroi sytë (20), sytë e shuar (8)… duke perënduar sytë e lodhur (9)…*
- Dëshpërim: *sytë e tij të zbrazët (26)…*
- Habi: *mos shqyeni sytë (13), shqyen sytë (22), sy të shqyer (3), sytë e habitur (22)…*
- Trishtim, indiferencë, si: *sytë e ngrirë, sy të ftohtë e ngurrues, sytë e Gurametos u bënë akull, sy indiferentë (16), sytë e tij të qelqtë prej kukulle (24), sy të ftohtë (21)…*
- Konfuzion mendor, frikë *sy të çakërritur (6), sy të turbulluar, sy të turbullt (33)…*
- Lodhje: *picërroi sytë, perëndoj sytë e lodhur…*

Të tëra somatizmat e sipërpërmendura janë përshkrime të gjendjeve psikologjike të personazheve në veprat që kemi qëmtuar dhe analizuar. Ato shërbejnë më së shumti për të përshkruar figurën e personazheve qendrore të veprave, doktor Gurametos së madh, kolonelit, priftit, por edhe figurave të tjera të skicuara në romanet e marrë për analizë.
Përjetimet e doktor Gurametos na shfaqen si të pikturuara përpara syve me somatizmat e listuara në tabelën 1 në të gjitha momentet emocionale që ai përjeton. Gjendja psikologjike e turbullt gjatë takimit me kolonel Schwaben, ku përzihen ndjenja e gëzimit, habisë, mallit, por edhe gjendja depresive e frikës, e krijuar nga pyetjet dhe mënyra e shtrimit të tyre nga hetuesit shqiptarë, ai gjerman dhe rus, përshkruhen dhe paraqiten edhe më dramatike kur ajo lexohet qartë në pamjen e jashtme, në sytë e tij. Përshkrimet psikologjike marrin, në këtë mënyrë, vlera metalinguistike, ato shpjegojnë mendimet, qëndrimet, veprimet apo mosveprimet e personazhit.
Me somatizmat e paraqitura në tabelën 1 përshkruhen edhe personazhe të tjera, në romanin “Darka e gabuar”: hetuesit e çështjes, ushtarët e kolonelit, njerëzit e kafenesë së qytetit.

Në veprën tjetër të marrë për analizë “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, somatizmat përdoren më së shumti për të karakterizuar personazhet joqendrore të veprës. Për mendimin tonë, për arsyen se autori përzgjedh një procede tjetër për përshkrimin e gjendjeve psikologjike të gjeneralit dhe priftit. Gjenerali përshkruhet më së shumti përmes monologut të brendshëm dhe rrëfimeve në retrospektivë. Në këtë roman shkrimtari ndërthur me mjaft finesë dy plane: njëri plan ka të bëjë me çastin e

ligjërimit dhe tjetri me rrëfimin retrospektiv të ndodhive që kanë ngjarë para çastit të ligjërimit.

Nëse i përqasim mjetet leksikore të përdorura nga Kadareja në shqip dhe përkthimin e tyre në gjermanisht vëmë re se gjendja emocionale përshkruhet pothuajse në më të shumtën e rasteve në të dyja gjuhët me somatizma që kanë si pjesë përbërëse të tyre *syrin.* Somatizmat *lachende Augen, zusammengekinffenen Augen, verquollene Augen, funkelnde Augen, leere Augen, große Augen, aufreißende Augen, trübe Augen, kühle Augen* përvijojnë në përkthim konturet e personazheve, duke u nisur nga emocione të lexuara në sytë e personazheve: *gëzim, habi, trishtim, indinjatë.*

4.5.4 Somatizma me gjymtyrë përbërëse *dorën*

Tabela 1: Somatizma dorë nga Darka e gabuar

	I. Kadare	J. Röhm	Lloji i ekuivalencës
1	...një *dorë* e fshehtë sikur i kishte sjellë punët në atë farë mënyre...[906]	Doch es sah nun einmal danach aus, als habe *eine im Verborgenen waltende Hand* die zwei Chirurgen der Stadt untrennbar miteinander verbunden...[907]	e plotë
2	...*dora e fatit* kishte kryer atë që duhej kryer, dhe aq në mënyrë të përsosur, saqë era, ashtu siç e kishte nxjerrë perden përjashta, po aq vrullshëm e kishte pështjellë për ta futur brenda, fill pas valëvitjes…[908]	...*die Hand des Schicksals* hatte in Gestalt des Windes getan, was getan werden musste, und zwar so perfekt, dass der nach draußen geblassene Vorhang vom gleichen Luftzug auch wieder hineinbefördert worden war..[909]	e plotë
3	...rrekeshin *të hiqnin dorë* nga çdo mendim...[910]	...legte sie zu den Akten...[911]	Aspak
4	...*dora e padukshme*, ajo që i kishte ruajtur të dy doktorët nga pezmatimi, *kishte bërë* që nga i gjithë ky lëmsh botëror ata të dilnin fifty-fifty...[912]	*Die unsichtbare Hand*, deren Walten die beiden Ärzte schon früher von Zank und Streit bewahrt hatte, *sorgte* also auch unter den jetzigen komplizierten Weltverhältnissen dafür, dass es beim Patt zwischen ihnen blieb...[913]	e plotë
5	...I ndezur nga fjalët e veta, kumtuesi ngriti kryet për të thënë se, në të vërtetë, kishte kohë që ato e *kishin marrë në dorë* qytetin...[914]	...von den eigenen Argumenten mitgerissen, verstieg sich der Referent zu der Behauptung, dieses Häuflein von Damen *habe* die Stadt in Wahrheit schon lange *fest in der Hand...*[915]	e plotë

Tabela 2: Gjenerali i ushtrisë së vdekur

	I. Kadare	J. Röhm	Buchholz/Fiedler	Lloji i

[906] Kadare, I., Darka e gabuar, f.7.
[907] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 5.
[908] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 27.
[909] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 21.
[910] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 35.
[911] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 28.
[912] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 100.
[913] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 85.
[914] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 111.
[915] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 96.

				ekuivalencës
1.	..s´mund *ta vë dorën në zjarr*...[916]	...ich würde *meine Hand* dafür nicht *ins Feuer legen*...[917]	..aber dafür möchte ich nicht *die Hand ins Feuer legen*...[918]	e plotë

Numri i somatizave me gjymtyrë *dorën* është relativisht i vogël. Nga tabela del qartë se, më së shumti, frazeologjizmat me këtë pjesë trupi janë identike në të dyja gjuhët, dmth. somatizmat në shqip dhe përkthimet në gjermanisht janë ekuivalente të plota. Në të gjitha frazeologjizmat e skeduara nga romanet, *dora* shërben vetëm si sferë dhuruese e komponenteve konceptuale të emetuara nga frazeologjizmat. Megjithatë në fjalorët përkatës kemi mjaftueshëm shembuj frazeologjizmash, kur gjymtyra *dorë* përdoret si sferë pritëse, dmth., sferë ku projektohen koncepte.
Në somatizmat e evidentuara nga romanet në të dyja gjuhët *dora* qëndron:

- si konceptualizim i fuqisë. Shembujt *dorë e fshehtë, dorë e fatit, dorë e padukshme* jepen po me aq besnikëri edhe në gjermanisht. Edhe në përkthim ruhet shkalla e idiomaticitetit.
- Në somatizmin *rrekeshin të hiqnin dorë* gjymtyra *dorë* qëndron për të treguar veprim/mosveprim. Ajo konceptualizohet si mjet me anë të të cilit kryhen veprime. Në “Fjalorin frazeologjik të gjuhës shqipe” të J. Thomait janë shënuar tri kuptime për njësinë frazeologjikë *heq dorë*. Kuptimi i tretë “*nuk mendoj më si më parë, nuk i përmbahem një mendim a një ideje*” është ai që transmeton njësia frazeologjike në kotekstin e ligjërimit. Torturat e vazhdueshme për shpjegimin e darkës mistike i kishin shtyrë njerëzit të vendosnin paralele me darkën e krishtit. Ky paralelizëm rezulton i gabuar në çastin kur përqasen rolet e personazheve në të dyja darkat. Prandaj njerëzit tërhiqen nga mendimet e deritanishme. Folja *rrekem,* si fjalë e ligjërimit të bisedor, modifikon kuptimin e frazeologjizmit, duke përcaktuar shkallën e përfshirjes në këtë proces të njerëzve, aspektin e veprimit. Kjo folje i jep tërë njësisë një ngjyrim të ligjërimit të thjeshtë.
  Gjegjëse në përkthim, siç e shohim edhe nga tabela, është frazeologjizmi *legt zu den Akten*. Në fjalorin e frazeologjizmave “Duden Redewendungen” nën gjymtyrën *dorë* nuk ka asnjë gjegjës për frazeologjizmin e shqipes. Kuptimi i gjegjëses në gjermanisht shpjegohet në fjalorin e sipërpërmendur: *etwas als erledigt betrachten* (ta konsiderosh diçka si të përfunduar, si të mbyllur). Nga përqasja e kuptimeve konstatojmë se gjetja e gjegjëses bëhet sipas kriterit të së tretës së krahasueshme. Prandaj edhe në përkthim mungojnë shumë elemente kuptimore të transmetuara nga frazeologjizmi në gjuhën shqipe.
- si konceptualizim i pronësisë, i posedimit të diçkaje apo të dikujt. Në të dyja gjuhët është i pranishëm ky konceptualizim, prandaj edhe ekuivalenca është e plotë. Dëshirojmë të vëmë në dukje se gjegjëset shqip dhe gjermanisht kanë diferenca në aspektin e veprimit që emërtojnë. Këto diferenca lidhen me foljet në frazeologjizmat përkatëse shqip dhe gjermanisht. Gjymtyrët folje *marr* dhe *kam* (haben) emërtojnë dy momente të ndryshme të veprimit. *Marr* nënkupton një ndodhi në proces, ndërsa *kam* rezultatin e veprimit, gjendje të procesit.
- si dëshmi e fajësisë apo pafajësisë. Motivimi i kësaj shprehjeje frazeologjike në gjuhën gjermane shpjegohet në fjalorin e frazeologjizmave „Duden

[916] Kadare, I., *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 228.
[917] Röhm, J., *General der toten Armee*, f. 288.
[918] Buchholz, O./Fiedler, W., *Generla der toten Armee*, f. 215.

> Redewendungen“ me rëdësinë e veprimit që emërton drejtpërdrejt procesin e të vënit të dorës në zjarr në ritualet gjyqësore në mesjetë. Gjatë gjykimit, të akuzuarit duhet të dëshmonin pafajësinë e tyre duke vendosur dorën para zjarrit për disa momente.[919] Në raste djegieje të dorës, i akuzuari shpallej i fajshëm, në të kundërt, jo. Gjykojmë se një motivim i tillë duhet të jetë edhe në gjuhën shqipe.

Motivimi i shprehjeve frazeologjike në të cilat *dora* shërben si sferë dhuruese e koncepteve *fuqi, zotërim apo pronësi* bazohet mbi të përjetuarën, dmth., realen të kapshmen me sy. Si rrjedhojë, edhe ekuivalenca në të dyja gjuhët është në pjesën më të madhe, e plotë.

4.5.5 Somatizma me gishtin

Tabela 1: Darka e gabuar

1	...do të *mbetej* prapë *me gisht në gojë*[920]	...würde auch der kleine D. G. auch am Ende unëeigerlich *in die Röhre gucken*[921]	Aspak
	...Te porta, me pamje të ngrefosur, i fryrë me një pezm pa kuptim, Remzi Kadareja *ua tundi gishtin*[922]	Am Krankenhauseingang *fuchtelte* ihnen Remzi Kadare zornroten Gesichts *mit dem Finger vor der Nase herum*[923]	e plotë

Për somatizmin e skeduar nga romani „Darka e gabuar“ *tund gishtin* shërben, si mekanizëm, koncept metafoirk, motivimi i pranishëm në komunitetin gjuhësor shqiptar dhe më gjerë i gjestit që verbalizohet në këtë somatizëm. Dobrovol´skij/Pirainen e quajnë grupin e frazeologjizmave të cilat kanë si mekanizëm motivimi sjellje të konvencionalizuara jogjuhësore, siç janë gjestet apo pozicionimi i pjesëve të trupit, si grupi i somatizmave që kanë element motivues kinegramet.[924] *Tundja e gishtit* në teorinë e shenjave jogjuhësore përfshihet në grupin e shenjave gjeste. Për gjestet thuhet se ato tregojnë jo vetëm gjendjen ndjesore të folësit, por edhe qëndrimin dhe angazhimin e tij përkundrejt objektit të referimit.[925] Pikërisht, gjendja dhe masa e përfshirjes së folësit Remzi Kadareja, i cili, me anën e tundjes së gishtit, dëshiron të vejë në dukje mospajtimin, indinjatën e tij ndaj veprimit të hetuesve, të cilët, nga Guva e Shanishasë po shkonin drejt spitalit ku kishin punuar dy Gurametot, skicohet nga Kadareja përmes somatizimit *tund gishtin*, por edhe nga metaforat *i ngrefosur, i fryrë nga një pezm.*

Gjegjësja në gjermanisht *fuchteln mit dem Finger herum* (tund gishtin) është ekuivalente e plotë me atë që përdor Kadareja. Në gjermanisht ky somatizëm nuk është i leksikalizuar. Ai nuk gjendet në fjalorin „Duden Redewendungen“. Për ta qartësuar më tepër kuptimin që synon të transmetojë me somatizmin, J. Röhmi përdor edhe elementin gjuhësor me funksionin e rrethanorit të vendit *vor der Nase* (para hundës), i cili nuk gjendet në origjinal. Nga ana tjetër, edhe në gjermanisht gjendja

[919] Shih, *Duden Redewendungen, Band 11*. f. 319.
[920] Kadare, I., *Darka e gabuar*, f. 80.
[921] Röhm, J., *Ein folgenschwerer Abend*, f. 67.
[922] Kadare, I., *Darka e gabuar*, f. 125.
[923] Röhm, J., *Ein folgenschwerer Abend*, f. 107.
[924] Dobrovols´kij, Dimitrij/ Piirainen, Elisabeth. *Zur Theori der Phraseologie. Kognitive und kulturelle Aspekte.* Tübingen, 2009, f. 27.
[925] Linke, A/Nussbaumer, M/Portmann, P. R., *Studienbuch Linguistik*, Tübingen, 1991.

emocionale e Remziut nuk prezantohet vetëm përmes somatizmit, por edhe me metaforën, epitet *zornrot* (i kuq prej pezmit), që përcakton emrin Gesicht (fytyrë). Sigurisht që edhe fjala e përbërë *zornrot* e përbërëve prej elementeve gjuhësore *Zorn* (pezm) dhe *rot* (i kuq) skicon para syve të lexuesve fytyrën e kuqe prej zemërimit që kishte kaptuar Remzi Kadarenë, duke përforcuar edhe më shumë ndikimin që synon të realizojë përdorimi i somatizmit *tund gishtin*. Ideja e përsëritjes së veprimit përmes parashtesës *herum*[926]që i vendoset foljes *fuchteln* (tund) përforcon shkallën e intensitetit të gjendjes emocionale të indinjuar.

Mekanizmat motivues që fshihen pas somatizmit në shqip *mbes me gisht në gojë* nuk i gjejmë të shpjeguar në ndonjë fjalor. Por, sipas mendimit tonë, një mundësi shpjegimi të kuptimit të këtij somatizmi mund të na japë krahasimi me kuptimin që ka ky veprim tek foshnjet. Mbajtja e gishtit në gojë nga një grupmoshe fëmijësh që nuk e ka ende të zhvilluar aftësinë e të folurit, është e vetmja mënyrë që mbetet dhe mund të bëhet prej tyre, pa kërkuar ndihmën e të tjerëve, për të kënaqur apo qetësuar disi vetveten.
J. Röhmi përdor gjithashtu një frazeologjizëm për të emërtuar procesin e pamundësisë për të pasur diçka, gjendjen e mbetjes me asgjë, i cili për nga koncepti dhurues nuk është ekuivalent me atë që përdor Kadareja në roman. Kuptimi i njësisë frazeologjike në gjermanisht *in die Röhre gucken* (fjalë për fjalë: të shikosh përmes tubave, dmth., të mbeshësh pa gjë) ka në thelb një motivim tjetër nga sfera e gjuetarëve, që lidhet me pamundësinë e qenve që përdoren në gjueti për të kaluar përmes tubave.[927] Kuptimi i frazeologjizmit shpjegohet në Duden Redewendungen *leer ausgehen, Nachsehen haben* (të përfundosh bosh, të mos kesh asgjë, përveç gjërave më të këqija) dhe ka diferenca kuptimore me somatizmin në gjuhën shqipe *mbes me gisht në gojë*.
Në gjuhën gjermane, somatizmi ekuivalent me variantin e Kadaresë do të ishte *von der Hand in den Mund leben* (të jetosh me dorë në gojë). Motivimi i këtij somatizmi lidhet me përdorimin e tij nga Gerhard Aberle në romanin *„Stehkneipen“* në të cilin thuhet: *Früher war ich Verteter, heute bin ich ein armer Rentner und lebe von der Hand in den Mund* (më parë isha përfaqësues dhe sot po jetoj me dorë në gojë). Kuptimi i këtij somatizmi është: *të shpenzosh edhe ato pak të ardhura përsëri për nevoja të jetesës.*
Mund të themi se për të verbalizuar konceptin e mbijetesës, ekzistojnë në të dyja gjuhët somatizma me pjesë të ndryshme të trupit, përkatësisht *gisht* dhe *dorë.* Marrëdhënia që vendosin të dyja gjymtyrët është *pars pro toto*.

4.5.6 Somatizma me këmbë

Tabela I: Darka e gabuar

1	*...u prit me këmbët e para...*[928]	...kam nicht gut an...[929]	Aspak
2	...Qyteti i tërë, ndërsa duhej t`i binte në gjunjë doktor Gurametos së madh, *t`ia lante këmbët me lot* e t`i kërkonte ndjesë për dyshimet...[930]	...Die Stadt war geneigt, sich vor dem großen Doktor Gurameto auf die Knie zu werfen, *seine Füße mit Tränen zu waschen* und ihn um die Vergebung für ihr Mißtrauen aufzuflehen...[931]	e plotë

[926] Parashtesa *herum* tregon lëvizje rrethore. Shih, Duden Online, lema herum.
[927] Shih, Duden Redewendungen, Band 11, f. 624.
[928] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 13.
[929] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 10.
[930] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 23.
[931] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 30.

3	...e bënë doktor Gurameton e madh *të shkelte me këmbë* sedrën e vet...[932]	...den großen Doktor Gurameto seinen Stolz *zu bezwingen*...[933]	Aspak
4	...Shaqo Mezini *mbajti këmbët*.[934]	...Shaqo Mezini blieb stehen.[935]	Aspak

Tabela 2: Gjenerali i ushtrisë së vdekur

	Kadareja	Röhm	Buchholz/Fiedler	Lloji i ekuivalencës
	...*m'u zgjidhën këmbët* papritur... [936]	...*setzen sich meine Beine* ganz alleine *in Bewegung*...[937]	...weshalb *meine Beine* plötzlich *in Beëegung kamen*,..[938]	-e plotë
	...gjithë instinktet ... *ishin ngritur më këmbë*...[939]	Ihre alten Laster brachen wieder aus, und zwar schlimmer als zuvor...[940]	...alle... Urinstinkte ëaren erwacht[941]	-aspak -aspak
	Këto paragrafe të vjetra *u ngatërrohen* atyre *nëpër këmbë* tërë jetën si litarë, gjersa një ditë *u ngecin këmbët nëpër to* dhe bien e nuk ngrihen më.[942]	Die Bluträcher sind letzlich nichts anderes als kalte Exekutoren von Paragraphen eines Kodex aus Urväterzeit, *über die sie immer wieder stolpern*, bis sie schließlich stürzen und liegenbleiben.[943]	Diese alten Paragraphen *haben* sie ihr ganzes Leben lang wie Fangstricke *zwishen den Beinen*, bis sie sich eines Tages darin verheddern, zu Boden stürzen und nicht mehr hochkommen.[944]	-aspak -e pjesshme
	..duke *iu marrë këmbët*...[945]	Sie *stolperten* die Hoteltreppe hinauf...[946]	Beide schwankten,...[947]	-aspak -aspak

Në përgjithësi, somatizmave me gjymtyrë *këmbën* në gjuhën shqipe u përgjigjen somatizma me gjymtyrë leksemën *Bein* dhe *Fuß*. Për të dyja këto leksema, në fjalorin e frazeologjizmave të gjuhës gjermane Duden Redewendungen, gjejmë shumë somatizma. Në shqip përpos leksemës *këmbë* është edhe leksema *shalë*, gjegjëse për *Bein*. Më tepër ajo përdoret në ligjërimin bisedor dhe ka më së shumti ngjyrim negativ. Për këtë arsye ajo zëvendësohet pothuajse në të gjitha rastet në ligjërimin e thjeshtë me leksemën *këmbë*.

Në somatizmat nga veprat e analizuara të Kadaresë konceptualizimi metaforik i gjymtyrës *këmbë* është:

[932] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 84.
[933] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 70.
[934] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 197.
[935] Röhm, J., Ein folgenschwerer Abend, f. 173.
[936] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 97.
[937] Röhm, I., General der toten Armee, f. 123.
[938] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 95.
[939] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 108.
[940] Röhm, J., General der toten Armee, f. 137.
[941] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 108.
[942] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 124-125.
[943] Röhm, J., General der toten Armee, f. 151.
[944] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 119-120.
[945] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 224.
[946] Röhm, J., General der toten Armee, f. 283.
[947] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 211.

- *Këmbë* tregon qëndrim. Somatizmat *m`u zgjidhën këmbët, ishin ngritur më këmbë, mbajti këmbët* konceptualizojnë këmbën si gjymtyrë të trupit të njeriut me anën e së cilës realizohen lëvizje të ndryshme, ose aspekte të ndryshme të lëvizjes. Ky konceptualizim lidhet me përjetimin e drejtpërdrejtë, pra, me komponente konceptuale që lidhen me realen. Krahasimi i ekuivalencës konceptuale të vendosur me gjegjëset në gjermanisht tregon se në pak raste kemi ekuivalencë të plotë, edhe pse konceptualizimi metaforik për këmbën që lidhet me të qëndruarin duhet të ishte universal. J. Röhmi në mjaft raste nuk përdor ekuivalentet konceptuale gjegjëse në gjermanisht. Për somatizmin *ishin ngritur më këmbë* në gjermanisht ka një somatizim të ngjashëm me të njëjtën gjymtyrë. Somatizmi gjegjës gjermanisht *wieder auf die Beine kommen* është i ligjërimit të thjeshtë dhe mund të përdoret në sferën e shëndetësisë dhe të ekonomisë.[948]Jo vetëm sfera e përdorimit të somatizmit të gjuhës shqipe është më e gjerë, por edhe regjistri i ligjërimit është jo i njëjtë me atë në gjermanisht. Vetëm kuptimi i dytë prej tri kuptimeve të shënuara në Fjalorin Frazeologjik të Jani Thomait (*u ngrit nga shtrati, u shërua, e mori veten*) është ai që emeton përgjegjësja në gjermanisht.
  Përkthimi i somatizmit *mbaj këmbët* me foljen e përbërë *stehenbleiben* (qëndroj, ndalem) lidhet me semantikën e foljes. Folja *stehenbleiben* përbëhet prej dy foljesh, *stehen* (qëndroj) dhe *bleiben* (ndalem, ndërpres lëvizjen). Semantika e foljes *stehen* në gjermanisht presupozon këmbët në rolin semantik të vepruesit. Pra, në semantikën e foljes *qëndroj* kemi të bëjmë me dukurinë e presupozicionit semantik.[949]

- *Këmba* si gjymtyra që finalizon të ecurin, lëvizjen. Somatizmat *u ngatërrohen nëpër këmbë, ngecin këmbët* verbalizojnë konceptin që lidhet sigurisht me funksionin e kësaj gjymtyre. I tërë pasazhi ku gjenden këto somatizma, përshkruan ndikimin e fuqishëm të kodit të gjakmarrjes në Shqipëri në rregullimin e jetës së njerëzve nga këndvështrimi i dy të huajve. Edhe vdekja, edhe sjellja e njerëzve parashkruhen në paragrafe të veçanta të Kanunit. Tabloja figurative që paraqet ritin e gjakmarrjes realizohet nga Kadareja përmes: krahasimit *paragrafe si litarë*, shprehjeve frazeologjike *ngatërrohen nëpër këmbë, ngecin këmbët, pjesë teatrale të përgjakshme*. Skenari i pjesës teatrale të përgjakshme duket sikur luhet para syve të lexuesve: paragrafë të krahasuar si litarë, që nënkuptojnë jo të domosdoshmen, fillimisht vetëm pengojnë, më pas ndalojnë e hedhin poshtë njerëzit që e kanë të pamundur të ngrihen më. Figura e enumeracionit ngatërroj këmbët, ngecin nëpër këmbë, bien dhe nuk ngrihen kulmon sigurisht me atë që shënon edhe fundin e jetës, vdekjen. Këtë fundjete si në skenë, autori e prezanton përmes krahasimit të artikuluar nga goja e priftit: *është si butafori*.
  Në përshkrimin e tablosë në gjermanisht përkthyesit J. Röhm dhe O. Buchholz/ W. Fiedler ndeshin në vështirësi. J. Röhmi përzgjedh procedurën e emërtimit të drejtpërdrejtë të elementeve gjuhësore që skicojnë tablonë. Ai emërton drejtpërdrejt procesin e pengesës me foljen *stolpern* (pengojnë), *procesin e rënies* (stürzen) dhe *të shtrirjes në tokë* (liegenbleiben). Edhe në variantin e Röhmit kemi një numërim te veprimeve drejt përshkallëzimit. Më afër origjinalit është përkthimi i Buchholz/Fiedlerit. Somatizmin u

[948] Shih, Duden Redewendungen, Band 11, f. 103-104.

[949] Për dukurinë e presupozicionit semantik kemi folur në kapitullin I, në sythin Presupozimet, f. 7.

ngatërrohen nëpër këmbë, përkthyesit e japin përmes të njëjtit koncept (*haben zwischen den Beinen*), edhe pse foljet gjegjëse *haben* (kam) dhe *ngatërrohen* shprehin momente të ndryshme të veprimit, përkatësisht rezultat, proces. Somatizmin tjetër *ngecin nëpër këmbë* Buchholz/Fiedleri e emërtojnë përmes foljes metaforë *verheddern* (ngecin nëpër litarë). Përshkallëzimi krijohet edhe në përkthimin e Buchholz/Fiedlerit.

- Si sferë projektimi *këmba* shërben për të treguar gjendje, sjellje njerëzore,

  Gjendje të keqe fizike. *i merren këmbët* i referohet konceptualizimit metaforik *drejt* përkundrejt *shtrembër,* ku *drejt* konceptualizon të mirën dhe *shtrembër,* të keqen. Somatizmi emërton gjendje fizike të keqe, që vjen pas një lodhjeje të gjatë ose pas marrjes së një sasie të madhe alkooli. Përgjegjësja gjermanisht në roman është një folje e vetme, e cila emërton drejtpërdrejt procesin e të ecurit duke u lëkundur, konkretisht O. Buchholz/ W. Fiedleri e emërtojnë me format foljore *schwankten* (lëkundeshin) dhe Röhmi *stolperten hinauf* (pengoheshin lart). Përkthimet humbin jo vetëm në figurshmëri, por edhe nuk japin me besnikëri çka përshkruan Kadareja. Njëkohshmëria e shprehur përmes elementeve gjuhësore *ngjitem duke iu marrë këmbët* humb në të dyja përkthimet.[950] Ngjitja e shkallëve përcaktohet nga Kadareja me zigzage.
- Somatizmi *u prit me këmbët e para* lidhet me metaforën orientuese sipas së cilës e keqja është poshtë, te pjesët e poshtme të trupit, dmth., ai që pret me këmbët e para, mund të jetë jomiqësor, keqdashës, madje edhe armiqësor. Pyetja që lidhej me sqarimin e qëndrimit të shqiptarëve ndaj synimeve miqësore të deklaruara nga gjermanët kishte ngjallur reagim, indinjatë te pala e tretë frikacake. Këtë lloj shqetësimi Kadare e ironizon mjaft bukur me anën e disa elementeve gjuhësore, si: *krahasime* (ankth i veçantë nazik si një maçok i ngopur, mendjemadh dhe disi i pafytyrë), *proverba* (dhi ngordhalaqe dhe bishtin përpjetë), *përdorimi i mënyrës habitore* të foljes *dua* emërtuese e dëshirave të palës së tretë, *frazeologjizma* (shqyej leckash, u prit me këmbët e para).
  Somatizmi shqip *u prit me këmbët e para* nuk ka gjegjëse në gjermanisht. J. Röhmi e çmetaforizon shprehjen duke e emërtuar drejtpërdrejt procesin e reagimit të palës shqiptare. Folja polisemike *ankommen* (këtu në kuptimin *pres*), në fragment, në formë të mohuar dhe mbiemri gut (mirë) nuk japin saktësisht domethënien e somatizimit në shqip. Kuptimi i somatizmit në shqip: *e priti keq, reagoi keq* nuk është i njëjtë me *e pres jo mirë*. Kundërthënia *jo mirë* dhe *keq* nuk është shumë e saktë, pasi *jo mirë* nuk emërton cilësinë e kundërt të mbiemrit *mirë,* por vetëm e mohon atë. Mohimi, përjashtimi i një cilësie apo veprimi nuk nënkupton domosdoshmërisht pohimin e së kundërtës.[951]
- Në somatizmin *shkel me këmbë sedrën, këmba* si gjymtyra e poshtme e trupit të njeriut, konceptualizon të keqen. Kuptimi i somatizmit është të vesh poshtë diçka që duhet vlerësuar dhe si e tillë mund të lokalizohet në pjesën e poshtme të trupit të njeriut. Një imazh të tillë J. Röhmi e jep gjermanisht duke përdorur folje me kuptim metaforik *bezwingen* (mposht).

[950] Edhe funksioni ikastik që kanë shprehjet frazeologjike që motivohen nga përjetimet konkrete reale është realisht më i dukshëm se ato që kanë leksema të veçanti.
[951] Shih, Thomai, J. Leksikologji e gjuhës shqipe, Tiranë, 2005, f. 137.

- Në somatizmin *i laj këmbët me lot e i kërkoj ndjesë*, variant i somatizmit të shënuar në fjalor *t´i lash këmbët e t´i pish ujin*, përulësia jepet përmes konceptit metaforik, sipas së cilit e keqja është poshtë dhe mund të largohet vetëm duke e pastruar pjesën e poshtme. Varianti i përdorur nga Kadareja, sipas së cilit largimi mund të bëhet me lot, tregon për shkallën e pendesës së padrejtësisë ndaj doktor Gurametos. Të njëjtin imazh përcjell edhe gjegjësja gjermanisht në roman. Ekuivalenca është e plotë. Edhe pse somatizmi *die Füße mit Tränen waschen* nuk është shënuar në fjalorin e frazeologjizmave të gjuhës gjermane, koncepti është i njëjtë në të dyja gjuhët, sepse ka origjinë të njëjtë. Në besimin kristian larja e këmbëve bëhet për tri arsye: e kërkonte kulti; arsye higjenike; si shenjë mikpritjeje ose përulësie. Në disa momente të Biblës përshkruhet larja e këmbëvë si shenjë përulësie apo nderimi. Ky koncept verbalizohet edhe nga shprehja e mësipërme. Masa e pendesës së treguar theksohet më shumë, sepse koncepti i përulësisë përmes larjes së këmbëve kombinohet me metaforën Träne (lot), që implikon edhe një dëshpërim të palës akuzuese.

4.6 Frazeologjizmat me *shpirtin dhe mendjen*

Këtë grup të njësive frazeologjike e kemi përzgjedhur ta trajtojmë në të njëjtin syth për të treguar dhe përshkruar konceptualizimin e *shpirtit* dhe *mendjes* në kulturën shqiptare dhe atë gjermane. Mënyra e konceptualizimit të *shpirtit* dhe *mendjes* në kulturën shqiptare, dhe përqasja me gjegjëset në përkthim janë një mjet i mirë për evidentimin e dallimeve midis dy gjuhëve dhe njëkohësisht mentalitetit dhe mendësive përkatëse.
E menduam shumë interesante trajtimin e këtij tipi të frazeologjizmave edhe për dy arsye të tjera:
- në secilën prej gjuhëve është i vështrië dallimi dhe përvijimi i qartë i koncepteve të leksemave *mend* dhe *shpirt*. Ato përfshijnë shumë koncepte të tjera, aktivizojnë dhe lidhen me një tërësi konceptesh. P.sh., në qasje dhe teori të ndryshme, kuptimi që përcakton leksema *shpirt* është i ndryshëm. Në metafizikë, shpirti është i pavdekshmi, në këndvështrimin psikologjik ai është i ngjashëm me psikikën. Ndryshe përkufizohet ai në teoritë filozofike e bestytnitë mitike.
- së dyti, leksemat gjegjëse në të dyja gjuhët nuk janë ekuivalente në vëllimet kuptimore të tyre. Në gjuhën gjermane leksema *mendje* nuk ka një ekuivalente të vetme. Vëllimi kuptimor i fjalës *mend*/*mendje*, me katër kuptimet e listuara në fjalorin e gjuhës shqipe, përmbledh vëllimin kuptimor të fjalëve në gjermanisht: *Gedanken, Verstand, Gehirn/Hirn, Besinnung, Erinnerung* Këtë e dëshmojnë edhe shprehjet frazeologjike të cilat kanë si gjegjëse në shqip gjymtyrën mend/mendje: *im Gedanken sein* (mendjehumbur), *hat man wohl ins Gehirn geschossen* (nuk e ke mendjen në vend, fjalë për fjalë të kanë gjuajtur në tru), *zu Verstand kommen* (i erdhi mendja), *einen Riss im Hirn haben* (të kesh një të çarë në tru), *die Besinnung rauben*, *sich in Erinnerung bringen* (sjell ndër mend, në kujtesë). Anasjelltas, përkthimi i leksemave të fundit nga gjuha gjermane në gjuhën shqipe paraqet vështirësi për cilindo.
Edhe leksema *shpirt* ka dy gjegjëse në gjuhën gjermane: *Geist*, *Seele und Gemüt*, dallimi i kuptimeve të të cilave është tejet i vështirë.

Kjo pikënisje e mendimit tonë për të trajtuar frazeologjizmat me gjymtyrë *shpirtin* dhe *mendjen* gjen mbështetje edhe nëse përqasim llojin e ekuivalencës që vendoset në

të dyja gjuhët. Nga tabelat duket qartë se ekuivalenca midis njësive frazeologjike në shqip dhe atyre në gjermanisht në të shumtën e rasteve mungon.

4.6.1 Frazeologjizma me gjymtyrën emërore *shpirt*

Tabela 1: Darka e gabuar

	I. Kadare	*J. Röhm*	*Lloji i ekuivalencës*
1	...po jepja shpirt...[952]	... nun sei es mit mir,...[953]	aspak
2	...me shpirt ndër dhëmbë...[954]	... meine arg gebeutelte Vorhut...[955]	aspak
3	...po kthehej me shpirt ndër dhëmbë...[956]	...meine Übel malträtierte Vorhut...[957]	aspak
4	...kjo s´kishte penguar që shpirtrat të qetësoheshin…[958]	... Trotzdem trug die Visite zur Besänftigung der Gemüter bei...[959]	e pjesshme
5	...mezi mban shpirtin...[960]	...knapp dem Tod entronnen...[961]	Aspak
6	...zonjat ishin fytyra e vërtetë e qytetit, shpirti dhe dyzimi i tij...[962]	...die Damen seien die heimlichen Herscherinnen der Stadt, ihr Gesicht, ihre Seele, ihre Inkarnation...[963]	e plotë
7	...të vrarë në shpirt...[964]	...sie beteuerten , nicht weniger betroffen gewesen zu sein als die anderen,...[965]	aspak

Tabela 2: Gjenerali i ushtrisë së vdekur

	Kadare	*Röhm*	*Buchholz-Fiedler*	*Lloji i ekuivalencës*
1	....më dhemb shpirti për ta...[966]	Mir schmerzt die Seele...[967]	Sie tun mir in der Seele leid...[968]	-e plotë - e pjesshme
2	...duhej *të mbanin shpirtin me bukë. Shpirtin me bukë mbaje* , por mos e bëj leckë dinjitetin e vendit tënd...[969]	…die armen Teufel hätten keine andere Überlebensschance gehabt. Gut, irgendwie mussten sie sich durchschlagen, aber das kann man auch, ohne die Würde seines Landes vor die Hunde gehen zu lassen...[970]	Schließlich und endlich hätten sie ja essen müssen, wenn sie am Leben bleiben wollten. Ja, um zu überleben, muss man essen, aber man darf doch nicht die Würde seines Landes in den Dreck ziehen...[971]	- aspak - aspak

[952] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 43.
[953] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 34.
[954] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 44.
[955] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 34
[956] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 45.
[957] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 35.
[958] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 79.
[959] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 65.
[960] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 93.
[961] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 78.
[962] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 112.
[963] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 96.
[964] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 195.
[965] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 170.
[966] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 26.
[967] Röhm, J., General der toten Armee, f. 33.
[968] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 23.
[969] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 110.
[970] Röhm, J., General der toten Armee, f. 136.
[971] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 107.

3	...po përpiqeni të gërmoni në shpirtin tim....[972]	..halten sie mich für psychisch gestört,[973] ...	Sie halten mich wohl für einen Geisteskranken, dass sie versuchen, wie ein Psychiater in meinem Innern herumzuwühlen...[974]	- aspak - aspak
4	Po jepte shpirt.[975]	Er lag im Sterben.[976]	Er lag im Sterben.[977]	-aspak - aspak
5	...gjersa dha shpirt...[978]	...bevor es endlich aus war...[979]	bis er starb...[980]	-aspak -aspak
6	…ia plasi shpirtin kjo punë…[981]	...das Herz brach ihnen dabei...[982]	...die Arbeit bedrückte ihre Seele...[983]	-aspak - e pjesshme
7	..të hante dhe të pinte për shpirtin e tyre.[984]	...für ihre Seele das Brot zu essen und den Wein zu trinken begann.[985]	Für die Seele der Toten von dem Brot aß und von dem Wein trank.[986]	- e plotë - e plotë
8	..ndieja një mërzi në shpirt...[987]	...war traurig, die ganze Welt kam mir vor ëie das Stadion,...[988]	...empfand ich eine solche innere Leere,...[989]	-aspak -aspak
9	..ndjeu një rrënqethje në shpirt...[990]	Ihn schauderte und er begann.[991]	...ein Schauer überlief ihn,...[992]	- aspak - aspak
10	...kjo punë na plasi shpirtin...[993]	Uns platzt bei dieser Arbeit die Seele...[994]	..diese Arbeit hat unseren Seelen einen Sprung zugefügt.[995]	- e plotë - e pjesshme
11	na plasi shpirtin...[996]	Es macht einen müde...[997]	...sie hat uns seelisch ruiniert...[998]	- aspak - e pjesshme
12	..ndieja një mërzi në shpirt...[999]	...war traurig, die ganze Welt kam mir vor wie das Stadion,...[1000]	...empfand ich eine solche innere Leere,...[1001]	- aspak - aspak

[972] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 127.
[973] Röhm, J., General der toten Armee, f. 155.
[974] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 122.
[975] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 161.
[976] Röhm, J., General der toten Armee, f. 194.
[977] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 153.
[978] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 161.
[979] Röhm, J., General der toten Armee, f. 195.
[980] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 153.
[981] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 165.
[982] Röhm, J., General der toten Armee, f. 205.
[983] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 156.
[984] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 204.
[985] Röhm, J., General der toten Armee, f. 258.
[986] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 193.
[987] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 219.
[988] Röhm, J., General der toten Armee, f. 274
[989] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 205.
[990] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 214
[991] Röhm, J., General der toten Armee, f. 269.
[992] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 201
[993] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 217
[994] Röhm, J., General der toten Armee, f. 273.
[995] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 204.
[996] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 217.
[997] Röhm, J., General der toten Armee, f. 273
[998] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 204.
[999] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 219.
[1000] Röhm, J., General der toten Armee, f. 274.
[1001] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 205.

Siç del edhe nga shembujt e listuar në tabelat 1 dhe 2, numri i gjegjësve me ekuivalencë të plotë dhe të pjesshme është i kufizuar për shembujt e përzgjedhur nga romani „Darka e gabuar“. Rastet me ekuivalencë të plotë të evidentuara në romanet „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“ dhe “Darka e gabuar”, sipas mendimit tonë lidhet me konceptimin e njëjtë të *shpirtit* si botë e brendshme e njeriut dhe me sferën e njëjtë prej nga vjen koncepti i shpirtit si josubstancial, si jomaterial. Në besimin kristian, koncepti i vazhdimësisë së jetës, dmth. masës jo materiale të saj në botën e përtejme është universal, prandaj edhe veprimi i *të ngrënit dhe të pirit për shpirtin e dikujt* është universal.
Një përqindje realtivisht të lartë përbëjnë shembujt e përzgjedhur nga romanet e sipërcituar me *aspak ekuivalencë* në gjuhën gjermane. Përqindja e rasteve me aspak ekuivalencë në romanin “Darka e gabuar” është 71,4%, në dy variantet në gjermanisht të “Gjeneralit të ushtrisë së vdekur”, përkthyer nga Röhmi dhe Buchholz/Fiedleri përqindjet janë përkatësisht 75% dhe 58,33%.
Ndër rastet me aspak ekuivalencë mund të përmendim shembullin *po jepja shpirt*, i cili emërton gjendjen e pragvdekjes. Mendësia e *të dhënit shpirt* nuk është e njëjtë në gjuhën gjermane. Folja *jepja* presupozon që shpirti të konceptohet si materie. Në besimin fetar kristian, shpirti është i pavdekshëm, kështu që edhe nuk mund të jepet apo të dalë. Në të gjitha përkthimet e skeduara nga romanet në shqip mungon konceptualizimi i njëjtë si me atë të gjuhës shqipe. Kërkimi në fjalorin e frazeologjizmave në gjuhën gjermane dëshmon se edhe në gjermanisht ka frazeologjizma me të njëtën gjymtyrë, *shpirtin*. Por *shpirti* në konceptualizimin gjermanisht nuk mund të dalë, por të frymënxirret jashtë masës trupore e cila, si materie, është e vdekshme. Gjegjësja ekuivalente *den Geist ausgeben* në gjuhën gjermane përdoret për të ironizuar dhe jo emërtuar momentin e pragvdekjes.[1002]
Arsyeja e mospërdorimit të frazeologjizmit tjetër *den Geist aushauchen* (të frymënxjerrësh shpirtin) për mendimin tonë lidhet me diferencat në regjistër me frazeologjizmin në shqip. Në gjermanisht frazeologjizmi i përket ligjërimit libror, në shqip, të thjeshtë.
Edhe gjegjësja tjetër në gjermanisht që ka të bëjë me procesin fiziologjik të mosfrymëmarrjes *den letzten Atem aushauchen* (të frymënxjerrësh frymën e fundit) është gjithashtu e ligjërimit libror. Motivimi i njësisë së fundit frazeologjike në gjuhën gjermane është i dukshëm, ai lidhet drejtpërdrejt me perceptimin.
Në fakt, raporti mes *frymë* dhe *shpirt* është “raporti mes asaj që shihet, ndihet, dhe asaj që nuk shihet, midis shkakut dhe pasojës, midis thelbit të një dukurie dhe shfaqjes së saj.”[1003]
Ndërsa motivimi i njësive të tjera frazeologjike është nga sfera kishtare, nga bibla. Në këngët e vajit, “Jeremia”, ndeshet një konceptualizim i shpirtit, i cili shkëputet nga trupi.[1004]

Një analizë më e hollësishme e frazeologjizmave të skeduar nga romani “Darka e gabuar” dëshmon se *shpirti* në gjuhën shqipe konceptualizohet si:

- vazhdimësi, mbarim i ekzistencës. Në shembujt: *dha shpirt*, *mezi mban shpirtin* koncepti i ekzistencës, jetës biologjike jepet përmes gjymtyrës emërore *shpirt*. Gjymtyrët foljore *jep* dhe *mban* shenjojnë gjendje të

[1002] Shih, *Duden Redewendungen, Band 11*, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, f. 266.
[1003] Shih, Toska, Teuta, *Përfaqësimi i përvojës shqipfolëse në gjuhë te njësitë frazeologjike*, Doktoraturë, Tiranë, 2012.
[1004] Shih,bibelwissenschaft.de/online-bibeln/luther-bibel-1984

ndryshme, përkatësisht: të mosekzistencës apo mbijetesës, jetesës së mundimshme. Një konceptim i tillë për shpirtin, dmth. konceptualizimi i tij si komponenti më jetësor për njeriun, si materie mungon në mentalitetin dhe kulturën gjermane, ku ai shihet më tepër si botë e brendshme e njeriut apo si pjesa e pavdekshem e tij. Në romanin “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” gjejmë një variant tjetër të këtij konceptualizimi *mbaj shpirtin me bukë.* Barazimi i konceptit të jetës, shprehur nga gjymtyra *shpirt,* me ushqimin, shprehur nga gjymtyra *me bukë* tregon për rëndësinë që ka të ushqyerit në kulturën shqiptare. [1005]

- Në njësinë frazeologjike *zonjat ishin … shpirti …i tij* vëmë re se ekuivalenca e vendosur midis njësisë frazeologjike të gjuhës shqipe dhe përkthimit në gjermanisht është e plotë, çka dëshmon se konceptualizimi i shpirtit si tërësia e vetive dhe e tipareve (të mira a të këqija) të karakterit ose të personalitetit të një njeriu, karakteri i njeriut është i pranishëm në të dyja gjuhët. Vëmë re se në këtë rast në gjermanisht përdoret leksema *Seele*.

- Tri raste të tjera të evidentuara nga romani “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” të njësisë frazeologjike *kjo punë na plasi shpirtin* të mbështetura mbi konceptualizimin e shpirtit si botë e brendshme e njeriut janë trasmetuar me të njëjtën figurshmëri dhe shkallë idomaticiteti edhe në gjermanisht. Ndër përkthimet e listuara për këtë njësi frazeologjike varianti *platzt die Seele bei dieser Arbeit* është më besniku përkundrejt origjinalit. Variante të tjera të përkthimit, si *die Arbeit bedrückt ihre Seele*, *diese Arbeit hat unseren Seelen einen Sprung zugefügt,* edhe pse ndërtohen mbi të njëtin koncept, kanë devijime me origjinalin jo vetëm në regjistrat gjuhësorë, por edhe në mënyrën e kombinimit të gjymtyrës *shpirt* me gjymtyrët e tjera. Diferencat midis kuptimeve të foljeve *bedrückt* (shtyp) dhe *plas,* si edhe togut *einen Sprung zufügen* me foljen *plas* janë në rrafshin morfologjik, semantik dhe pragmatik. Më larg origjinalit janë përkthimet *hat uns seelish ruiniert* (na shkatërroi shpirtërisht); *das Herz brach ihnen dabei aus* (iu këput zemra).
  Përkimet semantike të frazeologjizmave të ndërtuara mbi këtë koncept në të dyja gjuhët dëshmohen edhe nga frazeologjizmat e tjerë, si p.sh.: *keine Seele haben* (është i pashpirt); *sich etwas von der Seele reden* (lehtësoj shpirtin); *mit ganzer Seele bei etwas sein* (jepem me mish e me shpirt pas diçkaje); *eine gute Seele haben* (njeri shpirtmirë). Përdorimi vetëm i gjymtyrës Seele në frazeologjizmat ku ai konceptohet si botë e brendshme, tregojnë se në përkthimet nga shqipja në gjermanisht duhet të kërkohet për ekuivalente leksema *Seele*. Kuptimet e leksemës *Geist* vijnë më së shumti nga sfera kishtare.

- Në variantin në shqip *gërmoj në shpirtin e dikujt,* gjymtyra *shpirt* prezanton konceptualisht psikikën e njeriut. Prifti në momentin e ligjërimit na shfaqet në pozicionin e psikanalistit, i cili përmes vëzhgimeve, pyetjeve dhe vlerësimeve të përgjigjeve për pyetjet e shtruara arrin në përgjithësime apo përfundime, të

[1005] Jo vetëm për ekzistencën por edhe për konceptualizimin e dashurisë, bukurisë sfera e të ngrënit zë një vend të rëndësishëm. Kështu në shqip gjejmë frazeologjizma, si: është për t‘ u ngrënë, ma ngopi zemrën. Shih, Sadiku, G., Eine Untersuchung von Beziehung zwischen Emotionen und Sprache am Beispiel einiger ausgewählter Begriffe (Konzepte) im Deutschen und Albanischen, botuar në, *Emotionen in Sprache und Kultur,* Ljubljana, 2012, f. 352-365, këtu f. 360.

cilat gjenerali nuk do t´ia pohojë vetes edhe pse janë ndoshta të vërteta. Gjithë aktiviteti i prftit në këtë moment të ligjërimit jepet nga Kadareja në shqip me njësinë frazeologjike të artikuluar nga gjenerali: *ju po përpiqeni të gërmoni në shpirtin tim..?* Semantika e foljes *gërmoj* ngërthen elemente kuptimore që lidhen me kohëzgjatjen dhe ngulmimin për të arritur rezultatin e dëshiruar si edhe thellësinë e investigimit. Përkthimi *aspak ekuivalent* në gjermanisht *halten Sie mich für psychisch gestört* (më mbani psiqikisht të sëmurë) dhe ai me ekuivalencë të pjesshme *wie ein Psikiater in meinem Innern herumzuwühlen* (si një psikiatër kërkoni në brendësinë time) humbin jo vetëm në figurshmëri, por edhe nuk implikojnë elementet kuptimore që ngërthehen në kuptimin e foljes *gërmoj*.

Njësitë frazeologjizike *me shpirt ndër dhëmbë, të vrarë në shpirt, ndjeu një mërzi/ një rrënqethje në shpirt* përshkruajnë gjendjen emocionale të grupeve të njerëzve apo njerëzve të veçantë të prekur nga një ngjarje apo ndodhi tejet sfilitëse apo e rrezikshme. Në thelb të këtyre përshkrimeve qëndron konceptualizimi i *shpirtit* si pjesa më e thellë dhe e mbrojtur nga vetë organizmi njerëzor. Në rast cënimi (mërzitjeje, rrënqethjeje, vrasjeje) *të shpirtit*, gjendjet emocionale të përjetuara janë të mundimshme, të dëshpëruara. Përqasja me përkthimin e tyre në gjuhën gjermane tregon se ky koncept është i huaj në gjermanisht. Në përkthim, vlerësimet apo gjendjet psikologjike të shprehura nga Kadareja me njësi frazeologjike jepen përmes kombinimit të drejtpërdrejtë të kuptimeve të gjymtyrëve të sintagmave, si psh: *pararoja e goditur fuqishëm, pararoja e keqtrajtuar sa më s'ka, ndjeva një zbrazëti, më mbuloi një rrënqethje.* Kjo bën që në përkthim të humbë figurshmëria e përdorur nga Kadareja dhe, gjithashtu, dramaciteti që synon të transmetojë Kadareja përmes përdorimit të frazeologjizmave. Vënia në gojën e kolonelit gjerman e frazeologjizmave tipike për mentalitetin shqiptar rrit tensionin dhe gjendjen dramatike të skicuar nga koloneli Schwabe gjatë darkës me Gurameton e madh. Nga ana tjetër, ato janë një mundësi përligjjeje për veprimet e mëpasme të ushtrisë gjermane të udhëhequr nga koloneli Schwabe.

4.6.2 Frazeologjizma me gjymtyrë emërore *mend/mendje*

Tabela 1: Darka e gabuar

	Kadare	Röhm	Lloji i ekuivalencës
1	*...me gjysmë mendjeje...*[1006]	*...mit dem verbliebenen Rest von Verstand...*[1007]	e pjesshme
2	*...mendja s`përqendrohej* dot...[1008]	... doch *fiel es schwer* sich auf die Frage *zu konzentrieren*[1009]	aspak
3	Përpara se të thonin *ka ikur nga mendja* doktor Gurametoja, një tjetër ndjesi ua mbajti frymën njerëzve, ajo e pendimit. Ishte një pendim i pafund e i pane.[1010]	"Ist Dr. Gurameto *denn verrückt geëorden*?" Das wäre wohl die reaktion der Leute gewesen, wenn nicht dieses grenzen, aber auch ein wenig richtungslose schlechte Gewissen sie stumm gemacht hätte.[1011]	Aspak

[1006] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 29.
[1007] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 23.
[1008] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 29.
[1009] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 23.
[1010] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 30.
[1011] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 23.

4	...ithtarët e doctor Gurametos së madh iu kthyen prapë dyshimit *për ikjen nga mendja të tij*. Që dikush *kishte ikur nga mendja* në këtë histori, kjo bënte mu[1012]	...um den schweren Vorwurf des Verrats zu begegnen, die Vermutung, Dokotr *habe* wahrscheinlich *den Verstand verloren.* Irgend jemand *war auf jeden Fall übergeschnappt*, man konnte nicht genau sagen[1013]	e pjesshme
5	Ky teprim i fantazisë ndihmoi që rikthimi i *mendjes së ikur* të bëhej më shpejt dhe qyteti të fitonte prapë gjykimin e ftohtë.[1014]	Diese Entgleisungen der Phantasie fördert die wiedererlangung *der zerstobenen Vernunft,* und die Stadt erhielt zurück ihre kühle Urteilskraft.[1015]	e pjesshme
6	...qyteti *mbante mend* darka të pazakonshme, të hareshme e të lemerishme...[1016]	...*kannte* die Stadt ungeëöhnliche Abendessen, fröhliche und tragische...[1017]	Apak
7	...*silleshin ndër mend* të tjera darka, shumica të pabesa, ngaqë, mesa dukej, ishin ato që më së shumti *mbaheshin mend*.[1018]	...verglich man es mit anderen Abendessen, an die man sich *erinnerte*. Meistens waren es solche, die böse geendet hatten, denn diese *prägt sich dem Gedächtnis* wohl besser *ein.*[1019]	-aspak -e pjesshme
8	...pa e *vrarë mendjen* më tej...[1020]	...*sich* nicht weiter *den Kopf* zu *zerbrechen*...[1021]	e pjesshme
9	...kjo *merrej me mend…*[1022]	...*stand fest…*[1023]	Aspak
10	...Kur grupi i tretë u lirua krejt befasisht, shumica *ranë në një mendje* se tradhtia e doktor Gurametos së madh kishte kaluar çdo kufi…[1024]	...Als überraschend die dritte, bis dahin größte Gruppe von Geiseln freigelassen wurde, *schloß die Minderheit daraus*, dass der Verrat der großen Doktor Gurameto alle Vorstellungen übertraf...[1025]	aspak
11	Të paaftë për shkoqitjen e kësaj mpirjeje të pashembullt, *mendja shkonte* vetvetiu te ndonjë dukuri e epërme, si ajo e Dynetshit..[1026]	Weil man keine Ursache für die beispiellose Erstarrung der Schläfer entdecken konnte, *dachte man* natürlich an ein übernatürliches Phänomen wie die Doppelnacht.[1027]	Aspak
12	...Me *kthjellimin e mendjes*, sytë, gjithashtu, po fitonin aftësinë të shikonin ato që duhej të shihnin...[1028]	...Am Ende aber *klärten sich* Blick und *Verstand*, und man gewann die Fähigkeit zurück, die Dinge so zu sehen, wie sie waren...[1029]	e pjesshme

[1012] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 33.
[1013] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 26.
[1014] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 34.
[1015] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 26.
[1016] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 35.
[1017] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 27.
[1018] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 35.
[1019] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 27.
[1020] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 42.
[1021] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 32.
[1022] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 60.
[1023] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 49.
[1024] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 62.
[1025] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 51.
[1026] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 72.
[1027] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 60.
[1028] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 73.
[1029] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 60.

13	...na e *bërë mendjen dhallë*, tha apendicisti...[1030]	...du *machst uns* einfach *konfus*, bescherte sich der Blinddarm...[1031]	aspak
14	...*mendja* nuk *i shqitej* dot nga teksti i këngës, e, bashkë me të, tmerri dhe afshi mekës ua këputnin gjunjët...[1032]	...*mußten sie an* das Lied *denken*, was neben der Aufregung und der stickigen Luft bewirkte, daß sie schwache Knie bekam....[1033]	Aspak
14	...shkurt më i lig nuk *mbahej mend*. Java e parë e tij i trandi të gjithë me befasitë tronditëse…[1034]	...An einen schlimmeren Februar *konnte man sich* nicht *erinnern.* Die erste Woche begann mit einem Schock...[1035]	Aspak
15	...*Mendjet punonin* si në ethe…[1036]	...*Die Gehirne arbeiteten* fieberhaft...[1037]	e pjesshme
16	... ia tha pjesën më të madhe atyre që *kishte bluar në mendje* 30 orët e fundit.[1038]	Er ratterte herunter, was er sich in den vergangenen 30 Studen *in Gedanken zurechtgelegt hatte*. Als er zu den Worten „Tu es ihnen nach!“ kam, kam es plötzlich zu einer Stockung in seinem Gehirn.[1039]	e pjesshme

Tabela 2: Gjenerali i ushtrisë së vdekur

	Kadare	Röhm	Buchholz/Fiedler	Lloji i ekuivalencës
1	...*vramë mendjen*...[1040]	wir *haben* uns später *den Kopf zermartert,*[1041]	Später *zerschmeterten ër das Hirn*...[1042]	-aspak -aspak
2	...*e merrte me mend*...[1043]	-	...und *stellte sich vor*...[1044]	- mungon - aspak
3	...ia *merr mendja*...[1045]	...aber die genaue Stelle *kennt* keiner...[1046]	...aber keiner *ahnt*...[1047]	- aspak - aspak
	Atij po i *merreshin mendtë* nga kjo furi e tërbuar, e rrezikshme dhe e ndritshme.[1048]	Der wütende, gefährliche, glitzernde Sturm *machte ihn schwindelig*.[1049]	..dieser gefährliche wildige, feuerige Sturm *raubte ihm die Besinnung.*[1050]	-aspak -e pjesshme
	..*me mend* hyri përsëri në dasëm.[1051]	*In Gedanken* kehrte er aber doch zu der Hochzeit zurück.[1052]	..doch *im Geist* begab er sich abermals auf die Hochzeit.[1053]	-e pjesshme -e pjeshme

[1030] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 95.
[10311031] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 81.
[1032] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 131.
[1033] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 113.
[1034] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 121.
[1035] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 104.
[1036] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 128.
[1037] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 110.
[1038] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 174.
[1039] Röhm, J. Ein folgenschwerer Abend, f. 152.
[1040] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 66.
[1041] Röhm, J., General der toten Armee, f. 85.
[1042] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 63.
[1043] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 170.
[1044] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 159.
[1045] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 184.
[1046] Röhm, J., General der toten Armee, f. 231.
[1047] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 174
[1048] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 185.
[1049] Röhm, J., General der toten Armee, f. 233.
[1050] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f.175.
[1051] Kadare, I., Gjenerali i ushtrisë së vdekur, f. 197
[1052] Röhm, J., General der toten Armee, f. 250.

Numri i frazeologjizmave të skeduara nga romanet e analizuara me gjymtyrë emërore emrin *mend/mendje* është pothuajse i njëjtë me ato me gjymtyrë emërore *shpirt*. Nëse ndalemi te lloji i ekuivalencës së vendosur midis romaneve të Kadaresë dhe përkthimeve, evidentojmë se në të shumtën e rasteve vendoset ekuivalencë e pjesshme midis versioneve të përqasura në shqip dhe në gjermanisht. Rastet me ekuivalencë të pjesshme nga përkthimi i romanit “Darka e gabuar” përbëjnë 33% të numrit të shembujve të analizuar, nga romani “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” 33% përkthyer nga Buchholz/Fiedleri dhe 0% nga Röhmi. Relativisht i madh është numri i rasteve me aspak ekuivalecë. Në romanin “Darka e gabuar” shifra arrin në 66,74 dhe në dy romanet e tjera 66,67% te Buchholz/Fiedleri dhe 100% te Röhmi.

Nga një analizë më e thelluar e shembujve konstatojmë se *mend/mendje* shërben si koncept jo vetëm për sferën burimore, por edhe për atë qëllimore. Kjo do të thotë, elemente konceptuale prej të cilave ndërtohet kuptimi i leksemës *mendje* shërbejnë si koncepte metaforike për zbërthimin e kuptimit të frazeologjizmit, por edhe si pikë projektimi e koncepteve metaforike të fushave të tjera burimore.

- Si sferë burimore:

Në shembujt *mbaj mend, silleshin ndër mend/sjell ndër mend, mbahej mend/mbaheshin mend,* mendja është përdorur për kujtesën, aftësinë për të kujtuar. Në gjermanisht asnjëra prej njësive frazeologjike shqip nuk ka gjegjëse ekuivalente. Ato përkthehen me folje që emërtojnë drejtpërdrejt procesin e kujtesës, si: *kannte* (kennen), *erinnern*. Përdorimi i foljes *kennen* (njoh) në kuptimin e rinjohjes, kuptimi i tretë i shënuar në fjalor presupozon që procesi ka lidhje me dije/informacione të ruajtura në kujtesë, të cilat mund të aktivizohen. Shembulli tjetër *mbaheshin mend* është përkthyer nga J. Röhmi në mënyrë metaforike: *sich dem Gedächtnis einprägen* (i nguliten kujtesës darka të pazakonshme), duke përdorur një njësi me ekuivalencë të pjesshme me variantin e Kadaresë. Kuptimi i njësisë *mbaheshin mend* i referohet një veprimi të përfunduar me vlerë përgjithësuese, implikon një veprim të përfunduar, ndërsa *i nguliten në mendje,* një aspekt tjetër të veprimit, i cili është në proces, në vazhdimësi dhe jo plotësisht i përfunduar.

Frazeologjizmi *e marr me mend*/*merrej me mend, ia merr mendja* lidhet me konceptin e përfytyrimit, e të kuptuarit. Edhe këto njësi frazeologjike nuk kanë gjegjëse ekuivalente në gjermanisht. J. Röhm i përkthen me foljet *feststehen, vorstellen, ahnen,* folje të cilat emërtojnë drejtpërdrejt kuptimin që emetojnë frazeologjizmat. Frazeologjizmi në shqip presupozon ngjarje apo ndodhi të tjera, gjykimi dhe vlerësimi i të cilave bën të mundur që rrjedhoja apo pasoja e tyre të jetë e vetëkuptueshme, të imagjinohet si e mundur. Nga përshkrimi i deritanishëm vëmë re se semantika e foljes *feststehen, vorstellen, ahnen* nuk përmbajnë implikaturën semantike që emetojnë frazeologjizmat në shqip.
Edhe në kotekstin ligjërimor në romanin „Darka e gabuar“ del qartë se është e pritshme, e imagjinueshme që gjermanët të kishin emra për personat që shtinë mbi pararojën gjermane, qoftë edhe nofka, të cilat do t´i kënaqnin gjermanët sipas motos: *kur s´ke pulën, ha sorrën.*[1054] Pritshmëria që presupozon frazeologjizmi nuk presupozohet nga semantika e foljes *feststehen* (vendos përfundimisht).

[1053] Buchholz, O./Fiedler, W., General der toten Armee, f. 187
[1054] Kadare, I., Darka e gabuar, f. 60. Karakterin kulturor të proverbave e kemi trajtuar edhe në kapitullin „Metaforat në romanet „Darka e gabuar“ dhe „Gjenerali i ushtrisë së vdekur“, në sythin

Po ashtu përfytyrimi i varrosjes së ushtarëve të kolonelit i zgjohet atij tek sheh punëtorët e komunales të kryejnë procesin e kundërt me atë të ngjarë vite më parë. Folja *përfytyroj* nuk implikon vazhdimësi të procesit, por një produkt imagjinate të përfunduar.
Në monologun e plakës Nicë, kuptimi i formës mohuese të frazeologjizmit lidhet me një përfytyrim me karakter universal të varrosjes së të vdekurve nën tokë. Përkundrejt këtij përfytyrimi, pritshmërie, e kundërta ka ndodhur me eshtrat e kolonelit të Batalionit V. Të dyja foljet e përdorura në përkthim *kennen* (njoh), *ahnen* (hamendësoj) devijojnë nga kuptimi i emetuar nga frazeologjizmi në shqip.

Në frazeologjizmin *ka ikur nga mendja/kishte ikur nga mendja* dhe variantet e sjella nga Kadareja *mendje e ikur, ikjen nga mendja, mendja* shikohet si aftësi për të menduar, për të njohur botën. Mungesa e kësaj aftësie konjitive njohëse presupozon largimin e saj për arsye të ndryshme. Në këtë rast leksemat gjegjëse në gjermanisht do të ishin *Verstand* und *Vernunft*. Me këto leksema ka frazeologjizma në gjermanisht që referojnë në këtë gjendje. Ato janë: *dir hat man wohl den Verstand geklaut* (fjalë për fjalë: ty të kanë vjedhur pa dyshim gjykimin) dhe *den Verstand verlieren* (të humbësh gjykimin). J. Röhm në përkthim e emërton më së shumti drejtpërdrejt gjendjen e krijuar nga moszotërimi i arsyes njëherë duke përdorur togun *werden verrückt* (të bëhesh i çmendur) dhe njëherë me foljen në kuptimin figurativ *überschnappen* (rrjedh).
Në të vërtetë, frazeologjizmi gjermanisht *të kanë vjedhur mendjen/gjykimin* nuk është ekuivalent i plotë me format dhe variantet e njësisë frazeologjike në romanin „Darka e gabuar“. Njësia frazeologjike *ka ikur nga mendja* jep një konstatim të gjendjes së mungesës së aftësisë konjitive njerëzore, pa iu referuar shkaqeve dhe pa gjetur pse-në. Në semantikën e njësisë mungon shkaktari i gjendjes, çka është e ndryshme në njësinë gjegjëse gjermanisht. Njësia frazeologjike gjermanisht *ty të kanë vjedhur mendjen,* e ligjërimit të thjeshtë, implikon një shkak/shkaktar të gjendjes, e cila në kotekstin në roman nuk mund të pohohet apo saktësohet. Edhe frazeologjizmi *den Verstand verlieren (*të humbësh mendjen) nuk i referohet një procesi plotësisht të përfunduar, ai presupozon shkaqe më së shumti implicite të cilat çojnë në një humbje. Thënia në të cilën është përdorur në gjermanisht *të humbësh gjykimin/mendjen* jep në njëfarë mënyre shpjegimin e pse-së së humbjes së logjikës, frikën për të mos e quajtur tradhtar. Koteksti tjetër ligjërimor në roman ku përdoret frazeologjizmi nuk le vend për të shqyrtuar dhe diskutuar mbi konstatimin. Kadareja ndërthur pikërisht konstatimin e arritur me frazeologjizmin *ikën nga mendja* me një tjetër frazeologjizëm, i cili motivohet nga një onomatope tingëllore *mu*, *bënte mu.* Në frazeologjizmin *bënte mu* kombinohen dy perceptime me njëra-tjetrën, ai pamor, me atë tingëllor, dukuri, e cila quhet sinestezi. Vëzhgimi i ngjarjeve së bashku me zhurmën që shkaktonin ato për t’u përhapur më tej shpinin grupin e njerëzve në përfundimin se Gurametoja i madh kishte humbur gjykimin. Nga ana tjetër, kombinimi i të dy frazeologjizmave në të njëjtën fjali bëhet me qëllim të caktuar nga Kadareja. Përdorimi i regjistrare ligjërimore të caktuar jep informacion edhe mbi statusin social të folësve. Bëhet fjalë pikërisht për një palë naive, infantile, e cila vëzhgimeve të jashtme dhe perceptimeve pamore u vesh vlerën e argumenteve, duke i quajtur kështu vlerësime të padiskutueshme, absolute. Nga ana tjetër, pikërisht, kjo mënyrë logjikimi i bënte edhe më qesharake vlerësimet e këtij grupimi. Pra, ironizimi

„ Evidentimi i marrëdhënieve të ekuivalencës së vlerave formale-estetike të metaforave në variantet shqip dhe gjermanisht të romanit “Darka e gabuar” “.

i një mënyre të tillë të arritjes në përfundime është një synim tjetër i shkrimtarit në këtë pasazh.

Frazeologjizmat *mendja shkon/shkonte, mendja bluan/bluante, mendja nuk i shqitej, mendja s'përqendrohej, mendjet punonin/medja punon, mendja* koceptualizon mendimin, procesin e të menduarit. Ato verbalizojnë intesitete dhe qëllime të ndryshme të mendimit; *mendja bluan* nënkupton përsiatjen, dmth., rrahjen e mendimeve, *mendja nuk i shqitet* prezupozon kohëzgjatje të mendimit për një çështje, ndërsa *mendja s'përqendrohej* mosfunksionim të procesit të të menduarit. Në gjermanisht ato vijnë të përkthyera përmes foljeve që shprehin të menduarin, si p.sh., *denken, sich konzentrieren* duke humbur masën, qëllimin dhe intesitetin që implikojnë frazeologjizmat në shqip. Folja *denken,* gjegjëse e njësisë frazeologjike *mendja shkon* dallon nga njësia në shqip, për shkak të presupozimeve të nënkuptuara. Kur themi *mendja shkon* nënkuptojmë një proces mendor të pavetëdijshëm, për të shpjeguar një dukurie të pazbërthyeshme, në rastin konkret, qëllimin dhe shkakun e muzikës nga shtëpia e Gurametos së madh. Kadareja ofron, mjeshtërisht, një variant shumë origjinal për zgjidhje: *dynetëshin.*

Mendja përdoret për kokën, për trurin në njësinë e ligjërimit të thjeshtë: *vramë mendjen*. *Kopf* (kokë) dhe *Hirn* (tru) janë leksema gjegjëse në sistem në gjermanisht. J. Röhm dhe O. Buchholz/ W. Fiedleri në përkthim japim frazeologjizmat ekuivalente me këto gjymtyrë. Edhe në këtë rast *mendja* konceptualizon të menduarin. Në bashkëlidhje me foljen *vras,* frazeologjizmi implikon elemente kuptimore që lidhen me kohëzgjatjen e mendimit dhe ndjenjën e shkaktuar nga ky proces, lodhjen. Këtë implikacion të nënkuptuar e shpreh drejtpërdrejt folja *zermartern* (lodh), e ligjërimit libror, e përzgjedhur nga J. Röhm. Kuptimi i dytë i saj shënohet në fjalor si lodhje e tepërt, si rrjedhojë e një të menduari të gjatë dhe torturues. Folja tjetër që përzgjedhin O. Buchholz/ W. Fiedleri *zerschmettern* (shkattërroj, asgjësoj) i hiperbolizon pasojat e shkaktuara nga veprimi i të menduarit.

Ekuivalencë e pjeshme vendoset midis frazeologjizmit *kishte bluar në mendje* dhe përkthimit *sich in Gedanken zurechtgelegt hatte* (kishte bërë gati në mendime). Në semantikën e foljes në gjermanisht, si edhe në shqip, implikohen momenti i përsiatjes, përgatitjes për një pozicionim të caktuar. Por, në shqip, shkalla e idiomaticitetit të frazeologjizmit është më e madhe. Folja *bluaj* përdoret në kuptimin e saj figurativ. Semantika e foljes *bluaj* presupozon rrahje dhe analizë të problemit, bazuar mbi analizën e elementeve më të vogla përbërëse të tij. Forma më se e kryer e foljes në gjuhën shqipe, nënkupton një veprim të përmbushur në momentin e ligjërimit, me të tashmen e ligjërimit. Kjo do të thotë, që veprimi sipas kuptimit të foljes *bluaj* ka përfunduar përpara çastit të ligjërimit në rrëfim.

Frazeologjizmi *ranë në një mendje/bie në një mendje* qëndron për dakordësi, vendim. Për këtë frazeologjizëm mungon gjegësja ekuivalente në gjermanisht, ajo përkthehet me *schließen* (nxjerr një përfundim nga shqyrtimi i situatës). Semantikat e foljeve në shqip dhe gjermanisht kanë implikaturë të ndryshme.

Siç del edhe nga analiza e deritanishme, të gjitha frazeologjizmat në shqip u referohen kuptimeve që përmblidhen në vëllimin kuptimor të leksemave *mend/mendje*. Në frazeologjizmat e shqyrtuara gjejmë të shprehura jo vetëm kuptime të veçanta, por edhe implikacione dhe presupozicione që lidhen me aspekte, intensitete, qëllime të

kuptimeve. Diferenca me gjegjëset gjermanisht rezulton padyshim nga mungesa e një ekuivalenteje të plotë me leksemën mend/mendje në shqip.

- Sfera qëllimore e projektimit metaforik të frazeologjizmave me *mend/mendje*:

Mendje shërben edhe si pikë projektimi për të treguar pavendosmëri, paaftësi ose aftësi jo të mirë në gjykim në frazeologjizmin: *me gjysmë mendjeje*. Sipas parimit plot është mirë, gjysma tregon lëkundje, gjykim, mendim jo të mirëpeshuar, Röhmi e përkthen frazeologjizmin me njësinë gjuhësore: *mit dem verbliebenen Rest vom Verstand* (me gjysmën e mbetur të gjykimit). Gjykimi konceptualizohet në gjuhën shqipe si njësi e matshme – prandaj flasim për gjysmë mendjeje, mendje të mbushur plot – ndërsa në gjermanisht, jo.

Frazeologjizmi *me kthjellimin e mendjes* referon mbi një gjendje qartësie që shoqërohet edhe me një gjykim të mirë dhe të drejtë. Gjegjësja në gjermanisht *klärten sich Blick und Verstand* është ekuivalente e pjesshme me frazeologjizmin në shqip. Si në shqip dhe në gjermanisht kuptimi përcaktohet sipas metaforës orientuese *e pastër/e khtjellët* që vlerësohet pozitivisht, përkundrejt të kundërtës të errëtën/ të pistën. Përdorimi në shqip i emrit tregon për shkallën e abtraksionit më të madh në gjuhën shqipe, krahasuar me gjegjësen në gjermanisht.

Më merren mendtë referon në një gjendje jo të mirë drejtpeshimi, si pasojë e një lodhjeje fizike, psikologjike apo marrjeje të një sasie të tepruar alkoli mbi masë. Metafora orientuese e qëndrueshmja është mirë, e kundërta jo mirë shërben si mjet motivimi për shpjegimin e gjendjes së krijuar nga lëvizja, rrotullimi i trurit. Gjegjësja ekuivalente mungon në përkthimin e J. Röhmit, ai e emërton me shprehjen *mir ist schwindelig* (mua më rrotullohet, fjalë për fjalë: mua më është e rrotullueshme). Në semantikën e përcaktorit kallëzuesor *schwindelig* implikohen elemente konceptuale që shkakton veprimi i të rrotulluarit, pikërisht, të rrotulluarit e trurit, mendjes. Me një shkallë figurshmërie më të lartë e përkthen shprehjen Buchholz/Fiedleri. Shprehja *die Besinnung rauben* ndërtohet mbi kuptimin metaforik të foljes *rauben* (vjedh) me emrin *Besinnung* (të menduarin). Përkthyesit përmendin gjëmimin e daulles, ngashërimën e violinave, dinamikën e valles, shkaktare për gjendjen e krijuar, që referon në një paaftësi në të menduar, pasojën. Personalizimi i drejtpërdrejtë në përkthim i mjeteve zhurmëprodhuese i lejon përkthyesit të përdorin foljen *rauben* (vjedh). Kadareja e përdor frazeologjizmin në diatezën pësore, strukturë që i lejon atij theksimin e gjendjes së krijuar dhe jo të shkaktarëve. Është gjendja psikologjike e gjeneralit ajo që vendoset në fokus të ligjërimit dhe që skicohet po me aq detaje deri në çastin e hyrjes së plakës Nicë me thesin në kurriz.

Frazeologjizmi *m´u bë mendja dhallë* përcakton një gjendje të lodhur, të turbullt. Mendojmë se kuptimi lidhet me implikacionin që ngërthen kuptimi i leksemës *dhallë*: duke qenë diçka e tepërt që mbetet pas prodhimit të gjalpit, ajo shihet si jo e dobishme, jo e mirë. Shndërrimi i mendjes/trurit nga një substancë me formë të përcaktuar në të lëngët, pa formë, sigurisht shkakton një gjendje të paformë, pa konture, dmth. konfuzion. Dhalla është një lëng tipik për kulturën shqiptare, por jo gjermane. Prandaj edhe në përkthim mungon gjegjësja ekuivalente.

Si përfundim mund të themi, se përfytyrimet tona të përditshme metaforike bazohen në imazhe. Për të gjitha somatismat në veprat e analizuara mund të themi se konceptet

metaforike të tyre janë të lidhura me imazhe dhe përfytyrime që kemi për pjesët përkatëse të trupit. Ato pasqyrojnë funksione të organeve me të cilat lidhen, madhësinë dhe gjendjen e tyre. Kështu, p.sh., goja është për të folur, shprehur mendime, sytë për të parë, për të shquar, duart për të kapur, vepruar, këmbët për të lëvizur. Nga ana tjetër nëpërmjet somatizmave shprehen dhe përshkruhen gjendje emocionale, karaktere, veprime. Emocionet që verbalizohen përmes somatizmave mund të jenë universale. Somatizmat shprehin simbolikën e gjuhës së trupit, si dhe tradita e parafytyrime. Si të tilla, ato mund të mbartin edhe veçanti në secilën prej gjuhëve që përqasim.

Përfundime të përgjithshme

Në këtë pjesë të punimit do të parashtrojmë përfundimet e përgjithshme që arritëm gjatë shtjellimit të punimit.

Në punimin tonë "*Vështrim krahasues mbi veçantitë leksiko-semantike në disa vepra në prozë të I. Kadaresë në variantet shqip dhe gjermanisht"* paraqitëm, trajtuam, analizuam dhe përqasëm koncepte, përftesa, parametra, instrumente të rëndësishme të lidhura me domethënien e tekstit letrar në përgjithësi dhe me atë të prozës së Kadaresë në origjinal dhe në përkthim në veçanti, duke u përqendruar kryesisht në procedetë e natyrës leksiko-semantike, të cilat në tekstin letrar ngjyrojnë ligjërimin dhe i japin shprehësi dhe vlera estetike atij.
Por ndërmarrja jonë shkencore pati një përparësi: duke u pozicionuar në hapësirat e shkencave të ligjërimit, veçanërisht në hapësirën e gjuhësisë kognitive, gjuhësisë së tekstit, pragmatikës, semanikës tekstore, traduktologjisë..., etj., analiza jonë u mbështet në dy përvoja të ndryshme receptive, e për pasojë, në dy procese ndërtimore tekstore mesazhmarrëse si pasojë e këtij receptimi – në tonën, si lexues (model) të tekstit në shqip; dhe, së dyti, në atë të përkthyesve J. Rohm, O. Buchhols, W. Fidler, si lexues (model) të tekstit në shqip, por njëherazi bartës të një situate leximore interpretative të lidhur ngushtë me mentalitetin e kulturën gjermane; për më tepër, në rolin e përkthyesit, ata ishin të kushtëzuar më së tepërmi nga veçantitë e gjuhës dhe kontekstit kulturor gjerman në përvijimin e kuptimit të tekstit në gjermanisht. Ne u pozicionuam sërish në shqyrtimet tona si receptues edhe të tekstit në gjuhën gjermane. I tërë ky proces shqyrtimi shfaqej i ndërlikuar, dhe parakuptonte gjerësi në këndvështrime.
Përqasja e këtyre proceseve të ndërtimit të kuptimit të tekstit si lexues/studiues/përkthyes na përforcoi idenë që teksti në prozë i I. Kadaresë është shumëvlerësh: ai përmban tharmin, substancën dhe mjetet gjuhësore, letrare e estetike prej të cilave në procesin e receptimit e ndërtimit të kuptimit, lexuesi përvijon vlera dhe përjeton kënaqësi estetike; për më tepër, përkthyesi është i nxitur maksimalisht të përftojë vlera edhe në procesin e përkthimit, duke u pozicionuar paraprakisht si një lexues model, nëse do të shpreheshim me termin e U. Eco-s. Analizat na çuan në përfundimin e rëndësishëm që vlerat përgjithësisht janë transmetuar, duke ruajtur të pranishme veçantitë gjuhësore, konceptualizimet dhe zgjidhjet kulturore në të dyja realitetet tekstore – shqip dhe gjermanisht. Dhe përderisa ato vlera përvijohen si veçanti, atëherë kërkimi shkencor na çoi në përshkrimin dhe interpretimin e tyre, procedurë kjo që endej lirshëm në hapësirat e shkencave të ligjërimit, por edhe më gjerë, në dijet që kanë të bëjnë me filozofinë, etikën, etnopsikologjinë, etj.
Marrëdhëniet ndërdisiplinore në kërkimin shkencor aktualisht janë karakteristikë dalluese e studimeve të kësaj natyre dhe të një objekti të tillë studimi. Ne ishim po ashtu të detyruar nga objekti ynë i studimit, metodologjitë e përzgjedhura për analizë, kategoritë dhe konceptet me të cilat shqyrtuam, që t'i vendosnim interpretimet tona edhe në këto hapësira ndërdisiplinore, e për më tepër, t'i bënim dijet e tyre jo pak herë bazë për interpretimet tona.
Gjithsesi, pavarësisht hapësirës së gjerë në të cilën vendosëm dukuritë, pavarësisht natyrës së larmishme të dijeve që vinin nga disiplina të ndryshme gjuhësore të shkencave të ligjërimit, në analizat tona u përqëndruam në shqyrtimin e veçantive kuptimore që shfaqin njësitë gjuhësore, të tilla si leksemat, sintagmat, thëniet, por edhe tingujt-fonema (në procesin e përftimit të simbolizmit tingullor), ndaj mund të

pohojmë tashmë të sigurt se në prozën e Kadaresë janë të pranishme përpunimet gjuhësore të të gjitha njësive, përdoren mjeshtërisht procede përmes të cilave njësitë e sistemit gjuhësor në procesin e përdorimit përftojnë vlera estetike dhe mundësojnë jo thjesht informacione në lidhje me brendinë e mesazheve të tejçuara, por, përmes tyre, mundësojnë edhe nxitje për zbërthim të nënteksteve të bartura; dhe në këtë proces, përjetime intensive estetike.

Përqasja e vlerave të përftuara në dy realitetet tekstore, në shqip dhe gjermanisht, na thellon bindjen se gjetjet gjuhësore, konceptuale dhe pragmatike të tekstit në shqip të Kadaresë janë të natyrave elitare, superiore, që gjejnë format e përshtatshme edhe në gjuhën gjermane dhe në kontekstin e kulturës dhe mentalitetit të përdorimit të mjeteve shprehëse në atë gjuhë. Rendja jonë pas përshkrimit dhe inventarizimit të veçantive në fushën tingullore (aspekti ikastik në ligjërim), në atë të leksemave (interpretimi i përdorimeve të shtresave të ndryshme leksikore, në përputhje me informacionin dhe ndjesitë e përçuara e në rezonancë me kushtëzimet socio-kulturore e historike), të veçantive kuptimore të përftuara në procesin përdorimor të këtyre njësive, duke përftuar nëntekstet e mundshme a lakunat semantike (një mori gjetjesh interesante të Kadaresë në formën e implikaturave dhe presupozicioneve të natyrave të ndryshme semantike e pragmatike); po ashtu, rendja jonë pas përshkrimit dhe inventarizimit të metaforave dhe kuptimeve metaforike të përftuara në kontekste e kotekste të caktuara, të veçantive të sintagmave të natyrave të ndryshme, të ngulitura ose jo (njësive frazeologjike dhe veçanërisht atyre të mbështetura në pjesë të ndryshme të trupit), pra, rendja pas të gjithë këtyre elementeve të analizave empirike në veprat në prozë të Kadaresë, në të dyja versionet, na mundësoi përvijimin e idesë tjetër të rëndësishme në këtë punim, që tekstet e Kadaresë, aq të pasur e të ngjeshur në vlera dhe përpunime gjuhësore, imponojnë situata leximore të suksesshme në gjuhë të ndryshme, kur procesi i receptimit të tyre dhe më tej ai i përvijimit/ndërtimit të kuptimit bëhet nëse është analizuar mesazhi tekstor i Kadaresë në mënyrë shumëplanëshe: semantike, pragmatike, psikologjike, estetike, sociohistorike, etj.

Ndaj përballë teksteve në prozë të Kadaresë, përkthyesit qëmtojnë dhe përqokin vlera nga më të spikaturat në gjuhën dhe kulturën e tyre; ndaj përballja me tekstet në shqip dhe gjermanisht kanë të nevojshme kalimin nëpër një ecuri që do të nxjerrë në pah, më së paku, edhe tregues të tillë si: përcaktimin e kuptimit të tekstit si konfigurim dijesh, ku shtresohen dije llojesh të ndryshme, si dijet semantike, dijet proceduriale, dijet enciklopedike; kushtëzimin e domethënies nga sfondi sociokulturor, lidhjet emocion-njohje-gjuhë dhe trajtimin e emocioneve si sistem të njohjes dhe vlerësimit; kushtëzimet e tekstit letrar, të kuptimit/domethënies së tij nga sfondi sociokulturor; lidhjet lakuna gjuhësore - lakuna kulturore me raportet kulturë-gjuhë (që ne i gjetëm në formën më të dukshme në romanin“Prilli i thyer”); kategorizimin e përftesave dhe instrumenteve që lidhen me kombinimet e qëllimshme tingull-kuptim në zbërthimin e mesazhit të veprës (“Gjenerali i ushtrisë së vdekur” na ofroi një larmi përftesash dhe kombinimesh nga më domethënëset dhe funksionalet); ngjizjen e kuptimit me shoqërim idesh në grupin e metaforave dhe kategorive gjuhësore që lidhen me interpretimin, si presupozimet, implikaturat etj.; dallimin e koncepteve metaforike që përngjashmojnë në të dyja gjuhët (analiza e somatizmave nga ana jonë qe një mënyrë jo vetëm për t’i shqyrtuar në mënyrë empirike, konkrete ato përngjashmime ose diferenca, por qe edhe një mënyrë për të parë se si sillen gjuhët në përftimin e ngjyrimeve, dhe sa funksionale bëhen ato kur përdoruesi/shkrimtari/përkthyesi zotëron kompetencat e duhura).

Po ashtu, analiza e shtresave të veçanta të fondit leksikor në veprat e marra për analizë, si neologjizmat, arkaizmat, huazimet tregon kushtëzimet e domethënies së

kësaj shtrese të leksikut nga sfondit sociokulturor dhe domosdoshmërinë e aktivizimit të dijeve që lidhen me sfondin sociokulturor në rrokjen e domethënies së shtresave të ndryshme të këtij fondi.
Vlerat kuptimore të grupimeve të kategorizuara shfaqen vetëm në tekst dhe rroken në të gjitha nuancat dhe ngjyrimet e tyre vetëm nëse shqyrtohen vlerat kuptimore, që rrjedhin nga konteksti dhe mbahen parasysh të veçantat dhe të përbashkëtat e kontekseteve të ndryshme sociokulturore në gjuhë të ndryshme. Shqyrtimi i këtyre vlerave në të dyja gjuhët mundëson të vlerësohet jo vetëm teknologjia e përftimit të mjeteve të këtyre shtresimeve në të dyja gjuhët, por sidomos të dalë në pah vlera që përftohet nga përdorimi i tyre aktualisht në gjuhë, me funksione jo thjesht informative, por edhe stilistike e estetike.
Në mënyrë të veçantë realitetet tekstore në të dyja gjuhët shfaqin vlera dhe veçanti në mënyrën e organizimit dhe përdorimit të mjeteve gjuhësore që nxisin për të plotësuar të pathënën a të ashtuquajturat lakuna semantike. Ndaj shqyrtimet përgjatë punimit u përqendruan në dukurinë e lakunave.
Vlerat kuptimore në prozë, në tekstin origjinal dhe në versionet e përkthyera, përkapen nga lexuesi apo shqyrtohen dhe rindërtohen nga ai, nëse procedurat e ndërtimit të kuptimit synojnë të plotësojnë të pathënën ose të nënkuptuarën. Siç theksuam përgjatë punimit, nga autorë të ndryshëm kjo dukuri është emërtuar dukuria e lakunave. Proza e Kadaresë, e pasur në nëntekste, imponon këndvështrime që nxiten përmes teorisë së lakunave, sepse teksti i Kadaresë është polisemantik dhe duhet rindërtuar çdo kuptim i tij. Analiza përmes teorisë së lakunave na ka çuar në përfundimin, që përkthyesit e Kadaresë kanë gjetur në tekstin e tij një hapësirë tejet të gjerë, ku kanë vendosur gjetjet e tyre, ku kanë shfaqur kompetencën e tyre gjuhësore, tekstore, estetike.
Teksti i J. Röhmit dhe O. Buchholz/ W. Fiedlerit është një rindërtim apo një plotësim i të nënkuptuarës në tekstin e Kadaresë dhe një ‘tjetër’ tekst, i cili, edhe vetë, shfaq veçanti të reja. Në këtë proces zinxhir të përftimit të domethënieve, na çuan përqasjet e bëra në variantet shqip dhe gjermanisht.
Analiza e një numri të madh fjalësh - emërtime dukurish dhe objektesh etnografike që mbajnë shenjën e kulturës së një kohe të shkuar - nxori në pah ndryshime kuptimore dhe përdorimore të elementeve të sistemit. Parimi i përkthimit sipas së tretës së krahasueshme ose parafrazimi, janë procede të përdorura nga përkthyesi për mënjanimin e lakunave gjuhësore, kulturore dhe etnografike. Përqasja e varianteve shqip dhe gjermanisht sipas teorisë së lakunave nxori në pah edhe elemente, dukuri dhe komponente që paraqesin vështirësi në përkthim. Të tilla, për gjuhët që përqasim, janë shtresat e veçanta të leksikut që emërtojnë koncepte, nocione jo të njëjta në të dyja gjuhët; të tilla janë gjithashtu disa kategori të sistemit gjuhësor, si modelet e ndryshme të fjalëformimit, mënyra dëshirore dhe habitore, kategoritë foljore refleksive/jorefleksive, rendi i ndryshëm i gjymtyrëve në fjalitë e nënrenditura; e po ashtu, disa veçanti të stilit që lidhen me përdorimin e shpeshtë të emrave abstraktë, me krijimin e neologjizmave, me përftimin e stilemave me anë të zgjerimit, me dukurinë e përsëritjes së fjalëve me peshë të konsiderueshme kuptimore, etj.
Një element tjetër i rëndësishëm në shqyrtimet e njësive që bëhen bartëse të shprehësisë është analiza e funksionit ikastik/evokativ. Kjo analizë ka të bëjë me raportin e substancës dhe formës tingullore, me kuptimin e shenjës, me vetitë e tingujve të gjuhës dhe ndërthurjetn tyre, dendurinë e shpërndarjen e tyre. Kuptimi i tekstit u vështrua në disa komponente, shtresa apo plane në të cilat ai ngjizet; përmes kësaj analize për funksionin ikastik në ligjërimin në prozë të Kadaresë u arrit të

analizohen më nga afër dhe më thellë vlerat që përftohen nga përdorimi i onomatopeve, pasthirrmave, aliteracionit, personifikimit, foljeve performative, etj.
Nga ana tjetër, në prozën e Kadaresë, metaforat dhe kuptimet metaforike të mbishtresuara në thënie shndërrohen në formë ekzistence të ligjërimit dhe diskursit letrar në veprat e tij.
Metaforat, si përpunime madhore të kuptimeve referenciale, i ofrojnë teksteve vlera në procesin e receptimit të tyre, sepse bëhen bazë për interpretime të fushave të ndryshme në shenjim. Kadare është mjeshtër i bashkëshoqërimit të fushave të ndryshme, të konceptualizimeve të ndryshme, duke përftuar, në këtë mënyrë, variacion në mendim dhe në të shprehur. Kjo mënyrë shenjimi është mendimore dhe perceptive. Në mënyrë të veçantë, vlera përbëjnë përdorimet e përftuara përmes sinestezisë, pra, bashkëshoqërimet ndjesore të shqisave të ndryshme.
Përkthyesit kanë njohur në thellësi jo vetëm teknikën e përftimit të metaforave në gjuhën shqipe dhe gjermane, por edhe vlerat që fitojnë përdorimet metaforike në procesin përdorimor të gjuhës në tekst.
Ndaj, versionet në gjermanisht na kanë dhënë një gamë të gjerë vlerash, që vërehen në metaforat e leksikalizuara, por, në mënyrë të veçantë, në ato inovative. Nga analiza e grupimeve të metaforave të kategorizuara sipas shkallës së ekuivalencës, u tregua se, vlerat përdorimore të metaforave, të përcaktuara edhe nga presupozimet dhe implikaturat, nuk mund të realizohen në përkthim pa probleme. Nga analiza e grupimeve të metaforave që paraqesin vështirësi në transmetimin e vlerave kuptimore në diskurs, u evidentuan metaforat e leksikalizuara, pikërisht, si rrjedhojë e ndryshimeve kulturore, të ngulitura tashmë në secilën gjuhë. Ndërsa metaforat e paleksikalizuara, edhe pse janë kombinime fushash, imazhesh të reja, paraqesin vështirësi në përkthim, pikërisht sepse këto bashkëshoqërime fushash janë të pangulitura.
Në këtë kuadër, një grup të veçantë në përftimin e veçantive në secilën gjuhë, veçanti që lidhen me materien gjuhësore, por edhe konceptualizimet dhe mentalitetet në receptimin e mesazheve të natyrave të ndryshme, me mjete shenjuese të ndryshme, përbëjnë përdorimet që lidhen me gjymtyrë të trupit. Somatizmat nga romanet e analizuara të Kadaresë, kanë më së shumti një mekanizëm motivimi të njëjtë, sepse, si koncept metaforik bazë, shërben funksioni i tyre, madhësia apo gjendja e tyre. Në rastet kur si mekanizëm motivimi shërbejnë përvoja, tradita dhe parafytyrimet, somatizmat ndërtohen mbi koncepte metaforike jo gjithnjë të njëjta në të dyja gjuhët. Sfonde të ndryshme sociokulturore kristalizojnë edhe koncepte metaforike, që herë përngjashmojnë dhe herë dallojnë nga njëri-tjetri.

Nga analizat e bëra arrijmë në konkluzionin që vlerat e mirëfillta gjuhësore-estetike të përzgjedhjeve leksiko-semantike të Kadaresë, përveçse kanë përftuar një univers të tërë vlerash në tekstin shqip, kanë nxitur përpjekjet dhe përzgjedhjet gjuhësore të përkthyesve, teksti i të cilëve herë përngjashmon me imazhet dhe domethëniet e tekstit në shqip dhe, herë të tjera, ka sjellë suksesshëm gjurmët e një konceptualizimi të përftuar nga gjuha dhe kultura gjermane. Në çdo rast, tharmi ekzistues në tekstin e Kadaresë ka nxitur dhe ngjizur vlera të shumëfishta në procesin e receptimit në të dyja gjuhët.

Bibliografia

Ammer, Karl, *Einführung in die Sprachwissenschaft. Bd. 1*, Halle (Saale), 1958

Baldauf, Christa, *Metapher und Kognition. Grundlagen einer neuen Theorie der Alltagsmetapher*. Frankfurt a. M.: Lang, 1997.

Beckermann, Ansgar/ Stephan, Achim, Stichwort Emergenz, 1994.

Beyer, R., *Zur Differenzierung des kognitiven Aufwandes bei der Anregung von Vorwissen*, në, Zeitschrift für psychologie (botuar nga) Beyer, R; Artz, E.; Guthke, T. , Leipzig 198/1, 1990, fq 9-32.

Bousfield. W. A.,*The occurence of clustering in the recall of randomly arranged associates*, në, Journal of General Psychology 49.

Burger, Harald, Phraseologie in der Presse, në, *Phraseme und typisierte Rede*, (botuar nga) Nicole Fernandez Bravo et al, f. 77-89.

Burger, Harald, Phraseologie (und Metaphorik) in intertextuellen Prozessen der Massenmedien, në, *Europhras 2000, Internationale Tagung zur Phraseologie vom 15.-18. Juni 2000 in Aske/Schweden*, (botuar nga) Palm-Meister, Christine, Tübingen, Satufenberg, f. 5-13.

Busse, Dietrich, *Textinterpretation: sprachtheoretische Grundlagen einer explikativen Semantik*. Opladen, 1992.

Bußman, Hademud., *Die dreiwertige Logik der Sprache*, Berlin, 1991.

De Beaugrande, Robert-Alain/ Dressler, Wolfgang Ulrich, *Einführung in die Textlinguistik*, Tübingen, 1981.

Carston, Robyn, *Thoughts and utterances. The pragmatics of explicit communication.* Oxford, Blackwell, 1999.

Christophe, Alain, Das Phrasem im literarischen Text: interne und externe Kohärenz, në, Europhras 2000. Internationale Tagung zur Phraseologie vom 15-18. Juni 2000 in Aske/Schweden, (botuar nga) Palm-Meister Christine, Tübingen, Stauffenburg, 2004, f. 25-35.

Collins, Allan M., Retrieval time from semantic memory, në, *Journal of Verbal Learning and.Verbal Behavior, 8:2,* (botuar nga) Collins, Allan M. /Quillian, M. Ross.

Collins, Allan M., A spreading-activation theory of semantic processing, në, *Psychological Review 82*, 1975, *(botuar nga)*Collins, Allan M. / Loftus, E. F., fq. 407-428.

Coseriu, Eugenio, *Textlinguistik: Eine Einführung*. Tübingen, 1981.

Coseriu, Eugenio, *Sprachkompetenz*, Tübingen, Gunter Narr Verlag, 2007.

Çabej. Eqerem/ Xhuvani, Aleksander, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962.

Damasio, Antonio, R., *Descartes´Irrtum. Fühlen, Denken und das menschliche Gehirn*, München u.a., List, 1997.

Damasio, Antonio, *Selbst in der Mensch: Körper, Geist und die Entstehung des menschlichen Bewusstseins*, München, Siedler, 2011.

Davidson, Donald, What Metaphors Mean, në, *Inquiries into Truth and Interpretation*, (botuar nga) Donald Davidson Oxford, Clarendon, 1984, f. 343-370.

Dedecius, Karl, *Die Kunst der Übersetzung*, Berlin, Logos, 2002.

Dibra, Klodi/ Varfi, Nonda *Gjuhësi teksti*, Tiranë, 2005.

Dobrovol´skij, Dmitrij, Textbildende Potenzen von Phraseologismen, në, *Textlinguistik und Stilistik. Beiträge zu Theorie und Methode*, (botuar nga) Fleischer, Wolfgang, Akademie der Wissenschaften der DDR. Linguistische Studien. Reihe A, Arbeitsberichte 164, 1987, f. 69-85.

Dobrovols´kij, Dimitrij/ Piirainen, Elisabeth, *Zur Theori der Phraseologie. Kognitive und kulturelle Aspekte.* Tübingen, 2009.

Durham, Mary Edith, *The Burden of the Balkan*. London, Edward Arnold, 1909.

Elsie, Robert, *Leksiku i Kulturës Popullore*, Tiranë 2005.

Engelkamp, Johannes, Die Repräsentation der Wortbedeutung, në, *Handbuch der Lexikologie*, Königstein/Ts, (botuar nga), Christop Schwarze/ Dieter Wunderlich,1985, fq. 292-313, këtu fq. 299.

Ertelt-Vieth, Astrid, *Kultur modellieren aus empirisch- induktiver Sicht*, Frankfurt/Main, Verlag für interkulturelle Kommunikation,1999.

Ertelt-Vieth, Astrid, *Interkulturelle Kommunikation und kultureller Wandel*, Tübingen, Gunter Narr Verlag, 2005.

Fleischer, Wolfgang, *Phraseologie der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen, Niemeyer, 1997.

Földes, Csaba, Über die somatischen Phraseologismen der deutschen, russischen und ungarischen Sprache. Versuch einer konfrontativen Analyse, në, *Germanistisches Jahrbuch DDr-UVR. Hrsg. vom Deutschlektorat beim Kultur- und Informationszentrum der DDR in Budapest. Bd. 4.* Budapest. 1985, f. 18-40.

Genette, Gérhard, *Figures*, Paris, 1976.

Gilles/ Raemdonck Dan Van, *100 fiches pour comprendre la Linguistique*. Bréal, 1999.

Glaton, Francis, *Psychometric experiments,* Brain 2, 1980.

Glück, Helmut, Paraphrase, në, *Fremdsprachen in Geschichte und Gegenwart*, (botuar nga), Helmu Glück, Wiesbaden, Harrasowitz, 2005.

Gramatika e Gjuhës Shqipe I, (botuar nga) Akademia e Shkencave, Tiranë 2002.
Gramatika e Gjuhës Shqipe II, (botuar nga) Akademia e Shkencave, Tiranë 2002.

Grau, Oliver/Keil, Andreas, *Mediale Emotionen. Zur Lenkung der Gefühle durch Bild und Sound*. Frankfurt am Main, Fischer, 2005.

Hans, Arens *Sprachwissenschaft, der Gang ihrer Entwicklung von der Antike bis zur Gegenwart*, I, Fischer Verlag, 1969

Hartung, Wolfdietrich, Linguistische Zugänge der sprachlichen Kommunikation, në, *Kommunikation und Wissen. Annährungen an ein interdisziplinäres Forschungsgebiet*. (botuar nga) Hartung, Berlin, 1991, fq. 1-90.

Heinemann, Wolfgang/Viehweger, Dieter, *Textlinguistik: eine Einführung*. Tübingen 1991.

Hirschfeld,, Lawrencw A./ Gelmann, Susan, A., *Mapping the Mind. Domain Specifity in Cognition und Culture*, Cabridge, Cambridge University Press, 1994.

Koller, Werner, *Einführung in die Übersetzungswissenschaft*. Heidelberg/Wiesbaden, 1992.

Iser, Wolfgang, *Der Akt des Lesens - Theorie ästhetischer Wirkung*, München, Wilhelm Fink Verlag, 1976.

Iser, Wolfgang, Die Appellstruktur der Texte, në, *Rezeptionsästhetik*, (botuar nga) Rainer Warning, München, 1994.

Ismajli, Rexhep, *Shumësia e tekstit*, Prishtinë, 1977.

Jakobson, Roman, *Linguistische Aspekte der Übersetzung, Ausgewählte Texte*, Suhrkamp Verlag, 1982.

Jauß, Hans Robert, *Literaturgeschichte als Provokation der Literaturwissenschaft*, Frankfurt, 1967.

Juli Zeh, Zur Höhle mit der Authentizität! *Die Zeit 39,21.09.2006*.

Kade, Otto, *Kommunikationswissenschaftliche. Probleme der Translation*, Darmdtadt, 1998.

Klix, Fridhardt, Über Wissensrepräsentation im menschlichen Gedächtnis, në, *Gedächtnis –Wissen – Wissensnutzung.* Berlin, 1984, fq. 9-73.

Klix, Fridhardt/Sydow, Hubert, *Zur Psychologie des Gedächtnisses*. Berlin, 1977.

Kintsch, Walter, *Gedächtnis und Kognition*. Sprinter Verlag Berlin, 1982.

Kittay, Eva Feder, *Metaphor. Its Cognitive Force and Linguistik Structure*. Oxford, Clarendon, 1987.

Koller, Werner, *Einführung in die Übersetzungswissenschaft*, München, Wiebelsheim, Quelle & Meyer, 2001.

Körtner, Uhlrich H. J. *Der inspirierte Leser*, Göttingen, 1994.

Lang, E. Paraphraseprobleme I. Über verschiedene Funktionen von Paraphrasen beim Ausführen semantischer Analysen, në, *Linguistische Studien, Beiträge zur semantischen Analyse. Reihe A, Arbeitsberichte, Nr. 42*,1977, f. 25-40.

Lechner, G., *Sprachform von Dichtung*. Berlin, Weimar 1984.

Leontjew, Alexej A., *Zur Psychologie der sprachlich-kommunikativen Einflussnahme,* në: *Probleme der Psycholinguistik*. Berlin, 1975.

Leontjew, Alexej, *Psikolinguistische Einheiten und die Ergänzung sprachlicher Äusserungen,* München, Max Huber Verlag, 1977.

Liebert, Wolf-Andreas, *Metaphernbereiche der deutschen Alltagssprache. Kognitive Linguistik und die Perspektiven einer kognitiven Lexikographie.* Frankfurt a. Main, Lang, 1992.

Linke, Angelika/ Nussbaumer, Markus/ Portmann, Paaul R., *Studienbuch Linguistik*, Tübingen, 1991.

Locke, John, *An essay concerning human understanding*, Ed. By Roger Woolhouse, Penguin Books, 1997.

Lutzeier, Peter Rolf, *Linguistische Semantik.* Stuttgart, 1985.

Lyons, John, Bedeutungstheorien, në, *Sematik: ein internationales Handbuch der zeitgenösisschen Forschung. Semantics*, (botuar nga) Achim v. Stechow; Dieter Wunderlich. Berlin/New York, 1991, fq 1-24.

Lyons, John, *Semantics*. Cambridge, 1997.

Lloshi, Xhevat, *Njohuri mbi stilistikën shqiptare*, Tiranë, 1999.

Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë: Toena 1999.

Markovina, Irina, *Interkulturelle Kommunikation*, Frankfurt/Main, 1993.

Markovina, Irina/ Sorokin, Jurij Aleksandrovic, Interkulturelle Kommunikation: Eliminierung kulturologischer Lakunen, në, *Sprache, Kultur, Identität, Selbst- und Fremdwahrnehmung,* (botuar nga) Astrid Ertelt-Vieth, Frankfurt am Main, Peter Lang Verlag, 1993, f. 174- 178.

Markstein, Elisabeth, Erzählprosa, në: *Handbuch Translation*, Tübingen, 1998.

Marku, A., Një nobeliste për Shqipërinë, Gazeta Shqiptare, Online, 23. 11. 2013.

Memushaj, Rami, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, Dituria, 2002

Metscher, Thomas, *Herausforderung dieser Zeit: Zur Philosophie und Literatur dieser Zeit. Vorträge und Aufsätze*. Düsseldorf, (Beiträge zur marxistischen Theorie) 1989.

Miller, Georg A., *Wörter. Streifzüge durch die psycholinguistik*. Heidelberg, 1993.

Morris Charles, W., *Grundlagen der Zeichentheorie*, München, 1972.

Motsch, Wolfgang, *Zur Kritik des sprachwissenschaftlichen Strukturalismus, Sprache und Gesellschaft 3*, Berlin, 1974.

Müller-Richter, Klaus/Larcati, Arturo (botues), *Die Streit um die Metapher. Poetologiche Texte von Nietsche bis Handtke.* Mit kommentierenden Studien. Darmstadt, WGB, 1998.

Neubert, Albrecht, *Arten der lexikalischen Bedeutung*, në, LS/ZISW/A. 45, 1978.

Neumann, Werner, Zeichen, Gedanke, Handlung: Zur linguistischen Fassung des Zeichensbegriffes, në, *LS/ZISW/A 10*, 1974,

Neumann, Werner et al, *Theoretische Probleme der Sprachwissenschaft*. Teilband 2. Berlin, 1976.

Nogales, Patti, D., *Metaphorically speaking*, Stanford, Ca: Standford Univ., 1999.

Nuyts, Jan, *Epimestic, modality, language und conceptualization. A cognitive pragmatic perspective*. Amsterdam, Benjamin, 2001.

Palm-Meister, Christine, *Phraseologismen. Eine Einführung*. Tübingen, Narr, 1997.

Panasiuk, Igor, *Kulturelle Aspekte der Übersetzung,* Münster, LIT Verlag, 2005.

Panasiuk, Igor, *Perspektiven der Anwendung des Lakunen-Modells in der Translationswissenschaft*, Münster, 2005.

Përnaska, Remzi/Plangarica, Tomorr, Mbi disa skaje filozofike-logjike-gjuhësore në

fushën e sintaksës së shqipes, teorisë së të thënit/pragmatikë dhe gjuhësisë tekstore, në, Konferencën Shkencore Ndërkombëtare "*Terminologjia në shkencat e ligjërimit"*, Elbasan, 2013, f. 6.

Pinkal, Manfred, Kontextabhängigkeit, Vagheit, Mehrdeutigkeit, në, *Handbuch der Lexikologie*, Königstein/Ts. 1985, (botuar nga) Christoph Schwarze/ Dieter Wunderlich, f. 27-63.

Pinkal, Manfred, Vagheit und Ambuguität, në, Semantik: *Ein Handbuch des zeitgenössischen Forschung. Semantik*, (botuar nga) Arnim von Stechow/Dieter Wunderlich Berlin; New York, 1991.

Pinker, Steven, *The Language Instinct: How the Mind Creates Language*. New York: HarperCollin, 2007.

Piper, Klaus, *Lesen heißt doppelt leben*, München, 2000.

Plangarica, Tomorr, *Në tekst për tekstin. Studime*. Elbasan, Sejko 2002.

Plangarica, Tomorr, Mbi invariantet kohore-aspektore të së pakryerës, së kryerës së thjeshtë dhe së kryerës në gjuhën shqipe, në, *Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me rastin e 100-vjetorit të lindjes së studjueses Agnija Desnickala, Shën Petersburg, Rusi, 23-30 shtator, 2012*.

Plangarica, Tomorr, Mbi lidhjet e gjuhësisë me letërsinë në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe letërsisë. në, *Konferenca e parë ndërkombëtare Arsimore e Shqipërisë, 7-8 dhjetor, 2012*.

Pohl, Inge, Identifikation und Wirkungsweise der semantischen Implikation soziokulturellen Hintergrundwissens (Teil I), në, *Sprachsystem und sprachliche Tätigkeit*. Festschrift zum 65. Geburtstag von Karl-Ernst Sommerfeldt, (botuar nga) Gerhard Bartels/ Inge Pohl , Berlin, Bern, New York, Paris, Wien (Sprache – System und Tätigkeit 2),.

Pohl, Inge, Identifikation und Wirkungsweise der semantischen Implikation soziokulturellen Hintergrundwissens (Teil II), në, *Studien zur Semantik*. (botuar nga) Gerhard Bartels/ Inge Pohl G. Bartels, Frankfurt a. M./ Berlin/ Bern/ New York/ Paris/ Wien (Sprache, System und Tätigkeit 4), 1992.

Polenz, Peter v., *Deutsche Satzsemantik*. Berlin/New York, 1988.

Radtke, Burkhard, *Metapher und Wahrheit*, Berlin, Logos, 2001.

Raul, Lilo, Contact de langues et emprunts dénotafis et connatatifs, në, *Interkulturalität in Forschung und Lehre*, Oberhausen, Athena, 2010.

Raymund, Wilhelm, *Die Sprache der Affekte*, Tübingen, 2001.

Rastier, François, *Sens et textualité*, Paris, Hachette, 1989.

Reichmann, Oskar, Historische Lexikographie, në, *Sprachgeschichte. Ein Handbuch zur Geschichte der deutschen Sprache und ihrer Erforschung*, (botuar nga) Werner Besch/ Oskar Reichmann/ Stefan Sonderegger, 1. Halbband, Berlin, New York 1984, fq. 460-492.

Reiß, Katharina, Veermer,Hans, *Grundlegung einer allgemeinen Translationstheorie*, Tübingen, Niemeyer, 1991.

Ricoeur, Paul, *La metafore vive*, 1975.

Ricoeur, Paul *Die lebendige Metapher*, München, Fink, 1986.

Rieger, Burghard, *Unscharfe Semantik: die empirische Analyse, quantitative Beschreibung, formale Repräsentation und prozedurale Modellierung vager Wortbedeutungen in Texten*. Frankfurt/M., Bern; New York; Paris, 1990.

Risku, Hanna, *Transalatorische Kompetenz. Kognitive Grundlagen des Übersetzens als Experimenttätigkeit,* Tübingen, Staufenberg, 1998.

Roos, Eckhard, *Idiom und Idiomatik. Ein sprachliches Phänomen im Lichte der kognitiven Linguistik und der Gestalttheorie*. Aachen, Shaker, 20012.

Rousseau, Jean –Jacques, *Essai sur l'origine des langues. Texte établi et annoté par* Ch. Porset. Bordeaux, Ducros, 1968

Rrokaj, Shezai, *Strukturalizmi klasik në gjuhësi*, Tiranë, Shblu, 2002.

Sadiku, Emine, *Kadareja ky stilist i madh,* Tiranë 2000.

Sadiku, Gladiola, Sprach- und Kulturgebundenheit der Metapher, në, *Sprachendiversität und Interkulturalität, Oberhausen,* Athena, 2013.

Sadiku, Gladiola, Eine Untersuchung von Beziehung zwischen Emotionen und Sprache am Beispiel einiger ausgewählter Begriffe (Konzepte) im Deutschen und Albanischen, në, *Emotionen in Sprache und Kultur*, Ljubljana, 2012

Saussure, Ferdinand, *Cours de linguistique generale*, Lausanne und Paris, 1916.

Saussure, Ferdinad, *Cours de linguistique generale*, Lausanne und Paris, 1931.

Schaller, Helmut, W., *Die Balkansprachen,* Heidelberg, 1975.

Schippan, Thea, *Einführung in die Semasiologie*. Leipzig, 1975.

Schipann, Thea, *Arten der lexikalischen Bedeutung*. In: LS/ZISW/A. 65, 1980.

Schippan, Thea, *Bedeutung als Wissenskomplex*, në, PF, R. A, 82, 1986.

Schippan, Thea, *Probleme der semantischen Analyse,* në, *Germanistische Mitteilungen, 27,* 1988.

Schippan, Thea, *Lexikologie der deutschen Gegenwartssprache.* Niemeyer,1992.

Schneider, Stefan, *Eine Studie zur Musikalität der Lyrik*, Berlin 2009.

Schröder, Harmut, *Lakunen und die latenten Probleme des fremdkulturellen Textverstehens*. Anwendungsmöglichkeiten eines Modells der Enthnopsycholinguistik bei der Erforschung tesxtueller Aspekte bei der internationalen Produkterforschung, në, Sprache und Kultur in der internationalen Marketingkommunikation, (botuar nga) Bungarten, Theodor, Tostedt, (Antikon), 1994, f. 180- 202.

Schwaz-Friesel, Monika, *Indirekte Anapher. Studien zur domänenegebundenen Referenz und Kohärenz im Deutschen*. Tübingen, Niemeyer, 2000.

Schwarz-Friesel, Monika, Kohärenz versus Textsinn. Didaktische Facetten einer linguistischen Theorie der Kontinuität, në, *Angewandte Linguistik. Perspektiven für den Deutsch- und Fremdsprachenunterricht,* (botuar nga) Ziegler, Arne/Scherner, Maximilian, Tübingen, Narr, 2006.

Schwarz-Friesel, *Sprache und Emotion*, Tübingen, A. Francke,2007a.

Schwarz-Friesel, Monika/ Skirl, Helge, *Metapher,* Heidelberg, Universitätsverlag, 2007.

Schwarz-Friesel, Monika, *Einführung in die Kognitive Linguistik.* 3., vollständig überarbeitete und erweiterte Auflage. Tübingen, A. Francke, 2008.

Schutte, Jürgen, *Einführung in die Literaturtheorie*. Metzler, 2005.

Serebrennikow, B. A et al., *Allgemeine Sprachwissenschaft: Existenzformen, Funktionen und Geschichte der Sprache*. Bd. I, München/Salzburg, 1973.

Skirl,Helga, Metaphorical Anaphors. A Phenomenon of the Sematics-Pragmatics Interface, në, *Anaphors in Texts*. *Cognitive, formal and applied approaches to anaphoric reference.* (botuar nga) Schwarz-Friesel, Monika/ Consten, Manfred/ Knees, Mareile, Amsterdam, Philadelphia, Benjamins, 2007.

Skirl, Helge, *Emergenz als Phänomen der Semantik am Beispiell des Metapherverstehens. Emergenz konzeptuelle Merkmale an der Schnittstelle von Semantik und Pragmatik,* Tübingen, Gunter Narr Verlag, 2009.

Sorokin, Jurij Aleksandrovic, *Lakunen – Theorie. Zur Optimierung interkultureller Kommunikation,* në, *Sprache, Kultur Identität,* (botuar nga) Astrid Ertelt-Vieth Frankfurt/Main, Berlin, 1994, f. 167- 178.

Stolze, Radegundis, *Hermeneutisches Übersetzen*, Gunter Narr Verlag, 1992.

Trabant, Jürgen, *Historische Antropologie der Sprache*, Frankfurt am Main, 1998.

Thomai, Jani, Krijimtaria gjuhësore e shkrimtarit shprehje e prirjeve të tij ideore dhe

stilistike, në, *Drita*, 25.01.1987, Tiranë, 1987.

Thomai, Jani, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989.

Thomai, Jani, *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1991.

Thomai, Jani, *Leksikolgjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2005.

Ullmann, Stephen, *Semantics. An Introduction on the Science of Meaning*. Oxford, Basil Blackwell.

Varfi, Nonda, *Introduction à la lexicologie du français*, Lausanne, Ecole de français moderne, 1999.

Varfi, Nonda, *Mbi huazimet e shqipes*, në, Rreth huazimeve në shqipen standarde. Akte të seminarit të tretë. Tiranë, 2004.

Vehbiu, Ardian, *Fjalët e huaja, neologjizmat dhe ligjërimi*, në, Gjuha Jonë 1, Tiranë, 1986.

Vermeer, Hans J., *Aufsätze zur Translationstheorie*, Heidelberg, 1983.

Wengeler, Martin, *Linguistik als Kulturwissenschaft*, Hildesheim et al., Olms, 2006.

Weinrich, Harald, Für eine Literaturgeschichte des Lesers, në, *Literatur für Leser*, (botuar nga) Harald Weinrich, Stuttgart, 1970.

Wilhelms, Gottfried, *Die Metapher – „Kern um Wesen aller Poesie“ oder „Schminke, Parfüm“? Zur Problematisierung der bildlichen Rede in der modernen Literatur*, në, Deutsche Viertelsjahrbericht 62, f. 549-569.

Wittgenstein, Ludwig, *Prototractus: En Early Version of Tractatus Logico-Philosophicus*, London Routledge/ Kegan Paul, 1971.

Wolf, Dieter, Zur Vagheit in der Entwicklung der Sprachzeichendeutung, në, *Diachrone Semantik und Pragmatik: Untersuchungen zur Erklärung und Beschreibung des Sprachwandels*, (botuar nga)Busse, Dietrich, Leipzig, 1991, fq 101-115.

Wolfski, Werner, *Schlechtbestimmtheit und Vagheit. Tendenzen und Perspektiven.* Tübingen, 1980.

Wotjak, Gerd, *Bedeutung und Wissenskonfiguration: Eine Quadratur des Kreises oder wie löst man den Gordischen Knoten*, në, ZfG, 8, 1987

Xhuvani, Aleksandër, *Vepra I*, Tiranë 1980.

Adresa interneti

bibelwissenschaft.de/online-bibeln/luther-bibel-1984

Mala, Jiřina, Stilistische Funktionen der Phraseologismen in publizistischen Textsorten, URL**:** www.phil.muni.cz/stylistika/studie/publizistischen.doc. Zugriff vom 25.08.2008

Rüth, Lisa, Die Skopostheorie nach Reiß/Vermeer: Ein Überblick, Url, http://www.academia.edu/405115

Sadikaj, S. Metaphorische Konzepte in somatischen Phraseologismen des Deutschen und Albanischen. http://www.opus-bayern.de/uni-wuerzburg/

Toska, Teuta, Përfaqësimi i përvojës shqipfolëse në gjuhë te njësitë frazeologjike, Doktoraturë, Tiranë, 2012, http://www.doktoratura.unitir.edu.al/

Vepra

Kadare, Ismail, *Kështjella*, Tiranë, 1981.
De Siati, Giuseppe, *Die Festung*, Frankfurt am Main, Wien, 1988.
Kadare, Ismail, *Kronikë në gur,* Tiranë, 1981
Kadare, Ismail, *Koha e shkrimeve*, Tiranë, 1981
Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur,* 1981.
Buchholz, Oda/Fieder, Wilfried, *General der toten Armee*, München, 1988.
Röhm, Joachim, *General der toten Armee,* Tiranë, 1981
Kadare, I. *Prilli i thyer,* 1981.
Röhm, Joachim, *Der zerrissene April*, Frankfurt am Main, Fischer, 2003.
Kadare, I. *Dimri i madh*, Tiranë, 1981
Kadare, Ismail, *Darka e gabuar, Tiran*ë, 2008
Röhm, Joachim, *Ein folgenschwerer Abend*, Zürich, Amman Verlag, 2010.

Fjalorë

Duden Grammatik, Band 4. Mannheim, 2005.
Duden Redewendungen, Band 11
Duden, Universal Wörterbuch, 1996.
Fjalori Enciklopedik Shqiptar. Tiranë, 1984.
Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe. Tiranë, 2007.
Fjalori frazeologjik gjermanisht-shqip, Tiranë, 1998
Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe, 2005.
Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, Tiranë1980.
Fjalori i Shqipes së Sotme Shqipe, Tiranë 2002.
Le Petit Robert. Dictionnaires Le Robert, 2004.
Lexikon der Redensarten. Herkunft und Bedeutung deutscher Redewendungen, Gütersloch/München, 2005
Lexikon der Sprachwissenschaft, Stuttgard, 2002
Linguistisches Wörterbuch. Heidelberg, Wiesbaden (3 Bde.), 1990.
Wahrig. Deutsches Wörterbuch, Bertelsmann 1984.

Abstrakti

Shqyrtimet, analizat dhe interpretime tnë këtë punim janë bërë nga këndvështrimi, metodologjitë, kategoritë dhe konceptet e ofruara nga gjuhësia përqasëse/kontrastive, gjuhësia e tekstit, pragmatika, semantika e tekstit,... etj.; në fokus të shqyrtimeve janë vënë disa prej veçantive më të spikatura leksiko-semantike në prozën e shkrimtarit, të ndriçuara nga aparati konceptual i këtyre dijeve. Dukuritë më të spikatura kanë qenë ato që ngjizen përmes përftesave të ndryshme gjuhësore, stilistike e pragmatike, të cilat lidhen me sfondin sociokulturor, ato që formësohen prej lidhjeve kuptimore të fjalëve dhe përdorimeve të tyre, duke përftuar ngjyrime të niveleve të ndryshme (metaforat, metonimitë… etj.), ose përdorimet idiomatike të natyrave të ndryshme, që në procesin e kontekstualizimit dhe përdorimit me shije e intuitë të spikatur gjuhësore, ngarkohen sërish me domethënie, ngjyrime dhe vlera estetike. Interpretimet përmes analizës komponenciale ose semike, të pranishme në këtë punim, janë bërë në funksion të domethënieve që përftohen në hapësira më të gjera se fjala: në thënie, në tekst. Nga analizat e bëra arrijmë në konkluzionin që vlerat e mirëfillëta gjuhësore-estetike të përzgjedhjeve leksiko-semantike të Kadaresë, përveçse kanë përftuar një univers të tërë vlerash në tekstin shqip, kanë nxitur përpjekjet dhe përzgjedhjet gjuhësore të përkthyesve, teksti i të cilëve herë përngjashmon me imazhet dhe domethëniet e tekstit në shqip dhe, herë të tjera, ka sjellë suksesshëm gjurmët e një konceptualizimi të përftuar nga gjuha dhe kultura gjermane. Në çdo rast, tharmi ekzistues në tekstin e Kadaresë ka nxitur dhe ngjizur vlera të shumëfishta në procesin e receptimit në të dyja gjuhët.

Fjalë kyçe: gjuhësi teksti, gjuhësi përqasëse/kontrastive, gjuhësi konjitive, stilistikë, pragmatikë, semantikë teksti, diskurs letrar, *sfond sociokulturor, dukuri ikastike/evokuese, kuptim teksti, zhvendosje e figurshmërisë, shtresë leksikore, lakunë leksikore, metaforë, somatizëm.*

Abstract

Reviews, analysis and interpretations found in this work are made from the perspective, methodologies, categories and concepts offered by contrastive linguistics, text linguistics, pragmatics, the semantics of the text, ... etc..; The focus of the reviews have been some of the most salient lexicon-semantic characteristics in the writer's prose, lit by the conceptual apparatus of knowledge. The most remarkable phenomena have been those deriving from different linguistic, stylistic and pragmatic sources which relate to the socio-cultural background, those who are shaped from semantic connections of the words and their uses, thus acquiring overtones of different levels (metaphors, metonymy ... etc.), or idiomatic uses of various natures, that in the process of contextualization and prominent linguistic intuition, are again charged with meaning, colorings and aesthetic value. Interpretations through componential analysis, present in this paper, are made in view of meanings obtained in larger spaces than the word: in statements, in the text. From the analysis conducted, we conclude that the mere linguistic-esthetic values of Kadare's lexicon-semantic choices, apart from having obtained an entire universe of values in the Albanian text, have spurred efforts and linguistic choices of translators, whose texts on some occasions resemble with images and meanings of the text in Albanian and, on other occasions, have successfully brought traces of a conceptualization derived from the German language and culture. In any case, the existing yeast in Kadare's text has promoted multiple values in the process of reception in both languages.

Keywords**: text linguistics, contrastive linguistics, cognitive linguistics, stylistics, pragmatics, text semantics, literary discourse,** *socio-cultural background, evocative occurrence, text understanding, figure shift, lexical layer, lexical lacunae, metaphor, somatic phraseologisms*